



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

POLITIKA GJUHËSORE MBI PAKICAT NË BALLKAN: ARRITJE DHE PERSPEKTIVA

UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËSISË

AKTE

TË

KONFERENCËS SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

POLITIKA GJUHËSORE MBI PAKICAT
NË BALLKAN:
ARRITJE DHE PERSPEKTIVA

Maj 2022

POLITIKA GJUHËSORE MBI PAKICAT NË BALLKAN: ARRITJE DHE PERSPEKTIVA

*(Përmbledhje e akteve të konferencës shkencore ndërkombëtare,
organizuar më 12 nëntor 2021 në Korçë)*

KOMITETI SHKENCOR I KONFERENCËS:

Prof. dr. DHIMITRI BELLO, Universiteti i Korçës
Prof. dr. SHEZAI RROKAJ, Universiteti i Tiranës
Prof. dr. ALI JASHARI, Universiteti i Korçës
Prof. as. dr. JONELA SPAHO, Universiteti i Korçës
Prof. dr. BERTON SULEJMANI, Universiteti i Tetovës
Prof. dr. ALJULA JUBANI, Universiteti i Tiranës
Prof. dr. KRISTINA JORGAQI, Universiteti i Tiranës
Prof. dr. MIMOZA GJOKUTAJ, Universiteti i Tiranës
Prof. dr. MIMOZA KORE, Universiteti i Tiranës
Prof. as. dr. ELONA ÇEÇE, Universiteti i Korçës
Prof. as. dr. ANYLA SARAÇI, Universiteti i Korçës
Phd. Daniela CARMEN STOICA, Universiteti i Korçës

KOORDINATORË TË KONFERENCËS:

Prof. as.dr. ROZANA RUSHITI, Universiteti i Tiranës
Msc. LONORA HYSOLLI, Universiteti i Korçës

REDAKTIMI GJUHËSOR DHE PËRGATITJA PËR BOTIM:

Msc. Eftiona Bylykbashi, specialiste e botimeve, Universiteti “Fan S. Noli”

Botim elektronik

ISBN 978-9928-4731-1-0

TABELA E PËRMBAJTJES

KRONIKË	6
KONSTANTINOS D. DINAS	7
GREEK LANGUAGE AND ITS DIDACTIC.....	7
SEANCA I	15
POLITIKA GJUHËSORE PËR PAKICAT KOMBËTARE DHE PLANIFIKIMI GJUHËSOR.....	15
PROF. DR. SHEZAI RROKAJ	16
AREALI SHQIPFOLËS: SHQIPJA SI GJUHË ZYRTARE, GJUHË PAKICE KOMBËTARE A GJUHË NË RREZIK	16
PROF. DR. ALI JASHARI	49
A KA NJË “CONTRADICTION IN ADJECTO” MES SHQIPES DHE TË FOLMEVE TË SAJ?.....	49
PROF. DR. BERTON SULEJMANI; PROF. DR. IZMIT DURMISHI	61
ARRITJET DHE PROBLEMET E ZBATIMIT TË GJUHËS SHQIPE NË INSTITUCIONET SHTETËRORE DHE PRIVATE TË MAQEDONISË SË VERIUT	61
PROF. AS. DR. SEJDI GASHI	76
RRJEDHAT E PLANIFIKIMIT GJUHËSOR NË KOSOVË DHE STATUSI I SHQIPES GJATË VITEVE 1999-2021.....	76
PROF. DR. MIMOZA KORE	85
LIGJI PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË RMV DHE SFIDAT E STATUSIT TË SHQIPES STANDARDE NË KONTEKSTIN E RI.....	85
Prof. Dr. Hamit Xhaferi	94
KOMUNIKIMI NDËRKULTUROR DHE QËNDRIMI NDAJ KUMTIMIT LETRAR DHE ARTISTIK	94
DR. ELSA SKËNDERI RAKIPLLARI	100
PRANI DHE MUNGESA TË POLITIKAVE GJUHËSORE NË PEIZAZHIN LINGUISTIK.....	100
.....	112
PROF. AS. DR. ABDURRAHIM MAXHUNI	118
POLITIKAT GJUHËSORE DHE TRASHËGIMIA ISLAME NË GJUHËN SHQIPE	118
DR. BESNIK RAMA; DR. ALBANA TAHIRI	129
GJUHA, GLOBALIZIMI DHE DIVERSITETIKULTUROR.....	129
PHD. ILIA BELLO	146
MBI DISA PROBLEME TË PAKICAVE ETNIKE BALLKANIKE DHE TË DREJTAT E TYRE GJUHËSORE.....	146
DR. ERIS DHAMO; MIRANDA HYSA; ANILA SULAJ	155
TË KUPTOJMË NDIKIMIN E POLITIKAVE MULTIKULTURORE	155

DR. ERIS RUSI	172
GJUHA ALEGORIKE E FRANC KAFKËS DHE ISMAIL KADARESE	172
PROF. DR. QEMAL MURATI	185
E DREJTA NATYRORE VS E DREJTA LIGJORE PËR GJUHËN	185
NË MAQEDONINË E VERIUT	185
SEANCA II	200
GJUHËT NË KONTAKT.....	200
PROF. DR. DHIMITRI BELLO	201
NE DHE TË TJERËT- NGJASHMËRI, NDRYSHIME DHE PARAGJYKIME.....	201
AKAD. KRISTINA JORGAQI	211
A ËSHTË GJUHA ROME NË SHQIPËRI NJË GJUHË E RREZIKUAR?.....	211
PROF. DR. ARBËR ÇELIKU	232
PUSHTETI I GJUHËS NË SHOQËRITË E MARGJINALIZUARA. RASTI ME SHQIPTARËT E MAQEDONISË SË VERIUT	232
PROF. AS. DR. SPIRIDHULLA POÇI	243
AROMANISHTJA DHE GJENDJA E SAJ PËRBALLË GJUHËS SHQIPE	243
PROF. AS. DR. LINDITA XHANARI (LATIFI)	251
PAKICAT SHQIPTARE NË TURQI- PROBLEMATIKAT E KALUARA DHE ZHVILLIMET E REJA NË FAVOR TË SAJ	251
DR. ERZEN KOPERAJ	260
DR. ZAMIRA SHKRELI	260
GJUHA E FQINJIT – LIDHJE DHE NDASI.....	260
DR. ARDIAN DOKA	271
RRETH DISA EMËRTIMEVE TË SHQIPES SË FOLUR PËR PAKICAT	271
PROF. AS. DR. ELONA ÇEÇE (BIBA)	276
FAKTORËT SOCIOLINGUISTIKË DHE KAHU I NDËRNDIKIMIT FONETIK - ARGUMENTE QË SHËRBEJNË PËR TË PËRCAKTUAR PERSPEKTIVËN E ZHVILLIMIT TË BILINGUIZMIT SHQIP-VLLAHISHT NË ZONËN GJEOGRAFIKE TË RRETHIT TË KORÇËS.....	276
DR. HYSNIE HAXHILLARI (HYSKA)	290
NDËRTIME SINTAKSORE TË GJUHËVE NË KONTAKT: SHQIP-MAQEDONISHT-ARUMANISHT	290
DR. URTIS HARRI	305
ÇËSHTJE DHE PROBLEMATIKA TË PAKICAVE TURKE NË BALLKAN	305
SEANCA III	311
VARIETETET GJUHËSORE, GJUHA NË PËRDORIM DHE PROBLEME TË EDUKIMIT	311
PROF. AS. DR. ROZANA RUSHITI; DR. ILIRJANA NANO	312
E DREJTA E PËRDORIMIT TË GJUHËS DHE POLITIKAT ARSIMORE	

MBI PAKICAT NË SHQIPËRI.....	312
PROF. ASOC. NAIM BERISHA	327
SHQIPJA NË RRJEDHAT GLOBALIZUESE	327
PROF. AS. DR. ANILA ÇEPANI; PROF. AS. DR. ADELINA ÇERPJA	332
RRETH NJË PROJEKTI TË DIVERSITETIT GJUHËSOR DIGJITAL PËR PAKICAT NË BALLKAN.....	332
PROF. AS. DR. KLEDI SHEGANI	349
POLITIKAT NË ARSIM QË LEHTËSOJNË MËSIMIN E GJUHËS AMTARE TE FËMIJËT E EMIGRANTËVE TË KTHYER NË ATDHE	349
PROF. AS. DR. MIMOZA ZEKAJ	356
VËSHTRIM MBI FORMIMIN DYGJUHËSOR TË NXËNËSVE MINORITARË NË QARKUN E GJIROKASTRËS DHE ROLI I SHKOLLËS	356
PROF. AS. DR. ALBANA DEDA	365
PROBLEMATIKAT QË SHFAQ APLIKIMI I KRITERIT FONETIK TE PËRDORUESI	365
PROF. AS. DR. NEVILA KOÇOLLARI FURXHIU; DR. ERIS DHAMO	376
IDENTITETI NË FOKUSIN E KOMUNIKIMIT POLITIK PËR NDRYSHIM SOCIAL	376
PROF. DR. IRENA NIKAJ	405
KOMENTE RRETH MENDIMIT ANTIK, ZHVILLIMIT TË SHKENCËS DHE STUDIMEVE GJUHËSORE.....	405
DR. ELVIS BRAMO	415
KOMPETENCA GJUHËSORE E FËMIJËVE MINORITARË GREKË NË PROCESIN E MARRJES SË SHQIPES SI GJUHË E DYTË.....	415
MSC. LONORA HYSOLLI	423
GJUHA DHE DISKRIMINIMI GJUHËSOR.....	423

KRONIKË

Në datën 12 nëntor 2021 në Universitetin “Fan S. Noli” zhvilloi punimet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan: Arritje dhe Perspektiva”, një bashkorganizim i departamentit të Gjuhës dhe të Letërsisë, Universiteti “Fan S. Noli” me departamentin e Gjuhësisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës.

Seancën plenare e hapi rektori i Universitetit “Fan S. Noli”, prof. dr. Dhimitri Bello, i cili theksoi: *“Kjo konferencë organizohet edhe në kuadër të 50- vjetorit të këtij universiteti. Ajo do të sjellë punime mjaft interesante nga specialistët më të mirë të fushës, të cilët do të dalin me konkluzione konkrete për ndërmarrjen e projekteve të tjera në të ardhmen, në lidhje me politikën gjuhësore mbi pakicat në Ballkan”.*

Në emër të dekanit të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, në seancën plenare përshëndeti përgjegjësi i departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, prof. dr. Shezai Rrokaj. Ai tha se nga kjo konferencë do të dilet me ide të qarta mbi realitetin juridik të pakicave në Ballkan i kristalizuar me ligjet e vendeve përkatëse. Konferencën e përshëndeti më pas edhe znj. Kostandina Bezhani, kryetare e Komitetit për Pakicat Kombëtare, si dhe prof. dr. Berton Sulejmani, dekan i Fakultetit Filologjik i Universitetit të Tetovës. Në emër të departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë të Universitetit “Fan S. Noli” përshëndeti prof. dr. Ali Jashari.

Seanca plenare vijoi me kumtesën e prof. Fernando Ramallo (online nga Universiteti i Vigos), si dhe të prof. Kostandinos Dinas (online).

Konferenca i zhvilloi punimet në tre sesione paralele:

- I- Politika gjuhësore për pakicat kombëtare dhe planifikimi gjuhësor;
- II- Gjuhët në kontakt;
- III- Varietete gjuhësore, gjuha në përdorim dhe probleme të edukimit.

Korçë, 12 nëntor 2021

KONSTANTINOS D. DINAS

PROFESSOR OF LINGUISTICS

UNIVERSITY OF WESTERN MACEDONIA, GREECE

(KEYNOTE SPEAKER)

GREEK LANGUAGE AND ITS DIDACTIC

Address

Ladies and gentlemen, dear colleagues, thank you for the honorable invitation to be keynote speaker at your conference on an issue that has preoccupied and afflicted the countries and peoples of the Balkans for many years in the past. It is certain that we must discuss these issues free from nationalist and fanatical perceptions based on historical reality.

Precursory clarifications

The Balkans or Balkan Peninsula is, first, a geographical term, derived from the Turkish name of Mount Aimos (Koca Balkan Dağları) and refers to the area that was formerly known as the Illyrian or Greek Peninsula. It is, however, also a cultural term, referring to peoples who live in this area, some from the very old years, others moving from northern areas during the long historical time and others who passed through this geographical area with various qualities for some time and left their cultural imprint. A key element of this culturally heterogeneous but with many common features of Balkan society is the language(s) that have been spoken and are spoken during this long period of history.

Cultural unity is confirmed by the existence of a science, Balkanology or Balkan Linguistics (Sandfeld 1930), a term coined according to Romanesque or Germanic Linguistics, which studies the history, culture, and languages of the Balkan peoples. But while in the case of the Romanist or the Germanist the study concerns languages belonging to the same language family, it is not at all the case of the Balkan languages: Greek, Albanian, Bulgarian, Serbian, Romanian and Turkish. Let me clarify that I set the limits to the official languages of the Balkan states, since it is known that many other languages are spoken in the Balkan states, such as Gypsy, Aromanian, Pomak, Armenian, etc.

Turkish belongs to the large Turkish family of languages, all other languages belong to the Indo-European language family, but belong to very different

branches or are individual: modern Greek is a continuation of ancient Greek, which was not divided into several languages; Albanian also remained inseparable and according to some it represents modern Illyrian, according to others it represents Thracian; Bulgarian and Serbian are part of the group of Slavic languages, but with different typologies (synthetic versus analytical language); and finally, Romanian is a Neo-Latin, such as Italian, French or Spanish.

After all these, a question arises: if these languages are so different in their origin and with completely different structures, how is it possible for them to be part of a group and to be the object of study of Balkanology? The answer to this question is that these languages constitute what we call in Linguistics a language federation (Balkan Sprachbund), in other words they have in common several characteristics and share features that are either caused by the same language substrate or due to geographical proximity.

A necessary historical introduction

To understand the modern multilingual and colorful situation in the Balkans, it is necessary for me to refer briefly to the historical conditions that led us to where we are today. It is indisputable that in ancient times the dominant language of civilization was Greek with its various dialectal varieties, but mainly with the Attic dialect and the Hellenistic common, which was formed with the decisive political support of the Macedonian state of Philip II and Alexander the Great. Greek dominated almost completely in the southern part of the Balkan Peninsula - hence the term "Greek Peninsula" - with the other two important languages of that time, Illyrian, and Thracian, dominating in the northwestern and northeastern part respectively.

The arrival of Latin in the Balkans, together with the Roman troops and the conquest of the peninsula by the Romans, marked the first significant linguistic penetration into the area with many linguistic influences in all existing languages, influencing mainly the creation of the four languages of the Balkans: Romanian, Aromanian, Moglenic and Istro-Romanian. The second major milestone was the arrival of the Slavs and their language from the north, which accepted and exerted influences on the existing languages, but mainly created or contributed to the creation of the newer Slavic languages of the region, Bulgarian, Serbo-Croatian,

Slovenian, Pomak, etc. Finally, the arrival of the Ottomans and the spread of the Turkish language brought about a significant reorganization in the Balkan Peninsula, which caused significant changes in all the Balkan languages, mainly as the language of the Ottoman administration.

I invite you to imagine all this constant rearrangement of the population, language, and cultural scene throughout this long period by adding one more element: the political unity of this vast and linguistic-wise colorful space for a period beginning with the conquest of the peninsula from the Romans, in the 2nd BC. century, and ends with the creation of the Balkan nation-states after the two Balkan wars, in the early 20th century. This political unity was first ensured by the Roman Empire, which was followed by the Byzantine Empire and, finally, the Ottoman Empire until its dissolution. This politically unified space for two thousand years allowed the population within it to move with relative freedom and without seeking permission from the authorities wherever they thought they would provide better living conditions for their livestock or for themselves.

All the peoples, therefore, who speak these languages, apart from the Turks, continue, some more intensely and some less, the Byzantine tradition and remained for over a thousand years under a common ecclesiastical administration, that of the Ecumenical Patriarchate of Constantinople, so that in the end they are considered a single world with many common features. This reality justifies the first part of the question I put in the title of my speech: blessing, which I mean as “community / similarity in diversity”.

And I explain: many of the common features of the Balkan languages are explained by the long coexistence of the peoples of the Balkans. Animal husbandry, practiced by the Slavic-speaking, Roman-speaking and Albanian-speaking populations of the Balkans during the Middle Ages, seems to have played an important role. The constant movements of these populations favored the contact between foreigners and influenced the evolution of the Balkan languages. Although difficult to prove, the linguistic substrate should certainly not be ruled out, as it may explain how spoken Latin in the Balkans evolved into a different kind of neo-Latin language than in France or Spain.

The Balkan linguistic federation is mainly based on a cultural unity, as it is known that in ancient times the Balkan Peninsula was divided into two

geographical areas of cultural influence: the Latin zone, which included the Danube basin and the region up to Aimos and Black Sea; and the Greek cultural zone, which included the rest of the region, i.e., south of Skopje, west of Sofia and following the Danube to the Black Sea. The boundaries were set based on Latin and Greek inscriptions, it is known as the “Jireček line” (Jireček, 1911).

Greek culture, of course, exerted a tremendous influence on the Balkan peoples throughout Byzantine rule, when it gradually replaced the Roman culture influenced by Christianity and the Greek civilization, dominant in the region. Latin studies have been abandoned in the Eastern Roman state since the time of Justinian, and from the 8th century Greek became the only language of the “Romans-Romioi” and lingua franca of the entire Balkans at least. Based on Orthodoxy and not on “nationality” Byzantine culture acquires a remarkable power of assimilation of the peoples of the Balkans, to whom Greek culture and Orthodoxy were transmitted, a culture with ancient foundations and a church with ecumenical tendencies.

The Balkan linguistic-cultural unity

In this way, a unified Balkan culture was created based on the tangible fact of coexistence of the Balkan peoples. The peoples of the Balkans not only share spiritual creations but also have much in common in material culture: they have common types of dwellings, they practice the same professions, they have the same means of transport, they show similarities in women's and folk clothing, in carols, wedding customs, etc.

We can safely speak of a “common life” of the Balkan peoples up to a time very close to ours. With the acceptance of a common cultural type and with Greek as lingua franca, we came to believe that there is a cultural unity in the Balkans. There are, for example, myths-legends, which are widespread with various variations and local adaptations to all Balkan peoples. Indicatively we mention:

- the narrative folk song of “the dead brother”, with many Balkan variations.
- the Greek legend about the “Bridge of Arta” answers in Romanian about the church of Argeş (Biserica de Argeş).

- respectively with the acritic songs, which praise the struggles and achievements of Basil Digenes Akritas, are the Slavic songs that refer to the Slavic hero Marco Craljević.
- folk myths and legends also have a common expression in relation to ancient literature, which remains alive in Byzantium.
- perhaps most important is a common sense in the conception of nature: in fairy tales and songs still life speaks, birds bring all kinds of help, they convey messages of love.

Balkanisms - inter-Balkan linguistic elements

Also, languages, although very different in origin, present a unity reminiscent of related languages. The bilingualism of the Balkan peoples, in which the Greek language was usually one of the two terms, is the necessary hypothesis for the explanation of specific common linguistic elements. Apart from Turkish and often Serbo-Croatian, passing from one language to another we have the feeling that only the vocabulary changes, while the way of expression is the same.

For the economy of time, I will give the most common Balkanisms without a detailed presentation (cf. Banfi, E. 1985):

- correspondences between the phonetic systems of the Balkan languages: the vowels [a], [e], [i], [o], [u] are pronounced without phonological oppositions.
- presence of neutral vowel [ə], most likely substrate effect: in Bulgarian with Ъ, in Albanian with ë and in Romanian with ă.
- overlapping of genitive και dative case in Albanian, Bulgarian, Romanian, Greek.
- post - position of the article in Romanian, Albanian and Bulgarian
- analytical types of the degrees of comparison of adjectives in Bulgarian, Romanian and Greek
- complete loss of the infinitive in Greek and Bulgarian and partial loss in Romanian, Serbo-Croatian, and southern Albanian varieties
- formation of periphrastic future tense with a part of the verb “θέλω” (= want) + infinitive in Greek, Albanian, Bulgarian, Romanian and Serbo-Croatian.

The question arises here: are these similarities coincidental? Certainly not. They prove through these few examples the unified way of approaching the world through the different but also so similar languages of the Balkan peoples. What a blessing, indeed!

Is linguistic diversity a problem?

If things were still as I described them in detail above, indeed the linguistic diversity in the Balkans would be like a colorful meadow with all the flowers in bloom. But things are changing for the worse since the time when (in the middle of the 19th century) the so-called Eastern Question, that is, the preparation of the states of the region to replace the collapsing Ottoman Empire by annexing and integrating as much of it as possible, took on great proportions and brought in disputes and armed conflicts the peoples who until then coexisted harmoniously. In this claim, the linguistic difference and / or similarity became one of the bases on which the nationalisms of the Balkan states were based, leading the peoples from friendship and harmonious coexistence to growing enmity and hatred between them.

Thus, the resemblance only of the Romanian language to the Aromanian of the Greek area - two of the languages of the Balkan Latin - was based on the claim of the Greek Vlachs (Aromanians) by the Romanians more as a bargaining chip in the imminent claim of the due to the non-existence of common borders of Romania with the Greek state. In the similarity of the Slavo-Macedonian of the Greek area with the Bulgarian language, Bulgaria supported similar claims of annexation of territories and populations that it considered to belong to it, leading to armed conflicts within the Ottoman —until then— territory known as Struggle in Macedonia with all the disastrous consequences for the populations and countries involved. This new reality, which intensified at the beginning of the 20th century and influenced the outcome of the two Balkan wars - and especially the second, resulted in the incrimination of language and the criminalization of speakers. The blessing of linguistic diversity turned into a problem as language and speakers became the “Apple of contention” between the Balkan states. The (new) states that emerged from the Treaty of Bucharest of 1913, which set the definitive —hopefully— boundaries between the Balkan states, had to be mono-ethnic, monocultural and, therefore, monolingual. Any deviation was a problem.

In this spirit, policies of linguistic assimilation of all foreign language populations within the Balkan nation-states were pursued and the use of a language other than the official state under the influence of a wrong but nevertheless followed political identification of language with the nation. Thus—to cite as an example only in the Greek case, which was of course not the exception—Greece, as recently impressively homogeneous linguistically and culturally, met the other "voice"—in terms of words such as culture—with two versions. The first concerned "islets" of stigmatized foreign language: other languages spoken within Greek territory, linked to strong devaluation stereotypes, leading to policies of marginalization and assimilation. The second version concerned, as language learning, the encounter with hegemonic European languages (formerly French, then English) and was associated with strong overvaluation stereotypes. The contact with the dominant European languages contributed to the confirmation of the European identity of the Modern Greeks. The need for this confirmation is linked to another very basic and critical phenomenon, the Language Issue. The overestimation of the archaic form of the Modern Greek Language as the preeminent one, in order to be the official national language, and the consequent underestimation of the spoken, mother tongue, vernacular, are connected with the historical need to confirm the European identity of the newly formed nation state. The vehicle of this confirmation was the ancient Greek heritage—language and culture—that had so much prestige in Western Europe.

This perception also had its educational imprint, as in all levels of education—but mainly in the first ones—a systematic effort was made to uproot the "other voice" either in the form of a foreign language to the Greek language or even on an interlingual level with the restriction and devaluation of the linguistic dialects and idioms of Greek (cf. Χριστίδης 2001: 264).

Things are changing, hopefully...

After realizing that the loss of languages around the world is accelerating, linguists, institutions, but also global organizations have taken initiatives to record and enhance and even revive endangered languages. So UNESCO in 1995 published the Red Paper on Endangered Languages and there is a strong possibility that in the coming years we will see an intensification of the

international effort to save languages that still have room for such a thing. This effort is part of a more general attitude and a new “communication ethic” is now being produced, where diversity represents a challenge. Diversity is maintained and encouraged in all areas of social interest and different ways of approaching problems are supported, different sensitivities are manifested for dealing with the future. The interest for its preservation and development is being cultivated more and more and the right to difference is emphasized. Recently, in parallel with the activities for the protection of the environment (cf. the World Wildlife Fund for the conservation of biodiversity), a special interest is developing for the “endangered”, “less widespread”, “less spoken”, “patients”, “minority”, “heritage languages”, “indigenous” languages, etc.

Epilogue

In this internationally favorable climate in terms of linguistic diversity, do we in the Balkans - with all our "Balkan" peculiarities - could reverse this poor situation that I have described above in terms of preserving and - why not - strengthening language diversity? My answer is yes, provided that all the Balkan states accept that the borders in the Balkans must not be called into question and that bilingual population groups within the states will not be claimed by neighboring states on the sole basis of linguistic similarity. Thus, to be just one example, the Aromanians will be able to speak their language in all the Balkan countries —as it already happens— without be claimed from any other state than the one in which they belong and live. Such a policy will not create artificial minorities in the Balkans and will help the peaceful coexistence and cooperation of the peoples of the Balkans as in the good old days.

It remains for me to thank the organizers once again for inviting me to this excellent conference, and I hope that you have all found it a fruitful event!

Thank you for your attention!

Bibliography

- Banfi, E. 1985. *Linguistica balcanica*. Bologna: Zanichelli.
- Sandfeld, K. 1930. *Linguistique balkanique, problèmes et résultats*. Paris: Champion.
- Jireček, Konstantin, *Geschichte der Serben (The history of the Serbs)*, Gotha, 1911
- Χριστίδης, Α.-Φ. Γλωσσική Εκπαίδευση και γλωσσικός αποκλεισμός. In Κέντρο Ελληνικής Γλώσσας, *Εγκυκλοπαιδικός Οδηγός για τη Γλώσσα*, Θεσσαλονίκη. 2001.

SEANCA I

**POLITIKA GJUHËSORE PËR PAKICAT KOMBËTARE DHE
PLANIFIKIMI GJUHËSOR**

PROF. DR. SHEZAI RROKAJ

**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI I TIRANËS**

shezai.rrokaj@unitir.edu.al

AREALI SHQIPFOLËS: SHQIPJA SI GJUHË ZYRTARE, GJUHË PAKICE KOMBËTARE A GJUHË NË RREZIK

Abstrakt

Shqiptarët janë komb kryesisht i vendosur në Gadishullin Ballkanik: në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Në vijimësi territoriale trevat shqipfolëse janë në Serbi e Mal të Zi, pastaj në disa shtete të ish-Jugosllavisë, si: Kroacia, Bosnje-Hercegovina e Sllovenia. Në një shtetje më të gjerë se këto treva areali shqipfolës gjehet në shtete si: Rumania, Bullgaria, Ukraina dhe Turqia. Një vend të veçantë zenë entitet shqipfolës të hershme dhe të reja në Greqi dhe Itali, si dhe në shumë shtete, si: Austria, Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Suedia, Zvicra etj. Përtej kontinentit evropian areali shqipfolës shtrihet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada, Egjipt e Argjentinë. Sigurisht, nisur nga shumë faktorë, në një shpërndarje më pak domethënëse nga pikëpamja gjuhësore, gjuha shqipe, në trajtat e saj arkaike a moderne, ndeshet dhe në shumë shtete të tjera. Gjithandej, kudo ku ndodhen, shqiptarët dhe gjuha e tyre shqipe me gjithë mozaikun e saj vlerësohen në rreth 13 milionë folës, ku pjesa më rëndësishme ndodhet në Ballkan. Qasja jonë në këtë punim merr shtysë nga disa koncepte gjuhësore, të cilët veprojnë brenda një larmie faktorësh jashtëgjuhësorë historikë, gjeografikë, politikë, ekonomikë, socialë, të cilët do t'i vëmë në dukje rast pas rasti. Konceptet gjuhësore kryesore nga jemi nisur për trajtimin e këtij areali shqipfolës janë: Politikë gjuhësore, planifikim gjuhësor, gjuhë e mbrojtur, gjuhë e pambrojtur etj. Në këtë mënyrë, sipas vendeve ku flitet, punimi rreket të bëjë një klasifikim të këtij areali shqipfolës sipas tri koncepteve gjuhësore themelore: shqipja- gjuhë zyrtare, shqipja- gjuhë pakice kombëtare dhe shqipja- gjuhë në rrezik. Pa pretenduar arritjen e një punimi shterues kjo përpyekje vlen të shërbejë për të nisur nga ky këndvështrim, studime më të thella dhe më gjithëpërfshirëse të arealit shqipfolës, megjithë 'kurthet' që ngrihen në sipërmarrje të kësaj natyre prej larmisë së faktorëve, veçanësisë së vendeve, mjegullisë së viteve dhe vetë 'njeriut', bartës i fjalës shqipe dhe endacak, në sfidë me veten brenda territorit të tij dhe tjetrit, me gjuhë ndryshe, në territorin e vet.

Fjalët kyçe: areal shqipfolës; gjuha shqipe; pakicë kombëtare; planifikim politikë; gjuhësore

1. Hyrje

Shqiptarët janë një komb kryesisht i vendosur në Gadishullin Ballkanik: në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut. Në vijimësi territoriale trevat shqipfolëse janë në Serbi e Mal të Zi, pastaj në disa shtete të ish- Jugosllavisë si: Kroaci, Bosnje-Hercegovinë e Slloveni. Në një shtrirje më të gjerë se këto treva areali shqipfolës gjehet në shtete, si: Rumani, Bullgari,

Ukrainë dhe Turqi. Një vend të veçantë zenë entitet shqipfolëse të hershme dhe të reja në Greqi e Itali, si dhe në shumë shtete të tjera si: Austri, Britani e Madhe, Francë, Gjermani, Suedi, Zvicër etj. Përtej kontinentit evropian areali shqipfolës shtrihet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada, Egjipt e Argjentinë. Në një shpërndarje më pak domethënëse nga pikëpamja gjuhësore, gjuha shqipe, në trajtat e saj arkaike a moderne, ndeshet edhe në shumë shtete të tjera. Gjithandej, kudo ku ndodhen, shqiptarët dhe gjuha e tyre shqipe me gjithë mozaikun e saj vlerësohen në **rreth 13 milionë folës**, ku pjesa më rëndësishme ndodhet në Ballkan.

Qasja jonë për vëzhgimin e arealit shqipfolës merr shtysë nga disa koncepte gjuhësore që veprojnë brenda një larmie faktorësh jashtëgjuhësorë historikë, gjeografikë, politikë, ekonomikë, socialë, të cilët do t'i vëmë në dukje rast pas rasti. Konceptet gjuhësore kryesore nga jemi nisur për trajtimin e këtij areali shqipfolës janë: politikë gjuhësore, planifikim gjuhësor, gjuhë e mbrojtur, gjuhë e pambrojtur etj. Në këtë mënyrë, sipas vendeve ku flitet, punimi rreket të bëjë një klasifikim të këtij areali shqipfolës sipas tri koncepteve gjuhësore themelore: shqipja gjuhë zyrtare (kupto standarde), shqipja gjuhë pakice kombëtare dhe shqipja gjuhë në rrezik (GJNR). Pa pretenduar arritjen e një punimi shterues, gjë që i kapërcen synimet e këtij shkrimi, gjithsesi, kjo përpjekje vlen të shërbejë për të nisur nga ky këndvështrim studime më të thella dhe më gjithëpërfshirëse të arealit shqipfolës, megjithë 'kurthet' që ngrihen në sipërmarrje të kësaj natyre prej larmisë së faktorëve, veçanësisë së vendeve, mjegullisë së viteve dhe vetë 'njeriut', bartës i fjalës shqipe dhe endacak në ngarendje, në sfidë me veten brenda territorit të tij dhe në përjasje me tjetrin, me gjuhë ndryshe, në territorin e vet.

2. Politikë gjuhësore, planifikim gjuhësor

Me politikë gjuhësore, kuptohen nisma politike, kryesisht të shteteve shumëgjuhëshe, me qëllim përdorimin, zhvillimin dhe zbatimin e gjuhëve të veçanta si: njohja e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve të punës në organizma ndërkombëtare ose akte normative për mësimin e gjuhës së nënës tek emigrantët (...), si dhe mësimi i gjuhëve të huaja dhe mësimi në disa gjuhë (Bussmann, 2008). Ndërsa **planifikimi gjuhësor** ka lidhje me nisma gjuhësore me qëllim zgjidhjen e problemeve të komunikimit në një situatë gjuhësore njëgjuhëshe apo

shumëgjuhëshe. Siç do të shihet më poshtë, fillimisht studimet në fushën e politikave gjuhësore dhe të planifikimeve *ad hoc* synonin njësimin e 'gjuhëve zyrtare' shtetërore a kombëtare në vende me situata gjuhësore njëgjuhëshe, mandej studimet shkencore dhe ndërhyrjet shtetërore apo të organizmave ndërkombëtare kanë vënë në qendër të vëmendjes gjuhët e pakicave kombëtare, dialektet përballë trysnisë së gjuhëve zyrtare si dhe gjuhët në rrezik (GJNR).

Einar Haugen dallon dy tipe planifikimi: a) planifikim i statusit funksional të gjuhëve në shtetet shumëgjuhëshe hedh bazat për zgjedhjen e gjuhës kombëtare, zhvillon strategji përtëritjeje gjuhësore ose përkundër rrezikut të bjerrjes gjuhësore; b) planifikim i korpusit mbi të cilin ngrihen dhe zhvillohen normat e standardit, normat drejtshkrimore, normat gramatikore dhe fjalorët normativë, me qëllim orientimin e shkrimtarëve dhe folësve në një bashkësi gjuhësore johomogjene (Haugen, 1968).

Si rregull, politika gjuhësore, nëpërmjet ndërhyrjes së shtetit me kornizë ligjore i hap rrugën planifikimit gjuhësor, por lidhjet midis tyre janë të ndërsjella. Kjo sepse që të dyja anët konvergojnë në statusin ligjor, politik dhe shoqëror të gjuhës si gjuhë zyrtare kombëtare, gjuhë pune, gjuhë pakice, gjuhë e institucioneve shtetërore, e arsimit shkencës a gjuhë në rrezik etj.

Në shtete shumëgjuhëshe, me politikat e tyre gjuhësore ato mbështesin ose diskriminojnë gjuhët e pakicave, duke krijuar konflikte midis prestigjit të gjuhës zyrtare kombëtare a shtetërore dhe diskriminimin e gjuhëve të pakicave (Haarmann, 2001). Përveç kuadrit ligjor gjuhësor të vendeve të veçanta, **politikat gjuhësore në vende demokratike drejtohen nga institucione ndërkombëtare si: KE-ja, BE-ja, UNESCO-, OKB-ja** etj., të cilat mbështesin jo vetëm gjuhët zyrtare të komunikimit brenda shtetit a ndërmjet shteteve, por edhe gjithë diversitetin tjetër gjuhësor e kulturor të gjuhëve të pakicave, të gjuhëve në rrezik, të dialekteve a të folmeve brenda bashkësisë shtetërore.

E gjithë **qasja jonë ndaj arealit shqipfolës mbështetet në tri parime themelore**: Së pari, **parimi i të drejtës natyrore të qenies njerëzore** (e drejta natyrore e njeriut) sepse, para se gjuha të jetë një e drejtë ligjore ajo është një e drejtë natyrore. Pikësëpari, e drejta gjuhësore është në lidhje të ngushtë me idenë se te qeniet njerëzore ekzistojnë karakteristika natyrore universale që burojnë nga një mekanizëm mendor i lindur i cili drejton procesin e përvetësimit të gjuhës

amtare (Chomsky, *Knowledge*, 1986, Jackendoff, *Linguaggio*, 1999). Ndërsa ligjet në një shoqëri i referohen qenies njerëzore, gjuha është vetëqenia e saj. Së dyti, është **parimi i reciprocitetit ndërshtetëror a ndëretnik në qasjen e shteteve ndaj gjuhëve dhe kulturave të njëri-tjetrit**. Së treti, është **parimi i emancipimit demokratik të shoqërive tona**, ku gjuhët dhe kulturat nuk shihen në mënyrë diskriminuese, por si vlerë e shtuar dhe përfitim i ndërsjellë i shoqërive në kontakt.

2. Problematika e koncepteve “gjuhë zyrtare, gjuhë pakice kombëtare, gjuhë në rrezik”

2. 1. Shqipja gjuhë zyrtare dhe gjuhë pjesërisht zyrtare

Gjuha zyrtare dhe pjesërisht zyrtare shqipe përfshin Republikën e Shqipërisë, Republikën e Kosovës dhe pjesërisht Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në gjendjen e sotme gjuha **zyrtare (standarde) shqipe** përballlet me **disa dukuri** si: **shkëputja prej stereotipit ideologjik të peridhës totalitare të një pjese të rëndësishme të diskursit publik**, ku stereotipi gjuhësor u mbishtresëzua dhe dominoi sferën publike të komunikimit në rrafshet politike, shoqërore, kulturore, artistike, administrative etj. Bashkë me përmbysjen e sistemit komunist e gjithë kjo mënyrë të foluri, e mbështetur mbi dogmën, e ngulitur në gjuhë, në fjalorë, që përdorej në shkollë, në jetën e marrëdhënieve politike, shoqërore e kulturore, do të bjerrë gradualisht bashkë me përtëritjen e brezave të folësve, të cilët po krijojnë një tjetër sjellje gjuhësore publike (Rrokaj, Çështje 4).

Një dukuri tjetër pas viteve ‘90 është **heqja e barrierave kufitare shtetërore brenda truallit kombëtar**. Ky ndryshim ka krijuar mundësi të reja qarkullimi dhe komunikimi midis folësve, të cilët dalin prej vendbanimeve të tyre dhe lëvizin lirshëm bashkë me fjalën në gjithë territorin indigjen. **Lëvizja e lirë** ka krijuar realitete të reja gjuhësore brenda vetë arealit gjuhësor shqipfolës, duke vënë në pikëpyetje konceptet klasike të të folmeve, të dialekteve, sociolekteve etj (Rrokaj, Çështje 2).

Gjithashtu, nga pikëpamja teorike dhe empirike sot ka gjithmonë e **më pak kundërti lidhur me bazën njëdialektore toske mbi të cilën u ngrit standardi (gjuha zyrtare) i sotëm i gjuhës shqipe**, pa mohuar edhe efektin e konvergencës gjuhësore apo rolin ndihmëtar të gegërishtes. Debatimi mbi bazën

“mbidialektore” të standardit në Kongresin e Drejtshkrimit nxori në dritë disa aspekte si, bie fjala, vetë tradita administrative e gegërishtes në periudhën e Zogut, duke përfshirë edhe kryeqytetin në arealin gegë, gjë e cila mund të ishte një mundësi empirike dhe praktike për ngritjen dhe shtrirjen e një standardi me bazë substrati gegërishten. Për më tepër, vendimi politik në vitet '50 për moslejimin e gegërishtes së shkruar, ende pa u mbledhur e u vendosur në qendra akademike si: Kongresi (1972) apo në Konsultën e Prishtinës (1968), ishte një ndërhyrje politike, e cila solli pas viteve '90 në mënyrë të kuptueshme debate publike për Kongresin e Drejtshkrimit.

Në thelb koncepti ‘mbidialektor’ kishte të bënte vetëm me funksionin e standardit për gjithë arealin shqipfolës. **Baza dialektore ku mbështetëj standardi dhe funksioni mbidialektor gjithëpërfshirës janë dy koncepte të ndryshme që Kongresi nuk i ndau qartas**, duke lënë të kuptohej se meqenëse baza e standardit ishte kinse mbidialektore, për pasojë funksioni i tij i natyrshëm do të ishte mbidialektor. **Funksioni i standardit medoemos duhet të ishte gjithëpërfshirës kombëtar, por substrati mbi të cilin ngrihej ky standard ishte pa dyshim toskë.**

Gjithsesi, si proces dinamik, në kushtet e reja gjeopolitike, por edhe të zhvillimit të mendimit teorik, ky standard duhet të jetë sa më gjithëpërfshirës, duke synuar t’i afrohet gjuhës kombëtare. **Ngritja e Këshillit Ndërkademi** këto vite ka synuar të bëjë ndreqjet dhe plotësimet e nevojshme nga këndvështrimi i gjuhës në përdorim. Ndaj edhe nevoja për studime deskriptive gjithëpërfshirëse në vitet e fundit, përmes zhvillimit të **gjuhësisë së korpuseve**, duke synuar ngritjen e databejzëve të kompjuterizuar të gjuhës si bazë studimi, është rruga e duhur për të vëzhguar gjendjen e gjuhës në përdorim si dhe për të krijuar fjalorë e gramatika të mbështetura në korpuse, të cilat **njohin variacionin brenda gjuhës në një shkallë më të lartë**, duke vënë në përfaqje e në bashkëveprim normën preskriptive me normën deskriptive të “pranueshmërisë në përdorimin natyror të gjuhës” (Rrokaj: Konf. 2020).

Nga ana tjetër, **hapja e trevave shqiptare ndaj njëra-tjetrës, e kryesisht ndaj shoqërisë globale, ka krijuar një trysni të madhe të fjalëve dhe strukturave gjuhësore në standardin e shqipes**. Vala goditëse mbi standard është shumë më e fortë sesa aftësia qëndrestare (mbrojtëse) e tij për disa faktorë

si: procesi dinamik i vetë standardit për përsosje ndaj nevojave shoqërore për komunikim, kushtet e reja politike, sociale, kulturore, ekonomike dhe ndryshimi në perceptim i bashkësisë gjuhësore, forca dhe frekuenca e goditjes së gjuhës ardhëse, kohëzgjatja e goditjes, gjendja aktuale e përvetësimit të gjuhës standarde dhe hapësira njësuese në rrafshin gjeopolitik për të mënjeluar pengesat në një komunikim me frekuencë të lartë në këto tri shtete etj. Pragmatizmi për mbijetesë rrit nevojën për një komunikim global utilitar, duke ridimensionuar vetëdijen gjuhësore të idiomës kombëtare.

Sidoqoftë, siç theksojnë disa studiues (Hobsbawm 1996, Anderson 2000, Savoia GjJ, 2003), çdo gjuhë standarde (pra edhe shqipja) nuk mund të jetë e as nuk mund të maksimalizojë një kompromis shoqëror kombëtar, i cili realizon një komunikim të njësuar për gjithë masën e folësve, pavarësisht veçorive dialektore. **Identifikimi i gjithë gjuhës (shqipe) vetëm me standardin, duke e konsideruar si të vetmen ‘gjuhë’ komunikimi, nuk është i drejtë, as praktikisht e as teorikisht**, pasi kufizon hapësirën perceptuese të folësve dhe cenon diversitetin gjuhësor e kulturor të tyre në arealin shqipfolës.

Regjimet politike totalitare priren drejt **një politike gjuhësore të natyrës preskriptiviste**, që orientohet drejt **‘pastërtisë së gjuhës’ a ‘purizmit gjuhësor’**. Kjo vihet re në qëndrimin mohues ndaj fjalëve të huaja. Nga ana tjetër, sipas këtij këndvështrimi, gjuha zyrtare kombëtare u **imponohet gjuhëve të pakicave kombëtare apo edhe dialekteve të saj, duke i konsideruar këto varietete, si të folme deficiente, si copëzime a përthyerje në dëm të gjuhës dhe kulturës së njësuar kombëtare**. Në të kundërt, në sisteme demokratike politikat gjuhësore integrojnë dhe mbrojnë gjuhët dhe kulturat e pakicave si dhe të dialekteve apo varieteteve të tjera, të cilat shihen në frymën e legjislacionit evropian e ndërkombëtar si pjesë e pasurisë së trashëgimisë gjuhësore e kulturore. Mbi këto parime në shoqëritë demokratike ndërtohen edhe politikat arsimore (Profili 2015-2017). *Në këtë mënyrë, qëndrimi ndaj standardit shoqërohet me një tolerancë më të arsyeshme lidhur me efektet globale të huazimeve, duke i parë ato edhe në kahjen e një nevoje të një shoqërie të integruar dhe si një pasuri e ndërsjellë e trashëgimisë ndërkulturore (Blackwood, Tufi, 2015).*

Siç e përmendëm më lart, për sa i përket gjuhës shqipe ‘pjesërisht zyrtare’ në Maqedoninë e Veriut, i jemi përmbajtur **“Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve” (15 janar 2020)**. Nga pikëpamja e politikës gjuhësore ky ligj, në nenin 1, pikat 2, 3, përcakton se “gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në pajtim me këtë ligj.” Kjo është e detyrueshme në të gjitha nivelet qendrore të shtetit si: kuvendi (neni 4), qeveria (neni 5), institucionet qendrore (neni 6), emrat e institucioneve, vultat dhe zyrat rajonale (neni 7), simbole në kartmonedha, monedha, pulla postare, fletëpagesa, raporte, uniforma etj. (neni 8), procedura në drejtësi, gjyqësor (nenet 9, 10), ekzekutimin e sanksioneve (neni 11), evidencat amzë dhe dokumentet personale të udhëtimit (nenet 12, 13, 14), procesin zgjedhor (neni 15) emërtimet e shesheve dhe objekte të tjera, vendkalime kufitare (neni 16). Gjithashtu në pikëpamje të planifikimit gjuhësor në këtë ligj është përcaktuar edhe Agjencia për Zbatimin e Gjuhës (neni 18) si dhe Inspektoriati për Përdorimin e Gjuhëve (nenet 20, 21).

Megjithë arritjet e vlerësueshme të këtij ligji, në zbatim të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e ratifikuar me ligjin nr.8496, datë 3.6.1999 dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, siç jemi shprehur në raste të tjera (Rrokaj:Tetovë, 2019), **ky ligj në nenin 1, pika 4, në vetëqeverisjen lokale e shtrin efektin vetëm aty ku arrihet 20%-shi, kurse “Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve të cilat i flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësisive të vetëqeverisjes lokale”, të cilat medoemos nuk janë shqiptare.**

Ama, është fakt se pothuajse gjithë problematika e qytetarëve ushtrohet në territorin vendor, që do të thotë se realisht **ky ligj nuk ua njeh të drejtën e përdorimit të gjuhës shqiptarëve duke marrë si kriter 20 %-shin në plan shtetëror, kudo ku ata ndodhen, por vetëm në ato territore të vetadministrimit lokal, ku ata përbëjnë 20%. Po si i bëhet për ato komuna ku shqiptarët janë më pak se 20%, bie fjala, 19%, 18% apo 15%?**

Nga ana tjetër, nëpërmjet këtij ligji krijohet një problematikë e rëndë sociale, e cila haset në lëvizjen e lirë të qytetarëve në territor, pasi cenohet lëvizja e lirë demografike e shqiptarëve në hapësirën shtetërore maqedonase, sidomos në ato territore ku ata nuk përbëjnë 20%, ngase u duhet të përballen me ‘murin gjuhësor’

të vetëm gjuhës maqedonase zyrtare dhe humbin të drejtën që kishin për gjuhën e tyre në territorin ku më parë ishin 20%.

Mendojmë se duhet shkuar drejt zgjidhjes që parasheh përdorimin e gjuhës shqipe në gjithë shtrirjen shtetërore, pavarësisht faktit nëse në disa komuna ata janë më pak ose më shumë se 20%, dhe ky kriter të mos jetë kushtëzues për komunat ku shqiptarët janë më pak se 20%. Kjo sepse ushtrimi i të drejtës së përdorimit të gjuhës nga niveli qendror në atë vendor lë jashtë territore ku shqiptarët janë rezidentë me më pak se 20%. Kësisoj, për të tejkaluar këtë ngërç numerik të 20%-shit **është e nevojshme që në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në RMV të prevalojë e drejta e njeriut për arsimim në gjuhën amtare shqipe si e drejtë natyrore e qenies njerëzore.**

Siç e theksova më lart, e drejta për arsimim në gjuhën amtare është një e drejtë natyrore që lidhet me arsyen e qenësisë së qenies njerëzore. Është e drejtë themelore, jashtë çdo ideologjie e ca më pak e varur nga kritere numerike, si rasti në fjalë. E drejta themelore njerëzore, ku futet edhe gjuha, para se të jetë një e drejtë shtetërore ligjore ajo është një e drejtë në thelb, që buron prej vetë ekzistencës së qenies njerëzore.

2.2. Shqipja gjuhë pakice kombëtare

Termi ‘**pakicë kombëtare**’ mori një përdorim të gjerë në politikat gjuhësore të shteteve evropiane, përfshi edhe ato ballkanike, pas Konventës Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e ratifikuar me ligjin nr.8496, datë 3.6.1999. Sipas kësaj Konvente, nën ombrellën ‘pakicë kombëtare’ kuptohet përgjithësisht çdo diversitet gjuhësor, kulturor e fetar të etnive a komuniteteve (siç parapëlqehet sot), të cilat i kanë këto tipare ndryshe nga etnia që flet gjuhën zyrtare kombëtare. Termi ‘pakicë kombëtare’ ka krijuar paqartësi me koncepte që vijnë nga tradita shkencore. A është i drejtë, i plotë, gjithëpërfshirës dhe shkencërisht i përligjur koncepti ‘pakicë kombëtare’ për realitetet etnike me të cilat është në kontakt gjuha shqipe? Në traditën shkencore tek ne përcaktohen me termin ‘**minoritete**’ grekët, maqedonët dhe serbo-malazezët, kurse me termin ‘**pakicë etno-kulturore**’ janë trajtuar vllahët e romët. Boshnjakët dhe egjiptianët janë trajtuar si ‘**komunitete gjuhësore**’. Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë (Nr.96/2017) i përmbledh në një term të vetëm ‘pakicë kombëtare’, të tria këto entitete

gjuhësore. Siç do të shihet më poshtë, ky ligj njohu për herë të parë edhe pakicën bullgare.

Në Kosovë, Ligji nr. 03/L-047/2008, “Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës” **trajton si komunitete serbët, turqit, boshnjakët, romët, ashkalitë, egjiptianët, goranët dhe komunitete të tjera.** Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë që ‘lirisht të kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë kulturën dhe identitetin e tyre dhe të ruajnë e përmirësojnë elementët esenciale të identitetit të tyre, veçanërisht fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë e tyre kulturore.’ Sipas këtij ligji këto komunitete dhe personat që u përkasin atyre lirshëm kultivojnë, shprehin dhe zhvillojnë identitetet e tyre.

Në RMV, sipas Ligjit për Gjuhët me termin ‘pakicë kombëtare’ përfshihen shqiptarët, bullgarët, serbët, vllahët, turqit boshnjakët e ndonjë komunitet tjetër. Në fakt, deri më sot në literaturën studimore edhe në këtë shtet është folur për minoritete kombëtare, me të cilat identifikohen **shqiptarët, bullgarët dhe serbët, kurse vllahët, romët dhe turqit janë trajtuar si pakica etno-gjuhësore.** Kjo ndarje, e cila mbështetet mbi kritere historike, gjuhësore e kulturore, është mënjeluar në ligj përmes përdorimit të termit ombrellë *pakicë kombëtare* (alias gjuhë komuniteti). Futja nën një ombrellë është një deformim shkencor historik, etnik, kulturor, gjuhësor e gjeografik, i vetë këtyre ‘komuniteteve’ dhe i raportit të tyre me entitetin kombëtar, e bërë kjo kinse prej pragmatizmit *semplist* të plotësimit të këtij prioriteti të vënë si kusht prej Konventës Kuadër. Në qasjen historike dhe në traditën shtetformuese termi minoritet parakupton një pakicë kombëtare që ka vijimësi territoriale me trungun amë, në dallim nga pakicat e tjera që nuk kanë vijimësi territoriale, por ekzistojnë në formën e enklavave apo të shpërndara në territorin shtetëror a kombëtar.

Kurse elementet e përbashkëta identifikuese të pakicave kombëtare dhe minoriteteve mbeten gjithsesi **gjuha, kultura, feja** si dhe numri i vogël i folësve në raport me popullsinë shtetformuese, që shkon përreth 1 deri në 5%. Ky parashtrim na mundëson sqarimin nëse shqiptarët në MV janë pakicë kombëtare apo element shtetformues. Siç u theksua më lart, Ligji për Gjuhët i bën bashkë me komunitetet e tjera, madje në këtë ligj edhe termi ‘gjuhë shqipe’ nuk haset kërrkund. Ligji për Gjuhët ka vendosur kriterin numerik 20%, me të cilin bëhet

një dallim në disa të drejta që kombësitë përkatëse i fitojnë në nivel të qeverisjes qendrore dhe atë vendore, porse ai është mëdyshas për sa i përket dallimit në aspektin cilësor pakicë kombëtare/element shtetformues. Kjo do të thotë se koncepti element shtetformues, ndryshe nga komunitetet e tjera, i ravijëzon shqiptarët si pjesë e domosdoshme për qenien e shtetit; pa të cilët nuk mund të jetë shteti kudo, në gjithë shtrirjen shtetërore, si në nivel qendror dhe në atë vendor. Kurse në fakt, koncepti pakicë kombëtare në Ligj tkurret në vetëm përfitim të drejtash në nivel të vetadministrimit lokal dhe vetëm aty ku shqiptarët janë jo më pak se 20% në qeverisjen vendore.

2.2.1. Kriteri numerik për përcaktimin e entitetit gjuhësor

Përveç kriterëve përmbajtësore si gjuha, kultura dhe feja, që përdoren për përcaktimin e përkatësisë etnike dhe të statusit të saj si gjuhë zyrtare (pjesërisht zyrtare), gjuhë pakice kombëtare (entiteti shtetformues) a gjuhë në rrezik, siç do ta trajtojmë në vijim, duket sikur kriteri numerik është ai që bën dallimin midis këtyre realiteteve. Në fakt, gjuhët e pakicave kombëtare dhe më pak akoma ato të gjuhëve në rrezik, shkojnë pak a shumë **nga 1 deri në 5%** të popullsisë së shtetit. Mirëpo çështja e shifrave mbetet mjaft e luhatshme në shtete nacionaliste, kolonialiste a me ideologji të tjera totalitare, përfshi dhe **Ballkanin, ku ushqehen qëndrime antropofagjie apo antropoemie (Strauss, L. Claude. 1955) me prirje diskriminuese dhe asimiluese ndaj gjuhëve dhe kulturave në kontakt.** Në këtë mënyrë, pavarësisht faktit se në parimet e Konventës Kuadër përcaktohet se institucionet publike në nivel qendror dhe vendor mbledhin të dhëna në lidhje me identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare, mbështetur në të drejtën e vetidentifikimit të këtyre personave dhe në dokumentacionin e gjendjes civile, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të vendeve përkatëse, ky parim i vetëdeklarimit apo vetidentifikimit rezulton i pamjaftueshëm për të qartësuar e përcaktuar qenësinë si pakicë, apo edhe si element shtetformues. Në realitetin ballkanik mjaft qytetarë **për arsye të pragmatizmit për mbijetesë** po ndërrojnë nënshtetësi, kombësi, emër e fe, siç është, bie fjala, rasti i fundit me pasaportat e Bashkimit Evropian (maqedonas dhe shqiptarë që vetdeklarohen si bullgarë për hir të marrjes së pasaportës bullgare). Si dhe në shumë vende e rajone të tjera, pragmatizmi për mbijetesë përballë ofertës së shoqërisë globale po vë në dyshim qenien identitare të

qytetarit, duke i kthyer censuset në rezultate ‘të besueshme’ vetëm për shumicat në pushtet. Ndaj është e domosdoshme që të merren parasysh edhe kriteret historike e gjeografike, të cilat hedhin dritë mbi përkatësinë e tyre, duke u mbështetur në të dhëna mbi *usus*-in gjuhësor, kulturor e fetar rrënjësor.

Si në mjaft vende me problematika të tilla konfliktuale edhe në Ballkan, mbështetja për këto çështje vetëm te censusi, sido që në parim ai është një metodë vetëdeklarimi gjithandej e përdorur sot për të marrë të dhëna të ndryshme të popullsisë, përfshi edhe përkatësinë gjuhësore, vështirë se, edhe për shumë kohë, mund të na japë realitete etnike të sakta nga pikëpamja numerike. Kjo sepse, nga njëra anë ideologjizmi nacionalist, që lidhet me supremacinë dominuese të etnisë kryesore ndaj etnive numerikisht më të vogla dhe, nga ana tjetër, pragmatizmi utilitarist i globalizimit, ku qytetarët ndërrojnë edhe nënshtetësinë e madje edhe etninë në këmbim të një aspirote integruese në shoqërinë postindustriale, bëjnë që realitetet etnike edhe numerikisht të paraqiten të diskriminuara dhe të deformuara.

Në Ballkan, në Republikat e Shqipërisë, të Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut, shqipja është gjuhë zyrtare dhe pjesërisht zyrtare (RMV, në komunat ku shqiptarët përbëjnë më shumë se 20% të popullsisë). Mirëpo, **në katër komuna në Mal të Zi** (Ulqin, Tuz, Guci e Plavë), **dhe tri komuna në Serbi** (Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë) **gjuha shqipe trajtohet si gjuhë pakice kombëtare**. Në këto dy shtete, në zbatim të Kartës Europiane mbi gjuhët rajonale ose minoritare, gjuha shqipe është e mbrojtur me ligj në Serbi (2006) dhe Mal të Zi (2006).

Si gjuhë pakice kombëtare në këto shtete shqipja lidhet me trungun amë me vijimësi territoriale; folësit janë autoktonë dhe ajo është mbrojtur me ligj për sa i përket përdorimit të gjuhës dhe mësimin të saj në shkollë. Këtu vlen të qartësohet më tej koncepti ‘gjuhë e mbrojtur’. Ai nuk lidhet vetëm me faktin se shteti e mbështet dhe e mbron me politika gjuhësore si gjuhë pakice kombëtare, por pikësepari sepse folësit si përdorues aktivë janë autoktonë dhe në vijimësi territoriale me trungun amë. Si të tillë, janë mbrojtës *par excellence* të saj. Mbrojtësi i gjuhës është përdoruesi natyror i saj në territorin indigjen. Sidoqoftë, pavarësisht problematikave të krijuara dhe konflikteve të herëpashershme, politika gjuhësore e këtyre shteteve, ku shqipja është gjuhë pakice në përdorim,

i mbron qoftë edhe formalisht si të tilla, jo vetëm si pasuri kulturore, por si një e drejtë për t'u shkolluar e për t'u përdorur në jetën e përditshme etj.

2.3. Shqipja potencialisht ose realisht gjuhë në rrezik (GJNR)

Mirëpo, siç u theksua më lart, koncepti 'gjuhë e mbrojtur' për shqipen përballet me konceptin 'gjuhë në rrezik', ose 'potencialisht në rrezik'. Një gjuhë e rrezikuar është kur rrezikon të mos përdoret, pasi folësit e saj vdesin ose zhvendosen drejt një gjuhe tjetër. Humbja e plotë e gjuhës ndodh kur gjuha nuk ka më folës amë dhe bëhet një "gjuhë e vdekur". Një gjuhë e vdekur ende mund të studiohet përmes regjistrimeve ose shkrimeve, por është e vdekur ose e zhdukur nëse nuk ka folës të rrjedhshëm.

Zhvendosja e gjuhës më së shpeshti ndodh kur folësit kalojnë në një gjuhë të lidhur me pushtetin social ose ekonomik, në situata kolonializimi, globalizimi e nacionalizmi, sidomos aty ku trysnia antropofagjike dhe antropoemike sjell pasoja fatale asimilimi etnik.

Faza e parë në vdekjen e gjuhës është rreziku potencial, që ndodh kur një gjuhë përballet me një tryzni të fortë të jashtme, por ende ekzistojnë komunitete të folësve, të cilët e kalojnë gjuhën tek fëmijët e tyre. *Faza e dytë* është kur një gjuhë ka arritur fazën e rrezikimit, pra ka vetëm disa folës të mbetur dhe fëmijët të cilët, në pjesën më të madhe, duke kaluar te gjuha tjetër, nuk e mësojnë gjuhën amë. *Faza e tretë* e zhdukjes së gjuhës është kur një gjuhë nuk ka gjasa të mbijetojë edhe për një brez tjetër dhe së shpejti mund të zhduket. *Faza e katërt* është kur nuk ka më folës të rrjedhshëm.

Nisur nga ky këndvështrim po paraqesim një qasje të arealit shqipfolës, lëvizja e të cilit është ndikuar nga faktorë të ndryshëm historikë, politikë, ekonomikë, shoqërorë, hera-herës të përbashkët për disa shtete gjeografikisht afër njëri-tjetrit, por edhe të ndryshëm për shtete të tjera, ku ky areal shfaqet në formën e një diaspore të hershme apo një diaspore të re. Siç do të shihet në vijim, ndër faktorët më të rëndësishëm që kanë ndikuar në arealin shqipfolës janë pushtimi osman, Lufta e Parë Botërore, Lufta e Dytë Botërore, ish-Jugoslavia, ish-komunizmi/lëvizja e lirë dhe emigracioni kryesisht ekonomik. Le të ndalemi më poshtë:

2.3.1. Areali shqipfolës në Bosnje-Hecegovinë, në Kroaci, në Slloveni

Shqiptarët për herë të parë u vendosën në **Bosnje dhe Hercegovinë** në kohën e sundimit osman, dhe shkaqet kryesore ishin ekonomike, politike dhe shoqërore. Shumica e tyre vinin nga Shqipëria veriore. Në Bosnje dhe Hercegovinë ata jetuan si barinj, fermerë, mjeshtra, roje kufitare, dhe shumë shpejt u asimiluan nga vendasit.

Me ardhjen e austro-hungarezëve numri i shqiptarëve është ulur, për shkak të emigrimit të mëtejshëm në Europë. Kështu, në censusin e vitit 1910, u regjistruan vetëm 273 banorë në Bosnjë dhe Hercegovinë që flisnin shqip.

Mirëpo gjatë kohës së ish-Jugosllavisë një numër i madh i shqiptarëve, për shkak të kushteve të vështira të jetesës në Shqipëri, Kosovë, Mali të Zi e ish-Maqedoninë, u vendosën në Bosnje dhe Hercegovinë, kryesisht në Sarajevë, Tuzël, Zenicë, Banja Lukë, Doboj, Bërçko, Bijelina, Monstar dhe Trebinje.

Në vitin 1930 numri i shqiptarëve në Bosnje dhe Hercegovinë thuhet se është katërfishuar. Sipas censusit të vitit 1991, në Bosnje dhe Hercegovinë jetonin rreth 5 mijë qytetarë të deklaruar shqiptarë. Ndonëse në Kushtetutën e vendit dhe me ligj ata njihen si pakicë (te kategoria “të tjerët”), për ta, si edhe për komunitete të tjera pakicë, gjuha shqipe pak shkruhet dhe flitet dhe folësit e saj vazhdojnë të asimilohen në shoqërinë boshnjake, megjithë përpjekjet e herëpashershme për ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar nëpërmjet shoqatave të ndryshme etj.

Disa vite me radhë bashkësia shqiptare ka pasur nisma ku është ofruar mësimi plotësues për nxënësit shqiptarë, falë edhe ndihmës së Komunës Stari Grad në Sarajevë e cila për disa vite ka ndihmuar financiarisht, por me reduktimin e buxhetit të tyre ndihma modeste e kësaj komune u ndërpre. Sot vlerësohet se **në Bosnje dhe Hercegovinë** jetojnë 10 mijë deri 12 mijë shqiptarë, gjë që e bën një nga komunitetet më të mëdha si pakicë në këtë vend.

Sipas klasifikimit të mësipërm të GJNR-ve situata gjuhësore e shqipes është ajo e fundit të fazës së parë drejt fazës së dytë.

Në **Slloveni** shqiptarët e parë të vendosur në territoret e Sllovenisë së sotme kanë ardhur pas rënies së Perandorisë osmane dhe kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore me krijimin e shtetit Jugosllav, sidomos nga Kosova dhe Mali i Zi. Në kohën e ish-Jugosllavisë, shqiptarët emigruan në Slloveni kryesisht për arsye ekonomike dhe politike.

Në fillim, ishte një komunitet i vogël në Slloveni, mirëpo keqësimi i gjendjes politike në Kosovë, bëri që numri i shqiptarëve atje të rritej, ndërsa sot, sipas të dhënave statistikore, numri i shqiptarëve është rreth 6 mijë e 200 qytetarë ose 0.31% e numrit të përgjithshëm të banorëve në këtë shtet.

Qysh atëbotë, gjendja e rëndë ekonomike, dhe më vonë edhe politike, i detyroi shqiptarët të kërkojnë për të gjetur kushte më të mira jetese në këtë shtet, i cili ka pasur një standard jetësor më të lartë në krahasim me njësitë e tjera të ish-Federatës Jugosllave.

Edhe Sllovenia e mbron me kushtetutë dhe me ligj të drejtën e kësaj pakice, por vetë procesi i asimilimit në shoqërinë sllovene ka bërë që, megjithë përpjekjet nga shoqata a nisma individuale, mungesa e shkollimit sistematik përbën një rrezik të madh të asimilimit të shpejtë apo të shkrirjes së tyre si pakicë kombëtare.

Sipas klasifikimit të mësipërm të GJNR-ve, këtu shqipja ndodhet midis fazës së dytë dhe të tretë të asimilimit.

Në **Kroaci** shqiptarët janë pakicë kombëtare e njohur nga Kushtetuta e Kroacisë dhe e mbrojtur nga ligji për pakicat. Sipas censusit të vitit 2011 numri i tyre shkon në rreth 17 mijë e 500 banorë ose 0.41% e popullsisë së përgjithshme. Një periudhë e rëndësishme e emigrimit të tyre ishte koha e sundimit osman, kur shqiptarët katolikë u larguan për në Perëndim. Në këtë kohë në Kroaci erdhën edhe Arbëreshët e Zarës. Kurse një pjesë tjetër e tyre erdhi në trevat kroate në kohën e sundimit venedikas, sepse disa territore të Kroacisë dhe Shqipërisë ishin nën sundimin e Republikës së Venedikut. Në kohën e ish-Jugosllavisë, shqiptarët emigruan në Kroaci për arsye ekonomike dhe politike, sidomos pas vitit 1945. Emigrantët shqiptarë vinin kryesisht nga Kosova dhe Republika e ish-Maqedonisë.

Sot, bashkësia e arbëreshëve është e shpërndarë nëpër Kroaci. Komuniteti më i rëndësishëm shqipfolës është ai i Arbëreshëve të Zarës (Arbanas) në disa fshatra rreth Zarës si: Zemunik, Dračevac, Crno, Ploča, etj., ku shqiptarët janë vendosur në këto treva gjatë dy periudhave të ndryshme të emigrimeve; e para në vitin 1655 dhe e dyta në vitet 1726-1733.

Gjatë gjithë këtyre fazave e në vijim, ashtu si dhe për shqiptarët në Slloveni e Bosnje-Hercegovinë, një pjesë e madhe e tyre u asimilua për arsye integruese politike, shoqërore dhe ekonomike etj.

Duhet theksuar se për të tria këto vende, ndonëse politika gjuhësore zyrtare është mbrojtëse, në fakt, planifikimi gjuhësor është problematik. Dukuria e asimilimit për arsye politike, ekonomike shoqërore është e pandalshme. **Në ndarjen e mësipërme të GJNR-ve, në përgjithësi, gjendja gjuhësore e tyre vendoset midis fazës së parë dhe të dytë (me pak dallim Sllovenia)**, ngase një pjesë e mirë e folësve, kryesisht ata të ardhur në kohën e ish-Jugosllavisë, falë edhe afrisë me trungun amë, e ruajnë kujtesën gjuhësore dhe e transmetojnë të pasardhësit e tyre.

2.3.2. Areali shqipfolës në Bullgari, në Rumani, në Ukrainë dhe në Turqi

Studiuesi Idriz Ajeti (Ajeti: Studime, 2017) shkruan se shqiptarët e **Bullgarisë** janë shpërngulur nga Korça, Ohri, Elbasani, Çermenika, Golloborda, diku nga shekulli XV deri në shekullin XIX, dhe pastaj një pjesë është zhvendosur edhe në Ukrainë. Mes shekullit XV dhe XVII grupe shqiptarësh nga të dyja besimet, si katolikë dhe ortodoksë, u vendosën në disa pjesë të Bullgarisë veriore dhe një pjesë në Trakinë Jugore. Disa nga ardhësit e parë shqiptarë në Bullgarinë moderne ishin minatorë në Kopilovtsi, një fshat në afërsi të një qendre të madhe minierash. Të dhënat bëjnë të ditur se 1 mijë e 500 prej tyre jetonin në afërsi të Tërnovës.

Vende të tjera në veri të Bullgarisë, ku prania shqiptare ka qënë fort e ndjeshme janë Chervena Voda afër Rousse, Poroishte afër Razgradit, Dobrina afër Provadias dhe Devnya afër Varnas.

Gjuha e përdorur prej tyre është shumë arkaike. Ndër studimet shkencore për shqiptarët në këto treva vlen të përmendet Bojka Sokolova (Bojka Sokolova, Die albanische Mundart von Mandrica, 1982). Një vend të veçantë zë fshati Mandricë, i cili u krijua më 1636 nga disa barinj othodoksë shqiptarë që furnizonin ushtrinë otomane me produkte qumështi. Ata u lejuan të merrnin një copë tokë dhe të mos pagonin taksa. Në vitin 1873 Mandrica ishte një vendbanim me 250 shtëpi, me rreth 1 mijë e 100 banorë shqiptarë. Pjesa më e madhe e shqiptarëve erdhën në Bullgari në shekullin XVIII nga rrethinat e Korçës dhe në shekullin XIX nga rajoni i Sulit. Në 1908 burime greke e regjistronin popullsinë prej 3 mijë e 500 banorësh, kurse **Censusi i 2006-s ka regjistruar 75 shqiptarë të deklaruar.**

Mirëpo shqiptarët dhe **gjuha shqipe në Bullgari, nuk përfshihet nën ombrellën ‘pakicë kombëtare’**. Madje as edhe Mandrica, e njohur nga censuset zyrtare si shqiptare nuk gëzon statusin e gjuhës së pakicës kombëtare. Më lart theksuam se një nga tri parimet që merren parasysh në qasjen ndaj gjuhëve, krahas atyre të së drejtës natyrore të qenies njerëzore dhe të emancipimit demokratik të shoqërive tona për vlerësimin e gjuhëve dhe të kulturave, është edhe parimi i reciprocitetit ndëretnik a ndërshtetëror. Kësisoj, **ndërsa Republika e Shqipërisë e njeh në Ligjin për Pakicat (Nr.96/2017) pakicën bullgare si pakicë kombëtare, megjithë problematikën, që trajtuam më lart, ky parim nuk zbatohet për pakicën kombëtare shqiptare në Republikën e Bullgarisë**. Për nga niveli i përdorimit shqipja këtu renditet midis fazës së dytë dhe të tretë të GJNR-ve.

Sipas censurit të vitit 2002, në **Rumani** kishte 520 shtetas të deklaruar si shqiptarë dhe 484 deklaruan gjuhën shqipe si gjuhë amtare. Numri i tanishëm i shqiptarëve në Rumani llogaritet të jetë diku rreth 10 mijë qytetarë. Shumica e anëtarëve të komunitetit shqiptar jetojnë në Bukuresht, kurse pjesa tjetër është e vendosur kryesisht në qendra të mëdha urbane, si: Temishvar, Jash, Konstancë dhe Kluzh-Napokë (George, Grigore, 2007).

Në vitin 1893, bashkësia shqiptare në Rumani numëronte rreth 30 mijë banorë. Në vitin 1920, rreth 20 mijë shqiptarë jetonin në Bukuresht. Një valë e re e emigrimeve shqiptare, shumë syresh myslimanë erdhi nga ish-Jugosllavia, në prag të Luftës së Parë Botërore.

Bashkësia shqiptare ka qenë trysnuar gjatë regjimit komunist në Rumani, duke filluar nga viti 1953, kur shoqatat kulturore shqiptare u mbyllën. Shumë të drejta shqiptarëve u janë rikthyer pas Revolucionit rumun të vitit 1989, por numri i qytetarëve që deklarohen shqiptarë ka rënë ndjeshëm mes viteve 1920 dhe 2002. Ashtu si pak më lart, te rasti i Bosnje-Hercegovinës, qytetarët e bashkësisë shqiptare janë përfshirë në kategorinë "të tjerët" gjatë censuseve të kryera ("Albanezi - Date demografice", 2008).

Shumica e familjeve janë ortodokse dhe e kanë prejardhjen nga trevat përreth Korçës. Shumë shqiptarë të tjerë të Rumanisë ndjekin fenë islame. Sipas një artikulli të vitit 1999 nga studiuesi rumun George Grigore, **rreth 3 mijë**

anëtarë të bashkësisë islame në Rumani mund të jenë shqiptarë (George, Grigore. 2007).

Edhe në Rumani gjendja e gjuhës shqipe konsiderohet “gjuhë në rrezik” midis fazës së dytë dhe të tretë të GJNR-ve, duke shkuar drejt asimilimit, sepse politika gjuhësore mbrojtëse nuk ndiqet nga një planifikim gjuhësor *ad hoc* dhe për më tepër procesi i asimilimit është i madh, pasi është ndërprerë vijimësia e ruajtjes së gjuhës nga prindrit te fëmijët, por edhe për shkak të largësisë relative gjeografike prej trungut amë. Shqiptarët e Ukrainës erdhën nga zona e Korçës, fill pas pushtimit turk dhe për rreth 200 vjet jetuan në Bullgari. Më pas një pjesë u zhvendosën në Ukrainë dhe kanë 300 vjet që jetojnë aty. Banorët janë toskë, të shpërngulur nga rajoni i Pogradecit dhe Korçës, si pasojë e përndjekjes osmane. Numri i shqiptarëve që jetojnë në Ukrainë arrin në 5 mijë banorë. Shqiptarët e Ukrainës fillimisht u vendosën në veri të Odesës, 220 km në fshatin Karakut së bashku me bullgarët dhe gagauzët.

Në fillim të vitit 1860 një pjesë e fshatit Karakurti (Zhovtnjovoje) u shpërngul në rajonin e brigjeve të detit Azov, ku u themeluan tri fshatra: Taz (Devnenskoje), Xhandran (Gamovra), ku jetojnë edhe sot në tokën që ua dhuroi Katerina II e Ruisë.

Gjuha shqipe gjehet sot në këto katër fshatra, Karakurt (Zhovtnjovoje), Taz (Devneskoje), Tyshki (Gjeorgjevka) dhe Xhandran (Gamovra). Mirëpo **statusi i saj në përdorim është një përzierje e shqipes toske me rusishten**. Gjuha shqipe ka pësuar ndryshime si pasojë e kontakteve të përhershme me bullgarishten, gagauzishten, ukrainishten dhe rusishten. Shkrimi me alfabetin shqip mungon. Si alfabet ata përdorin kryesisht atë cirilik. **Procesi i asimilimit gjuhësor dhe kulturor, për shkaqe historike dhe politike, bashkë me kushtet ekonomike, po e shpie shqipen drejt asimilimit dhe është në fazën e tretë të klasifikimit të GJNR-ve.**

Shqiptarët në Republikën e Turqisë përbëjnë një pakicë kombëtare, e cila nuk është e njohur zyrtarisht. Kjo pakicë përbëhet nga shqiptarë të cilët erdhën në Turqi gjatë periudhës osmane, kryesisht shqiptarë nga Kosova, ish-Maqedonia, Çamëria, si dhe në numër më i vogël nga Shqipëria dhe Mali i Zi, të cilët emigruan si pasojë e persekutimit serb dhe grek pas fillimit të Luftërave Ballkanike (Geniş & Maynard. 2009). Numri i shqiptarëve në Turqi llogaritet të

jetë nga 500 mijë deri në 1.3 milionë, ndërsa sipas disa burimeve tjera numri i qytetarëve me prejardhje shqiptare është rreth 5 milionë (Cuneyt, Yenigun. 2009).

Në censusin e vitit 1965, rreth 13 mijë shtetas të Turqisë flisnin shqipen si gjuhë amtare, që përbënte rreth 0.04% të popullsisë. Shumica ishin të vendosur në Bursa, Sakarja, Tokat dhe Stamboll. Rreth 390 mijë të tjerë flisnin shqipen si gjuhë të dytë (1.28% e popullsisë). Gjithsej, numri i popullsisë shqipfolëse në Turqi në vitin 1965 ishte rreth 403 mijë ose 1.3% e popullsisë së Turqisë. Por, për shkak të mungesës së regjistrimit të popullsisë sipas origjinës edhe numri i shtetasve turkë me prejardhje shqiptare nuk mund të dihet saktësisht. Edhe Turqia paraqet një situatë shqipfolëse komplekse, që lidhet me Perandorinë osmane nga njëra anë, por edhe me periudhën e ish-Jugosllavisë, ku u shpërngulën për në Turqi shumë shqiptarë nga Kosova, Mali i Zi, ish-Maqedonia, për arsye politike të situatës konfliktuale me serbët, por edhe për arsye ekonomike, shoqërore etj. Vetëm se politika turke në tërësi nuk i ka njohur shqiptarët si pakicë kombëtare, sepse i konsideron si pjesë integrale e ish-Perandorisë osmane, duke marrë si kriter identifikues fenë islame. Pra, **gjuha shqipe dhe folësit e saj në Turqi janë në fazën e tretë dhe të katërt të GJNR-ve**. Nuk ka folës të rrjedhshëm, nuk ka politikë gjuhësore dhe planifikim gjuhësor; gjuha shqipe nuk mbrohet dhe madje as nuk njihet si pakicë kombëtare. Disa përpjekje për të nxitur mësimdhënien e gjuhës shqipe nga qeveria aktuale janë të papërfillshme për të ndryshuar gjendjen gjuhësore shqipfolëse në këtë shtet.

2.3.3. Areali shqipfolës në Greqi dhe në Itali

Arbëreshët ose arbërorët, të njohur edhe si arvanitët, janë popullsi meorigjinë shqiptare në **Greqi**, të cilët tradicionalisht kanë folur dhe flasin arbërisht. Ata u vendosën në Greqi gjatë fundit të Mesjetës dhe ishin element dominant i popullsisë në disa rajone të Peloponezit dhe Atikës, deri në shekullin e 19 (Jonathan, M. Hall. 2000). Arbëreshët sot identifikohen zyrtarisht si grekë prej një procesi të asimilimi shekullor, por konsiderohen si popullsi me origjinë shqiptare (Peter, Trudgill. & George, A. Tzavaras. 1977). Ata e quajnë veten e tyre si *arvanitas* (në greqisht) dhe *Arbëror* (në gjuhën shqipe). Kurse komunitetet shqipfolëse në Greqinë e veriut nuk janë *arvanitas*, por kryesisht çamë e toskë, të cilët konsiderohen si shqiptarë (të njëjtë me pjesën tjetër të

territorit të Shqipërisë). Arbëreshët nuk e quajnë veten e tyre si shqiptarë (Greek Helsinki Monitor. *The Arvanites*, 1995). Dialekti arbërisht është në një gjendje të bjerrur për shkak të ndërrimit të vazhdueshëm të gjuhës në greqisht, migrimit të madh të brendshëm nëpër qytete dhe përzierjes së mëvonshme të popullsisë gjatë shekullit të 20 (Hamp, Eric. 1989, Sasse, H. Jürgen. 1990, Crystal, David. 2000, Joseph, H.Greenberg. 2003). Nuk ka shifra të besueshme për numrin e arbëreshëve në Greqi sot (nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për etninë në Greqi) nga vitit 1951. Që atëherë, vlerësimet e numrit të arbëreshëve kanë variuar prej 25 mijë deri në 200 mijë qytetarë (Botsi, Eleni. 2003).

Identiteti arvanit është ruajtur nga tre faktorë të rëndësishëm: gjaku, gjuha dhe jetesa në zonat rurale, kurse identiteti grek është zhvilluar nga tre faktorë të rëndësishëm: feja, bashkëjetesa historike dhe urbanizimi i jetës (Çështje 3, Arvanitët, Rrokaj, Shezai. Spiro, Aristotel. 2014). Shqipja ‘arvanitese’ gjendet midis fazës së tretë dhe të katërt të klasifikimit të GJNR-ve. Si në rrafshin fonetikor, në gramatikor dhe leksikor ka një ndikim të fortë të greqishtes, duke krijuar njëfarë kreolizimi me greqishten. **Në Greqi kjo popullsi as nuk njihet e as nuk mbrohet me ligj.** Vetë arvanitasit nuk kanë asnjë aftësi përdorimi të rrjedhshëm të gjuhës shqipe, sepse ata nuk e përdorin këtë idiomë si mjet komunikimi me shkrim (përgjithësisht përdorin alfabetin grek, por dëshmohet edhe përdorimi i alfabetit shqip (Jochalas, Tito. 2000)) ose me gojë.

Nga ana tjetër, pas rënies së komunizmit në vitet '90, ashtu si dhe në vende të tjera, edhe në Greqi kanë shkuar kryesisht për arsye ekonomike me qindra mijëra shqiptarë. Një pjesë e tyre kanë marrë shtetësinë, dhe një pjesë tjetër është në pritje. Për shkak të lëvizjes brenda territorit grek si dhe të hyrjedaljeve së shpeshta në territorin amë, si dhe të mungesës së shtetësisë apo kalimit të kufirit në mënyrë të paligjshme, është e vështirë të jepet një numër i saktë i tyre në territorin grek. Gjithashtu, shpërndarja e tyre në territor e bën të vështirë krijimin e enklavave të mëdha gjuhësore. Në kuadrin e politikave evropiane për të drejtat e njeriut, siç është edhe ajo gjuhësore, shteti grekmbështet në parim mësimin shqip për fëmijët e emigrantëve, sidoqë jo mjaftueshëm dhe me një politikë gjuhësore e planifikim gjuhësor *ad hoc*. **Megjithatë, koha e pakët e shkëputjes prej vendit amë, vajtje-ardhjet e shpeshta për shkak të afërsisë me territorin indigjen, te moshat e rritura**

shqipja ende mbetet në kufijtë e përdorimit të gjuhës zyrtare. Këto mosha mund të konsiderohen ende si folës të shqipes zyrtare, megjithë presionin e kuptueshëm asimilues të jetës së përditshme urbane në Greqi. **Por, për fëmijët e tyre nuk është e njëjta gjë. Mungesa e arsimimit në gjuhën shqipe, dhe shkëputja e lidhjeve frekvente me territorin amë, arsimimi në shkollat greke dhe vetë trysnia e fortë urbane po i shpie drejt një situatë gjuhësore të fazës së parë të GJNR-ve.**

Arbëreshët e **Italisë** janë ndër minorancat etnike gjuhësore që emigruan në Itali nga mesi i shekullit XV, pas vdekjes së Skënderbeut dhe në vijim. Sot ato jetojnë në rreth 50 komuna italiane të vendosura në 5 rajone të ndryshme dhe me një popullsi të përgjithshme që llogaritet të jetë rreth 100 mijë banorë.

Ashtu si popullsia arvanite në Greqi edhe arbëreshët e Italisë kanë pësuar në rrjedhë të shekujve efektet e trysnisë politike, ekonomike, shoqërore e fetare, si dhe dekadat e fundit pasojat e globalizimit që kanë shkaktuar zhvendosjen e tyre drejt qendrave urbane. Sidoqoftë, shumë faktorë si: gjuha, kultura dhe feja kanë qenë themelore në ruajtjen e pasurisë etnike arbëreshe. Ndryshe nga arvanitët në Greqi, arbëreshët zhvilluan një letërsi të tyre, një kulturë *ad hoc* dhe ruajtën fenë ortodokse, ndryshe nga ajo katolike në Itali. Megjithatë, trysnia e fuqishme politike, ekonomike, kulturore e arsimore italiane dhe situata gjuhësore e sotme në këto treva ka bërë që para disa muajsh OKB-ja të japë alarmin se gjuha shqipe e arbëreshëve të Italisë është në rrezik (faza e dytë e GJNR-ve) të ndjeshëm zhdukjeje dhe është një nga gjuhët e përfshira në projektin e saj për shpëtimin e mbi 3 mijë gjuhëve në rrezik ndër rreth 7 mijë që janë sot në botë. Projekti “Endangered Languages Project” i OKB, i realizuar nga një grup ekspertësh në fushën e edukimit e gjuhës, në bashkëpunim me mjaft universite të botës dhe motorin e kërkimit Google, ka vënë si synim të mbajnë gjallë memorien e së shkuarës përmes gjuhës e të sensibilizojë opinionin publik botëror mbi problemin e gjuhëve në rrezik zhdukjeje.

Siç u theksua më lart, nga gjuhë e kolegjeve të njohura dikur në Itali, **sot arbërishtja nuk është më e sigurt me statusin e saj: edhe ajo është përfshirë në listën e gjuhëve të rrezikuara sipas UNESCO-s.** Ka pasur qëndrime të ndryshme lidhur me mënyrën e mësimdhënies së gjuhës shqipe, siç janë qasjet e Giuseppe Gangale-s dhe Francesco Solano-s: vetëm arbërishten duke e zhvilluar

atë në vetvete apo arbërishten me shqipen aktuale ndihmëtare të këtij detit (Çështje 1, 2007).

Ligji 482, i miratuar nga Parlamenti italian më **15 dhjetor 1999**, dhe i bërë publik në fletoren zyrtare numër 297 më 20 dhjetor 1999, përcakton mbrojtjen ligjore të të gjitha minorancave gjuhësore historike në Itali, përfshi edhe arbërishten. Në nenin 2 të ligjit italian shkruhet se “në zbatim të nenit 6 të Kushtetutës dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të vendosura nga organet europiane e ndërkombëtare, Republika Italiane mbron gjuhën e kulturën e popullsisë shqiptare, katalanase, gjermanike, greke, sllovene e kroate dhe të gjithë atyre që flasin në gjuhën franko-provencial, friulian, ladin, oksitanisht e sardo.”

Kjo normativë ligjore parashikon që në të gjitha shkollat e ciklit parashkollor në territoret arbëreshe, krahas gjuhës italiane, duhet të përdoret dhe gjuha shqipe për veprimtari edukuese. Në shkollat e ciklit të parë e të dytë parashikohet që krahas gjuhës italiane të përdoret dhe gjuha arbëreshe si mjet mësimi. **Një rol të madh studimor, gjithaq edhe mësimdhënës, për gjuhën dhe kulturën arbëreshe dhe shqiptare po luajnë katedrat e gjuhës shqipe në Kozencë, Palermo, Napoli, Leçe, Romë etj.** Megjithatë, mësimi i gjuhës shqipe dhe promovimi i kulturës arbëreshe në komunat arbëreshe, megjithë përpjekjet e tyre për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre, janë në vështirësi serioze. Mungesa e fondeve ka çuar në mbylljen e mjaft shkollave në gjuhën shqipe e të sporteleve të saj pranë bashkive në këto treva e me një numër çdo vit në reduktim të nxënësve arbëreshë që mësojnë gjuhën amtare, ndërkohë që rinia, për arsye të trysnisë së globalizimit e integritimit në mjedisin urban, po i braktis këto treva, duke u asimiluar në vazhdimësi.

Për shqiptarët e ardhur pas viteve '90 është e njëjta situatë gjuhësore si në Greqi, po kështu në **Gjermani, Austri, Zvicër, Mbretërinë e Bashkuar, Holandë, Francë etj.** Për arsye të ikjes prej vendit amë këto tre dekadat e fundit (shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi kanë shkuar masivisht pak më herët, gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë) dhe të kontakteve të përhershme me vendlindjen brezat e prindërve kanë ruajtur gjuhën shqipe zyrtare në trajtën që flitet në trojet nga vijnë, megjithë trysninë urbane të asimilimit. **Kurse çështja e kompetencës së shqipes te fëmijët edhe këtu, si në**

shtetet që përmendëm më lart, është drejt fazës së parë të GJNR-ve. Mos arsimimi sistematik i tyre në gjuhën shqipe, pavarësisht përpjekjeve të shteteve demokratike për zbatimin e të drejtave të njeriut për arsimim dhe respektim të të drejtave etnike, shkollimi në gjuhët e vendeve ku janë dhe procesi i globalizimit është i pashmangshëm.

2.3.4. Areali shqipfolës në SHBA, në Kanada, në Egjipt e në Argjentinë

Sipas të dhënave nga një studim i vitit 2008 i qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, janë rreth 201 mijë amerikanë me prejardhje të plotë ose të pjesshme shqiptare (shqiptaro-amerikanë) (USA Census Bureau, 2008).

Shumica e valës së parë të emigrantëve, rreth 10 mijë, kishin për qëllim të vendoseshin përgjithmonë në SHBA, por u kthyen përsëri në Shqipëri pas Luftës së Parë Botërore. Pikërisht në këtë kohë, një grup tjetër i emigrantëve nga Shqipëria shkuan në SHBA. Numri i shqiptarëve që janë shprehur se gjuha shqipe është gjuhë e tyre amtare në vitin 1920 ishte rreth 6 mijë qytetarë.

Pas Luftës së Dytë Botërore shqiptarët që emigruan në SHBA ishin kryesisht emigrantë politikë, dhe në vitin 1970 kjo shifër u rrit në rreth 17 mijë qytetarë.

Pas dëbimit të çamëve nga Çamëria edhe trojet shqiptare që sot janë në Greqi në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, një numër i madh prej tyre emigruan në Shtetet e Bashkuara menjëherë pas dëbimit të tyre, duke pohuar gjithashtu se edhe qeveria komuniste në Shqipëri i kishte diskriminuar dhe persekutuar ata. Ata arritën të ruajnë traditat dhe gjuhën e tyre, dhe krijuan në 1973 Shoqatën e të Drejtave të Njeriut Çamëria, e cila më vonë u bë Organizata Shqiptaro-Amerikane Çamëria, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Në vitin 1980 qytetarët që kishin braktisur gjuhën amtare vlerësoheshin rreth 70 mijë shtetas të SHBA-ve me prejardhje shqiptare.

Në 1990 shumë shqiptarë nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Republika e Maqedonisë (së Veriut), emigruan në SHBA si refugjatë të luftës. Një tjetër komunitet shqiptaro-amerikan (shqiptarë të Kosovës) në Riverside, Kaliforni / San Bernardino, rajoni i Kaliforni-së përfshin shqiptarët nga Kosova, të cilët hynin në Shtetet e Bashkuara në March Joint, Air Reserve Base në Riverside.

Gjithashtu, ka një popullsi të deklaruar si italo-amerikanë, që shkuan në SHBA gjatë fillimit të shekullit XX e në vijim, të cilët janë nga Italia e Jugut me

prejardhje arbëreshe dhe ruajnë ende dialektin arkaik toskë. Zona e Greater New Orleans ka një komunitet të madh të arbëreshëve, me prejardhje prej emigrantëve sicilianë (Fischer, J. Bernd. 2005).

Statusi gjuhësor i shqipes së shqiptaro-amerikanëve është ai i fazës së dytë të GJNR-ve, kurse tek arbëreshët, si dhe për Kanadanë më poshtë, gjuha shqipe është në fazën e tretë të GJNR-ve.

Shqiptarët në **Kanada**, të njohur edhe si shqiptaro-kanadezë përbëjnë një komunitet prej rreth 31 mijë banorësh, sipas censusit të vitit 2011 (National Household Survey, 2011).

Shqiptarët e parë emigruan në Kanada në fillim të shekullit XIX, për shkak të kushteve kryesisht ekonomike. Megjithatë, pas Luftës së Dytë Botërore shumë pak shqiptarë emigruan në Kanada, dhe shumica prej tyre ishin nga ish-Jugosllavia. Numri më i madh i shqiptarëve që emigruan u vendosë në Montréal ose Toronto, por gjithashtu edhe në Calgary dhe Ontario.

Në vitin 1986, numri i shqiptarëve të regjistruar ishte nën 1 mijë e 500 shtetas, por në vitin 1991, këto shifra pothuajse u dyfishuan. Numri i shqiptarëve në Kanada u rrit në fund të viteve 1990, pasi ata u larguan prej krizës ekonomike dhe politike në Shqipëri dhe ish-Jugosllavi.

Më vonë, pas konfliktit Serbi-Kosovë, shumë shqiptarë lanë Kosovën dhe emigruan në Kanada. Kështu, në vitin 1999, qeveria e Kanadasë numëronte rreth 7 mijë refugjatë shqiptarë nga Kosova, por shumë syresh edhe nga Shqipëria. **Statusi i tyre gjuhësor është i ngjashëm me ata të shqiptarëve në SHBA: faza e dytë e GJNR-ve për shqiptarët dhe faza e tretë për arbëreshët e Italisë.**

Shqiptarët në **Argjentinë** përbënin një komunitet prej rreth 50 mijë banorësh.

Shumica e shqiptarëve që emigruan në Argjentinë ishin arbëreshë nga Italia jugore, ndërsa rritja e emigrimeve shqiptare në Argjentinë ndodhi në fillim të shekullit të 20, me mbërritjen e rreth 20-30 mijë shqiptarëve.

Sot, përveç disa familjeve në Rosario dhe Córdoba, pothuajse të gjithë shqiptarët e Argjentinës jetojnë në Buenos Aires. Sipas fesë, shumica e shqiptarëve në **Argjentinë** janë të krishterë, ndërsa një pakicë janë myslimanë. Për shkak të largësisë dhe të mungesës së politikave gjuhësore *ad hoc*, megjithë përpjekjet e komuniteteve dhe të përfaqësisë sonë diplomatike, **gjuha shqipe**

është në bjerrje të vazhdueshme, duke u vendosur në fazën e tretë të GJNR-ve.

Shqiptarët në **Egjipt** emigruan për herë të parë si ushtarë dhe mercenarë në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, duke bërë emër dhe duke fituar respekt në luftën osmane për të dëbuar trupat franceze në vitet 1798-1801. Mehmet Ali Pasha (1769-1849) themeloi dinastinë shqiptare të Egjiptit, e cila zgjati deri në vitin 1952. Në shekullin XIX dhe fillimin e shekullit XX shumë shqiptarë të tjerë u vendosën në Egjipt për arsye ekonomike dhe politike. Pas rënies së dinastisë, me revolucionin egjiptian të vitit 1952, komuniteti shqiptar u zvogëlua dhe humbi ndikimin (Patrick, R. Carstens. 2014).

Pak shqiptarë do të vazhdonin të vinin në Egjipt, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, kryesisht për t'i shpëtuar regjimit komunist.

Me ardhjen në pushtet të Gamal Abdel Naserit dhe rritjen e nacionalizimit arab në Egjipt, jo vetëm familja mbretërore, por edhe i gjithë komuniteti shqiptar me rreth 4 mijë familje u detyruan të largoheshin nga vendi. Pjesa më e madhe e komunitetit bektashian u shpërngul në SHBA apo në Kanada. **Gjuha shqipe në këtë shtet mbetet në fazën e tretë të GJNR-ve.**

3. Përfundime

Shumë projekte po synojnë për të parandaluar ose ngadalësuar bjerrjen a humbjen e gjuhëve, duke rivitalizuar gjuhët e rrezikuara, duke promovuar arsimimin dhe shkrim-leximin në gjuhët e pakicave, si dhe duke përfshirë në projekte të përbashkëta komunitete folëse dhe gjuhëtarë apo edhe mbrojtës nga shoqëria civile. Siç u vu re më lart, shumë vende kanë miratuar legjislacion specifik që synon mbrojtjen dhe stabilizimin e gjuhës së komuniteteve të gjuhës origjinare që bartin folësit në një areal tjetër gjuhësor (pakica të ardhura nga larg) apo ata që flasin në shtetin si zgjatim territorial i gjuhës tjetër (minoritete).

Çështja e GJNR-ve ka marrë një zhvillim të madh pas viteve '90, sidomos pas marrjes në mbrojtje prej UNESCO-s dhe projektit të Google 2, duke sjellë një larmi botimesh, ku gërshetohen shumë disiplina si drejtësia, shkencat shoqërore (Chrystal David. 2000; Hagège, Claude. 2000; Nettle, Daniel. dhe Roumaine, Susanne. 2000; Evans, Nicholas. 2011). Shpesh kjo çështje është

ngritur edhe emocionalisht si një zhdukje e programuar dhe e qëllimshme e një pasurie shpirtërore të njerëzimit (Harrison, K. David. 2007).

Në fakt, duke u distancuar prej qëndrimeve pasionante, **gjuhëtarët mund dhe duhet të japin kontribute serioze që vijnë prej kërkimesh konkrete teorike e empirike.** Aroux mbron idenë se gjuhësia është një shkencë me observator, pra me mjete që bëjnë të mundur vëzhgimin e dukurive në terren konkretisht, me anketime dhe me pyetësorë për këto gjuhë (Aroux, Sylvain. 1998). Vëzhgimi i tyre duhet të jetë i përhershëm për arsye se ato janë në ndryshim të pandërprerë.

Studiuesit deskriptivistë, sociolinguistët shprehen se GJNR janë një observator më vete dhe se vetëm të dhënat e tyre që dalin prej GJNR-ve duhen marrë si bazë për përfundime teorike gjuhësore, por edhe si burim i sigurt ku duhet të mbështeten censuset dhe politikat gjuhësore shtetërore.

Në literaturën anglofone studimet për GJNR, kryesisht prej viteve 1990, (Grenoble, A Lenore & Whaley, J. Lindsay. 1998), kanë synuar fillimisht me krijimin e një vetëdijeje rreth termit “zhdukje” të shumë gjuhëve të botës, parë kjo si një shqetësim, madej edhe si reagim ndaj shkaqeve dhe faktorëve që ndikojnë në këtë proces në peizazhin gjuhësor botëror, qofshin ata politikë, ekonomikë, shoqërorë a thjesht gjuhësorë.

Nga ana tjetër, pyetësorin e vlerësimit të qenësisë së GJNR-ve, UNESCO e ka kthyer në një program për promovimin e gjuhëve si mjete për edukimin dhe kulturimin (Fishman, A. Joshua. l’EGIDS Extended Graded Intergenerational Disruption Scale), i cili u zhvillua më tej nga Lewis, Simons etj, (Lewis, P. Michael. Simons, F.Gary. Charles, D. Fennig. 2013). Gjithaq, njohja e plotë e tyre shërben për hipoteza teorike mbi invariantet gjuhësore dhe njohjen e mëtejshme të diversitetit të tipologjive strukturore gjuhësore dhe prejardhjes gjenealogjike apo afrisë gjeografike të tyre (Rijkhoff, Jan. Bakker, Dik. 1998; Song, J. Jung. 2001).

Po kështu, një problem tjetër që është vënë në dukje nga studimet është ai i paragjyqimit të folësve që flasin ende GJNR. Kjo do të thotë se, krahas rëndësisë për studime përshkruese dhe dokumentuese nga gjuhëtarët, duhen vëzhguar situatat e ndryshme ku ndodhen folësit e tyre, dhe këtu ekziston një larmi situatash sipas rasteve që paraqiten.

Jean Louis Calvet (Essais, 2004) thekson se këto qëndrime po ia ndryshojnë kahjen gjuhësisë nga një gjuhësi e gjuhës së masës folëse (si sistem) në një gjuhësi të kumtimit të folësve konkretë, pra një ‘gjuhësi ndërvepruese’ të folësve gjatë ligjërimit. Gjithë kjo e kthen çështjen e folësve në qendër të vëmendjes. *Çdo politikë gjuhësore që ngurtësohet në respektimin e rregullave të vendosura ex cathedra, sikur rregullat t’i bënin politikëbërësit apo edhe vetë gjuhëtarët dhe jo përdoruesit natyrorë të gjuhës, rrezikon t’i nxjerrë rregullat e vendosura jashtë konteksteve jetësore të folësve (kryesisht gjuha e folur), duke krijuar realitete paralele me atë të zhvillimit natyror të gjuhës, sepse gjuha zyrtare, sikundër gjuha e pakicave apo vetë dialektet brenda gjuhës kombëtare, nuk mund të jenë një veshje e drunjë, por një veshje që rri sipas shtatit të përdoruesit* (Rrokaj: Konf. 2020).

Për më tepër, kur studiuesit shkojnë në terren në rastet e GJNR-ve gjendja e zotërimit të kompetencave gjuhësore nga ana e folësve, në përkthim, shqiptim, ndërtime fjalish, kontekste ligjërimore të ndryshme është e variueshme (Newman, Paul. & Ratliff, Martha. 2010). Pra, nuk kemi të bëjmë me folës që e zotërojnë idiomën në të njëjtin nivel, që do të thotë se çështja e konceptit “folës” i një gjuhe në kësi rastesh vihet në pikëpyetje për sa i përket kompetencës ndaj GJNR-ve. Kjo larmi gjuhësore ka vënë në vështirësi studiuesit për përcaktimin e statusit të folësit në raport me zotërimin e GJNR, ku çdonjëri bëhet i çmuar nga pikëpamja studimore gjatë përdorimit vetjak. Në këtë drejtim studiuesit propozojnë disa tipologji folësish si: folës tradicionalë, gjysmë-folës, folës të rinj, folës fantazmë, folës të moshuar etj. (Bert, Michel. & Grinevald, Colette. 2010). Gjithsesi studimet në terren japin të dhëna mbi vitalitetin e GJNR-ve, duke vënë në diskutim konceptin se çdo të thotë të flasësh një gjuhë, gjë që na shpie drejt dy qasjesh: gjuha si sistem ku përshkruhet funksionimi në rrafsh të ndryshme dhe gjuha si institucion sociopolitik që na shpie drejt politikash gjuhësore.

Pra çfarë kuptojmë me GJNR, sistemin që pëson ndryshime të rëndësishme prej rënies drastike të folësve që e përdorin? Apo statusi i gjuhës, i cili bie në të njëjtën kohë me humbjen e statusit të grupit me të cilin ajo lidhet? Në politikat gjuhësore a duhet të mbetemi te gjuha si sistem duke studiuar vetë rrafshet e saj apo duhet gjithashtu të orientohemi te folësit dhe grupet shoqërore përkatëse, të cilët për shumë arsye politike, ekonomike, shoqërore etj, orientohen drejt

zgjedhjeve ekzistenciale? Që të dyja këto qasje janë të nevojshme që të ndërthuren për një politikë dhe planifikim gjuhësor të dobishëm dhe sa më pranë realiteteve të folësve.

Nga ana tjetër, prirja e vetëdijshme për t'i ruajtur me çdo kusht, deri në utopi, gjuhët nga gjuhëtarë, mbrojtës të pasurisë kulturore etj. (De Swaan, Abram. 1999), është shpeshherë përkundër ndryshimeve gjuhësore që gjuhët pësojnë përgjatë historisë së tyre, dhe sidomos përkundër vullnetit të grupeve që vendosin me shumë ose me më pak liri, me ose pa kufizime për konservimin ose jo të përdorimit.

Duke përfunduar mund të themi se për gjuhët zyrtare dhe të pakicave kombëtare, si rasti i shqipes, politika gjuhësore është e lidhur me planifikimin gjuhësor. Do të veçonim tre faktorë që kanë ndikuar në politikën gjuhësore dhe planifikimin e saj. Së pari, është ideologjia nacionaliste e supremacisë së një etnie mbi tjetrën, ku etnitë me gjuhët dhe kulturat e tyre nuk janë parë si vlerë e shtuar dhe si një përfitim i ndërsjellë, por janë diskriminuar me politika asimiluese. Së dyti, ideologjia totalitare, që ka shumë qasje me nacionalizmin, e cila ka deformuar perceptimin mbi botën me të ashtuquajturin stereotip ideologjik a “gjuhë druri”. Së treti, coptimi i trevës kombëtare në disa shtete me gjuhë, kultura të ndryshme dhe me qasje e politika diskriminuese për shqiptarët, përfshi këtu edhe politikat e tyre gjuhësore.

Sidoqoftë, siç pohova më lart, për qasjet studimore dhe politikat gjuhësore ndaj çdo gjuhe, përfshi dhe shqipen, duhen mbajtur parasysh tri parime kryesore: a) parimi i së drejtës natyrore, ku gjuha para se të jetë një e drejtë ligjore është pjesë e vetë ekzistencës së qenies njerëzore; b) parimi i reciprocitetit ndërshtetëror, *ipso facto* ndëretnik; c) emancipimi shoqëror demokratik ku, gjuhët, kulturat e etnive nuk janë burim konflikti, por një pasurim i ndërsjellë i vetë këtyre shoqërive.

Bibliografi:

Ajeti, Idriz. Studime për gjuhën shqipe, Prishtinë, 2017.

Alain, Ducelier. Travaux et mémoires. Bd. 3. L'Albanon et les Albanais au 16 siècle, Paris (Centre de recherches d'histoire et civilisation byzantine), 1968.

- «Langues menacées, savoirs en péril», *Revue internationale des sciences sociales* 173, Mithun, Marianne, 1998.
- Anderson, Benedict. *Comunità immaginate. Origini e fortuna dei nazionalismi*, Manifestolibri, Roma, 2009.
- Sylvain, Auroux. *La raison, le langage et les normes*, Paris, Presses Universitaires de France, Austin, 1998.
- Austin et Sallabank, la ‘Cambridge Conference on Endangered Languages’, revistat *Language Documentation and Description et Language Documentation and Conservation*. Article published by EDP, 2011.
- Bert, Michel. & Grinevald, Colette. «Proposition de typologie des locuteurs de LED», *Faits de langues* 35/36, 2010.
- Blackwood, Robert. & Tufi, Stefania. *The linguistic landscape of the medoterranean*, University of Liverpool, UK, 2015.
- Bojka, Sokolova. *Die albanische Mundart von Mandrica*, Berlin, 1982.
- Borin, Lars. «The why and how of measuring linguistic differences », Lars Borin & Anju Saxena (eds.), *Approaches to measuring linguistic differences*, Berlin, Mouton de Gruyter. Burling, Robbins, 1969. «Proto-Karen: A reanalysis», *Occasional Papers of the Wolfenden Society on Tibeto-Burman Linguistics* 1, 2013.
- Botsi, Eleni. *Die sprachliche Selbst- und Fremdkonstruktion am Beispiel eines arvanitischen Dorfes Griechenlands: Eine soziolinguistische Studie* Arkivuar 9 prill 2008 tek Wayback Machine. University of Konstanz. “Studim gjuhësor i vetes dhe të tjerëve në shembullin e një fshati arvanit të Greqisë. Studim sociolinguistik” Punim doktrate. Universität Konstanz, 2003.
- Bussmann, Hadumod. *Lexikon der sprachwissenschaft*, digjitalizuar, 2008.
- Calvet, L. Jean. *Le Marché aux langues: les effets linguistiques de la mondialisation*, Paris, 2002.
- Chomsky, Noam. *Knowledge of language, Its nature, Origin and Use*, Praeger, New York, 1986.
- Claus, Haebler. *Grammatik der albanischen Mundart von Salamis. Albanische Forschungen. Bd. 3*. Wiesbaden (Harrassowitz). 1965.

- Costa, James. «New Speakers, New Language: On Being a Legitimate Speaker of a Minority Language in Provence», *International Journal of the Sociology of Language* 231, 2015.
- Crystal, David, *Language death*, Cambridge, Cambridge University Press, 2000.
- Cuneyt, Yenigun. *Balkan Multikulturalism: Example to itself & to the EU*, 2009.
- Dahl, Östen. «An exercise in a posteriori language sampling», *Sprachtypologie und Universalienforschung* 61, 2008.
- De Swaan, Abram. «Le sentimentalisme des langues. Les langues menacées et la sociolinguistique», 2007.
- Endangered Languages; Language Loss and Community Response*, Cambridge, Cambridge University Press, 2001.
- Evans, Nicholas. *Dying Words: Endangered Languages and What They Have to Tell Us*, Oxford, 2011.
- Fischer, J. Bernd. "Albanian refugees seeking political asylum in the United States: process and problems" in *Journal of Ethnic and Migration Studies*, 2005.
- Frashëri, Kristo. *Historia Shqiptare*, Tiranë, 1964.
- Gasquet, C. Médéric. «La 'mort' des langues: repères historiques, critiques et réflexions éthiques», 2010.
- Geniş & Maynard. "Taking a chronological perspective, the ethnic Albanians currently living in Turkey", 2009.
- Georg, Stadtmueller. *Forschungen zur albanischen Frühgeschichte. (Albanische Forschungen. Bd. 2)*. Wiesbaden (Otto Harrassowitz). 1966.
- George, Grigore. "Muslims in Romania" Arkivuar 26 shtator 2007 tek Wayback Machine, in *International Institute for the Study of Islam in the Modern World (ISIM) Newsletter* 3, July 1999; retrieved July 16, 2007.
- Greek Helsinki Monitor. *The Arvanites*. 1995.
- Grenoble A. Lenore dhe Lindsay J. Whaley, *Endangered Languages: Language Loss and Community Response* 1998.
- Grenoble A. Lenore dhe Lindsay J. Whaley, *Saving Languages: An Introduction to Language Revitalization*. New York, Cambridge University Press. 2006.

- Haarmann, Harald. *Babylonian world. History and future of languages.* Frankfurt, New York: Campus, 2001.
- Hagège, Claude. *Les structures des langues, Que sais-je?* PUF, 2000.
- Hagège, Claude. *Halte à la mort des langues*, Paris, 2000.
- Hamp, P. Eric. *On the Arvanitika Dialects of Attica and the Megarid.* In: *Balkansko Eznikoznanie III. 2.* 1961.
- Hamp, P. Eric. "On sign of Health and Death". In: Dorian C. (ed.). *Investigating obsolescence. Studies in Language Contraction and Death.* Cambridge. Cambridge University Press. 1989.
- Haugen, Einar. *Language Conflict and Language Planning: The Case of Modern Norwegian.* Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1966.
- Harrison, K. David. *When Languages Die: The Extinction of the World's Languages and the Erosion of Human Knowledge*, Oxford Univ. Press, 2007.
- Haugen, Einar. *Language Planning in Modern Norway.* De Cruyter Mouton, 1968.
- Hobsbawm, E.J. *Nazioni e nazionalismi dal 1870*, Einaudi, Torino, 1990. Inalcik, H. *Hicri 835 Tarihli Suret-i Defter-i Sancak-i Arvanid.* Ankara, 1945 dhe Puto, Arben.: *Histoire de le Albanie dès origines à nos jours*, Roan, 1974.
- Jackendoff, Ray. *Linguaggio e natura umana*, il Mulino, Bologna, 1999.
- Lewis, M. Paul. Gary, F. Simons. Charles, D. Fennig. *Ethnologue: Languages of Africa and Europe*, bot. XVII Hardcover, 2013.
- Jochalas, Tito. *Andros. Arvanitët dhe arvanitishtja.* Athinë, Pataki, 2000.
- John, Wiley & Sons. Fishman, A. Joshua. *Reversing Language Shift: Theoretical and Empirical Foundations of Assistance to Threatened Languages*, Bristol, Multilingual Matters, 1991.
- Jonathan, M. Hall. *Ethnic Identity in Greek Antiquity.* Cambridge University Press, 2000.
- Joseph, H. Greenberg. et al. (eds.), *Universals of Human Languages: method – theory*, vol. 1, Stanford, Stanford University Press 1963.
- Kloss, Heinz. *Research possibilities on group bilingualism: a report*, Québec, CIRB. Lewis, Paul M., 2009. *Ethnologue: languages of the world.* [15th edition], Dallas (Texas), SIL International. Lewis, 1969.

Largimet shqiptare dhe ku janë shpërndarë: albasoul.com

Laurie, K. Hart. "Culture, Civilization, and Demarcation at the Northwest Borders of Greece". *American Ethnologist*. 26. (1), 1999.

Lukas, D. Tsitsipis. Language change and language death in albanian speech communities in Greece. A sociolinguistic study. University of Wisconsin-Madison (Dissertation), 1981.

Médéric, C. Gasquet.- alicé Vittrant et Sylvie Voisin Greenberg, Joseph H., Language in the Americas, Stanford, Stanford University Press, 1987.

Médéric, C. Gasquet. Alain, Giacomo. Yvonne, Touchard. Daniel Veronique. Pour la (socio)linguistique, Paris, L'Harmattan, 2010.

Mufwene, S. Salikoko. Créoles, écologie sociale, évolution linguistique, Paris, L'Harmattan, 2005.

National Household Survey. Data tables – Statistics Canada, 2011.

Nettle, Daniel. & Romaine, Suzanne. Vanishing, Voices. The Extinction of the World's Languages: The Extinction of the World's Languages, Oxford, Oxford University Press, 2000.

Newman, Paul. & Ratliff, Martha. Linguistic Fieldwork, Cambridge, Cambridge University Press, 2001.

O'Rourke, Bernadette, Pujolar, Joan. & Ramallo, Fernando. «New Speakers of Minority Languages: The Challenging Opportunity», *International Journal of the Sociology of Language* 231, 2015.

Patrick, R. Carstens. The Encyclopædia of Egypt during the Reign of the Mehemet Ali Dynasty 1798-1952, Friesen Press, ASIN B00MH7FQHG, 2014.

Perley, Bernard. «Zombie Linguistics: Experts, Endangered Languages and the Curse of Undead Voices», *Anthropological Forum* 22(2), 2012.

Peter, Trudgill. & George, A. Tzavaras. "Why Albanian-Greeks are not Albanians: Language shift in Attika and Biotia." në H. Giles (ed.). Language, ethnicity and intergroup relations. Academic Press, 1977.

Population by ethnicity and religion". *Census of Population, Households and Dwellings 2011*. Croatian Bureau of Statistics, 2012.

- Profili i politikës arsimore gjuhësore, Shqipëria, departamenti i arsimit, Këshilli i Evropës, Strasburg. 2015-2017.
- Rijkhoff, Jan. & Bakker, Dik. «Language sampling», *Linguistic Typology* 2-3, 1998.
- Rijkhoff, Jan. Bakker, Dik. Hengeveld, Kees. & Kahrel, Peter. «A Method of Language Sampling», *Studies in Language* 17(1), 1993.
- Rrokaj, Shezai. Ligji për gjuhët në Maqedoninë e Veriut dhe gjuha shqipe, Konf. Albanologjike, Tetovë, 2019.
- Rrokaj, Shezai. Rreth koncepteve të Françesko Solanos dhe Giuseppe Gangales për çështjen e gjuhës në ngulimet arbëreshe, në Çështje 1, *Shkronjë pas shkronje*, 2007.
- Rrokaj, Shezai. Këndvështrimi i Demirajt për standardin si proces dinamik, qasje e duhur për një reformë gjuhësore të pritshme, Konferencë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2020.
- Rrokaj, Shezai. Çështje të gjuhës shqipe 1, Albatros, 2007.
- Rrokaj, Shezai. Çështje të gjuhës shqipe 2, *Shkronjë pas shkronje*, 2009.
- Rrokaj, Shezai. Çështje të gjuhës shqipe 3, *Shkronjë pas shkronje*, 2014.
- Rrokaj, Shezai. Çështje të gjuhës shqipe 4, Pegi, 2018.
- Sasse H. Jürgen. Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland. Wiesbaden. 1991. rbeitpapier (No. 12) Köln: Institut für Sprachwissenschaft, Universität zu Köln, 1990.
- Savoia, Leonardo. Aspekte ideologjike të nacionalizmit gjuhësor, *GjJ*, 1-2/, 2003.
- Song, J. Jung. *Linguistic Typology. Morphology and Syntax*, Harlow, Longman, 2001.
- Stolz, Thomas, «Harry Potter meets Le petit Prince – On the usefulness of parallel corpora in crosslinguistic investigations », Berlin, *STUF* 60(2), 2007.
- Strauss, L. Claude. *Tristes Tropiques*, Plon, Paris, bot. i parë, 1955.
- Titos P. Jochalas. Über die Einwanderung der Albaner in Griechenland. Eine zusammenfassende Betrachtung. München (Rudolf Trofenik). (Sonderdruck aus *Dissertationes Albanicae*), 1971.
- USA Census Bureau, Table: Ancestry for People with one or more Ancestry Categories Reported Arkivuar 22 janar 2020 tek Wayback Machine

Walter, Breu. Sprachliche Minderheiten in Italien und Griechenland. Aus: Spillner, Bernd (Hrsg.): Interkulturelle Kommunikation. (Forum angewandte Linguistik. Bd. 21). Frankfurt a. M. / Bern / N.Y. / Paris (Lang), 1990.

Wayback Machine at Divers online Arkivuar 21 prill 2018 "Albanezi - Date demografice" Arkivuar 11 gusht 2010 tek në Wayback Machine; retrieved February 26, 2008.

PROF. DR. ALI JASHARI

**DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË**

A KA NJË “CONTRADICTIO IN ADJECTO” MES SHQIPES DHE TË FOLMEVE TË SAJ?

Abstrakt

Kjo nuk është një pyetje retorike, por një çështje e përshenjtur prej kohësh e që është në rend të ditës për studiuesit e shqipes. Cilat janë pikëpamjet kryesore të shprehura nga studiuesit shqiptarë dhe të huaj? A ka një contradictio in adjectio në fjalorët shpjegues kombëtarë, dialektorë dhe krahinorë. “Lufta” për fjalët dhe mes fjalëve.

Në kumesë sillen argumente dhe shembuj konkretë për të ashtuquajturën “contradictio in adjectio” në katër rrafshë: në rrafshin fonetik (cilat janë “kundërshtitë e brendshme”); në rrafshin morfologjik (trajta e shquar, gjinia, shumësi i emrave, foljet e parregullta, pjesoret e foljeve etj.; shembulli i Kadaresë); në rrafshin leksikor (sidomos në lidhjet sinonimike të fjalëve, si kokë/krye, gjalpë/ tlyem, qumësht/ tamël etj.), në formimin e çifteve homonimike të leksikut të shqipes, përputhjet e rastësishme fonetike si burim homonimesh; në idiomatikë (si perceptohet “forma e brendshme” në njësi frazeologjike të njëjta nga kuptimi, por të ndryshme nga burimi, vatrat kuptimore mbi bazën e të cilave lind “contradictio in adjectio” në fushën e frazeologjisë, rasti ngre kokë/ ngre krye).

Fjalët kyçe: *contradictio in adjectio; rrafshë gjuhësore, fjalorë kombëtare dhe krahinorë, lidhje sinonimike, lidhje homonimike, idiomatikë, formë e brendshme etj.*

Kjo nuk është një pyetje retorike, por një çështje e përshenjtur prej kohësh në gjuhësinë shqiptare. Para se ta shtjellojmë dhe të argumentojmë përgjigjen për këtë pyetje, na duhet të sqarojmë se shprehja latine *contradictio in adjecto*¹ në këtë kontekst nuk përdoret për të shënuar mjete stilistike të tipit “heshtje që flet”, apo “Si ta them të shkretën vajtje/ që ndiej në zemër ças-për-ças/ atë durim të pa-duruar/ të zemërimeve pa gaz (te Lasgush Poradecit)², por për të shprehur në mënyrë të perifrazuar se a ka një kundërthënie, a kundër-vënie, a kundërshti të

¹ Shih: A. Jashari, *Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2007.

² Shih J. Thomai, *Studime për gjuhën shqipe, III*, Tiranë 2017, fq. 173-175.

brendshme mes gjuhës shqipe si një e tërë dhe dialekteve a të folmeve si pjesë të saj?

Përgjigjen apo përgjigjet për këtë pyetje mund t'i përimitohen në shumë anë të sistemit gjuhësor, por në kumtesën tonë po marrim në sy vetëm sistemin leksiko-frazeologjik, duke veçuar *lidhjet kup-timore sinonimike*, *lidhjet homonimike*, *aftësitë fjalëformuese* dhe *lidhjet idiomatike* që krijohen mes fjalëve. Për këtë kemi analizuar katër shembuj, (tre vargje sinonimikë dhe një çift sinonimik) nga qindra të tillë:

I. asht,-i ≈ eshtër ≈ kockë (koc);

II. litar≈konop≈tërkuzë≈fërtomë (fortomë);

III. gjel≈këndes≈kokosh≈kaposh≈këndues≈kanxh≈gollak;

IV. tëlyen ≈ gjalpë;

I. asht,-i ≈ eshtër ≈ koc (kockë)

Fjala e parë *asht,-i* është e mbarë gjuhës dhe, siç shihet, krijon lidhje sinonimike me dy-tre fjalë të tjera që shenjojnë të njëjtën realie.

Hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera³:

ASHT,-I m. éshtra, éshtrat. anat. Kockë, eshtër: *E i afëruo ashtë endaj ashtë* (Buzuku). *Nxorri ashtë kali* (Th. Mitko, FShG). *Ashtin e thatë nuk e lpin kush* (fj.u.). *Ashti i krahut (i këmbës)*//ASHT,-I m. sh.-a(t). Kopsë e vogël prej kocke//ASHT,-I m. sh.-a(t). bot. Bimë barishtore me gjethe të vogla vezake dhe me lule ngjyrëvjollcë, që, kur këputet lëshon, një lëng të bardhë//ASHT,-I m. sh.-a(t). Ahishtë, ashtë, pyll ahu: *Asht ba si Ashti i Bjeshkës së Keqe-është* shëndoshur shumë (M. Elezi, FGjSh)//ASHT_v mb. Që ka shumë kocka: *E ke ble mishin asht* (M. Elezi, FGjSh).

Shërben si temë fjalëformuese për disa fjalë: *rrashtë* “kafkë”; *ashtnor*, *ashtnim*, *ashtëroj*, *ashtërim*, *ashtnore* “vend ku lihen eshtnat e të dekunve”.

Është vatër kuptimore për shumë njësi frazeologjike e shprehje të tjera idiomatike: *ashti i burrit*; *është bërë asht e lëkurë (dikush)*, *është bërë ashti i thatë*, *është bërë asht e zhëngë (dikush)*; *(flet) sikur zien asht (dikush)*, *të hëngërt dreqi eshtnit! mallk.*, *është asht i vjetër (dikush)*, *mos t'u kalbtë ashti kurrë ur*.

³ Për këtë dhe shembuj të tjerë homonimesh, shih Ali Jashari, *Fjalor i homonimeve në gjuhën shqipe*, ASHSh, Tiranë 2020.

mos vdeksh kurrë!, e ka ashtin të fortë (dikush), e ka ashtin hirrë (dikush), e la në asht (dikë a diçka), i ka lënë ashta e rrashtë, me mbetë si ashti në hu, ka mbetur asht e lëkurë (dikush), i mbeti (i ngeci) ashti në fyt (dikujt), mbeti si ashti në hu (dikush), iu ngjit lëkura për asht (dikujt), nuk i është pjekur ashti (dikujt), ia shkokloi eshtrat si kokrrat e drithit në boçë, m'u shkoq ashti i kurrizit, ia shkoqi ashtin e kurrizit, Më ka vajtur (më ka shkuar) thika në asht etj.

Fjala e dytë *eshtër* është shumësi i singularizuar i *asht*, sinonim i saj, e trashëguar nga fondi indoevropian.

Nuk hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera.

Shërben si temë fjalëformuese: *eshtërák,~e, eshtërgjërë, eshtë-rí,~a, eshtërí,~i, eshtërmádh,~e, eshtëróhet, eshtëró, ~e eshtak,~e, éshtërt (i,e), eshtëtráshë, eshtë,~e etj.*

Ka vetëm disa njësi frazeologjike me vatrën kuptimore *eshtër*: *la eshtrat vdiq; ia theu eshtrat etj.*

Fjalët e tretë *kockë (koc)* hyn në lidhje sinonimike me *asht* dhe *eshtër*.

Nuk hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera.

Shërben si temë fjalëformuese: *kockëbútë, kockëdálë, kockëfórtë, kockëgjërë, kockëhóllë, kockëmádh,~e, kockë-rína,~t dhe kockurína,~t f. vet. sh., kockëtráshë, kockëvó-gël, kockór,~e, kocomí,~u, koconár,~i etj.*

Shërben si vatrë kuptimore për shumë njësi frazeo-logjike: *u bë kockë (diçka), u bë kockë e lëkurë (dikush), i ranë kockat, deri sa të më bien kockat, ia bluajti kockat, cipë e kockë, i kanë dalë kockat (dikujt), të ha me gjithë kocka, më ka hyrë (deri) në kockë, (është) kockë e fortë, është kockë në fyt (në grykë), është kockë e moçme, i dha (i hodhi) një kockë (dikujt), iu kalbën koskat, s'ka kockë (për të bërë një punë), e ka zemrën me kockë (dikush), i ka kockat ujë, i kërcasin kockat (diçkaje), kjo kockë e di, me kocka e kokalla, për një kockë gjer në Poloskë! tall. la kockat, i la kockat udhëve (rrugëve), mbledh (shpij) kockat, me mish e me kockë, ia theu kockat, lëpin kockat e hedhura, ka zemër me kockë, janë si mishi me kockën (me thuan), i mbeti kocka në fyt, mblodha kockat, nuk i është pjekur kocka (dikujt), pret të bien kocka nga qielli, më shkrinë kockat, ia shprishi kockat, i ka vajtur (i ka shkuar) thika në kockë, nuk e ka vrrarë kockën (dikush), sikur i kanë zënë kockat çmërsh, sikur i ka zier kockën (dikujt), (flet) sikur zien kockën etj.;*

Ia brini (ia shtrydhi) kocin (dikuajt), është një dorë (grusht) kocij (dikush), një dorë (nji grusht) kocij, është koc e lëkurë (dikush), s'të jep kocin e morrit (dikush), i ka mbetur fillja e kocit (dikuajt), iu nxiftë koci! (dikuajt) mallk., më ka rrjedhur koci ujë (për dikë a për diçka), më ka therur në koc (diçka) etj.

II.litar,-i ≈ konop ≈ tërkuzë≈ fërtomë (fortomë)

Fjala *litar* është huazuar nga greqishtja dhe është sinonime me fjalët *konop* e *tërkuzë*.

Hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera:

LITÁR,-I_I *m. sh.*-ë(t). Tufë fijesh kërpi etj. të përdredhura, që përdoret për të lidhur kafshët, tërkuzë, konop, fërtomë, lidhës: *Me një copë litār shtim n qafë* (P. Budi, RR). *Në shtëpinë e varurit s'flitet veç për litar* (I. Kadare, FS). *Lidhe me litar*. // LITÁR,-I_{II} *m. sh.*-ë(t). Masë gjatësie rreth dhjetë-dymbëdhjetë metra: *Arritën me një litar diell. Një litar kali larg*. // LITÁR_{III} *ndajf.* Me pika të trasha, të dendura dhe pa ndërprerje; me rrëshekë: *Shiu binte litar*. // LITÁR_{IV} *ndajf.* Shumë (me mbiemrin e gjatë): *Dita i dukej litar e gjatë*.

Shërben si temë fjalëformuese për disa fjalë: *i litartë, litarth* (zorra e kërthizës), *litarthi*.

Shërben si vatër kuptimore për shumë njësi frazeologjike:

e bëri litar (diçka), bën litar me rërë (dikush), e bëri litar vrahu (diçka), pa bërë litar, e binte litar-litar (diçka), mos bli litarin, pa blerë kalin (lopën etj.), e do pa litar e pa kandar (dikush), do litar prej rane (prej rëre), ia drodhi litarin (dikuajt), nuk e duron litarin në fyt, kur flet ai, pret litar, ha pa litar, i hodhi (i vuri) litarin në qafë (në grykë) (dikuajt), ia heq litarin (dikuajt), s'të jep as litar përt'u varur (dikush), është i drejtë si litari në thes (dikush) iron. është në litar, është me litar në qafë (dikush), është litar thesi (dikush), e ka litarin në qafë (nëgrykë) (dikush), s'e kam për ta nxjerrë në litar, ia këputi litarin (dikuajt), ka këputur litarin, kërkon litar për brirët, kërkon litar prej rëre (dikush), i lëshoi litarin (dikuajt), të lëshon litarin nëpër këmbë, të lidh pa litar, me litar nëpër këmbë, me litar në qafë (në grykë), si litar i zhdredhur, e luan në litar (dikë), u mbështoll litari gjer te strumbullari, iu mblodh litari (dikuajt), ia mblodhi litarin(litarët) (dikuajt), po pëshillet litari, ia preu litarin (dikuajt), presin litarin bashkë,i rrinte me litar në grykë (dikuajt), shkoi në litar (dikush), (shpëton) si litari në

dhjamë (dikush), as nuk të var, as nuk ta heq litarin (dikush), do varur në litar pa sapun (dikush), nuk e vë qafën në litar (dikush) etj.

Fjala e dytë sinonime *konop*, është huazim nga sllavishtja, prej emrit të kërpit në latinisht.

Hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera:

KONÓP,-I m. sh.-ë(t). Kafshë e egër, bishë (Th. Mitko, FShG). // KONÓP,-II m. sh.-ë(t). Litar i hollë: *Lidh me konop. Të dredh në konop* dikush-të mashton (H. Shehu, FU).

Shërben si temë fjalëformuese për fjalët *konópas* “një lojë fëmijësh” (Kosovë) dhe *konopishtë* “shkurre me gjethe të holla, të tulta e përherë të gjelbra, me lule të varura si vile, që përdoret për zjarr; marenë” (Jug).

Shërben si vatër kuptimore për shumë njësi frazeologjike:

aq i mbërrin konopi (dikujt), e bëri konop dushku, e bën konop me një (diçka), me çue në konop (dikë), ia ka dredhur konopin (dikush/dikujt), të dredh në konop (dikush), i drejtë si konopi në thes, i gjykuem në konop, është me konop në fyt, është i mirë për konop të lagur, ta lësh konopin zhag, e lëshon konopin zhag, të mbledh konoptë, po e ngrehe (po e tërhoqe) konopin zhag ta shkel gjithkush, nuk ta pret konopin, s’ta pret konopin (lakun) me të pa vjerrë, e qiti në konop, me më qitë në konop, me e pa në konop nuk ia ngjes dorën etj.

Fjala e tretë sinonime *tërkuzë* ka përdorim të gjerë.

Nuk hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera.

Shërben si temë fjalëformuese për fjalët *tërkuzar* (ai që bën litarë), *tërkuzore* (teleferik) dhe *tërkuzas* (lojë fëmijësh, litarthi). Del edhe si emër i një lumi në periferi të Tiranës.

Shërben si vatër kuptimore për disa njësi frazeologjike: *u bë tërkuzë (diçka), e bëri tërkuzë (diçka), mblidhet tërkuzë, tërkuzë e dhirtë* njeri me turp të lartë, të dobët e të thatë, *shtron tërkuzë keq. e zgjat, e stërhollon, një tërkuzë larg*

Fjala e katërt sinonime *fërtomë* (*fortomë*), nuk hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera, nuk shërben si temë fjalëformuese për krijimin e ndonjë fjale të re; është vatër kuptimore për 3-4 njësi frazeologjike: *ia preu fërtomën* ia hoqi pengesën që kishte përpara; *ia ka zënë këmbët fërtoma* ka përpara një pengesë; *bie shi me fërtoma* bie shumë shi, bie shi me litarë.

III. gjel ≈ këndes ≈ kokosh ≈ kaposh ≈ këndues ≈ kanç(xh) ≈ gollak

Fjala *gjel*, që prin vargun e mësipërm sinonimik, është e mbarë gjuhës dhe, siç shkruan akad. Kolec Topalli “në disa të folme konkurron me *këndes*, *këndues*, *kaposh*, *kokosh* etj.”⁴

Hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera:

GJEL,-I m. sh.-a(t). zool. Mashkulli i pulës, këndes, kaposh, kokosh: *Lafsha e gjelit*. Fryhet si *gjel*. *Gjel i egër*. // GJEL,-I m. sh.-a(t). Thelë, copë, pjesë, çark, falë: ‘*I gjel thiut* (Gj. Shkurtaç, FK).

Shërben si temë fjalëformuese për fjalët: *gjele*, *gjelëz* “një lloj shpendi i egër, *gjelosh*, *gjelac* “pupëz, *gjelaman* “një lloj fluturë me ngjyrë të gjelbër, *gjelastrak*, *gjeluc*, *gjelush*, *gjelastran* “gjel i vogël”, *gjelcak* “kosore si kmesë me presë në trajtën e lafshës së gjelit” (Korçë), *gjelas*, *gjelazi* “anash në kurriz”, “duke u zënë, duke u grindur”, “njëlloj, bara-bar”, *gjelash* “një lojë fëmijësh”, *gjelohem* “kapardisem, krekosem (si gjel)” (Kukës), *gjelashiten* “kapen gjelat”, fig. “kapen me fjalë”, *gjelafitem* “kapem”, *gjelthi*, *ngjelthi* “gjelas, duke u zënë”, “njëlloj, barabar”, *kacagjel* “milingonë e madhe”, fig. “mburravec”, *kacagjelohem* “mburrem, kapardisem”, *kacagjelthi* “duke u kapardisur”; në Kosovë *kacagel* “me këmbë të gjata (si të gjelit)”, *gjelegër*, *gjeldet*, *gjeldetës*, *gjelafytem*, *gjelazez* “një lloj shpendi i egër, që ushqehet me peshq”, *gjelkokosh*, *gjeldash* “kokërr misri që ka plasur në zjarr”, *gjelujës* “gjel uji”, *pupagjel* “kokoshkë”, *gjysmagjel* “figurë e përrallave shqiptare” etj.⁵

Është vatër kuptimore për mjaft njësi frazeologjike: *i bën gjeli vezë (dikujt)*, *kur të bëjë gjeli vezë*, *ia bën gjelit me sy (dikush)*, *ka rënë si gjeli ndër pula (dikush)*, *i dal gjel kaproll (dikujt a diçkaje)*, *është gushavur si gjel deti (dikush)*, *gjel pa brekë*, *gjel gollak*, *si gjeli pa krye*, *me një gjel plaçka*, *si gjeli majë plehut (në plehë)*, *si gjeli ndër pula*, *gjel në pula*, *si gjeli në thekër*, *ia ha gjeli qurret (dikujt)*, *ka ngrënë mish gjeli (dikush)*, *hidhet (kërcen) si gjel*, *është gjel i egër (dikush)*, *është si gjeli në gardh*, (është) *gjeli i konakut*, *është si gjeli në rrumbull të plehut*, *këndon si gjel (dikush)*, *kanë kënduar gjelat*, *më këndojnë dyzet gjela (mbi kokë)*, *kur këndojnë gjelat e parë*, *s’i këndon më gjeli në shtëpi (dikujt)*, *sa këndoi gjeli tretë*, *nuk këndon gjeli pa i ardhur vakti*, *i këndon gjeli mbi samar*, *kërcen si*

⁴ Kolec Topalli, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë 2017, fq. 590.

⁵ Po aty, fq. 590-591.

gjel (si gjeli në thekër), mbahet si gjeli në brekë, s'mban gjeli brekë, ngrihet që me gjelat, përpushet si gjeli pa kokë, i pjell edhe gjeli, kur të pjellë gjeli, s'pyet Muçoja për gjela deti, i rri si gjel, shkon si gjel me lafshë përpjetë etj.

Fjala e dytë *këndes* është formim i brendshëm nga *këndoju*, sinonim me përdorim më të përgjithshëm.

Si fjalë e prejardhur nuk krijon lidhje homonimike, por tema fjalëformuese e saj ka krijuar lidhje të tilla:

KËNDÓJ_I *fol.*, -óva, -úar. Nxjerr me zë tinguj muzikorë, ia marr një kënge; jam këngëtar: *Këndonjinë kankënë e re* (Buzuku). *E zogjtë e malit këndojnë/ dikush afër, dikush larg* (M. Camaj, V, 2). *Ndër vallet vajzat këndojen rrap-sodhin e Skandërbekut e t'Arbris* (Ll. Perrone, FE). *Këndon bukur (shtruar si bilbil). Këndon e kërcen.* // **KËNDÓJ_{II}** *fol.*, -óva, -úar. Lexoj: *Di (ka mësuar) të shkruajë e të këndojë.* // **KËNDÓJ_{III}** *fol.*, -óva, -úar. vjet. Ysht: *Në sepet vate e vloj/ me tre hoxhë e këndoi* (Q. Haxhihasani, FÇ). *E këndonte prifti (hoxha, yshtësja).* // **KËNDÓJ_{IV}** *fol.*, -óva, -úar. Vë në lojë, tall. // **KËNDÓJ_V** *fol.*, -óva, -úar. Mbaroj; shpërdorj: *Ia kënduan rakisë.*

Është temë fjalëformuese për dy fjalë të tjera, që formojnë një çift homonimesh: **KËNDESK/Ë**, -A_I *f. sh.* -a(t). Zog i vogël pule⁶. // **KËNDESK/Ë**, -A_{II} *f. sh.* -a(t). Monedhë e vjetër floriri, që ka të stampuar figurën e këndesit⁷.

Shërben si vatër kuptimore për disa njësi frazeologjike:

çdo këndes këndon në plehun e tij, çirret si këndesi në mëngjes, s'di këndesi të mbajë brekë, dy këndesë në një pleh, ecën si këndes çallmaxhuk, hahen si këndesat majë plehut, si këndesi pa bisht, si këndes pa brekë, si këndesi majë plehut, këndes pa pendë, me një këndes plaçka, si këndesi majë plehut, i këndon këndesi në bark, i ka kënduar gjithnjë këndesi, (ngrihet) me këndesin e parë, ç'mban këndezi me dy krahë, i pjell edhe këndesi (dikujt), kur të pjellë këndesi, nuk shtron këndesi në vezë etj.

Fjala e tretë sinonime kokosh është huazim nga bullgarishtja (sikurse del edhe në rumanisht e hungarisht).

⁶ Shih Qemal Murati, *Fjalor i fjalëve dhe i shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*, Shkup, 2015, fq. 114.

⁷ Shih Ali Jashari, *Fjalori leksiko-frazeologjik i Devollit*, Korçë, 2016, fq. 260.

Prej saj është formuar fjala *kokoshkë* “pupagjel”; *kokoshtar* (kokosh-tar) “njeri mendjemadh”⁸.

Krijon lidhje homonimike:

KOKÓSH,-I m. sh.-ë(t). Këndes, gjel: *Dy kokoshë në një pleh nuk këndojnë-fj.u.* // KOKÓSH,-II m. sh.-ë(t). Pupagjel, kokoshkë. // KOKÓSH,-III m. sh.-ë(t). Milingonë.

Është vatër kuptimore për disa njësi frazeologjike: *ku ka shumë kokoshë, s’merret vesh kur gdhihet; i këndon kokoshi; me një kokosh plaçka; si kokoshi majë samarit; i pjell edhe kokoshi* etj.

Fjala e katërt *kaposh*, të cilën prof. Çabej e nxjerr si formim të brendshëm nga kryqëzimi *kapua* (kapoi) me sufiksin *-osh*⁹.

Hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera:

KAPÓSH,-I m. sh.-ë(t). Këndez, kokosh, gjel; pak plaçka: *Kaposh deti.* (K. Kristoforidhi, FShG). *Kaposh i egër. Me një kaposh plaçka-me fare pak plaçka; shumë i varfër* (J. Thomai, FFGjSh). // KAPÓSH,-II m. sh.-e(t). *zool.* Milingonë e madhe me ngjyrë të kuqërreme; kacagjel. // KAPÓSH,-III m. sh.-e(t). Pufkë, pupagjel: *Kërcejnë kaposhët në tigan.* // KAPÓSH,-IV m. Lloj qëndisjeje (me kryqe).

Prej saj formohet fjala *kaposhkë* “pupagjel, gjldash”.

Është vatër kuptimore për mjaft njësi frazeologjike:

është bërë si kaposh deti, nuk bie kaposhi në zogj, del kaposh mbi të tjerët, (e gënjeu) si kaposhi pulën, ia ha kaposhi bukën na dora, je kaposh e kaposh do jesh, ka kaposhin në mes samarit, kaposh i egër, si kaposhi majë plehut, si kaposhi mes pulave, si kaposh majë samarit, u katandis kaposhi një thelë, i ka kënduar kaposhi gjithë jetën, këndon kaposhi e jo pula në shtëpi, si lafsha e kaposhit, mbeti si kaposhi plak, ngeci kaposhi në lakror, me një kaposh plaçka, i pjell edhe kaposhi, plasi si kaposh misri, i rri kaposh mbi kokë, kur të shtrohet kaposhi mbi vezë, nuk shtrohet kaposhi në zogj etj.

⁸ Po aty, fq. 120.

⁹ Shih: E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipës, V, K-M*, Tiranë 2014, fq. 42.

Fjala e pestë *këndues* është formuar nga *këndoji*. E ka Buzuku “*parë se të këndonjë kënduesi, tri herë...*”¹⁰. Këtë fjalë e shënon së pari Kristoforidhi: *këndues, -i* gjel¹¹. Nuk e ka FGJSSH (1980).

Hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera.

KËNDUES, -I m. sh. -a(t). Gjel, këndes: *Ku ndonji zogë a ndonji këndues* (Gj. Fishta). *E muer me vedi qenin, macën dhe knusin* (A. Çeta).// KËNDUES, -II m. sh. -a(t). thelbi i plotë i arrës, kanxh: *Më duel arra këndues* (M. Elezi).// KËNDUES, -III sh. - (t). Yshtës, yshtar. (nga këndoju^{III} për “ysht, shqiptoj fjalë a formula magjike për të shpëtuar dikë nga ndonjë e keqe”).

Nuk formon ndonjë fjalë të re.

Është vatër kuptimore vetëm për disa njësi frazeologjike: *dikuj edhe knduesi i ban voe e dikuj as pula; shkoi knduesi për ni çaj rusi* (kur je i varfër harxhoh kot më të shtrenjtën, se atë ke); *e ka kënduesin në ferrë (dikush), kur të këndojë kënduesi i parë, i këndon kënduesi në prag të derës, knduesi asht hanori (sahati) i të vorfnit etj.*

Fjala e gjashtë sinonime është *kanç(xh), -i*, që, sipas M. Elezit¹² vjen nga *kangë* me sufiks *in ç*.

Hyn në lidhje homonimike me fjalë të tjera:

KANXH, -I m. sh. -a(t). Gjel, këndues: *Kanxh i groshëm* (M. Elezi, FGjSh). *Na kndoi kangji n'çarranik* (R. Sokoli).// KANXH, -II m. sh. -a(t). Thelbi i plotë i pacopëtuar i arrës (në gjuhën e fëmijëve): *I theva arrat e më duelën katër kanxha* (M. Elezi).

Nuk është formuar deri tani ndonjë fjalë të re mbi bazën e saj.

Është vatër kuptimore për mjaft njësi frazeologjike dhe shprehje të tjera: *dy kanxha në ni pleh nuk shprushin, dy kanxha s'mun këndojnë në ni pleh, këndon si kanxhi në pleh, mashkull asht edhe kanxhi, po burrë s'i thotë kush, dijen ia çon kanxhi* “nuk di, ka pak mend”, *hahen si kanxhat, ka një kanxh çakla* “është shumë i varfër”, *kur të bajë kanxhi voe* “kurrë, asnjëherë”, *ku s'ndihet kanga e kanxhit* “ku ha pula gur”, *me i ndenjë kanxh mbi krye* “e mbikëqyr vazhdimisht”,

¹⁰ Po aty, fq. 77.

¹¹ Shih: K. Kristoforidhi, *Fjalor shqip-greqisht*, 1961, fq. 155.

¹² Shih Mehmet Elezi, *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë 2005, fq. 659.

me i hipë kanxhit “i merr gjërat lehtë”, *me një kambë si kanxhi* “pa përkrahje, pa mbështetje”, *nuk e kam në shpatull të kaxhit* “nuk e përfill, nuk e llogaris”, *si kanxh i sëmutë* “turivarur”, *si kanxhi krye-këputun* “pa ditur ku shkon e çka bën”. Fjala e shtatë sinonime është *gollak* “gjel race, me trup të madh e me këmbë të gjata, me qafë të rrjepur, që këndon me një zë të trashë e të ngjirur”, si formim i brendshëm me prapashtesën *-ak* nga sllav. *gol* “i zhveshur, lakuriq”.

Në FGJSSH (1980)¹³ jepet edhe me kuptime të figurshme për një njeri që e ka zërin të trashë e të ngjirur (*këndon si gollak*) dhe për dikë që është mendjelehtë. Edhe në fjalorët sinonimikë¹⁴ për shqipen për *gollak* jepen sinonimet *zëtrashë* dhe *mendjelehtë*. Te Pano Tase e gjejmë si mbiemër “këndes gollak, gjel gollak: zëtrashë”¹⁵. H. Shehu e jep si mbiemër *gollak* “që është me golle, i zbrazët: *vend me golle*

Nuk hyn në lidhje homonimike, nuk shërben si temë fjalëformuese dhe as vatër kuptimore për njësitë frazeologjike.

Vargut sinonimik *gjel* ≈ *këndes* ≈ *kokosh* ≈ *kaposh* ≈ *këndues* ≈ *kanç(xh)* ≈ *gollak* mund t’i shtojmë edhe sinonime të tjera, si *kadoc*, *kikirec*, *titiraç* (*gjel* i vogël që këndon shumë), *përfendç* etj.

IV. *tëlyen* ≈ *gjalpë*

Fjala *tëlyen* e pëngjitur nga pjesorja e *lyej* me nyjen *të* (gjinia asnjënjëse), dëshmohet qysh te Buzuku (*Aj kâ me ngranë tëlyenë e mjaltë*)¹⁶ dhe është sinonime me *gjalpë*.

Nuk hyn në lidhje homonimike me asnjë fjalë tjetër.

Shërben si temë fjalëformuese për fjalët *tëlynore* (bimë barishtore) dhe ***tëlyençe*** (e ëmbël, që shkrihet në gojë).

Shërben si vatër kuptimore për disa njësi frazeologjike: *ka rënë tëlyeni në të hollë maze*, *e bleu për tëlyen e i doli dra*, *ka ngrënë tëlyen me grusht (me pehar)*, *me*

¹³ Shih FGJSSH (1980), fq. 563

¹⁴ Shih J. Thomai etj., *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005, fq. 313; Ali Dhrimo etj., *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë 2007, fq. 134

¹⁵ Pano Tase, *Fjalor dialektor (me fjalë e shprehje nga Jugu i Shqipërisë)*, Tiranë, 2006, fq. 90

¹⁶ Shih: K. Topalli, *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2015, fq. 909.

tëlyen hahen edhe lëvozhgat e ahut, tëlyeni kallajis vajin, tëlyeni shkrin edhe lëvoren e qarrit, e ka zënë tëlyeni (dikë) etj.

Fjala sinonime *gjalpë*, është trashëguar nga fondi indoevropian dhe ka përdorim të gjithëmbarshtëm.

Nuk hyn në lidhje homonimike me asnjë fjalë tjetër, por, siç shihet më poshtë, fjalët e formuara prej saj *gjalpëtore*_I “që e ka qumështin me shumë yndyrë”: *lopë gjalpëtore*; *gjalpëtore*_{II} “një bimë barishtore që e ha shumë bagëti, janë homonime leksikore”.

Shërben si temë fjalëformuese për fjalët: *gjalpanik* “lloj byreku”, *gjalpëtore* “që e ka qumështin me shumë yndyrë: *lopë gjalpëtore*” dhe “një bimë barishtore që e ha shumë bagëti”, *gjalpani* “ëmbëlsirë me miell misri a gruri të përzier, me vezë e me shumë *gjalpë*”, *i pagjalpë* “i palyrë”.

Shërben si vatër kuptimore për disa njësi frazeologjike: *i bën arrat gjalpë arixheshke, e bëri për gjalpë të skuqur, gjalpë i gjallë, gjalpi në lakror është, gjalpë i mirë në lëkurë të qenit, gjalpi tret edhe gurët fj.u., e kam gjalpin në fasule (në lakra), e ka si gjalpin në tepsi (dikë), e ka (shkon, është) gjalpë e vaj (me dikë), e ka mjaltë e gjalpë (me dikë), kërkon petulla me gjalpë, shkon gjalpë e vaj, ia leu bukën me gjalpë (dikujt), nxjerr gjalpë nga uji (nga guri), (shkon, ecën) si në gjalpë (diçka), si thika në gjalpë etj.*

Siç shihet, faktet flasin vetë. Sistemi leksikor i gjuhës i jep të gjitha mjetet për të përmbushur funksionin themelor të saj. Për të njëjtën realie përdoruesi i gjuhës ka mjaftueshëm shenjues që ta shprehë mendimin sa më qartë e sa më bukur, me të gjitha nuancat kuptimore e stilistiko-emocionuese, si fjala *titiraç* (duhet të jetë formim onomatopeik) për gjelin e vogël që këndon shumë.

Çiftet dhe vargjet sinonimikë janë të hapur, i përfshijnë fjalët pa asnjë dallim, se vetë gjuha është e tillë. Po kështu ndodh edhe në fushën e homonimisë kur përdoret i njëjti shenjues për realie të ndryshme. Lidhjet homonimike krijohen në të shumtën e rasteve brenda fjalëve të shqipes. Këtë mund ta dëshmojmë me faktin se në 6500 paragrafë homonimikë me rreth 17.000 njësi homonimike¹⁷ që trajtohen leksikografikisht në *Fjalorin e homonimeve të gjuhës shqipe*, shumica

¹⁷ Shih Ali Jashari, “*Fjalor i homonimeve në gjuhën shqipe*”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2020.

dërrmuese e lidhjeve janë krijuar me fjalë brenda shqipes, qoftë nga përputhja fonetike, qoftë përmes fjalëformimit a shpërbërjes së polisemisë.

Edhe ndërtimet e qëndrueshme idiomatike janë një tjetër tregues i larmisë së madhe të fjalëve sinonime që shërbejnë si vatra kuptimore të tyre. Për shembull, mund të themi *e bën litar*, *e bën konop* (e zgjat shumë), por *e bën tërkuzë* mbizotëron në përdorim. Mund të themi *një këndes* (*një kokosh*, *një kaposh*) *me plaçka*, por jo *një këndues me plaçka*; sikurse nuk *e kam në shpatull të kanxhit* “s’e përfill, s’e llogarit), është formim i njëmendtë, sepse nuk haset në shqipe një formim analogjik sipas tij dhe të thuhet *s’e kam në shpatull të gjelit* (*të kaposhit*, *të gollakut*) etj.

Analiza që bëme më lart në bazë të lidhjeve sinonimike, homonimike, idiomatike dhe aftësive fjalëformuese të fjalëve ne bind që pyetjes së bërë në titullin e kumtesës sonë duhet t’i përgjigjemi se nuk ka një dukuri të tillë. Gjuha, siç dihet, ka ligjësitë e veta. Në gjuhë asgjë nuk është e tepërt, e padobishme, përndryshe mund të themi se gjuha është si puna e lejlekut që i hedh jashtë folesë së saj zogjtë e pasaktë, të gjymtuar, ndaj dhe ka lindur shprehja “e hodhi si lejleku shtërgun”.

PROF. DR. BERTON SULEJMANI

FAKULTETI I FILOLOGJISË

UNIVERSITETI I TETOVËS

berton.sulejmani@unite.edu.mk

PROF. DR. IZMIT DURMISHI

FAKULTETI I FILOLOGJISË

UNIVERSITETI I TETOVËS

izmit.durmishi@unite.edu.mk

**ARRITJET DHE PROBLEMET E ZBATIMIT TË GJUHËS SHQIPE NË
INSTITUCIONET SHTETËRORE DHE PRIVATE TË MAQEDONISË
SË VERIUT**

Abstrakt

Në këtë kumtesë do t'i trajtojmë arritjet dhe problemet e zbatimit të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore dhe private të Maqedonisë së Veriut. Me ndryshimet e fundit kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në gazetën zyrtare të 14 janarit 2019 u shpall edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Sipas këtij ligji, madje, po të krahasohet me ligjet paraprake, përkatësisht, nga pavarësimi i këtij shtetit 1991 (emërtimi i mëparshëm: Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë) e deri me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës (17 qershor 2018) mes IRJM-së dhe Greqisë, përdorimi i gjuhës shqipe ka një ngritje, por nuk është plotësisht e barabartë me maqedonishten. Me fjalë të tjera, gjuha shqipe është në përdorim zyrtar, por jo zyrtare. Pjesë e punimit do të jenë edhe problemet dhe gabimet gjuhësore që paraqiten në mbishkrimet publike e private në qytetin e Shkupit dhe të Gostivarit.

Fjalët kyçe: *gjuhë zyrtare; gjuhë në përdorim zyrtar; shqipja standarde*

1. Korniza ligjore. Ligji për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Statusi i komuniteteve në shtetet multietnike, dallon sikurse në aspektin juridik-kushtetues, gjithashtu edhe në atë praktik. Diversiteti duhet pranuar si vlerë, e jo vështirësi e funksionimit të shteteve bashkëkohore, bazuar në faktin e numrit të madh të etniteteve të cilat ekzistojnë dhe gjuhëve të ndryshme. Përdorimi i lirshëm i gjuhës, është një e drejtë elementare që mund t'i

garantohet një komuniteti¹⁸. Ndërsa, në Maqedoninë e Veriut, krahas etnitetëve pakicë (turq, boshnjakë, serbë, romë, etj.) etniteti maqedonas dhe ai shqiptar përbëjnë grupet më të mëdha në shtet. Ky i fundit (pra etniteti shqiptar) përbën mbi 35% të popullatës në vend.

Me ndryshimet e fundit kushtetuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në gazetën zyrtare të 14 janarit 2019 u shpall edhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve. Sipas këtij ligji, madje, po të krahasohet me ligjet paraprake, përkatësisht, nga pavarësimi i këtij shtetit 1991 (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, në vazhdim: IRJM) e deri me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës (17 qershor 2018) mes IRJM-së dhe Greqisë, përdorimi i gjuhës shqipe ka një ngritje, por jo plotësisht e barabartë me maqedonishten. Me fjalë të tjera, gjuha shqipe është në përdorim zyrtar, por jo zyrtare. Gjuha shqipe vetëm në dy shtete të Ballkanit është gjuhë zyrtare, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës, ndërsa në Maqedoninë e Veriut gjuha shqipe është pjesërisht zyrtare. Siç dihet, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, ky shtet filloi të quhet Republika e Maqedonisë së Veriut (maq. Република Северна Македонија – Republika Severna Makedonija). Nenet 1, 2, dhe 3 në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve paraqesin bazë mbi të cilën shtrihet përdorimi i gjuhëve zyrtare, përkatësisht gjuhë që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuhës shqipe). Në këto nene përcaktohen institucionet dhe niveli i pushtetit në të cilin ka shtrirje ky ligj. Nëse në pushtetin lokal duhet që këshilli i komunës të vendosë për gjuhët zyrtare, ky ligj vë themelin për zbatimin e gjuhës shqipe në institucionet shtetërore. Për çdo eventualitet, në vazhdim po e japim nenin 1 dhe nenin 2 të ligjit në fjalë:

Neni 1

- (1) Në tërë territorin në Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.*
- (2) Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në pajtim me këtë ligj.*
- (3) Në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe*

¹⁸ Arsim Bajrami, *Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës*, f. 230, Prishtinë, 2011.

organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet tjera, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(4) Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti që e shfrytëzojnë së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve në të cilat flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Neni 2

(1) Qytetarët kanë të drejtë ta përdorin cilëndo nga gjuhët e theksuara zyrtare dhe alfabetet e tyre nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, ndërsa institucionet nga neni 1 paragrafi (3) të këtij ligji si dhe institucionet tjera e kanë për obligim që t'u mundësojnë qytetarëve shfrytëzim, përdorim dhe zbatim të atyre gjuhëve zyrtare dhe alfabeteve të tyre në cilëndo qoftë procedurë, si edhe zbatim të atyre procedurave në atë gjuhë zyrtare dhe në atë alfabet.

(2) Në pajtim me të drejtën e qytetarëve që ta përdorin cilëndo nga gjuhët e cekura zyrtare nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji në procedurat gjyqësore, administrative, ekzekutive, procedurat parahetimore dhe hetimore, procedurat penale dhe për kundërvajtje, procedurat kontestimore dhe jashtëkontestimore, procedurat për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe procedurat tjera të parapara me ligje tjera. Gjykatat, prokuroritë publike, si dhe të gjitha organet tjera, trupat dhe institucionet tjera janë të obliguara ta mundësojnë shfrytëzimin, përdorimin dhe zbatimin e cilësdo prej gjuhëve zyrtare nga neni 1 paragrafët (1) dhe (2) dhe alfabetet e tyre në ato procedura dhe procedura tjera.

(3) Në institucionet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë nga neni 1 paragrafi (3) i këtij ligji, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj në: komunikim, përdorim dhe zbatim në të gjitha procedurat e qytetarëve para të gjitha organeve të cilat e përbëjnë pushtetin shtetëror (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, gjyqësia, prokuroria publike), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit i

Republikës së Maqedonisë, në procesin zgjedhor, arsim, shkencë, shëndetësi, kulturë, gjatë zbatimit të autorizimeve policore, në veprimtarinë radiodifuzive, noteri, përmbarrim, objekte infrastrukturore, evidencën e amzës, dokumentet personale, financat, ekonomi, si dhe në sferat tjera.

Përpjekja e fundit për avancimin e përdorimit të gjuhës shqipe është bërë më 11 janar 2018, kur Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Ky ligj ka bërë emërtimin në kllapa “gjuha shqipe” (edhe pse në tekst akoma mbetet “gjuha të cilën e flasin 20% e qytetarëve”) dhe e ka zgjeruar përdorimin e saj zyrtar në organe të pushtetit presidencial, ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor, lokal, si edhe në komunikim ndërkombëtar, në ushtri, në polici dhe në monedha, por edhe në veprimtari të tjera (i mbikëqyrur për herë të parë nga institucione për mbrojtjen e gjuhës). Edhe në këtë ligj mbetet formulimi “pranë gjuhës maqedonase”, që nënkupton se statusi i maqedonishtes ka mbetur “kodi i vetëm i komunikimit të shtetit”, sipas asaj që është projektuar në KAÇKM¹⁹ (Kuvendi Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Maqedonisë), dhe që vazhdon, kjo për shkak të politikës së bartësit kryesor të sovranitetit të shtetit.

Po të bëjmë një krahasim me shtetin e dytë të shqiptarëve në Ballkan, pra me Republikën e Kosovës, ku popullata serbe me rreth 2% të popullatës, shohim se përdorimi i gjuhëve të komuniteteve në Republikën e Kosovës ka përmasa shumë më të gjera dhe si e drejtë elementare ushtrohet në përmasa shumë më të gjera, vështruar në aspektin krahasimtar, me sistemet e ndryshme kushtetuese, të cilat nivelin e garantimit të kësaj të drejte në ushtrimin e saj e kanë shumë më të ulët, zakonisht në nivelin e përdorimit zyrtar të gjuhës²⁰. Në raport me sistemet e ndryshme kushtetuese, qartë shihet shtrirja e gjerë e përdorimit të gjuhëve të komuniteteve në Republikën e Kosovës. *"Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës"*

¹⁹ Që nga mbledhja e KAÇKM-së (Kuvendi Antifashist i Çlirimit Kombëtar të Maqedonisë), e mbajtur më 2 gusht 1944 në manastirin “Prohor Pçinski”, kur u vunë themelet e shtetësisë së Maqedonisë, aty në nenin 1 të *Vendimit të Kuvendit Antifashist të Çlirimit Popullor të Maqedonisë* u vendos që: *“Në shtetin maqedonas si gjuhë zyrtare vendoset gjuha popullore maqedonase”*. (Службен весник на Федерална Единица на Македонија, бр. 1, 1945. / Gazeta Zyrtare e Njësisë Federale të Maqedonisë, nr. 1, 1945).

²⁰ Po aty.

janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj²¹. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton përdorimin e gjuhës serbe në tërë vendin dhe gjuhëve të komuniteteve tjera në nivel komunal në harmoni me ligjet në fuqi²².

Pra nga ky aspekt shihet qartë se gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut nuk është gjuhë zyrtare, por është në përdorim zyrtar. Kjo e bën që qytetarët shqiptarë kur të drejtohen në ndonjë institucion publik e shtetëror duhet që krahas maqedonishtes ta përdorin gjuhën amtare, pra bëjnë punë të dyfishtë. Po jua jap një shembull konkret: për ta nxjerrë letërnjoftimin në gjuhën shqipe duhet që qytetari shqiptar të bëjë kërkesë për këtë. Nëse nuk do ta plotësojë formularin e paraparë edhe në gjuhën shqipe, letërnjoftimi do t'i lëshohet vetëm në gjuhën maqedonase. Ndërsa serbët me rreth 2 % popullatë në Republikën e Kosovës cilitdo institucion publik a shtetëror në tërë territorin e vendit i drejtohen në gjuhën serbe, e pastaj institucioni nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm qofshin ata përkthyes etj., e shqyrtojnë kërkesën e parashtruesit. Serbët për dokumentet e ndryshme, qoftë letërnjoftim, pasaportë etj., kërkesën e parashtron vetëm në gjuhën serbe (mund ta parashtrorë edhe në gjuhën shqipe) por dokumenti zyrtar i lëshohet në dy gjuhë, pra në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

Problemi i politikës gjuhësore në Maqedoninë e Veriut mbetet perceptimi i ndryshëm që kanë për shtetin dhe për politikën gjuhësore kombi maqedonas dhe kombi shqiptar aty. Derisa maqedonasit e shohin shtetin si pronë të tyre etnike, veten si bartës të sovranitetit dhe maqedonishten si gjuhë që e ndërton kërthizën e shtetit, ata i perceptojnë shqiptarët si një minoritet i madh në shtetin e tyre. Në anën tjetër, shqiptarët e shohin veten si kombi i dytë në Maqedoni, mendojnë se shteti duhet të mbështetet në dy kombet më të mëdha dhe politika gjuhësore duhet të jetë sipas të tipit të Finlandës dhe Kosovës – me shumëgjuhësi të

²¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 5, 2008.

²² Jusuf Zejneli, *Sfidat e Zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare mbajtur më 20-22 shkurt 2020 në Shkup “*Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV*”, f. 158, Shkup, 2021.

institucionalizuar²³.

Derisa maqedonasit e kanë argument historinë dhe autoktoninë, shqiptarët e kanë argument demografinë: maqedonasit thonë se kështu ka qenë nga ASNOM-i, ndërsa shqiptarët thonë se “në Finlandë janë më pak se 5% suedezë dhe në Kosovë janë më pak se 2% serbë, ndërsa suedishtja në Finlandë dhe serbishtja në Kosovë janë gjuhë zyrtare. Ndërkaq shqiptarët, si popull autokton në Maqedoninë e Veriut janë së paku 25% (pra ¼ e shtetit – maqedonas ka 64%)²⁴.

Sidoqoftë, shteti i Maqedonisë, me nacionalizëm të theksuar gjuhësor, vazhdon ta ruajë trinitetin “shteti-kombi-gjuha”, që nënkupton se Maqedonia është shtet i kombit maqedonas, në të cilin flitet gjuha maqedonase (pra, politikë njëgjuhësore që i njeh gjuhët e pakicave ose minoriteteve)²⁵.


2. Gabimet drejtshkrimore në mbishkrimet publike e private të qytetit të Shkupit e Gostivarit. Mënyra se si shkruhen emrat e lokaleve, dyqaneve, rrugëve dhe gjithçkaje tjetër ka dy vlera. E para është ajo se çfarë do të thotë ky fjalim dhe e dyta se si thuhet ai. Në rastet kur në emërtimet, por edhe në fjalimet publike përdoren terma të gabuar apo të huaj, edhe lexuesit kanë të drejtë ta marrin si të mirëqenë atë fjalë dhe ta përdorin në të ardhmen, edhe pse ajo mund të jetë gabim. Andaj është i nevojshëm korrektori letrar, i cili do të ketë për detyrë që ta përpunojë dhe ta kthejë fjalimin e dikujt në formën e duhur, sipas rregullave të drejtshkrimit sot. Duket që në qendër të vëmendjes të qëndrojnë gjuha e shkruar. Pikërisht në këtë mënyrë besojmë se do të arrijmë të rregullojmë edhe gabimet gjuhësore që pikësëpari nisin nga politikanët shqiptarë. Studiuesi i njohur Gjovalin Shkurtaj mendon se “*Ligji parashikon të rregullojë gabimet që dalin nga zyrat e qeveritarëve dhe jo shkarjet e gojës që mund të bëhen gjatë një fjalimi*”. Me këtë duam të themi se vërtetë një politikan mund të gabojë në një fjalim apo në një fjalë të mbajtur diku rastësisht, por është detyra e zëdhënësit që

²³ Zeqirija Ibrahim, *Politikat gjuhësore europiane në përjasje me politikën gjuhësore në RMV*, f. 250-251.

²⁴ Попис на населението, домаќинствата и становите во Република Македонија, 2002, книга X / Regjistrimi i popullsisë, amvisërive dhe banesave të Republikës së Maqedonisë, 2002. libri X.

²⁵ Zeqirija Ibrahim, *Politikat gjuhësore europiane në përjasje me politikën gjuhësore në RMV*, f. 251.

ta rregulloje ose ta përshtate këtë fjalë para se t'ua përcjellë medieve apo para se ta publikojë atë. Një gjë e tillë vlen edhe për ligje, emërtim rrugësh etj. të cilat duhet të rregullohen nga ana gjuhësore para se të botohen në fletoren zyrtare dhe të vihen në vende publike. Nuk është e mundur të kalojë një javë pa qenë pjesë e lajmeve gabimet drejtshkrimore në mbishkrimet në gjuhën shqipe. “Për çudi”, këto gabime ndodhin vetëm me mbishkrimet në gjuhën shqipe, assesi në gjuhën maqedonase e gjuhën angleze. Më shkon mendja mos vallë këto gjëra mund të jenë edhe të orkestruara nga qarqe të ndryshme, gjithnjë me qëllim të defokusimit të shqiptarëve nga problemet tjera në këtë shtet. Besoj që secili nga ju pajtohet me ne se gabimet e llojit **Maqedonisht Operës dhe Baletit* (Македонска Опера и Балет) në vend të **Teatri i Operës dhe i Baletit në Maqedoninë e Veriut**, nuk mund të vijnë nga një shqiptar, qoftë edhe pa shkollim adekuat.



Ajo që bie në sy nga materiali i grumbulluar është se të gjitha bizneset private të qytetarëve maqedonas, por edhe institucione arsimore e bankare në qytetin e Shkupit e Gostivarit në përgjithësi, por edhe në komunat tjera nuk respektojnë gjuhën shqipe. Mbishkrimet e vendosura në ndërmarrjet apo institucionet e tilla janë të shkruara në gjuhë të ndryshme, duke sjellë në laramani dhe kaos i përgjithshëm. Në disa prej tyre dominon vetëm gjuha maqedonase, ndërsa në disa prej tyre ka vend për gjuhën angleze dhe jo për gjuhën shqipe, edhe pse popullsia dominuese në këtë komunë është ajo shqiptare. Në çdo anë ku janë të pranishme dyqanet apo lokalet e ndryshme me pronarë maqedonas shihet

që nga largësia shkrimi cirilik i reklamave, duke mos përmbajtur asnjë fjalë shqipe. Për fat të keq kjo gjendje është edhe tek disa pronarë shqiptarë. Në komunën e Çairit e Gostivarit theksojnë se nuk kanë çfarë të bëjnë përballë këtyre dukurive që janë evidente që nga e kaluara. Por nga ana tjetër, ndërmarrjet shqiptare gati se shumica e respektojnë dygjuhësinë në mbishkrimet e tyre, duke vendosur fillimisht gjuhën maqedonase dhe pastaj gjuhën shqipe, vetëm e vetëm për t'u mos u përballur me ligjin dhe sanksionet.

Në të gjitha filialet e bankave që veprojnë në komunën e Çairit, mbishkrimet i kanë të shkruara me alfabet cirilik, p.sh.: *СТОПАНСКА БАНКА*, *ОХРИДСКА БАНКА*, *КОМЕРЦИЈАЛНА БАНКА etj.* Versionin në shqip, edhe pse shumë i kufizuar e gjejmë në ndonjë nga këto banka, si: “Halkbank”, “Procredit” e “*Sparkasse Bank*”. Madje, kjo e fundit para pak kohësh ka shtuar edhe versionin e tretë në gjuhën shqipe në faqen e saj elektronike.

Me alfabet cirilik janë edhe shumë shkolla të mesme, ku në shumicën e këtyre shkollave ka edhe paralele në gjuhën shqipe, si psh.: С.У.Г.С. „Владо Тасевски“ – Скопје; Д.С.У. „Георги Димитров“; СУГС Гимназија „Орце Николов“ – Скопје; Државно средно хемиско-технолошко училиште „Марија Кири – Склодовска“; Гимназија „Јосип Броз Тито“.

Ndërsa, ato shkolla fillore e të mesme, të cilat drejtohen nga drejtorë shqiptarë (ose kanë ndihmës drejtorë shqiptarë d.m.th. kanë paralele edhe në gjuhën shqipe) mbishkrimet e këtyre shkollave i gjejmë edhe në gjuhën shqipe. Vetëm në gjuhën maqedonase vërejmë mbishkrime edhe në sektorin privat të qytetit të Gostivarit. P.sh.:



3. Norma drejtshkrimore e toponimeve shqipe në tabelat rrugore në RMV sot. Përpjekje për të vënë sadopak rend në përdorimin e emrave të përveçëm të vendeve në tabelat rrugore në Maqedoninë e Veriut prora kanë ekzistuar. Madje, krahas gjithë këtij kaosi gjuhësor që ka ndodhur te ne, sidomos nga viti 1991 e deri më sot, këto përpjekje kryesisht kanë qenë individuale e kolektive (katedrat e gjuhës shqipe Shkup e Tetovë). Andaj, nevoja e hartimit të një politike gjuhësore zyrtare në Maqedoninë e Veriut siç ndodhi me themelimin e Agjencisë për Zbatimin e Gjuhëve, e cila tashmë është në një fazë të re, pra në fillimet e punës së saj, është për t'u përshëndetur, sepse puna e angazhimi i gjuhëtarëve dhe dashamirëve të gjuhës nuk mund t'i tejkalojë të gjitha këto probleme gjuhësore, por domosdo duhej të krijohet një institucionin që do të merret me këto çështje.

Mjafton të udhëtoni nëpër qytetet, fshatrat e lagjet e kryeqytetit, veçanërisht në vendbanimet shqiptare, qoftë me mjetet e transportit publik, qoftë me ato private gjithçka do ta keni të qartë, sepse numri më i madh i emrave të vendit në tabelave rrugore është vetëm në gjuhën maqedonase. Megjithatë, me ndryshimet e fundit kushtetuese, tabelat rrugore, i gjejmë edhe në gjuhën shqipe, por një pjesë e tyre edhe me gabime drejtshkrimore.

Në këtë kumtesë do të përpiqemi që nëpërmjet disa shembujve të vijmë në disa përfundime të cilat do të ndihmonin në tejkalimin e këtyre vështirësive që po na ndodhin prora. Ja disa nga luhatjet kryesore:

3.1. Në emrat e vendeve të tipit: (maq. Копачин Дол, Ново Село, Ново Лисиче, Гази Баба, Кисела Вода, Крива Паланка etj., nuk do të duhej që në gjuhën shqipe të shkruhen ndaras, pra në dy pjesë siç i kemi në maqedonishte, por në një vend. Mbishkrimet e tipit **Kopaçin Doll*, **Novo Sellë*, **Novo Lisiçe*, **Gazi Babë*, **Kisella Vodë*, **Kriva Pallankë* etj., janë në kundërshtim me traditën e shkrimeve të emrave të vendeve në gjuhën shqipe. Forma e drejtë e shkrimit të emrave të mësipërme do të duhej të ishte: **Kopaçindoll**, **Novosellë**, **Novolisçe** (në këtë lagje jetojnë edhe shqiptarë, andaj do të duhej që të dalim në terren dhe t'i konsultojmë banorët shqiptarë të kësaj lagjeje se si e quajnë ata këtë lagje. Kam përshtypje se ata e quajnë vetëm **Lisicë** e lagjen e re **Lisicë e Re**, herë-herë e dëgjojmë edhe **Dhelpra e Re*), **Gazibabë**, **Kisellavodë** etj. Ndërsa emrat, si Крива Паланка, Ѓорче Петров, Демир Хисар, Македонска Каменица, Македонски Брод (Kriva Pallanka, Gjoçe Petrov, Demir Hisar, Makedonska Kamenica, Makedonski Brod) do të duhej të shkruheshin **Kriva-Pallankë,~a**, **Gjoçe-Petrov,~i**, **Demir-Hisar,~i**, **Makedonska-Kamenicë,~a**, **Makedonski-Brod,~i**, etj. Mendoj se kjo do të ishte zgjidhja më e mirë sepse edhe në “*Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës Shqipe*” (Tiranë, 1976) gjejmë **Dimitrovgrad,~i**, **Shëngjin,~i**, përkatësisht **Novi-Sad,~i**, **Shën-Naum,~i**, por edhe **Shëngjin,~i**.



3.2. Nga ana tjetër, në mbishkrimet e autobusëve të NQP-së të qytetit të Shkupit vërejmë: * *Radishanë* (maq. Радичани) për *Radishan* (pashq.) *Radishani* (shq.) etj. Ajo që bie në sy kohëve të fundit në qytetin tonë (në Shkup), është edhe përdorimi i gjuhës shqipe në autobusët e Ndërmarrjes së Transportit Publik të Qytetit të Shkupit. Por edhe këtu nuk mungojnë gabimet gjuhësore.

Madje, ndonjëherë më shkon mendja mos qëllimisht qarqe të caktuara i lejojnë që të dalin me gabime. Gjithnjë, për të pasur me çka të merren shqiptarët në RMV (partitë, mediet etj.). Qofsha gabim!

Këtë që po e them po e ilustroj vetëm me toponimin e një lagjeje të komunës së Butelit, asaj të Radishanit. Në mbishkrimin e autobusit me numër **57** e gjejmë **Radishanë*, pra me **-ë** në fund. Ky toponim duhet të shkruhet pa **-ë**, pra **Radishan,~i**, sepse në këtë lagje jetojnë shqiptarë dhe çdoherë kanë thënë: *Po shkoj te një shok imi në Radishan. Radishani qenka lagje e qetë*. Nga ana tjetër, te faqja zyrtare e kësaj ndërmarrjeje, nuk e di se për ç'arsye, kemi një përdorim të pjesshëm të gjuhës shqipe. Nga ana tjetër, autobusët e ndërmarrjeve private të qytetit të Shkupit, aspak s'e përdorin gjuhën shqipe, sikur ata nuk e kanë obligim, (shih fotografinë e mëposhtme).



Edhe në qytetin e Gostivarit vërejmë gabime në shkrimin e toponimeve në tabelat e rrugës. Nga fotografia mëposhtme vërejmë se emri i fshatit **Vrapçisht** është shkruar gabimisht **Vrapçishte* (sigurisht, duke u mbështetur në emërtimin e të njëjtin fshat në gjuhën maqedonase e turke). Në gjuhën shqipe duhet të shkruhet: **Vrapçisht**, ndërsa në trajtën e shquar bën **Vrapçishti**. Sepse, po ta lëmë ashtu siç e kemi të shkruar gabimisht në tabelë, **Vrapçishte*, në trajtën e shquar do të duhej t'i thoshim **Vrapçishta*. Banorët shqiptarë të këtyre trevave asnjëherë nuk i kanë thënë kështu, por prora i kanë thënë **Vrapçisht,~i**.



Njëjtë qëndron puna edhe me trajtën e gabuar drejtshkrimore të oikonimit *Lagja e Re që mund ta shihni në tabelën e mëposhtme. Norma e shqipes standarde kërkon që ky emër të shkruhet **Lagjja e Re**²⁶.



3.3. Si duhet t'i shkruajmë toponimet shqipe. Përdorimi i emrave të vendit në trajtë të shquar apo të pashquar është një laramani dhe mosunifikim tjetër të cilin e vërejmë. Emrat e vendeve kur shoqërohen me shifër kilometrash, si: *Kumanovë 15 km, Shkup 10 km, Tetovë 30 km, Strugë 90 km* që do të thotë: *Deri në Shkup 10 kilometra, Deri në Tetovë 30 kilometra* e kështu me radhë. Prandaj në këtë rast si normë mendojmë të jetë trajta e pashquar e emrit. Përdorimi i emrave të shquar në këto raste (d.m.th. *Kumanova 15 km; Struga 90 km*) nuk na duket i pranueshëm, sepse kuptimi këtyre do të ishte: *Kumanova mban 15 km dhe*

²⁶ Këtu kemi vërejtur edhe një gabim drejtshkrimor në gjuhën maqedonase, jo Ново мало siç është në tabelle, por duhet: Ново маало.

Struga mban 25 km, ku emrat e përveçëm emërtojnë vende të njohura nga kalimtarët, çka nuk i përgjigjet gjithnjë realitetit. Edhe kur në vend të shifrave të kilometrave emrat e përveçëm të vendeve shoqërohen me një shigjetë për të treguar drejtimin për në ato qytete a fshatra, mirë do të ishte që të shkruhen në trajtë të pashquar, si: *Kumanovë, Shkup, Tetovë, Strugë* etj.

Emrat e përveçëm në tabelat e vendosura në stacionet e autobusëve e në stacionet hekurudhore duhet të shkruhen në trajtë të pashquar, si: *Qendër, Çair, Gostivar, Kërçovë, Arbënovë* (fshat në komunën e Debërcës), *Ohër* etj. Të njëjtat mund të zberthehen kështu: *Ky stacion quhet Qendër. Ky është stacioni "Qendër". Jemi në stacionin Qendër*, prandaj edhe nuk është e nevojshme që në këtë rast të shënohet edhe fjala stacion, siç ndodh ndonjëherë (*stacioni Tetovë*).

Nga na tjetër, do të duhej të përdorëshin në trajtë të shquar në hyrje të qytetit a fshatit, të cilët të njohin me qendrën e banuar që kalimtari ka përpara: *Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Kërçova, Struga. Ohri* (= *Kjo është Tetova. Ky është Shkupi* etj.).

Si përfundim, toponimia shqiptare gjatë historisë, si dhe shkrimi i toponimeve në gjuhën shqipe, gjer më sot, njeh dy mënyra të ndryshme të përdorimit lidhur me trajtën e emrave të përveçëm të vendeve në tabela, si: **Kopaçindoll, Novosellë, Novolisiçe ose Kopaçin-Doll, Novo-Sellë, Novo-Lisiçe**. Raste të tilla kemi edhe në "*Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës Shqipe*" (Tiranë, 1976) gjejmë **Dimitrovgrad,~i, Shëngjin,~i**, përkatësisht **Novi-Sad,~i, Shën-Naum,~i**.

4. Në ç'trajtë duhet t'i shkruajmë toponimet shqipe në pullat postare?

Toponimet shqipe në pullat postare duhet që t'i shkruajmë në **trajtë të shquar**, si p.sh.: Shkupi, Maqedonia e Veriut, Tirana, Shqipëria, Prishtina, Kosova, Ulqini, Mali i Zi, Zagrebi, Kroacia, Lubjana, Sllovenia, Beogradi, Serbia, Lisbona, Portugalia etj., e assesi në trajtë të pashquar, si: **Shkup, *Maqedoni e Veriut, *Tiranë, *Shqipëri, *Prishtinë, *Kosovë, *Ulqin, *Mal i Zi, *Zagreb, *Kroaci, *Lubjanë, *Slloveni, *Beograd, *Serbi, *Lisbonë, *Portugali* etj. Shkrimi në trajtë të shquar i këtyre toponime ka këtë kuptimin (ose kështu mund ta lexonim fotografinë e qytetit a shtetit të paraqitur në pullën postare):

1. Në këtë pullë postare është paraqitur Shkupi (sot ose dikur) dhe:

2. Kur ta shohim një pullë postare mund të themi: si qenka (sot) Zagrebi, ose sa i bukur qenka/paska qenë Zagrebi etj.

Përdorimi i të njëjtave në trajtë të pashquar nuk do të na jepnin kuptim të drejtë e të mirë, khs.: * *në këtë pullë postare është Shkup (sot ose dikur)*, ose kur ta shohim pullën postare në të cilën është qyteti i Zagrebit, mund të themi: **si qenka ose sa qenka i bukur Zagreb* etj. Pra, toponimet shqipe në pullat postare duhet t'i përdorim **në trajtë të shquar**.

Që të mos dalin me gabime gjuhësore emrat e qyteteve e fshatrave në mbishkrimet e tabelave rrugore e në mbishkrimet publike e private në gjuhën shqipe, do të ishte mirë dhe e rrugës, që paraprakisht, të angazhohen gjuhëtarë të zotë (për fat të mirë i kemi edhe në RMV), të cilët do t'i zbatonin drejtshkrimin për toponiminë në gjuhën shqipe me përpikëri.

Literatura e shfrytëzuar:

ASHSH, IGJL, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973.

BAJRAMI, Arsim, *Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës*, Prishtinë 2011. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 17 nëntor 1991 (me amendamentet kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, (“Gazeta Zyrtare e RMV-së”, nr.7, të datës 14.1.2019).

ÇELIKU, Mehmet, *Çështje të shqipes standarde*, ASHSH, IGJL, Tiranë, 2006.

IBRAHIMI, Mustafa & SULEJMANI, Berton, “Gjuha e firmave dhe mbishkrimet publike në qytetin e Shkupit”, Shkup, 2016.

IBRAHIMI, Zeqirija, Politikat gjuhësore europiane në përfaqje me politikën gjuhësore në RMV, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare mbajtur më 20-22 shkurt 2020 në Shkup “Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV”, f. 154-168, Shkup, 2021.

ISMAJLI, Rexhep, Në gjuhë dhe për gjuhë, “Dukagjini”, Pejë, 1998.

KRASNIQI, Haxhi (1983). T'i shkruajmë drejt firmat nëpër institucionet e sektorit shoqëror dhe në shitoret private. Në “Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe”, Prishtinë.

SULEJMANI, Berton, Toponimia shqiptare në tabelat rrugore në Maqedoninë e Veriut, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare mbajtur më 20-22 shkurt 2020 në Shkup “Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV”, f. 58-61, Shkup, 2021.

SHKURTAJ, Gjovalin (2003). Sociolinguistikë. Tiranë.

ZEJNELI, Jusuf, Sfidat e Zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare mbajtur më 20-22 shkurt 2020 në Shkup “Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në RMV”, f. 239-252, Shkup, 2021.

Dokumente dhe vegëza interneti:

Службен весник на Федерална Единица Македонија, бр. 1, 1945.

Попис на населението, домаќинствата и становите во Република Македонија, 2002, книга X.

PROF. AS. DR. SEJDI GASHI

INSTITUTI ALBANOLOGJIK PRISHTINË

sejdi.iap@hotmail.com

RRJEDHAT E PLANIFIKIMIT GJUHËSOR NË KOSOVË DHE STATUSI I SHQIPES GJATË VITEVE 1999-2021

Abstrakt

Në këtë punim synohet të trajtohen rrjedhat e planifikimit gjuhësor në Kosovë dhe statusi i shqipes gjatë viteve 1999-2021.

Në gjuhën shqipe, termat politikë gjuhësore dhe planifikim gjuhësor janë të rinj. Termi planifikim gjuhësor (ang. Language planning) është përdorur për herë të parë nga Einar Haugen (1959) që nënkuptonte ndërhyrjen e mekanizmave shtetëror në standartizimin e gjuhës përmes rregullave të drejtshkrimit. Nga ana tjetër, termi planifikim gjuhësor mjaft shpesh njëjtësohet me termin politikë gjuhësore, por mirëfilli ata dallojnë. Politika gjuhësore kryesisht është produkt i politikbërësve, ndërkaq planifikimi gjuhësor është një ndërmarrje që realizohet nga specialistët e fushës. Ndarja e tillë nuk është e ngurtë, sepse në jo pak raste specialistët janë politikbërës dhe asnasjelltas. Gjithashtu, njihen praktika kur specialistët e gjuhës u janë nënshtruar instrumenteve dirigjuese të politikbërjes.

Gjuha si tipar dallues i qenies njerëzore është një faktor shumë i rëndësishëm i identitetit individual dhe kolektiv për çdo folës, veçmas te ata pjesëtarë të pakicave kombëtare ku gjuha është një ndër elementet kryesore të përcaktimit identitetit dhe të ruajtjes së tij. Ashtu si identiteti, edhe gjuha nuk është proces statik, por zhvillohet në vazhdimësi gjatë tërë jetës së individit-folës. Sigurimi i plotë dhe efektiv i folësve për të përdorur gjuhën e tyre nënkupton që autoritetet të lejojnë identifikimin e lirë të personave nëpërmjet gjuhës dhe të mos kufizojnë që identitetet kombëtare të tyre të izolohen vetëm brenda kategorive të ngurta gjuhësore. Megjithatë, në kohë njihen përjetime kur shoqërive e kombeve të caktuara u është mohuar e drejta për përdorim të lirshëm të gjuhës amtare, sidomos në sistemet politike totalitare.

Për sa i përket Kosovës, në shtator të vitit 2008, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, është themeluar Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) e cila në mënyrë të veçantë dhe të harmonizuar merret me çështjet e komuniteteve në kuadër të punës së Qeverisë së Kosovës. Poashtu, është themeluar edhe insticioni i quajtur “Zyra e Komisionarit për Gjuhët”. Prandaj, rrethanat e reja ndikuan që shqipja në Kosovë të ndërtojë raporte të reja, jo më me një gjuhë të përbashkët të popujve sllavo-jugorë, por me gjuhë të veçanta.

Fjalët çelës: *Kosovë, planifikimi i gjuhëve, statusi zyrtar i gjuhëve, ligj, kushtetutë, varietet gjuhësor, pakica kombëtare.*

Hyrje

Planifikimi gjuhësor i shqipes në Kosovë, kompleks dhe me shumë kthesa, në rrjedhë të moteve ka qenë objekt diskutimesh e vlerësimesh të ndryshme.

Në gjuhën shqipe, termat politikë gjuhësore dhe planifikim gjuhësor në kuptimin e mësipërm, janë të reja¹. Termi planifikim gjuhësor (ang. Language planning) është përdorur për herë të parë nga Einar Haugen (1959)² që nënkuptonte ndërhyrjen e mekanizmave shtetërorë në standartizimin e gjuhës përmes rregullave të drejtshkrimit.

Ndonëse, termi *planifikim gjuhësor* shpesh njëjtësohet me termin *politikë gjuhësore*, ata në thelb dallojnë. Politika gjuhësore kryesisht është produkt i politikbërësve, ndërsa planifikimi gjuhësor është një ndërmarrje që realizohet apo do të duhej realizuar nga specialistët e fushës. Ndarja e tillë nuk është e ngurtë, sepse jo rrallë specialistët janë politikbërës dhe asnasjelltas. Gjithashtu, në mjaft raste specialistët e gjuhës u janë nënshtruar instrumenteve dirigjuese të politikbërjes. Sidoqoftë, këto dy veprimtari në rrafshin e gjuhës (politika gjuhësore dhe planifikimi gjuhësor) nënkuptojnë qëndrimet që merren ndaj gjuhës dhe çështjeve rreth saj.

Pra, me politikë gjuhësore para se gjithash nënkuptohet qëndrimi i autoriteteve dhe institucioneve shtetërore, kundrejt çështjeve e problemeve gjuhësore që hasen ose krijohen brenda një shteti ose me problemet gjuhësore që hasen në grupe të ndryshme shoqërore (qofshin ato të shumicës apo të pakicave etnike). Nga gjuhëtarët, që në trajtimet dhe studimet e tyre është marrë në vështrim planifikimi gjuhësor në Kosovë dhe më gjerë, duhen veçuar: Rexhep

¹ Bahri Beci, *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, “Dukagjini”, Pejë, 2000, fq.14.

² Einar Haugen, *Planning for a Standard Language in Modern Norway*, *Anthropological Linguistics*

Vol. 35, No. 1/4, A Retrospective of the Journal *Anthropological Linguistics: Selected Papers*, 1959-1985 (1993), pp. 109-123 (15 pages): in (<https://www.jstor.org/stable/30028247> (qasur së fundmi më 6.11.2021)).

Published By: Trustees of Indiana University.

Ismajli³, Victor A. Friedman⁴, Gjovalin Shkurtaç⁵, Joshua A. Fishman⁶, Janet Byron⁷, Shkumbin Munishi⁸, Bahri Beci⁹ e ndonjë tjetër.

1.0. Rrjedhat e planifikimit gjuhësor të Kosovës në ish-Jugosllavi

Në rastin e planifikimit të shqipes në Kosovë, por edhe në Shqipëri, jo rrallëherë, procesi është karakterizuar me ngjyrimet ideo-politike, duke shkaktuar kështu polarizime të konsiderueshme në qarqet akademike dhe politike gjithandej. Një gjendje e tillë sikur po vazhdon edhe sot, sidomos kur kihen parasysh përpjekjet e një numri individësh dhe institucionesh shkencore të Prishtinës dhe të Tiranës për rishkrimin e standardit të shqipes (kupto: ristandardizimin e saj).

Çështje e vërteta, në Kosovë kurrënjëherë nuk kanë munguar përpjekjet për një shqipe të përbashkët standarde dhe për të drejtën e përdorimit të saj në domenin publik si në Kosovë ashtu edhe në hapësira të tjera të ish-Jugosllavisë. Në këtë drejtim duhen veçuar dy mbledhjet e gjuhëtarëve për zgjidhjen e disa çështjeve të ortografisë së gjuhës shqipe (e para e datës 14 - 15 nëntor 1952 dhe mbledhja e dytë, më 30-31 maj 1957). Së këndejmi, duhet veçuar edhe Konsultën Gjuhësore të Prishtinës të vitit 1968, që me plot gojën mund të cilësohet paraprijëse e Kongresit të Drejtshkrimit të Shqipes të vitit 1972, e cila vuri themele të forta dhe kristalizoi mjaft mirë çështjen e planifikimit të shqipes, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri. Motoja e Konsultës së Prishtinës "një komb, një gjuhë", rikonfirmoi qendrimin se shqiptarët e Kosovës duke qenë të një gjaku me ata të Shqipërisë, po bënin dhe do të bënin "luftë për gjuhën", pra

³ Rexhep Ismajli, *Standarde dhe identitete*, "Dukagjini", Pejë, 2003.

⁴ Victor A. Friedman, *Language planning and status in the Republic of Macedonia and in Kosovo*, in: *Language in the former Yugoslav Lands*, Edited by: Ranko Bugarski & Celia Hawkesworth, Bloomington, Indiana, 2004, fq. 197-231.

⁵ Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003.

⁶ Joshua A. Fishman, *Sociolinguistic Studies on the Albanian language*, in "International Journal of the Sociology of Language", nr. 178, 2006.

⁷ Janet Byron, *Selection among alternates in language standardization: the case of Albanian*, The Hague: Mouton, 1976.

⁸ <http://linguasocio.blogspot.com/2010/02/planifikimi-i-statusit-te-gjuheve-ne.html>.

⁹ Bahri Beci, *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, "Dukagjini", Pejë, 2000.

për shqipen, sepse ajo përbënte mjetin kryesorë të identitetit kombëtar shqiptar dhe të ruajtjes së tij.

Parë nga rrafshi sociologjik dhe ai politik, në demokracitë e mirëfillta, gjithëherë autoritetet shtetërore lejojnë identifikimin e lirshëm të individëve apo grupeve shoqërore nëpërmjet gjuhës dhe nuk vënë kufizime që identitetet e tyre kombëtare të izoloohen vetëm brenda kategorive të ngurta gjuhësore, mirëpo në Kosovë për shumë kohë është mohuar një proces i tillë, sepse deri në vitin 1999 “raportet midis shqipes dhe serbokroatishtes në ish- Jugosllavi përshkruhen qartë përmes klasifikimeve në kuadër të rregullimit zyrtar të plurilinguizmit¹⁰, pasi që gjuha serbo-kroate, si gjuhë e parë zyrtare, kishte një privilegj të theksuar dhe ishte “Lingua Franca” për tërë Jugosllavinë. Pra, shqipja si një prej gjuhëve të ish- Jugosllavisë kishte status jo afirmativ, ndoshta nga fakti që ” rrjedha e formësimit të identiteteve politike e kulturore të popujve të Ballkanit është e cilësuar me konflikte të ndërsjella në projektin e tyre që të sajohen shtete, kufijtë e të cilëve do të përputheshin me banorët që do të kishin një identitet homogjen kombëtar”¹¹. Nga ana tjetër, rrudhja e mundësive për një shqipe të barabartë me gjuhët e tjera për komunikim zyrtar në organet federative të ish- Jugosllavisë, në masë të theksuar ishte ndikuar nga i ashtuquajtimi ”sindromi maqedonas”, i kultivuar dhe afirmuar kryesisht nga serbët “që të bëjnë diferencimin e gjuhës (sh)qipe- shiptarski¹² për kosovarët dhe shqiptarët tjerë në ish- Jugosllavi nga gjuha shqipe (albanski) për shqiptarët e Shqipërisë”¹³.

1.1. Situata gjuhësore në vitet e '90-ta

Fillimvitet e '90-ta sollën fundin e Luftës së Ftohtë, shumë sisteme politike në Evropë ndryshuan, ato totalitare filluan të shturen, veçmas në Evropën Lindore dhe Juglindore. Pas këtyre zhvillimeve u krijuan kushtet për

¹⁰ Rexhep Ismajli, *Standarde dhe identitete*, “Dukagjini”, Pejë, 2003, fq. 135-136.

¹¹ Muhamedin Kullashi, *Identitetet në sprovë*, Kumtesë e lexuar në Simpozium ndërkombëtar me temë” Identiteti evropian i Kosovës, i mbajtur më 26 dhe 27 qershor 2007 në Prishtinë, gjendet në: http://www.alterhabitus.org/repository/docs/FORUM2015_English_Shqip_681037.pdf (përditësuar më:06.11.2021).

¹² Ky term nuk ishte i liruar nga përdorimi pezhorativ sepse ka një histori shoqërore që i vishet ky term.

¹³ Po aty.

rithemelimi e sistemeve të reja politike e shoqërore, pra “këto sisteme politike totalitare që ishin ndërtoar mbi ideologjinë komuniste u zëvendësuan me ato pluraliste e demokratike, sipas modeleve perëndimore”¹⁴.

Nëpër një proces të tillë transformimesh, ndryshim konceptesh dhe idesh, kaloi edhe Kosova. Mirëpo, fundi i viteve '80-ta shënoi përkeqësimin e situatës politike në Kosovë si pasojë e suprimimit të Autonomisë së saj nga organet federative të ish-Jugosllavisë (të iniciuara dhe projektuara kryesisht nga serbët) si dhe si rezultat i politikës gjenocidale që ndiqej nga këto organe.

Në përpjekje për mbijetesë, shqiptarët e Kosovës iu kundërpërgjigjen masave të dhunshme serbe, duke organizuar jetën e tyre institucionale në të gjiha rrafshet. Gjendje e tillë vazhdoi deri në qershor 1999, pra me përfundimin e luftës në Kosovë. Pas kësaj kohe, u krijuan rrethana dhe mundësi të reja, prandaj edhe politikat gjuhësore, planifikimi gjuhësor dhe statusi i gjuhëve u zhvilluan në kushte e rrethana më të favorshme, sepse “gjatë njëzet viteve të fundit (1990-2000, shënim yni) dhe kryesisht në përgjigje të valës së fundit të konflikteve etnike dhe të kërkesave që kanë rezultuar nga to për nivele në rritje të autonomisë kulturore dhe politike, komuniteti ndërkombëtar ka përqendruar energji të konsiderueshme në zhvillimin e standardeve për të siguruar mbrojtjen e komuniteteve jo-shumicë. Fokus kyç ka qenë mbrojtja e të drejtave gjuhësore, dhe që nga vitet 1990 organizata si Kombet e Bashkuara (OKB), Këshilli i Evropës (KE) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) kanë zhvilluar një numër të rëndësishëm instrumentesh”¹⁵.

1.2. Misioni ndërkombëtar në Kosovë dhe statusi i gjuhëve

Në qershor të vitit 1999, sipas Rezolutës 1244 të OKB-së, Kosova u vendos nën Administrimin Ndërkombëtar (UNMIK). Së këndejmi, me qëllim organizimi më të lehtë dhe më efikas, misioni i UNMIK-ut, solli rregullore të ndryshme administrative, të cilat ishin “ligje” në vete. E tillë ishte Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001, 16 sipas së cilës, në Kosovë, gjuhë zyrtare apo

¹⁴ <http://linguasocio.blogspot.com/2010/02/planifikimi-i-statusit-te-gjuheve-ne.html>.

¹⁵ *Të drejtat gjuhësore në kornizën ligjore ndërkombëtare dhe vendore*, në: https://zck-ks.net/repository/docs/Politika_e_gjuheve_shqipe.pdf (qasur së fundmi më 8.11.2021).

¹⁶ <http://www.unmikonline.org/regulations/2001/reg09-01.htm> (Kaptina 3 nga UNMIK/REG/2001/9).

në përdorim zyrtar përcaktoheshin gjuha shqipe, serbe dhe ajo angleze, kurse në komunat ku kishte popullsi të komuniteteve tjera (jo shqiptare, jo serbe) në masën mbi 3% të popullsisë, në komunikimin zyrtar garantohej edhe përdorimi igjuhëve të tyre amtare.

Pesë vjet më vonë, saktësisht, më 20 tetor 2006 Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve¹⁷, pra nga tani edhe në mënyrë institucionale u sanksionua se Institucionet e Kosovës do të sigurojnë përdorim të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë, duke krijuar kushte të favorshme edhe për gjuhët e komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë. Sipas ligji të përmendur, "gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës"¹⁸, ndërkaq, "në komunat e banuara nga një bashkësi, gjuha amtare e të cilës nuk është gjuhë zyrtare dhe e cila përbën së paku 5 përqind të popullsisë së përgjithshme të asaj komune, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës zyrtare në atë komunë dhe do të përdoret barabartë me gjuhët zyrtare. Pavarësishtkësaj që u tha më lartë, në mënyrë të veçantë, në komunën e Prizrenit gjuha Turkedo të ketë statusin e gjuhës zyrtare"¹⁹. Pra, ky ligj obligon institucionet e Kosovës që të sigurojnë të drejtat gjuhësore të personave që iu takojnë komuniteteve gjuhaamtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare...²⁰ Nga sa shihet, ligji i tillë është në harmoni të plotë me standardet dhe instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen epakicave kombëtare dhe gjuhëve rajonale ose të pakicave që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, përfshirë Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare²¹.

1.3. Rrjedhat gjuhësore në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë së saj

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, saktësisht në shtator të vitit 2008, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, është themeluar Zyra për Çështje të

¹⁷ Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Prishtinë, VITI II, Nr. 10, 1 Mars, 2007.

¹⁸ Po aty, neni, 2, pika 2.1.

¹⁹ Po aty, neni 2, pika 2.3.

²⁰ Po aty, neni 2, pika 2.5.

²¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008, neni 22.

Komuniteteve (ZÇK)²², e cila në mënyrë të veçantë dhe të harmonizuar merret me çështjet e komuniteteve në kuadër të punës së Qeverisë së Kosovës, si dhe Zyra e Komisionarit për Gjuhët²³. Prandaj, rrethanat e reja që u krijuan në Kosovë ndikuan që shqipja të ndërtojë raporte të reja jo më me një gjuhë të përbashkët të popujve sllavo-jugorë, por me gjuhë të veçanta. Për këtë, gjuhëtari Shkumbin Munishi, thekson se “pas këtyre zhvillimeve edhe statusi i shqipes u avancua sërish dhe në të njëjtën kohë u zhduk edhe rreziku i dukurive glotofagjike që kanë mundur të nxjerrin krye nën okupimin serb duke e vënë shqipen përballë një ballafaqimi dhe bashkekzistence jo më vetëm me gjuhët regjionale, siç ishte serbishtja, por me një gjuhë që sot u prin proceseve globalizuese botërore, siç është anglishtja”²⁴.

Për sa u përket rrugëve që po ndiqen në Kosovë për kristalizimin e politikës gjuhësore si dhe ndërmarrjeve që janë realizuar e po realizohen në këtë rrugë në vazhdimësi, qoftë institucionalisht apo vetjakësisht, duhet vënë në dukje faktin se një “debat i mirëfilltë mbi politikën gjuhësore për Kosovën mund të zgjasë më tepër se sa është pritur. Nuk ka zgjidhje të shpejta dhe, si në shumë debate të tjera fundamentale në çdo shoqëri demokratike, procesi është me po aq rëndësi sa edhe rezultati”²⁵.

Përfundime

Nga sa u tha më lart mund të përfundohet se shqiptarët e Kosovës kurrënjëherë nuk kanë hequr dorë nga përpjekjet për një shqipe të përbashkët dhe standarde për të gjithë shqiptarët, ashtu siç nuk kanë rreshtur së bëri “luftë për gjuhën”, pra për të drejtën e tyre në përdorimin e gjuhës së vet amtare në domenin publik në Kosovë, por edhe në hapësirat e tjera të ish-Jugosllavisë.

Për kohë të gjatë, statusi zyrtar i shqipes në Kosovë juridikisht ishte i shpërfillur, sepse gjuhë e shkrim-leximit dhe e komunikimit formal zyrtar ishte serbishtja, veçmas gjatë viteve 1950- 1970, për të vijuar pastaj me periudhën

²² <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,134>.

²³ <http://www.komisioneri-ks.org>.

²⁴ Po aty.

²⁵ Gianfranco D’Eramo, *Elementet e një ligji mbi përdorimin e gjuhës*, në: <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/15262.pdf> (qasur së fundmi më 8.11.2021).

kohore 1989- 1999. Vitet '80-'90-ta qenë më të rëndat për shqiptarët dhe proceset socio-politike në Kosovë, prandaj edhe shqipja pati fatin e njëjtë.

Pas përfundimit të luftës së Kosovës të vitit 1999 dhe ndërhyrjes së faktorit ndërkombëtar, situata ndryshoi, së këndejmi ndryshoi edhe statusi zyrtar dhe planifikimi i gjuhëve në Kosovë. Tanimë, Republika e Kosovës ka ngritur mekanizma të veçantë për sa i përket zhvillimit të politikave të mirëfillta gjuhësore si dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve pakicë për të komunikuar në gjuhën e tyre amtare, ashtu siç e parasheh Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë.

Literaturë

Bahri Beci, Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri, “Dukagjini”, Pejë, 2000.

Gjovalin Shkurtaç, Sociolinguistika, SHBLU, Tiranë, 2003.

Janet Byron, Selection among alternates in language standardization: the case of Albanian, The Hague: Mouton, 1976.

Janet Byron, Language planning in Albania and in Albanian-speaking Yugoslavia. Word 30 (1–2). 15–44, 1979.

Janet Byron, An overview of language planning achievements among the Albanians of Yugoslavia. International Journal of the Sociology of Language 52. 59–92, 1985.

Joshua A. Fishman, Sociolinguistic Studies on the Albanian language, in: International Journal of the Sociology of Language, nr. 178, 2006.

Rexhep Ismajli, Standarde dhe identitete, “Dukagjini”, Pejë, 2003.

Victor A. Friedman, Language planning and status in the Republic of Macedonia and in Kosovo, në: Language in the former Yugoslav Lands, Edited by: Ranko Bugarski & Celia Hakesworth, Bloomington, Indiana, 2004.

Dokumente juridike

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.
(https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_Kosoves-2.pdf).

Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, Prishtinë, VITI II, Nr. 10, 1 Mars, 2007.

Burime nga interneti

Muhamedin Kullashi, Identitetet në sprovë, Kumtesë e lexuar në Simpozium ndërkombëtar me temë” Identiteti evropian i Kosovës”, i mbajtur më 26 dhe 27 qershor 2007 në Prishtinë, gjendet në:

http://www.alterhabitus.org/repository/docs/FORUM2015_English_Shqip_681037.pdf (përditësuar më:06.11.2014).

<http://www.komisioneri-ks.org>.

<http://www.osce.org/sq/kosovo/120011?doenload=true>.

<http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,134>.

<http://www.unmikonline.org/regulations/2001/reg09-01.htm>(Kaptina 3 nga UNMIK/REG/2001/9)

<http://linguasocio.blogspot.com/2010/02/planifikimi-i-statusit-te-gjuheve-ne.html>.

PROF. DR. MIMOZA KORE

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

mimo.kore@gmail.com

LIGJI PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE NË RMV DHE SFIDAT E STATUSIT TË SHQIPES STANDARDE NË KONTEKSTIN E RI

Abstrakt

Në këtë kumtesë do të trajtojmë realitetin e ri gjuhësor që u krijua për shqipen në RMV me miratimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Maqedonia e Veriut është një vend multietnik dhe pakica me mbi 20% fitoi me këtë ligj të drejtën e gjuhës së dytë zyrtare. Bilinguizmi duhet parë si vlerë për shoqërinë e këtij vendi, sepse prodhon stimuj origjinalë të ndërthurjeve kulturore, të njohjes më të mirë të etnive me njëra-tjetrën.

Më tej do të ndalemi te statusi i shqipes si gjuhë e dytë zyrtare, i cili kërkon rritje të kujdesit për zbatimin drejt të saj, shton përgjegjësinë e të gjithë atyre që kanë për detyrë ruajtjen dhe përkujdesjen e vazhdueshme. Në këtë aspekt do të paraqesim shkurtimisht disa shkelje të normës së shqipes standarde si dhe probleme që lindin gjatë përkthimit nga njëra gjuhë te tjetra, të cilat kërkojnë njohuri të mira të gjuhës burimore ashtu dhe të gjuhës në të cilën përkthehet.

***Fjalë kyçe:** të drejtat dhe liritë e njeriut, bilinguizmi, gjuhë shqipe, huazime, shqipe standard*

Konteksti ligjor

Rruga që ka nisur Republika e Maqedonisë së Veriut drejt Bashkimit European, sikurse shtetet të tjera të Ballkanit, kërkon edhe zbatimin e kërkesave dhe të standardeve të vendosura nga Europa e cila, në kuadrin e zbatimit të të drejtave të njeriut, e sheh edhe bi-e multilingualizmin si vlerë e bekim dhe jo si anë negative të shoqërive multietnike. Europa është simbol i të qenit e bashkuar në diversitet, ku të drejtat e personave që i përkasin pakicave, janë pjesë integrale e të drejtave themelore të njeriut, të cilat jo vetëm janë pjesë kryesore e vlerave të Bashkimit European, por edhe përbëjnë një element thelbësor në procesin e zgjerimit të BE-së. Në fushën e mbrojtjes së pakicave, BE-ja ka mbajtur një qëndrim të dyfishtë ku mund të konstatohen dy dimensione, një i brendshëm (shtetet anëtare) dhe një i jashtëm (shtetet candidate dhe potenciale candidate). Në Strategjinë e Zgjerimit të vitit 2012, KE-ja braktisi disi termat e karakterit të

përgjithshëm dhe iu referua pakicave në një mënyrë më konkrete duke nënvizuar se “të drejtat e personave që u përkasin pakicave janë çështje kyç në të gjitha shtetet që aspirojnë të bëhen pjesë e Bashkimit Europian”¹. KE-ja shkon edhe më tej duke deklaruar se “qëndrimet ose sjellja e përgjithshme e shoqërisë ndaj grupeve vulnerable, siç janë pakicat kombëtare, mbeten një problem shqetësues në shtetet e Ballkanit Perëndimor”. Përfshirja e fjalës “*shoqëri*” shtoi për herë të parë dimensionin e duhur, i cili mungonte në strategjitë e mëparshme të KE-së.

Zbatimi i drejtë i kësaj i jep mundësi në këtë kontekst bashkësisë shqiptare të shfaqë lirisht një trashëgimi specifike tiparesh kulturore në RMV, të cilat kanë të bëjnë me identitetin e kësaj bashkësie. Shumica e autorëve që janë marrë me studimin e konceptit të identitetit etnik e kombëtar, gjuhën e kanë parë si një nga tiparet kryesore të përbërjes, krahas tipareve të tjera kulturore, fetare e politike. Kjo ndodh edhe për faktin se gjuha, duke qenë mjet identifikimi, është e ndërlidhur me të gjitha strukturat shoqërore, të cilat ndikojnë në ndërtimin e formave identitare.² Faktorët e rinj politikë që u krijuan RMV, siç janë dëshira dhe përpjekjet për të hyrë në BE, bënë të mundur të spikasë më shumë identiteti shqiptar, e bashkë me të, si një komponent përbërës i dorës së parë, gjuha zyrtare shqipe.

Me Ligjin e ri për përdorimin e gjuhëve (të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më 11 janar 2018), gjuha shqipe gjithsesi ka status më të avancuar, por jo të zgjidhur përfundimisht, sepse vihet në pozitë të pabarabartë me maqedonishten³. Statusi i saj nuk është as në nivelin e statusit të serbishtes në Kosovë (megjithëse flitet vetëm nga 2% serbë). Ligji i Kosovës mbi Përdorimin e Gjuhëve, i miratuar në vitin 2006, thotë shprehimisht:

1. Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë *gjuha shqipe* dhe *gjuha serbe*. 2. Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligjin. Ky ligj thotë në Nenin 1 të tij:

¹ Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2012-2013, f.5.

² Sh. Munishi, “Luhatjet në identitetet gjuhësore dhe kombëtare në Ballkan”, në *Komunikimi ndëretnik në Ballkan*, “Arbëria”, 2013, f.53.

³ Q. Murati, Blofi me shqipen në Maqedoni, gazeta “Dita”, 22.01,2012

(1) Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është *gjuha maqedonase* dhe alfabeti i saj cirilik.

(2) Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në pajtim me këtë ligj.

Duket qartë që në Nenin 1, pika 1 thuhet se maqedonishtja është gjuhë zyrtare në “tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare”. Ky ligj ka bërë emërtimin në kllapa “gjuha shqipe” dhe po kështu në këtë ligj mbetet formulimi “pranë gjuhës maqedonase”, që nënkupton se statusi i maqedonishtes ka mbetur “kodi i vetëm i komunikimit të shtetit” duke sanksionuar disi me të kamufluar qëllimin nacionalist “Një komb, një shtet, një gjuhë”. Në ligj madje togfjalëshi *gjuha shqipe* përmendet vetëm një herë dhe në të gjitha nenet e tjera flitet për “gjuha që e flasin, së paku 20% e qytetarëve”. Krahasuar me Kosovën, shtetin më të ri në Ballkan, serbishtja, që flitet nga rreth 2% e popullsisë së saj (serbët në Kosovë, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, janë vetëm 1.5%.)⁴ njihet me ligj si gjuhë zyrtare paralele dhe përdorimi i saj nuk është asnjëherë selektiv e arbitrar, po zbatohet në të gjithë Kosovën; kurse në Maqedoni shqipes nuk iu njoh po ai status si i serbishtes në Kosovë, edhe pse flitet nga 25,1% e popullsisë.

Sfidat reale të zbatimit të shqipes standarde në RMV

Statusi i ri që fitoi gjuha shqipe në mënyrë të menjëhershme ngre kërkesën që jo vetëm ajo të zbatohet aty ku i jep të drejtë Ligji për gjuhët, por nga ana tjetër rrit edhe më tepër kërkesat për zbatimin drejt të saj, rrit dhe përgjegjësinë e institucioneve që kanë për detyrë ta zbatojnë Ligjin për gjuhët, që të ruajnë prestigjin e shqipes. Kudo në shkolla, institucione, mediat shqiptare etj., shqipja duhet të paraqitet në nivelin e gjuhës së kultivuar mirë, ku nuk ka vend për gabime drejtshkrimore apo siç do të tregojmë më poshte edhe më keq, për ato kuptimore.

⁴ Popullsia sipas gjinisë etnicitetit dhe vendbanimit, Prishtinë 2013. <https://ask.rks-gov.net › media › popullsia-sipas-gjin...>

Së pari, është detyrë e shkollës të ngulisë njohuri të mira të shqipes standarde. Në klasën e tretë fillore, fëmijët në RMV fillojnë mësimin edhe të gjuhës maqedonase, që është gjuha e shumicës. Çdo mësues ka për detyrë të ndalojë diskriminimin që mund të mbahet ndaj gjuhës me status më të ulët, në mënyrë që të përmirësojnë motivimin e nxënësve për të mësuar mirë gjuhën e tyre amtare. Zbatimi i arsimit shumëgjuhësh duhet parë si një e mirë e nevojshme për të rritur ndërgjegjësimin gjuhësor dhe fleksibilitetin e të mësuarit. Duke marrë në shqyrtim disa tekste mësimore gjejtëm fjali e formulime që jo vetëm nuk janë në përputhje me natyrën e gjuhës sonë, por ka ndërtime të gabuara e të përkthyer keq, që e rrisin vështirësinë e të nxënësve të mësimin nga fëmijët e grupmoshës përkatëse.

Si gabim që përsëritet shpesh në këto tekste ⁵ është përdorimi i gabuar i gjinisë së përcaktorëve: *Maqedonia është vend të cilën e zbukurojnë shumë bukuri natyrore* [për: të cilin]; *Do ta njoftosh vetveten si person dhe si pjesë i grupit* [për: njofton, person, pjesë e grupit]; *Në cilat shtete ka pjesë të liqeneve tanë natyrorë?* [për: liqenet tona]; *është i shpërndarë dielli me tetë rrezet e saja.* [për: rrezet e tij]

Ka luhajtje në përdorimin e trajtës së emrit, kategori gramatikore që shqipja e dallon shumë mirë te emrat: *Në republikën populli e zgjedh pushtetin në zgjedhje demokratike.* Emri priret nga prafjala në dhe patjetër duhet në trajtën e pashquar. [në republikë]

Shqipja këtu, por dhe kudo ku jetojnë shqiptarë duhet ta ketë të unifikuar shkrimin e emrave të përveçëm. Gjetëm në tekstin e kl V: **Litvania, Viktor Igo** [për Lituania, Viktor Hygoi].

Gjen konstrukte gjuhësore, të cilat janë përkthime të papërshtatura me tipologjinë e shqipes, duke dhënë modele të gabuara te gjuhës amtare te fëmijët: *Në mes gjenden majat e maleve tona, ndërsa uji i përfaqëson lumenjtë dhe liqenet; Sot në Maqedoni lindet dielli i ri i lirisë.; Sa vjet jetoni në Australi? Përdori njohuritë e tua nga aktivitetet hulumtuese përmes stuhinë e ideve.*

Në kushtet e bilinguizmit që ekzistojnë në RMV e tani me zbatimin e Ligjit për gjuhët edhe më i theksuar në çdo zyrë e institucion, paraqitet rreziku i përzierjes

⁵ Klasa V “Shoqëria”, 2010; Libri i Fizikës për kl. VII, Shkup, 2010.

së kodeve të gjuhës amtare, që përbën kodin dominancë, me kodin e gjuhës tjetër, maqedonishten. Sigurisht për bilingualët simultantë ndërhyrjet (interferencat) gjuhësore nga njëra gjuhë te tjetra janë të pritshme.⁶

Përzierja dhe interferenca gjuhësore ndodhin kur elementet (në fonetikë, leksik e sintaksë) të një gjuhe kalojnë në gjuhën tjetër. Ata që i njohin të dy gjuhët mirë dinë të ruajnë dhe “...balancën relative midis dy gjuhëve (shën.ynë: e kësisoj) mund të minimizojnë interferencat duke shmangur situatën kur njëra gjuhë bëhet parazitare kundrejt tjetrës”⁷

Përkthimi nga shqipja në maqedonishte e anasjelltas, mbetet një nga sfidat e tjera në rrethanat e zbatimit të ligjit. Janë dy gjuhë pa asnjë lidhje farefisnie midis tyre e sigurisht kjo krijon probleme gjatë përkthimit. Gjatë këtij procesi hasen edhe gabime, të cilat janë dy llojesh: së pari kemi gabimin e lidhur me kompetencën gjuhësore e këtu kemi parasysh gabimet gramatikore dhe gabime të kompetencës komunikuese⁸. Të parat mund t’i konsiderojmë disi më të lehta se të dytat, sepse nuk ndikojnë në të kuptuarit e fjalisë, thënies, pra as nuk e ndryshojnë kuptimin. Të dytat janë më të rënda dhe sjellin pasoja më të mëdha në komunikim. Në këtë kuptim, përkthimi është një ambient krijues, që kërkon aftësi të mira gjuhësore e komunikative të përkthyesit, sepse shqipja dhe maqedonishtja janë gjuhë të ndryshme që nuk kanë struktura paralele me shtrate kuptimore të barazvlefshme.

Edhe pse nuk e njohim maqedonishten, nga një sy që i kemi hedhur shtypit dhe medieve shqiptare në RMV apo njoftimeve të ministrive të ndryshme, kemi vënë re struktura që nuk pajtohen me shqipen standarde, që është dhe gjuha zyrtare me të cilën duhet të prezantohet komuniteti shqiptar.

Kemi vënë re disa fjalë, veçanërisht në diskursin politik, të cilat kanë një denduri të shprehur në RMV, por edhe në Kosovë. Me siguri janë ndikime të

⁶ J. Kolgjini, “Nxënia e dy gjuhëve si gjuhë e parë si dhe invergjencia, konvergjenca e inovacionet gjuhesore: shqipe dhe anglishte”, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 31/1, 2012, f.673.

⁷ B. MacWhinney, Extending the competition model International Journal of Bilingualism, 2005, f.76-77.

⁸ Shih M. Kriezi “Problemet kryesore dhe llojet e gabimeve në mësimdhënien e shqipes si gjuhë e huaj”, Seminari 35/1 për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare.

sllavishtes. Kështu gjejmë të përdorur fjalën *qasje* me kuptime më të zgjeruara se kuptimi në gjuhën shqipe; [em.qasje < fol.qas me kuptimin *afrohem* FGjSh, Tiranë 2006, f.869]. Sigurisht që polisemia dhe zgjerimi i kuptimeve të një fjale është një tjetër rrugë pasurimi e shqipes, por kur ato largohen shumë prej kuptimit fillestar, bëhen të panjohura për një pjesë të bashkësisë gjuhësore dhe krijojnë keqkuptime në komunikim. Akad. Idriz Ajeti, i cili e vuri re të përdorej nga intelektualët e Kosovës e me siguri këtë kaloi edhe në Shqipëri, na thotë se emrit prejfoljor *qasje* iu shtuan edhe kuptimet e serbokroatishtes: *pristup, prilaz* e kështu ky emër përdoret edhe me kuptimin: *paraqitje, parime, metodë*⁹. Kjo ka ndodhur edhe këtu: *Sa i përket vendimit duhet të them se ajo e cila është e rëndësishme është ajo se për ne jep mundësi për qasje më konstruktive në zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Greqinë.* [për: *jep mundësi për zgjidhje*]; *Gjithashtu, janë bërë përpjekje që materia të jetë dhënë në mënyrë të qasur dhe bashkëkohore me shfrytëzim të aparatit matematikor.*

Vihen re si në ligjërimin e shkruar ashtu dhe në atë të folur struktura me folje joveprore, të cilat natyra e shqipes nuk i pranon, pasi në këto raste ajo përdor forma veprare: *Autorët do tu falënderohen të gjithë shfrytëzuesve të ardhshëm;* [për: *do të falënderojnë*]¹⁰ Në *Marrëveshje nuk janë nënshkruar vetëm përfaqësuesit e Maqedonisë dhe Greqisë por edhe ato të Kombeve të Bashkuara* [Për: **nuk kanë nënshkruar**] (telegraf, 21,1, 2019); *Unë jam i lindur në Maqedoni, në Gostivar.* [për; *kam lindur*]

Shpesh bilingët mund të jenë fare të pavetëdijshëm për interferencat. Sipas Mackeyut,..."dy gjuhë shpesh kanë të njëjtat pjesë të ligjëratës, por mund të dallojnë dukshëm në mënyrën si i sistemojnë ato në struktura"¹¹. I shpeshhtë është përdorimi i mbiemrit para emrit apo dhe ndajfoljes përpara foljes, çka bie ndesh me tipologjinë e shqipes, e cila ka një rend të kundërt të tyre: *Mickoski hapur flet se punon kundër NATO* [për: *flet hapur*]; *Redaksia jonë është anëtare e Këshillit*

⁹ Këtë dukuri e vërejti edhe T. Osmani në "Shqipja e Malit të Zi në sfidat e kohës", *Seminari ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë, 2010, f.334.

¹⁰ FIZIKA Për vitin III të arsimit të mesëm profesional, Shkup, 2011

¹¹ W. F. Mackey, 1962. Cituar sipas (V. Nuhiu, *Ndikimi i anglishtes në gjuhën shqipe*, f. 240)

për Etikë në media në Maqedoni dhe në këtë mënyrë plotësisht i përkushtohemi etikës... [për: i përkushtohemi plotësisht]; *Që më mirë të njihesh me vendin tënd.* [për: të njihesh më mirë]; *Çfarë më tepër i inspirojnë të huajt në vendin tonë?* [për: çfarë inspirojnë më tepër]

Vihen re përzierje kodesh gjuhësore në përdorimin e sintagmave parafjalore, të cilat janë ndikime sllave sipas modelit: folje e ndjekur nga shprehje parafjalë (*me*) plus një emër a përemër në instrumental: Gjuha në organet që *menaxhojnë me evidencat*; *Ministrat qeverisin me arsimin, me ekonominë...* Në këto rast kemi të bëjmë me kalke të pastra, të cilat janë interferenca në të cilat gjedhja e gjuhës dhënëse zëvendësohet element për element në gjuhën marrëse. Gjuha marrëse, pra shqipja standarde nuk i njeh. Te gjitha këto vinë edhe si rezultat i dëshirës së përkthyesve për t'i qëndruar besnik tekstit që përkthehet.

Nga shembujt që po parashtrijmë këtu, del qartë se kodet e dy gjuhëve “i ngatërrojnë” njerëzit e shkolluar, pra ata që i zotërojnë të dyja gjuhët. Këtu lind pyetja, a stepen ata kur kalojnë nga një gjuhë në tjetrën? E. Haugeni¹² thotë se bilingu nuk tregon as vetëdijen më të vogël kur del prej një gjuhe në tjetrën. Folësit sipas tij përdorin cilëndo shprehje që e kanë më afër “majës së gjuhës”. Por fakt mbetet që interferencat gjuhësore vijnë prej atyre që nuk zotërojnë mirë gjuhën, pra që kanë më pak kompetencë gjuhësore në shqipen amtare, që kanë njohuri jo të mira gramatikore të saj. Na kanë rënë në sy shembuj të përdorimit të gabuar rasor: *Zaev tha se nuk mendon që OBRM-PDUKM do të ketë shumicë prej dy të tretave* [për: prej dy të tretash], *por tha se është detyrë e tij që t'i theksojë hapat e opozitës.* [telegraf, 21,1, 2019]; *...i cili tha se nëse kanë shumicë prej dy të tretave* [për: prej dy të tretash]... në *Kuvend për aq kohë sa e kemi popullin pas neve* [për: pas nesh] (tetova neës); *Ndryshe, pas më shumë se dy dekadave është paralajmëruar* [për: pas dy dekadash].

Po kështu, gabime të përdorimit të vetës së foljeve: *...deklaroi Trajkovski, duke shtuar se ministri mund të vjen në Manastir, por jo të flet kundër interesave maqedonase.* Të gjitha këto përdorime janë kalke sipas gjedheve të sllavishtes jugore ku shprehjet me rasën rrjedhore “od = prej” nuk kanë përdorim të dëndur, sepse ekzistojnë përdorime të shumta sinonimike.

¹² E. Haugen, 1973, f. 530.

Gjithashtu, përdorim i gabuar, si ndikim i sllavishtes është përdorimi i togut *edhe atë* “мақ. и тоа (i toa)”: ...*ka nis edhe zëvendësimi i tabelave në rrugë edhe atë në gjuhën shqipe; Maqedonia duhet të forcojë statusin e vet në qyteterimin perëndimor dhe atë me praninë brenda integriteteve qytetëruese.*

Importimet gjuhësore shpesh nuk “shartohen” dot mirë në sistemin tjetër gjuhësor. Roxher Belli¹³ shprehet: “... ideali i një ekuivalence të plotë është një iluzion mendor, pjellë e imagjinatës... Kalimi nga njëra gjuhë në tjetrën, me përkufizim, nënkupton ndryshimin e formës. Gjithashtu, ballafaqimi i formave nxjerr në pah kuptime që asnjëherë nuk mund të përputhen plotësisht; nuk ka sinonimi absolute ndërmjet fjalëve të së njëjtës gjuhë.”

Një dukuri që rëndom të tërheq vëmendjen në shkrime të ndryshme në RMV është dyfishimi i kundrinorit dhe bashkimi i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë. Në gjuhën tonë bashkohen trajtat e shkurtra të përemrave në rasën dhanores me trajtat e shkurtra të përemrave në rasës kallëzore. Siç dihet, duke filluar nga Lopašov (1978),¹⁴ shprehur në mënyrë informale, dublimi i kundrinorit të drejtë në vetën e tretë nëpërmjet një trajte të shkurtër shërben për të shprehur funksionin tematik (përkundrejt funksionit rematik) të kundrinës, çka mund të shihet qartë në kontekstet e dhëna në shembujt e mëposhtëm. Më saktësisht, kur kundrina është pjesë e theksit logjik të fjalisë, atëhere ajo nuk mund të dublohet kursesi nga një trajtë e shkurtër. Në të kundërt, kur kundrina nuk është pjesë e theksit logjik të fjalisë, atëhere ajo duhet të dublohet domosdoshmërisht. Ja disa raste të gabuara: *Mickoski i ndjek udhëzimet e Gruevskit, 23.12.2019; Kuvendi e miratoi Ligjin e ri për ndërtim; i cili 17 vite më parë ua mori jetën 800 personave. Në 2 gusht të vitit 1944 në manastirin Prohor Pçinski është e mbajtur mbledhja e pare; Presim që mbledhja e Qeverisë së Shtip së bashku me kryetarët e komunave nga rajonet ti përcaktojmë prioritetet (për: të përcaktojnë).*

Përkthimet e dobëta e të paqëlluara mirë nuk shkaktojnë vetëm humor, por në disa raste, ato ndikojnë negativisht në jetën e qytetarëve. Duke qenë se baza e

¹³ R. T. Bell (1991) Translation and Translating: Theory and Practice. London: Longman, fq. 7.

¹⁴ D. Kallulli, Aspekte të sintaksës së shqipes dhe rëndësia e tyre për gjuhësinë teorike, në *Seminari ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Prishtinë, 33/1.

përkthimeve nga njëra gjuhë te tjetra aktualisht është rritur duke u zgjeruar në fushat e biznesit, mjekësisë, jurisprudencës etj, është bërë e nevojshme saktësia dhe vëmendja gjatë përkthimit. P.sh. kur merreni me çështje juridike, një fjalë e vetme mund të ndryshojë tërë kuptimin e një dokumenti. Vëmendja për detajet edhe më të vogla kërkohet në dokumentet, licencat e ndryshme, patentat, dokumentacioni i imigracionit, pronësia e letrave të pasurive apo dhe shënimet në medikamentet mjekësore etj. Të gjitha, në dukje të parëndësishme (khs.p.sh. me aktet diplomatike), por të afta për të të ndryshuar jetën nëse përkthehen dobët. Përkthimi nuk kërkon vetëm njohjen mirë të gjuhës në të cilën përkthen por dhe njohjen e kulturës së popullit që e flet atë, e këto janë vetëm parakushtet për të nisur përkthimin.

Si përfundim, në se duam një bashkëjetesë të gjatë e të qetë e cila do të rrjedhë ngadalë drejt integritit euroipian, integrim që ruan njëkohësisht dhe diversitetin kulturor e gjuhësor, le ta kuptojmë e zbatojmë Ligjin për zbatimin e gjuhëve në shoqërinë e sotme të RMV sipas motos: "Duke pasur parasysh mjedisin e duhur, dy gjuhë janë aq normale sa dy mushkëri" (Cook 2002b: 23).

PROF. DR. HAMIT XHAFERI

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE, TETOVË

h.xhaferi@seeu.edu.mk

KOMUNIKIMI NDËRKULTUROR DHE QËNDRIMI NDAJ KUMTIMIT LETRAR DHE ARTISTIK

Abstrakt

Përmes këtij punimi shkencor qëllimi ynë ka qenë studim i fenomeneve lidhur me të folurit përbuzës dhe mërisë përmes misionit që i përket nacionalizmit borgjez në Ballkan të atij sllavo maqedonas dhe serb. Shfaqja e botës, jetës dhe e realitetit të përshkrimit të ngjarjeve gjithashtu të regjimit ideologjik reaksionar ngërthen brenda vetvetes origjinën nga Chauvin dikjot prej ushtarëve të Napoleonit, i cili nëpërmjet shumë emocioneve të vrullshme shkarëzente të tjerët për të përdorur zotësitë e tij gjuhësore ose përtë thërritur mbi pushkën e dudit, konceptin e lashtë, mirëkuptimit kundrejt veprimit dallues, qeveritë e Ballkanit, Maqedonia e Veriut.

Fjalë kyçe: *Përçmimi ose mllëfi, Shtetëzimi, borgjezia, politika reacionare nacionaliste, Napoleoni, Chauvin, qeveritë e Ballkanit, Maqedonia*

Kumtimi midis tërësisë së njohurive ka qenë mjaft i brishtë, andaj duhet përkundrazi vetëm që njëfarë shqipërimi i mirëfillt i mendimit që i përket kulturës që ka të bëjë me të folmet ndërmjet etnive kombëtare dhe tërësisë së njohurive që janë ngërthyer gjatë kumtimit. Andaj kultura kurdoherë ka qenë e nevojshme që vetiu është pasqyruar, duke qenë më e kuptueshme apo më e qartë. Kjo si e këtillë ngërthen në vete mjaft modele të cilat ndërliidhen me tiparet e duhura dalluese në fushën e kulturës letrare ose gjuhësore duke u shqipëruar dhe ndërliidhur me fushat e ndryshme letrare. Përpikëria e shqipërimit sidomos sqarimit që i përket kumtimit në mes tërësisë së njohurive qëndron sipas njëllaj natyre kryesore mbi shkëmbimin e njoftimeve ndërmjet ca ose shumë trashëgimishë në fushën e zhvillimit shoqëror. Meqë bëhet fjalë mbi përpikmërinë gjatë shqipërimit, pashmangshmërisht lypset vënë në rrafshin parësor vërtetësinë lidhur me sajimin e vlefshmërisë, gjegjësisht letërkëmbimit të nevojshëm mbi kumtimin e gjuhëve dhe tipareve dalluese që janë të gjithllojshme. Një vërtetësi e këtillë ka qenë tërësisht nga cilësia e shqipëruesit, mirëpo aspak thjeshtë në të. Mënyra e të shqipëruarit të përpiktë ndërthuret përmes rëndësisë së shqipëruesit mbi atë kumtim mirëpo gjithashtu nëpërmjet

zotërimit të tipareve që nuk kanë të bëjnë me gjuhën, gjer tek pjesa e një teksti të shkruar shoqëror në të cilin gjendet ecuria e zhvillimit. Është e njohur që ndërlydhja ndërmjet kulturave ka prekur pasqyrimin e tyre me anë të sistemit të dijeve dhe njohurive të shqipërimit, meqë ka qenë e pastër ngaqë përveç kësaj diturie shkëmbimet ndërmjet kulturave as që kanë gjasë me u zhvilluar. Gjithashtu as që ka gjasë në asnjë mënyrë që të përshtaten krejt të folmet ndërkombëtare. Qyshkur gjatë formimit të ekzistencës së njeriut do të duhej të kishte shkëmbim mendimesh ndërmjet bashkësive përmes shqipërimeve veçanërisht paraqitjeve dhe sqarimeve gojore dhe jofjalësore. Kuntimi ndërmjetkulturave qëndron në mënyrë të ngjeshur në shqipërimin apo sqarimin, që ishin ca pajisje mjaft me rëndësi që ndërlydhen me ndërtimin e shtegut të kapërcimit që i përkasin njoftimit përmes konceptimit, prej të folmes identike ose nivelit zhvillimor nga vijuesja. Shqipërimi ka qenë dikurë prej dukurive goxha të vjetra që i përkasin gjuhës. Ky ishte vështruar porsa alternativë e domosdoshme e cila në vete mbart shifrën e rëndësishme të ligjërimeve ndër glob prej epokës teksa shoqëria që ka qëndrim njerëzor porsa kishte filluar me u përhapur në mënyrë të gjerë mbi botën e Planetit tonë. Shqipërimi luan një rol të rëndësishëm, sepse është i posaçëm gjatë kumtimit midis bashkëbiseduesve të cilët llafosin të folmedhe kultura që kanë shumëllojshmëri. Vlera gërshetohet përmes ndërrimit të thënieve të cilat ngërthejnë në vete domethënien ose përcimin e përpiktë nga njoftimi midis atij që bisedon me një tjetër ose ndërmjet tipareve dalluese që i përkasin shumëllojshmërisë përmes zakoneve, tërësisë së njohurive veçanërisht traditës që s'është e njëllajshme.

- Prej kumtimit mbi marrëdhëniet ndërmjet kulturave, brenda ecurisë së shqipërimit, shqipëruesit, i mbetet përzgjedhja e lirshme mbi seleksionimin e ligjërimeve, duke pikëzuar pikëpamjet prej të folmes origjinare për fjalën gjurmë, mirëpo ky krah i lirshëm miratohet thjesht për të mbetur përherë besëtari brendisë së përmbajtjes. Njëllaj funksioni që është i shënueshëm dhe me vlerë trajton po ashtu kundërshtimi shoqëror meqë shqipëruesi lypset me qenë i përqëndruar duke mëtuar që lidhet me zhvillimin shqipëror apo gjendet vazhdimisht në gjendje vendosmërie duke qëlluar madhësinë që ruan vlerën e saj të nevojshme sidomos artistike, përmes thjeshtësisë së synimit apo pasqyrimin të kumtimit. Veprimtarinë e shqipëruesit s'duhet me e kryer secili individ i cili njih

më shumë të folme. Shqipëruesi lypset me qenë zotëruer i vërtetë i ligjërimit apo zhvillimit gjuhësor, si gurrë veçanërisht edhe si gjurmë. Njëkohësisht, shqipëruesi lypset me qenë i pashmangshëm gjithashtu njëri ndër zotëruerit mjaft të vërtetë të kundërshtimit shoqëror që e shqipëron ose e sqaron një çështje. Gjatë shkëmbimit të mendimeve ndërmjet kulturave, veprimtaria e shqipëruerit as që duhet mbështetur thjeshtë mbi njëvlefshmërinë gjuhësore, meqë sipas aspektit të këtillë vihet në rrezik dërgimi i lajmërimit përmes domethënies. Drejtuesi i përcjell shenja pritësit. Lidhur me individin e njëlojtë i cili as që e llogarit ligjërimit – se është zanafillë e kumtimit, shenjat e këtilla as që e ndeshin konceptimin, për këtë arsye do ishin të pashmangshëm të hyrët në mes të shqipëruerit, që me përjashtim ia del dot duke i zotëruar, apo drejtuar te thënia që ka konceptim mbi pritësin e njoftimit. Andaj duket sikur e krijon ai atë? Natyrisht për të zbuluar treguesit e vërtetë gojorë ose jогоjarisht, sikurse gjithashtu për të menduar mirë patjetër vaktin ose kundërshtimin shoqëror në të cilin rastis shqipërimi. Kur i kemi në konsideratë të tëra tiparet dalluese të lartpërmendura, shqipëruesi lypset me qenë kurdoherë i zgjuar duke zbatuar kumtimin që është i përmbushur. Ky lypset me zotëruar tej mase dhe rrjedhshëm të folurit ose të ruajturit të ligjërimit origjinar po ashtu shumë drejt arrihet te ligjërimit dhe tërësia e njohurive të gjuhës tonë. Njëkohësisht lypset zotëruar bukur mirë etapën ose rrethanat shoqërore lidhur me atë të shqipëron. As që ka gjasa me u shmangur njëkohësisht pozicioni i brendshëmose tërësia e njohurive, personalisat e shqipëruerit. Qysh mund të mbërrijmë gjer te ligjërimit i duhur mbi çastin e duhur? Pa dyshim as që ka qenë njëfarësoj peripecie e ndjeshme lidhur me njërin ndër shqipëruerit që zotëron profesionin evet, mirëpo nga rrethanat e shumëllojshme, pengesat ka gjasa me qenë të arritshme ose në nivelin e ngritur. Një rast i këtillë rastis rëndom me rastin e shqipërimeve shoqërore dhe zakonet ose doket kombëtare ose të jetës së çdoditshme apo e folmja e një shtrese të popullit e njëlojtë veçorie me tipare dalluese që është e duhur. Gjithashtu modeli i shqipërimit që është i përpiktë tek disa dukuri shoqërore në Shqipëri ka qenë gjithashtu të ngrënit e orizit të zier dhetë përvëluar me gjalpë dhe gjellë të gatuar me plëndësin dhe me këmbët e berrit e ndreçur me uthull, me hudhra e me spec të cilin e përgatisin mjaft amvise toname rastin e shtegtimeve ose rrugëtimeve në largësi. Në ç'mënyrë duhet sqaruar

ndokujt të jashtmi, fjala vjen se në Shqipëri ka qenë si traditë kur nisen rrugës për në verime, veçanërisht në pjesën jugore, për pushime anës udhës, qëndrojnë për të ngrënë oriz të zier dhe të përvëlur me gjalpë? Mbi tërësinë e njohurive gojore dhe zakonin e kundërshtimit shoqëror që është e sotmja e popullit tonë, bie fjala të ushqyerit me oriz të zier dhe të përvëlur me gjalpë duke i vënë mbi të një sasi të vogël orizi ka qenë e pashmangshme mbshtjellja e barkut, me qëllimin e vetëm duke ndijuar aspak trazim përmes udhëtimit që është i largët. Vallë a ka gjasa që e merr vesh atë dikush nga të huajt, mëngjezi i kujtë brenda përudhës së largët qëndron veçse njëlloj trapani gjithashtu njëfarë kupe me tambël? Rrethanat e lartpërmendura ndërlidhen ngjeshur me dëshminë për arsye se objektivat në bazë të rrethanave janë të shumëllojshme. Natyrisht se shqipëruesi e ka fare lehtë duke shqipëruar çdo gjë që shtjellohet më lart përmes nocionit “ngrënie”. Mirëpo në qoftë se lypset njëfar shqipërimi goxha i hollësishëm, shqipëruesi ishte i obliguar që të shtjellojë në imtësi trajtimin e edukimit të këtillë ose për ç’arsye denduria e shfrytëzimit anës itinerarit (rrugëtimeve) veçanërisht dendësisë vendore të cilët e shtrojnë ngrënien e këtillë që ishte e një niveli të lartë. Këtij i nevojitet të shqipërojë duke sqaruar në atë aspekt duke mos u krijuar mosmarrëveshjet ose keqkuptimet në bashkëbisedim, ngaqë jo më kot një kumtim i arrirë ndërmjet kulturave zbatohet veçse atëherë kur ekziston kuptimi. Dihet që evropiani i cili ndofta ka patur gjasë të kishte ardhur për të parë jugun e Shqipërisë duke mos qenë i shtrënguar të rrënoj mënyrën e vet të ngrënies në sabah ose gjatë rrugëtimeve, mirëpo nëse do dëshirojë të përputhet me tërësinë e njohurive të cilat sapo i vrojton, për ç’arsye të mos e vërtetoj. Nënvizohet nocioni adaptim, për arsye segjithnjë kur zihet në gojë kumtimi, është i njohur sepse në kuadër tëkëtij ka një mirëkuptim që shpallet me zë të lartë ose me zë të heshtur, të paracaktuar ose jo, të folur ose të pafolur me fjalë dhe ndikime, me synimin unik që ka të bëjë me kumtimin e përpiktë. Një mënyrë e dytë e cila flet për përpikmërinë veçanërisht zgjuarsinë që lypset t’i ketë shqipëruesi gjatë bashkëbisedimit ndërmjet kulturave të ndryshme është i pranishëm shqipërimi ose sqarimi i gjendjes në rrethanat e një mortit në Shqipëri. I ngjashëm me indianin, që e sprovon gjendjen e mortit të dikujt në Shqipëri. Natyrisht se çështjafillestare të cilën duhet bërë të përjetojë asfiksimin në fushën e zhvillimit

shoqëror artistik siç ka qenë tërësia e rrobave të femrave prej ngjyrës së korbit, sepse është i njohur siç është dukuria e kodit indian i cili sprovohet prej njerëzve që janë të ngjeshur me të bardhëllemta. Ndërmjetësimi i shqipëruetit të shkathët i cili e zotëron bukur tërësinë e arritjeve lajmëtare, të cilat e kanë bërë të mundshëm indianin të marr vesh se dukuria e njëjtë e cila përmes gjuhës, veçanërisht zhvillimin tonë shoqëror i cili shfaqet përmes gjëmës, tek e folmja e zhvillimit indian. Niveli i peripecisë përmes shtjellimit mund të ishte akoma edhe ca i rëndësishëm në qoftë se indiani as që kishte me qenë pjesëmarrës tek e vetëquajtura ndodhi, mirëpo rëndomë njëlloj lëçitësi i romanit shqiptar për të cilin ndër të tjera bëhet fjalë mbi dukurinë e mortjes poashtu tërë ceremoninë fetare të kësaj. Çështja kishte me qenë fatkeqësi e madhe, në qoftë se indiani tërësisht befaz paraqitet nga kjo ndodhi përmes rrobave që i përkasin këtij në bazë të dokeve indiane. Janë krijuar mosmarrëveshje që janë të dyanshme anët të cilat kanë qenë me ecuri të kumtimit. Munden të dispononin me çdo gjë përveç kumtimit që është mbërritur. Munden me u krijuar, mosmarrëveshje thjeshtë prej keqkuptimit. Në këtë të mbramen kishte me qenë i prejardhur nga njëlloj shqipërimi ose sqarimi i gabuar nga rrethana e duhur. Patjetër mbi çështjen e këtillë, shqipërueti ka për obligim t'i zmadhojë ose t'i sqarojë fillimisht për të shfrytëzuar shenjat e pikësimit - dy gjysmëkllapat këndore ose sqaruese, sepse boja gjëmë mbi trashëgiminë apo në pasurinë tonë shpirtërore shfaq shqetësim veçanërisht boja qumështore shfaq ngazëllim apo ngazmend. Tjetërsoj prej trashëgimisë që lidhet me nivelin dhe fushën e zhvillimit të trashëgimisë indase, tek ngjyrat e këtilla shfrytëzohen nga rrethanat që janë në kundërshtim. Zgjuarsia e shqipëruetit veçanërisht përcaktimi i barasvlerave ose letërkëmbimeve reale mbikuptimin e kundërshtimit shoqëror që është i vendosur, duke mbështetur indianin për me qartësuar njëmend gjendjen, mirëpo e përkrah githashtu në arritjen e përhapjes së njoftimit domethënës prej njërit tipar dallues në të dytin. Njëfarë ligjërimi i folur keq gjithashtu i pa përpiktë as që ka mundësi për me kumtuar kurrëgjë domethënëse. Tek dikush prej kumtimeve ishte me vlerë transmetimi të njoftimit mjaft domethënës prej një rës tërësie zhvillimi mbi ndonjë të dytë, në të cilin tek vija me ujë të lajmërimit prej lajmërimpritisit te lajmërimdhuruesi, poashtu funksioni mjaft i vrullshëm të cilin e lozte dragomani

veçanërisht kundërshtimi shoqëror prej kujt rrjedh kumtimi. Marrëveshja midis zhvillimit shoqëror as që plotësohet veçse për të shqipëruar përmbledhjen e sistemuar të mendimit lingistik, mirëpo gjithashtu ajo shoqërore dhe artistike, siurse gjithashtu për të pasur në konsideratë të vërtetën e çfarëdo mjedisiapo nga cilado faze që rastis ndërrimi i njoftimit.

DR. ELSA SKËNDERI RAKIPLLARI

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

skenderi.elsa@gmail.com

**PRANI DHE MUNGESA TË POLITIKAVE GJUHËSORE NË
PEIZAZHIN LINGUISTIK**

(RASTI I QYTETIT TË TETOVËS)

Abstrakt

Studimet e para për peizazhin linguistik lindën, më shumë se nga një kërkues për emërtesat e përdorura në hapësirën publike, për të parë politikën gjuhësore në ato zona ku kishte konflikte gjuhësore. Peizazhi linguistik ka dy funksione parësore: funksionin informues dhe atë simbolik. Për disa studiues ai shpreh vitalitetin etnolinguistik të një komuniteti, ndërsa për të tjerë është një medium ku fare mirë mund të qëmtohet sa e fortë dhe e zbatuar është politika gjuhësore. Shenjat zyrtare të peizazhit linguistik reflektojnë “politikën gjuhësore të dukshme të një shteti”, por nga ana tjetër shenjat jozyrtare reflektojnë politikën gjuhësore të padukshme të komunitetit dhe mund shpalosin rrënjët e identitetit kulturor dhe të aspiratave identitare të anëtarëve të këtij komuniteti. Veç trajtesës teorike për mënyrën si reflektohen politikën gjuhësore implicite ose eksplicite të një vendi në peizazhin linguistik, në këtë kumtesë do të trajtohet edhe rasti i peizazhit linguistik të qytetit të Tetovës në Maqedoninë e Veriut.

Fjalë kyçe: *peizazh linguistik, politika gjuhësore,, ligji për gjuhët, Tetovë, vitalitet etnolinguistik.*

1. Peizazhi linguistik dhe politikën gjuhësore

Studimet e para që janë marrë me peizazhin linguistik kanë qenë të prirura për t'i parë shenjat gjuhësore në hapësirat urbane nga perspektiva e politikave gjuhësore, planifikimit gjuhësor dhe të kontaktit gjuhësor në hapësira shumëgjuhësore e shumëkulturore. Një studim i shumëcitur dhe i konsideruar edhe si themeltar në fushën e peizazhit linguistik, është ai i studiuesve Rodrigue Landry dhe Richard Y. Bourhis (1997), me titull “Peizazhi gjuhësor dhe vitaliteti etnolinguistik”. Në këtë studim peizazhi linguistik shihet nga një qasje teorike etnolinguistike dhe argumentohet se peizazhi linguistik është medium ku mund të vëzhgohet qartë sjellja gjuhësore e banorëve të një vendi. Veç të tjerash studimi i Laundry-t dhe Bourhis-it (1997) ka një rëndësi të veçantë dhe është i

shumëcituar, sepse në të jepet për herë të parë një përkufizim i thukët dhe i qartë për peizazhin linguistik: “Gjuha e shenjave rrugore publike, tabelat e reklamave, emrat e rrugëve, emrat e vendeve, shenjat e shitoreve komerciale dhe shenjat publike në ndërtesat qeveritare kombinohen për të formuar peizazhin gjuhësor të një territori të caktuar, rajoni ose grumbullimi urban” (25).

Autorët e pohojnë faktin se fillimisht peizazhi gjuhësor është parë në lidhje me politikat gjuhësore dhe veçanërisht për zona ku ka pasur konflikte gjuhësore, por pa u interesuar për konceptin e peizazhit gjuhësor, madje as në ato raste kur vende të caktuara kanë miratuar ligje për rregullimin e gjuhës, që do të përdorej në hapësirat publike. Për ta peizazhi linguistik ka dy funksione parësore: funksionin informues dhe funksionin simbolik.

Sa i takon funksionit informues, peizazhi linguistik e kryen atë duke shërbyer si shënues i një territori gjeografik, që banohet nga një bashkësi gjuhësore e caktuar. Në një farë kuptimi përmes peizazhit gjuhësor shihet se deri ku i ka kufijtë një bashkësi gjuhësore e ku fillon bashkësia tjetër. “Kësisoj peizazhi linguistik shërben për të informuar anëtarët brenda dhe jashtë grupit për karakteristikat gjuhësore, kufijtë territorialë dhe kufijtë gjuhësorë të rajonit ku kanë hyrë” (Laundry, Bourhis 1997, 25). Krahas kësaj, nënvizojnë autorët, shenjat gjuhësore publike shërbejnë për të bërë me dije se në cilën gjuhë komunikohet në një vend të caktuar apo për statusin që ka një gjuhë e caktuar krahasuar me një gjuhë tjetër, në raste të situatave të bilinguizmit apo të diglosisë. Shpesh, vërejnë autorët, gjuha që ka një status më të lartë, haset më dendur në hapësirën publike. Ndaj, peizazhi linguistik mund të reflektojë marrëdhëniet e pushtetit dhe të statusit që kanë varietete të caktuara gjuhësore.

Nga ana tjetër, funksioni simbolik i peizazhit linguistik, ka të bëjë me pikëpamjen se gjuha është një prej simboleve të identitetit etnik. Po ashtu, peizazhi gjuhësor, në këtë hulli mund të shërbejë, thonë autorët, për të dalluar vitalitetin etnolinguistik të një grupi të caktuar. “Këshu prania ose mungesa e gjuhëve rivale në fusha specifike të peizazhiat gjuhësor mund të simbolizojnë fuqinë ose dobësinë e grupeve konkurrenente etnolinguistike [...]. Mungesa e gjuhës së një grupi në shenjat publike mund të konsolidojë një normë sociolinguistike që i bën anëtarët e grupit ta përdorin gjuhën e tyre në fusha sa vjen e më të ngushta” (28).

Kësisoj, sipas Laundry-t dhe Bourhis-it, peizazhi gjuhësor mund të shërbejë si treguesi më i drejtpërdrejtë i statusit dhe marrëdhënieve të pushtetit, që ekzistojnë mes komuniteteve gjuhësore të një territori të caktuar. Kjo linjë e përcaktimit të marrëdhënieve mes varieteteve gjuhësore të një territori të caktuar, si pasojë e pranisë ose mungesës në peizazhin lingvistik, por edhe e përcaktimit të vitalitetit etnolingvistik të një bashkësie gjuhësore, është ndjekur veçanërisht në hulumtime që kanë pasur në fokus territore të njohura për bi- ose multilinguizëm. Sipas studiuesve Van Mensel, Vandenbroucke dhe Blackwood (2016) është pikërisht ky qëndrim teorik, ai që e ka karakterizuar valën e parë të studimeve në fushë të peizazhit lingvistik.

Studimet për peizazhin lingvistik, siç e përmendëm dhe në krye të këtij sythi, u zhvilluan në sfondin e një interesi të veçantë për politikën gjuhësore¹ dhe për verifikimin e zbatimit të tyre. Të tilla ishin studimi i Rosenbaum-it dhe kolegëve të tij (1977) për përdorimin e anglishtes në Rrugën “Keren Kayemet” në Izrael, studimi i Monnier-it (1989) për peizazhin lingvistik në Kebek (Québec) të Kanadasë, ku synohej verifikimi i përdorimit të frëngjishtes, sipas Ligjit 101, studimet e studiueseve Stella Tulp (1976) dhe Veronika Wenzel (1978, 1998) për përdorimin holandishtes dhe frëngjishtes në emërtesat tregtare në Bruksel, ku të dyja gjuhët janë zyrtare. Çështja e interpretimit të peizazhit lingvistik nga pikëpamja e politikave gjuhësore është rimarrë nga edhe shumë studime të mëvonshme. Ideja mbizotëruese është se politika gjuhësore është mjet tepër i fuqishëm për të manipuluar sjelljet dhe praktikën gjuhësore (Shohamy 2006, Shohamy 2015, Backhaus 2007). Në veprën e saj “Politikat gjuhësore si agjenda të fshehta”, E. Shohamy (2006) analizon mënyrën se si politikën gjuhësore reflektohen në gjuhën e hapësirës publike. Sipas saj përdorimi *de facto* i gjuhës ndikohet nga një sërë aktivitetesh që janë reflektim i ideologjive gjuhësore.

¹ Me politikë gjuhësore do të kuptojmë ato vendime që merren për gjuhët dhe përdorimin e tyre në shoqëri dhe edukim (*shih* Shohamy 2015).

Siç shihet nga skema në figurën nr. 1, përdorimi konkret i gjuhës ndikohet nga disa mekanizma që shërbejnë për ngulitjen e politikave dhe ideologjive gjuhësore mbizotëruese. Në këtë paraqitje skematike *ligjet dhe rregulloret*² iu referohen në tërësi ligjeve, rregullave e rregulloreve që kanë të bëjnë me çfarë cilësohet gjuhë standarde dhe zyrtare. Nga ana tjetër testet gjuhësore, konsiderohen si një mjet i politikave gjuhësore dhe një degë e edukimit gjuhësor që ka ndikimin më të madh në praktikën gjuhësore.

Sipas skemës së Shohamy-t, gjuha në hapësirën publike është po ashtu një




Figura 1 Lista e mekanizmave mes ideologjisë dhe praktikës (Shohamy 2006, 58)

mekanizëm i politikës gjuhësore. Ndërsa *ideologjia* lidhet me besimet për gjuhën, që siç thotë Shohamy nuk mund të ndahen nga ideologjia politike e shtet-kombit, të besuarit në faktin që gjuhët dhe kombet janë identike, apo besime të tjera që mund të lidhen me varietete që gëzojnë prestigj krahasuar me disa të tjera. Te

² Në një tjetër artikull të sajën, në skemë në vend të *Rregulla dhe rregullore*, Shohamy (2015) përdor termin *Politikat e shpallura*, çka tregon se kjo pjesë e politikave gjuhësore është eksplicite, pra e hapur.

mitet përfshihen konceptet për *gjuhën e drejtë*, *gjuhën e mirë*, *gjuhën gramatikore* etj. (shih më tej Shohamy 2006: 130-133).

Gjuhët që shfaqen si pjesë e peizazhit gjuhësor të një vendi mund të thonë shumëçka për ndërtimin simbolik të hapësirës publike, vendin e një gjuhe specifike në komunitet, për aspektet etnolinguistike dhe të vitalitetit e diversitetit etnik, por edhe për zbatimin ose jo të politikave gjuhësore ekzistuese. Pavarësisht karakterit efemer të peizazhit linguistik, duke qenë se artefaktet në këtë peizazh, mund të ndryshojnë brenda një kohe relativisht të shkurtër, të dhënat e marra prej tij, vlejné për të realizuar një fotografim të realitetit gjuhësor në terren. Këto të dhëna janë të një rëndësie të veçantë, po të kemi parasysh se shenjat gjuhësore në hapësirën publike i serviren një publiku të gjerë dhe mund të ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në çështje të performancës ose vetëdijes gjuhësore. Këtë pikëpamje e hasim edhe te Cenoz dhe Gorter (2006, 68) të cilët theksojnë se: “gjuha në të cilën janë shkruar shenjat me siguri mund të ndikojë perceptimin e tyre (njerëzve) për statusin e gjuhëve të ndryshme dhe madje mund të ndikojë sjelljen e tyre gjuhësore. Peizazhi linguistik ose pjesë të peizazhit linguistik mund të kenë ndikim në përdorimin e gjuhës”.

Janë të shumta rastet kur emërtesat që përbëjnë peizazhin gjuhësor të një qyteti bëhen shkak për debate veçanërisht në rrethin e studiuesve dhe të gjuhëtarëve apo të atyre që merren me politikat gjuhësore e arsimore. Njihen gjithashtu raste të shumta, kur me anë të ligjeve dhe rregulloreve specifike, qeveritë në rang vendor ose kombëtar synojnë të rregullojnë sjelljet gjuhësore dhe kodin gjuhësor të përdorur në peizazhin gjuhësor. Ky lloj karakteri shtrëngues i një norme ligjore, megjithatë jo gjithmonë duket se jep efektin e pritshëm. Veçanërisht ato pjesë të peizazhit linguistik, që janë krijime private të individëve, kanë prirjen që t’iu shmangen rregullave preskriptive të politikave gjuhësore.

Politikat gjuhësore zyrtare janë qëmtuar me interes të veçantë sidomos në zona ku ka probleme etnike ose gjuhësore dhe ku një varietet i caktuar gjuhësor duhet të mbizotërojë përmes rregullimit me anë të normave detyruese. Kështu për shembull në vende Montreali, Jeruzalemi dhe Hong Kongu, politikat gjuhësore zyrtare përcaktojnë edhe rendin që duhet të kenë gjuhët në një shenjë, në rastet kur përdoret më shumë se sa një gjuhë (Backhaus 2006). Në raste të tjera, politika gjuhësore zyrtare është hartuar që të përfshijë edhe gjuhë të tjera përveç gjuhës

amtare, siç është rasti i Tokios. Ndërsa në vende si Dakari, kryeqyteti i Senegalit, gjuha e shenjave zyrtare, është vetëm frëngjishtja, pavarësisht gjuhëve të tjera lokale të vendit.

Megjithatë ka edhe vende ku politikat gjuhësore zyrtare janë të paspecifikuara në mënyrë eksplicite. Nëse do t'i referoheshim skemës së Shohamy-t (2006), të paraqitur më lart në figurën 1, atëherë skemës për politikat gjuhësore të këtyre vendeve do t'iu mungonte mekanizmi i parë, ai i politikave të deklaruara e të sanksionuara. Rast tipik, shprehen studiuesit Robert Blackwood dhe Stefania Tufi (2015), është ai i Italisë, ku nuk ka një qasje sistematike kombëtare për planifikimin e gjuhës në rrugë zyrtare, megjithatë ideologjia e gjuhës përhapet dhe konsolidohet përmes përkujdesjes dhe vëmendjes ndaj shkollës dhe politikave arsimore (23-24). Politikat gjuhësore të mirëfillta u sanksionuan gjatë regjimit fashist dhe ishin jo vetëm thellësisht puristë, por edhe tepër represive, veçanërisht ndaj përdorimit të gjuhëve të huaja e sidomos të minoriteteve, por edhe ndaj dialekteve. Çdo shfaqje gjuhësore që cenonte integritetin kombëtar dhe unitetin kulturor ishte e ndaluar.

Këto politika gjuhësore të fashizmit, përveçse për shkak të skajshmërisë shtrënguese, kanë marrë vëmendje të veçantë edhe ngase “përfaqësojnë përpjekjen e vetme sistematike për të rregulluar përdorimin e gjuhës në Itali, të paktën në sferën publike” (Blackwood, Tufi 2015, 25). Sidoqoftë, këto politika nuk sollën ndryshime të mëdha në përdorimin e gjuhës, përveçse konsoliduan paragjykimet dhe stigmatizimet rreth varieteteve gjuhësore jostandarde.

Blackwood dhe Tufi (2015, 26- 28), nënvizojnë se situata ndryshoi pas Luftës së Dytë Botërore, me miratimin e Kushtetutës (1948), ku ndonëse nuk u identifikua specifikisht italishtja si gjuha zyrtare e vendit, u përcaktua se “Republika ruan minoritetet gjuhësore me norma specifike”. Një tjetër ndryshim në drejtim të gjuhëve dhe kulturave minoritare qe Ligji i vitit 1999, për mbrojtjen e disa gjuhëve dhe kulturave që iu përkisnin minoriteteve, mes të cilave edhe për mbrojtjen e gjuhës dhe kulturës së Arbëreshëve. Kështu ligji përcaktonte “Republika mbron gjuhën dhe kulturën e popullsisë shqiptare, katalanase, gjermane, greke, sllovene dhe kroate dhe të atyre që flasin frëngjisht, franko-provençaisht, friulinisht, ladinisht, oksitanisht”.

Pavarësisht mungesës së politikave gjuhësore zyrtare në rang kombëtar, këshillat bashkiakë të qyteteve të ndryshme, rast pas rasti rregullojnë gjuhën e hapësirës publike përmes rregulloreve dhe udhëzimeve të ndryshme, shpesh duke e përligjur këtë praktikë me nevojën që ka për ruajtjen e autenticitetit kulturor të qyteteve të ndryshme.

Ndryshe prej rastit të Italisë, ku në nivel kombëtar politikat gjuhësore janë implicite, në Francë dhe në vendet e varura politikisht prej, politikat gjuhësore janë qendrore. Është i njohur fakti se ideologjia gjuhësore në Francë është mjaft centriste dhe po aq i njohur roli rregullues e mbikëqyrës ndaj gjuhës që ka *L'Académie française*, institucion i krijuar që në vitin 1635.

Për të përmbyllur këtë syth duhet thënë se ka raste kur peizazhi linguistik shndërrohet në medium, ku politikat gjuhësore jo vetëm formësohen por edhe kontestohen. Sidomos në zonat ku ka konflikte të ndryshme etnike apo gjuhësore, banorët reagojnë ndaj shenjave ekzistuese të peizazhit linguistik duke shkruar mbi to me gjuhët e ndaluara apo të palejuara, si formë e shprehjes së protestës ndaj politikave gjuhësore zyrtare (*shih* Shohamy 2006, Blackwood, Lanza, Woldemariam 2016). Kontestimi ndodh shpesh ngase shenjat e peizazhit linguistik shihen simbolikisht si shenja përfaqësuese të identitetit etnik.

Ligji i gjuhëve në RMV dhe situata etnike në Tetovë

Në realitetin e sotëm politik e social të thujse çdo qyteti, shumëgjuhësia është e pranishme, ndonëse mund të mos jetë e pasojë e bashkësive shumëgjuhësore. Peizazhet linguistike të qyteteve bashkëkohore priren kah shumëgjuhësia si shprehje e frymës së bashkëkohësisë. Gjithsesi, për të parë sa reflektohen politikat gjuhësore në peizazhin linguistik të një qyteti, ku politika gjuhësore është implicite, kemi zgjedhur të qëmtojmë peizazhin linguistik të qytetit të Tetovës, në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Tetova është një qytet me një popullsi prej 52,915 banorësh prej të cilëve, shumica dërmuese janë shqiptarë. Statistikat e servitura nga Agjencia e Zbatimit të gjuhës e RMV-së e përcaktojnë përbërjen etnike të Tetovës në nivelet 70.23% shqiptarë dhe 23.16% maqedonas. Komuna e Tetovës është pjesë e Rajonit të Pollogut, i cili ka një popullsi prej 304.125 banorë, prej të cilëve 222 679 janë shqiptarë dhe ku gjuhë zyrtare është edhe shqipja. Në Komunën e Tetovës, sipas

të dhënave, gjuha shqipe është përdorur si gjuhë zyrtare që nga vitit 1992 (Sela *et.al* 2021, 106- 121,).

Më 14 marsit të vitit 2018, në Republikën e Maqedonisë së Veriut është miratuar Ligji për përdorimin e gjuhëve. Ky ligj ka hyrë në fuqi më 14 janar të vitit 2019 dhe parashikon se krahas maqedonishtes edhe gjuha shqipe të gëzojë statusin e gjuhës zyrtare. Në ligj thuhet:

“(1) Gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik është gjuhë zyrtare në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare.

(2) Gjuhë tjetër që flitet të paktën nga 20% e qytetarëve (gjuha shqipe) është gjithashtu gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në përputhje me këtë ligj”.

Gjithsesi, ndryshe nga sa parashikohet *de jure, de facto* hapësira që zë dhe statu gjuha shqipe është shumë më e reduktuar krahasuar me maqedonishten. Siç shprehen studiuesit (Rrokaj 2020, Sela *et al.* 2021, mes të cilëve edhe I. Maksuti (2021): “Në Republikën e Maqedonisë së Veriut kemi një rast gati ‘*sui generis*’ të dygjuhësisë së njëanshme, pra pala shqiptare e mëson në shkollë dhe e njëj maqedonishten, ndërsa pala maqedonase nuk e mëson në shkollë dhe nuk e njëj thuajse fare gjuhën shqipe. [...] shqipja nuk ka pasur (ende nuk e ka plotësisht) statusin e njëjtë me maqedonishten, që ka rolin e gjuhës dominuese në shtet” (146).

Procedimi metodologjik

Analizat e peizazhit lingvistik, përgjithësisht janë deskriptive dhe interesohen për shpërndarjen e gjuhëve në hapësirën publike. Peizazhi lingvistik kërkon si rregull aplikimin e metodës së dokumentimit të shfaqjeve së varieteteve të ndryshme gjuhësore në zonën e caktuar urbane. Për hulumtimin tonë, të dhënat u mblodhën duke ndjekur një qasje etnografike (përmes *vëzhgimeve të pjesëmarrësit*).

Si fillim u përcaktua segmenti rrugor në të cilin do të mblidheshin të dhënat, pra emërtesat me karakter “*in vivo*”, duke u përqendruar vetëm te emërtesat në ballë të objekteve dhe jo te tekste të tjera shtesë që përmbante objekti. Përfshirja e teksteve të tjera, ndonëse në një farë mënyre e ngushton fokusin, pasi gjuha në hapësirën publike është shumë më e pranishme, “do të

rrezikonte ta shndërronte studimin në një mision të pamundur” (Ben-Rafael dhe Ben-Rafael 2016, 200). Në figurën nr. 2 paraqitet një hartë e Tetovës (marrë nga hartat e Google-it) që tregon të qarkuar segmentin rrugor nga ku u mblodhën të dhënat.




Figura 2 Segmenti prej ku u mblodhën të dhënat për peizazhin linguistik të Tetovës
(Burimi: Google Maps)

Ky segment është një ndër arteriet kryesore të lëvizjes në qytet në të është përqendruar pjesa më madhe e veprimtarive tregtare. Ndaj në këtë segment denduria e artefakteve gjuhësore është më e lartë dhe njësitë e mbledhura (në total 277 njësi), janë të mjaftueshme për të ofruar një pasqyrë të qartë të peizazhit linguistik të Tetovës. Kujtojmë këtu, se dokumentimi shterues i të gjitha artefakteve të peizazhit linguistik është thujse i pamundur (*shih* Blackwood 2015, 41).

Dokumentimi i peizazhit linguistik të është bërë përmes fotografimit me telefon celular të çdo objekti që përmbante shenja “*in vivo*” dhe përmes mbajtjes së shënimeve në mënyrë manuale³. Më tej këto të dhëna janë hedhur në kompjuter dhe janë grupuar sipas gjuhëve.

Rezultatet, pranitë dhe mungesat

Peizazhi linguistik i Tetovës paraqitet i larmishëm. Praninë më të madhe si gjuhë më vete në këtë peizazh e zë gjuha angleze, ndonëse ajo nuk është gjuha e asnjërit prej komuniteteve etnike të qytetit. Më tej, si gjuhë më vete dhe e

³ Gjejmë rastin të shprehim falënderime për E.K. për ndihmën e çmuar gjatë mbledhjes së të dhënave.

shoqëruar me gjuhë të tjera, në emërtesa më së shumti shfaqet gjuha shqipe. Maqedonishtja vetëm dhe e shoqëruar me gjuhë të tjera, shfaqet më pak në emërtesa, me një përqindje totale nëntë.

Gjuhët vetëm dhe në kombinim	%
Anglisht	35.4
Shqip	22.8
Shqip - anglisht	24.9
Maqedonisht	2.9
Maqedonisht-shqip	2.5
Maqedonisht- shqip-turqisht	2.2
Maqedonisht-shqip- anglisht	1.4
Të tjera	7.9

Tabela 1 Përqindjet e gjuhëve vetëm dhe në kombinim në peizazhin linguistik të Tetovës (N=277)

Sa iu takon shenjave gjuhësore në anglisht, bie në sy se emërtesat në anglisht përdoren për të emërtuar biznese veprimtaria e të cilave përqendrohet te teknologjia, telekomunikacioni, moda dhe lojërat e fatit. Për shembull: *Casino Bloom, City Casino club, Box casino, Golden Ball, Phone service (Euro com), 24/7 King, Gold Slot Club, Bosch Professional, Baby boutique LENA KIDS, BALANCE boutique.*



Figura 3 Emërtesë në anglisht e një shitoreje veshjesh



Figura 4 Emërtesë në anglisht e një shitoreje veshjesh



Figura 5 Emërtesë në anglisht e një biznesi lojrash fati

Emërtesat në vetëm në gjuhën shqipe përgjithësisht përmbajnë emra të përveçëm njerëzish ose shenjojnë veprimtari gastronomike dhe/ose artizanale. P.sh. *BEKIMI*, *BENI*, *Joni*, *Këmbimore EGZON*, *Salloni i Perdeve ARGJENDI*, *Këpucëtar*, *Artar*, *Qebaptore*, *gjellëtove SHARRI*, *Ëmbëltore MOSTAR*, *SALLONI i KËPUCËVE ENSAR*, *Mishtore*, *Furra e bukës AURORA* etj.



Figura 6 Emërtesë në gjuhën shqipe (Mishtore Korabi)



Figura 7 Emërtesë dygjuhëshe (shqip-anglisht)

Në ato emërtesa ku gjuha shqipe shoqërohet nga anglishtja, përgjithësisht në anglisht paraqitet emri që tregon natyrën e biznesit dhe në shqip emri i përveçëm, për të shenjuar pronarin e biznesit. Për shembull: *Fastfood Mimoza – Pula në prush*, *Nezir komerc tepiha*, *Ylli PHONE*, *Barnatore BETTY*, *Boutique DRITA*, *FATI light*, *DY VËLLEZËRIT boutique* etj.

Çfarë bie në sy, në ato njësi të peizazhit linguistik të Tetovës, që janë në shqip, është përdorimi i grafemës ë, siç duhet, me dy pika, ndryshe nga sa mund të vihet re, në peizazhin linguistik të Tiranës, ku prirja është për të mos i përdorur dy pikat e ë-së.

Maqedonishtja, ndonëse është gjuha zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në peizazhin linguistik të Tetovës përdoret rrallë, kryesisht në emërtesa dy-trigjuhëshe.

Barnatore Аптека Еczane UNIVERZAL –R, Kipper market Штеди секој ден !
-Kurse çdo ditë, Furra Prizreni i Vjetër ПЕКАРА – Bukëpjekës, Furrë Elsa FIDAN Печка Елса-фидан. СТОПАНСКА БАНКА. Banana Kick (Bastore sportive) СПОРТСКА ОБЛОЖУВАНИЦА.



Figura 8 Emërtesa e një biznesi për grafi dentare në Tetovë

Nëse shohim tabelën nr. 1 me përqindje përkatëse për secilën gjuhë, me një përqindje 7.9, del kategoria “Të tjera”, ku janë përfshirë të gjitha ato raste emërtesash të cila përmbajnë kombinime të tjera gjuhësore veç të përmendurave, për shembull rastet e emërtesave në gjuhën turke, gjermane e të tjera, ose emërtesa që janë të vështira të klasifikohen se i përkasin njëres gjuhë ose tjetrës, siç mund të jetë rasti i emrave të firmave të huaja. Shembuj nga kjo kategori përmendim: *Oxxie, Isak 1&2, Vero moda, Domenico, SPARKASSE, Peperoni,*

Al, Frizer image, Mozart, Hot döner, Döner SHARRI, Kiper market, Di Porte, Lavan, Penti etj.

Pamundësia për të klasifikuar të gjitha shenjat në një kategori specifike është praktikë e njohur e studimeve të peizazhit linguistik, veçanërisht kur bëhet fjalë për emra të përveçëm, për emra firmash e kompanish prestigjioze ose për terma. Diskutimin për klasifikimet e këtij lloji e hasim në literaturë të autorët Edelman 2009, Ben Rafael dhe Ben Rafael (2016). Vështirësitë për të klasifikuar të gjithë materialin e peizazhit linguistik shtohen po të kemi parasysh “ndotjen” dhe tejngopjen me informacion që kanë prirjen të kenë shenjat e peizazhit linguistik, për të tërhequr sa më shumë vëmendjen e klientëve (Shih Nash 2016,4 kur i referohet Gorter-it 2012)

Përdorimi shumë më i lartë në përqindje i gjuhës shqipe në raport me maqedonishten vjen në gjykimin tonë si dëshmi e vitalitetit etnolinguistik, koncept që e shohim të shtjelluar që në fillesa të disiplinës së Peizazhit linguistik të autorët Laundry dhe Bourhes (1997). Sipas tyre, “prania ose mungesa e gjuhëve rivale në fusha specifike të peizazhit gjuhësor mund të simbolizojnë fuqinë ose dobësinë e grupeve konkurrenente etnolinguistike [...].

Shenjat gjuhësore publike në peizazhin linguistik të Tetovës shërbejnë për të bërë me dije se në cilën gjuhë komunikohet më së shumti aty dhe për statusin që *de facto* gjuha shqipe, krahasuar me anglishten, maqedonishten e turqishten. Sipas autorëve Laundry dhe Bourhes (1997) gjuha që ka një status më të lartë, haset më dendur në hapësirën publike. Ndaj, peizazhi linguistik mund të reflektojë marrëdhëniet e pushtetit dhe të statusit që kanë varietete të caktuara gjuhësore.

Gjithsesi, koncepti i vitalitetit etnolinguistik duhet marrë me një fije rezervë, kur vjen puna të interpretimi i përdorimit të anglishtes në peizazhin linguistik të Tetovës. Prania e shenjave gjuhësore angleze nuk na është tregues i vitalitetit etnolinguistik të ndonjë komuniteti anglez. Një i tillë nuk ekziston në Tetovë, por është reflektim i zhvillimeve bashkëkohore në kuadër të globalizimit. Peizazhet linguistike urbane sot kanë një prirje që të njëtrajtësohen kur vjen puna të përdorimi i njërive në anglisht, pavarësisht nëse qyteti i përket Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shqipërisë, Polonisë Italisë apo Japonisë. Gjuha angleze, ndonëse në shumë raste nuk tregon një shumëgjuhësi sociale të vetvetishme dhe

nuk është mjet komunikimi në bashkësi, përdoret për të krijuar një atmosferë kozmopolitanizmi. Duke u përpjekur ta shpjegojë këtë dukuri Haarmann-i (1986) përdor termin “multilingualizëm jopersonal”. Përgjithësisht gjuhët e huaja dhe në veçanti anglishtja, kanë konotacione pozitive dhe shërbejnë për të tërhequr vëmendjen e të adresuarve (Piller 2001).

Rezultate të ngjashme në lidhje me praninë e anglishtes në shenjat e hapësirës publike kanë gjetur në studimet e tyre edhe studiuesit Ben-Rafael, Ben-Rafael (2016) (Huebner 2006), (Backhaus 2006), (Friedrich 2002) të cilët shprehen se këto rezultate vijnë si pasojë e statusit të anglishtes si lingua franca universal ose “një gjuhë hipercenrike e komunikimit ndërkombëtar” (de Swaan 2001, 185).

Thënë thjesht, sot për sot anglishtja është veshja në modë e shenjave të peizazheve linguistike urbane. Si e tillë, mjaft në modë, ajo na shfaqet edhe në peizazhin linguistik të qytetit të Tetovës, duke evokuar frymën moderne të kohës.

Pavarësisht politikës gjuhësore eksplicite në RMV, peizazhi linguistik (sidomos shenjat in vitro që janë krijime private të individëve) ka prirjen që t’iu shmanget rregullave preskriptive të politikave gjuhësore. Edhe në këtë rast, është e qartë se hapësira publike ka rregullat dhe rregullimin e vet, që siç thonë Shohamy dhe Gorter 2009, 3, “prirjen t’i mposhtin politikat e deklaruara”. Të njëjtin qëndrim e gjejmë edhe te Huebner-i (2006, 32). Shenjat zyrtare të peizazhit linguistik (tabelat e qarkullimit rrugor, tabelat e ndërtesave qeveritare etj) edhe në Tetovë rreken të reflektojnë politikat gjuhësore të deklaruara të RMV, ndonëse studiuesit pohojnë se shpesh gjuha shqipe në shenjat zyrtare nuk përdoret drejt “në mbishkrimet nëpër tabela në vendkalimet kufitare dhe në institucione tjera, ku gjuha shqipe ndodhet e cunguar” (Bajrami, Azemi 2021, 75).

Megjithatë, nga ana tjetër politika gjuhësore e padukshme e komunitetit të Tetovës dhe aspiratat identitare e anëtarëve të këtij komuniteti reflektohet në shenjat jozyrtare të bizneseve vendase, të emërtuara nga individët, duke kryer njëherazi edhe funksionin simbolik të ndërtimit të hapësirës publike.

Pavarësisht politikës gjuhësore zyrtare, të sanksionuar edhe me ligj, peizazhi linguistik i qytetit të Tetovës, i ka dhënë statusin e qytetarisë anglishtes, përmban një shumësi të konsiderueshme të shenjave të veta në gjuhën shqipe dhe i jep shumë më pak hapësirë gjuhës maqedonase, pavarësisht statusit të kësaj të

fundit si gjuhë zyrtare. Ky raport mes gjuhëve në peizazhin linguistik tregon se në fakt politika gjuhësore nuk mund të imponohet dhe as të diktojë identitetin etnolinguistik të një komuniteti. Shenjat gjuhësore “*in vivo*” të hapësirës publike të qytetit të Tetovës tregojnë më së miri se ka një divergjencë midis politikës gjuhësore të nëntëshme (implicite) dhe ideologjisë gjuhësore të komunitetit tetovar nga njëra anë dhe politikave gjuhësore eksplicite shtetërore në Maqedoninë e Veriut dhe karakterit preskriptiv të planifikimit gjuhësor nga ana tjetër.

REFERENCAT

- Backhaus, Peter. 2006. “Multilingualism in Tokyo: A look into the linguistic landscape.” *International Journal of Multilingualism*, 3(1), 52-66.
- Bajrami, Demush dhe Emin Azemi. 2021. “Maqedonia e Veriut dhe sfidat e shtrirjes së përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe” në *Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të ligjit të përdorimit të gjuhëve në RMV*. Botim i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve në RMV, Shkup.
- Ben-Rafael, Eliezer, dhe Ben-Rafael, Miriam. 2016. “Berlin’s linguistic landscapes: two faces of globalization.” Në *Negotiating and contesting identities in linguistic landscapes*, red. Blackwood, Robert, Lanza, Elizabeth, and Woldemariam, Hirut, 197-212. Londër: Bloomsbury Publishing.
- Ben-Rafael, Eliezer, Shohamy, Elana, Amara, Muhammad Hasan, and Trumper-Hecht, Nira. 2006. “Linguistic landscape as symbolic construction of the public space: The case of Israel.” *International Journal of Multilingualism*, 3(1), 7-30.
- Blackwood, Robert, Elizabeth Lanza dhe Hirut Woldemariam (red.) 2016. *Negotiating and contesting identities in linguistic landscapes*. Bloomsbury Publishing.
- Blackwood, Robert. 2015. “LL explorations and methodological challenges”. *Linguistic Landscape: An International Journal*. 1(1/2), faqe 38-53.
- Bourhis, Richard Y., dhe Landry, Rodrigue 2002. “*La loi 101 et l’aménagement du paysage linguistique du Québec*.” Në *L’aménagement Linguistique au Québec: 25 D’application de la Charte de la Langue Francaise*, edited

- by Bouchard, Pierre, and Bourhis, Richard Y., 107-132. Québec: Publications du Québec.
- Chilton, Paul, dhe Schäffner, Christina 2002. *Politics as Text and Talk Analytic approaches to political discourse*. Amsterdam/ Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
- Dee Swaan, Abram. 2001. *Words of the World: The Global Language System*. Cambridge: Polity.
- Edelman, Loulou. 2009. "What's in a name? Classification of proper names by language." In *Linguistic landscape: Expanding the scenery*, edited by Shohamy, Elana, and Gorter, Durk, 141-154. New York: Routledge.
- Friedrich, Patricia. 2002. "English in advertising and brand naming: sociolinguistic considerations and the case of Brazil." *English Today*, 18(3): 21–8.
- Haarmann, Harald. 1986. "Verbal strategies in Japanese fashion magazines- a study in impersonal bilingualism and ethnosymbolism". *International Journal of the Sociology of Language*, 58: 107–121.
- Huebner, Thom. 2006. "Bangkok's linguistic landscapes: Environmental print, codemixing and language change." *International Journal of Multilingualism*, 3(1): 31-51.
- Maksuti, Izer. 2021. "Maqedonia e Veriut dhe sfidat e shtrirjes së përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe" në *Shumëgjuhësia dhe sfidat e zbatimit të ligjit të përdorimit të gjuhëve në RMV*, fq. 126-153. Botim i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhëve në RMV, Shkup.
- Nash, Joshua. 2016. Is linguistic landscape necessary?, *Landscape Research*, DOI: 10.1080/01426397.2016.1152356.
- Piller, Ingrid. 2001. "Identity constructions in multilingual advertising." *Language in Society*, 30: 153–186.
- Rrokaj, Shezai. 2020. *Ligji për gjuhët në Maqedoninë e Veriut dhe gjuha shqipe*. Në: Albanologjia (Tetovë), 2020, 7, fq. 47-55.
- Sela, Ylber, Jusuf Zeneli, Jeton Shasivari, Valbona Hajretin, Argëtim Saliu, Llazo Matovski (2021). *Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019*. AZGJ, Shkup 2021.
- Shohamy, Elana dhe Durk Gorter (red.). 2009. *Linguistic Landscape. Expanding*

the scenery. Routledge.

Shohamy, Elana dhe Shoshi Waksman. 2009. Linguistic landscape as an ecological arena: Modalities, meanings, negotiations, education. In E. Shohamy & D. Gorter (Eds.), *Linguistic Landscape: Expanding the Scenery* (pp. 313-331). New York: Routledge.

Shohamy, Elana. 2006. *Language policy: Hidden agendas and new approaches*. Routledge.

Shohamy, Elana. 2015. "LL research as expanding language and language policy". *Linguistic Landscape* 1.1-2, faqe:152-171.

Stefania Tufi dhe Robert Blackwood. 2010. "Trademarks in the linguistic landscape: methodological and theoretical challenges in qualifying brand names in the public space", *International Journal of Multilingualism* 7:3, faqe 197-210, DOI: 10.1080/14790710903568417.

PROF. AS. DR. ABDURRAHIM MAXHUNI

INSTITUTI ALBANOLOGJIK, PRISHTINË

maxhuni44@hotmail.com

POLITIKAT GJUHËSORE DHE TRASHËGIMIA ISLAME NË GJUHËN SHQIPE

Abstrakt

Me kalimin gradual të shqiptarëve në fenë islame, filloi një etapë e re e huazimeve leksikore orientale në gjuhën shqipe, huazime që ndryshuan shumëçka në mendësinë e popullit shqiptar, duke filluar nga organizimi i jetës, i ceremonive mortore, i lindjeve, i festave e i jetës së përditshme në përgjithësi, rrjedhimisht duke ndikuar edhe në gjuhën shqipe. Ndonëse për kohë të gjatë kjo mendësi jetoi në gjuhë të huaja, sidomos atë turke, kjo nuk e ngushtoi rrethin e përdorimit të saj, por u shtri në diskursin e përditshëm. Periudha e Rilindjes Kombëtare ndikoi që trashëgimia islame të shkruhej edhe në gjuhën shqipe. U përkthye Kurani në gjuhën shqipe, u botuan vepra të ndryshme ku zinte vend edhe feja islami, periodiku islam filloi të zinte vend në radhën e karvanit të periodikëve që tashmë botoheshin në gjuhën shqipe dhe në fund filloi të zinte vend edhe në fjalorë dygjuhësh, sikurse edhe në atë normativ të gjuhës shqipe. Periudha e komunizmit frenoi botimet me tematikë islame, ndikoi në ngjyrimin e përfaqësimit të saj, deri në anashkalimi dhe në luftimin e kësaj trashëgimie shekullore. Në këtë kumtesë, do të ndalemi tek gjendja e përgjithshme e trashëgimisë islame në gjuhën shqipe, konkretisht në terminologjinë e saj.

Fjalët kyçe: politikë gjuhësore, trashëgimi islame, fjalorët, komunizëm, terminologji.

Hyrje

Trashëgimia kulturore islame në hapësirat shqiptare ka filluar të zërë vend shumë kohë më parë. Krahas trashëgimisë romake e bizantine, edhe ajo me elementë islamë është bërë pjesë e shqiptarëve tash e pesë shekuj, duke depërtuar në gjuhën që flasin, në mënyrën si ushqehen, në jetë e në mendësinë e tyre. Përveç që preku këto aspekte të jetës, ajo pati ndikim të madh edhe në besimin e shqiptarëve, me ç'rast gradualisht filluan ta pranonin fenë islame. Ndryshimet që ndodhën ndikuan në procesin e zhvillimeve kulturore, me mendësinë e të jetuarit, sikurse edhe në arkitekturë e në urbanizëm, por edhe në gjuhë e letërsi, në banim,

ushqim e veshmbathje. Ndonëse tradita fisnore ishte e fortë dhe ligji i njohur i kanunit të shqiptarët vazhdonte të kishte rol të pakontestueshëm, mendësia e të jetuarit filloi të përthithte elementët islamë qysh herët. Zhvillimet kulturore që ndodhën me ardhjen e Perandorisë Osmane mbështeteshin në një koncept të ri, të panjohur më parë, që buronte nga feja islame dhe nga kultura lindore me elementë islamë. Përveç shtrirjes graduale të administratës osmane, në fillimet e saj, kryesisht në qytetet, pastaj edhe në pjesët rurale, ndërtimi i xhamive e hapja e shkollave fetare patën ndikim të madh e të shpejtë në depërtimin e terminologjisë islame në gjuhën shqipe, së bashku edhe me leksikun e përgjithshëm oriental. Ndërtimi i xhamive e teqeve ishte hapi i parë ku ndërveprohej në bashkësi. Zgjerimi i komunitetit mysliman kërkonte që të përfaqësohej me njerëz që i njihnin rregullat e fesë dhe kishin njohuri rreth mësimëve islame, kështu lindi nevoja për shkolla fetare, ku do të përgatiteshin prijës fetarë. Letërsia e shekullit XVII ishte zhanri i parë ku filloi të pasqyrohej terminologjia fetare islame. E themi islame sepse deri në shekulli XVII letërsia e vjetër shqiptare karakterizohej si letërsia homogjene me tipologji fetare krishtere. Faza e letërsisë që do të pasonte ishte heterogjene, shtrirja e saj ishte më e madhe dhe tematikat e saj më të larmishme. Kjo letërsi do të njihej si letërsia e bejtexhinjve, autorët e së cilës u formuan në shkollat e lindjes e në gjuhë të huaj, e cila shkroi në gjuhën shqipe me alfabet arab. Ndonëse autorët e saj u shkolluan në shkolla fetare islame, e në gjuhë të lindjes, kjo letërsi përveç që kishte karakter islam, ajo ishte mjaft e përparuar me vlera artistike, duke krijuar tipologji të reja të veprave artistike, duke krijuar një figuracion të ri poetik dhe një shkollë të re të metrikës, të cilat vijjnë si rezultat i shkrirjes së asaj orientale me atë të letërsisë sonë gojore.¹

Nën ndikimin e gjuhëve dhe traditës lindore para shekullit XVIII, në kushte të përhapjes së fesë dhe kulturës islame në mbi dy të tretat e popullit shqiptar dhe në kushte të zhvillimit më të përparuar ekonomik e shoqëror të vendit, lindi rryma letrare e bejtexhinjve.² Kjo rrymë me alfabet arab, solli një dukuri të re letrare, e cila njihet me termin *alamiado*. Ky term është trajtë e shtrembëruar spanjolle e mbiemrit arab të gjinisë femërore *al<axhamijja*, që do të thotë joarabe, e huaj,

¹ Mahmud Hysa, *Alamiada shqiptare I*, Shkup, 2000, f. 54.

² Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike*, Prishtinë, 2011, f. 269.

persiane.³ Ndonëse, kjo letërsi sipas studiuesve nuk është gjurmuar sa duhet, nuk është studiuar sa duhet dhe se ka pasur rezerva në prezantimin e saj, për shkaqe të ndryshme, ndër të cilat për shkak të motiveve fetare islame, mbetet fillimi i një letërsie të mirëfilltë shqiptare. Realizimi i kësaj fryme të re është shprehur përmes divanit, kasideve, gazeleve, mevludëve, ilahive etj., gjë që nënkupton se kjo letërsi nuk ka qenë kryekëput fetare. Për fillet e letërsisë shqipe me alfabet arab në gjuhën shqipe (në këtë rast edhe të terminologjisë së dokumentuar Islame) ka mendime të ndryshme. Studiuesi që është marrë me këtë problematikë, Nehat Krasniqi⁴ nismëtar të letërsisë shqipe me alfabet arab e sheh Muço (Mustafa) Gega, me poezinë *Fetfanë ma dha myftiu*, gjysma e dytë e shekullit XVII, ndërsa në Kosovë nismëtar ka qenë Sheh Sylejmani Baba Rahoveci, me ilahin *Ah, un i mjeri kesh tu fjet*, e shkruar brenda viteve 1732-1771.

Një nga faktorët më të rëndësishëm dhe më përcaktues të zhvillimit të kulturës shqiptare me ndikime orientale-islame, gjatë tërë periudhës së sundimit osman në trojet shqiptare, gjithsesi ka qenë arsimit dhe edukimi.⁵ Arsimit dhe edukimi i gjeneratave të reja fillimisht është zhvilluar në xhami. Xhamitë e para në trojet shqiptare janë ngritur në Manastir nga fundi i shekullit XIV dhe fillimi i shekullit XV.⁶ Me ndërtimin e objekteve përcjellëseve në oborret e xhamive ka filluar një fazë tjetër e mësimit të organizuar. Cikli i ulët realizohej në mejtepe, të cilat ishin ngjitur me xhamitë. Mejtepi më i vjetër i ndërtuar në trojet shqiptare është ai i Sinanudin Jusuf Çelebiut, i ndërtuar në Ohër, para vitit 1491, pastaj ai i Ishak Çelebiut, i ndërtuar në Manastir më 1508, mejtepi i Suzi Çelebiut, i ngritur në Prizren para vitit 1513, mejtepi i Kuklibegut, i ndërtuar në Bresanë, para vitit 1538 etj.⁷

³ Po aty, f. 349.

⁴ Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike*, Prishtinë, 2011, f. 363.

⁵ Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë, 2017, f. 227.

⁶ Po aty, f. 227.

⁷ Për më tepër shih: Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë, 2017; Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë 1830-1912*, Prishtinë, 2019.

Shkollimi në mejtepe ishte shkalla e parë e arsimimit, ndërsa shkalla e dytë ishte në medrese. Edhe kjo shkollë kishte si model traditën osmane, që fillet i ka më 1331. Medresetë e para në trojet shqiptare janë ngritur në fillim të shekullit XV. Ndër medresetë e para është ajo e Ishak beut në Shkup, e hapur para vitit 1411, medreseja e Sinanudin Jusuf Çelebiut në Manastir, 1424. Në Kosovë, medreseja e parë është ajo e Gazi Ali beut, e ndërtuar në Vushtrri brenda viteve 1444-1445. Për të vazhduar pastaj me medresenë e Vjetër të Pejës, para vitit 1516, medresenë e Mehmet Pashës në Prizren, në vitin 1537, medresenë e Besharet begut, në Prishtinë, para vitit 1566.⁸

Një formë tjetër e pasqyrimin të terminologjisë islame ishte mevludi, që nisi me Hasan Zyko Kamberin për të vazhduar me Ismail Floqin, Hafiz Ali Ulqinaku etj. Përveç mevludëve, po me tematikë islame ishte edhe poema “Hadika” e Dalip Frashërit (1842), poema “Muhtarname” e Shahin Frashërit (1868), si dhe “Qerbelaja” e Naim Frashërit. Komunitetit Mysliman Shqiptar, më 1923 filloi të botonte revistën “Zani i Naltë”, revista e parë me përmbajtje islame në hapësirat shqiptare. Me zhvillimin kulturor të shqiptarëve, sidomos të një pjese të elitës u shtrua nevoja për një përkthim të Kuranit në gjuhën shqipe, të cilën i pari e përktheu Ilo Qafëzezi në dy pjesë: pjesën e parë e botoi më 1921, ndërsa pjesën e dytë më 1927. Hafiz Ali Korça më 1926 botoi 37 ajete dhe dy sure, për të vazhduar edhe me disa komentime të Hafiz Ibrahim Daliut. Deri më sot rrugës për përkthimin e Kuranit i kanë hyrë edhe të tjerë, por më të njohurit janë: Feti Mehdiu, Hasan Nahi e Sherif Ahmeti, që njihen ndër përkthimet më cilësore të Kuranit. Terminologjia islame filloi të zinte vend edhe në fjalorë dygjuhësh, por e përfaqësuar me elemente tepër të pakta. Ajo zuri vend edhe te Fjalori latinisht-shqip i Bardhit, te Fjalori i Kristoforidhit, te ai i Bashkimit dhe te shumë fjalorë të tjerë që u botuan më pas. Vend më të madh zuri në fjalorët shpjegues të shqipes (1954, 1980, 2006), e sidomos në Fjalorin e Orientalizmave në gjuhën shqipe të Dizdarit.

Pasqyrimi i leksikut fetar islam ka vazhduar të gjejë vend edhe më tutje në leksikografinë shqiptare. Te fjalori i Kristoforidhit, “*Fjalori i gjuhës shqipe*” (1904), gjejmë pak fjalë të sferës fetare islame, si: *agjërim, agjinoj*, por ka *Zot, perëndi, kishë, pendesë* etj. Pastaj në fjalorin “*Fjalori i Bashkimit*” (1908),

⁸ Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë, 2017, f. 232.

terminologjia fetare islame është pasqyruar pak më tepër se të Kristoforidhi: *haxhi, hoxhë, Kuran, mysliman, syfyr, xhami, tyrbe* etj. Pasqyrimi i leksikut islam në fjalorë dygjuhësh ka vazhduar edhe më tutje, si te autorët Jak Jungu, Antonio Buseti, Lukë Lukaj etj., te “*Fjalor shqip-serbokroatish*” (1981), te fjalorët e autorëve Emanuel Xhordano, Mikel Ndreca, Ferdinand Leka e Zef Simoni etj.⁹ Leksiku terminologjik islam është pasqyruar edhe në disa fjalorë të tjerë, si “*Fjalor i teologjisë*” (2006), “*Fjalor i terminologjisë fetare*” (2007), “*Fjalor i orientalizmave*” (2009), “*Glosar i nocioneve fetare*”, (2010). Njëri ndër fjalorët që në gjuhësinë shqiptare është cilësuar si më shkencori dhe që ka përfshirë orientalizmat në gjuhën shqipe është ai i Dizdarit “*Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*”, i nisur qysh moti, por i botuar pas vdekjes së autorit.

Leksiku terminologjik islam ka zënë vend edhe në fjalorët e gjuhës shqipe (1954, 1980, 2006). Termat e paraqitur në të tre fjalorët normativë të shqipes janë emërtime të objekteve, nocioneve, shërbimeve fetare, proceseve etj. Në shpjegimin e termave të dhënë shohim se Fjalori i 1980-ës është i ngarkuar me ideologji të kohës. Në fjalorin e fundit, atë të 2006-ës është bërë një përpjekje e mirë për ta liruar fjalësin e tij nga ideologji të ndryshme. Edhe terminologjia islame është rishikuar dhe rivlerësuar, duke i hequr pjesët në të cilat ka pasur ideologji të theksuar. Në parathënie të Fjalorit¹⁰ thuhet se “*përfshirja ose jo e një fjale në korpus është e motivuar shkencërisht sipas vlerave të saj reale, sipas praktikës gjuhësore të sotme dhe sipas parimeve e kriterëve të këtij fjalori, larg çdo paragjykimi krahinor a ideologjik.*” Megjithatë, ka akoma pjesë ku nuk është larguar plotësisht pjesa ideologjike. Fjala vjen për objektin ku myslimanët i kryejnë shërbimet fetare, thuhet: *xhamia “Kur s’ke bukë në shtëpi, pse çon vaj në xhami” si dhe “Gjeti xhami (kishë) ku të falet, kërkon mbrojtje a ndihmë atje ku nuk duhet ose ku nuk jepet.*”¹¹

Problem tjetër që është përcjellë edhe në Fjalorin e 2006-ës është edhe kufizimi kohor i fjalës nëpërmjet shkurtesës vjet. (fjalë a shprehje e vjetruar), duke i paraqitura ato si të vjetruara, vlerësim sipas kontekstit politik-ideologjik

⁹ Jani Thomai, *Terminologjia islame dhe leksikografia shqiptare*, në: simpoziumin “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët,” Prishtinë, 1995, f. 310.

¹⁰ Fjalor i gjuhës shqipe, 2006, f. 9.

¹¹ Po aty, f. 1207.

të kohës së komunizmit. Këtë problem e ka vërejtur edhe Thomai¹² në Fjalorin e 1980-ës, duke theksuar se ndikimi ideologjik në trajtimin e disa fjalëve të këtij Fjalori është shprehur me theksimin e karakteristikës së tyre fetare, por edhe me formula e perifrazime që në një farë shkalle i paraqitin ato si të vjetruara, madje edhe si jashtë normës letrare. p.sh.:

xhehenem-i, *fet. vjet. ferr* (sipas fesë myslimane).

xhenet-i, m. *fet. vjet. parajsë* (sipas fesë myslimane).

Këto fjalë, por edhe të tjera të leksikut fetar islam gjallojnë edhe sot e kësaj dite. Ato janë futur edhe në frazeologji, duke u përdorur gjerësisht sidomos me rastin e kryeshnoshit që bëhet kur vdes dikush, si: *ishalla për xhenet, u takofshi në xhenet, Zoti në xhenet* etj. Po ashtu edhe fjala xhehenem përdoret gjerësisht, me konotacione shpesh negative, si: *te kallt zjarri i xhehenemit, shpirtit n'xhehenem t'shkoft* etj., andaj nuk i bëjnë pjesë te leksiku i vjetruar.

Më poshtë kemi përzgjedhur disa nocione islame që janë përfshirë me zëra të veçantë në fjalorët normativë të shqipes për të parë se si janë përkufizuar, duke i krahasuar edhe me fjalorë të tjerë:

abdes - rit i larjes së duarve, të këmbëve e të fytyrës nga myslimanët para lutjeve¹³. Në gjuhën shqipe dhe në fjalorë të ndryshëm ekzistojnë tri variante *abdest, avdes, abdes*. *Abdes* e ka fjalori i 54-së dhe i 2006-së, ndërsa *avdes* e ka fjalori i 80-së. Varianti *abdest*, të cilin njohësit e fesë Islame e preferojnë më tepër, për shkak të afritë me variantin burimor e ka Fjalori i teologjisë¹⁴ dhe ai i terminologjisë fetare¹⁵. Nga ajo që fjalorët e tjerë e kanë shpjeguar këtë term, do të duhej të bëhej një rishpjegim i tij në Fjalorin e gjuhës shqipe: larje e detyrueshme e fytyrës, e duarve deri në bërryla, përshtuarja e pjesë së sipërme të kokës dhe larja e këmbëve deri në nyje, me qëllim të kryerjes së riteve fetare myslimane, si namazi, leximi i Kuranit etj. Ky, madje është edhe qëllimi i marrjes së abdesit. Shpjegim të përafërt e jep edhe Dizdari¹⁶.

¹² Jani Thomai, *Terminologjia islame dhe leksikografia shqiptare*, në: simpoziumin "Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët," Prishtinë, 1995, f. 313.

¹³ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 25.

¹⁴ Halit Muharremi, *Fjalor i Teologjisë*, Tiranë, 2006, f. 7.

¹⁵ Ekrem Murtezai, *Fjalori i terminologjisë fetare*, Prishtinë, 2007, f. 11.

¹⁶ Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 1.

agjërimit – veprim dhe gjendje sipas foljes *ditë agjërimiti*. *Agjëroj* – nuk ha e nuk pi në ditë të caktuara¹⁷. Shpjegimi i këtij termi, siç mund të shihet është i mangët. Është interesante se përveç fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe, këtë term nuk e ka asnjë fjalor tjetër. I vetmi fjalor që e ka, nga ata që i kemi marrë në shqyrtim e ka i Kristoforidhit dhe Glosari: shtylla e tretë e islamit. Muaji ramazan agjërohet nga të rriturit, të shëndoshët fizikisht dhe mendërisht, të aftit¹⁸. Shpjegimi i këtij termi duhet të plotësohet në fjalorin shpjegues të shqipes, sikurse te Glosari.

fakir – asket mysliman (kryesisht në disa vende të Lindjes) dervish.¹⁹ Te Glosari²⁰: i varfër; lypësë; pasues i misticizmit, i cili ka pranuar të jetojë në varfëri, apo i ka braktisur të mirat e kësaj bote. Te Dizdari²¹: i gJORë, vobeg, i vorfën, dorëhollë, njeri i shkretë, krye-ulët. Ndërsa te Murtezai:²² në fenë islame, njeriu, që e preferon dhe e praktikon varfërinë materiale, thjeshtësinë e jetës, për hir të dashurisë së tij spirituale ndaj All-llahut. Pavarësisht nga kuptimi burimor i kësaj fjale, në islam kuptimit të saj më tepër i përgjigjet shpjegimi i fundit. Të shpjegosh me një term tjetër këtë term, siç është në fjalorin shpjegues nuk është e arsyeshme. Meqenëse është përfshirë në fjalor duhet të zgjerohet dhe të saktësohet kuptimi i këtij termi.

hafëz - titulli më i ulët i një kleriku mysliman.²³ Fjalori i 1980-ës e ka *hafiz*, por në popull përdoret edhe trajta *hafuz*. Te Dizdari: hafiz, ruajtës i përmbajtjes së Kuranit. ai që zen dhe din përmendësh tekstin e librit që u tha. Titull fillestar në hjerarikinë klerikale muslimane.²⁴ Glasari e ka *hafidh*: Mbajtës, ruajtës, rojtarë ‘*hafiz*’, ai që e ka mësuar dhe ruan Kur’anin përmendësh në memorien e tij. Ndërsa ‘*hifdh*’ quhet vetë procesi të mësuarit përmendësh. Ndërsa te Murtezai me variantin *hafiz*: “mbajtës”, “ruajtës”. në fenë islame njëri ndër titujt e nderit, i cili arrihet në bazë të të mësuarit përmendsh të tërë Kuranit si libër i shenjtë i

¹⁷ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 30.

¹⁸ Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare*, Prishtinë, 2010, f. 24.

¹⁹ FGjSh, f.257.

²⁰ Vep.cit., f.51.

²¹ Vep.cit., f. 264.

²² Vep. cit., f. 123.

²³ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 370.

²⁴ Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 324.

muslimanëve.²⁵ Siç mund të shihet kuptimi i këtij termi është ai që e ruan në mendje librin e shenjtë të muslimanëve, e mëson përmendësh. Andaj, nuk është titulli më i ulët i një kleriku, sepse Kuranin e mësojnë edhe besimtarët që nuk janë pjesë e klerit. Kështu që ky term duhet të rishikohet dhe të plotësohet.

haxhi – titull për besimtarët (zakonisht muslimanë) që shtegtojnë në vendet e shenjta; pelegrin.²⁶ Te Dizdari: për muslimanë, titull që i jepet atij që shkon në Mekë dhe në Medine për të kryem pelegrinazhet e Qabesë dhe për të vizitue mazoleumin e Profetit, të detyrueme këta fetarisht, në kje se e lejon gjendja ekonomike dhe trupore besimtarin.²⁷ Te Glosari: Vizitë vjetore Mekës, duke i kryer ceremonitë fetare, e cila është obligim për çdo musliman dhe muslimane, nëse janë të aftë dhe kanë mundësi materiale, së paku një herë në jetë.²⁸ Shpjegim të ngjashëm e jep edhe fjalori i terminologjisë fetare: një ndër pesë shtyllat kryesore të fesë islame dhe njëri ndër pesë obligimet parësore të çdo muslimani të vërtetë, i cili ka moshë madhore dhe mjete të mjaftueshme materiale.²⁹ Ndërsa termi tjetër i pasqyruar në FGjSh *haxhillëk*³⁰, term të cilin nuk e ka Glosari, Dizdari dhe fjalorët e tjerë, i ndërtuar mbi bazën e emërimit *haxhi* dhe prapashtesës turke *-llëk*, emërton veprimin e kryer nga haxhiu. Andaj këta dy terma duhet të rishikohen, të plotësohet i pari dhe ndoshta të hiqet i dyti.

haram – diçka e padrejtë a e palejueshme ose e pamerituar.³¹ Shpjegim i mangët. Te Dizdari³²: ndalesë kategorike nga ana e fesë, e kundërligjshme. Te Glosari³³: Vepër e ndaluar, jo e lirë, e gabueshme; ajo që është ndaluar me Kur'an, sunnet, ose sipas principeve islame. Edhe shpjegimi i këtij termi duhet të saktësohet, duke futur elementin islam në të.

²⁵ Ekrem Murtezai, *Fjalori i terminologjisë fetare*, Prishtinë, 2007, f. 140.

²⁶ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 377.

²⁷ Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 375.

²⁸ Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare*, Prishtinë, 2010, f. 59.

²⁹ Ekrem Murtezai, *Fjalori i terminologjisë fetare*, Prishtinë, 2007, f. 145.

³⁰ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 377.

³¹ Po aty, 374.

³² Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 354.

³³ Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare*, Prishtinë, 2010, f. 57.

hallall – diçka e merituar ose e drejtë.³⁴ Te Dizdari³⁵: gja e drejtë dhe e lejueshme në çdo marrëdhënie (nga ana e fesë), legjitim. Te Glosari³⁶: Vepra e lejuar, e pagabueshme. Ajo që është e lejuar në Kur'an, sunnet dhe me fe. Term i cili duhet të plotësohet. Në gjuhën shqipe ka hyrë me kuptim fetar, mbi bazën e të cilit, pastaj janë krijuar edhe kuptime të tjera frazeologjike.

iftar – darka pas agjërimit të ditës në kohën e ramazanit; koha kur hahet kjo darkë.³⁷ Dizdari³⁸ e jep: kohë e caktueme për çeljen, prishjen e agjërimit që bjen në perëndim të diellit, në muzg. Te Glosari³⁹: Shujtë me cilën ndërpritet agjërimi ditor, pikërisht në kohën e namazit të akshamit. Fjalori i Murtezait nuk e ka, ndonëse e ka termin tjetër *imsak*, koha kur fillon agjërimi i ditës. Shpjegimi i Dizdarit mendoj se është më i saktë dhe më i kuptueshëm, sepse iftari nuk lidhet me darkë, por me perëndim të diellit, i cili ndryshon në kohë dhe hapësirë gjeografike.

islam - feja e myslimanëve, myslimanizmi, 2. Bota, kultura dhe qytetërimi mysliman.⁴⁰ Te Dizdari: të besuemit në njësinë (unitetin) e Zotit dhe të tjerave kushte të besimit musliman.⁴¹ Te Glosari: Nënshtrim, dorëzim i vetëdijshëm, i ndërjegjshëm, i qëllimshëm ndaj vullnetit të Zotit, Një dhe i Vetëm. Koncept i përgjithshëm, që përfshin të gjitha aspektet e jetës së njeriut të shpallura në librat e Zotit në Zebur, Tevrat, Inxhil dhe në veçanti në Kur'an...⁴² Ky term, ndër më të rëndësishmit për myslimanët duhet të rishpjegohet. Shpjegimi i Glosarit është më së afërmi kuptimit të tij.

kuran - libri kryesor i fesë myslimane.⁴³ Te Dizdari: libër i shenjtë i Muslimanëve, që besohet si i zdrypun ajete ajete me frymëzim e relevantë

³⁴ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 371.

³⁵ Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 340.

³⁶ Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare*, Prishtinë, 2010, f. 56.

³⁷ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 399.

³⁸ Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 410.

³⁹ Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare*, Prishtinë, 2010, f. 63.

⁴⁰ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 412.

⁴¹ Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 425.

⁴² Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare*, Prishtinë, 2010, f. 65.

⁴³ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 511.

hyjnore Profetit Muhamed.⁴⁴ Te Glosari: Shpallja e fundit nga ana e Allahut të madhërisëm në formë libri, e cila i është dhuruar njerëzimit nëpërmes pejgamberit të fundit Muhamedit a.s., në gjuhën arabe, në një periudhë kohore prej 23 vjetësh, aq sa zgjati edhe misioni i Pejgamberit a.s.⁴⁵ Si i tillë ky term duhet të rishpjegohet, sepse nuk është thjesht libër, e as kryesor i fesë myslimane, sikurse që nuk ka fe myslimane, por fe islame.

xhenaze - trupi i të vdekurit në arkivol.⁴⁶ Te Dizdari: trupi, kufoma, kurmi i të vdekurit, i lamë, i qefinosun, i spërkatur me gjysly e erëna të mire dhe ashtu i shtimë në tabut.⁴⁷ Ndërsa te Glosari: Ceremonia për varrimin e myslimanit apo myslimanës.⁴⁸ Pra, në bazë të kuptimit fetar islam, *xhenaze* nuk është thjesht trupi i të vdekurit, por është ceremonia që zhvillohet me rastin e vdekjes së tij, ku përfshihet edhe trupi i të vdekurit në arkivol.

Përfundime

Trashëgimia islame në gjuhën shqipe është mëshiruar dhe ka zënë vend të madh në mendësinë e popullit shqiptar. Si e tillë ndryshuar shumëçka në jetën e popullit shqiptar, si në mënyrën e të jetuarit ashtu edhe në besimin e tyre. Andaj, kultura islame është tepër e rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Ndonëse ka filluar të hyjë shumë herët në gjuhën shqipe, kultura e pazhvilluar dhe mungesa e alfabetit ka ndikuar në vonimin e paraqitjes së saj në formë të shkruar. Kushtet më të favorshme u paraqitën në fund të shekullit XVII, e përfaqësuar me format e reja poetike të ndikuara nga lindja, ku për herë të parë zuri të shkruhej nga autorët bejtexhinj me alfabet arab, me ç'rast terminologjia islame filloi të jetonte kryesisht në dorëshkrimet e këtyre autorëve. Ngritja e vetëdijes kombëtare, dhe si rezultat i kësaj edhe ngritja e vetëdijes gjuhësore gjatë kohës së Rilindjes Kombëtare krijuan kushte edhe më të favorshme për shkrimin e saj me alfabetin që u përzgjodh në Kongresin e Manastirit. Ndonëse pati përpjekje të suksesshme për zhvillimin e saj në gjuhën shqipe, ku u përkthye

⁴⁴ Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 568.

⁴⁵ Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare*, Prishtinë, 2010, f. 72.

⁴⁶ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 1208.

⁴⁷ Tahir Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005, f. 1108.

⁴⁸ Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare*, Prishtinë, 2010, f. 113.

Kurani, u botuan vepra të ndryshme me tematikë islame, ardhja e komunistëve në pushtet, e ndali vrullin e përparimit dhe të zhvillimit të saj. Terminologjia islame u përfaqësua edhe në leksikografinë shqipe, ndonëse me nocione jo të mjaftueshme. Ajo zuri vend edhe në fjalorët dygjuhësh e normativë të shqipes, ku përkufizimi i saj shpeshherë nuk jepet i plotë gjatë shpjegimit të termave, gjë që kërkon një rivlerësim, si nga ana përmbajtjesore, ashtu edhe nga ana semantike.

Literatura

Ekrem Murtezai, *Fjalori i terminologjisë fetare*, Prishtinë, 2007.

Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 2006.

Halit Muharremi, *Fjalor i Teologjisë*, Tiranë, 2006.

Jani Thomai, *Terminologjia islame dhe leksikografia shqiptare*, në: simpoziumin “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët,” Prishtinë, 1995, f. 310-315.

Mahmud Hysa, *Alamiada shqiptare I*, Shkup, 2000.

Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare*, Prishtinë, 2017.

Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike*, Prishtinë, 2011.

Qemajl Morina, *Glosar i nocioneve fetare*, Prishtinë, 2010.

Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë 1830-1912*, Prishtinë, 2019.

Tahir N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmave në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2005.

DR. BESNIK RAMA

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË, TIRANË

ramabesnik1@gmail.com

DR. ALBANA TAHIRI

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE, ALBANIAN UNIVERSITY

albanatahiri@gmail.com

GJUHA, GLOBALIZIMI DHE DIVERSITETIKULTUROR

Abstrakt

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, ndryshimet demografike në vendin tonë kanë rritur ndjeshëm shumëllojshmërinë kulturore të popullatës së nxënësve në institucionet e arsimit parauniversitar.

Shpesh kanë dalë në skenë jo pak çështje të diskutueshme rreth edukimit shumëkulturore dhe për integrimin e fëmijëve dhe të rinjve të pakicave, larg veçimit të fëmijëve romë, egjiptianë, me aftësi të kufizuara, nga shtresa të margjinalizuara etj., dhe nëse strategjitë e parashikuara janë plotësisht të drejta për të gjithë nxënësit.

Në bazë të tezës sonë qëndron rëndësia që kanë roli dhe puna e institucioneve arsimore për pranimin, regjistrimin, respektimin dhe integrimin e çdo fëmije, pavarësisht nga prejardhja e tij.

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, e bazuar në kompetenca (2014; 2015), kërkon që nxënësit të kuptojnë se si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë së bashku kulturat dhe përshtaten ndaj kulturës ndryshe. Sipas kësaj Kornize, shkolla do ta ketë kryer misionin e saj në këtë drejtim, nëse nxënësit arrijnë të respektojnë të tjerët, përgatiten për të kapërcyer paragjykimet, arrijnë kompromise për të pranuar e ndërthurur kulturat dhe tregohen tolerantë ndaj përkatësisë kulturore gjatë punës në grup dhe në komunitet.

Punimi synon t'u japë përgjigje pyetjeve, të tilla si: Sa dhe si reflektohet shumëllojshmëria kulturore në kurrikulat tona? Sa të përgatitur janë mësuesit, veçanërisht ata me formim fillestar, për të menaxhuar praktika mësimore kundër diskriminimit, pa injoruar dhe pa anashkuar pengesat kulturore? Sfida kryesore është kapërcimi i pengesave dhe gjetja e mundësive arsimore për të arritur suksesin.

Fjalët kyçe: *gjuha; globalizimi; diversiteti gjuhësor; pakica kombëtare; Korniza Kurrikulare*

I. SHUMËLLOJSHMËRIA KULTURORE NË DOKUMENTET KURRIKULARE

Në studime, raporte, hulumtime etj., në vend të fjalës “shumëllojshmëri” gjejmë të përdoret fjala “diversitet”. Nëse do të kërkojmë kuptimet leksikore të kësaj fjale, që vjen nga anglishtja “diversity”, vërejmë se ajo ka përdorime me kuptimet “shumëllojshmëri”, “larmi”, “pangjashmëri”, “ndryshim i plotë”. Në fakt, në kontekstin e marrëdhënieve njerëzore, termi “diversitet” i referohet mozaikut të njerëzve që sjellin shumëllojshmëri formimesh kulturore, stileshe, perspektivash, vlerash dhe besimesh si pasuri (asete) për grupet dhe bashkësitë ku ndërveprojnë.

Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë (KK), e bazuar në kompetenca (2014; 2015), kërkon që nxënësit të kuptojnë se si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë së bashku kulturat dhe përshtaten ndaj kulturës ndryshe. Theksi vihet në vlerësimin e rolit të kulturës në formimin e jetës dhe të shoqërisë ku jetojnë vetë nxënësit, si dhe të jetës dhe shoqërive të tjerëve, dhe në marrjen e vendimeve mbi bazën e njohurive për kulturën në faza të ndryshme të shkollimit të tyre, në emër të respektimit të shumëllojshmërisë kulturore dhe të bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve dhe kulturave. Sipas Kornizës sonë Kurrikulare, shkolla do ta ketë kryer misionin e saj në këtë drejtim, nëse nxënësit arrijnë të respektojnë të tjerët dhe përgatiten për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise, për t’u treguar tolerantëduke respektuarpërkatësinë kulturore gjatë punës në grup etj.

Sipas KK-së¹, nxënësit në arsimin parauniversitar:

- kultivojnë identitetin vetjak e kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- ndërtojnë marrëdhënie me të tjerët, me shoqërinë dhe me kulturat e tjera;
- njohin, respektojnë dhe çmojnë kulturën e tyre si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve;

¹MAS, *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2014, f. 11, 12, 15, 19, 21, 38.

- zhvillojnë vetëdijen/ndërgjegjësimin mbi globalizimin dhe larminë kulturore duke u përfshirë në ndërveprim me nxënës nga kulturat e tjera;
- zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të luajtur rolin e tyre si anëtarë të një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.

Në shumë nga programet mësimore, sidomos në ato të lëndëve që përfshihen në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”, synohet që nxënësi të arrijë të shpjegojë se individët dhe grupet ku ata bëjnë pjesë, duhet të pranojnë dhe ta respektojnë diversitetin, p.sh., atë gjuhësor,²për të ruajtur marrëdhënie miqësore, me qëllim që të sigurohet paqja dhe jetesa paqësore. Gjithashtu, gjithnjë sipas kërkesave të dokumenteve kurrikulare, kërkohet që nxënësit e arsimit parauniversitar të shpjegojë se si grupet dhe organizatat duhet të nxitin unitetin dhe ta trajtojnë diversitetin, duke mbajtur marrëdhënie miqësore, me qëllim sigurimin e rendit dhe qetësisë.

Arsimi shumëkulturore i referohet çdo forme të edukimit apo të mësimin që përfshin historitë, tekstet, vlerat, besimet dhe perspektivat e njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore. Në përgjithësi, të edukosh shumëllojshmërinë kulturore, do të thotë të zbatosh parimin e barazisë në arsim për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga kultura, dhe të përpiqesh të kapërcesh pengesat për të siguruar mundësi arsimore dhe sukses për nxënësit me prejardhje të ndryshme kulturore.

Në qendër të shumë debateve rreth edukimit shumëkulturore mbetet çështja nëse metoda të tilla mund të shërbejnë vërtet për të integruar nxënësit e pakicave, larg veçimit të fëmijëve romë, egjiptianë, me aftësi të kufizuara, nga shtresa të marginalizuara etj., dhe nëse strategjitë e parashikuara janë plotësisht të drejta për të gjithë nxënësit.

Që nxënësit me përkatësi kulturore të ndryshme të nxënë në mënyrë efektive, kërkohen qasje edukative që vlerësojnë dhe njohin prejardhjen kulturore të të gjithë nxënësve. Në këtë mënyrë, krijimi i qëndrimit pozitiv ndaj shumëllojshmërisë kulturore në shkollë përmirëson dukshëm të nxënësit dhe

²Izha, *Programi i lëndës “Gjuhë shqipe”*, shkalla e parë dhe e dytë, Tiranë, 2015, f. 17 dhe 57.

nxitsuksesin e të gjithë nxënësve, veçanërisht të nxënësve nga grupet kulturore që janë historikisht pakicë, ose që vuajnë nga tregues më të ulët të nivelit arsimor.

Në procesin e të nxënit, edukimi shumëkulturor kërkon përdorimin e teksteve, materialeve, referencave dhe shembujve historikë që janë të kuptueshëm për nxënësit me prejardhje të ndryshme kulturore apo që pasqyrojnë përvoja të veçanta kulturore.

Nëse do të pranojmë që ne në shkollëtonë kemi tekste tradicionale, materiale mësimore dhe shembuj kulturorë që zakonisht pasqyrojnë vetëm kulturën shqiptare në përgjithësi, nëse ne do të pranojmë që në kurrikul dhe në tekstet shkollore mungon reklamimi i përkatësive kulturore të pakicave, nxënësit romë dhe egjiptianë, p.sh., mund ta ndiejnë veten në situata të pafavorshme arsimore, edhe për shkak të mungesës dhe të pengesave kulturore apo gjuhësore që anashkalohe apo dhe injorohen. Nëse edukimi i shumëllojshmërisë kulturore bëhet që në fëmijërinë e hershme, kapërcehet shumë më lehtë çdo situatë apo pengesë mes individëve në moshat më të rritura. Në bazë të kësaj teze qëndron rëndësia që ka puna e institucioneve parashkollore për pranimin, regjistrimin dhe respektimin e çdo fëmije, pavarësisht nga prejardhja e tij. Të qenët në grup dhe veprimi me moshatarë janë premisa për shoqërim, për afim, për pranim e mbështetje.

II. DREJTIME NË METODOLOGJINË E PUNËS PËR EDUKIMIN SHUMËKULTUROR NË SHKOLLË

Edukimi i shumëllojshmërisë kulturore nuk i përket vetëm shkollës, nuk fillon e nuk mbaron në shkollë, por misionin kryesor në këtë drejtim e ka shkolla, nëpërmjet së cilës garantohet e drejta për arsimimin e të gjithë shtetasve: “...Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar...”.³Në vijim, po paraqesim disa aspekte

³Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (neni 5, pika 1, “E drejta për arsimim”)

dhe drejtime pune ku duhet të mbështeten mësuesit për edukimin shumëkulturore në shkollë:

Pasurimi i përmbajtjeve mësimore

Kurrikula, tekstetshkollore dhe materialet mësimore mund dhe duhet të përfshijnë përvoja arritjesh dhe referenca të shumta kulturore. Për shembull, në orët e lëndës “Qytetari” mund të trajtohen këndvështrime të ndryshme kulturore, të tilla si ato të pakicave greke, maqedonasee malazeze, por dhe bullgare, rome, egjiptiane, vllahe, arumune etj. Nëse në KK (Korniza Kurrikulare) orientimet janë të qarta, nuk ndodh kështu në tekstet shkollore. Në këto të fundit, shumëllojshmëria kulturore trajtohet kryesisht në forma teorike, bëhet kujdes të mos ketë diskriminim etj., por mungojnë kërkesat për përfshirjen e nxënësve në veprimtari mësimore, hulumtuese etj. që krijojnë vërtet mjedis gjithëpërfshirës për të gjithë nxënësit dhe situata për një qëndrim pozitiv ndaj kulturave të ndryshme.

Krahas kësaj, standardet e të nxënësve përshkruajnë atë që nxënësit pritet të mësojnë dhe të jenë në gjendje të bëjnë në mosha të caktuara dhe në të gjitha nivelet e shkollimit. Në këto standarde po reflektohen aspekte të shumëllojshmërisë kulturore. Për shembull, në Kornizën Kombëtare të Arsimit Parauniversitar theksohet se “*Në një botë gjithnjë e më e globalizuar, në të cilën cilësia e Tokës për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm është e kërcënuar, nxënësve u nevojiten njohuri, shkathtësi dhe qëndrime për t’u kujdesur me përgjegjësi për mjedisin natyror dhe atë që ka krijuar e do të krijojë dora e njeriut dhe për të mënjeluar shpërdorimin e burimeve dhe praktikave të papërgjegjshme. Kjo kërkon që të rehat dhe të rinjtë të ndërgjegjësohen se si të luftohen në mënyrë efektive: varfëria, marginalizimi, diskriminimi dhe padrejtësia*”.⁴ Por kurrikulat tona ende nuk arrijnë të marrin parasysh përvojat arsimore të të nxënësve të gjuhës nga nxënësit me nevoja të veçanta.

Pranimi dhe njohja e prejardhjes kulturore të nxënësve

Këtu, pikënisja mbetet te mësuesi. Nga mësuesit kërkohet që ata të studiojnë dhe të njohin mirë prejardhjen kulturore të të gjithë nxënësve të shkollës,

⁴MAS, *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë*, 2014, f. 10

me qëllim që të pranojnë dhe të përfshijnë përvojat e të mësuarit dhe përmbajtje mësimore që lidhen me interesat dhe perspektivat personale kulturore dhe të trashëgimisë të nxënësve. Kjo është një çështje kyç marrëdhëniesh. Pa e pranuar tjetrin siç është dhe pa i dhënë vendin që i takon, nuk përlligjet asnjë hap i ndërmarrë, sado i pasur e i larmishëm të jetë teorikisht. Nga ana tjetër, vlera të padiskutueshme merr nxitja e çdo nxënësi për të mësuar prejardhjen kulturore të nxënësve të tjerë në klasë, duke u dhënë mundësi nxënësve nga kultura të ndryshme të diskutojnë dhe të ndajnë përvojat e tyre kulturore, përmes organizimit dhe pjesëmarrjes në veprimtari të larmishme në klasë, në shkollë e jashtë saj. Veprimtari të tilla organizohen shpesh në shkollat tona dhe vlejné më shumë se çdo trajtim teorik që bëhet në tekstet shkollore dhe në literatura të ndryshme që u rekomandohen shkollës, mësuesve, nxënësve.

Analiza kritike

Kurrikula dhe përmbajtjet mësimore-edukative të miratuara nuk lejojnë që me nxënësit të trajtohen situata përjashtuese, diskriminuese etj. Megjithatë, mësuesit duhet të shqyrtojnë në mënyrë të posaçme materialet mësimore, që të mund të identifikojné materiale potencialisht paragjyquese ose të njëanshme. Kapërcimi i situatave të tilla jo të këndshme duhet bërë nga mësuesit në bashkëpunim me nxënësit, duke diskutuar rreth pikëpamjeve kulturore të secilit dhe duke analizuar në mënyrë kritike materiale mësimore e praktika mësimore, apo politika shkollore që mund të pasqyrojnë paragjykimet kulturore, me synimin e vetëm: Ndërhyrje për ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme për të zhdukur paragjykimet.

Gjetja dhe përdorimi i burimeve mësimore

Arsimi shumëkulturor mbështetet, në përgjithësi, në parimin e barazisë. Një nga kërkesat është gjetja dhe shpërndarja e burimeve mësimore, përfshirja e përvojave të të nxënësve duke e bazuar këtë në nevojën e respektimit të drejtësisë, jo thjesht në barazinë pa kompromis. Për shembull, nxënësit që nuk e zotërojnë mirë gjuhën shqipe, për shkak se vijnë nga mjedise familjare ku flitet tjetër gjuhë (greqisht, maqedonisht, romisht, bullgarisht, vllahisht etj.), mund të mësojnë në mjedise dygjuhëshe dhe të lexojné tekste dygjuhëshe. Ata duhen mbështetur vazhdimisht nga nxënësit e tjerë që flasin shqip, në mënyrë që të mos

mbeten prapa në shkollë apo ta braktisin shkollën për shkak të kufizimeve të gjuhës.

Roli i partnerëve të shkollës për krijimin dhe mbajtjen e qëndrimit pozitiv ndaj të nxënit cilësor në shkollë

Pjesëmarrja e partnerëve dhe aktorëve është thelbësore dhe shumë e rëndësishme në çdo hap të planifikimit dhe zbatimit të programeve për krijimin dhe forcimin e qëndrimit pozitiv ndaj shumëllojshmërisë kulturore në shkollë. Kjo nuk duhet kuptuar thjesht si dhënie mesazhesh nëtavolinë apo në rrugë e në shkollë, po si gjetje e zbatim të mekanizmave që ndryshojnë sjellje pozitive dhe që adresojnë problematikat.

Mjedisi shumëkulturore në shkollë është shumë i ngrohtë e miqësor, nëse dhe prindërit e nxënësve, të çfarëdo prejardhjeje kulturore qofshin, do të marrin pjesë, do të qëndrojnë bashkë dhe do të përfshihen në veprimtari gjithëpërfshirëse edhe në kohën e tyre të lirë, Padyshim që standardi i të nxënit do të ishte më cilësor.

III. STANDARDE PËR MJEDISE ME SHUMËLLOJSHMËRI KULTURORE

Zhvillimi profesional i mësuesve

Arsimi shumëkulturore kërkon edhe kualifikimin dhe trajnimin e mësuesve, që ata të jenë të përgatitur për mjedise me shumëllojshmëri kulturore. Qysh në fillimet e viteve 1980, në vende të ndryshme të botës nisi akreditimi i organizatave arsimore dhe i institucioneve shtetërore të arsimit për të përfshirë në programet e trajnimit të mësuesve edhe module për shumëllojshmërinë kulturore. Shtete, të tilla si Kalifornia, Florida dhe Masaçusets (Massachusetts), ndërmorën përpjekje ambicioze për të trajnuar mësuesit në fushën e arsimit shumëkulturore.

Në krye të punimit tonë, ne shtruan pyetjet: Sa të përgatitur janë mësuesit e rinj për të menaxhuar praktika mësimore kundër diskriminimit, pa injoruar dhe pa anashkaluar pengesat kulturore? Sa ambicioz është zhvillimi profesional i mësuesve në sistem për edukimin e shumëllojshmërisë kulturore? Përgjigjet për secilën nga këto pyetje kanë veçoritë e veta. Formimi fillestar i mësuesve të rinj në fakultetet e edukimit dhe problematikat me të cilat ndeshen këta mësues në klasë dhe në shkollë, flasin për mungesë kompetencash për menaxhimin e situatave dhe zgjidhjen e duhur. Mësuesve të rinj u mungon sjellja e kërkuar për

zotërimin e situatave reale dhe për kapërcimin e konflikteve të ndryshme që lindin shpesh mes nxënësve me gjini të ndryshme, me prejardhje kulturore të larmishme etj. Nëse qëndrojmë te mësuesit në sistem, është shumë e thjeshtë të dallojmë se ata i menaxhojnë situatat problematike që krijohen, falë moshës që kanë dhe përvojës së punës me fëmijët dhe adoleshentët. Mësuesve në sistem u mungon një udhëzues i mirëfilltë për menaxhimin e rastit/rasteve. Ata nuk kanë marrë ndonjë trajnim për të njohur shkencërisht shkak-pasojat e konflikteve që lindin në klasa dhe në mjedise me shumëllojshmëri kulturore. Për këtë arsye, konfliktet mes nxënësve, apo dhe ato nxënës-mësues, mësuesit, ia faturojnë moshës fëmijërore apo rinore. Një praktikë e papranueshme është zgjidhja e njëanshme e konflikteve nga mësuesit, ndërkohë që mësuesi, në çdo rrethanë dhe ndaj çdo nxënësi, duhet të jetë krejtësisht i paanshëm.

Personeli i shkollës me prejardhje të ndryshme kulturore

Institucionet tona arsimore duhet të vlerësojnë punësimin e mësuesve nga prejardhje të ndryshme kulturore, dhe këtë ato ta bëjnë në mënyrë të qëllimshme dhe aktive. Prania në shkolla e edukatoreve dhe e mësuesve romë, egjiptianë, grekë, maqedonas, vllahë etj. është një tregues i qartë i respektimit të intelektualëve me prejardhje nga pakicat. Askush nuk ka psetë pretendojë se mësuesit romë, egjiptianë etj. janë më të aftë sesa mësuesit e tjerë në fushën e edukimit shumëkulturore. Nga ana tjetër, këta mësues nuk duhen paragjykuar se janë më pak të aftë se pjesa tjetër e stafit mësimor të shkollës. Çdo mësues, pavarësisht nga prejardhja e tij, përfaqëson dhe pasqyron vlerat themelore të komunitetit nga ka origjinën. Shkolla dhe nxënësit e saj do të kenë vetëm përfitime nga prania e edukatorëve dhe mësuesve model nga një shumëllojshmëri të gjerë të përkatësive kulturore.

Aktet ligjore dhe nënligjore

Krijimi i qëndrimit pozitiv ndaj shumëllojshmërisë kulturore në shkollë është një kërkesë që buron nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndaj nuk mund të flasim për gjithë përfshirje në shkollë, nëse nuk zbatojmë me përparësi Kushtetutën, ligjet, VKM-të, urdhrat, udhëzimet, strategjitë, planet e veprimt, konventat dhe çdo akt që garanton barazi në arsim. Kështu, veç Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, ose shkurt DUDNj (neni 26), këtu përfshihen edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (nenet 28 dhe 29, KDF, 1989); Konventa

për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 18, ICCPR, 1966); CEDAW (neni 10, 1979); Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (neni 24 CRPD, 2006); Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial (nenet 5 dhe 7, CEFRD, 1966); Konventa për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (nenet 13 dhe 14); Konventa 138 e ILO/ONP mbi Moshën Minimum për Punë (neni 2 dhe 6); Konventa e ILO/ONP për Format e Këqija të Punës së Fëmijëve (nenet 7 dhe 8); Karta Sociale Europiane e Rishikuar (nenet 7, 10, 15 dhe 17, 1996); Konventa Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNj, 1950); Karta Themelore e të Drejtave (nenet 13, 14, 21, 32) etj.

VKM-të për arsimimin e pakicave kombëtare

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, gjatë periudhës 2018 – dhjetor 2020 janë hartuar dhe miratuar katër VKM në fushën e arsimit. Në njërin prej VKM-ve, veç të tjerash, përcaktohet: “3. *Tekstet shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, të përgatitura e që janë gjendje pranë strukturave shtetërore, kalojnë në administrim të ministrisë përgjegjëse për arsimin, e cila i riboton këto tekste, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, duke respektuar të drejtat e detyrimet lidhur me këto tekste. 4. Ministria përgjegjëse për arsimin siguron përkthimin e teksteve të katalogut zyrtar të teksteve shkollore, nga gjuha shqipe në gjuhën e pakicës kombëtare, në përputhje me lëndët mësimore që zhvillohen në arsimin bazë...*”⁵.

Sipas pikës 4 të VKM-së nr. 561, datë 29.9.2018, “4. *Nisma për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare mund të merret nga: a) Njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse; b) Njësia arsimore vendore përkatëse; c) Komuniteti i zonës, ku pritet të hapen klasa të pakicave kombëtare. 5. Për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare, kryetari i bashkisë dhe titullari i*

⁵VKM nr. 227, datë 17.04.2019, “Mbi përgatitjen, botimin, publikimin dhe shpërndarjen e teksteve të nxënësve që u përkasin pakicave kombëtare në sistemin arsimor bazë parauniversitar”

njësisë përkatëse arsimore vendore, pas konsultimit me përfaqësues të pakicave kombëtare, i paraqesin propozimin përkatës ministrit përgjegjës për arsimin.”⁶.

Pika 1 e VKM-së nr. 562, ngarkon institucionet publike të arsimit të lartë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mësimore e shkencore shkencat shoqërore, sociale dhe ato të edukimit, të përfshijnë në veprimtarinë e tyre mësimore njohjen, hulumtimin dhe promovimin e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare.”⁷.

Sipas pikës 3 të VKM-së nr. 1155, datë 24.12.2020, “*Njësitë e vetëqeverisjes vendore, numri thelbësor dhe kërkesa e mjaftueshme me qëllim sigurimin e së drejtës për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare, përcaktohen në bazë të kriterëve të mëposhtme: a. numri i personave që i përkasin pakicës kombëtare, i cili duhet të jetë jo më pak se 20 për qind e numrit të përgjithshëm të banorëve të njësisë administrative, si nëndarje e bashkisë; b. periudha e regjistrimit si banor në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas periudhave të regjistrimit të popullsisë, konfirmuar me vërtetim të lëshuar sipas të dhënave nga Regjistrat Themeltarë të Gjendjes Civile dhe /ose Regjistri Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010; c. kërkesa formale, paraqitur nga prindër apo kujdestarë ligjorë të fëmijëve që i përkasin pakicës kombëtare, pranë bashkisë/njësisë administrative, ku shprehet vullneti në mënyrë formale dhe bazuar në të drejtën e vetë identifikimit, të mjaftueshme për formimin e klasës.”⁸.*

Ende nuk ka filluar zbatimi konkret i këtyre VKM-ve, pasi nuk ka nisma për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare të njohura rishtas në ligjin përkatës.

Lista e mëposhtme përshkruan disa shembuj përfaqësues të edukimit shumëkulturore që ngjallin debat:

⁶VKM nr. 561, datë 29.9.2018, “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”

⁷VKM nr. 562, datë 29.9.2018, “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”

⁸VKM nr.1155, datë 24.12.2020, “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”

Diskriminimi pozitiv në arsim

Ashtu si në fusha të tjera, edhe në arsim, gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit janë ndërmarrë disa politika të dukshme favorizuese, shprehëse të diskriminimit pozitiv. Kështu, me udhëzim të posaçëm të ministrisë përgjegjëse për arsimin, fëmijët romë u lejuan të regjistrohen në shkollë edhe pa certifikatë lindjeje (sot lejohet çdo fëmijë); fëmijëve romë, egjiptianë, fëmijëve të pakicave kombëtare, atyre me aftësi të kufizuara, me status jetimi etj. (janë mbi 15 kategori të tilla fëmijësh) u jepen tekstet shkollore falas në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm të lartë; të rinj romë, egjiptianë, paraplegjikë, tetraplegjikëtj., pranohen në institucionet e arsimit të lartë me kuota të veçanta, jashtë meritë-preferencës, duke u përjashtuar dhe nga taksa e shkollimit në bachelor në masën 100 për qind dhe në master 50 për qind. Përderisa këto janë politikadiskriminimi pozitiv, ka të ngjarë që ato të keqkuptohen, një ditë prej ditësh, dhe të keqinterpretohen si sisteme favorizuese për pakicat. Për fat të mirë, nuk jemi përballë një situatë që, për shembull, pranimet me kuota të veçanta në IAL, si shprehje e një trajtimi preferencial të pakicave të caktuara, të bëhen burim i një debati të vazhdueshëm në vend.

Përcaktimi dhe sigurimi i burimeve njerëzore

Në vendin tonë, janë të mirëpërcaktuara organikat e burimeve njerëzore për secilin institucion arsimor publik. Kjo bëhet në përputhje me nevojat e çdo shkolle për mësues, sipas numrit të nxënësve për klasë dhe normave mësimore, që caktohen me udhëzim të ministrit. Kështu që, asnjë shkollë nuk mund të punësojë më shumë mësues, qofshin këta ekspertë të specializuar në një fushë të caktuar, siç është arsimi special. Vitet e fundit, në shkolla po shërbejnë dhe mësues ndihmës që punojnë me nxënësit me aftësi të kufizuara, por nuk janë bërë e nuk po bëhen ende monitorime për të vlerësuar se çfarë pune konkrete po bëjnë këta dhe cilat janë efektet pozitive të pranisë së tyre në shkollë. Prania e mësuesve ndihmës në sistem është një nxitës për të siguruar fonde dhe burime njerëzore të specializuara edhe për nxënësit e pakicave të tjera, por një pjesë e mësuesve ndihmës ende nuk i plotëson kriteret për vendin e punës. Në institucionet arsimore të pakicave kombëtare shërbejnë edukatore dhe mësues që kanë origjinën nga pakica përkatëse. Por kjo nuk ndodh me pakicën romë, p.sh., prej së cilës frekuentojnë sistemin tonë arsimor parauniversitar mbi 5500 djem e

vajza. Nxënësit romë kanë vështirësi në përvetësimin e gjuhës shqipe, prandaj do të ishte një ndihmë e madhe për ta, nëse edukatoren në arsimin parashkollor dhe mësuesin në arsimin fillor ta kishin nga pakica e tyre osedikë që zotëron mirë dhe gjuhën rome.

Vlerësimi dhe testimi

Askush nga ne nuk mund të pretendojë se duhet të kemi të njëjtat pritshmëri të larta akademike nga të gjithë nxënësit dhe studentët. Praktika tregon senxënësit dhe studentët nga shtresa në nevojë kanë rezultate më të ulëta, përgjithësisht, në testimet e standardizuara, siç janë ato të provimeve kombëtare në mbarim të klasës së nëntë dhe të maturës shtetërore, në provimet në universitete, por dhe në testime për qëllime studimi, siç janë ato të klasave të tretaetë pesta.⁹ Në këto kushte, siç e trajtuam pak më lart, qeveria po zbaton politika të diskriminimit pozitiv duke u mundësuar të rinjve romë, egjiptianë, paraplegjikë, tetraplegjikë, me status jetimi etj. regjistrim në institucionet e arsimit të lartë me kuota të veçanta.

Në shkollën tonë, nxënësit vlerësohen duke u provuar përmes një testi të vetëm. Kjo mendohet si e vetmja mënyrë e drejtë dhe objektive për të vlerësuar të nxënësit dhe progresin akademik të nxënësve dhe të studentëve. Shumëllojshmëria kulturore nuk është argument për të përdorur shumëllojshmëri testesh dhe vlerësimesh. Nxënësve dhe studentëve u kërkohet të kalojnë të njëjtën provë, pavarësisht nga aftësia që kanë ata. Kur shtrohet çështja se kemi nxënës me vështirësi të dukshme e të qarta në të nxënë, lëshimi përmes testit të diferencuar nuk do të ishte zgjidhja e duhur. Zgjidhjen shkolla e bën përmes punës së diferencuar, përmes PEI-së që hartojnë dhe zbatojnë mësuesit e arsimit bazë me secilin nga nxënësit me vështirësi në të nxënë, siç janë nxënësit romë, egjiptianë, me aftësi të kufizuar, ata që kthehen nga emigracioni etj.

Kurrikula dhe të mësuarit

⁹AKP, *Vlerësim kombëtar (Për nxënësit e klasës III dhe V)*, Tiranë 2014. Marrë në: <http://shqiptarja.com/pdf/new/256032743-Testimi-i-Agjencise-Kombetare-te-provimeve-per-nxenesit-e-9-vjecares.pdf> dhe: AKP, *Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të*, Tiranë, 2016. Marrë në: http://www.akp.gov.al/images/pdf/vleresimi_kombetar_kl5.pdf

Nëse vërejmë me sy kritikë tekstet shkollore, p.sh., të gjuhës shqipe, të historisë, të qytetarisë etj., me të drejtë do të na lindë një shqetësim: në to, në vend që të mbizotërojnë përmbajtja kulturore, u kushtohet shumë vëmendje temave “të rëndësishme” dhe ngjarjeve historike. Pra, dallohet vëmendje e pamjaftueshmendaj trajtimit të aspektit shumëkulturor.

Parimi i gjithëpërfshirjes është një argument i fortë i cili kërkon që kurrikula dhe të mësuarit të trajtojnë pikëpamjet e shumta kulturore, qofshin këto krejt të ndryshme nga njëra-tjetra, në mënyrë që nxënësit me prejardhje të ndryshme kulturore të shohin grupet e tyre kulturore të përfaqësuara në përmbajtjet kurrikulare në të gjitha nivelet e shkollimit.

IV. KAPËRCIMI I PENGESAVE - SFIDA KRYESORE PËR SUKSES NGA NXËNËSIT ME PREJARDHJE TË NDRYSHME KULTURORE

Ekzistojnë një sërë faktorësh që ndikojnë krijimin e mjedisit gjithëpërfshirës dhe qëndrimin pozitiv ndaj shumëllojshmërisë kulturore. Në praktikën e shkollës sonë gjen përvoja mjaft pozitive, ashtu sikurse dhe raste që shprehin nevojën për të bërë më shumë nga sa është arritur. Kapërcimi i pengesave të shumta mbetet sfida kryesore. Theksi kryesor i investimit janë:

Dhuna verbale dhe shmangia e saj

Shkolla jonë vazhdon të vuajë nga dhuna verbale që vjen nga të gjitha drejtimet: nga mësuesi ndaj nxënësit dhe anasjelltas, nga drejtuesit ndaj mësuesit dhe ndaj nxënësit, nga prindërit ndaj fëmijës dhe ndaj mësuesit e shkollës, nga komuniteti ndaj shkollës. Vëmendja kryesore mbetet në dhunën që ushton mësuesi ndaj nxënësit dhe nxënësi ndaj mësuesit. Kjo dhunë, dhjetëvjeçarët e fundit ka marrë përmasa mjaft të mëdha. Konfliktet mes dy aktorëve kryesorë të orës së mësimi janë aq shumë të shpeshta saqë, jo rrallë, degjenerojnë deri në ndërprerjen e punës. Vitet e fundit, jemi dëshmitarë të masave ekstreme ndaj mësuesve të cilësuar si fajtorë në konfliktet me fëmijët/nxënësit. Këto masa, kur kanë qenë të nxituara, kanë bërë efekt të kundërt, duke frustruar mësuesit e tjerë, të cilët e ndiejnë veten krejtësisht të pambrojtur. Me këtë, nuk duam të dalim në krah të mësuesit. Aspak. Mësuesi mbetet përgjegjësi kryesor për gjithçka që i ndodh atij në shkollë me nxënësit. Por, nëse institucionet arsimore do të vendosin paanshmëri e drejtësi, gjykimi i çdo rasti duhet të jetë jashtë çdo qëndrimi

autoritar mbi mësuesin, i panxituar, i mirëpeshuar dhe në dobi të klimës miqësore në shkollë. Nuk jemi kundër respektimit të të drejtave të fëmijëve, por ne duhet t'i edukojmë ata me lirinë e individit që mbaron atje ku fillon liria e tjetrit. Faktet e viteve të fundit tregojnë se masat e nxituara, të marra ndaj mësuesve, kanë shtuar dhunën verbale, në vend që ta shmangin atë.

Sistemi i integruar

Baza ligjore e nënligjore, në zbatim edhe të konventave për të drejtat e njeriut dhe të fëmijëve, në aspektin gjithëpërfshirës, integrimine ka një nga parimet në fushën e arsimit. Por niveli i njohurive, i qëndrimeve mbizotëruese dhe i praktikave aktuale të prindërve, p.sh., romë dhe joromë, në lidhje me përfshirjen e fëmijëve romë në shkollë japin një pasqyrë të ndryshme. Rreth 1/3 e prindërve joromë mbështesin plotësisht qëndrimin që fëmijët romë kanë të drejta si fëmijët e tjerë për të ndjekur shkollën dhe rreth gjysma e tyre pajtohen plotësisht me qëndrimin që arsimit i ndryshon shanset jetësore për çdo fëmijë, pavarësisht gjinisë.¹⁰ Pra, për të siguruar sistem të integruar, shumë sjellje duhen ndryshuar. P.sh., është i pashpjegueshëm fakti që ka shkolla të cilat hezitojnë të regjistrojnë fëmijët romë, egjiptianë, autikë etj.; është i pashpjegueshëm fakti që në klasë, fëmijët me kultura të ndryshme ulen një banka më vete. Këto nuk janë dukuri shumë të përhapura, por ende gjallojnë.

Përmirësimi i proceseve demokratike në shkollë

Është bërë shumë për një klimë demokratike në shkollë, përmes parimit se të gjithë janë të barabartë, kanë të drejta të barabarta dhe gëzojnë liritë që u takojnë. Në shkolla ngrihen organet kolegjiale dhe fëmijët e të rinjtë kanë të drejtë të organizohen, të zgjidhen e të zgjedhin. Problemi qëndron në nevojën e vendosjes dhe të zbatimit të kritereve përmes përcaktimit të raporteve të përfaqësimit. Një ilustrim: edhe në shkolla ku afër gjysma apo mbi gjysma e nxënësve janë romë dhe egjiptianë, në këshillat e prindërve dhe në borde zgjidhen shumë pak prindër romë dhe egjiptianë. Në shkollë vendi, në vitin 2017 numëroheshin vetëm 67 prindër romë anëtarë në bordet e shkollave.¹¹

¹⁰ACER, *Plani i komunikimit për ndryshimin e sjelljes*, Tiranë, 2017, Material i pabotuar

¹¹Treguesstatistikorë, sipas MAS-it, 2017

Panorama e proceseve demokratike në shkollë varet nga angazhimi i gjithë aktorëve brenda e jashtë shkollës, përfshirë komunitetet nga kultura të ndryshme.

Drejtësia, shëndetësia dhe ushqyerja, si dhe mbrojtja sociale janë faktorë jo më pak të rëndësishëm se këta që trajtuam, pasi, kur çdo individ trajtohet me drejtësi, gëzon shërbim shëndetësor dhe ushqyerje dhe përfiton nga mbrojtja sociale, puna e shkollës si institucion arsimor bëhet më efektive.

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ndryshimi që ndodhi në përmasa të mëdha, sidomos gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, për shkak të lëvizjeve demografike, kërkon krijimin e një mjedisi dhe qëndrimi pozitiv ndaj shumë llojshmërisë së kulturave.

Çështja shtrohet nëse shkolla arrin apo jo integrimin e pakicave dhe edukimin e shumëllojshmërisë kulturore. Në vijim të shumë teknikave, metodave dhe strategjive që trajtuam në studimin tonë, mendojmë se puna e institucioneve arsimore, që nga parashkollori, do të arrijë të kapërcejë pengesa e vështirësi, nëse mbahen parasysh dhe rekomandime si këto në vijim:

- Në tekstet shkollore të futen përmbajtje mësimore për të gjitha kulturat, me qëllim që të nxitet ndërveprimi i nxënësve edhe nëpërmjet paraqitjes së bashkësive etnike dhe kulturore si pjesë e synimeve të njëjta që ka shkolla.
- Zhvillimi profesional i mësuesve të përfshijë programe trajnimi dhe studime që e bëjnë mësuesin më të ndjeshëm dhe e pajisin atë me kompetenca dhe mekanizma që, gjatë shërbimit në shkollë, të realizojë qëllimet mësimore që kanë të bëjnë me pranimin dhe respektimin e individëve të ndryshëm në realitetin shumëkulturor në shkollë.
- Të organizohen ditë të hapura me prindërit e të gjithë nxënësve: “Kjo është shkolla jonë”.
- Minifilma të shkurtër të xhiruar nga vetë nxënësit, janë një premisë për njohjen dhe përhapjen e kulturave të ndryshme.
- Shkollat i kanë të gjitha mundësitë që të zhvillojnë festivale për shumëllojshmërinë kulturore: Çfarë di unë për kulturën tënde? Çfarë di ti për kulturën time?

- Në gazetën e shkollës të zënë vend shkrime nga vetë nxënësit, metematikë jetën në komunitet.
- Parimi i gjithëpërfshirjes është një argument i fortë, i cili kërkon që kurrikula dhe të mësuarit të trajtojnë pikëpamjet e shumta kulturore, qofshin këto krejt të ndryshme nga njëra-tjetra, në mënyrë që nxënësit me prejardhje të ndryshme kulturore të shohin grupet e tyre kulturore të përfaqësuara në përmbajtjet kurrikulare në të gjitha nivelet e shkollimit.

LITERATURA:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
3. Ligj nr. 96/2017” për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”
4. Dispozitat normative për sistemin arsimor parauniversitar, 2013
5. Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar
6. Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”
7. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, 10 dhjetor 1948
8. Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, 1 korrik 2010
9. Konventa mbi të Drejtën e Fëmijës, 20 nëntor 1989
10. MAS, *Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020*
11. *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2014
12. Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor
13. IZha, *Programi i lëndës “Gjuhë shqipe”, shkalla e parë dhe e dytë*, Tiranë, 2015
14. Programi i qytetarisë:
http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/kurrikula/Programi_Qytetaria,_klasa_1_dhe_klasa_6.pdf
15. Programi i lëndës së artit pamor, shkalla e parë dhe e dytë
16. Programi i lëndës së muzikës shkalla e parë dhe e dytë
17. AKP, *Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të*, Tiranë, 2016, f. 4

18. ACER, *Plani i komunikimit për ndryshimin e sjelljes*, Tiranë, 2017, Material i pabotuar
19. MASHT, Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë, Prishtinë, 2012
20. VKM nr. 486, datë 17.06.2020, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”.
21. VKM-ja nr. 682, datë 29.07.2015, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar
22. Udhëzimi i MAS-it Nr. 42, datë 15.10.2014, “Për arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e paraburgimit, të vuajtjes së dënimit”
23. Udhëzimi i MASH-it Nr. 36, datë 13.08.2013, “Për procedurat për arsimimin e fëmijëve të ngjuar”
24. Udhëzimi i MASH-it Nr. 38, datë 13.08.2013, “Për arsimimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e përkujdesjes shoqërore”
25. VKM nr. 561, datë 29.9.2018, “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën epakicave kombëtare”
26. VKM nr. 562, datë 29.9.2018, “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”
27. VKM nr. 227, datë 17.04.2019, “Mbi përgatitjen, botimin, publikimin dhe shpërndarjen e teksteve të nxënësve që u përkasin pakicave kombëtare në sistemin arsimor bazë parauniversitar”
28. VKM nr.1155 datë 24.12.2020, “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”
29. VKM nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar.

PHD. ILIA BELLO

DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË

UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, KORÇË

ibello@unkorce.edu.al

MBI DISA PROBLEME TË PAKICAVE ETNIKE BALLKANIKE DHE TË DREJTAT E TYRE GJUHËSORE

Abstrakt

Politikat gjuhësore lidhen me ideologji të ndryshme dhe mund të jenë në funksion të ambicieve të ndryshme për dominimin shoqëror dhe kombëtar.

Planifikimi gjuhësor në shumicën e rasteve shoqërohet me një ideologji të caktuar, ngaqë nuk është e vetëmjaftueshme si rrjedhim synimet për të zhvilluar një gjuhë të caktuar në përgjithësi i shërbejnë kauzave të caktuara dhe u referohen institucioneve kombëtare ose ndërkombëtare, masat e përpunimit të kodit gjuhësor ndërmerren nga sisteme të ndryshme qeverisëse. Sipas një përkufizimi më të përgjithshëm, e drejta gjuhësore merren me çështjet e politikave gjuhësore në dokumentat e së drejtës ndërkombëtare.

Disa hulumtues bëjnë dallimin midis të drejtave gjuhësore dhe të drejtave linguistike të njeriut. Ky punim synon të sjellë në vëmendje:

-Disa probleme që lidhen me të drejtat gjuhësore në disa vende ballkanike, si: Bullgaria, Rumania, Greqia, Serbia, Maqedonia e Veriut, si dhe ideologjitë që ndikojnë në politikat gjuhësore të tyre.

Planifikimi i mësimi të gjuhës përvijon të ardhmen e një gjuhe, zhvillimin dhe rimëkëmbjen e saj. Në rastet e një gjuhe në rrezik qeveritë përkatëse marrin edhe masat e mbijetesës. “Imperializmi” gjuhësor, nga ana tjetër, diku më i fshehtë dhe diku i më hapur, ndjek qëllimet e tij strategjike për hegjemoninë gjuhësore mbi bashkësitë e tjera.

Fjalët kyçe: Ballkan; pakicat etnike; ideologji; politika gjuhësore; të drejtat gjuhësore

Të drejtat gjuhësore të njeriut

Ideja e të drejtave të njeriut - jo si një doktrinë filozofike, por si zbatim praktik, e ka zanafillën në Angli në shekullin XVII, kryesisht me mbrojtjen dhe imunizimin e individit (personit, qytetarit) nga arbitrariteti i pushtetit. Çështja e të drejtave të njeriut, e ka historinë e vet të pavarur, fillimi i së cilës lidhet me emrat e T. Hobbes, J. Locke dhe J. J. Rousseau.

Mes dy “rekomandimeve” të arsyes ka padyshim një dialog që filloi në fund të shekullit të XVII, por shkrirja e vërtetë, teoria dhe praktika juridike mund t'i atribuohet vetëm epokës më të re, dmth fundit të shekullit XX.

“Zhdukja” e gjuhëve dhe varianteve gjuhësore.

Një nga studiuesit e parë për çështjet e "vdekjes së gjuhës" - gjuhëtari austriak Wolfgang Ulich Dresler – tregon se fenomeni vërehet në komunitete të paqëndrueshme dygjuhëshe ose shumëgjuhëshe si rezultat i ndryshimit të gjuhës nga ana e gjuhës së prekur të pakicës në gjuhën dominuese të shumicës.

Si rezultat i dominimit dhe i hegjemonisë gjuhësore, e cila është pa dyshim jo vetëm gjuhësore, por edhe politike dhe kulturore, formohet një bashkësi homogjene njëgjuhëshe dhe ka humbje (vdekje) të gjuhës së pakicës (Dressler 1988:, Crystal 2000).

NDËRTIMI I GJUHËS DHE TË DREJTAT GJUHËSORE NË BALLKAN

Një nga problemet kryesore të vendeve ballkanike, në përgjithësi, është se ato ato janë të vështira për t'u përshtatur me standardet dhe “kanunet” kulturore të botës perëndimore.

Modernizimi i gjuhëve kombëtare ballkanike

Po të shohim faktet dhe shembujt historikë në vendet e Ballkanit, në praktikë proceset e ndërtimit sociolinguistik ose janë deri diku spontane ose janë të organizuara dhe të përgatitura me shumë kujdes.

Zakonisht bëhet fjalë për "përpunimin" e një standardi në dy forma:

- përmes debateve dhe diskutimeve më të gjata *ose*
- nëpërmjet akteve kolektive të njëanshme, d.m.th. të “kongreseve” në kuptimin e vërtetë të fjalës që dalin me deklarata, programe apo manifeste ku synojnë disa strategji dhe politika gjuhësore.

Roli i gjuhës në ringjalljen kulturore dhe vetëvendosjen e kombeve ballkanike është i mirëkuptuar nga autorët e manifesteve dhe të dokumenteve programore në shekujt XVIII dhe XIX.

Gjuha letrare moderne greke

Gjuha letrare moderne greke është ndoshta gjuha moderne e krijuar ndoshta më e vështira në Evropë. Intelektualët romantikë grekë të dehur nga fuqia dhe thellësia e gjuhës së tyre amtare dhe ndikimi i saj nëpër mbarë botën, kanë detyrën e vështirë, ndoshta edhe të pamundur të ndërrimit, që të përshtatin/

përkthejnë gjithë këtë trashëgimi fjalësh dhe idesh në një gjuhë konceptuale më moderne, të imazheve më të afta për të korresponduar me modernitetin.

Gjuha latine, enciklopedia franceze, filozofia klasike gjermane etj. të cilat janë të bazuara në greqishte, duhet të rishikohen dhe përshtaten me mjedisin e ri grek.

Tendencat iluministe në Perëndim dhe racionalizmi në një sërë aspektesh janë të papajtueshme me traditat filozofike orthodoxe - një detyrë me të cilën një numër teologesh dhe shkrimtarësh grekë dhe rusë kanë punuar për dekada.

Kësaj shtate komplekse gjuhësore në jug i shtohet edhe një detyrë e vështirë intelektuale- diversiteti dialektor në Ballkan për të kapërcyer nevojat e një arsimi demokratik dhe të aksesueshëm (shih: Dragova 1972, Konev 1983, Dimçeva 1985:).

Situata gjuhësore në Greqi njihet si situata e diglosisë (vetë termi është edhe greqisht) dhe kjo dikotomi gjuhësore midis dy varieteteve gjuhësore *katarevusa* dhe *dhimotiki*) ka rrënjë shumë të thella, që në kohën e antikitetit.

Kjo përshkruhet me detaje në aspektin historik nga dijetari gjerman Krumbacher më 1903 (Rizov 2012). Sipas disa autorëve (Triandafilos 1938, Logachev 1979:), kjo diglosi është formuar artificialisht dhe është ushqyer artificialisht, por gjithsesi, çështja zgjidhet vonë.

Në vitin 1976 Ligji 306 vendos për unifikimin në favor të versionit kombëtar të gjuhës “dhimotiki”. “Purizmi i intelektualëve grekë ndaj gjuhës së përbashkët evropiane dhe sot as nuk mund të vlerësohet në mënyrë të qartë - ajo çon në kufizime për sa i përket terminologjisë ndërkombëtare latine, por nga ana tjetër, ruan origjinalitetin e mendimit elitar ortodoks dhe është një pengesë e ndikimeve katolike.

Pasojë e “purizmit” është semantika e zhvendosur e një numri fjalësh nga origjinë greke e lashtë, të cilat sot në greqishten e re janë në përdorim të përditshëm, por njëkohësisht për kombet e tjera janë adoptuar në funksionin e termave speciale.

Gjuha letrare serbo-kroate

Gjuha letrare e përbashkët serbo-kroate, nga vetë emri i saj, synonte bashkimin politik dhe kulturor ndërmjet serbëve dhe kroatëve.

Bashkimi dukej i vështirë ndërmjet katolikëve dhe të krishterët ortodoksë, të cilët, megjithatë, duhet të bashkoheshin relativisht lehtë bazuar në gjuhën e tyre të përbashkët sllave, pavarësisht dallimeve dialektore.

Natyrisht, këtu bëhet fjalë edhe për plane politike, edhe pse nga këndvështrimi modern nuk është plotësisht e qartë se cilat ambicie dhe skema strategjike dhe të kujt qëndronin pas kësaj.

Bazuar në gjuhën e tyre të përbashkët sllave, pavarësisht dallimeve dialektore sipas N. Ivanova

(2000) e cila shqyrton në detaje ndryshimet dhe ngjashmëritë midis dy gjuhëve letrare dhe nëntipet shoqëruese përkatëse.

Edhe serbët edhe kroatët kanë traditën e shkruar mesjetare e lidhur me nevojat kryesisht të kishës. Megjithatë, shfaqet hendeku ndarës mes katolikëve dhe traditës klerikale, e lidhur kryesisht me latinishten dhe orthodoksëve lindore ku letërsia kanonike, e shkruar në sllavishten kishtare, ka qenë ndikuar fuqishëm nga ekzemplarë grekë.

Megjithatë, këto dallime mund të jenë gjithashtu të dobishme nga pikëpamja e depërtimit të ndërsjellë, d.m.th. e përkthimit në kuptimin më të gjerë, midis dy kanuneve dhe krahasimit të disa koncepteve kryesore.

Filologu Vuk Karaxhic, ndërtoi projektin për gjuhën serbo-kroate.

Autoriteti i Vuk Karaxhicit për çështjet gjuhësore u bë i padiskutueshëm kur pas vitit 1920 ai botoi një përkthim të Dhiatës së Re në serbishte dhe hartoi fjalorin, koleksione të vlefshme gramatikore dhe folklorike, si dhe pati meritë të konsiderueshme për kalimin edhe të serbëve dhe të kroatëve në dialektin shtokavian që ishte bazë për gjuhën e ardhshme letrare të përbashkët.

Nuk mund të mohohet autorësia e tij mbi parimin fonetik demokratik që qëndronte në themel të kodifikimit të së ardhmes të gjuhës letrare. (Unbegaun 1935, Stevanovich 1971: 18-27, Tolstoy 1988: 194-200, Konev L. Gaj ishte një nga kujdestarët e parë të unifikimit gjuhësor të sllavëve të jugut.

Më vonë, pati shumë përpjekje të ngjashme, dhe disa nga këto projekte përfshinin edhe gjuhën bullgare.

Një shembull në këtë drejtim është përpjekja e A. Bezenshek për të përdorur stenografinë si mjet për bashkimin gjuhësor të sllavëve të jugut (Ivanova 2008). 2007).

Traktati i Vjenës lejon lirinë e zgjedhjes në sistemin grafik, si dhe mundësinë e përdorimit alternativ të tingujve të ndryshëm dhe digrafia në Jugosllavinë e mëvonshme nuk u duk që të ketë provokuar probleme të veçanta.

Mirëpo, deri në kohën e J.B. Titos në vitin 1954, në Novi Sad u krye një kodifikim pjesërisht i ri, duke i dhënë një barazi edhe më të madhe të dy gjuhëve dhe mundësinë e statusit të barabartë duke zëvendësuar emrin kroat- serbisht dhe serbokroatisht.

Gjatë vitin 1967, kur kërkesa politike për autonomi më të madhe të Kroacisë në kuadër të RSFJ-së sërish mori formë gjuhësore.

Disa nga intelektualët përfaqësues, duke përfshirë edhe emrin e laureates për çmimin Nobel Miroslav Karleza, nënshkruajnë një deklaratë "për emrin dhe pozicionin e gjuhën letrare kroate."

Matica Hrvatska refuzon të përfundojë fjalorin e madh në gjuhën letrare dhe populllore serbokroate.

Matica Kroate dhe Matica Serbe fillojnë të botojnë "Fjalorin Serbo-Kroatisht në gjuhë letrare dhe populllore" në përputhje me vendimet e Traktatit të Novi Sadit. Të dyja botuan vetëm vëllimin e parë dhe pas tërheqjes së gjuhëtarëve kroatë, vëllimet e mbetura botohen deri në fund vetëm nga Matica Serpska.

Fjalori duhet të kishte 30 vëllime (17 janë botuar deri më tani) me mbi 450.000 fjalë.

Shpërbërja e federatës jugosllave tregoi qartë se edhe çështja e statusit gjuhësor mund të përfshihet edhe në kontradiktat më të thella politike.

Gjuha e re letrare bullgare

Gjuha letrare moderne bullgare bazohet në traditën e Shën Kirilit dhe Metodit dhe dishepujt e tyre Klimenti, Sava, Gorazdi, Naumi dhe Angelarius, të cilëve sllavizmi u ka ndërtuar një kult dhe i quan "shtatë të shenjtët".

Rilindja Bullgare përpiqej në shumë aspekte të rizbulonte trashëgiminë, e trashëguar nga Shën Klementi i Ohrit, që në vitin 893 u shpall ipeshkv i parë i gjuhës bullgare i cili hedh bazat e para për shkrim-leximin e njerëzve të thjeshtë dhe të klerikëve, veçanërisht në zonën e Maqedonisë, duke përdorur shkronjat cirilike dhe duke shërbyer në gjuhën sllave-bullgare nëpër kisha.

"Historia sllavo-bullgare", shkruar nga Paisii Hilendarski, ishte një vepër që luajti një rol të rëndësishëm në zgjimin e vetëdijes bullgare. Kjo vepër me

devijime të vogla është shkruar në sllavishten kishtare dhe jo në bullgarishten moderne.

Gjuha e re bullgare pati detyrën komplekse të emancipimit të vetvetes në tri drejtime jo vetëm nga ndikimi kishtar sllav dhe rus, por edhe nga ndikimi grek, pasi shumë nga intelektualët dhe filologët bullgarë janë në fakt greko-bullgarë bilinguistë. Të tillë janë Neofit Rilski, Rakovski, Ivan Bogorov, Seliminski e shumë të tjerë të tjerët. Për sa u përket situatave gjuhësore në Plovdiv, Stanimaka, V. Tërnovo, Plovdiv, një qytet tipik i bilinguizmit dhe diglosisë bullgaro-greke, (Videnov 2005:).

Barrierave gjeografike i shtohet edhe patriotizmi lokal i figurave kulturore që deshën të përfshinin vendlindjet e tyre si baza të ndërtimit të gjuhës, pavarësisht se qendrat kryesore letrare dhe arsimore bullgare në pothuajse të gjithë shekullin e XIX nuk ishin brenda vendit (i cili ndodhej nën sundimin osman të kohës), por ishin të shtrira në qytetet e Bukureshtit, të Brailës, të Beogradit, të Kragujevacit, d.m.th. në emigracion (Venediktov 1990).

Qendrat kulturore bullgare në atë kohë ishin kolonitë e mëdha të përkohshme ose të përhershme që banoheshin nga bullgarët, pra ishin qytetet e Selanikut dhe në Stamboll (Konstandinopojë), sepse prej shekujsh prania bullgare atje ishte e konsiderueshme dhe atje botoheshin gazetat dhe punonin shtypshkronjat bullgare.

Në veprën e tij “Nga historia e gjuhës letrare bullgare deri te teoria e gjuhëve letrare” B. Valçev jep një analizë të hollësishme të qendrave kulturore e letrare të bullgarëve gjatë Rilindjes dhe shpërndarjen gjeografike të intelektualëve bullgarë.

“Një sqarim i rëndësishëm sipas B. Valçev 2009:

Për shkak të specifikave të ekzistencës bullgare, nuk ishte e mundur që të formohej një qendër kryesore kulturore, politike dhe ekonomike, e mishëruar në një qytet të vetëm” (Valchev 2009:). Megjithatë, proceset e standardizimit nuk shkaktuan konflikte serioze dhe rivalitete, pasi grafiku ishte relativisht i unifikuar dhe rregullat drejtshkrimore e shkollave të formuara gradualisht të V. Tërnovos dhe Plovdivit t nuk provokonin probleme në leximin e teksteve.

Sipas Valçev, “...Në asnjë rast, megjithatë, nuk mund të flitet për ndonjë bazë të përgjithshme dhe lokale të padiferencuar të gjuhës – ajo është bazuar fort

në dialektin verilindor, ku sistemi dhe struktura e së cilës duken qartë sot” (Valchev 2009:).

Në vitet 1960, një rreth i ngushtë intelektualësh krijuan një shoqëri letrare dhe botuan “Revista periodike”, ku trajtuan çështjet e standardizimit të drejtshkrimit (Rusinov 1985:).

M Drinov dhe rrethi i tij i ngushtë ishin ligjvënësit e drejtshkrimit modern bullgar, i cili, megjithatë, është kodifikuar përfundimisht vetëm në vitin 1891 në Principatën e lirë Bullgare.

Gjuha bullgare është një shembull i mirë i përshkallëzimit në rritje, por edhe i vështirësive në kodifikim, megjithatë nuk karakterizohet nga konflikte dhe përmbysje të mëdha.

Qëndrimi ndaj gjuhëve të huaja në Ballkan /Evropë.

Studimi i gjuhëve të huaja është bërë pikërisht për të krijuar një ekuilibër ekolinguistik midis globalizmit dhe lokalizmit.

Dihet se një nga qëllimet kryesore të arsimit, përveç transmetimit dhe zhvillimit të njohurive gjuhësore, është edhe formimi i një sistemi vlerash dhe ndërtimi i unitetit kombëtar. Ky funksion kryhet kryesisht duke ndërtuar një model të unifikuar global nga këndvështrimi i nocioneve të brendshme kombëtare për historinë dhe gjeografinë. Këto njohuri megjithatë janë pjesë përbërëse e gjuhëve kombëtare dhe e të gjitha simboleve dhe identitetit të gjuhës kombëtare.

Në fund të shekullit XX u bënë shumë përpjekje për mbështetjen e shumëgjuhësisë dhe stimulimin e kulturave të pakicave.

UNESCO (1953) ka luftuar për mirëkuptim ndërkombëtar dhe paqen përmes edukimit shkollor. Në shumë nisma dhe iniciativa, këto në përputhje me parimet e Deklaratës së të Drejtave të Fëmijës (1959) theksohet se të rinjtë në të gjitha shtetet (në moshën kur krijohen shprehitë e qëndrueshmërisë dhe formësimi i personalitetit) duhet të ushqehen me frymën e solidaritetit dhe mirëkuptimit reciprok. Në lidhje me arsimin e lartë psh., Evropa nuk mund ta krahasonte këtë situatë me Afrikën post-koloniale ose Indinë (Iversen 2008).

Skemat e Scutnab-Kangas dhe Phillipson për të drejtat gjuhësore (të gjuhës amtare) teorikisht janë vërtetuar mirë, por të paktën për momentin, skema e gjuhës (gjuhës amtare) dhe e gjuhës së dytë nuk është e zbatueshme në Evropë.

(gjuha ndërkombëtare, p.sh. anglisht). Në fakt, përkufizimi i gjuhës amtare përcaktohet nga kriteret e mëposhtme:

- origjina (gjuha që u mësua e para),
- identifikimi (i brendshëm - gjuha, me të cilën identifikohet individ, dhe i jashtëm - gjuha me të cilën e identifikojnë të tjerët),
- kompetenca (gjuha që njih më mirë),
- funksioni (gjuha që i shërben më shumë) (Scutnab-Kangas dhe Phillipson).

Vitet e fundit, njëfarë harmonizimi është arritur në Evropë, me standardet e mësimin të gjuhës.

Bibliografi

АМОН 1989: Ammon, Ulrich. 1989. Towards a descriptive framework for the status/function (social position) of a language within a country. In: Ammon, Ulrich (ed.). *Status and Function of*

Languages and Language Varieties, 21-106. Berlin: de Gruyter.

Ангелов 1997: Angelov, Angel G. Glottopolitics in the Balkans during the Twentieth Century. In: *The*

European Legacy, 1997, 2, Cambridge, MA: MIT Press.

Ангелов 2000б: Ангелов, Ангел Г. Political Border as a Factor for Language Divergence. In: *Sprachwandel in der Slavia*, Lew Zybatow (Hrsg.), Frankfurt am Main: Peter Lang – Linguistik

International, B. 2, 613-633.

Ангелов 2005: Ангелов, Ангел Г. Проучване и учене на общороманското и общославянското словно богатство. В: *Комуникативната компетентност в съвременния научен дискурс*.

Ангелов 2012: Ангелов, Ангел Г. *Закони, шаблони и творчески отклонения в поведението и в езика*. В:

Адриана Емилова Симеонова-Дамянова (състав.). *Игри, актьори, роли в класната*

стая и в живота. Юбилеен сборник с докладите от националната конференция в

чест на проф. дпн Мария Герджикова, София, Булвест 2000, 242-249

- Бакманд 2000: Bente Bakmand. National language planning, why (not)? *Journal of Intercultural Communication*, 3. URL: <http://www.immi.se/intercultural/>.
- Бакунин 2005: Михаил Бакунин. Принципи и организация на интернационалното революционно общество. Революционен катехизис. В: *Минева 2005*
- Верхаген 2008: Verhagen, Frans C. Worldviews and Metaphors in the Human-Nature Relationship: An Ecolinguistic Exploration Through the Ages. In: *Language & Ecology* vol. 2 no. 3.
- Водак 1989: Wodak, Ruth (ed.), *Language, power, and ideology*; Studies in political discourse (Series in Critical Theory, volume 7). John Benjamins: Amsterdam and Philadelphia.
- Водак и Майер 2001: Wodak, Ruth, and Michael Meyer. *Methods of Critical Discourse Analysis*. Introducing qualitative methods. London: SAGE, 2001.

DR. ERIS DHAMO

**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS**
eris.dhamo@unitir.edu.al

MIRANDA HYSA

**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS**
miranda.hysa@unitir.edu.al

ANILA SULAJ

**FAKULTETI I EKONOMISË DHE I AGROBIZNESIT
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS**
asulaj@ubt.edu.al

TË KUPTOJMË NDIKIMIN E POLITIKAVE MULTIKULTURORE

Abstrakt

Multikulturalizmi në tërësinë e tij thekson rëndësinë e identitetit kombëtar dhe të ligjeve kombëtare, ndërkohë që nxit lidhjet ndërmjet grupeve me prejardhje të ndryshme racore dhe etnike (Giddens, 2008). Ai i referohet si politikave informale dhe atyre formale, të cilat u mundësojnë qytetarëve dhe grupeve kulturore të ndryshme të ndërveprojnë në harmoni me njëri-tjetrin.

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë politikat multikulturore dhe vlerësimin e tyre, por, në fakt, të mos nxjerrë një përfundim prej saj. Fokusi ynë në këtë punim janë kryesisht prezantimi me indeksin e politikave mbi multikulturalizmin kryesisht në Evropë, nevoja dhe domosdoshmëria për krahasimin mbi politikat multikulturaliste me vendet e zhvilluara.

Në fund të punimit mbetet e hapur pyetja nëse është koha të ndërtojmë politika multikulturore dhe të krijojmë indeksin e vlerësimit të politikave kulturore.

***Fjalë kyçe:** multikulturalizëm, politikë, Indeks, Evropë, grup kulturor.*

Hyrje

Kultura është ajo që na formon; ajo formon identitetin tonë dhe ndikon në sjelljen tonë. Kultura është "mënyra jonë e të qenit", më konkretisht, ajo i referohet gjuhës së përbashkët, besimeve, vlerave, normave, sjelljeve dhe objekteve materiale që kalojnë nga një brez në tjetrin (Schaefer, 2006). Multikulturalizmi është thelbësor për krijimin e besimit se të gjithë qytetarët janë të barabartë, ai siguron që të gjithë qytetarët të mund të ruajnë identitetin e tyre, të krenohen me prejardhjen e tyre dhe të kenë një ndjenjë përkatësie. Politikat me fokus multikulturalizmin u japin grupeve të ndryshme një ndjenjë përkatësie, pranueshmërie, sigurie dhe vetëbesimi, duke i bërë ata më të hapur dhe pranues ndaj kulturave të ndryshme. Përvojat e shumë vendeve të zhvilluara me evidencat përkatëse kanë treguar se multikulturalizmi inkurajon harmoninë racore dhe etnike dhe mirëkuptimin ndërkulturor.

Multikulturalizmi, i njohur gjithashtu si bashkëjetesa me njerëz që konsiderohen "të ndryshëm", është bërë një pjesë kritike e politikëbërjes, sidomos në kohën kur rritja e popullsisë shoqërohet me heqjen e kufijve hapësinorë dhe diferencat ndërmjet grupeve etnike, gjuhësore, racore evidentohen dhe zhvillimi dhe emancipimi shtron nevojën për përfshirje kulturore. Multikulturalizmi, është përcaktuar gjerësisht dhe në shumë dimensione, por në tërësinë e tij ai thekson rëndësinë e identitetit kombëtar dhe të ligjeve kombëtare, ndërkohë që nxit lidhjet ndërmjet grupeve me prejardhje të ndryshme racore dhe etnike (Giddens, 2008). Në këtë kuptim, multikulturalizmi i referohet si politikave informale dhe atyre formale të cilat u mundësojnë qytetarëve dhe grupeve kulturore të ndryshme të ndërveprojnë në harmoni me njëri-tjetrin. Janë të shumtë shembujt e sotëm të cilët pasqyrojnë realitetet politike, si dhe të kudogjendura janë edhe modelet multikulturore, të paraqitura ndonjëherë dhe si një rrjet kuptimplotë konkluzionesh dhe përgjithësimesh rreth kulturës. Multikulturalizmit në të përditshme i referohemi ekzistencës së disa kulturave në një shoqëri, ose më mirë akoma bashkëegzistencës, duke siguruar rezultate më të mira se sa një diskutim abstrakt i parimeve të përgjithshme apo një recitim enciklopedik i fakteve të izoluara kulturore. Të gjithë presin të respektojmë strukturat dhe parimet bazë që garantojnë shoqërinë tonë demokratike, si Kushtetuta, demokracia parlamentare, liria e fjalës dhe fesë, gjuha kombëtare, shteti i së drejtës, pranimi dhe barazia.

Respektimi i detyrimeve të ndërsjella qytetare është kusht paraprak për të shprehur dhe ndarë vlerat kulturore.

Politika e multikulturalizmit është një temë e rëndësishme studimi, sepse politika të tilla përfaqësojnë një tregues se si një vend e percepton diversitetin e tij. Sa më mirë një vend të inkorporojë grupe të ndryshme, aq më mirë do të përdorë të gjitha talentet e qytetarëve të tij. Një popullsi më e informuar kontribuon në një demokraci më të mirë. Politika zyrtare duhet të promovojnë iniciativa të tilla përfshirëse për të përmirësuar komunikimin ndërmjet grupeve kulturore.

Përkufizimet mbi multikulturalizmin nisin shumë herët, që në vitet 1970, ne mund të gjejmë një përkufizimin i cili është relevant edhe sot, ai i Berry, Kalin dhe Taylor (1977), i cili e përkufizon multikulturalizmin në dy anë të rëndësishme: (i) praninë e diversitetit etno-kulturor në një shoqëri dhe (ii) praninë e pjesëmarrjes së barabartë nga të gjitha grupet kulturore në atë shoqëri.

Për sa i përket aspektit të parë, ata bënë dallime midis tri kuptimeve të ndryshme të komponentit të diversitetit etnokulturor të multikulturalizmit. Së pari, multikulturalizmi është një fakt demografik: shumica e shoqërive në mbarë botën tani janë të ndryshme kulturalisht. Së dyti, multikulturalizmi është një ideologji: individët dhe grupet kanë pikëpamje për pranimin ose refuzimin e tyre të këtij diversiteti. Së treti, disa qeveri artikulojnë politika publike dhe zhvillojnë programe që adresojnë pranueshmërinë e diversitetit si dhe promovimin e tij. Këto tre karakteristika janë të lidhura ngushtë (Berry dhe t.j., 1977). Nëpërmjet ndërtimit dhe aplikimit të politikave të multikulturalizmit, vendet njohin potencialin e të gjithë shtetasve të tyre, duke i inkurajuar ata të integrohen në shoqëri dhe të marrin pjesë aktive në çështjet sociale, kulturore, ekonomike dhe politike. Ideologjia multikulturore përcaktohet si një vlerësim për diversitetin kulturor dhe një nevojë për akomodim të ndërsjellë që promovon pjesëmarrjen e barabartë (Berry dhe etj.,1977).

Në një këndvështrim psikologjik e social, multikulturalizmi bazohet në parimet e drejtësisë kolektive, të bazuar në grup, duke theksuar dallueshmërinë kategorike dhe duke konceptuar shoqërinë si të përbërë nga nëngrupe qartësisht të identifikueshme (Gale & Staerklé, 2017; Guimond dhe t.j., 2014; Verkuyten, 2005).

Si një teori politike, multikulturalizmi vlerëson për më tepër praninë e grupeve të dallueshme dhe të ndryshme kulturore dhe miraton njohjen normative të dallimeve ndërmjet tyre, për shembull nëpërmjet mbrojtjes ligjore të praktikave kulturore ose të drejtave gjuhësore (Licata dhe t.j., 2011; Moghaddam, 2008; Taylor, 1992). Megjithatë, filozofët politikë debatojnë për shkallën në të cilën multikulturalizmi, me theksin e tij në të drejtat e grupit, është normativisht i pajtueshëm me theksin e shoqërive liberale perëndimore mbi parimet e drejtësisë individuale, të shprehura në vlerat ideologjike të lirisë individuale dhe përgjegjësisë personale (Barry, 2001; Joppke, 2004).

Ky debat i përputhshmërisë ka ndodhur kryesisht brenda konteksteve perëndimore si Amerika e Veriut dhe Evropa, ndërsa përkatësia e tij është vënë në pikëpyetje në kontekstin e regjimeve postkomuniste ose autoritare (Kuzio, 2005; Kymlicka & Opalski, 2001).

Aplikimi i politikave mbi multikulturalizmin ka çuar në norma më të larta natyralizimi se kurrë më parë. Shoqëria jonë evropiane dhe jo vetëm, me anë të politikave të saj, pa ushtruar presion për të asimiluar dhe hequr dorë nga kultura emigrantëve ju mundëson atyre të zgjedhin lirisht shtetësinë e tyre të re dhe u mundëson dhe i mbron nëse dëshirojnë të identifikohen me grupin e tyre specifik apo jo.

Një nga aspektet më të prekshme të politikave të dedikuara multikulturalizmit janë dhe gama e gjerë e mbrojtjes së ushtrimit dhe e praktikimit të feve dhe të ruajtjes së identitetit fetar pa frikën e “persekutimit” zyrtar dhe të shumtë janë studiuesit të cilët besojnë se pa këtë frikë ne jemi më të gatshëm të pranojmë kultura të ndryshme.

Diversiteti ynë është një pasuri kombëtare. Përparimet e fundit në teknologji i kanë bërë komunikimet ndërkombëtare më të rëndësishme se kurrë dhe ne sot flasim më shumë gjuhë dhe kuptojnë më shumë kultura, falë pranimin të ndërkulturalizmit.

Multikulturalizmi është parë kryesisht si një njohje simbolike e diversitetit kulturor dhe jo si një ndryshim thelbësor në politikën qeverisëse (Dickerson dhe etj., 2009). Dhe kur dakortësojmë që multikulturalizmi është një detyrim qeveritar, duhet sigurisht të kemi në konsideratë edhe burimet që orientohen drejt zbatimit të nismave multikulturore, si e vetmja mënyrë që këto politika të mos

mbeten për vite politika margjinale. Ideat e multikulturalizmit fillimisht u pranuan mirë edhe pse disa e kritikuan politikën për mungesën e përmbajtjes dhe theksimin e aspekteve folklorike të diversitetit etnik pa adresuar shqetësimet më imediate të grupeve minoritare (Bennett, 1998).

Sot janë të zakonshme formimet e shoqërive kulturore pluraliste dhe sipas studimeve rezulton se kur individët dhe shoqëritë kanë besim dhe ndihen të sigurt për identitetin e tyre kulturor dhe vendin e tyre në shoqërinë e madhe, rezultojnë qëndrime reciproke më pozitive; në të kundërt, kur këto identitete kërcënohen, do të rezultojë armiqësia e ndërsjellë ndërmjet individëve të kulturave të ndryshme (Berry, 2011). Kjo e dhënë shton më tepër rëndësinë studimore të kuptimit të politikave ndërkulturore dhe të rëndësisë së aplikimit të tyre.

Multikulturalizmi është bashkëjetesë, është diversitet, por të kesh diversitet nuk do të thotë bashkëjetesë paqësore dhe as nuk do të thotë se vendi domosdoshmërisht dëshiron dhe mundet t'i shtojë diversitetit bashkëjetesën. Në raste kur vendi përballet me një qeveri të paqëndrueshme të krijuar në rrethana të destabilizuara apo tranzitore ndërtimi dhe zbatimi i strategjisë së duhur multikulturore kthehet në sfidë, në të njëjtën kohë kur i duhet së pari të menaxhojë efektet e qëndrueshme të tranzicionit apo të po shkaktojnë krizave. Ndaj sot kemi shembuj me politika multikulturore të suksesshme, si në Zvicër, (një vend me demokraci e drejtpërdrejtë dhe me një garë mjeshtërore për fitimin e shtetësisë nga emigrantët dhe fëmijët e tyre të lindur në Zvicër) apo dhe në Kanada (e cila ka arritur paqen kulturore brenda kufijve të saj si dhe përfshirjen e emigrantëve), sepse multikulturalizmi mund të arrihet vetëm në nivel kombëtar kur zbatohet me sukses përmes politikave adekuate.

Qasjet ndaj multikulturalizmit bëjnë një ndryshim, sepse politikat multikulturore mund të bëjnë një nga tri gjërat: (a) Mund të parandalojë që të ndodhë asimilimi ose të paktën të zgjasë kohën e asimilimit në vijë të drejtë, (b) mund të lehtësojë asimilimin, ndërsa grupe të ndryshme integrohen për një kulturë të përbashkët, ose (c) mund të lehtësojë një formë alternative të asimilimit, pasi grupet arrijnë sukses në institucionet e shoqërisë pritëse dhe megjithatë ruajnë identitetin etnik në më shumë sesa thjesht një nivel simbolik.

Metodologjia

Fokusi ynë në këtë punim janë kryesisht prezantimi me indeksin e politikave mbi multikulturalizmin kryesisht në Evropë, nevoja dhe domosdoshmëria për krahasimin mbi politikat multikulturaliste me vendet e zhvilluara. Sigurisht që studimi ka nisur me pyetjen paraprake dhe më themelore: - a janë në fakt këto politika një tërheqje për tabanin politik bërës në vend? Në mënyrë të veçantë, politikat evropiane të multikulturalizmit kanë ardhur si politika apo janë bashkekzistuese?

Ky është një studim eksplorues, i cili përdor më shumë qasje cilësore sesa kërkimi përshkrues. Ai është më fleksibël dhe duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e gjerë të temës, pasi është e rëndësishme të lejohet një mënyrë për të mbledhur të dhënat. Për shkak se ky studim eksploron perspektivat e politikës multikulturore është e mundur të adresohen më shumë pyetje të hapura. Ky është një studim dytësor, mbledhje e informacionit nga kërkimet parësore të publikuara më parë dhe për këtë studim janë mbledhur informacione nga burime shkencore (studimet e rasteve, revistat, artikujt). Është një studim në internet, pasi më botën e sotme, kjo është një nga mënyrat më të shpejta për të mbledhur informacion. Shumë të dhëna janë lehtësisht të disponueshme në internet dhe mund t'i aksesojmë sa herë që na nevojiten, por për të garantuar të dhënat një aspekt tejet i rëndësishëm, i cili është vendosur dhe kriter, është vërtetësia dhe autenticiteti i faqeve burimore të internetit nga e morëm informacionin.

Qëllimi i këtij studimi është të eksplorojë politikat multikulturore dhe vlerësimin e tyre, por, në fakt, të mos nxjerrë një përfundim prej saj. Ndaj ky studim na mundëson një bazë të fortë për eksplorimin e ideve politikëbërëse, zgjedhjen e dizajnit fleksibël të kërkimit dhe evidentimin e variablave që në fakt janë të rëndësishëm për analizën (Indeksi dhe BE-ja). Më e rëndësishmja e këtij studimi është se një kërkim i tillë mund të ndihmojë organizatat ose studiuesit të reflektojnë mbi situatën në vend.

Është prezantuar Indeksi i Politikave të Multikulturalizmit me narrativën standarde në dy mënyra. Së pari, duke kërkuar të argumentojmë se tërheqja nga multikulturalizmi në Evropë është më e fortë dhe është plotësuar në nivelin e diskursit politikë. Ndërsa edhe pse ka pasur shembuj të një tërheqje nga politikat e multikulturalizmit në disa vende, ky nuk është modeli dominues evropian.

Pamja më e gjerë në Evropë është ajo e stabilitetit dhe zgjerimit të politikave multikulturore në dekadën e parë të shekullit të 21-të. Së dyti, prezantimi me dyzimet që ekzistojnë nëse programet e multikulturalizmit këmbëngulja janë të papajtueshme me integrimin qytetar, nëse ka kufij për përputhshmërinë e politikave të multikulturalizmit dhe integrimin qytetar. Në shumë vende, programet e integrimin qytetar po shtresohen mbi nismat multikulturore të prezantuara më parë, duke prodhuar atë që mund të mendohet si një version multikulturore i integrimin qytetar. Disa vende po përqafojnë versione më të detyrueshme, madje jo liberale të integrimin qytetar (Joppke, 2010), të cilat janë të papajtueshme me një mbështetje multikulturore për diversitetin.

Indeksi i Politikave Multikulturore

Megjithëse multikulturalizmi ndonjëherë mendohet se i referohet vetëm pranisë së diversitetit kulturor në një shoqëri, elementi i dytë thelbësor i multikulturalizmit (pjesëmarrja e barabartë) është po aq i rëndësishëm. Një pikëpamje e multikulturalizmit që merr parasysh vetëm ekzistencën e diversitetit kulturor mund të çojë në shfaqjen e grupeve të veçanta kulturore brenda një shoqërie të larmishme. Diversiteti pa pjesëmarrje të barabartë do të çojë në ndarje ose veçime; pjesëmarrja e barabartë pa diversitet do të rezultojë në asimilimin ose shkrirjen. Në mungesë të diversitetit dhe barazisë, ka të ngjarë të ndodhë marginalizimi dhe përjashtimi, por kur diversiteti dhe barazia janë të pranishme, gjendet integrimi dhe multikulturalizmi.

Indeksi i referohet një grupi specifik politikash të "multikulturalizmit", në të cilin është përcaktuar mënyra se si ato politika përfshijnë një formë njohjeje dhe akomodimi të pakicave, mbi dhe përtej mbrojtjes jo diskriminuese, në bazë të të drejtave politike dhe civile të individit. Ndërsa politikat e multikulturalizmit në këtë kuptim janë një fushë e rëndësishme e politikave publike dhe kontestimeve politike, ato natyrisht nuk janë i vetmi lloj i politikës që ndikon në statusin dhe trajtimin e grupeve kulturore të ndryshme, ose në gjendjen e marrëdhënieve ndërmjet grupeve. Sigurisht që politikat mbi multikulturalizmin dhe statusi i grupeve të ndryshme në një shoqëri gjithashtu ndikohen nga mënyra se si shoqëritë organizojnë tregun e punës dhe shtetin e mirëqenies, për shembull, ose nga mënyra se si janë strukturuar partitë politike dhe përfaqësimi politik, ose edhe nga politikat rreth kontrollit kufitar.


Indeksi i Politikave Multikulturore (Multicultural Policy Index -MPI) është një bazë të dhënash të rëndësishme që përshkruajnë dhe përcaktojnë sasinë e politikave kombëtare të multikulturalizmit (MPI; Banting & Kymlicka, 2006–2012). Ai ka nisur si një projekt kërkimor shkencor që monitoron evolucionin e politikave multikulturore në demokracitë e zgjedhura perëndimore me kalimin e kohës. Përmes grumbullimit të rezultateve të një sërë treguesish të politikave publike përfaqësuese të multikulturalizmit, MPI është një masë e dobishme dhe e saktë e qasjes së një shteti-komb ndaj diversitetit kulturor që ndihmon kërkimin krahasues dhe kontribuon në kuptimin e përgjithshëm të marrëdhënieve shtet-pakicë brenda tendencave moderne të globalizimit dhe migrimit masiv.

Nuk ka asnjë përkufizim të pranuar universalisht për atë se çfarë është një "politikë multikulturalizmi" dhe asnjë linjë të saktë që do të mundësonte dallimin politik ndërmjet MCP-ve dhe fushave të tjera të politikave të lidhura ngushtë me multikulturalizmin, siç janë politikat kundër diskriminimit, politikat e qytetarisë dhe politikat e integritit. Prandaj, çdo listë e MCP-ve ka të ngjarë të jetë e diskutueshme dhe ndoshta arbitrare, sidomos për disa kultura e shoqëri si kjo e jona, me numër të kufizuar politikash. Megjithatë, lista e politikave që ka identifikuar MCP-ja është kryesisht në përputhje me përdorimet më të zakonshme të termit multikulturë si në debatin publik ashtu edhe në atë shkencor dhe ofron një bazë të dobishme për studimin e pretendimeve konkurruese në lidhje me efektet sociale të MCP-ve dhe në lidhje me evolucionin e tyre me kalimin e kohës. Për ndërtimin e këtij instrumenti autorët e MCP-së janë nisur nga premisa se 21 vendet e kampionimit janë demokraci liberale perëndimore dhe si të tilla janë të përkushtuara nga kushtetuta për të ofruar disa të drejta themelore civile dhe politike për të gjithë qytetarët mbi baza jo diskriminuese. Megjithatë, ato ndryshojnë në masën në të cilën shkojnë përtej mbrojtjes jo diskriminuese të të drejtave tradicionale individuale të qytetarisë për të ofruar gjithashtu një formë shtesë të njohjes publike, mbështetjes ose akomodimit për pakicat etnokulturore për të ruajtur dhe shprehur identitetet dhe praktikatat e tyre të dallueshme, që në fakt kërkohet të matet me Indeks MCP.

Indekset përqendrohen në përfundime dhe jo në rezultate sepse matja e rezultateve është metodologjikisht shumë e vështirë. Për të matur efektin shkakësor të një politike, duhet të krahasohet rezultati pas zbatimit të politikës -

i cili është i vëzhgueshëm - me rezultatin që do të kishte ndodhur po të mos ishte zbatuar politika - që nuk është e vëzhgueshme - kështu që nevojitet një kundër fakt. Përveç vështirësive metodologjike të operacioneve të tilla, ato janë me burime intensive dhe për rrjedhojë do të përbënin sfida serioze për objektivat e të pasurit të indekseve në shkallë të gjerë që mbulojnë disa vende dhe vite.

Indeksi i Politikave Multikulturore



Burimi: Banting, K., & Kymlicka, W. (2006–2012). The multicultural policy index. (<http://www.queensu.ca/mcp/>).

Secili prej treguesve të politikave synon të evidentojë një dimension politikash ku shtetet liberal-demokratike përballen me zgjedhjen nëse do të marrin apo jo një kthesë multikulturore dhe nëse do të bëhen më akomoduese dhe mbështetëse për pakicat. Meqenëse MCP-ja synon të njohë mbështesë ose akomodojë diversitetin, është pothuajse e pashmangshme që lloje të ndryshme grupesh të kërkojnë lloje të ndryshme të MCP-ve. Emigrantët e sapoardhur ka të ngjarë të kërkojnë forma të ndryshme mbështetjeje ose strehimi sesa popujt indigjenë që jetojnë në tokat e stërgjyshërve të tyre. Ky Indeks është fokusuar në tre lloje grupesh kryesore që gjenden në shumë demokraci perëndimore: grupet etnike me origjinë emigrante, pakicat kombëtare historike dhe popujt indigjenë. Për secilin prej këtyre grupeve, Indeksi identifikon një sërë politikash që janë

karakteristike ose emblematike të "kthimit multikulturor". Indeksi rendit tetë politika për grupet e imigrantëve (siç është arsimi multikulturor); gjashtë politika për pakicat kombëtare (siç është statusi i gjuhës zyrtare); dhe nëntë politika për popujt indigjenë (siç janë pretendimet për tokën). Studimet tregojnë se ky Indeks kap çështje thelbësore që karakterizojnë kthesën multikulturore në politikat publike përkufizimet e këtyre politikave dhe rregullat për vlerësimin e vendeve individuale dhe gjithashtu pasqyron dhe një kronologji të detajuar të evolucionit të politikave në secilin vend.

Indeksi bazohet në një sërë politikash publike që shihen nga të gjithë palët, si nga kritikët ashtu edhe nga ata mbrojtësit, si emblematikë e kthesës multikulturore. Secili prej tyre synon të evidentojë një dimension politikash, ku shtetet liberal-demokratike përballen me një zgjedhje nëse do të merrnin apo jo një kthesë multikulturore, për të shkuar kështu përtej politikave anti-diskriminuese, për të ofruar njëfarë shkalle njohjeje pozitive, akomodimi dhe mbështetje për pakicat.

Tetë treguesit e përdorur për të ndërtuar Indeksin MCP për pakicat imigrante janë:

- 1) afirmimi kushtetues, legjislativ ose parlamentar i multikulturalizmit, në nivel qendror dhe/ose rajonal dhe komunal;
- 2) adoptimi i multikulturalizmit në kurrikulën shkollore;
- 3) përfshirja e përfaqësimit/ndjeshmërisë etnike në konstituimin e mediave publike ose licencimin e mediave;
- 4) përjashtimet nga kodet e veshjes, qoftë me statut ose nga çështjet gjyqësore;
- 5) lejimi i shtetësisë së dyfishtë;
- 6) financimi i organizatave të grupeve etnike për të mbështetur aktivitetet kulturore;
- 7) financimi i arsimit dygjuhësh ose mësimin në gjuhën amtare;
- 8) veprime afirmative për grupet e pa favorizuara të emigrantëve.

Për secilin tregues, vendet vlerësohen si 0 (nuk ka një politikë të tillë), 0.5 (pjesëshëm) ose 1.0 (politikë e qartë). Rezultatet e komponentëve grumbullohen

më pas, me peshë të barabartë për secilin tregues, duke prodhuar një vlerësim me pikë të vendit që varion nga 0 në 8¹

Evropa përballë politikave multikulturore

Në të gjithë demokracitë perëndimore, ne shohim një prirje drejt rritjes së njohjes së të drejtave të pakicave, qoftë në formën e pretendimeve për tokën dhe të drejtave të traktateve për popujt indigjenë; forcimi i të drejtave gjuhësore dhe autonomisë rajonale për pakicat kombëtare nënshtetërore; dhe të drejtat e akomodimit për grupet etnike me origjinë emigrante. Të gjitha këto ne i quajmë “politika multikulturalizmi”.

Termi *politika multikulturore* mbulon një gamë të gjerë politikash, por e përbashkëta e tyre është se ato shkojnë përtej mbrojtjes së të drejtave themelore civile dhe politike të garantuara për të gjithë individët në një shtet liberal-demokratik, për të zgjeruar gjithashtu një nivel të njohjes dhe mbështetjes publike. që pakicat të shprehin identitetet dhe praktikatat e tyre të dallueshme. Deri në vitet 1950 dhe 1960, shumë shtete perëndimore diskriminonin në mënyrë eksplicite grupe të caktuara racore ose fetare, duke u mohuar atyre të drejtën për të emigruar ose për t'u bërë qytetarë, ose duke i nënshtuar atyre diskriminimit ose ndarjes në aksesin në arsimin publik, strehimin ose punësimin. Ky lloj diskriminimi i qartë i sanksionuar nga shteti është hedhur poshtë dhe shumica e vendeve kanë miratuar gjithashtu masa për të trajtuar diskriminimin nga aktorët jo shtetërorë si punëdhënësit privatë ose pronarët. Miratimi i masave të tilla kundër diskriminimit shpesh diskutohet si një formë e multikulturalizmit apo të drejtave të pakicave, pasi që minoritetet janë përfituese.

Megjithatë duhet evidentuar se ndërsa ne po përdorim termin, multikulturalizmi nuk ka të bëjë vetëm me sigurimin e zbatimit të ligjeve jo diskriminuese, por me ndryshimin e vetë ligjeve dhe rregulloreve për të pasqyruar më mirë nevojat dhe aspiratat e veçanta të pakicave. Për shembull, logjika e antidiskriminimit kërkonte shtrirjen e votës për individët aborigjenë në Kanada në vitin 1960, por ishte një logjikë tjetër që zgjeroi të drejtat e

¹ Përveç rezultateve të përbëra sipas vlerësimit të Indeksit, pikë të veçanta për secilin prej tetë treguesve janë të disponueshëm për të 21 vendet e studiuara në tre kohë (1980, 2000, 2010) në faqen web www.queensu.ca/mcp. Prandaj, studiuesit, nëse dëshirojnë, mund të ndryshojnë peshën e caktuar për secilin tregues.

vetëqeverisjes tek komunitetet aborigjene në vitet 1980, përmes transferimit të pushtetit tek këshillat aborigjenë. Në mënyrë të ngjashme, logjika e anti-diskriminimit kërkon që Sikhis²-tët të punësohen në bazë të meritave në forcën policore, por ndryshimi i kodeve të veshjes së policisë në mënyrë që sikhiset të mund të veshin një çallmë është një kërkesë për akomodim pozitiv. Të drejtat e vetëqeverisjes për aborigjenët dhe të drejtat e akomodimit për Sikhistet janë shembuj paradigme të multikulturalizmit, pasi politikat përkatëse po ripërcaktohen qëllimisht për t'iu përshtatur aspiratave të anëtarëve të grupeve minoritare.

Bashkimi Evropian në vitin 2005 miratoi një grup “Parimesh të përbashkëta bazë për integrimin e imigrantëve”. I pari prej këtyre parimeve është se integrimi është një proces dinamik, i dyanshëm i akomodimit të ndërsjellë nga të gjithë emigrantët dhe banorët e shteteve anëtare. Integrimi është një proces dinamik, afatgjatë dhe i vazhdueshëm i dyanshëm i akomodimit të ndërsjellë, jo një rezultat statik. Kërkon pjesëmarrjen jo vetëm të emigrantëve dhe pasardhësve të tyre, por të çdo banori. Prosesi i integritit përfshin përshtatjen nga emigrantët, burra dhe gra, të cilët të gjithë kanë të drejta dhe përgjegjësi në lidhje me vendin e tyre të ri të banimit. Ai përfshin gjithashtu shoqërinë pritëse, e cila duhet të krijojë mundësi për pjesëmarrjen e plotë ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të emigrantëve. Prandaj, shtetet anëtare inkurajohen të marrin në konsideratë dhe të përfshijnë si emigrantët ashtu edhe qytetarët kombëtarë në politikën e integritit, dhe të komunikojnë qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre reciproke Ndonëse pak e njohur dhe akoma më pak e pranuar, kjo deklaratë e BE-së përmban tre gurët themelore të multikulturalizmit: (1) të drejtën e të gjithë popujve për të ruajtur kulturat e tyre; (2) të drejtën për të marrë pjesë plotësisht në jetën e shoqërisë më të madhe; dhe (3) detyrimin për të gjitha grupet (si ato dominuese ashtu edhe ato jodominuese) për t'u përfshirë në një proces ndryshimi të ndërsjellë. Kërkimet për pranimin e kësaj politike në Evropë sapo kanë filluar. Megjithatë, ka disa studime në këtë fushë (p.sh., van de Vijver, Breugelmans & Schalk-Soekar, 2008) të cilat evidentojnë një ndryshim të evropianët, të cilët

² Besimtarë të lidhur me Sikhizmin, një fe monoteiste që e ka origjinën në shekullin e 15-të në rajonin Punjab të nënkontinentit Indian, bazuar në zbulesën e Guru Nanak.

bëjnë një dallim të qartë midis të drejtës së emigrantëve për të ruajtur kulturat e tyre në mënyrë private (d.m.th., në familjet dhe komunitetet e tyre) dhe të drejtës për të pritur ndryshime në kulturën publike të shoqërisë së vendbanimit. Në pjesën më të madhe të këtij hulumtimi, u zbulua se është e pranueshme të shprehet kultura e trashëgimisë së dikujt në familje dhe në komunitet, por që nukduhet të shprehet në domenet publike, si në institucionet arsimore ose të punës. Kjo pikëpamje është në kundërshtim me parimet bazë të përshkruara nga Bashkimi Evropian, ku procesi identifikohet si një akomodim i ndërsjellë.

Në Evropë sot ka ende vende të shqetësuara me idenë që qytetarët e tyre të kenë identitete të shumëfishta. Në Gjermani dhe Francë, për shembull, kërkesat e natyralizimit thonë se lidhja e tepërt me vendin e origjinës së emigrantëve ose me fenë e tij/saj është arsye për refuzimin e natyralizimit.. Emigrantët nuk ftohen të shtojnë një identitet të ri në identitetin e tyre të vjetër. Përkundrazi, ata duhet të heqin dorë nga identiteti i tyre i vjetër. Ky supozim i nënkuptuar se identitetet e mëparshme duhet të hiqen, ose të paktën të nënshtrohen dhe të fshihen për qëllime publike, pasqyrohet, për shembull, në kodet e veshjes, ndalimi i shtetësisë së dyfishtë ose rreptësia e testeve të natyralizimit. Ndërsa shumica e vendeve kanë një formë të testit të gjuhës si një kërkesë për shtetësinë, disa vende e vendosin këtë nivel njohjeje shumë më të lartë se të tjerët. Disa vende kërkojnë që emigrantët të kenë njohuri të afërta me njohuritë gjuhësore dhe kulturore të vendasve.

Politika të tilla padyshim synojnë asimilimin e plotë, ndërkohë që parandalojnë emigrantët e integruar jo plotësisht të fitojnë shtetësi. Në të kundërt, disa vende i vendosin kriteret shumë më të ulëta, duke kërkuar vetëm një demonstrim të përpjekjeve të mirëbesimit nga ana e emigrantit, dhe nivele të aftësive shumë më të ulta se të lindurit në atë vend, me rezultatin e pritshëm që emigrantët bëhen qytetarë (dhe për rrjedhojë të fillojnë të ndryshojnë shoqërinë) përpara se të jenë të asimiluar. Në këtë kuptim, testet e shtetësisë nuk janë në thelb të papajtueshme me angazhimet multikulturore.

Megjithatë, në pjesën më të madhe të Evropës, ekziston një keqkuptim i zakonshëm se multikulturalizmi nënkupton vetëm praninë e shumë komuniteteve kulturore jo-dominuese në një shoqëri (d.m.th., vetëm komponentin e mirëmbajtjes kulturore), pa pjesëmarrjen dhe përfshirjen e tyre të barabartë në

një shoqëri më të madhe. Është kjo pikëpamje e gabuar që ka bërë që disa në Evropë të deklarojnë se "Multikulturalizmi ka dështuar". Por, një dekadë apo më shumë në Evropë u formulua dhe u trajtua interkulturalizmi, i cili i parapriu debatit aktual të studimet perëndimore në menaxhimin e diversitetit.

Një nga kritikantët më të spikatura të ngritura kundër multikulturalizmit është se ai kontribuon në shfaqjen e enklavave etnike në shoqëritë perëndimore (Simpson 2004; Qadeer 2005; Terzano 2014).

Në diskursin evropian, niveli i detyrimit normalisht diskutohet në termat e ekuilibrit midis të drejtave dhe detyrave (Boervi, 2010). Disa vende kanë zhvilluar qasje vullnetare, të cilat theksojnë të drejtën e emigrantëve për t'u integruar dhe për të ofruar programe mbështetëse. Por vende të tjera e kanë bërë integrimin një detyrë, duke krijuar programe të detyrueshme dhe duke u mohuar emigrantëve aksesin në të drejtat sociale ose rinovimin e qëndrimit nëse nuk arrijnë të kalojnë disa pragje integrimi. Joppke në studimet e tij të shumta mbi multikulturalizmin ka argumentuar jo vetëm se ka pasur një tërheqje me shumicë nga multikulturalizmi, por gjithashtu se modelet e dallueshme kombëtare të trajtimit të emigrantëve po i lënë vendin politikave konvergjente të antidiskriminimit dhe integritimit qytetar (Joppke, 2004). edhe studimet e tij të mëvonshme sjellin të dhëna për një pamje të ndryshme të Evropës.

Zhvillimet bashkëkohore në Evropë nuk mund të errësohen nga kompleksiteti i imazhit politikbërës të multikulturalizmit dhe nga një model i përbashkët i integritimit qytetar evropian. edhe pse njëkohësisht në të gjithë vendet evropiane multikulturalizmi mund të mos jetë tipik, kjo nuk e bën më pak demokratike Evropën dhe politikat e saj. Parimet dhe politikat themelore të një qytetarie multikulturore liberal-demokratike janë të zbatueshme. Referuar studimit të fundit ndërkombëtar të multikulturalizmit në Evropë këto parime dhe politika janë ende të gjalla, aktive dhe të qëndrueshme, edhe pse tani nën titullin e "politikave të diversitetit" ose "dialogut ndërkulturor" ose "kohezionit të komunitetit" apo edhe "integritimit qytetar" (Vertovec dhe Wessendorf 2010).

Ai gjithashtu errëson faktin se një formë e integritimit multikulturor mbetet një opsion i gjallë për demokracitë perëndimore, si në Botën e Re ashtu edhe në Evropë.

Referenca

- Banting, K., & Kymlicka, W. (2006–2012). The multicultural policy index. Retrieved from [http:// www.queensu.ca/mcp](http://www.queensu.ca/mcp)
- Barry, B. (2001). Culture and equality: An egalitarian critique of multiculturalism. Cambridge, MA, USA: Harvard.
- Berry, J. W., Kalin, R., & Taylor, D. (1977). Multiculturalism and ethnic attitudes in Canada. Ot•tawa: Ministry of Supply and Services.
- Berry, J.W. (2011). Intercultural Relations in Plural Societies: Research Derived from Canadian Multiculturalism Policy. *Canadian Ethnic Studies* 43(3). doi:10.1353/ces.2011.0033.
- Borevi, Karin (2010). "Dimensions of Citizenship. European Integration Policies from a Scandinavian Perspective". In Bo Bengtsson, Per Strömlad & Ann-Helén Bay (ed.), *Diversity, Inclusion and Citizenship in Scandinavia*, Newcastle upon Tyne: Cambridge Scholars Publishing.
- "Canada's Multicultural Policies." Understanding Canadian Diversity Edukit, http://www.edukits.ca/multiculturalism/student/diversity_multiculturalism_e.html
- David Bennett (1998). *Multicultural states: rethinking difference and identity*. Psychology Press. ISBN 978-0-415-12159-0.
- Gale, J., & Staerklé, C. (2019). Multiculturalism in classically liberal societies: Group membership and compatibility between individual and collective justice. *Journal of Experimental Social Psychology*, 85, Article 103877. <https://doi.org/10.1016/j.jesp.2019.103877>
- Guimond, S., de la Sablonnière, R., & Nugier, A. (2014). Living in a multicultural world: Intergroup ideologies and the societal context of intergroup relations. *European Review of Social Psychology*, 25. <https://doi.org/10.1080/10463283.2014.957578>
- Jonathan L. Black-Branch; Canadian Education Association (1995). *Making Sense of the Canadian Charter of Rights and Freedoms*. Canadian Education Association. ISBN 978-0-920315-78-1.
- Joppke, C. (2004). The retreat of multiculturalism in the liberal state: Theory and policy. *The British Journal of Sociology*, 55. <https://doi.org/10.1111/j.1468-4446.2004.00017.x>

- Joppke, Christian (2004. 2010). *Citizenship and Immigration*. London: Polity Press.
- Kuzio, T. (2005). Western multicultural theory and practice and its applicability to the Post-Soviet States. *Journal of Contemporary European Studies*, 13, 221-237.
- <https://doi.org/10.1080/14782800500212475>
- Kymlicka, W., & Opalski, M. (2001). *Can liberal pluralism be exported? Western political theory and ethnic relations in Eastern Europe*. New York, NY, USA: Oxford University Press.
- Licata, L., Sanchez-Mazas, M., & Green, E. G. T. (2011). Identity, immigration, and prejudice in Europe: A recognition approach. In S. J. Schwartz, K. Luyckx, & V. L. Vignoles (Eds.), *Handbook of identity theory and research: Volume 2. Domains and categories* https://doi.org/10.1007/978-1-4419-7988-9_38
- M. O. Dickerson; Thomas Flanagan; Brenda O'Neill (2009). *An Introduction to Government and Politics: A Conceptual Approach*. Cengage Learning. ISBN 978-0-17-650042-9.
- Moghaddam, F. M. (2008). *Multiculturalism and intergroup relations: Psychological implications for democracy in global context*. Washington, DC, USA: American Psychological Association.
- R. Schaefer *Sociology: A brief introduction*. New York, NY: McGraw-Hill, 2006.
- Taylor, C. (1992). *Multiculturalism and "The Politics of Recognition."* Princeton, NJ, USA: Princeton University Press.
- Van de Vijver, (2008) F.J.R. Van de Vijver, S.M. Breugelmans, S. Schalk-Soekar. Multiculturalism: Construct validity and stability *International Journal of Intercultural Relations*.
- Verkuyten, M. (2005). Ethnic group identification and group evaluation among minority and majority groups: Testing the multiculturalism hypothesis. *Journal of Personality and Social Psychology*. <https://doi.org/10.1037/0022-3514.88.1.121>
- Vertovec, Steven and Susanne Wessendorf (2010). "Introduction: assessing the backlash against multiculturalism in Europe", in Steven Vertovec and

Susanne Wessendorf, eds., *The Multiculturalism Backlash: European discourses, policies and practices*. London: Routledge.

DR. ERIS RUSI

**DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË
erusi@unkorce.edu.al**

GJUHA ALEGORIKE E FRANC KAFKËS DHE ISMAIL KADARESË

Abstrakt:

Ky punim synon të ndalet në shtresëzimet alegorike gjuhësore që gjenden në veprën letrare të Franc Kafkës dhe të Ismail Kadaresë, duke marrë në krahasim vepratpërkatese “Metamorfoza” dhe “Pallati i ëndrrave”. Punimi do të nisët nga premisa qëalegoria, simbolika dhe gjuha e një kohe “tjetër” ka shërbyer si element dallues i modernitetit në letërsinë e shekullit XX, duke krijuar mekanizmat e një lirie të zgjeruar edhe në kontekstet politike ku censura kushtëzonte hapësirën e shprehjes letrare.

Në këtë punim do të nisemi nga hipoteza që ekziston një lidhje në kohë dhe në hapësirë midis gjuhës alegorike në veprën e Franc Kafkës dhe gjuhës alegorike në veprën e Ismail Kadaresë, kua të përbashkëtat e komunikimit letrar lidhen me një përfytyrim të përbotshëm të njeriut përballë makinerisë së pushtetit, burokracisë dhe zakoneve. Letërsia mund të na komunikojë realitetin e jetës, por vetëm me kusht që këtë ta bëjë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, duke vendosur një largësi midis subjektit të trajtuar dhe objektit që trajtohet, duke krijuar kështu një lloj alegorie letrare.

Nën këtë prizëm, do të analizojmë që:

- a- gjuha e përdorur nga këta dy autorë lidh botën e ëndrrave me botën e realitetit;*
- b- gjuha alegorike nxjerr në pah mungesën e një kohe lineare dhe e zëvendëson atë me kohën ciklike;*
- c- gjuha e një kohe “tjetër” shërben për të krijuar përfytyrimin e një realiteti “tjetër”.*

Fjalë çelës: *alegori, modernitet, komunikim letrar, simbolikë gjuhësore, censurë.*

1. Alegoria si deshifrim i realitetit

Një nga autorët e parë italianë që dalloi rrezikun që sillte trajtimi i drejtpërdrejtë i realitetit, i teorizuar sidomos nga kritikët militantë të neorealizmit, ishte Italo Kalvino. Shkrimtari i afruar me fantastikën italiane, me botën mitologjike, të përrallave, të folklorit, me përqasjen e individit nën ankthin dhe shtypjen e një shoqërie në ndryshim e sipër, teorizoi rrugëdaljen nga ky nënshtrim ndaj realitetit, në ciklin “leksionet amerikane”, duke futur në lojë konceptin e “lehtësisë”.

Për ta ilustruar këtë koncept iu referua mitit të Perseut, heroit antik që vrau Meduzën. Është e njohur që për të vrarë përbindëshin, Perseu duhej të shmangte vështrimin e drejtpërdrejtë të saj në sy, përndryshe do të shndërrohej menjëherë në një statujë guri pa jetë. Strategjia për ta mposhtur Meduzën, ishte ta shihje në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, përmes mburojës-pasqyrë.

Kalvino veçon në këtë hile të Perseut, të njëjtin raport që ekziston ndërmjet shkrimtarit dhe realitetit të botës. Kështu, sipas tij, letërsia mund të na komunikojë realitetin e jetës, por vetëm me kusht që këtë ta bëjë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, duke vendosur një largësi midis subjektit të trajtuar dhe objektit që trajtohet, duke krijuar kështu një lloj alegorie letrare. Lexuesi që arrin të kapë kuptimin e saj, mbërrin te realja, por këtë e bën me shkëputjen e nevojshme të vëzhguesit, i cili duke qenë pak në largësi, mund të kontrollojë efektet e mundshme negative të tekstit.

Ky lloj perceptimi i reales, shtresëzimi i saj, shndërrimi, ngjyrimi tjetër, kalimi nga një gjendje e njohur dhe e kapshme në një realitet që ka nevojë të zbërthehet dhe paraqet dallime të errëta dhe misterioze, është në thelb edhe motori lëvizjes i fantastikes letrare gjatë Nëntëqindtës. Efektet e shumëfishta kuptimore të lëndës letrare, ilustronjë procesin e kërkimit, të identifikimit dhe të mbërritjes në Tjetërvendin letrar, që është hapësira, kontinenti i prekshëm, ku shpërfaqet letërsia me shtresëzime kuptimore të shumëfishta. Alegoria, simbolika, gjuha e një kohe tjetër, me ngjarjet që rrokullisen pas në histori dhe hapësirë, shërbejnë për të mbajtur një këmbë në bashkëkohësi, por pa harruar përmasat e një jete brenda kontureve të ditëve të dikurshme. Brenda “Pallatit të Ëndrrave”, është e mundur të shihet gjithashtu njëhësi i autorit me muret e tekstit letrar. Në çdo alegori të veprës, ndjehet dora e autorit, shihet si përthyhen qëndrimet e tij, që janë edhe qëndrimet lexuesit, edhe kundërshtitë e personazheve, edhe autonomia e dallueshme e krejt veprës letrare.

Ajo kërkon të jetojë përtej jetës së autorit dhe të epokës në të cilën u krijua. Pavarësisht perceptimit që mund të kemi për Kadarenë, si autor shqiptar, ku dallohet origjina dhe përkatësia e tij kombëtare, në rastin e veprave me shtresëzim të fuqishëm alegorik si “Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave”, “Piramidës”, “Gjeneralit të ushtrisë së vdekur” etj, mund të kapërcehen kufijtë e kombëtares,

për të dalë në nocione universale që e afrojnë dhe e ngjasojnë Kadarenë me krijues të tjerë të mëdhenj, në botë dhe në kohë të ndryshme.

Nën këtë arsyetim, kritika e ka përqsuar letërsinë e Kadaresë me prozën e një prej shkrimtarëve të tjerë më të mëdhenj të Letërsisë së shekullit XX, Franc Kafkën, një prej autorëve më të rëndësishëm të letërsisë moderne të shek. XX.

2. “Metamorfoza” kafkiane mes alegorisë, simbolit dhe fantastikes letrare

Kafka shkruante në formë të veçantë, jo lehtë të kuptueshme. Lexuesit nuk ishin të gjithë të kënaqur me dyfishësinë e teksteve të tij. Marrëdhënia me krijimin ishte gati e mundimshme, shkaktonte thujtë vuajtje fizike, pakënaqësi, dhimbje tek lexuesi i tekstit. Por pikërisht ky stil specifik i Kafkës garanton aktualitetin e tij të pandërprerë. Në një artikull të studiuesit Kersten Knipp, ja si vjen përshkrimi i autorit, përmes njëres prej veprave më të rëndësishme të tij, “Metamorfozës”:

“Ja ku shtrihet ai, njeriu i pafuqishëm. Kurrizi i fortë si një zhguall. Kur ngre kokën sheh barkun e tij të fryrë, të murrme dhe këmbët e tij të holla, mjerane i shfaqen para syve të pafuqishme. A është ky trupi i një njeriu? Jo. Është trupi i një insekti gjigant. Një buburreci të pështirë, i cili mbrëmjen e kaluar ishte ende njeri. “Metamorfoza” quhet historia e Kafkës e vitit 1912, rrëfimi ndoshta më i famshëm i tij. Një tekst i frikshëm, shqetësues, për cenueshmërinë e njeriut, pozitën e tij të pasigurt në botë, që brenda një nate mund ta kthejë në pozicion jashtë loje në shoqëri. Por përse e mbështjell Kafka historinë e tij me këtë tis misteri? A nuk mund të rrëfente ndryshe? Në mënyrë “më realiste”, “më të besueshme?”¹

Përse pra shkruan Kafka kaq errët, i vë personazhet e tij përballë situatash, të cilat në realitet nuk ekzistojnë, të paktën të marra fjalë për fjalë? Me këtë mënyrë të shkruari Kafka ia vështirësoi punën vetes, pasi ajo u bë pengesë që ai të pëlqej si autor nga një publik i gjerë, gjatë kohës që jetonte. Me anë të përdorimit alegorik të gjuhës, endjes së mistershme të pluhuros tekstore, Kafka rindërtonte realitetin e jashtëm, por nuk e linte njëlloj me atë çka mund të shihte

¹Kersten Knipp, Franz Kafka - ein literarisches Rätsel, artikull i botuar në versionin online të “Deutsche Welle”, 11.09.2013.

syri i njeriut të zakonshëm, por i qepte edhe fajin, ndijimet, zërin e nënvetëdijes, klithmat e shpirtit dhe pamundësinë e zërit për t'u bërë tingull i jashtëm.

Hapja dhe pranimi i të mbinatyreshme, e të njëjtit lloj, në mënyrë të përshkallëzuar, është modul që spikat në veprën letrare të Franc Kafkës, që skicohet brenda skemës me shpjegime të qarta që në *incipit*. Tek “Gjuetari Grakus” kafkian, gjuetari i ngecur ndërmjet jetës dhe vdekjes si pasojë e një ndëshkimi të pashlyeshëm që e detyron të notojë në përhumbje, hipur mbi një varke funebre që ka humbur drejtimin, nëpër të gjitha vendet e botës, nuk ka drojë që t’i tregojë kryebashkiakut që ka ndër mend ta mirëpresë, gjendjen e tij si vdekur në jetë. Dhe nga ana tjetër as kryebashkiaku nuk shfaq shenjën më të vogël të habitës apo përhumbjes përballë këtij zbulimi skandaloz:

“ - *Ka shumë të ngjarë që edhe ju ta dini që jam gjuetari Grakus, -i foli i vdekuri.*

- *Sigurisht, - konfirmoi kryetari i Bashkisë[...] Ju keni vdekur?*

- *Po, siç po e shihni, - u përgjigj gjuetari.*

- *Por ju jetoni, po ashtu.*

- *Në një farë mënyre. – u përgjigj gjuetari. –Në një farë mënyrë jam ende i gjallë.”²*

Kafka në tregimin “E vërteta mbi Sanço Pançon”, ilustron se si lindin krijimet fantastike të letërsisë së tij. Protagonisti rrëfen që duke shkruar gjatë natës, i jep formë narrative “djallit” të tij (Don Kishotit), mendimeve, anktheve më të frikshme personale, të cilët pasi formësohen, largohen prej tij dhe nisin një jetë të pavarur, duke bërë veprime nga më të çuditshmet, por pa i bërë ndokujt keq ndonjëherë.

Këto figura, mund të themi, lindin në mënyrë të menjëhershme, siç mund të lindë një mendim, siç mund të formohet një ëndërr brenda trurit të njeriut. A nuk ndodh po njëlloj edhe në hapësirat ku ngrihet “Pallati i ëndrrave”? Këto të fundit si ngjizen gjatë natës në nënvetëdijen e njerëzve, bekohen në jetën e ditës së re, kanë autonominë e tyre, por ndryshe nga tregimi kafkian, mund të shkojnë deri

²Kafka, Franz *Il cacciatore Gracco*, në *Tutti i racconti*, përgatitur nga Ervino Pocar, Mondadori, Milano, 1979, f.350.

aty sa t'iu bëjnë keq, krijuesve të tyre. Njëlloj si me krijimet letrare, që mund t'i quajmë edhe ëndrrat e mëdha të njerëzimit, nën regjimin e diktaturave, çdo frymëmarrje intelektuale, çdo ide e individit nën censurë, përgjohej, monitorohej dhe shoqërohej (pas verifikimit) deri në ndëshkimin e ashpër, mizor, të ëndërrimtarit (krijues, artist, njeri liberal me botëkuptim e mendësi ndryshe sistemit).

Sipas studiuesit Thomas Anz, mund të thuhet se Kafka në tekstet e tij, ndodhitë enigmatike që ia atribuon institucioneve si p.sh. gjykatave apo personave të respektit, i praktikon nga ana e vet tek lexuesit, duke ua bërë të vështirë të merren me tekstet e tij. Po t'i rikthehem artikullit të Knipp, mund të veçojmë një dukuri interesante se si u pritën tekstet e para të kësaj forme letrare nga lexuesit e kohës:

“Disa nga lexuesit e tij i ka trazuar ky karakter misterioz. Kështu p.sh. edhe një farë Dr. Siegfried Wolff, i cili e lexoi rrëfimin menjëherë pas publikimit, dhe iu drejtua autorit, Kafkës. "Shumë i nderuar zotëri", i shkruante ai, "Ju më keni bërë të palumtur. Unë bleva 'Metamorfozën' tuaj dhe ia dhurova kushërirës sime. Por ajo nuk arrin ta shpjegojë historinë. Kushërira ime ia dha mamasë së saj, por as ajo nuk diti ta shpjegojë. Vetëm Ju mund të më ndihmoni. Ju duhet ta bëni këtë pasi Ju jeni shkaktari i këtij shqetësimi. Pra Ju lutem më thoni se çfarë duhet të kuptojë kushërira ime nga 'Metamorfoza'.”³

3. Në katin e imagjinare: nga rrathët danteskë tek tmerri i modernes kafkiane

Teoriku çek Lubomir Dolozel ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në trajtimin e raporteve midis botëve fiksonale brenda intertekstualitetit letrar. Sikundër pohon ai:

“Veprat letrare janë të lidhura jo vetëm në nivelin tekstor, por edhe, në mënyrë jo më pak të rëndësishëm, në nivelin e botëve funksionale. [] Këto kalojnë nga një krijues i fiksonit tek një tjetër, nga një periudhë tek tjetra, nga një kulturë në një tjetër akoma, si njësi të zgjatueshme, kur tashmë skeleti, stili, mënyrat e rrëfimit dhe të origjinalitetit fillestar kanë rënë në harresë. Një botë e rrejshme kujtohet më lehtë sesa teksti që i dha

³ Po aty.

mundësinë të dilte në dritë [...] kjo shpjegon atëherë se si intertekstualiteti i qëllimshëm [...] është mbi të gjitha i nënkuptueshëm, ndërsa vijimësia e botëve të rrejtshme është gati përherë e qartë, madje në shumë raste duke e theksuar këtë vijimësi”⁴.

Krijimi i botëve të rrejtshme, i një realiteti tjetër që komunikon përmes forcës imagjinative, i nënkuptuar, kumtet e autorit, mbetet element i rëndësishëm në interpretimin letrar. “Nëpunësi i Pallatit të ëndrrave” të Kadaresë, është shembulli i përsosur i këtij fenomeni në letërsinë shqiptare.

Në qasjen që do t’i bëjmë këtij teksti, do të shohim se si intertekstualiteti i veprës, sugjerohet nga vetë autori i cili bën një përjasje të përfytyrimit të tij me ferrin dantesk. Njëherësh ne do të shtrojmë paralelizmin ndërmjet kësaj dimensionit krijues të Kadaresë dhe mistikës ekzistenciale të Kafkës, ku ankthi ndaj modernitetit është i prekshëm dhe shkakton një kaos brenda rendit të programuar në dimensionin e reales.

Romani “Pallati i Ëndrrave” në fillimin e vet shtrihet që në ngjizjen e tij brenda një simbolike të rrumbullakosur në nënvetëdijen e autorit. Bota e ëndrrës, dimensionin jashtë reales, që është i pakapshëm dhe ushtron fuqi të padukshme në jetën e përditshme, i del shpesh përpara Kadaresë. Siç tregon në ftesë në studio vetë autori, persekutimi nga ëndrrat ka qenë shpesh i tillë, sa veç duke hedhur mëdyshjet, frikën, paqartësinë në letër, duke krijuar veprën e plotë e të mbaruar, atij i mundësohej të shkëputej nga hija frymë-marrëse e ëndrrës:

“ ‘Muzgu i perëndive të stepës’ e ka zanafillën në një ëndërr, ose që të jem më i saktë në përpjekjen time për të qortuar apo modifikuar një ëndërr. Nuk e dija se mund të kishte në planetin tokësor diçka që mund të më shkaktonte aq shumë mall për ta parë edhe njëherë, një mall të papërbalueshëm, nga ata që duket se do të të kartalagjizojnë brinjët, duke t’i kaltëruar, duke t’i kthyer në rreze drite, si në emblemat e firmave kinematografike”⁵.

⁴ Lubomir. Dolezel, Heterocosmica. Fiction e mondi possibili, Milano, Bompiani, 1999, f. 203.

⁵ Ismail Kadare, Ftesë në studio, f. 145

Më tej Kadare tregon se ka pasur një marrëdhënie të pandarë me një ëndërr, të parë në Rusinë e largët. Në një rast ajo duket se tentoi të shkonte tek “Muzgu i Perëndive të stepës”, në një rast tjetër tek “Kush e solli Doruntinën”, në një rast tjetër tek “Kronikë në gur” e në rastin më të përshtatshëm tek “Pallati i Ëndrrave”. Duket se “ëndrra” nistore e Kadaresë është gjendur përpara dilemës, ku të shkonte më parë, ku të ndalej, të hapej, të shtrihej e të vdiste, duke gjetur më në fund vendin e përshtatshëm që mund t’i lëshonte përjetësinë, brenda një pallati, që do të mbante emrin e saj.

Ismail Kadare shfaq detajet e krijimit të veprës “Pallati i Ëndrrave”, duke treguar vërtet shëmbëlltyrën e ferrit, rugëtimin e imazhit nëntokësor, të qullur nga shpirtrat e kobshëm të të mallkuarve, të ndezur flakë nga zjarri mëkatar që nuk flinte kurrë, si një dukuri që përsosmërinë e sajë pat arritur në përfytyrimin e Dante Aligierit. Që në projektin e veprës ishte kërkimi i një strukture që të përngjante me fantastiken e kobshme të nënbotës danteske, por që nevojitej të ishte njëherësh edhe origjinale në tërësinë e vet:

“Kishte kohë që më joshte projektimi i një skëterre. E dija që ishte e vështirë, për të mos thënë e pamundur që pas arkitektëve të mëdhenj të gjertanishëm, anonimëve egjiptianë, Homerit, shën Agustinit, Dantes, të krijoja një projekt origjinal. Ndaj kur nisa të shkruaj “Nëpunësin e Pallatit të Ëndrrave”, ose më saktë kur isha duke menduar kapitujt e mesit, me një hare e frikë njëkohësisht, pashë se pa dashur po realizoja ëndrrën e vjetër: në të gjithë strukturën e romanit tim, si një plan i dytë, spikaste skëterra. Ishte një lloj mbretërie e vdekjes, ku në mos ne vetë, ishte gjumi dhe ëndrrat tona, pra një pjesë e jonë që gjendej ndërkaq matanë, në kohën që ne ndodheshim këtej”⁶.

Përveç dëshirës së patundur për të krijuar humnerën e ëndrrave, Kadare ilustron rrugëtimin nga një botë tek tjetra, shënjon kufirin, këtej dhe andej, iu jep flatra tokësore, reale, ëndrrave të pakapshme të nënndërgjegjes së njeriut, e si i

⁶ Po aty, f. 175

tillë realizon mitin e udhëtimit të madh, të transportimit të fantastikes nga dimensionin i të njëmendtës, te faqja e panjohur e të panjëmendtës⁷.

Mes “Komedisë Hyjnore” dhe “Pallatit të Ëndrrave” ekziston një raport i ngushtë komunikues. Siç tregon studiuesi Gilles Banderier, bëhet fjalë për “[...] disa rrjedha, të shpjegueshme ose jo, si një lumë që zhduket diku, për t’u shfaqur gjetiu – një gjetiu sa hapësinor dhe kohor”⁸.

Pikërisht dimensionin hapësinor “gjetiu”, është Tjetërvendi i alegorisë letrare. “Nëpunësi i Pallatit të ëndrrave” e jep realitetin e kohës dhe të njerëzve të saj prapa metaforave të tilla të gatshme si “pallati i ëndrrave”, nëpunësit dhe interpretuesit e tyre, ëndrra kolektive dhe individuale, ëndrra fatsjellëse dhe rrezikndjellëse, ëndrra e rëndomtë dhe bash-ëndrra. Të gjitha këto Kadaresë ia ofroi mekanizmi i ndryshkur i shtetit të fuqishëm të perandorisë otomane në fundin e tij. Shtresëzimet kohore të “Nëpunësit”, përkundër natyrës së shumëfishtë kuptimore të një sërë veprash të tjera të autorit, lidhen me raportin themelor që qëndron në boshtin e romanit: raporti i individit me shtetin, më saktë raporti i individit që ka ambicien të integrohet në strukturat shtetërore dhe që e gënjen mendja se do të fuqizojë veten prej fuqisë së pushtetit, por në të vërtetë, duke e parë nga brenda këtë ngrehinë të përbindshme, ai njih dobësinë dhe

⁷ “Te Pallati i ëndrrave”, si në asnjë roman tjetër të Ismail Kadaresë, madje rrallë, edhe në letërsi të tjera, është njësh e njëmendta me të panjëmendtën (irealen), e besueshmja me të pabesueshmen, e zakonshme me absurden, paradoksalen dhe grotesken, e përcaktuara me të papërcaktuarën, rrëfimi i drejtpërdrejtë me rrëfimën simbolizues të shkallës së lartë, në përmasat dhe në nivelin e një alegorie parabolike shumë të shtrirë”, Bashkim Kuçuku, në “Kadare – Vepra”, Shtëpia botuese “Onufri”, vëllimi 11, Tiranë, 2009, f. 252

⁸ Gilles Banderier, “Pasqyra e Dantes” artikull i botuar në “L’Oeil de boeuf”, Paris, 2000, i përfshirë në përmbledhjen “Kadare – Vepra”, Shtëpia botuese “Onufri”, vëllimi 11, Tiranë, 2009, f. 239-242. Në të njëjtin artikull Banderier thekson që: “[...] Ka disa ngjashmëri që janë fare të dallueshme dhe të vetëdijshme (mes Dantes dhe Kadaresë) [...] Kadare flet fillimisht, në mënyrë domethënëse, për “kate”, pastaj për “rrathë”. Në katin e gjashtë dhe të fundit (më i keqi): “të çkombësuarit”, tradhtarët e gjuhës amtare; në të nëntin – dhe të fundit – rreth Ferrit: tradhtarët ndaj familjeve të tyre, atdheut të vet apo bujtësve të tyre. [...] Ferri te Dantja dhe më shumë te Kadareja është një figurë plotërisht (totalite). Ai thuhet se mbivendoset botës, duke u shtirë gjithashtu në kohë dhenë hapësirë, njëherazi horizontal dhe vertikal.”

pafuqinë e tij, sheh peshën mbytëse të strukturave gjigante të makinës perandorake, e cila ndryshon vetëm nga përmasa fizike, por jo nga mënyra e të ushtruarit të artit të shuarjes së identitetit njerëzor.

Kjo ndodh në gjithë historikun e tekstit, pasi në të kundërt mungesa e plotë për të kuptuar dhe për të verbalizuar imazhet, do të përkonte me shkatërrimin në themel të Tabir Sarajit (Pallatit të Ëndrrave). Do të shohim se Kadare procedon në të njëjtën gjueti të transformimit të mureve të ndërtesës, në një organizëm të gjallë, që lëviz me gjithë kthinat e tij si një përbindësh i vetëm, i kompozuar nga fillimi në fund me misteret, intrigat, kurthet, ankthet, ulërimat e kzistencës së sipërme e të nëntokëshme të njeriut. Paralajmërimi dhe kërkimi me ngulm i të nesërmes është për bazë në këtë institucion të çuditshëm, unik në llojin e tij:

“[...]Ideja e Sovranit për krijimin e Tabir totalit u mbështet në atë që Allahu e hedh ëndrrën kumtuese mbi globin tokësor në po atë mënyrë të shkujdesur siç hedh ylberin apo rrufenë, apo afron befaz një kometë, që kushedi nga ç’thellësi të mistershme të gjithënjës e tërheq. [...] Prandaj ky pallat i ëndrrave nuk është ëndërr, por një nga bazat e shtetit tonë. [...] Sepse, në kontinentin e përnatshëm të gjumit gjenden drita dhe terri i njerëzimit, mjalti dhe helmi, madhështia dhe mjerimi i tij”⁹.

Romani “Pallati i Ëndrrave”, ka gjendjet, kushtëzimet, marrëdhëniet, tangjentet, unin e shkrimtarit, gjendjen e tij, qëllimet e tij dhe imazhet e tij. Ai është ngritur mbi një simbolikë alegorike dhe ironie bashkë. Në këtë hapësirë, e cila në të shumtën e rasteve është e kamufluar, njehsohet dhe gjendja e autorit. “Pallati” ka një përqendrim në të cilin autori përpiqet ta zhvillojë ngjarjen përmes reflektimit psikologjik-shpirtëror të Mark-Alemit, i cili reflekton konturet e Tabir Saraj, punon e jeton brenda ndërtesës ku reflektohet hija e madhe e një institucioni që sa vjen e merr nga gjumi i protagonistit, duke i shtuar ankthet dhe ditët e vështira të ekzistencës mbi botë.

Le të marrim, në këtë pikë, një nga ëndrrat e para që i bie të lexojë nëpunësi Mark-Alem:

⁹ Ismail Kadare, “Vepra” cit. f. 275.

“[...] Një mace e zezë kishte kapur në gojë hënën dhe po vraponte e ndjekur nga turma. Gjithë udhës nga ikte, dukeshin gjurmët e hënës së plagosur”¹⁰.

E para që krijohet tek lexuesi është ndjesia e gjakut, përkuqja e tokës që në vrapin e maces, sa vjen e bëhet më e errët, pasi drita e mekur, e plagosur, është me macen vetë: hëna që regëtin e dobët në dhëmbët e saj. Pa u futur në simbolikën e ëndrrës dhe interpretimin, ky shembull vlen edhe për ëndrra të tjera, që nuk janë thjesht elementë të mbartu brenda një simbolike që ka nevojë të zbërthehet. Përkundrazi ëndrrat janë të gjalla po aq sa dhe personazhet e tjerë, prej mishi e prej gjaku, në tekst.

Ato kanë një liri absolute për të vendosur fatin e së nesërme, e kjo është qasja imagjinare, fantastikja e rrëfimit që i shpirtëzon jo vetëm objektet tashmë (si Tabir Saraji – organizëm përbindësh), por edhe esencën magjike të fillimbotës, të mbërthyer brenda pellgut nënvetëdijësor të individit. Pushteti i tyre është i ndjeshëm, fati dhe jeta e ëndërruesit varet nga mënyra si do të lexohen ato. Duket sikur autonomia e ekzistencës është në duart e imagjinatës dhe të misterit që fle në kontinentin e ëndrrave.

Kulloj kalimi i pushtetit, i forcës, i ekzistencës nga njeriu tek ëndrrat e tij, plotësohet me një tjetër lloj metamorfoze që ndodh brenda mureve të këtij pallati që ngrihet mbi fatet e botës: shndërrimi i njeriut në objekt. Kjo jo vetëm nëse konsiderojmë parëndësinë e individëve të veçantë, që merren për bazë veç në funksion të ëndrrës së tyre, por brenda labirintit të pallatit, në shkallaret, katet, dyert e tij, njerëzit mund të njehsohen me objekte pajetë, siç ndodh p.sh. në takimin e nëpunësit me eprorin e tij:

“[...] Po sytë e zyrtarit vazhdonin të vështronin derën në lartësinë e rrezes dhe, megjithëse e dinte tashmë atë zakon të tij, një çast besoi se ai priste dikë tjetër përpara se t'i njoftonte atë gjë për të cilën e kishte thirrur.[...] Zyrtari për herë të parë ia nguli sytë Mark-Alemit, por jo në fytyrë, diku te mesi i tij, aty ku duhej të ndodhej rezja, në qoftë se Mark Alemi do të ishte derë”¹¹.

¹⁰ Po aty, f. 302.

¹¹ Po aty, f. 327.

Mund të flasim për një lloj ftohtësie postmoderne e dalluar kryesisht në letërsinë evropiane pas viteve '80 të shekullit të kaluar, ku objektet jetëzoheshin dhe merrnin dimensione njerëzore, ndërsa individët ishin të destinuar të nguroseshin e të zbrazeshin nga shpirtërorja dhe njerëzorja ekzistenciale e tyre.

Ky lloj përshkrimi i protagonistit, një derë që qëndronte më këmbë, për të kaluar nga një anë, tek ana tjetër e labirintit brenda pallatit, mund të orientojë analizën në konsiderimin e gjithçkaje që merrte frymë nën peshën e pushtetit perandorak, si të pajetë, të pavlerë, të kontrolluar e të lëvizshme, veç për t'u përkulur, në mëshimin e duarve të pushtetit mbi dorezën e dalë në pah. Ndjesia e ftohtësisë, e frikës së turbullt e misterioze, përhapet dhe e pushton protagonistin që e pranon në mendimet e tij, kurthin e pallatit që merr frymë:

*"[...] Përbindësh, tha ai me vete, duke u habitur dhe vetë me mllëfin e papritur. S'të mjaftojnë të tjerat, por na hëngërke dhe njerëz"*¹².

Përfundime

Franc Kafka mund të etiketohet dhe të pranohet gjerësisht si një nga profetët më të rëndësishëm në panoramën e letërsisë botërore të shek. XX; si autori që i parapriu realitetit të mesit të shekullit të kaluar e të mëvonshëm, si p.sh. njeriu i kontrolluar nga të gjitha anët apo njeriu i torturuar. Njeriu nuk është asgjë në botën moderne. Të paktën si person ai vlen pak. Në radhë të parë është e rëndësishme që e gjitha, pra shoqëria në përgjithësi të funksionojë. Ky besim gjeti shprehje ekstreme në lëvizjet totalitariste të shekullit të XX-të: nacional-socializmi dhe komunizmi.

Me të njëjtën shtysë, një pjesë e rëndësishme e krijimtarisë letrare të shkrimtarit Ismail Kadare i dhe frymë idesë së "fajit kolektiv", të njeriut që humb personalitetin dhe individualitetin e vetvetes, pasi futet në humbëtitat e sistemit, kafshohet nga morsa e burokracisë dhe përjeton ndjesitë më të errëta e të çuditshme brenda vetes, pa qenë dot e mundur që t'i shkëputet fajit (apo ndëshkimit).

Të gjithë janë të fajshëm, por faji asnjëherë nuk është i kapshëm, real, i gjendshim dhe i prekshëm me dorë. Është në formën e ëndrrave, derdhet në trutë

¹² Po aty, f. 350.

e njerëzve gjatë gjumit të tyre, planifikon ndryshimin e të nesërme, krimin e së ardhmes, padrejtësinë e kohës, e në këtë ngjan me ortekun e vrullshëm që merr për poshtë dhe këput të parën, jetën e ëndërrimtarit. Nën këtë optikë, sulmi ndaj sistemit, ndaj ligjësisë të diktaturës e burokracisë që vegjetonte në këtë regjime, përkon me amullinë, ankthin, frikën e njeriut kafkian, nga bota shpërfillëse, e ligjeve dhe rregullave që cenonin, ngushtonin, ulnin deri në një apati frymëmarrëse, tavanin e qiellit, të kohës, të lirisë, mbi shpinën e njerëzve.

Pikërisht ky ngushtim i hapësirës, deri në izolimin total të gjymtyrëve të njeriut për të lëvizur i lirë, është zgjatimi që më shumë nga të gjithë lidh e mban afër shkrimtarin gjerman me autorin shqiptar.

Si Kafka, po ashtu edhe Kadare, në disa prej veprave më përfaqësuese të tyre denoncojnë, por nuk i japin dot goditjen e pritshme marrëdhënies krejtësisht të shtrembëruara midis të drejtës së njeriut dhe të drejtës së shtetit. Tregon që kjo e fundit nuk mund të ekzistojë nën regjim, sikundër dhe liria e individit është e papërfillshme kur ky zbrazet nga personaliteti i tij dhe shndërrohet në thjesht një emër.

Ku është pesha e personazheve, hija që lëshon shpirti i tyre nën dritën e ekzistencës? Përmes tjetërvendit letrar, në kohë të ndryshme, dy autorët tregojnë sa e vështirë dhe e pamundur ngjan jeta e njeriut nën qiellin e shekullit XX. institucionet, burokracitë, formale e ferrit dhe ndëshkimet penale, nëse i përziejmë dhe i ngatërrojmë fijet e veprave, do ngjajë aq e afërt të këmbejmë individin e Kafkës, që gjykohet dhe procedohet pa e marrë dot vesh konkretisht fajin e tij, me të përgjumurit e humbur të Perandorisë osmane, që kanë bërë faje të rënda në jetë-vdekjen e tyre, në pragun e gjumit kur kushdo, edhe më i miri, i buti, i dashuri i njerëzve, ka të drejtë e mund ta kryejë një krim.

Ajo që stimulon afrimin mes këtyre dy autorëve është edhe kompleksiteti i figurave të ndërtuara në veprat e tyre: shndërrimi, transformimi jetëzimi i krijesave në krijesa të tjera, i mureve të gurtë, në përbindësia alegorikë, përmes përdorimit të një gjuhe sa të thjeshtë aq dhe të mistershme, që nuk e thotë kurrë deri në fund të vërtetën që mund të pritët të dalë në dritë.

Është një lloj refleksi, ku idetë, imazhet, ndijimet, pasqyrohen si në lojën e shëmbëllimeve, duke tërhequr dhe shtyrë njëkohësisht vëmendjen e lexuesit. Edhe kur duket sikur mund të zbardhet në fund tisi i misterit, është e njëmendtë

që do të jetë i pamundur kuptimi tërësor i tij. Përmes kapërcimit të fantastikes, Tjetërvendit letrar, reflektimit në forma të ndryshme, mes transformimeve të njëpasnjëshme, të skenave, personazheve, botëve reale, dy autorët fragmentarizojnë kuptimin e tekstit, i japin nuanca alegorie çdo domethënieje, duke krijuar kështu ndjesinë e diçkaje të madhe, e kumtit të mistershëm që qëndron i varur pezull mbi ekzistencën e njeriut.

E gjithë kjo realizohet nëpërmjet përdorimit të një stili të zhveshur nga zbukurimet e tepërta, thelbësor, aq sa fjalët mbeten në buzët e lexuesit dhe sikur ai të dojë t'i shqiptojë, do mund të nxjerrë veç tinguj të vetmuar, që aq larg mund të jenë nga e vërteta personale e individit në izolim. Në këtë kontekst, megjithatë, duhet të shtojmë që imazhet e letërsisë së këtyre dy autorëve nuk shkojnë drejt interpretimit si të përmyllura e të padepërtueshme. Një lexim interpretues, që e zhvesh tekstin nga alegoritë, shpesh çon në përfundimin e kërkimit, në gjetjen e një bote të brendshme të individit, që ndryshon aq shumë nga eksperiencia e jashtme e botës, që nuk mund të përkthehet dot lehtë me fjalë, por kodifikohet vetëm përmes simboleve dhe metaforave.

Bibliografi

- Barthes, R. (2004). *Teoria e tekstit*, Fjala.
- Çausi, T. (1993). *Universi letrar i Kadaresë*, “Dituria”, Tiranë.
- Çausi, T. (2002). *Kadareja përmes pasqyrave*, “Onufri” Tiranë.
- Dado, F. (2006). *Teoria e veprës letrare. Poetika*. “Toena”, Tiranë.
- Di Gesù, M. (2005). *Palinsesti del moderno. Canoni, generi, forme nella postmodernità letteraria*, Mondadori, Milano.
- Eliade, M. (1963). *Myth and Reality*, “Harper & Row, Nju York.
- Kadare, I. (2007) *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, “Onufri”, Tiranë.
- Mandala, M. (2016). *Për një botim kritik të Nëpunësit të pallatit të ëndrrave*.
- Kafka, F. (1979). *Il cacciatore Gracco*, në *Tutti i racconti*, Mondadori, Milano
- Kafka, F. (2002). *La metamorfosi e tutti i racconti pubblicati in vita* (Vol. 22). Feltrinelli Editore.
- Kafka, F. (1979). *The Basic Kafka* (Vol. 82561). Simon and Schuster.

PROF. DR. OEMAL MURATI

INSTITUTI ALBANOLOGJIK

gemalmurati@hotmail.com

E DREJTA NATYRORE VS E DREJTA LIGJORE PËR GJUHËN NË MAQEDONINË E VERIUT

Abstrakt

*Shekulli 21 paraqet një moment të rëndësishëm për të reflektuar qasje të tjera pozitiviste për gjuhën, për bashkëjetesë linguistike, që ata që flasin një gjuhë tjetër të mos konsiderohen armiq, por miq. Nuk e ka thënë kot **semiologu i njohur francez Claud Lévi-Strauss** se “**Gjuha është mënyra e parë për të vendosur rendin në botë**”. Gjuhët në thelbin e tyre krahasohen me urat, që i lidhin popujt e nuk i ndajnë, e jo me muret, që krijojnë barriera. Gjuha krahasohet me lirinë. “Ata që nuk pranojnë lirinë e të tjerëve, nuk meritojnë as lirinë e tyre” (Abraham Lincoln). E rrjedhimisht: Ata që nuk pranojnë gjuhën e të tjerëve, nuk meritojnë as gjuhën e tyre. Mund të thuhet se maqedonasit kanë qenë populli që më së shumti e kanë ndier peshën e mohimit të gjuhës dhe të kombësisë së tyre, e e ndiejnë edhe sot (kombi maqedonas dhe maqedonishtja kontestohen nga Bullgaria). Dhe, për paradoks, ata janë sot që ushtrojnë të drejtën e tyre si “shumicë” për t’u dhënë të drejta gjuhësore të tjerëve me pikatore. Të drejtat gjuhësore hyjnë në korpusin e të drejtave universale të popujve, ato as nuk mund të jepen e as nuk mund të merren, përveçse nga shtetet jodemokratike e diktatoriale.*

Për mbrojtjen e nevojshme kushtetuese dhe ligjore të gjuhëve, shqipja nuk është një gjuhë e kufizuar në disa dhjetëra mijëra folës dhe maqedonishtja nuk është një gjuhë që flitet nga dhjetëra milionë njerëz në RMV, por këto dy gjuhë fliten nga një numër pothuajse i barabartë i folësve të gjuhëve respektive. Çfarë do të humbisnin maqedonasit sikur gjuha shqipe të jetë e barabartë në frymën e kushtetutës me maqedonishten? Asgjë. Por, çfarë do të fitonin? Maqedonia si shtet do të bëhej më e hapur dhe më demokratike, çdo shtetas i kësaj Republike do të ishte më i pasur në komunikimet e ndërsjella qytetare, ekonomike, tregtare, politike, kulturore e shkencore – edhe me një vlerë tjetër rajonale e botërore, dhe shqiptarët e maqedonasit do ta kuptonin më mirë njëri-tjetrin dhe do të kishin më pak ose aspak mëri me njëri-tjetrin.

Maqedonia e Veriut - Rajoni me pasurinë më të madhe të gjuhëve në Europë

Maqedonia e Veriut është vendi me pasurinë më të madhe të gjuhëve dhe të bashkësive etnike në Evropë dhe, paradoksalisht, është vendi me demokraci më të pazhvilluar linguistike në Evropë, kur e drejta për përdorimin zyrtar të gjuhës së tjetrit ende shikohet me racizëm dhe primitivizëm. Sikurse vëren sllavisti i

njohur Volf Oshlis: “Në Maqedoni, përveç maqedonasve, jetojnë dhe 23 bashkësi të tjera etnike”, fakt që përbën një dukuri të rrallë në Evropë, ku në një vend kaq të vogël të fliten aq shumë gjuhë (në provincën Dobruxa të Rumanisë, me 3 milionë banorë, jetojnë 17 bashkësi etnike (Antić 2007: 126). Dy gjuhët themelore që fliten këtu janë: maqedonishtja dhe shqipja.¹ Me Kushtetutë, vetëm maqedonishten është sanksionuar si gjuhë zyrtare në tërë territorin, kurse shqipja dhe gjuhët e tjera me status lokal. E drejta për gjuhën e tjetrit mbetet ende një problem në Maqedoni, një paranojë dhe frustrim se ajo e rrezikuaka maqedonishten (!), që është krejt e kundërt me kahet evropiane, ku mëton të hyjë dhe Maqedonia si shtet. Kjo bie ndesh edhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare.

Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe Minoritare/ Evropska povelja o manjinskim i regionalnim jezicima (The European Charter for Regional and Minority Languages), e propozuar në 1992 dhe miratuar gjashtë vjet më vonë në Strasburg, ilustron situatën gjuhësore dhe kulturore që Ballkani e ka shfaqur për shekuj, se shumëgjuhësia, së bashku me shumëkombësinë, nuk mund të neglizhohen, mohohen apo çrrënjosen, pavarësisht nga aktivitetet kulturore,

¹ Ballkanologu i njohur gjerman Gustav Weigand në veprën e tij të famshme “*Ethnographie von Makedonien: Geschichtlich – nationaler, sprachlich-statistischer Teil* (Lajpcig, 1924), përkthyer edhe në bullgarisht: Вайнгад, Густав, *Етнографија на Македонија*, Превод Елена Пипилева), për përbërjen etnike të Maqedonisë në çerekun e parë të shekullit XX (1924) theksonte: “Maqedonia është e populluar nga nacionalitete të ndryshme, të cilat në bazë të numrit të popullsisë radhiten: bullgarë, turq, shqiptarë, grekë, arumunë, spanjollë. Pjesa tjetër, përfshirë edhe serbët, janë aq të paktë në numër, saqë dalin jashtë vëmendjes sonë.”

Në këtë tablo etnike në Maqedoni, siç mund shihet, nuk ekzistojnë fare “maqedonasit”, të cilët sot hiqen si “pronarë” të Maqedonisë, dhe ngulin këmbë kundër gjuhës shqipe! “*Qysh rilindësi i shquar Gjorgje Pulevski në shek. e 19-të, të periudhës osmane, me Fjalorin e tij në tri gjuhë (Речник од три језика / Фјалџор Нка тре јуха / Љугат уч лисаниден од Ѓорѓи Пулевски од 1875 г.)*, artikulonte faktin se atëherë, Maqedonia ka qenë dhe është shumëgjuhësore dhe shumëkulturore, pra fliste për natyrën e Maqedonisë shumëgjuhësore, si themel për bashkekzistencë ndërmjet popujve” (Fridman 2009). Ndërkohë që maqedonasit e sotëm projektojnë Maqedoni monolinguale e monokulturore.

politike dhe gjuhësore që po zhvillohen në një shoqëri, dhe se gjuhët kombëtare ose mbizotëruese nuk kanë qenë kurrë të vetme, absolute dhe të pacenueshme, por shumë gjuhë të tjera minoritare dhe rajonale kanë bashkëjetuar (dhe ende bashkëjetojnë) me to. Kjo duhet të kuptohet si një *sine qua non* edhe në Maqedoninë e Veriut.

Maqedonia ka qenë shumëgjuhëshe në vazhdimësi, dhe kjo ka kushtëzuar shfaqjen dhe zhvillimin e një identiteti gjuhësor të veçantë të bashkësitë e ndryshme etnike, i cili, nga njëra anë, dallohet qartë nga identitetet e etnive të tjera, por nga ana tjetër, tregon ngjashmëri të konsiderueshme me to.

Njohësi i mirë i gjuhëve, i mentalitetit, i historisë dhe i rrjedhave shoqërore në Ballkan, sociolinguisti dhe ballkanologu i shquar amerikan Viktor Fridman, thotë se:

“Nga pikëpamja gjuhësore, konstatohet se popujt mund të jetojnë mirë së bashku, pasi vetë ngjashmëritë gramatikore të gjuhëve në Ballkan, apo edhe dasitë e tyre, tregojnë se popujt kanë jetuar së bashku dhe mund të vazhdojnë bashkëjetesën. Mua më duket se shumëgjuhësia është pasuri. Në vendet ku njerëzit e etniteteve të ndryshme jetojnë së bashku, ata mësojnë gjuhët e njëri-tjetrit, për shembull Dibra, ku maqedonasit dhe shqiptarët i flasin gjuhët e njëri-tjetrit. Derisa njerëzit të kuptojnë se shumëgjuhësia është një pasuri, atëherë nuk do të ketë asnjë problem në bashkëjetesën mes tyre.”

Këto postulate nuk janë kuptuar drejt nga pushteti maqedonas, i cili që prej themelimit të këtij shteti (1991) ka promovuar dhe zbatuar njëgjuhësinë, përdorimin e maqedonishtes si gjuhë e vetme zyrtare në gjithë territorin e Maqedonisë, kundruall shumëgjuhësisë, ku gjuha shqipe dhe gjuhët e bashkësive të tjera etnike kanë status të dorës së dytë.

Gjuha dhe diskriminimi gjuhësor në RMV

Një nga postulatet thelbësore për të drejtat e njeriut për gjuhën është: *Sa më shumë gjuhë, aq më mirë* (Polis 1996: 44). E kundërta, njëgjuhësia ose mbivlerësimi i një gjuhëve karshi të tjerave në bashkësitë shumetnike, shumëgjuhësore e shumëkulturore, që po promovohet në disa shtete, si p.sh. në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është linguistid dhe kulturocid. *E drejta për gjuhën nuk është diçka që dikush duhet t’ua japë të tjerëve, por diçka që nuk*

mund t'ua mohojë. Kështu, edhe e drejta për gjuhën në RMV nuk është diçka që dikush duhet t'ua japë shqiptarëve me përbindje, siç po eksperimentohet nga establishmenti politik maqedonas, por diçka që askush nuk mund t'ua marrë. Shumëgjuhësia është një pasuri e paçmuar për njerëzimin, për të promovuar inkluzivitet (përfshirje) dhe për të luftuar diskriminimin. Porse, më shumë se si vlerë, në shumë shtete dhe vende kjo shpeshherë është kuptuar, e kuptohet edhe sot, në të kundërtën e saj, në urrejtjen dhe luftimin kundër gjuhës së tjetrit, siç është rasti dhe në Maqedoninë e Veriut.

Duke trajtuar çështjen e shumësisë së gjuhëve dhe të popujve, historiani i madh i ideve Arno Borst (1913) thotë se:

“Vetëm në saje të një përgjithësimi të vonë qeniet njerëzore që flasin të njëjtën gjuhë konsiderohen miq, ndërsa ata që flasin një gjuhë tjetër konsiderohen armiq” (Hobsbaum 1996: 57).

Mbi bazën e këtij postulati, është krijuar dhe ajo që Borns e quan *“nacionalizëm filologjik”*, shikimi i gjuhës me dy palë syze: glorifikimi i gjuhës vetjake dhe urrejtja e gjuhës së tjetrit, që vazhdon të bëhet edhe sot.

Shembullin më tipik për këtë mund të thuhet se e kemi në Ballkan dhe në Maqedoninë e Veriut shumëgjuhësore, ku ata që flasin një gjuhë tjetër ende konsiderohen si armiq. E do të duhej të ishte ndryshe. Na kujtohet të gjithëve ai slogani i famshëm i artikuluar nga studentëria e Shkupit: *“Panta rei, ali jazikot ne”* (çdo gjë rrjedh, çdo gjë ndryshon, por gjuha, jo). Me aluzion të qartë: çdo gjë mund të pranohet në Maqedoni, por gjuha shqipe jo! Tanimë, situata gjuhësore në Maqedoninë e Veriut, tri decenie më pas, ka avancuar në njëfarë shkalle, porse mendësia e animoziteti ndaj gjuhës së tjetrit, jo.

Gjuha është mënyra e parë për të vendosur rendin në botë

Shekulli 21 paraqet një moment të rëndësishëm për të reflektuar qasje të tjera pozitiviste për gjuhën, për bashkëjetesë linguistike, që ata që flasin një gjuhë tjetër të mos konsiderohen armiq, por miq. Nuk e ka thënë kot **semiologu i njohur francez Claud Lévi-Strauss** se *“Gjuha është mënyra e parë për të vendosur rendin në botë”*. Gjuhët në thelbin e tyre krahasohen me urat, që i lidhin popujt e nuk i ndajnë, e jo me muret, që krijojnë barriera. Gjuha krahasohet me lirinë. *“Ata që nuk pranojnë lirinë e të tjerëve, nuk meritojnë as lirinë e tyre”* (Abraham Lincoln). E rrjedhimisht: Ata që nuk pranojnë gjuhën e të tjerëve, nuk

meritojnë as gjuhën e tyre. Mund të thuhet se maqedonasit kanë qenë populli që më së shumti e kanë ndier peshën e mohimit të gjuhës së tyre, e e ndiejnë edhe sot (kombi maqedonas dhe maqedonishtja kontestohen nga Bullgaria). Dhe, për paradoks, ata janë sot që ushtrojnë të drejtën e tyre si “shumicë” për t’u dhënë të drejta gjuhësore të tjerëve me pikatore. Të drejtat gjuhësore hyjnë në korpusin e të drejtave universale të popujve, ato as nuk mund të jepen e as nuk mund të merren, përveçse nga shtetet jodemokratike e diktatoriale.

Maqedonasit – të ngarkuar rëndë me intolerancë ndaj gjuhës së tjetrit

Nacionalizmi filologjik primitiv në RMV, i kultivuar për një kohë të gjatë, nuk është fashitur as sot e kësaj dite, ende ka një urrejtje patologjike kundër gjuhës së tjetrit. Çështja e përdorimit zyrtar të gjuhëve në RMV, nga bashkësitë e ndryshme etnike që bashkëjetojnë në këtë rajon, akoma vazdon të jetë e mbarsur me atavizmat e së kaluarës dhe rrjedhimisht të ketë një tablo të zymtë. Ja disa shembuj që e ilustronjë këtë.

1. Situata gjuhësore, pas pavarësisë së Maqedonisë në vitin 1991, *shenjon statusin e maqedonishtes si gjuhë e vetme zyrtare dhe statusin e shqipes si gjuhë e dytë zyrtare në zonat ku flitet nga të paktën 20% e qytetarëve*. Kjo situatë në fushën e të drejtave linguistike nuk është aspak demokratizim, por është thellësisht diskriminuese. Dhe, për më tepër, linguistët maqedonas, - të ngarkuar rëndë me intolerancë ndaj gjuhës së tjetrit, - e ndiejnë si një fatkeqësi që pas vitit 2001 maqedonishtja është e “dyzuar” me shqipen në fushën e të drejtave gjuhësore:

“Za žal, po 2001 godina, makedonskiot standarden jazik e prinuden da bide “vo dvojestvo” so albanskiot jazik na svojata teritorija, vo republika Makedonija”

/ Fatkeqësisht, pas vitit 2001, gjuha standarde maqedonase u detyrua të jetë “e dyzuar” me gjuhën shqipe në territorin e saj, në Republikën e Maqedonisë/ (Tanturovska 2013: 23, 30).

“Ekspertët” e gjuhës maqedonas, përdorimin e kufizuar të shqipes me Marrëveshjen kornizë të Ohrit e shohin jo si një e drejtë gjysmake që u është cenuar shqiptarëve, por, për më tepër, si “kufizim” të maqedonishtes:

“Objektivisht, përdorimi i gjuhës maqedonase në komunikimin publik është i kufizuar. Nuk është më gjuha e vetme zyrtare në të gjitha organizatat themelore të sistemit. Marrëveshja Kornizë vërteton se gjuha maqedonase është zyrtare në të gjithë territorin e Maqedonisë, por gjithashtu thuhet se në rajone me popullsi të pakicave shumicë (kryesisht, shqipe), gjuha e asaj popullate është gjithashtu në përdorim zyrtar. Edhe pse ky pozicion nuk u pëlqen maqedonasve, ata e pranuan atë për hir të "paqes në shtëpi", si pasqyrim i rrethanave objektive” (Stamatoski 2004: 190).

Është paradoks i llojit të vet që “ekspertët” e gjuhës maqedonase barazojnë gjuhën me territorin – e kujt është gjuha, i tij është dhe territori. Ata harrojnë, nga historia dhe e tashmja, se në shtetin e ri që quhet Republika e Maqedonisë (sot RMV), nuk është vetëm maqedonishtja në territorin e vet, por është edhe gjuha shqipe në territorin e vet dhe se kjo gjuhë nuk është aty me qira. Fatkeqësia është se tendencat për njëgjuhësi në Maqedoninë shumëgjuhësore e multikulturore ka sfond të Institutit të gjuhës maqedonase dhe të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve (MANU), që është një skizofreni institucionale. U pëlqen apo nuk u pëlqen maqedonasve, duhet të kuptohet ky fakt relevant: shqipja është në truallin e saj në RMV e jo në truallin e maqedonasve dhe është një nga gjuhët themelore që flitet nga një e treta e popullsisë, e po kështu është edhe një kryegjuhë që flitej në këto hapësira në Ballkanin antik, së paku nja një mijë vjet përpara maqedonishtes së sotme. Konventa e Këshillit të Europës 1992, shumëgjuhësinë e ka pranuar si parim të ndërtimit të Europës së Bashkuar, ndërsa RMV edhe sot dëshiron të promovojë shtet unitar maqedonas dhe njëgjuhësinë maqedonase në një vend me pluralitet gjuhësh e kulturash, që për shumëgjuhësinë është quajtur “rajoni më ballkanik i Ballkanit”.

Shqipja në menden e urrejtjes

2. Për lojërat stupide që bëhen me gjuhën në RMV, lexojmë në medie tituj e fraza të tilla:

“I riu shqiptar ndalohet nga polici maqedonas dhe nuk dëshiron të flasë maqedonisht” (titull, 29.30.2020).

“Derisa polici po i komunikonte disa rregulla në gjuhën maqedonase, i riu shqiptar i është përgjigjur se e kupton krejt çka po flet, por nuk dëshiron të flas në gjuhën maqedonase”.

Ai është thirrur në të drejtën e përdorimit të gjuhës së tij amtare, që garantohet edhe me ligj.

Qytetarë maqedonas kanë reaguar bujshëm përmes një videoje, duke theksuar se ja ku e solli vendin, *Ligji i miratuar për gjuhët*, që zyrtarizoi gjuhën shqipe” - përcjell INA. Në këtë tablo, qytetarët maqedonas reagojnë bujshëm sepse *u paskan dhënë shumë të drejta gjuhësore shqiptarëve* (e kush janë ata që japin të drejta!), *kurse shqiptarët i keqpërdorin këto të drejta!*

Për mbrojtjen e nevojshme kushtetuese dhe ligjore të gjuhëve, shqipja nuk është një gjuhë e kufizuar në disa dhjetëra mijëra folës dhe maqedonishtja nuk është një gjuhë që flitet nga dhjetëra milionë njerëz në RMV, por këto dy gjuhë fliten nga një numër pothuajse i barabartë i folësve të gjuhëve respektive.

Në ndërtimin e identitetit shtetëror e kushtetues, *Ligji i miratuar për gjuhët*, statusin e gjuhës shqipe e ka avancuar, por nuk e ka zyrtarizur si gjuhë të barabartë me maqedonishten. Prandaj dhe frustrimi i të riut shqiptar kundër gjuhës maqedonase nuk është thjesht shprehje kundër kësaj gjuhe, por është shprehje e asaj që gjuha e tij amtare shqipe, që është vënë në mengenen e urrejtjes prej kohësh, vazhdon të ndihet e tillë edhe sot, qoftë te maqedonishtfolësit e qoftë

dhe te qarqet politike maqedonase. Klasa politike maqedonase vazhdon t’i mëshojë elementit të funksionit *simbolik të gjuhës* – identifikimi i maqedonishtes me shtetin si gjuhë kryesore zyrtare në gjithë territorin e IRM, kurse gjuhë zyrtare është edhe ajo që flitet nga 20 për qind e popullsisë. Pra, statusi i gjuhës te maqedonasit shihet *si kod për dominim*, kurse te shqiptarët *si kod për barabarësi*.

Në kontekstin linguistik, dy janë funksionet themelore të gjuhës – *funksioni i komunikimit dhe funksioni simbolik*. *Funksioni i komunikimit* është sigurisht më thelbësor, dhe aty ndërthuren dhe funksionet e tjera, duke përfshirë aspektin simbolik si mjet për identifikimin e grupeve, d.m.th. manifestimin e përkatësisë në grupe të caktuara shoqërore (etnike, kombëtare, fetare). (Bugarski 1995: 26). Vili Brand (1913-1992) – kancelar i Republikës Federative të Gjermanisë (1968-1974) dhe fitues i Çmimit të Nobelit për Paqe 1971, për aspektin komunikues të gjuhës sjell këtë shembull përmbajtjesor:

“Në qoftë se unë blej diçka prej teje, ti duhet të flasësh në gjuhën time. Por në qoftë se unë të shes ty diçka – unë jam i detyruar të flas në gjuhën tënde.”

Shqipja si “gjuhë e huaj” në plëngun e vet në Maqedoninë e Veriut

3. Si reflektim i integritimeve evropiane, edhe Maqedonia e Veriut ka filluar të demokratizohet edhe në gjuhë, porse ky demokratizim lë shumë për të dëshiruar. Ministrja e Arsimit dhe Shkencës, Milla Carovska, promovoi konceptin e ri të arsimit fillor me të cilën sigurohet *inkluzivitet, multikulturalizëm dhe tolerancë*. Një segment nga koncepti është përmes procesit arsimor fëmijët nga mosha e hershme t`i mësojnë vlerat e vërteta qytetare, t`i respektojnë dallimet dhe të nxjerrin një shoqëri për të gjithë, ku: *Gjuha shqipe do të mësohet si gjuhë e huaj*.

Vetë nocioni “*shqipja si gjuhë e huaj*”, që mbetet akoma ide prijëse e politikës shtetërore (maqedonase), për një inxhiniering të ri etnik maqedonas, nuk shpreh *inkluzivitet*, por *ekskluzivitet*, dhe si i tillë është i gabuar dhe i helmon nxënësit, sepse i ndan gjuhët në dy kategori: “gjuha jonë” (maqedonase) dhe “gjuhë e huaj” (shqipe). Shqipja në Maqedoni nuk mund të trajtohet si një *gjuhë e huaj*, d.m.th. e një populli të huaj që jeton në RMV, por si *gjuhë joamtare* te maqedonasit, sepse kjo është gjuhë rrënjëse që e flasin pothuajse gjysma e popullsisë së këtij shteti, dhe është një ndër gjuhët kryesore të Ballkanit dhe të Evropës. Kurrkund në botë nuk mund të trajtohet gjuha e shumicës si *gjuhë e jona*, e gjuha e pakicave si *gjuhë e huaj*. Kjo, për faktin e thjeshtë, se: “*Gjuha shqipe s’është e armikut po e një populli shtetformues në Maqedoni. Pa shqiptarët nuk ka Maqedoni*” (Edi Rama).

Gjuha shqipe në RMV nuk është gjuhë e një pakice të thjeshtë

4. Po kështu, edhe Kryeministri maqedonas, Z. Zajevev, do të deklaronte publikisht: *Gjuha shqipe është gjuhë e dytë zyrtare në Maqedoni!* Ky formulim lavdërues përmban në vete dy kute: në një anë shqipja gjuhë zyrtare, në anën tjetër “gjuhë e dytë”. Gjuha shqipe në truallin e saj në Maqedoninë e Veriut nuk është gjuhë e një pakice të thjeshtë, siç është ajo ta zëmë në Serbi (ku edhe atje flitet në Parlament), por është gjuhë e një popullate themelore konstitutive të këtij shteti. *U pëlqen apo nuk u pëlqen maqedonasve, shqipja është në truallin e saj në Maqedoninë e Veriut e jo në truallin e maqedonasve dhe është një nga gjuhët*

themelore që flitet nga një e treta e popullsisë, e po kështu është edhe një gjuhë që flitej lashtërisht në këto hapësira në Ballkanin antik, së paku nja një mijë vjet përpara maqedonishtes së sotme. Gjuha shqipe duhet të ketë status të barabartë me gjuhën maqedonase, dhe, konform të drejtave linguistike europiane, shqipja duhet të jetë gjuhë e parë atje ku flitet nga një popullsi shumicë shqipfolëse, dhe maqedonishtja duhet të jetë gjuhë e parë atje ku flitet nga një popullsi shumicë maqedonishtfolëse.

Në fushën e të drejtave gjuhësore, një paradoks të llojit të vet përbën edhe emërtimi i gjuhës shqipe me përshkrime numerike, pra jo me emrin e saj të vërtetë, por si *Gjuha që e flasin 20 për qind e popullsisë* (me aludim për shqipen). Por çka nëse kjo përqindje mund të jetë 19.99 ose 30 për qind? Në qoftë se gjuhët në RMV do të emërtohen me përshkrime numerike ose me përshkrime të tjera, atëherë edhe për gjuhën “shumicë” maqedonase të tjerët do të mund të përdornin cilësimin “*gjuha që e flet popullsia maqedonase e cila nuk ka ekzistuar me këtë emër para vitit 1944*” (siç e cilëson zëvendëskryeministri bullgar Krasimir Karakaçanov).

Në qoftë se koncepti i Maqedonisë ekziston, atëherë ai duhet të bazohet në njohjen e ndërsjellë dhe barabarësinë e gjuhëve

5. Barazia e gjuhëve është barazia e popujve dhe anasjelltas. “Zvicra e vogël asgjë nuk humbet... ngaqë nuk ka një gjuhë të vetme zyrtare” (V. I. Lenin). Edhe në rastin e Maqedonisë Veriore, ky shtet i vogël, i quajtur për shumësinë e gjuhëve “Zvicra e Ballkanit”, asgjë nuk humbet me barabarësinë gjuhësore, andaj nuk duhet të promovojë me këmbëngultësi një gjuhë zyrtare të vetme (maqedonishten) dhe një gjuhë me status të dytë (shqipen). Në librin e tij “*Evropa u jeziku*” (2009), linguisti i njohur Ranko Bugarski jep këtë konstante të qëndrueshme për shumëgjuhësinë:

“Mbaj qëndrim pozitiv në lidhje me shumëgjuhësinë dhe multikulturalizmin, të cilat janë gjendja natyrore e pjesës më të madhe të njerëzimit dhe një burim i pasurisë, jo kërcënim për identitetin vetjak. Të pranojmë Evropën, diversitetin dhe vlerat e saj si një atdhe i zgjeruar gjuhësor, kulturor dhe shpirtëror” (Bugarski 2009: 55).

Ndërkaq, semiologu i shquar italian Umberto Eco thoshte:

“Në qoftë se koncepti i Evropës ekziston, atëherë ai është i bazuar në njohuritë e ndërsjella të gjuhëve.”

Rrjedhimisht, në qoftë se koncepti i Maqedonisë ekziston, atëherë ai duhet të bazohet në njohjen e ndërsjellë dhe barabarësinë e gjuhëve dhe të mos shikohet gjuha e tjetrit me syrin e ciklonit. *Gjuhët në Maqedoni nuk duhet të mitologjizohen, të antikizohen dhe të arkeologjizohen, por të funksionalizohen dhe të kenë status të barabartë në përdorimin publik. Më në fund, “duke njohur të Tjerët, ne njohim Vetveten”* (Hadži 2013: 12). Pasojisht, duke njohur gjuhën e Tjetrit, ne njohim edhe kulturën e tjetrit, por njohim më mirë gjuhën Tonë. Kurrkujt nuk i vjen e keqja nga gjuha e tjetrit, por nga mbivlerësimi i gjuhës vetjake dhe mohimi i gjuhës së tjetrit.

Gjuha nuk është vetëm mjet komunikimi, por edhe identitet e kulturë. Plicubicistit Vele Mitanski gjuhën e tij amtare maqedonase e përkufizon kështu:

“Gjuha nuk është vetëm një çështje e drejtshkrimit dhe e drejtpërdorimit. Gjuha është qëndrimi ndaj traditës, angazhim ynë për të ardhmen. Gjuha është një çështje e nderit dhe dinjitetit, një çështje e ligjshmërisë. Gjuha është një nga simbolet siç është flamuri, siç është stema, siç është himni kombëtar. Edhe më shumë se kaq. Absolutisht: gjuha për ne do të jetë atdheu i fundit, siç ka qenë thelbi i ekzistencës sonë, kur ne nuk kemi pasur atdhe në kuptimin e një shteti të organizuar.”

Absolutisht, edhe gjuha shqipe është identitet edhe për shqiptarët në truallin e tyre të quajtur Republika e Maqedonisë së Veriut. Prandj *“Sa më shumë gjuhë, aq më mirë bashkëjetoher”* (Victor Friedman).

Në vendet normale, gjuhët shërbejnë që njerëzit të kuptohen, jo për të krijuar probleme” (Mariano Rajoy). Por duket se Maqedonia është e destinuar të ecë gjithmonë në linjën e kundërt.

Statusi i shqipes në Maqedoninë e Veriut është më i keq se statusi që ka pasur gjuha shqipe në Maqedoninë socialiste të Titos

6. Statusi i shqipes në Maqedoninë e Veriut sot është më keq se statusi që ka pasur gjuha shqipe në Maqedoninë socialiste të Titos. Për këtë mund të sillen fakte të shumta të përdorimit shumë të kufizuar të shqipes në të gjitha format dhe

Ilojet e komunikimit të shkruar e të folur: në emërtimet e rrugëve, në tabela, reklama, sinjalet rrugore, receta mjekësore, fatura, bileta; ajo ka një përdorim të përgjysmuar në Kuvendin e Maqedonisë; nuk lejohet në aeroportin e Ohrit, as në ushtrinë maqedonase, as në Gjykatën Kushtetuese. As në vendkalimet kufitare që ndajnë Kosovën me Maqedoninë. Aty mund të shkruhet vetëm maqedonisht dhe anglisht, por jo dhe shqip, paçka se kufiri ndan përmes dy popullsi shqiptare, e për rrjedhojë kufirin e kalojnë kryesisht shqiptarët e Maqedonisë që shkojnë në Kosovë dhe, anasjelltas, shqiptarët e Kosovës që hyjnë në Maqedoni. Burimi i kësaj anomalie është tek orientimi antishqiptar i klasës politike maqedonase, e cila “urrejtjen për gjuhën e tjetrit” (shqipes) e ka injektuar te popullata maqedonase, aq sa nëpërkëmbja e gjuhës shqipe dhe diskriminimi institucional i saj është bërë detyrë kombëtare maqedonase! Këtë mund ta konkretizojmë me një konstatim të tillë se, sipas disa sondazheve të bëra publike, 99 për qind e shqiptarëve të Maqedonisë mund të komunikojnë në gjuhën maqedonase, por vetëm 3 për qind e maqedonasve mund të komunikojnë në gjuhën shqipe. Ky diskriminim i gjuhës shqipe është sanksionuar edhe në legjislacionin themelor të shtetit maqedonas, në kushtetutë e në ligje të tjera. Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë gjuha shqipe as nuk përmendet me emër: aty flitet për gjuhë zyrtare (të shkallës së parë), e cila është maqedonishtja, dhe gjuhë tjetër zyrtare, d.m.th. të shkallës së dytë, që është shqipja, apo për “gjuhë që e flet 20 për qind e popullsisë”; madje, edhe në Marrëveshjen e Ohrit shqipja përmendet vetëm në dy raste, ndërsa në 6 raste ajo zëvendësohet me shprehjen: “çdo gjuhë që flitet nga të paktën 20% e popullsisë”.

Duke iu referuar statusit që kanë gjuhët e pakicave në Shqipëri dhe në Kosovë, si dhe politikat gjuhësore në shtete shumëgjuhëshe, si Zvicra, Finlanda etj., madje edhe në ish-Jugosllavi, ku gjuha zyrtare shihej si kod i barabarësisë, mund të vërehet se në Maqedoni gjuha zyrtare shihet si kod për dominim, prej nga buron edhe modeli i centralizmit gjuhësor-politik që zbatohet në praktikë. Këto e bëjnë Maqedoninë vendin me pasurinë më të madhe të gjuhëve në Europë dhe me shkeljen më të madhe të të drejtave të përdorimit zyrtar të gjuhës së tjetrit. Kjo politikë gjuhësore në një shtet me jo më pak se 23 gjuhë është anakronike dhe e dëmshme. Në këto rrethana, shqipja zyrtare “është vetëm një eksperimentim dhe simulim dhe se deri në zyrtarizimin e saj nevojitet edhe

shumë kohë dhe një politikë më këmbëngulëse shqiptare” dhe se, pas amnistisë politike të vitit 2001, “nevojitet edhe amnistim i gjuhës shqipe”. Po kjo kërkon që klasa politike shqiptare në Maqedoni të luftojë më me këmbëngulje për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Kushtetuta, Marrëveshja e Ohrit dhe legjislacioni i vendit për gjuhën, duke kërkuar edhe përmirësime e plotësime të këtij legjislacioni. Për ta bërë këtë, ajo duhet të mbështetet në ekspertizën e gjuhëtarëve që merren me çështje të politikave gjuhësore dhe që njohin situatën gjuhësore në Maqedoni, qofshin këta shqiptarë apo të huaj. Nga ana tjetër, popullsia maqedonase duhet të çlirohet nga mendësitë primitive nacionaliste, nga urrejtja për gjuhën e tjetrit dhe të kuptojë se shumëgjuhësia është një pasuri. Atëherë nuk do të ketë asnjë problem në bashkëjetesën e etnive të Maqedonisë.

Shqiptarët në Maqedoni nuk janë minoritet, nuk janë pasardhës migrantësh apo pushtuesish, nuk janë një fenomen i përkohshëm dhe efemer. Ata jetojnë, punojnë, prodhojnë histori, shoqëri, ekonomi e kulturë në këto troje që prej kohësh të pambamendshme (Zaimi 2015). Ata prodhojnë edhe gjuhën e tyre shqipe, e cila nuk mund të mohohet e të injorohet nga shteti i ri shtalib maqedonas, siç është injoruar dhe mohuar padrejtësisht deri tani.

Paraardhësit tanë ballkanas nuk e urrenin gjuhën e tjetrit

7. Paraardhësit tanë ballkanas e njihnin mirë gjuhën e tjetrit, ushqenin respekt për gjuhën e tjetrit, kanë lënë një thesar gjuhësh që ne të komunikojmë me të tjerët. Dhe, mbi të gjitha, nuk e urrenin gjuhën e tjetrit. Porse janë elitat e sotme politike, kulturore dhe intelektuale, individë a grupe shoviniste ata që shfaqin mëri e shovinizëm ndaj gjuhës së tjetrit. Me këtë mënyrë të komunikimit me mendësi dhe imazhe intolerante ndaj gjuhës së tjetrit, ballkanasit janë bërë delja e zezë e Europës dhe e zeza e vetvetes.

Autori serb Dushan Nedeljković, i cili në fillimin e shekullit XX i kishte studiuar tiparet etnopsikologjike të popullatës së Rekës së Epërme, thotë se rekanasit gjuhët i mësonin jashtëzakonisht lehtë.

“Pothuajse të gjithë rekanasit e rritur flisnin së paku tri gjuhë. Ndokush dinte nga pesë deri në shtatë gjuhë, përveç maqedonishtes dhe shqipes, fliste edhe greqisht, romanisht, frëngjisht, anglisht” (Nedeljković 1934: 85).

Pra, edhe një popullsi rurale dinte 5 deri 7 gjuhë, në një vis krejtësisht të izoluar malor të Korabit. Kurse sot, maqedonasve u mjafton vetëm maqedonishtja, e shqiptarëve vetëm shqipja!

Në Maqedoni ka një paradoks të tillë lingvistik: minoritetet i flasin të gjitha gjuhët, pra janë shumëgjuhësorë; romët flasin romisht, maqedonisht dhe shqip; turqit – turqisht, maqedonisht e shqip; shqiptarët: shqip dhe maqedonisht; arumunët: arumanisht dhe maqedonisht; kurse maqedonasit flasin vetëm maqedonisht. Kush është i diskriminuar në këtë rast? Në Maqedoninë shumëgjuhësore, ku gjuhët janë pasuria më e madhe e këtij vendi, sigurisht humbësit janë vetë maqedonasit që nuk i kuptojnë të tjerët rreth e rrotull tyre e kapardisen vetëm në gjuhën e vet.

A mund të gjendet diçka tjetër më shumë “ballkanike” (mes të egërve ballkanas) se kur shikon kështu këtë pasqyrë të kotësisë së vetvetes dhe kur dehesh nën tingujt e mohimit të gjuhës së tjetrit? Njerëzit në Ballkan rendin të gjithë pas specifikave të tyre imagjinare, kush pas këngës së vet, kush pas fshatit të vet, kush pas kërthizës së vet. E kush pas mohimit të gjuhës së tjetrit. Këtu qëndron gjithë dallimi me një studiuese si Maria Todorova që këmbëngul se nuk flet për Ballkanin, por “Ballkanizmin”, d.m.th. për imazhin në përgjithësi të papajtuësëm dhe në përgjithësi negativ të Ballkanit në kulturën perëndimore, si dhe për paradokset e referimeve kulturore të supozuara (Albert Doja, *Ballkani midis fantazisë imagjinare dhe realitetit, Le Courier des Balkans*).

Linguisti i madh danez Otto Jespersen (1860-1943) qysh në vitin 1922, në reflektimet e tij për njerëzimin, popullin dhe individin nga këndvështrimi lingvistik, shprehej:

“Shkencëtari në fushën e gjuhës dhe të letërsisë, posaçërisht njeriu që merret me popujt e civilizuar të kohës sonë, ka dhe për detyrë të luftojë kundër sëmundjes së tmerrshme – nacionalizmit, i cili është aq larg nga patriotizmi sa njëri pol nga tjetri: thelbi i patriotizmit është dashuria – dashuria për vendin, popullin dhe gjuhën, dhe kjo mund të jetë e lidhur me ndjesinë e miqësive dhe simpative ndaj popujve të tjerë. Kurse shënjuesi thelbësor i nacionalizmit është antipatia, përbuzja dhe së fundi urrejtja ndaj gjithë asaj që është e huaj, vetëm pse është e huaj...” (Jespersen 1970: 6).

Maqedonasit nuk humbin asgjë që gjuha shqipe të jetë e barabartë me maqedonishte, por fitojnë shumë

8. Rruga për në Evropën demokratike e shumëkulturore nuk kalon vetëm përmes ndërrimit të emrit mitik Maqedoni, të kushtëzuar nga fqinji grek në Maqedonia e Veriut, por në radhë të parë përmes diversitetit linguistik, jo të dominimit të një gjuhe zyrtare në një shoqëri shumetnike, sikundër është Maqedonia e Veriut. Sot, në shekullin 21, ka ardhur koha kur nuk mund të mendohet si në periudhën e komiteteve ekzekutive të komunizmit jugosllav, kur imponohet me direktivë nga lart poshtë, dhe as të mendohet me mendësi mitike “të antikizimit maqedonas”, por me realizëm.

Maqedonia e Veriut nuk mund të ndërtohet dhe të ekzistojë si një shtet monolingual dhe monokulturor, për sa kohë që ky është një vend plurilingual dhe multikulturor.

Procesi i centralizmit gjuhësor-politik është i shekujve të kaluar (zë fill qysh në shek. 16 dhe vijon për disa shekuj), por ai nuk vlen për shek. 21. Këmbëngulja në mëtimin që maqedonishtja të jetë gjuhë e vetme zyrtare në Maqedoninë e Veriut, duke e kthyer gjuhën në simbol të bashkimit kombëtar-shtetëror, në kushtet e sotme është anakronik dhe i dëmshëm.

Çfarë do të humbisnin maqedonasit sikur gjuha shqipe të jetë e barabartë në frymën e kushtetutës me maqedonishten? Asgjë. Por, çfarë do të fitonin? Maqedonia si shtet do të bëhej më e hapur dhe më demokratike, çdo shtetas i kësaj Republike do të ishte më i pasur në komunikimet e ndërsjella qytetare, ekonomike, tregtare, politike, kulturore e shkencore – edhe me një vlerë tjetër rajonale e botërore, dhe shqiptarët e maqedonasit do ta kuptonin më mirë njëri-tjetrin dhe do të kishin më pak ose aspak mëri me njëri-tjetrin.

BIBLIOGRAFI

Antić 2007 = Antić – Stojčevska Vera, *Stranskite slavisti za Makedonija i za makedonskiot jazik*, Skopje, 2007, 126.

Bugarski 1995 = Bugarski, Ranko, *Jezik od mira do rata*, SlovoGRAF, Beograd, 1995.

Bugarski 2009 = Bugarski, *Evropa u jeziku*, Beograd, 2009.

- Hadži 2013 = Hadži, Požgaj Vesna, *Jezik između lingvistike i politike*, Beograd 2013.
- HJP = Hrvatski Jezički Portal.
- Ismajli 1979 = Ismajli, Rexhep, *Platoni dhe mendimi mbi gjuhën në antikë, 4, "Prishtini", 1979.*
- Kiznije 1996 = Kiznije, Zh., *Etnologija Evrope*, Beograd, 1996.
- Klajn 1980 = Klajn, Ivan, *Jezik oko nas*, Nolit, Beograd, 1980.
- Kordić 2016 = Kordić, Snježana, *Jezična prošlost u službi politike*, Peščanik.net, 17.11.2016.
- Kordić 2017 = Kordić, Snježana, *Nacionalizam u školi: zakonom protiv istine*, N1, 9.10.2017.
- Maleska 1997 = Maleska, Mirjana, *Etničkiot konflikt i prilagoduvanjeto (Makedonija 1991-1997)*, Kultura, Skopje, 1997.
- Murati 2019 = Murati, Qemal, *Kulturë gjuhe e komunikimi dhe gramatikë drejtshkrimore*, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, 2019.
- Nedeljković 1934 = Nedeljković, Dušan, *Gornjorekanska etnopsihološka grupa*, Glasnik Skopskog Naučnog Društva, knj. XIII, Skopje, 1934.
- Polis 1996: Polis – Revistë mbi artin e jetës publike, 1996.
- Stamatoski 2004 = Stamatoski, Trajko, *Makedonskiot jazičen identitet*, Kultura, Skopje, 2004.
- Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot, Konferencë shkencore, Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2003.
- Tanturovska 20013 = Tanturovska, Lidija, *Jazičen beležnik*, Institut za makedonski jazik "Krstе Misirkov" – Skopje, Skopje, 2013.
- Тантуровска 2014 = Тантуровска, Лидија, *За идентитетот на македонскиот јазик*, Институт за македонски јазик „Крсте Мисирков“, Скопје, 2014.
- Zaimi 2015 = Zaimi, Arbër, *Barazia, e domosdoshme për mbijetesën e Maqedonisë*, Gazeta "Shqip", 13.7.2015.

SEANCA II

GJUHËT NË KONTAKT

PROF. DR. DHIMITRI BELLO

**DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE LETËRSISË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”
dhimbello@yahoo.com**

NE DHE TË TJERËT- NGJASHMËRI, NDRYSHIME DHE PARAGJYKIME

Abstrakt

Një shekull më parë, Gustav Vajgandi, studiues i njohur i gjuhëve dhe i çështjeve të Ballkanit, shkruante kështu: “Vetëm dy prej shteteve evropiane, dhe këto thuhet më të voglat-Portugalia dhe Danimarka, konceptet “komb” dhe “kombësi” përputhen plotësisht; të gjitha të tjerat kanë në përbërjen e vet kombësi numerikisht të ndryshme, të cilat, të gjitha së bashku formojnë kombin”. Ky përfundim është në hyrje të një prej veprave të shumta të tij, që merr në shqyrtim etnografinë e një rajoni mjaft të diskutueshëm në çdo kohë.

Përbërjet e ndryshme; ne dhe të tjerët; “rivaliteti” mes tyre; epërsia ndaj tjetrit; historia jonë e pasur përkundrejt tjetrit “pa histori e lavdi”, paragjykimi për tjetrin, sipas mendësisë së kohës etj., kanë sunduar dhe, për fat të keq, vazhdojnë të manifestohen edhe në periudhën bashkëkohore ndër popujt e Ballkanit. Probleme këndvështrimesh historike për tjetrin dhe për veten, huazime dhe ndryshime historish ose figurash historike, kriza e thellë identitare, pasojë e ngushtësisë së marrjes së informacionit dhe mungesës së objektivitetit, konflikte në trajtime të ndryshme shkencore, kanë sjellë përplasje deri në përmasat e tragjikes. Shumica e një vendi shpesh është e prirur që të anashkalojë faktin se një pjesë e vogël e popullsisë flet një gjuhë të ndryshme nga e tyrja, manifestojnë një tjetër kulturë, besojnë në një zot tjetër nga ai që beson shumica, duke vendosur kështu shenjën e pabarazisë midis tyre.

Po cila është shumica dhe pakica, pjesa dhe e tëra, çfarë përfaqësojnë ato, çfarë vendi zënë në hapësirën shoqërore në të cilën jetojnë, sa të vetëdijshëm janë për përkatësinë e tyre etnike dhe fetare?

Historia ka treguar se vetëdija për një përkatësi të caktuar në kohë dhe rrethana të caktuara mund të ndryshojë shumë shpejt.

Fjalë kyçe: komb; kombësi; epërsi; paragjykim; gjuhë; huazim; përkatësi etnike; përkatësi fetare

Formati i kësaj konference ka të bëjë me pakicat në Ballkan. Kjo është një temë mjaft e gjerë, gjithmonë e hapur për gjykime, paragjykime e sugjerime dhe që nuk mund të shterje, të paktën për një kohë relativisht të gjatë. Se çfarë

përfaqësojnë këto bashkësi dhe emërtimet lidhur me to, cilësimet dhe etiketimet, ka një shumësi variantesh, shpeshherë të ndryshme dhe të kundërta me një-tjetrin.

Problemet fillojnë qysh me pjesën e përkufizimit të këtyre komuniteteve, të cilat veçohen nga pjesa tjetër e shoqërisë në bazë të disa tipareve e veçorive që i karakterizojnë, dhe që asnjëherë nuk kanë qenë e nuk janë njëloj në të gjitha vendet, madje, në të shumtën e rasteve, të papranuara nga përfaqësuesit e këtyre komuniteteve. Vetë kriteret që përdoren si elemente argumentuese për të përcaktuar saktë këto koncepte, janë të ndryshme.

Po përqendrohemi pak te minoritetet. Ç'janë minoritetet dhe sa mund të jetë numri i tyre në një rajon të caktuar? Ky është dhe do të mbetet një problem i përhershëm në gadishullin e Ballkanit. Vështirësitë që lidhen me konceptin “minoritet” dhe numrin e tyre të saktë janë të mëdha. Edhe nëse kufizohemi thjesht në Shqipëri, sërish nuk mund të dalim në një përfundim të saktë. Duke nisur që nga terminologjia e përdorur për shenjimin e tyre dhe për të vazhduar më pas në përcaktimin e saktë të numrit të minoriteteve, të shtrirjes dhe të historive përkatëse, përsëri nuk mund të arrijmë në një përfundim të pakontestueshëm nga palët.

Në këtë kumtesë po sjellim si shembull vetëm dy studiues shqiptarë që janë marrë me minoritetet në përgjithësi dhe më shumë me pjesën e Shqipërisë, Arqile Bërxoli me veprën e tij “Minoritet në Shqipëri”, botim i vitit 2005 dhe Beqir Meta në “Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri 1912-1924”. Që të dy kanë perceptime të ndryshme, qoftë për vetë emërtimet e këtyre komuniteteve, qoftë edhe për strukturën përbërëse të minoriteteve në vendin tonë. Bërxoli përcakton disa tipologji minoritetesh, si: *minoriteti komb*, *minoriteti i fuqishëm*, *minoriteti i ngushtë dhe minoriteti i paformuar*. (Bërxoli 2005: 21, 22, 23,24). Këto popullsi të grupimeve të vogla, pra të pakicave, janë emërtuar dhe emërtohen me terma të ndryshëm, por që, gjithsesi, duhet të bëhet një farë dallimi midis tyre, që, sipas Metës, përbën një pikë takimi të disiplinave të ndryshme: të shkencave politike, të teorisë të së drejtës, sociologjisë, sociolinguistikës, antropologjisë etj., të cilat e shohin këtë objekt nga anë të ndryshme. Në lidhje me vështirësinë e përcaktimit të termit përkatës për minoritetin, jo vetëm për Shqipërinë, por edhe në shkallë ndërkombëtare, ai shkruan: “Si në fillimet e shekullit XX, ashtu edhe sot,

vështirësia më e madhe juridike lidhet me përcaktimin e termit “minoritet”. Ende në pjesën më të madhe të teksteve ekzistuese ndërkombëtare nuk është dhënë ndonjë përcaktim i përgjithshëm i konceptit “minoritet”, çka do të bënte të mundur që të identifikoheshin në terma abstraktë grupet ose anëtarët e tyre, të cilët duhet të gëzojnë të drejtat që lidhen me këtë nocion” (Meta 2013: 16).

Nuk po zgjatem më shumë për këtë çështje, sepse do të përballemi me interpretime, arsyetime dhe përkufizime të ndryshme dhe përsëri do të mbetej një temë e hapur, e mbushur me më shumë pikëpyetje dhe pasaktësi, çka do të na largonte edhe më nga objektiviteti i kërkuar.

Për të sjellë më afër një farë panorame në lidhje me këto grupime, të etiketuar me emërtime të llojllojshme për “pastërtinë” e tyre etnike, po shpërfaqim disa këndvështrime, kryesisht diakronike, që na vijnë nga një bibliografi e kufizuar. Këtu do të shohim dallime dhe paragjykime për tjetrin, por edhe ngjashmëri të mëdha midis këtyre komuniteteve në gjuhë, në kulturë dhe në histori.

Në përditshmërinë tonë kemi “ne” dhe “të tjerët”, “ne” që i përkasim një bashkësie të caktuar, si dhe “të tjerët”, pjesës që nuk është e ngjashme me ne. “Ne” mund të jemi pakica ose shumica, krahasuar me të tjerët. Bëhet fjalë për grupime që bartin karakteristika të njëjta dhe të veçanta mes veti, që janë të ndryshme ose mungojnë te “tjetri” ose “të tjerët” jashtë nesh. Këto cilësi ose karakteristika të përcaktimit të ndryshimit dhe grupimit në një komunitet të caktuar, mund të jenë të natyrave të ndryshme. Mund të jenë te një numër i kufizuar njerëzish, të shpërndarë nëpër rajone të ndryshme, ose masë e madhe dhe e njësuar, mund të jenë pakicë (një pjesë e vogël e së tërës) ose shumicë, me raporte numerike dhe kulturore të ndryshme me pjesën tjetër.

Në bazë të kriterit përcaktues të komuniteteve, ato i kemi të natyrave të ndryshme. Sipas një emëruesi të përbashkët, që mund të jetë thjesht gjuhësor a me bazë fetare, ose me një emërues më të veçantë, siç është baza etnike.

Komunitetet me bazë etnike mund të përfshijnë brenda vetes edhe pjesën gjuhësore (që përgjithësisht është e njëjtë) si dhe besimin (që mund të jenë edhe të ndryshëm).

Vendi apo rajoni që ka shumësi me “ne” dhe “të tjerë”, padyshim, është Ballkani, pjesë e rëndësishme e Evropës, sepse përfshin në përbërje të vet shumë gjuhë, kombe, etnose, minoritete etnike dhe kombëtare, pakica kombëtare,

komunitete etno-kulturore, religjione, të cilat janë të mbushura plot me histori, legjenda dhe mite. Është rajoni ku ndahen dhe bashkohen gjuhë, ku “prodhohen” jashtëzakonisht shumë histori mbushur plot “me lavdi” për veten dhe “me nënçmim” për të tjerët, pavarësisht se në shumicën e rasteve njohuritë janë tepër të cekëta ose të gabuara, si për “tonën”, ashtu dhe për historinë e “të tjerëve”. Jemi “ne” që legjendat dhe mitet duam t’i besojmë si të vërteta reale, kur flitet për “trimërinë dhe besën” tonë; për “lashtësinë e kahershme”; për lidhje gjaku me heronj historikë të shndërruar në mite; “ne” jemi pjesë e lavdishme e historisë së vjetër dhe asaj të re, duke u bërë kështu të gjitha këto një ushqim i përditshëm për një masë të gjerë, për të mos parapëlqyer asgjë tjetër jashtë nesh, me mendësinë se ato janë pa vlera.

Ndaj, dhe për tematikën që po shtjellojmë sollëm si shembull rajonin e Ballkanit, për të trajtuar vetën e parë “ne” dhe vetën e tretë “ata”, “të tjerët” në kontekstin e një shumësie të tillë, duke u munduar të prekim pikat e përbashkëta dhe të veçanta, si dhe paragjykimet për njëri-tjetrin.

Çfarë jemi “ne”, ç’vend zëmë në hapësirën shoqërore në të cilën jetojmë, a jemi “të njëjtë” dhe pse disa të tjerë janë “të ndryshëm”? Në përgjithësi, shumëkush mendon se e di se çfarë është. Themi “mendon se e di”, pasi vërtetësia e asaj çka mendon është relative. Pakkush nga këta mund të na japë përgjigje shteruese, bindëse dhe objektive kur pyetet në lidhje me identitetin e tij. Pra, është një pyetje e vështirë, në vend të vështirë, në kohë të vështira, dhe kjo sidomos në trojet ballkanike.

Fakti që kemi një shumësi grupimesh, të cilët çdonjëri brenda vetes janë një “ne” dhe pjesa e ngelur jashtë nesh janë “të tjerët”, ka krijuar raporte jo të mira me njëri-tjetrin, ku njëri grupim mund të jenë “pakicë”, pjesë e së tërës, dhe pjesa tjetër “shumicë”, që mbizotëron brendapërbrenda territorit zyrtar të një shteti. Për padrejtësitë që mund t’u jenë bërë ose u bëhen grupimeve të vogla në caqet e një njësie shtetërore, pavarësisht së vërtetës dhe objektivitetit të vlerësimit të situatës reale, shpeshherë ka përpjekje për t’i ndrequr, por, asnjëherë nuk janë çuar deri në fund.

Të mësuar me histori heroizmesh për “veten” dhe “të ngjashmit”, na pëlqen që të vetëmashtrohemi, siç shprehet Ismail Kadareja, duke vlerësuar dhe mbi-vlerësuar “veten” dhe duke përçmuar gjithë “të tjerët” rreth nesh.

“Kur flitet për rëndësinë që ka njohja e vetvetes në historinë e popujve, kjo bëhet dyfish, trefish e domosdoshme në Gadishullin Ballkanik. Vështirë se mund të gjesh ndonjë zonë tjetër të botës ku vetëmashtrimi i një kombi, bëhet pengesa kryesore për moskuptim dhe, natyrisht, për mospranim të tjetrit. Pas tyre dihet ç’vjen: helmimi i ngadaltë ose i rrufeshëm i klimës, urrejtja, dhe më pas rrëmbimi i armëve.” (Kadare 2004: 17)

Pra, Kadare e quan këtë mbivlerësim historik për veten te popujt e Ballkanit si vetëmashtrim të një kombi. Druaj se, kohët e fundit, vetëmashtrimi është rritur ndjeshëm. Të “mësuar” me atë që servirim për veten tonë në histori, nuk marrim kurrë mundimin që të shohim se çfarë ndodh përtej “gardhit” tonë historik. Ndaj, një vëzhgim objektiv mbi historinë e popujve të Ballkanit, për kulturën dhe gjuhën e tyre, për doket dhe zakonet, do të na bindë se të përbashkëtat janë ato që mbisundojnë dhe të veçanta janë shumë më të pakta.

Studiues të ndryshëm që janë marrë me problemet e Ballkanit dhe popujve të tij i kanë vënë re këto ngjashmëri në tregues të ndryshëm të jetës së tyre. Kështu, K. Sandfeld, albanolog i shquar, të përbashkëtat në jetën materiale dhe shpirtërore, afërsinë në sistemin e vlerave morale dhe në psikologjinë popullore të popujve të këtij gadishulli i quante me shprehjen “shpirti i njëjtë” i popujve të Ballkanit (Sandfeld)

Ndërsa Petja Asenova, një prej studiueseve më në zë në gjuhësinë ballkanike, dukuritë e përbashkëta dhe të ngjashme gjuhësore ballkanike i vlerëson “si rezultat i simbiozës kulturore të grupeve etnike, që kanë populluar Gadishullin Ballkanik”.

Edhe Jernej Kopitar, i quajtur si pionier i gjuhësisë ballkanike, është ndër të parët që vëren dukuritë e njëjta gjuhësore ndër popujt e Ballkanit, duke shkruan se “*flasin të njëjtën formë gjuhësore, por me lëndë të ndryshme*”. (Demiraj).

Nëse gjuha merret si kriter përcaktues i një grupimi të caktuar, çfarëdoj emërtimi të ketë ky grup, si dhe raportet e tij me shumicën, edhe këtu do të hasim probleme të ndryshme që i përkasin sinkronisë, por më tepër ato lidhen me studimet diakronike. Edhe këtu, në mjaft raste, veprohet si me historinë në përgjithësi, “luftë” për përcaktimin e gjuhës amtare si gjuha më e vjetër e rajonit, prej së cilës kanë përfituar edhe gjuhët e tjera fqinje. Gjuhëtari dhe ballkanologu Gustav Vajgandi, duke u mbështetur në mjaft probleme demografike që

reflektohen edhe në gjuhët përkatëse, është shprehur: “... gjuha është diçka e jashtme, që ndryshon lehtë dhe, për pasojë, nuk është aspak element bazë i shpirtit të vërtetë popullor. Nëse nuk mund të mohohet se gjuha është faktor për prejardhjen e një populli, prapëseprapë duhet të dihet, që ajo në vetvete nuk është përcaktuese dhe se ka parakushte konkretizuese: në vend të parë cilësitë fizike dhe shpirtërore, në vend të dytë- doket dhe zakonet (folklori), dhe se është e domosdoshme të kemi një qasje kritike, që të përftohet qartësi për frymën popullore. Prandaj, është absolutisht e domosdoshme që të shihet historia, dhe në mënyrë speciale etnografia, duke shkelur në një bazë mundësisht sa më të sigurt.” (Vajgandi)

Nga ajo çka na sugjeron Vajgandi, mund të themi se gjuha nuk është përcaktuese e një identiteti të caktuar. Edhe historia e gjuhëve të botës na ka mësuar se gjuhët, në kushte dhe rrethana të caktuara, mund të ndryshojnë tek i njëjti komunitet.

Por, popujt e Ballkanit nuk janë të prirur që të kërkojnë të përbashkëtat, ngjashmëritë mes njëri-tjetrit, por janë në kërkim të dallimeve, “të madhështisë” kundrejt tjetrit, mbizotërimin në aspekte të ndryshme historike ose kulturore, dhe ajo çka mendohet që ka qenë “pronë” e autoktonisë sonë dhe që mund të jetë “huazuar” nga një grup tjetër etnik. Shpeshherë, kjo ndodh edhe në lëmë të gjuhësisë. Dukuri të ndryshme gjuhësore, që janë thujse të njëjta në shumicën e gjuhëve ballkanike, të quajtura “ballkanizma”, në mjaft raste janë bërë “mollë shërri” në debate të ndryshme gjuhësore nëse ky ballkanizëm i përket njëres gjuhë ose tjetres, gjë që, sipas shumëkujt, dëshmon edhe autoktoninë dhe lashtësinë e etnosit përkatës.

Ndaj, edhe problemet që lidhen me gjuhët e ndryshme ballkanike, variante ose dialekte të tyre, gjuhë që janë folur dikur dhe sot nuk haset asnjë formë e saj e dokumentuar, dialekte të dikurshme të shndërruara në standarde dhe anasjelltas, sollën si pasojë edhe ndryshimin numerik të gjuhëve në Ballkan.

Struktura etnike e Ballkanit ka ndryshuar kaq shpesh për shkaqe dhe interesa të ndryshme politike dhe ushtarake, sa që është mjaft vështirë të përcaktohet identiteti i saktë i tyre. Historia ka treguar se vetëdija për një përkatësi të caktuar në kohë dhe rrethana të caktuara mund të ndryshojë shumë shpejt. Ndaj sot, nëse kemi parasysh se çfarë ka ndodhur me strukturën etnike të popujve të Ballkanit

nën tryshinë e mbivendosjes së popujve të tjerë, është e tepërt, e kotë dhe ndonjëherë edhe qesharake të mëtohet për racë ose etni të pastër, për të mos folur më pas për gjuhët e tyre.

Po e konkretizojmë këtë me raste nga Republika e Maqedonisë së Veriut, që sot paraqitet si areali më interesant gjuhësor ballkanik. Është pikërisht kjo, treva që ka më shumë ballkanizma gjuhësore, dëshmi e teorisë së kontakteve gjuhësore.

Në veprën e tij Misha Glenny *“Histori e Ballkanit. Nacionalizmi, luftëra dhe fuqitë e mëdha”*, në një pjesë të marrë nga një bisedë e H.N. Brailsford me një fshatar të zonës së Manastirit, shkruan: *“Po flisja me një fshatar të pasur, i cili kishte ardhur nga një fshat fqinjë në pazarin e Manastirit. E fliste greqishten mirë, por jo si gjuhë amtare. “Fshati juaj, grek është a bullgar?” - e pyeta. “Si të them” - m’u përgjigj ai, “tani është bullgar, por para katër vjetësh ka qenë grek”. Përgjigjja i dukej krejt e natyrshme dhe e zakonshme. “Si ka mundësi?” - e pyeta me njëfarë habie, “si ka mundësi të ndodhë kjo mrekulli”. “Ka, si nuk ka mundësi” - më tha, - “ne jemi të gjithë të varfër, por duam të kemi shkollën tonë dhe një prift që të kujdeset për ne si e do puna. Kemi patur një mësues grek. I jepnim 5 stërlina në vit plus ushqimin, kurse konsulli grek i paguante edhe 5 stërlina të tjera; po prift tonin nuk kemi patur fare. Kishim disa fshatra një prift të përbashkët, por ai nuk ishte i përpiktë, ishte harraq e i pakujdesshëm. Shkuam te peshkopi grek për t’u ankuar, por nuk na bëri gjë. Bullgarët e morën vesh dhe erdhën dhe na afruan prift. Na thanë se do të na jepnin prift, që do të banonte në fshat, si edhe një mësues falas, pa para. Tani, zotni ju e kuptoni, ne jemi njerëz të varfër, natyrisht që do bëheshim bullgarë”*” (Glenny 2019: 217)

Në veprën e tij *“Etnografi e Maqedonisë”*, në pjesën ku i referohet arealit të gjuhës shqipe, Vajgandi jep edhe një vështrim statistikor për mjaft qytete me rrethinat e tyre përkatëse, që përfshiheshin në atë pjesë që quhej Maqedoni, si: Kumanovë, Preshevë, Kaçanik, Gostivar, Lumë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Fushë Kosovë, Vuçiternë, Mitrovicë, Galiçik, Dibër, Strugë. Po kështu, Vajgandi jep numrin e fshatrave që flisnin gjuhën shqipe, si dhe, në maft raste, edhe numrin e popullsisë shqiptare. Por, përpara se ta bëjë këtë gjë, ai mundohet të sqarojë një fakt kur shprehet: *“Këtu dua edhe një herë të theksoj faktin se në qytete, shumë të ashtuquajtur turq, sidomos në Manastir dhe Shkup, janë shqiptarë, që vihet re*

edhe nga theksi që i japin artikulimit të fjalëve turke, si p.sh. kàve në vend të kavè, mànda në vend të mandà etj. Në vende publike ata flasin turqisht, ndërsa në familje- shqip; ata quajnë veten “turk”, por në fakt kanë parasysh “muhamedan”, ndërsa turqit e vërtetë i quajnë “turk ushak” (oxhak turk). Nëpër fshatra ata dallohen lehtë nga veshjet, nga mjetet bujqësore që përdorin, nga karrocat (tek anadollakët rrotat janë bërë prej rondele druri). Në të gjitha rastet rëndësia e shqiptarëve në Maqedoninë Veriore, nënvleftësohet së tepërmi. Vështirë është që të japim shifër të saktë për numrin e tyre për shkak të përzierjes së popullsisë, ndaj, me të drejtë, mjaft vende të njohura, që janë të interesuar për këtë gjë, shprehin mosbesim te statistikat.”

Nëse u referohemi thjesht këtyre dy shembujve të sipërcituar, që na dëshmojnë qartë se çfarë ka ndodhur në të afërmen e largët dhe se sa shpejt ka ndryshuar në Ballkan struktura etnike, gjuhësore, kulturore e fetare, shumë lehtë mund të na nxjerrë në përfundime të qarta në lidhje me pastërtinë etnike të mëtuar nga shumë komunitete. Fshatari, që sipas bashkëbiseduesit fliste me një greqishte që dukej që nuk e kishte gjuhën e nënës, pasi tregon historikun e fshatit që ndryshonte përkatësinë e tij në lidhje me mësuesin dhe priftin e fshatit që herë dërgoheshin nga Greqia dhe herë nga Bullgaria, meqë bullgarët afruan këta të fundit pa pagesë, fshatari shprehet: “Kështu, zotëri, fshati ynë është i varfër, dhe kështu ne, natyrisht, u bëmë bullgarë.”

Raste si këto, që ka të bëjnë me vetëdijen etnike ose racore në gadishullin e Ballkanit, hasen me shumicë. Mjafton të bëjmë një përqasje të shkurtër në strukturën etnike të një vendi ballkanik në diakroninë e vet, do të vërejmë se sa ndryshojnë ato nga dje dhe deri në sot. Ishin kohëra të zhdukjeve dhe asimilimeve në masë të madhe të popullatës, duke ndryshuar gjuhë dhe identitet.

Nga sa parashtruam më lart, mund të arrijmë në disa përfundime.

a. Ndryshimet nuk duhet të na çojnë në ndarje të tillë në “ne” dhe në “të tjerë”, sepse, dikur, në një periudhë të padokumentuar, ato mund të kenë qenë një pjesë e tërë.

b. Realiteti i sotëm gjuhësor me grupime të ndryshme (le t’i quajmë edhe etnike), duhet marrë ashtu siç është, pa u hyrë debateve shterpë në lidhje me prejardhjen e tyre, sidomos kur nuk kemi të dhëna të mjaftueshme për argumentim shkencor. Ndoshta, në një moment të dytë, kur objektiviteti në

punimet shkencore të jetë parësor dhe bazik, pa u nisur nga paragjykime nacionaliste, mund të diskutohet për diakroni, deri në burimin e vet të pakontestueshëm.

c. “Të tjerët”, pavarësisht përmasave numerike që mund të kenë në një territor të caktuar, duhen parë me objektivitet dhe si një e mirë e shtuar e mozaikut gjuhësor, kulturor dhe fetar, duke iu referuar vlerave të përbashkëta që kemi me ta për të kaluar më pas edhe në atë që është ndryshe.

ç. Dukuritë e shumta dhe të njëjta që vihen re në gjuhët, në jetën kulturore dhe fetare, në sjelljen e përditshme në shoqëri, të shihen si një “pronë e përbashkët”, si një dëshmi e bashkëjetesës sonë herë në paqe e herë në luftë, herë afër dhe herë larg, pa qenë nevoja të “gërmojmë” nëpër arkiva me të vetmin qëllim: gjetjen e një “vërtetimi trashëgimie” dhe për të dalë më pas me përfundimin se kjo është “jona”, dhe ne jemi “të parët”, “autoktonët” etj.

Minoritetet, si pjesë integrale e një shoqërie të caktuar, duhen parë si një vlerë e çmuar e gjithë masës së popullsisë dhe jo si një “çiban i huaj” që dëmton trupin e shëndoshë të këtij vendi.

Edhe vetë minoritetet duhet të bëjnë maksimumin e tyre që të shërbejnë si ura të forta bashkëpunimi ndërmjet vendit ku jetojnë dhe vendit të tyre amë dhe jo të bëhen shkaktarë të konflikteve dhe të shndërrimeve të tyre në gremina ndarëse midis vendeve përkatëse.

Shpresoj shumë që kjo konferencë, në të gjitha seksionet e punimeve të saj, të jetë si një fillesë ku me përfundimet e nxjerra prej hulumtimeve të kryera, të shërbejë si pikënisje e një projekti të ri, më të madh, për të kryer studime më të thelluara, konkrete dhe të vështruara me objektivitet.

Bibliografi:

Bërxoli 2005: Bërxoli, Arqile. *Minoritet në Shqipëri*, Tiranë,

Demiraj: Demiraj, Shaban. *Gjuhësi ballkanike*, Shkup

Glenny 2019: Glenny, Misha. *Histori e Ballkanit. Nacionalizmi, luftëra dhe fuqitë e mëdha*, Prishtinë

Ismajli 2005: Ismajli, Rexhep. *Gjuhë standarde dhe histori identitetesh*. Tiranë

Kadare 2004: Kadare, Ismail. *Poshtërimi në Ballkan*. Sprovë. Tiranë,

Meta 2013: Meta, Beqir. *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri 1912-1924*.

Omari 2014: Omari, Luan, *Çështja e pakicave kombëtare dhe Shqipëria*. Tiranë

AKAD. KRISTINA JORGAOI

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

jorgaqi62@yahoo.com

A ËSHTË GJUHA ROME NË SHQIPËRI NJË GJUHË E RREZIKUAR?

Abstrakt

Në kumtesë synohet të bëhet një vlerësim paraprak i situatës sociolinguistike të gjuhës rome në Shqipëri për të përcaktuar shkallën e rrezikimit apo vitalitetit të saj, mbështetur në kriteret e propozuara në dokumentin e UNESCO-s të v.2003. Duke marrë për bazë konstatimet si dhe kuadrin ligjor për gjuhët e pakicave në Shqipëri paraqiten edhe disa propozime me karakter rivitalizues.

Fjalët kyçe: *gjuha rome, gjuhë pakice, gjuhë e rrezikuar, vitalitet gjuhësor, rrezikim gjuhësor, ndërrim i gjuhës, rivitalizim i gjuhës.*

“Pse duhet shpëtuar një gjuhë, që rrezikon të zhduket? Ndër të tjera, pse është pjesë e një biodiversiteti, që garanton pasurinë dhe larminë e kulturave njerëzore. Por edhe pse çdo gjuhë, qoftë ajo më e rralla, është shembulli i një mrekullie, madje i një mrekullie evolucioni, që ka krijuar një tërësi unike fjalësh, tingujsh dhe arkitekture gramatikore. Një tërësi, që është edhe një vizion i botës origjinale, një pasqyrë e metaforave, e mendimit që një popullsi e caktuar përdor për ta interpretuar botën. Ta lësh të zhduket, do të ishte një dëm i pariparueshëm: çdo gjuhë është një univers”.

Christopher Moseley

Çështja e gjuhëve të rrezikuara është bërë, së paku prej tre dekadash, një nga çështjet më të trajtuara në literaturën sociolinguistike të përbotshme dhe sot mund të flitet për një fushë të veçantë studimesh, siç është “Rrezikimi gjuhësor” (*Language Endangerment*). Rritja gjithnjë e më shumë e numrit të gjuhëve që rrezikohen të mos përdoren më – qoftë prej braktisjes së tyre nga folësit përkatës dhe përqaimit të një gjuhe tjetër (*language shift*), qoftë prej zhdukjes së folësve që i flasin ato gjuhë (*language death*) - e bën më se të kuptueshëm shqetësimin e

studiesve¹. Këta kanë krijuar tashmë edhe sisteme apo modele vlerësimi, të cilat ndihmojnë për të përcaktuar shkallën e rrezikimit të gjuhëve të ndryshme apo, thënë në mënyrë të figurshme, për të diagnostikuar shëndetin e tyre. Megjithë kufizimet që kanë², këto modele mbeten instrumente shumë të rëndësishme në duart e studuesve e të komuniteteve për të përcaktuar sferat e ndërhyrjeve për ruajtjen dhe fuqizimin ose rivitalizimin e gjuhëve të rrezikuara.

Ndër të parat sisteme vlerësimi të këtij lloji është ai i njohur si **GIDS** - *Graded Intergenerational Disruption Scale* - i përpunuar nga Joshua **Fishman** dhe i publikuar në v.1991³. Ky model pionier u ndoq edhe prej modelesh të tjera vlerësimi, ndër të cilët më të njohurit e të përdorshmit janë: sistemi i M.Lynn **Landweer**⁴; modeli i paraqitur në dokumentin e **UNESCO**-s hartuar nga **Brenzinger** et al. (2003)⁵; modeli **EGIDS** i përpunuar nga Paul **Lewis** dhe Gary

¹ Sipas botimit të 24-t të *Ethnologue* (2021), nga 7139 gjuhë të gjalla, që dokumentohen sot, 3018 (42%) konsiderohen si gjuhë të rrezikuara.

² Për një vështrim kritik të tyre shih edhe Ogone John Obiero, “From Assessing Language Endangerment or Vitality to Creating and Evaluating Language Revitalization Programmes”, *Nordic Journal of African Studies* 19(4), 2010; Annemarie Sorescu-Marincovic, Mirjana Miric, Svetlana Cirkovic, “Assessing Linguistic Vulnerability and Endangerment in Serbia. A Critical Survey of Methodologies and Outcomes”, në *Balkanica L1* (2020), f.65-104. Grace A. Gomashie and Roland Terborg, “Nahuatl, selected vitality indicators and scales of vitality in an Indigenous language community in Mexico”, në *Open Linguistics* <https://doi.org/10.1515/opli-2021-0010>.

³ *Reversing Language Shift: Theoretical and Empirical Foundations of Assistance to Threatened Language*, Clevedon, England: Multilingual Matters, 1991.

⁴ M. Lynn Landweer (1998), “Indicators of ethnolinguistic vitality case study of two languages: Labu and Vanimo”, ne Nicholas Ostler (ed.), *Proceedings of the second FEL conference: Endangered Languages – What Role for the Specialist?*, f.64-72; M. Lynn Landweer (2000), “Indicators of ethnolinguistic vitality”, ne *Notes on Sociolinguistics*, 5 (1), f. 5-22; M. Lynn Landweer (2016), “Indicators of Ethnolinguistic Vitality Review and Score Sheet”, *GIALens* Volume 10, No. 1.

⁵ Matthias Brenzinger et al., *Language Vitality and Endangerment*, Document submitted to the International Expert Meeting on *UNESCO Programme Safeguarding of Endangered Languages*, Paris, 10-12 March, 2003, 25 fq.

Simons (2009)⁶; dhe sistemi **LEI - Language Endangerment Index (2016)**⁷. Pikërisht me ndihmën e këtyre instrumenteve janë hartuar inventarë apo lista me të dhënat përkatëse për gjuhët e rrezikuara të botës, të cilat plotësohen e përditësohen vazhdimisht, si: *Ethnologue*, *UNESCO Atlas of the World's Languages in Danger*⁸, *The Catalogue of Endangered Languages (ELCat)*.

Një prej gjuhëve të rrezikuara, që figuron në të gjitha këto botime reference a inventarë ndërkombëtarë, është edhe gjuha rome apo romishtja, që flitet nga disa milionë romë në mbarë botën⁹ dhe njihet zyrtarisht si gjuhë pakicash në shumë shtete. Vetëm në Europë ajo konsiderohet e tillë në mbi 20 shtete, mes të cilave edhe në Shqipëri prej të paktën katër vitesh¹⁰. Po për romishten, ashtu si dhe për gjuhë të tjera pakicash në Shqipëri, nuk është ndërmarrë asnjëherë nga studiuesit shqiptarë ndonjë studim në kuadrin teorik e metodologjik të fushës së rrezikimit gjuhësor. Për këtë arsye zgjodhëm të realizojmë një proces vlerësimi paraprak për shkallën e rrezikimit të romishtes në Shqipëri mbështetur në të dhënat më të fundit që disponojmë, për të shqyrtuar se sa i qëndron së vërtetës përcaktimi i romishtes si një “gjuhë vërtetë e rrezikuar” (*definitely endangered*)¹¹, si dhe për të ofruar më pas disa propozime për rivitalizimin e mundshëm të saj.

Ndër sistemet a modelet për vlerësimin e shkallës së rrezikimit të romishtes në Shqipëri përzgjedhëm atë të një grupi ekspertësh, gjuhëtarë në zë në fushën e

⁶ “Assessing Endangerment: Expanding Fishman’s GID”, *Revue Roumaine de Linguistique*, 55(2), f.103-120.

⁷ Nala H. Lee and John Van Way, “Assessing levels of endangerment in the Catalogue of Endangered Languages (ELCat) using the Language Endangerment Index (LEI)”, in *Language in Society* 45, 2016, f.271-292.

⁸ Deri në v.1995 kjo vepër reference dilte me titullin *Red Book of Endangered Languages*.

⁹ Shifrat për popullsinë rome luhaten mjaft, për shkak të vështirësive të mëdha në identifikimin e saktë të kësaj popullsie të shpërndarë në shtete të ndryshme të botës. Sipas *Ethnologue* (2015), numri i romëve në botë shkon në afro 3.5 milionë, kurse, sipas studiuesish të tjerë, numri i romëve vetëm në Europë arrin në 6.6 milionë (Peter Bakker & Hristo Kyuchukov (eds.), *What is the Romani Language*, Hartfield, University of Hertfordshire Press, 2000).

¹⁰ Ligji nr. 96/2017, *Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë* (Neni 3, pika 2).

¹¹ *UNESCO Atlas of the World's Languages in Danger* (2010).

studimeve të gjuhëve të rrezikuara, hartuar në kuadrin e një programi të UNESCO-S¹². I konsideruar si “një piketë orientuese” e çmuar për gjuhëtarët, organizatat dhe bashkësitë, që merren me probleme të gjuhëve të rrezikuara¹³, ky model përbëhet përgjithësisht prej kriteresh a faktorësh konkretë e të matshëm, mbi bazën e të cilëve mund të përcaktohet vitaliteti i një gjuhe. Nga 9 faktorë a indikatorë, 8 (përfshirë faktori 2) vlerësohen/maten secili sipas një pikavarazhi të caktuar (0-5), që dëshmojnë nivelet e ndryshme të rrezikimit të gjuhës. Këta faktorë janë: 1. Transmetimi i gjuhës ndër breza; 2. Numri absolut i folësve të gjuhës; 3. Numri i folësve të gjuhës së një grupi në raport me popullsinë e përgjithshme të atij grupi; 4. Domenet gjuhësore ku ajo përdoret; 5. Shtrirja apo zgjerimi i përdorimit të gjuhës në domene të reja; 6. Ekzistenca ose jo e materialeve të shkruara, të cilat shërbejnë për arsimimin gjuhësor dhe alfabetizimin e bashkësisë, që e flet gjuhën; 7. Qëndrimet dhe politikat gjuhësore qeveritare e institucionale, përfshirë statusin zyrtar dhe përdorimin e gjuhës; 8. Qëndrimet e anëtarëve të komunitetit ndaj gjuhës së vet; 9. Sasia dhe cilësia e dokumentimit. Jemi të vetëdijshëm, sidoqoftë, se vlerësimi i vitalitetit gjuhësor është një proces i ndërlikuar e kompleks, që shkon përtej skemave apo modeleve konceptuale të ideuara prej studiuesve.

1. **Transmetimi i gjuhës ndër breza** konsiderohet si indikatori më i rëndësishëm i vitalitetit të një gjuhe, i cili matet, siç e përmendëm më lart, sipas një sistemi, që përcakton shkallën e rrezikimit të një gjuhe: (5) “gjuhë e sigurt” (*safe*), kur një gjuhë flitet nga të gjithë brezat dhe transmetimi i saj bëhet në mënyrë të pandërprerë; (4) gjuhë e **pasigurt** (*unsafe*), kur pjesa më e madhe e familjeve e përdorin atë gjuhë për të komunikuar në shtëpi dhe fëmijët e mësojnë si gjuhën e tyre të parë; (3) gjuhë **vërtetë e rrezikuar** (*definitely endangered*), kur gjuha përdoret më së shumti nga brezi i prindërve, kurse fëmijët nuk e mësojnë si gjuhë të parë në shtëpi; (2) “gjuhë **seriozisht e rrezikuar**” (*severely endangered*), kur ajo flitet vetëm nga brezi i gjyshërve dhe stërgjyshërve, ndërsa brezi i prindërve e kupton, por nuk e përdor për të komunikuar me fëmijët; (1) gjuhë **tërësisht e rrezikuar** (*critically endangered*), kur gjuha flitet vetëm prej

¹² Matthias Brenzinger et al., *Language Vitality and Endangerment ...*, vep.cit.

¹³ Ogone John Obiero, “From Assessing Language Endangerment ...”, art.cit., f.209.

shumë pak njerëzve nga brezi i gjyshërve e stërgjyshërve¹⁴; (0) “gjuhë e zhdukur” (*extinct*), kur atë nuk e flet ose nuk e kujton askush¹⁵.

Për të vlerësuar shkallën e transmetueshmërisë në breza të gjuhës rome sot, kishim përgatitur një pyetsor të posaçëm, të cilin, për shkak të kushteve të pandemisë së Covid-19, nuk arritëm ta plotësonim në terren. Shfrytëzuam atëherë të dhëna të paraqitura në studime autorësh, që janë marrë me probleme të natyrës sociale dhe ekonomike të komunitetit rom, dhe që vetëm në mënyrë të kufizuar kanë paraqitur fakte me karakter gjuhësor. Të dhënat e tyre, që pasqyrojnë shkallën e përdorimit të gjuhës rome në shtëpi, flasin edhe për shkallën e transmetueshmërisë së saj nga një brez në tjetrin në këtë komunitet: një gjuhë e folur në shtëpi është pas të gjitha gjasave një mjet komunikimi mes anëtarëve të familjes (fëmijë, prindër, gjyshër). Problemi qëndron te statistikat, të cilat ndryshojnë jo vetëm sipas autorëve, por edhe sipas studimeve të ndryshme të të njëjtëve autorë.

Kështu, sipas studimit të De Soto *et al.* (2005)¹⁶, 65% e popullsisë rome, që jeton në Shqipëri, përdor në shtëpi vetëm gjuhën rome, 29% përdor romishten e shqipen bashkë¹⁷ dhe vetëm 6% komunikojnë vetëm në shqip (këto janë kryesisht familje të krijuara nga martesat e përziera mes romësh e egjiptianësh ose romësh dhe joromësh).

¹⁴ Meqenëse fusha e studimit të *Rrezikimit gjuhësor* është e re, kuptohet që terminologjia e saj ende nuk është përpunuar sa duhet në gjuhën shqipe. Eda Derhemi, e vetmja studiuese shqiptare që punon në këtë fushë, duke dhënë kontribut të çmuar për studimin e gjuhës së arbëreshëve të Italisë, i ka dhënë në shqip termat, që shënojnë faktorët (3), (2), (1), përkatësisht si *gjuhë sigurisht e rrezikuar*, *gjuhë tej mase e rrezikuar*, *gjuhë skajshëm e rrezikuar* (Eda Derhemi, “Arbërishtja – gjuhë e rrezikuar”, në *Continuum, Revistë e Studimeve Arbëreshe*, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, viti I, nr. 1, 2020-2021, f. 212).

¹⁵ Brezinger et al, *vep.cit*, f. 7-8.

¹⁶ Hermine De Soto, Sabine Beddies, Ilir Gëdeshi, *Roma and Egyptians in Albania, From Social Exclusion to Social Inclusion*, World Bank Working Paper, 2005, No.53, f.15-16.

¹⁷ Në një studim të mëvonshëm (Ilir Gëdeshi, Elira Jorgoni, *Mapping Roma Children in Albania*, Centre for Economic and Social Studies (CESS), Tirana, 2011, f.27) shifra e popullsisë rome, që përdor romishten e shqipen në shtëpi, dyfishohet, duke shkuar në 69.4%.

Ndërkohë, sipas censusit të posaçëm të kryer vetëm për popullsinë rome (2014)¹⁸, rezulton një përqindje akoma më e madhe e saj, që e flet romishten në shtëpi: **80%** e familjeve rome shprehen se romishtja është gjuha kryesore, që ata flasin. Kurse dy burime të tjera raportojnë shifra shumë më të ulëta sa i takon përdorimit të romishtes në shtëpi si gjuhë amtare: **36%**¹⁹ dhe **55%**²⁰.

Të dhënat e mësipërme, që dëshmojnë se gjuha rome në Shqipëri flitet në shtëpi si gjuhë e parë nga pjesa më e madhe e fëmijëve ose e familjeve rome, tregojnë qartë për shkallën e lartë të ndërtransmetueshmërisë së romishtes në breza²¹, çka e klasifikon, me shumë gjasë, në nivelin (4) si **“gjuhë e pasigurt”**²².

2. **Numri absolut i folësve** të një gjuhe është një tjetër faktor, që dëshmon shkallën e vitalitetit apo rrezikshmërisë, që paraqet ajo gjuhë, ndonëse, siç e vënë në dukje edhe Brezinger et al., “është e pamundur të bësh një interpretim objektiv të numrave absolutë”²³. Dihet, megjithatë, që bashkësitë gjuhësore me një numër të vogël folësish përgjithësisht janë më të ekspozuara ndaj ndikimeve, që rrezikojnë gjuhët e tyre, sesa bashkësitë e mëdha të folësve (edhe pse numri i madh i folësve nuk përbën gjithnjë garanci për mbijetesë dhe shëndet të një gjuhe). Por sa është numri i romishtfolësve në Shqipëri? Burime të ndryshme

¹⁸ *Census 2014, Banesat dhe popullata rome në Shqipëri*, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, 2014, f.22.

¹⁹ Patrick Simon, Emira Galanxhi, Olgeta Dhono, *Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: Profili social-demografik dhe ekonomik bazuar në Censusin 2011*, Tiranë, 2015, f.27 (përgatitur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri, në kuadër të Programit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” i financuar nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim e Bashkëpunim).

²⁰ J. Kling, “Housing situation in numbers”, Roma in Central and Southeast Europe: Studim rajonal për romët i PNUD/BB/KE, 2011 (cituar sipas Patrick Simon et al., *Romët dhe egjiptianët në Shqipëri...*, vep.cit., f.27).

²¹ Brezinger et al, vep.cit, f. 7-8.

Në mbështetje të mendimit se romishtja në Shqipëri vijon të transmetohet ndër breza dhe se shumica dërrmuese e fëmijëve romë e flasin atë, madje e kanë gjuhën e vetme që njihin deri sa futen në shkollë, vjen edhe një përvojë e imja në terren si aktiviste e shoqërisë civile në kuadrin e projektit “Çdo fëmijë rom në kopsht” (UNICEF et al.).

²² Do të ishte me mjaft interes që, në një studim tjetër, të shiheshin lidhjet e ndërtransmetueshmërisë me variable shoqërore të tilla, si zona e banimit të romëve (zonë urbane, periferi zone urbane, zonë rurale), shkalla e arsimimit të tyre etj.

²³ Brezinger et al, vep. cit., f.8.

japin shifra të ndryshme, çka shpjegohet me vështirësitë në regjistrimin e kësaj popullsie për shkak të lëvizjeve të vazhdueshme brenda Shqipërisë, migrimeve të herëpashershme në shtete të tjera të një pjese të saj etj. Shifrat për romishtfolësit variojnë kështu nga **4025** persona, sipas të dhënave të censusit në Shqipëri të v. 2011²⁴, në **85 500** persona, sipas të dhënave të sjella nga studiuesit në kuadrin e përpjekjeve për vlerësim të popullsisë romishtfolëse në secilin prej shteteve europiane²⁵. Shifra të tilla me një diferencë të thellë mes tyre jo që nuk e ndihmojnë studiuesin të nxjerrë përfundime të sakta, por e çorientojnë atë. Në censusin e ri, që do të ndërmerret në v.2022, duhet synuar për një vlerësimi sasior më realist të popullsisë rome romishtfolëse.

3. Numri i folësve të gjuhës së një grupi në raport me popullsinë e përgjithshme të grupit është, gjithashtu, kriter i rëndësishëm për të vlerësuar nivelin e rrezikimit të një gjuhe. Duhet pohuar që përllogaritja e popullsisë rome, ashtu sikurse përllogaritja e popullsisë romishtfolëse, përbën një sfidë jo të vogël për të njëjtat arsye, që i përmendëm në paragrafin e mësipërm. Kjo bën që shifrat për popullsinë rome në Shqipëri të variojnë e luhaten së tepërmi (80 000-150 000²⁶, 90 000²⁷, 18 276²⁸, 8301²⁹).

Nëse u referohemi shifrave zyrtare, sipas të cilave popullsia rome në Shqipëri është **8301** banorë, kurse romishtfolësit janë **4025**, rezultojnë që gjuhën rome e flet afro **50%** e romëve të Shqipërisë. Ky rezultat romishten e folur në Shqipëri nuk e klasifikon plotësisht në ndonjërin prej 6 niveleve të shkallës, që i referohet faktorit 3, por e vendon diku aty në kufi mes nivelit 2 dhe 3, pra mes një gjuhe **vërtet të rrezikuar** (“gjuhën e flet shumica e popullsisë”) dhe një gjuhe **seriozisht të rrezikuar** (“gjuhën e flet një pakicë e popullsisë”). Jemi të prirur të besojmë se shifrat zyrtare nuk duhet të jenë fort të sakta dhe se numri i

²⁴ *Censusi i popullsisë dhe banesave 2011*, Instituti i Statistikave, Tiranë, 2012.

²⁵ Peter Bakker, Marcia Rooker, “The political status of the Romani Language in Europe”, Mercator-Working Papers num.2, 2001, f.9.

²⁶ Minority Rights Group International, *World Directory of Minorities and Indigenous Peoples – Albania: Roma*, 2008 (<https://www.refworld.org/docid/49749d6449.html>)

²⁷ Peter Bakker, Marcia Rooker, “The political status of the Romani Language in Europe”, art.cit., f.9.

²⁸ *Census 2014, Banesat dhe popullata rome në Shqipëri*, vep.cit., f.17.

²⁹ *Censusi i popullsisë dhe banesave 2011*, vep.cit.

romishtfolësve në Shqipëri është më i madh. Për këtë flasin, ndonëse në mënyrë të tërthortë, edhe shifrat e sjella më sipër te faktori 1, që dëshmojnë përqindjen e lartë të familjeve rome, të cilat romishten e kanë gjuhën e tyre të shtëpisë.

Nëse u referohemi shifrave të publikuara prej studiuesve, shkalla e rrezikimit të gjuhës rome, ndryshe nga ç' dëshmojnë shifrat zyrtare, rezulton të jetë e vogël. Kështu, sipas *Bakker et al*, në një popullsi rome prej 90 000 personash, romishten e flet 95% e saj³⁰, një e dhënë kjo që e klasifikon romishten në nivelin (4), atë të një gjuhe **të pasigurt** (“gjuha flitet nga shumica dërrmuese e popullsisë”). Po në këtë nivel mund të përfshihej romishtja, nëse do t'i referoheshim pohimit të studiuesit Marcel Courthiade, një autoritet në fushën e studimeve mbi romët dhe romishten, sipas të cilit “shumica dërrmuese [e romëve të Shqipërisë – K.J.] e përdorin romishten në sferën private dhe atë publike”³¹, duke u nënkuptuar kështu që ajo **flitet** nga pjesa dërrmuese e saj.

4. Shkalla e vitalitetit apo rrezikimit të një gjuhe varet edhe nga **domenet gjuhësore ku ajo përdoret**. Sa më të shumta të jenë këto domene, aq më pak e rrezikuar konsiderohet gjuha, por, nëse domenet nisin të tkurren, të reduktohen a të humbasin, ajo është realisht e kërcënuar. Për të matur shkallën e rrezikimit të një gjuhe lidhur me këtë faktor, ekziston, po ashtu, një klasifikim prej 6 shkallësh, që shkon nga niveli (5), ai më i ulëti i rrezikimit të një gjuhe, kur kjo përdoret në të gjitha domenet dhe me të gjitha funksionet, te niveli (0), kur një gjuhë nuk flitet më dhe konsiderohet e zhdukur³².

Çfarë mund të thuhet për romishten në Shqipëri lidhur me domenet, ku ajo përdoret sot? Statistikat janë të pakta, por, mbi të gjitha, kontradiktore. Në censusin e v.2014 për banesat dhe popullsinë rome në Shqipëri rezulton, sic u vu në dukje dhe më lart, që **80%** e kësaj popullsie romishten e përdor si mjet

³⁰ Peter Bakker, Marcia Rooker, “The political status of the Romani Language in Europe”, art.cit., f.9

³¹ Marcel Courthiade, “Between Conviviality and Antagonism: The Ambiguous Position of the Romanies in Albania”, *Patrin*, no.3, 1995, f.11.

³² Brezinger et al, vep.cit, f. 9-10.

komunikimi në familje³³, kundrejt 65%³⁴ dhe 55%³⁵, që del në studime të tjera. Situata paraqitet krejtësisht ndryshe në një tjetër studim, sipas të cilit thuajse 70% e romëve në Shqipëri përdorin si gjuhë shtëpie romishten dhe shqipen³⁶.

Referuar domeneve të përdorimit të romishtes, cila është atëherë shkalla e rrezikimit të saj? Rreziku që i kanoset romishtes, paraqitet, pra, në nivele të ndryshme në varësi të të dhënave, që merren për bazë. Nëse do të merrnim për bazë tri statistikat e para, romishten mund ta klasifikonim në nivelin (4)³⁷, që do të thotë se ajo përdoret më së shumti në sferën private e, mbi të gjitha, në shtëpi, duke u nënkuptuar kështu përdorimi i shqipes, gjuhës dominuese, në kontekste zyrtare dhe publike³⁸. Përdorimi i të dyja gjuhëve me funksione të ndryshme flet për një situatë diglosie dhe një shkallë të ulët rrezikimi të saj. Por, nëse do të merrnim për bazë statistikën e fundit (70%), romishten mund ta klasifikonim në një nivel, që flet për një shkallë më të lartë rrezikimi, në nivelin (3)³⁹, kur gjuha dominuese (shqipja) nis të depërtojë edhe në një domen siç është shtëpia, duke bërë kështu që gjuha jodominuese (romishtja) të humbasë terren. Në të dyja rastet, sidoqoftë, sa i takon domeneve ku përdoret, romishtja duhet konsideruar në një shkallë mesatare rrezikimi për sa kohë ajo vazhdon të funksionojë normalisht si gjuhë komunikimi brenda grupit etnik.

5. Shtrirja apo zgjerimi i përdorimit të një gjuhe në domene të reja flet, gjithashtu, për shkallën e vitalitetit të saj. Po a ia ka dalë dhe sa ia ka dalë romishtja në Shqipëri të përdoret në arsim, në media (gazeta, radio, televizion, internet) etj.?

³³ *Census 2014, Banesat dhe popullata rome në Shqipëri*, vep.cit., f.22.

³⁴ De Soto et al., *Roma and Egyptians in Albania ...*, vep.cit., f.15.

³⁵ J. Kling, "Housing situation in numbers", *Roma in Central and Southeast Europe...*, vep.cit., f.27.

³⁶ Ilir Gëdeshi, Elira Jorgoni, *Mapping Roma Children in Albania...*, vep.cit., f.27.

³⁷ Brezinger et al, vep.cit, f. 9.

³⁸ "Gjuha rome është e marginalizuar në media, e marginalizuar në arsim, irrelevante në jetën publike dhe e neglizhuar në administratë" (Dieter W. Halwachs, *Roma Language, Sociolinguistics*, Council of Europe, Project Education of Roma Children in Europe, f.2)

³⁹ Brezinger et al, vep.cit, f. 10.

Gjuha rome nuk ka askund një traditë përdorimi në sferat publike, çka përbën edhe një prej sfidave më të mëdha të saj. Historikisht romishtja te ne, por jo vetëm, nuk ka shërbyer kurrë si gjuhë **arsimimi** në asnjë nivel shkollimi. Këtë funksion ajo nuk e kryen as sot, kur ekziston tashmë kuadri ligjor, që garanton arsimimin të pakicave kombëtare në gjuhët e tyre amtare⁴⁰. Dhe mungesa e arsimimit të një bashkësie gjuhësore në gjuhën e saj amtare dihet që e kërcënon seriozisht një gjuhë me rrezikun e zhdukjes⁴¹.

Një nga faktorët më të rëndësishëm, që pengon realizimin e arsimimit të fëmijëve të pakicave rome në gjuhën e tyre amtare, është mungesa thuajse e plotë e mësuesve romë. Nëse mësues të gjuhëve të tjera të pakicave kombëtare përgatiten prej kohësh nëpër institucione arsimore në Shqipëri⁴², këto të fundit nuk kanë përgatitur ndonjëherë mësues të gjuhës rome. Hapja e një dege studimi për gjuhë shqipe dhe rome në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan (në vitet shkollore 2016-2017, 2017-2018) nuk dha ndonjë rezultat të frytshëm⁴³.

Përdorimin e romishtes romët *thuajse* nuk ia kanë dalë ta shtrijnë as në **median e shkruar**. Aktualisht nuk ka asnjë organ shtypi që del në këtë gjuhë. Sa i takon **medias audiovizive**, operatori i vetëm që transmeton lajme në gjuhët e pakicave, ndër të cilat edhe në gjuhën rome, është RTSH2, një kanal i posaçëm i të vetmit transmetues publik në vend, RTSH. Bëhet fjalë për një edicion informativ me një kohëzgjatje prej 5 minutash, që transmetohet rregullisht prej dhjetorit të v. 2016 nga e hëna deri të premtën. Deri sot nuk ka asnjë operator privat, që transmeton në ndonjë prej gjuhëve të pakicave, përfshirë edhe në romishte.

⁴⁰ Shih për këtë më poshtë, te faktori 7, ku trajtohet çështja e politikave gjuhësore të ndjekura prej shtetit shqiptar ndaj pakicave kombëtare.

⁴¹ Shih më poshtë pikën 6.

⁴² Mësuesit e gjuhës greke në Shqipëri përgatiten në shkollën e mesme pedagogjike të Gjirokastrës dhe në Universitetin “Eqrem Cabej” në Gjirokastrë (Departamenti i Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek). Greqishtja studiohet, gjithashtu, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës (Departamenti i Gjuhës Greke). Po në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja (Departamenti i Gjuhës Sllavo-Balkanike) studiohet edhe gjuha maqedonase.

⁴³ Sipas një komunikimi gojor të pedagogut të kursit universitar të gjuhës rome, Emiliano Aliu, në këtë degë arritën të diplomoheshin vetëm dy studentë nga komuniteti rom.

Si duhet vlerësuar atëherë shkalla e rrezikimit të gjuhës rome në Shqipëri sa i takon përdorimit të saj në domene të reja? I vetmi domen i ri, siç e pamë, është ai i medias audiovizive, por përdorimi i romishtes aty është tejet i kufizuar si nga pikëpamja sasiore (25 minuta transmetim në javë), ashtu dhe ajo cilësore (transmetohen vetëm edicione lajmesh). Kjo e rrit jashtëzakonisht shkallën e rrezikut, që i kërcënohet romishtes, duke e vendosur këtë gjuhë në nivelin e parafundit, nivelin (1) (“gjuha përdoret në vetëm pak domene të reja”), në klasifikimin prej 6 shkallësh a nivelesh rreziku⁴⁴.

6. Ekzistenca ose jo e materialeve të shkruara, që shërbejnë për arsimimin gjuhësor dhe alfabetizimin e bashkësisë, e cila e flet një gjuhë, ndikon drejtpërdrejt në shkallën e vitalitetit apo rrezikimit të asaj gjuhe. Po si paraqitet gjendja e romishtes në Shqipëri lidhur me këtë faktor? Situata është e tillë që ekzistojnë shumë pak materiale të kësaj natyre në romishte: një abetare rome⁴⁵ së bashku me librin e mësuesit⁴⁶, një gramatikë e gjuhës rome⁴⁷ si dhe një fjalor dygjuhësh romisht-shqip dhe shqip-romisht⁴⁸, vepra të romologut të shquar dhe një prej themeluesve të romologjisë, Marcel Courthiade. Për më tepër, këto materiale nuk njihen e nuk janë të aksesueshme nga komuniteti i romëve të Shqipërisë, pasi, siç e thamë, mësimi i romishtes dhe në romisht nuk është pjesë e kurrikulës shkollore. E, meqenëse arsimimi në një gjuhë të caktuar është thelbësor për vitalitetin e asaj gjuhe, romishtja, në këtë aspekt, duhet konsideruar si një gjuhë shumë e rrezikuar. Referuar modelit të vlerësimit të UNESCO-s për këtë faktor, të përbërë po prej 6 nivelesh, që i korrespondojnë shkallëve të

⁴⁴ Brezinger et al, vep.cit, f. 11.

⁴⁵ *Romano Startoro*, Sarajevo: Svjetlost, 1990, 64 fq.

⁴⁶ *Romano Startoro*, Sarajevo: Svjetlost, 1990, 92 fq. Libri është shkruar në shqip, serbokroatisht, sllovenisht, turqisht, bullgarisht, maqedonisht, rumanisht dhe greqisht, me qëllim që të përdoret nga mësuesit romë kudo në Ballkan.

⁴⁷ *Gramatika e gjuhës rrome*, vëll.I: njohuri të përgjithshme, fonologji, morfologji, Tiranë, 1989, 179 fq.

⁴⁸ *Fjalor rromisht-shqip: i të folmeve rrome në përdorim në Shqipëri: meqarisht, kabuxhisht, rupanisht e shkodranisht, rreth 4400 fjalë; me një fjalorth shqip- rromisht, rreth 3000 fjalë*, Rromani Baxt, Tirana, 2004, 252 fq.

ndryshme të rrezikimit të një gjuhe, romishten në Shqipëri do duhet ta përfshinim, pas shumë gjasash, në nivelin (2)⁴⁹.

Në këtë situatë të romishtes në Shqipëri ka patur e ka pa dyshim ndikimin e vet edhe situata e romishtes në përgjithësi si një gjuhë me traditë krejtësisht gojore dhe me një histori shkrimi shumë të re, as njëshekullore, të përbërë nga një mori përpjekjesh për grafizim⁵⁰. Pas përdorimit të një vargu alfabetesh për shkrimin e saj (latin, cirilik, grek, devanagari), ende sot nuk ka një alfabet të vetëm të përbashkët për shkrimin e romishtes. Nuk ekziston, gjithashtu, një drejtshkrim a ortografi standarde, ndërkohë që nuk kanë munguar përpjekjet për krijimin e varieteteve të kodifikuara qoftë për dialekte të veçanta, qoftë për një varietet të vetëm mbidialektor. Prirja mbizotëruese, gjithsesi, mbetet ajo e një modeli policentrik, ku bashkekzistojnë modele të ndryshme kodifikimi⁵¹.

Po çfarë alfabeti e drejtshkrimi kanë zgjedhur të përdorin ata të paktë individë romë në Shqipëri, në rastet kur u është dashur ta shkruajnë gjuhën rome? Edicionet informative, që përgatiten dhe lexohen çdo ditë në gjuhën rome, prej të paktën katër vjetësh, pranë kanalit RTSH2, shkruhen, sipas dëshmimeve gojore të autorit të tyre,⁵² me alfabetin e përpunuar prej romologut Marcel Courthiade, të miratuar në Kongresin IV Botëror të Romëve në Poloni (1990), i cili konsiderohet si alfabeti zyrtar i organizatës Bashkimi Ndërkombëtar i Romëve (International Roman Union) (1971)⁵³. Ky është në të vërtetë alfabeti i vetëm i përdorur në ato pak tekste të shkruara e të prodhuara në Shqipëri nga 1990-a e këtej, si fletëpalosje, postera etj.⁵⁴ Për këtë i duhet njohur merita Marcel Courthiade-s, i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për komunitetin

⁴⁹ Brezinger et al, vep.cit, f. 12.

⁵⁰ Yaron Matras, "Writing Romani: The pragmatics of codification in a stateless language", *Applied Linguistics* 20(4), 1999, f. 481-502.

⁵¹ Yaron Matras, "The Future of Romani: Toward a Policy of Linguistic Pluralism", European Roma Rights Centre, 11 March 2005.

⁵² Olsi Sherifi, gazetar me origjinë rome, i cili ka mësuar në mënyrë autodidakte të shkruajë e të lexojë në gjuhën rome.

⁵³ Ky është një prej disa alfabeteve që përdoren më së shumti për shkrimin e gjuhës rome, si alfabeti "panvllah", ai "i anglicizuar" etj.

⁵⁴ Alfabeti i propozuar nga Courthiade përdoret në sistemin arsimor rumun, por në mënyrë sporadike edhe në Maqedoninë e Veriut dhe Serbi.

rom të Shqipërisë jo vetëm përmes veprave për dokumentimin dhe kodifikimin e romishtes, por edhe zbatimit të një vargu projektesh të rëndësishme të natyrës sociale e kulturore. Prania e tij fizike e gjatë dhe e pandërprerë në Shqipëri ka patur, gjithashtu, rolin e vet të pazëvendësueshëm.

7. Qëndrimet dhe politikat gjuhësore qeveritare dhe institucionale, përfshirë statusin zyrtar dhe përdorimin, janë një tjetër tregues për shkallën e rrezikimit të një gjuhe. Ç’ mund të thuhet për romishten në këtë aspekt? Gjuha romë në Shqipëri ka prej të paktën 4 vitesh statusin e një gjuhe pakice kombëtare, ndaj së cilës shteti ka shpallur një politikë mbrojtjeje, mbështetjeje e nxitjeje për zhvillim. Kjo politikë gjen shprehjen e saj të hapur në një varg dokumentesh ligjore, si: *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* (1998)⁵⁵; *Konventa Kuadër Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*⁵⁶, një ligj i prodhuar prej Këshillit të Europës (1994) e i ratifikuar prej shtetit shqiptar (1999)⁵⁷; *Ligji Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë* (2017)⁵⁸; *Ligji Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë* (2012)⁵⁹; *Ligji Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë* (1998)⁶⁰; si dhe disa ligje të tjera e një numër vendimesh qeveritare. Në këto dokumente garantohen një sërë të drejtash gjuhësore për pakicat kombëtare, ndër të cilat e drejta për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre kulturor e gjuhësor; e drejta për t’u arsimuar në gjuhën amtare; për ta përdorur këtë të fundit jo vetëm në jetën private, por edhe atë publike; e drejta për t’u informuar në gjuhën amtare; për të patur median e shkruar dhe elektronike në atë gjuhë etj.

⁵⁵ Neni 18, Neni 20, Neni 22, Neni 23, Neni 24.

⁵⁶ Neni 5, Neni 6, Nenet 9-14.

⁵⁷ Përmes ligjit nr. 8496, dt. 3.06.1999.

⁵⁸ Nenet 12-15.

⁵⁹ Nr. 69/2012, ndryshuar me ligjin nr. 56/2015, dt. 28.5.2015. Shih Nenin 10, “Arsimimi për pakicat kombëtare”.

⁶⁰ Nr. 8410, dt. 30.9.1998 (ndryshuar me ligjin nr. 8655 date 31.07.2000; ligjin nr. 8794 date 10.05.2001; ligjin nr.9016 date 20.2.2003; ligjin nr.9124 date 29.07.2003; ligjin nr. 9531 dt. 11.05.2006; ligjin nr. 9677, dt. 13.01.2007). Shih nenet 36, 37, 68.

Edhe pse zyrtarisht shtet njëgjuhësh⁶¹, Shqipëria rezulton me një kuadër ligjor, që u siguron gjuhëve të pakicave mbrojtje e përkrahje të plotë. Një kuadër ligjor i tillë flet kështu për një politikë gjuhësore pluraliste të shtetit shqiptar, çka do ta rendiste këtë politikë në shkallën më të lartë të klasifikimit (5), kur shteti dhe institucionet u japin të gjitha gjuhëve mbështetje a përkrahje të barabartë. Gjykuar mbi bazën e një politike të tillë, gjuhës rome në Shqipëri nuk i kanoset kurrfarë rreziku. Por të mos harrojmë që shpallja e një politike gjuhësore nuk nënkupton edhe zbatimin automatik të saj, çka bën shpesh që mes politikave të shpallura dhe praktikave të ekzistojë një hendek i thellë. Kjo është situata, që ka të bëjë me disa gjuhë pakicash kombëtare në Shqipëri të shpallura rishtas si të tilla, të njohura me termin “gjuhë joterritoriale”⁶² (gjuha rome dhe arumanishtja). Ligji *Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë* (2017), ndonëse në fuqi prej 4 vjetësh, është pasuar me daljen e një numri shumë të kufizuar aktesh nënligjore⁶³, të cilat e kanë penguar praktikisht zbatimin e tij për të mundur realizimin e politikës gjuhësore të shpallur.

⁶¹ “Gjuha zyrtare e Republikës së Shqipërisë është shqipja” (*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* (1998), Neni 14.1.)

⁶² Termi “gjuhë joterritoriale”, që del dhe përkufizohet për herë të parë te *Karta Evropiane për Gjuhët e Pakicave ose Krahinore*, nënkupton ato “gjuhë të përdorura nga qytetarët e një shteti, të cilat ndryshojnë nga gjuhët e përdorura prej pjesës tjetër të popullsisë së atij shteti, por që, edhe pse të përdorura tradicionalisht brenda territorit të shtetit, nuk mund të identifikohen me një trevë të caktuar të tij” (Neni 1/c).

⁶³ VKM nr.561, dt. 29.9.2018, *Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare*. VKM nr. 562, dt. 29.9.2018, *Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë*. VKM nr. 227, dt. 17.4.2019, *Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare*. VKM nr. 463, dt. 3.7.2019, *Mbi përcaktimin e drejtimeve për miratimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për promovimin dhe krijimin e kushteve të nevojshme për personat, që u përkasin pakicave kombëtare për të përdorur dhe zhvilluar elementet themelore të identitetit të pakicave kombëtare, duke përfshirë edhe gjuhën e tyre*. VKM nr. 1155, dt. 24.12.2020, *Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrit*

8. **Qëndrimet e anëtarëve të komunitetit ndaj gjuhës së vet** kanë, gjithashtu, pjesën e tyre të rëndësishme në vlerësimin e shkallës së rrezikimit të gjuhës. Këto mund të jenë qëndrime pozitive, negative ose asnjësi, ndër të cilat qëndrimet positive shërbejnë si një nxitje për një përdorim më të madh dhe zhvillim të mëtejshëm të gjuhës, duke rritur kështu vitalitetin e saj. Të tjerat, kuptohet, ndikojnë në rritjen e shkallës së rrezikimit të gjuhës si pasojë e reduktimit të përdorimit dhe mungesës së përpjekjeve për ruajtjen dhe zhvillimin e saj, çka çon më pas në braktisjen e saj dhe përqafimin e një gjuhe tjetër.

Vlerësimi sasior apo matjet e këtij faktori për anëtarët e komunitetit rom në Shqipëri, përmes një pyetsori që kishim përgatitur, nuk qe e mundur të realizoheshin për arsyen që e bëjnë të ditur më lart. Kemi në dorë, ndërkaq, një të dhënë të rëndësishme, sipas së cilës 99% e romëve e konsiderojnë romishten si elementin kryesor, që i dallon ata prej shqiptarëve⁶⁴. Kjo dëshmon se romët e Shqipërisë kanë një shkallë tepër të lartë të vetëdijes mbi përkatësinë apo identitetin e tyre etnik, pavarësisht numrit real të folësve të romishtes. Një gjuhë i ka “të numëruara ditët”, kur folësit e saj nisin ta humbasin kujtesën identitare etnike e kulturore, por ajo i ka të mëdha gjasat për t’u fuqizuar e zhvilluar, nëse kjo kujtesë ruhet e përpunohet më tej.

9. **Sasia dhe cilësia e dokumentimit** të një gjuhe është një tregues tjetër me vlerë, që dëshmon shkallën e rrezikimit të saj. Dokumentimi nënkupton ekzistencën jo vetëm të materialeve të shkruara, si fjalorë, gramatika, tekste të ndryshme, letërsi, gazeta etj., por edhe të materialeve të regjistruara audio e video të zbardhura/transkriptuara, të përkthyer dhe të anotuara⁶⁵. Sa më shumë dhe sa më mirë të jetë e dokumentuar një gjuhë, aq më pak i kanoset asaj rreziku i

thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare.

⁶⁴ Të tjerë konsiderojnë si elemente kulturore themelore muzikën (80%), festat (80%), ceremonitë familjare (74%), zanatin e punimit me kashtë (67%), veshjet e grave (63%). Shih De Soto *et al.*, *Roma and Egyptians in Albania ...*, vep.cit., f.15.

⁶⁵ Brezinger *et al.*, vep.cit, f. 16.

zhdukjes. Përkundrazi, mungesa e dokumentimit ose dokumentimi i paktë e jociësor e vënë atë në një situatë jo të favorshme⁶⁶.

Si rezulton niveli i dokumentimit të romishtes? Kemi të bëjmë me një gjuhë transnacionale, pra, me një gjuhë, që ka një traditë si mjet komunikimi në një territor mjaft të gjerë, që nuk njihet kufij shtetërorë. Në kushte të tilla është krejt e kuptueshme që romishtja funksionon përmes varietetesh të shumta dialektore, gjithsecili i ndikuar prej gjuhës/gjuhëve dominuese me të cilat ka qenë e është në kontakt. Edhe pse gjuhë deri vonë e pashkruar e, për pasojë, e lëvruar shumë pak në letërsi e media të shkruar, romishtja rezulton një gjuhë e dokumentuar, e përshkruar dhe e studiuar mirë nga pikëpamja gjuhësore. Mjafton të përmendim vetëm dy ndërmarrje shkencore shumë të rëndësishme, që kanë realizuar dokumentimin dhe përshkrimin e dialekteve rome: *Romlex*, një bazë të dhënash leksikore online, që dokumenton leksikon e romishtes në 25 varietete të saj me përkthim në 15 gjuhë të botës; dhe një bazë të dhënash të morfosintaksës rome për më shumë se 100 varietete të romishtes ngritur pranë Universitetit të *Manchester*-it në kuadrin e një projekti ndërkombëtar.

Sa u takon të folmeve rome në Shqipëri - pjesë përbërëse e dialektit të njohur si *romishte ballkanike* -, mjaft të ndikuara prej shqipes, gjuhës dominuese, me të cilën ato kanë qenë në kontakt, nuk di të ketë patur përpjekje në vend për dokumentimin e tyre përmes regjistrimesh audio e video⁶⁷ dhe se sa përfaqësohen ato në dy ndërmarrjet e sipërpërmendura. Romishtja, sidoqoftë, duhet konsideruar si një gjuhë e dokumentuar shumë mirë, çka i jep asaj pikavarazhin më të lartë (5) në klasifikimin e faktorit përkatës.

Vlerësimet e mësipërme sasiore (matjet sipas sistemit 6-pikësh), por edhe ato cilësore (konsiderimi i disa faktorëve si më të rëndësishëm se të tjerët sa i takon

⁶⁶ Për ndonjë studiues “sasia dhe cilësia e dokumentimit nuk përbën në vetvete një indeks për vlerësimin e vitalitetit. Ekzistojnë gjuhë në botë, të cilave u mungon dokumentimi e, megjithatë, kanë folës. Sikurse ka të tjera, që janë të dokumentuara mirë, por që po i humbasin folësit krejt” (Ogone John Obiero, “From Assessing Language Endangerment ...”, art.cit., f.208).

⁶⁷ As regjistrimet e lajmeve në gjuhën rome, që jepen çdo ditë në RTSH2, nuk ruhen në arkivin përkatës (sipas pohimit të një burimi nga redaksia e lajmeve në gjuhët e pakicave kombëtare).

peshës që ato kanë për indeksin e vitalitetit), na sugjerojnë që shkalla e rrezikimit të romishtes në Shqipëri është më e ulët nga ç'konstatohet në *UNESCO Atlas of the World's Languages in Danger*. Ajo, pas gjasash, duhet klasifikuar si një “gjuhë e pasigurt”/*unsafe language* (4) dhe jo një “gjuhë vërtetë e rrezikuar”/*definitely endangered* (3). Megjithatë, përtej etiketimeve, të cilat gjithmonë ngjallin diskutime, vlerësimet e bëra duhet të shërbejnë si orientim bazë për të ndërmarrë veprime e ndërhyrje me karakter mbështetës, fuqizues a rivitalizues ndaj romishtes si gjuhë e rrezikuar.

Shkalla e rrezikimit të romishtes te ne, sikurse e pamë më lart, rezulton e lartë veçanërisht për faktin se ajo nuk është shtrirë apo nuk e ka zgjeruar përdorimin e saj në domene të reja⁶⁸, por edhe pse nuk ekzistojnë materiale të shkruara, që shërbejnë për arsimimin gjuhësor dhe alfabetizimin e romëve⁶⁹. Pra, romishtja nuk ka treguar kurrfarë prirjeje për zgjerimin e sferave të përdorimit duke vijuar të mbetet një gjuhë thuajse tërësisht e folur në domenin e shtëpisë dhe me përdorim vetëm në sferën private. Po kështu, romishtja nuk funksionon ende si gjuhë e shkollës dhe e arsimit, me gjithë kuadrin ligjor, që mundëson përdorimin e saj. Çfarë mund të bëhet? Hapi i parë që duhet ndërmarrë, është ideimi apo konceptimi i kurrikulës zyrtare përkatëse, ku të mbahet mirë parasysh fakti se pjesa dërrmuese e fëmijëve romë të moshës parashkollore janë folës njëgjuhësh në gjuhën e tyre amtare. Në këto rrethana studiuesit e fushës sugjerojnë një kurrikul, që parashikon alfabetizimin e fëmijëve në gjuhën e tyre amtare, në romishte, për të kaluar më pas në mësimin e gjuhës së shumicës, e për të vijuar më tej në arsimim dygjuhësh për krijimin e një bilinguizmi të qëndrueshëm⁷⁰.

Me realizimin e arsimit në gjuhën rome janë të lidhura ngushtë edhe dy çështje shumë të rëndësishme, pa të cilat ajo nuk mund të realizohet: e para, përgatitja e mësuesve të specializuar në mësimdhënien e romishtes si lëndë më vete, por dhe në mësimdhënien e lëndëve të tjera në gjuhën rome; e dyta, sigurimi i materialeve shkollore të shkruara.

⁶⁸ Faktori 5, i vlerësuar me 1 pikë.

⁶⁹ Faktori 6, i vlerësuar me 2 pikë.

⁷⁰ Yaron Matras, “The Future of Romani...”, art.cit.

Sa u takon **mësuesve**, këta duhet të jenë medoemos nga radhët e komunitetit rom, me një formim solid në fushën e mësimdhënies në përgjithësi e në mënyrë të veçantë në mësimdhënien e romishtes. Në Shqipëri nuk ka patur dhe nuk ka një institucion për përgatitjen e kuadrit mësimdhënës të gjuhës rome e në gjuhën rome. Për t'i siguruar ata shteti shqiptar mund të dërgonte fillimisht të rinj romë për të studiuar në institucione arsimore të vendeve me përvojë në këtë drejtim, si në Rumani, Çeki, Sllovaki, Hungari etj., e më pas të planifikonte ngritjen e tyre në vend.

Lidhur me **materialet shkollore të shkruara**, si tekste shkollore, literaturë mbështetëse, libra, fjalorë etj., problemi që del, është varieteti në të cilin duhet të jenë ato. Ende nuk ka, siç e thamë edhe më lart, një varietet standard të romishtes, pasi kemi të bëjmë me një gjuhë të një diaspore, që është e shpërndarë thuajse në tërë botën e, për pasojë, nuk ka një autoritet të vetëm të angazhuar në veprimtari planifikuese gjuhësore për ta ndryshuar statusin e saj nga një gjuhë vernakulare në një gjuhë standarde. Ekzistojnë ndërkaq disa varietete të kodifikuara të romishtes në shtete të ndryshme (Sllovaki, Austri, Hungari, Serbi, Rumani etj.), të ngritura mbi dialekte lokale, që fliten nga populli rome atje, varietete të cilat përdoren si gjuhë arsimimi, gjuhë e medias etj. Ekzistenca e një modeli të tillë kodifikimi policentrik na vë kështu përpara zgjedhjes: ose të krijojmë një varietet të kodifikuar të romishtes që flitet në Shqipëri (por që kërkon burime financiare e njerëzore të mëdha), ose të huazojmë për nevojat tona një varietet të gatshëm prej atyre që përmendëm më lart. Pa u zgjidhur çështja e varietetit që do të përdoret, nuk mund të flitet praktikisht për arsimim të romëve në gjuhën e tyre amtare.

Ndërhyrjet e mësipërme, të ashtuquajtura “nga lart-poshtë”, të cilat ndërmerren e realizohen nga institucionet shtetërore në vende, ku gjuhët e pakicave kombëtare njihen e respektohen ligjërisht, nuk mund të jenë të suksesshme e frytdhënëse, nëse nuk mbështeten e nuk nxiten prej komunitetit, që e flet gjuhën e pakicës, që rrezikon të bjerret. Po për ta realizuar këtë komuniteti duhet të jetë i ndërgjegjësuar për rrezikun, që i kanoset gjuhës së vet. A e kanë vallë këtë shkallë ndërgjegjësimi romët në Shqipëri? Vështirë të jepet një përgjigje pozitive për sa kohë nuk ka ende një elitë të dalë prej këtij komuniteti, së cilës, si kudo tjetër, do t'i takonte detyra jo vetëm për këtë, por edhe për ta

nxitur komunitetin për të ushtruar presion për kërkesat e veta. Nuk ka, pra, kurrfarë aktivizmi social nga radhët e romëve, aq më pak aktivizëm për të realizuar të drejtat e tyre gjuhësore. Problemet e mëdha ekonomike dhe shoqërore, që vazhdon të ketë ky komunitet, i kanë lënë në hije çështjet e natyrës kulturore e gjuhësore të tij.

Ruajtja, fuqizimi dhe rivitalizimi i një gjuhe të rrezikuar është një proces i gjatë e kompleks, që kërkon njëherësh angazhimin e shtetit dhe të komunitetit, që e flet gjuhën e rrezikuar. "...suksesi i këtij procesi është i vështirë dhe kërkon një ndërhyrje rigorozë teorike dhe empirike, mbështetje financiare e legale dhe sidomos një mobilizim total të komunitetit dhe institucioneve të tij nëpërmjet ideologjish të fuqishme"⁷¹

REFERENCA

- BAKKER, Peter & KYUCHUKOV, Hristo (eds.) (2000), *What is the Romani Language*, Hartfield, University of Hertfordshire Press.
- BAKKER, Peter, ROOKER, Marcia, (2001), "The political status of the Romani Language in Europe", *Mercator-Working Papers num.2*, 2001, f.1-37.
- BREZINGER, Matthias et al., (2003), *Language Vitality and Endangerment*, Document submitted to the *International Expert Meeting on UNESCO Programme Safeguarding of Endangered Languages*, Paris, 10-12 March, 25 fq.
- Census 2014, Banesat dhe popullata rome në Shqipëri*, (2014), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë.
- Censusi i popullsisë dhe banesave 2011* (2012), Instituti i Statistikave, Tiranë (www.instat.gov.al).
- COURTHIADE, Marcel, (1989), *Gramatika e gjuhës rrome*, vëll. I: *njohuri të përgjithshme, fonologji, morfologji*, Tiranë, 179fq.
- COURTHIADE, Marcel, (1990), *Rromano Startorro*, Sarajevo: Svjetlost, 64 fq.
- COURTHIADE, Marcel, (1990), *Rromano Startorro*, Sarajevo: Svjetlost, 92 fq.
- COURTHIADE, Marcel, (2004), *Fjalor rromisht-shqip: i të folmeve rrome në përdorim në Shqipëri: meçkarisht, kabuxhisht, rupanisht e*

⁷¹ Eda Derhemi, "Arbërishtja – gjuhë e rrezikuar", art.cit., f. 217.

shkodranisht, rreth 4400 fjalë; me një fjalorth shqip- rromisht, rreth 3000 fjalë, Rromani Baxt, Tirana, 252 fq.

DE SOTO, Hermine, BEDDIES, Sabine, GËDESHI, Ilir (2005), *Roma and Egyptians in Albania, From Social Exclusion to Social Inclusion*, World Bank Working Paper, No.53.

DERHEMI, Eda (2020-2021), “Arbërishtja – gjuhë e rrezikuar”, në *Continuum, Revistë e Studimeve Arbëreshe*, Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët, viti I, nr. 1, 2020-2021, f. 211-224.

GËDESHI, Ilir, JORGONI, Elira, (2011), *Mapping Roma Children in Albania*, Centre for Economic and Social Studies (CESS), Tirana.

GOMASHIE, Grace A., TERBORG, Roland, “Nahuatl, selected vitality indicators and scales of vitality in an Indigenous language community in Mexico”, në *Open Linguistics* <https://doi.org/10.1515/opli-2021-0010>

GRENOBLE, Lenore, and WHALEY, Lindsay (eds.), (1998), *Endangered Languages: Current Issues and Future Prospects*, Cambridge: Cambridge University Press, 361 fq.

HALWACHS, Dieter W., *Roma Language*, Sociolinguistics, Council of Europe, Project Education of Roma Children in Europe, f.2)

KOINOVA, M., (2000), *Minorities in Southeast Europe: Roma of Albania*, Center for Documentation and Information on Minorities in Europe – Southeast Europe (CEDIME).

MATRAS, Yaron, (1999), “Writing Romani: The pragmatics of codification in a stateless language”, *Applied Linguistics* 20(4), f. 481-502.

MATRAS, Yaron (2005), “The Future of Romani: Toward a Policy of Linguistic Pluralism”, European Roma Rights Centre, 11 March.

Minority Rights Group International, *World Directory of Minorities and Indigenous Peoples – Albania: Roma*, 2008 (<https://www.refworld.org/docid/49749d6449.html>)

OBIERO, Ogone John, (2010), “From Assessing Language Endangerment or Vitality to Creating and Evaluating Language Revitalization Programmes”, *Nordic Journal of African Studies* 19(4): 201–226.

- RACOVA, Anna, SAMKO, Milan (2017), “On the vitality and endangerment of the Romani Language in Slovakia”, *Asian and African studies* 26(2), f. 185-208.
- RAPORTI i pestë periodik paraqitur nga Republika e Shqipërisë mbështetur në nenin 25, paragrafi 2, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e minoriteteve”* (2021), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- SIMON, Patrick, GALANXHI, Emira, DHONO, Olgeta (2015), *Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: Profili social-demografik dhe ekonomik bazuar në Censusin 2011*, Tiranë (përgatitur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri, në kuadër të Programit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” i financuar nga Agjensia Zvicerane për Zhvillim e Bashkëpunim).
- SORESCU-MARINCOVIC, Annemarie, MIRIC, Mirjana, CIRKOVIC, Svetlana (2020), “Assessing Linguistic Vulnerability and Endangerment in Serbia. A Critical Survey of Methodologies and Outcomes”, në *Balkanica LI* (2020), f.65-104.

PROF. DR. ARBËR ÇELIKU

FAKULTETI I FILOLOGJISË

UNIVERSITETI I TETOVËS

arber.celiku@unite.edu.mk

**PUSHTETI I GJUHËS NË SHOQËRITË E MARGJINALIZUARA.
RASTI ME SHQIPTARËT E MAQEDONISË SË VERIUT**

Abstrakt

Boshti tematik i këtij punimi do të konsistojë në vënien në dukje të pushtetit të gjuhës shtetërore (maqedonase) ndaj popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut, edhe atë jo vetëm në përdorimin e leksemave të caktuara, por, para së gjithash, në komunikimin institucional.

Duke marrë parasysh implikaturat komunikuese të së shkuarës, kur institucionet kanë qenë kryekëput në zotërim të maqedonasve, shqiptarët edhe sot e ndiejnë pushtetin e gjuhës maqedonase. Shembujt e vjellë në terren dëshmojnë për këtë, sidomos në komunikim me gjykatat, policinë, administratën shtetërore, dhe kështu me radhë.

E gjithë kjo ndikon që, edhe pse gjuha shqipe me ndryshimet kushtetuese të vitit 2001 gjen përdorim ligjor në nivelin komunal, të kufizohet shtrirja e saj diakronike institucionale, gjë që e pamundëson edhe avancimin e saj të domosdoshëm në piramidën shtetërore.

Me këtë rast do të trajtohen faktorët e ndryshëm të kësaj amullie etnike-gjuhësore si ato: psikologjikë, historikë-shoqërorë, politikë dhe institucionalë, por do të ngritën gjithashtu mundësitë e përmirësimit të rrethanave faktike bazuar në legjislacionin në fuqi të përdorimit të shqipes në Maqedoninë e Veriut si dhe do të tentohet të ngritët vetëdija kolektive në shpërndarjen nga stigmatizimi i mëtejshëm etnik-gjuhësor.

Fjalët kyçe: *gjuha shqipe, gjuha maqedonase, pushteti i gjuhës, shoqëri të stigmatizuara, faktorët psikologjikë, historikë-shoqërorë, politikë, institucionalë*

1. Hyrje

Sado që sot e gjithë ditën të proklamohet se shqiptarët në Maqedoninë e Veriut i kanë realizuar të drejtat e tyre si përdorimin e gjuhës shqipe në nivel zyrtar, simbolet, përfaqësimin në piramidën e shtetit, dhe kështu me radhë, po mbetemi ende larg realitetit objektiv dhe rrëshqasim shkarazi në vorbullën e politikave ditore dhe nuk i ndihmojmë aspak procesit të avancimit të të drejtave kombëtare, që neve shqiptarëve na takojnë si populli i dytë më i madh numerikisht në Maqedoninë e Veriut, por edhe duke marrë parasysh të drejtën

tonë natyrore, pasi jetojmë në tokat tona gjeneratë pas gjenerate dhe kontribuojmë në sendërtimin e shtetit si në rrafshin ekonomik, politik dhe shoqëror.

Megjithatë, Maqedonia e Veriut paraqet një shoqëri dhe një njësi shtetërore komplekse, duke imponuar shtimin e problemeve rregulluese politike, gjë që e shteron mbështetjen në idetë pretenduese për demokraci. Kjo buron nga vazhdimi i politikave jugosllave ndaj shqiptarëve dhe komuniteteve tjera jomaqedonase edhe me mëvetësimin e Maqedonisë së Veriut në vitin 1991, kompleksi i një populli të vogël siç janë maqedonasit dhe krijimi i elitave politike populiste, diskursi politik i të cilave është përplot me nacionalizëm dhe urrejtje për të tjerët, kurse veprimtaria politike karakterizohet nga një plaçkitje masovike e buxhetit të shtetit, korrupsioni i skajshëm, diferencimi shoqëror, partizimi i shtetit dhe klientelizmi i pashoq.

Gjithsesi se në këto premisa shoqërore, po krijohet një disbalancë e tmerrshme, në radhë të parë, politike, juridike, ekonomike, gjuhësore, kulturore, dhe kështu me radhë. Kësisoj sa vjen dhe rritet pushteti etnik, institucional, gjuhësor dhe kulturor, gjë që konturon dukshëm një aparteid etnik, i cili bie ndesh me Kartën e Kombeve të Bashkuara për liritë themelore dhe të drejtat e njeriut (1948) si dhe me të gjitha konventat shoqëruese evropiane në këtë frymë. Kësisoj, e drejta natyrore e etnive jomaqedonase në Maqedoninë e Veriut (sidomos e popullit shqiptar) ka mbetur vetëm që të mbështetet në konceptonet metafizike.

Synimi i këtij punimi, me karakter lingvistik, synon shtjellimin e problematikës së pushtetit të gjuhës shtetërore (maqedonase) në Maqedoninë e

Veriut te popullata shqiptare, si një kontinuitet i imponuar ndër dekada, pavarësisht se ekziston tashmë një kornizë e përdorimit të gjuhës amtare shqipe përgjatë shkollimit, përmes medimeve të shkruara dhe elektronike, televizionit, etj.

2. Statusi i gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut

Sot e gjithë ditën janë ngritur dy teza shkencore se gjuha shqipe është gjuhë zyrtare apo gjen përdorim zyrtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por që as njëra dhe as tjetra tezë nuk është e qëndrueshme, duke marrë parasysh legjislacionin në fuqi, ndërsa jetësimi praktik i gjuhës shqipe përbën vetëm se një

dekor politik dhe, për dy dekada, është kthyer në gjah për përfitimin e votës shqiptare.

Në të vërtetë, pas konfliktit të vitit 2001 dhe arritjen e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit me ndërmjetësimin ndërkombëtar, u imponuan ndryshimet kushtetuese, ku do të avancohej përdorimi i gjuhës dhe simboleve të etnive jomaqedonase, përmes Amendamentit V, ku thuhet: “Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, siç është përcaktuar me këtë nen” (për më tepër shih: Kushtetuta e RM-së, Amendamenti V, 2001). Sjellja e një ligji për përdorimin e gjuhës së komuniteteve (ku bëjnë pjesë edhe shqiptarët, pavarësisht përfaqësimit zyrtar numerik me 25,4 % të regjistrimit po të vitit 2001) u zvarrit për arsye politike dhe vetëm në vitin 2008, gjatë qeverisjes së të djathtës nacionaliste maqedonase VMRO-DPMNE dhe BDI-së shqiptare, u soll ligji për përdorimin e gjuhëve të komuniteteve në pajtim me Kushtetutën e vitit 2001, në të cilin shqipja kishte status të barabartë juridik me gjuhët e komuniteteve tjera si turke, rome, serbe, bullgare etj.

Me rrëzimin e qeverisë VMRO-BDI dhe formimit të qeverisë së re LSDM-BDI-ASH, në vitin 2018 u soll edhe një ligj për përdorimin e gjuhëve, me të vetmen risi që gjuha shqipe u fut në kllapa: “Gjuha tjetër që e flasin më së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu, është gjuhë zyrtare dhe shkrimi i saj (shqip) në pajtim me këtë ligj” (neni 1, pika 2), ku kemi një rimarrje implicite të togfjalëshit emëror “gjuha tjetër” me leksemën “shqip”, edhe atë në kllapa jashtë çdo norme gjuhësore, lë të kuptohet disi se gjuha shqipe po futet fshehurazi në këtë ligj, megjithatë rezulton edhe i paqartë në disa çështje të rëndësishme, nga të cilat vlen të theksohet se në këtë ligj është lënë pasdore përdorimi i gjithmbarshëm territorial i “gjuhës tjetër (shqip)”, që nënkupton se përdorimi i saj është i mundshëm aty, ku “qytetarët” shqiptarë numerikisht përfaqësohen, së paku, me 20%, dhe kjo do të ndodhë krahas përdorimit të gjuhës së vetme zyrtare, që është gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik (neni 1, pika 3), kurse aty, ku shqiptarët numerikisht do të jenë nën 20%, gjuha zyrtare do të jetë vetëm gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik, përveç në rastet ku mund të arrihet konsensusi politik: “Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabetin që e përdorin më pak

se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale” (neni 1, pika 4). Vetëm sa për ilustrim, se sa ende vazhdon të jetë margjinalizues shteti i Maqedonisë së Veriut sidomos ndaj shqiptarëve si popull de facto shtetformues (sipas konventave evropiane për të drejtat e njeriut numerikisht mbi 20%), po i referohemi Kushtetutës së Republikës së Kosovës për përdorimin e gjuhëve: “Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe[sic!]” (neni 5, paragrafi 1), ku serbët kanë statusin e enklavës (me rreth 3% përfaqësim numerik) dhe “Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome [sic!] kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj” (neni 5, paragrafi 2), etni këto që trajtohen si pakica a minoritete dhe gëzojnë të drejtat e njëjta me shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, që duhej të kishin statusin e popullit përbërës, duke marrë parasysh përfaqësimin numerik mbi 20% në përputhje me konventat evropiane për liritë dhe të drejtat e njeriut.

Kësisoj në diskursin publik sot e gjithë ditën në Republikën e Maqedonisë së Veriut lidhur me çështjen a është apo nuk është gjuha shqipe gjuhë zyrtare, ekzistojnë dy interpretime paralele: njëri juridik dhe tjetri politik, por që i pari e kundërshton prerazi të dytin. Madje edhe në përdorimin e vetëqeverisjes vendore, ku shqiptarët janë mbi 20% në përputhje me ligjin, vetëm përdorimi i gjuhës shqipe paraqet vepër penale (sipas Kodit Penal të RMV-së), nëse fillimisht në shkresat zyrtare, dokumentet juridike dhe administrative nuk është e pranishme edhe gjuha maqedonase, që e hedh poshtë tezën se gjuha shqipe gjen përdorim zyrtar edhe në rrafshin e vetëqeverisjes vendore: “Në njësitë e vetadministrimit lokal gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik” (Kushtetuta e RMV-së, Amendamenti V, neni 1, paragrafi 7).

I vetmi dallim nga periudha e para konfliktit të vitit 2001, është fakti se shqiptarët kanë fituar statusin e pakicës kombëtare, të riformuluar fillimisht si “pjesë e popullit shqiptar” (Kushtetuta e vitit 2001) dhe më pastaj si “komunitet” (Kushtetuta e vitit 2018, e cila pësoi ndryshime të imponuara shkaku i Marrëveshjes për emrin me Greqinë) dhe gjuha shqipe gëzon statusin e gjuhës së pakicës. Pra, shteti i Maqedonisë së Veriut, në vazhdimësi, bën shkelje të rënda që bien ndesh me frymën e Kartës së Kombeve të Bashkuara (1948) dhe, në

veçanti, me Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave etnike (nr. 8496, të datës 3.6.1999), të cilat botërisht promovojnë të drejtën e përdorimit të gjuhës, kulturës dhe simboleve.

Ky është një tregues se shteti nacional (unitar) siç vazhdon të jetë Maqedonia e Veriut, njerëzit i ndan në qytetarë dhe shtetas (me këto nocione e luajti mirë lojën politike kryeministri Zoran Zaev), duke krijuar një paradigmë të së drejtës përmes fërkimit negativ në mjedisin e një procesi demokratik, i cili prodhon të drejta subjektive dhe pretendime në interes të qytetarëve, duke siguruar një lloj fiktiv të autonomisë private, kurse nga ana tjetër duke e bërë të mundshme përdorimin aktiv të autonomisë publike të shtetasve. Dhe, fërkimi negativ midis autonomisë private dhe asaj publike është një premisë e domosdoshme për disbalancën e rendit të një shteti demokratik ligjor. Gjithsesi se kjo disbalancë krijon entitete me ndasi të rritura shoqërore, në të cilat zë vend një hendek specifik shtresash shoqërore. Këtu forcohen ndërsjelltazi abstenimi rritës nga zgjedhjet i shtresave të margjinalizuara dhe jo të privileguara shoqërore nga njëra anë dhe parapëlqimi i mostrave politike, të cilat i shpërfillin interesat e këtyre segmenteve të popullatës nga ana tjetër.

Në këto rrethana, përveç pushtetit etnik, zë e ftillohet edhe pushteti i gjuhës shtetërore, i cili ndikon dukshëm edhe në spektrin gjuhësor, kulturor dhe shoqëror.

3. Nocioni i pushtetit të gjuhës

Gjuha nuk është “vetëm një mjet i komunikimit ose dijes, por gjithashtu edhe një mjet i pushtetit” (Bordieu 1977:546), që nënkupton se raportet komunikuese janë “edhe raporte simbolike të pushtetit [...], në të cilat aktualizohen raportet e pushtetit midis folësve ose midis grupeve të tyre përkatëse shoqërore” (Bourdieu 2015: 41).

Përveç që gjuha është një “mjet i pushtetit”, në shtetet me sistem politik autokrat, hibrid, a jodemokratik, gjuha rezulton të jetë edhe “mjet i sundimit [...] ajo i shërben legjitimitetit të raporteve të pushtetit të organizuar” (Habermas 1970:278).

Me këtë rast, vihet në lëvizje një mekanizëm i tërë i aparatit shtetëror, që bluan çka gjen përpara. Imponimi i gjuhës shtetërore, siç ka ndodhur me shqiptarët nën sundimin jugosllav, serb dhe maqedonas më vonë, ndikon në

konstruktimin edhe të një realiteti përtej-gjuhësor, në veçanti duke prekur dukshëm, para së gjithash, sferën kognitive të grupit të sunduar etnik. Synimi ka qenë deformimi i gjuhës dhe, me këtë, edhe deformimi i mbarë korpusit kulturor, historik dhe kombëtar shqiptar. Pra, çështja është se në çfarë raporti komplementar qëndrojnë me njëra-tjetrën: gjuha, të menduarit dhe të vepruarit. Këto janë postulatet bazë të pushtetit të gjuhës në shoqëritë e marginalizuara.

Edhe pse gjuha paraqet një mjet të fuqishëm identifikimi, por edhe një mjet të ndërveprimit shoqëror dhe, në asnjë mënyrë, një instrument politik, prapëseprapë ndër shqiptarët e Maqedonisë, pushteti politik i gjuhës ka shkaktuar disa dëme kolateralë që, pa një strategji të mirëmenduar afatgjatë, do të reflektojnë negativisht në polarizimin e mëtejshëm etnik në Maqedoninë e Veriut. Si dëme me këtë rast do të konsideroheshin:

- Mospranimi i ndërsjellë i gjuhës, kulturës dhe historisë së tjetrit (për dallim nga gjeneratat e mëparshme, të rinjtë shqiptarë sot e njohin shumë pak gjuhën maqedonase dhe me bashkëmoshatarët e tyre maqedonas, në rastet e komunikimit të domosdoshëm, ndërveprojnë në gjuhën angleze); dhe
- Thellimi i pranisë së një gjuhe hibride shqipe, me efekt kundërproduktiv në rrafshin mbarëkombëtar.

Nënkreu në vazhdim paraqet pjesën empirike të këtij punimi dhe do të shtrohen rezultatet e hulumtimit, me qëllim të nxjerrjes në pah të këtyre dëmeve në sferën e një komunikimi të çoroditur publik, si rrjedhojë e pushtetit sistematik të gjuhës shtetërore (maqedonase) ndaj shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut.

4. Metodologjia e hulumtimit

4.1. Qëllimet

- Të nxirret në pah ndikimi i gjuhëve sllave gjatë komunikimit publik ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut në rrafshin paradigmatic
- Të trajtohen faktorët shoqërorë-psikologjikë të këtij përdorimi
- Si të parandalohet veprimtaria e mëtejshme komunikuese
- Roli institucional, administrativ, politik dhe shoqëror në përmirësimin e kësaj veprimtarie hibride komunikuese

4.2. Ndërtimi i korpusit të të dhënave

Korpusi i hulumtimit është ndërtuar në bazë të bisedave të rastit me individë nga shoqëria civile, me zyrtarë shtetërorë si policë dhe gjykatës, dhe mjekë. Gjithashtu është analizuar diskursi mediatik dhe ai politik.

4.3. Shtrimi i rezultateve të hulumtimit

Nga pushteti i gjuhëve sllave në vazhdimësi dhe, së fundmi, nga pushteti i gjuhës shtetërore maqedonase ndaj shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, vazhdon të jetë ende i pranishëm një hibridizim i gjuhës shqipe, sidomos në të folurit e moshave më të vjetra dhe të shtresave me arsimim më të ulët. Për ilustrim do të shërbejë një sekuencë bisede, të zhvilluar nga ana ime me një zonjë fqinje në moshë të thyer dhe me arsimim të ulët:

“Djali ka pasur një sudar para një kohe. Ka qenë me një shoq në qerre. I erdhi pokana për në sud. Shkoi dhe e kaznetën 300 euro. Drzhave keqe. Pa pas asnji faj. U ka ra njani dhe këta fajtorë. Ç’të bëj unë e mjera me një penzije 200 euro të burrit rafmetli. Nuk më dalin as për ilaçe. Shneti e kom llom. As në bollnecë për vete sun shkoj (...)”.

Ky fragment bisede është në të folmen e Kërçovës dhe, siç është evidente, për pranuesit e tekstit jashtë perimetrit të kësaj të folmeje, sidomos për shqiptarët nga Shqipëria, rezulton të jetë tërësisht jokohorent. Fjalët e nënvizuara në këtë fragment janë fjalë me prejardhje sllave, që sot e gjithë ditën e përshtojnë diskursin publik ndër folësit e moshave më të vjetra dhe me arsimim më të ulët jo vetëm në Kërçovë me rrethinë, por edhe në të folmet tjera të shqipes në Maqedoninë e Veriut, madje, nga sa kam mundur të konstatoj, kjo dukuri është edhe më e shprehur në rajonin e Pollogut. Kësisoj do të ishte teksti në shqipen standarde:

“Djali ka pësuar një aksident para një kohe. Ka qenë me një shoq në makinë. I erdhi ftesa për në gjykatë. Shkoi dhe e gjobitën 300 euro. Shteti keq. Pa pasur asnjë faj. U ka rënë njëri dhe këta fajtorë. Ç’të bëj unë e gjora me një pension prej 200 eurove të burrit të ndjerë. Nuk më mjaftojnë as për ilaçe. Me shëndet jam keq. As në spital nuk shkoj dot (...)”.

Po ashtu kjo dukuri vërehet edhe te moshë e mesme, sidomos te personat që janë shkolluar në gjuhën maqedonase, serbe, kroate a boshnjake. Në bisedë e sipër me një mjek nga rrethina e Tetovës, i cili është i punësuar në Spitalin klinik të Tetovës, më tha: “Edhe pse të gjithë jemi shqiptarë, mbledhjet i mbajmë më së

shumti në gjuhën maqedonase, sepse na vjen më kollaj të shprehemi shkaku i mosnjohjes së terminologjisë mjekësore në gjuhën shqipe”. Situata ndryshon me individët, të cilët janë shkolluar në Universitetin e Tiranës, të Prishtinës dhe të Tetovës. Në diskursin e këtij grupi thuajse është e pamundur të hasësh fjalë me prejardhje sllave, ose vetëm ndonjërin që tashmë është familjarizuar në gjuhën shqipe.

Grupmoshat e reja, siç dhe e cekëm më lart, në përqindje të lartë nuk e flasin gjuhën maqedonase dhe me moshatarët e tyre maqedonas komunikojnë në anglisht.

Faktorët për këtë janë si në vijim:

- Ndikimi i medimeve (teksa gjenerata e vjetër dhe ajo e mesme janë rritur kryesisht me medime në gjuhën maqedonase dhe serbe, në mungesë të atyre në gjuhën shqipe, kurse gjenerate e re ndjek kryesisht mediumet shqiptare të Shqipërisë dhe Kosovës
- Tregu i punës (para konfliktit 2001 ka qenë thuajse e pamundur punësimi në administratën shtetërore pa njohjen e gjuhës maqedonase)
- Mundësitë e studimit në gjuhën amtare
- Përfaqësimi politik në shtet pas konfliktit të vitit 2001, etj.

Sa i përket ndikimit të maqedonishtes si konglomerat i sundimeve paraprake sllave ndaj shqiptarëve, mund të krijohet një tipologji e këtij ndikimi në leksikon e shqipes në sferat si në vijim:

- **Gjuha administrative:**

Zapisnik për procesverbal (vërehet te të punësuarit shqiptarë në administratën vendore a shtetërore, te policët, te të punësuarit nëpër gjykata, etj.)

Uverenie për certifikatë

Izvod për certifikatë a vërtetim

Vençanicë për fletëkurorëzim (përdoret në masë të madhe te publiku i gjerë)

Sud për gjykatë

Reshenie për vendim

Uplatnicë për fletëpagesë

Patarinë për udhëpagesë etj.

Këto leksema përdoren kryesisht në diskursin e gjerë publik po thuajse në të gjitha të folmet e shqipes në Maqedoninë e Veriut.

Me këtë rast, kemi edhe përkthime kalke nga gjuhët sllave si: Gjykata Themelore për Gjykatën e shkallës së parë, Gjykata e Apelit për Gjykatën e shkallës së dytë, Fakulteti Filologjik për Fakultetin e filologjisë, parafjalën -pranë nga sllavisht -pri, në vend të parafjalës

-në, si psh: Jam i punësuar pranë Universitetit të Tetovës në vend të Jam i punësuar në Universitetin e Tetovës (sllavisht: Rabotam pri Univerzitetot vo Tetovo), etj.

- **Terminologjia mjekësore:**

Bollnicë për spital

Dezhurna për repartin e kujdestarisë

Uput për udhëzim mjekësor

Lekarstvo për vërtetim mjekësor

Hitna për ndihmën e shpejtë

Veshtaçkë për marrjen e infuzionit

Infektivna për repartin e sëmundjeve infektive, e lakuar sipas modelit sllav

Rak për kancer

Injekcije për gjipërë dhe e lakuar sipas modelit sllav

Recept për recetë etj.

- **Terminologjia teknike:**

Branik për parakolpë (edhe në Shqipëri me prejardhje italiane)

Menjaç për kambio (me prejardhje italiane)

Rebrasni për rrip me dhëmbëzore

Kaish për rripin e motorit

Shmigavac për sinjalizuesin e makinës

Far për dritën e makinës

Ususivaç për thithësen elektrike të pluhurit

Stub për shtyllë

Çatma për tra

Podupliraç për shtyllën mbajtëse gjatë ndërtimit etj.

Këta ishin vetëm disa shembuj ilustrues se sa ka ndikuar pushteti i gjuhës shtetërore maqedonase në diskursin publik ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, duke shkaktuar kështu edhe një hibridizim të gjuhës shqipe, megjithatë pushteti i gjuhës maqedonase shkon edhe përtej leksikut, madje duke prekur edhe implikaturat e sjelljes në ndërveprimin shoqëror.

Gjatë bisedave të zakonshme me policë dhe gjykatës shqiptarë, rezultojnë ndodhi interesante në punën e tyre të përditshme me palë. Policët pohojnë se shpesh detyrohen t'u drejtohen vozitësve shqiptarë në gjuhën maqedonase, që ata të sillen në mënyrë korrekte me ata në cilësinë e personit zyrtar. Një gjykatës me përvojë gati gjysmë shekullore nga rrethina e Gostivarit, tanimë i pensionuar, në bisedë e sipër për këto fenomene, pohoi se kur u ka folur shqip palëve me kombësi shqiptare nuk e kanë marrë seriozisht, dhe kur ka ndërhyrë daktilografistja me kombësi maqedonase, ka ndryshuar befas sjellja e tyre, duke dëgjuar me vëmendje të madhe.

Në këto raste ndikojnë faktorët psikologjikë, në ushtrimin e pushtetit të gjuhës administrative maqedonase, si rrjedhojë e represionit të vazhdueshëm shtetëror në të shkuarën.

Dhe, gjatë analizës së diskursit politik, ajo që bie menjëherë në sy, politikanët shqiptarë në Maqedoninë e Veriut, kur shkruajnë dhe flasin shqip, përdorin një gjuhë të bastarduar, me leksik dhe sintaksë të çalë, kurse disponojnë me njohuri solide të gjuhës maqedonase.

5. Përfundime

Gjuha është njëra ndër çështjet më delikate njerëzore, sepse çdo individ lind, rritet dhe jeton me të. Sado që ta mësojmë një gjuhë të huaj, ndryshe mendojmë, perceptojmë dhe veprojmë në gjuhën e nënës. Prandaj dhe ajo nuk duhet të instrumentalizohet në asnjë mënyrë politikisht, dhe as të ndërnyhet për qëllime personale, por të shërbejnë si një fushë betejë për të gjithë ne, gjuhëtarë, politikanë, krijues, etj., që shqipja të jetë arma më e fuqishme në zhvillimin pozitiv të proceseve shoqërore. Sidomos ne gjuhëtarët e të gjitha trevave tona duhet më shumë të fokusohemi në përmbajtjen e çështjes, se sa në trajtimin e formës, me synimin e krijimit të një platforme të qëndrueshme dhe unike gjuhësore për gjeneratat që vijnë.

Siç dhe u vërejt në këtë punim, gjuha shqipe ndër shqiptarët e Maqedonisë së Veriut ndodhet përpara një trysnie të madhe politike-shtetërore, ajo po merr trajtën e një gjuhe hibride, duke pësuar një asimetri të dukshme përdorimi në rrafshin sinkronik me standardin. Sa më shumë që të thellohet kjo dukuri, aq më shumë do të largohemi nga trangu i përbashkët, prandaj duhen dhe ideuar programe të përbashkëta për minimizimin e këtij rreziku identitar. Duhet rishikuar kurrikulat mësimore, unifikimin e librave mësimorë, thellimin e bashkëpunimit institucional dhe krijimin e politikave të shëndosha gjuhësore.

Gjuha jonë e bukur dhe e dëlirë, siç do të thoshte Naimi, nuk duhet të jetë një “gogol” për ne, që na e vështirëson veprimtarinë komunikuese, por ajo duhet të paraqesë një instrument të shprehjes në mënyrën më të mirë të mundshme të mendimit, ndjenjës, dashurisë dhe unifikimit mbarëkombëtar.

Referencat

Bourdieu, Pierre: The Cultural Transmission of Social Inequality. Në: Harvard Educational Review (1977) 47 (4): 545–555

Bourdieu, Pierre: Perspectives on language in society. Në: Handbook of Pragmatics 2015: 36-47.

Habermas, Jürgen: Zur Logik der Sozialwissenschaften. Suhrkamp, Frankfurt am Main 1970

Dëshmitë

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut (2002, 2001, 2017) (www.vlada.gov.mk)

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (kryeministri.rks-gov.net)

Karta e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut (www.unric.org)

Ligji për përdorimin e gjuhëve (apj.gov.mk)

PROF. AS. DR. SPIRIDHULLA POÇI

DEPARTAMENTI I GJUHËS SHQIPE

UNIVERSITETI “EQEREM ÇABEJ” GJIROKASTËR

spiridhulla_poci@yahoo.com

AROMANISHTJA DHE GJENDJA E SAJ PËRBALLË GJUHËS SHQIPE

Abstrakt

Si në të gjithë hapësirën ballkanike, edhe në Shqipëri, komuniteti vllah jeton, prej shekujsh, në një bashkëjetesë paqësore me popullsinë shqiptare. Që pas Luftës së Parë Botërore e në vazhdim, pas rënies së sistemit komunist në vendet e Evropës Lindore, në vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare ka qenë trajtimi dhe mbrojtja e pakicave kombëtare, etnike, racore, fetare dhe e të drejtave të tyre nëpërmjet kuadrit ligjor të nënshkruar nga shtete të ndryshme.

Në këtë kuadër, edhe komuniteti vllah që jetonte dhe jeton në Shqipëri ruante në gjirin e tij gjuhën dhe kulturën e vet. Pas viteve 1990, kjo bashkësi është njohur si pakicë gjuhësore, por kushtet në të cilat u ndodh në këtë periudhë nuk favorizuan zhvillimin dhe ruajtjen e mëtejshme të gjuhës së saj, aromanishtes. Ndryshimi i marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore, pas vitit 1990, i shoqëruar me një emigracion masiv të popullsisë vllahe, prishi vatrën në të cilën ajo konservohej si gjuhë e zemrës, duke sjellë rruhdjen dhe rënien e saj. Sot, aromanishtja ruhet në vendbanimet unike vllahe, kurse në qendrat e tjera flitet mirë nga brezi i dytë dhe i tretë, por jo nga brezi i ri. Te vllahët, dikur dygjuhësh, sot mbizotëron gjuha shqipe.

Fjalët kyçe: aromanishtja, komunitet, legjislacion, politikat gjuhësore, vllah

Trajtimi dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave kombëtare, etnike, racore, fetare ka qenë një nga shqetësimet kryesore të bashkësisë ndërkombëtare pas rënies së sistemit komunist në vendet e Evropës Lindore. Shtetet e mëdha demokratike Perëndimore u përpoqën që, në këto vende, jo vetëm të krijonin një kulturë demokratike në të gjitha aspektet e jetës, në jetën politike e shoqërore, por të krijonin dhe kushtet e përshtatshme për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të pakicave.

Që pas Luftës së Parë Botërore, shumë shtete që dëshironin të bëheshin anëtare të Lidhjes së Kombeve, duhej të nënshkruanin deklaratat për njohjen e pakicave racore ose kombëtare që përfshiheshin brenda kufijve të tyre dhe të atyre të drejtave që gëzonte dhe shumica sunduese. Kështu në deklaratën e vitit

1921 kërkohet¹ “a) barazi para ligjit; b) përdorimin e gjuhës amtare në raportet private dhe në tregti, në çështjet të biznesit, në botimet dhe mbledhjet publike si dhe në gjykata; c) të drejtën e përfitimit falas nga institucionet bamirëse fetare e arsimore; d) në distriktet ku pakicat përbënin një numër të konsiderueshëm të popullatës mësimi në shkollat fillore të shtetit të zhvillohej në gjuhën e pakicës dhe një pjesë e barabartë e buxhetit qendror e vendor, për qëllime të edukimit, fetare e bamirësie, t’u jepej pakicave”. Më 1948 në “Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut” theksohej se njohja dhe respektimi i dinjitetit të njeriut dhe i të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore përbën themelin e lirisë, të drejtësisë dhe të paqes në botë². Dita - ditës të drejtat e pakicave po sanksionoheshin gjithnjë e më shumë në dokumente të tjera të kësaj organizate, ndër të cilat mund të përmendim: “Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike”, 1966 dhe “Deklarata mbi të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare, etnike, fetare dhe gjuhësore” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme më 1992.

Në një sërë dokumentesh të tjera që janë miratuar nga OSBE-ja, Këshilli i Evropës e Bashkimi Evropian, mbrojtja e të drejtave të pakicave ka qenë një nga problemet kryesore. Një nga dokumentet më të rëndësishme është Karta e Helsinkit, 1975, në të cilën theksohet çështja e “pakicave kombëtare ose e kulturave rajonale”. Në të theksohet “duke ditur kontributin që pakicat kombëtare ose kulturat rajonale mund të sjellin në bashkëpunimin mes këtyre shteteve në fusha të ndryshme të kulturës, të përpiqen që, kur brenda territorit të tyre ka pakica ose kultura të tilla, të lehtësojnë përhapjen e tyre, duke marrë parasysh interesat legjitime të antarëve të tyre”³. Ky dokument thekson, gjithashtu, që të merren masa për mbrojtjen dhe krijimin e kushteve për nxitjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të pakicave kombëtare. Edhe në dokumente të tjera si “Dokumenti i mbledhjes së Kompenhagës mbi dimensionin njerëzor të OSBE-

¹ AQH, fondi 151, viti 1925, dosja nr. 139: Protection des minorités par la Société des Nations, p. 16.

² Universal Declaration of the Human Rights, cituar nga R. Memushaj, Legjislacioni shqiptar për gjuhët e pakicave, Kërkime universitare, 2001, 5, f. 32.

³ Helsinki Final Act (1 August 1975) OSCE, sipas R. Memushi, Legjislacioni shqiptar për gjuhët e pakicave, Kërkime universitare, 2001, 5, f. 32.

së”, 1990, “Konventa-kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare”, 1995, “Deklarata universale e të drejtave gjuhësore”, 1996, theksohet mbrojtja e pakicave, duke përfshirë në të drejtat e tyre dhe të drejtat gjuhësore.

Edhe Shqipëria, duke qenë anëtare e OKB-së që nga viti 1955, ka ratifikuar, pothuajse, të gjitha konventat kryesore lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të kësaj organizate dhe të organizmave të tjerë ndërkombëtarë, si OSBE-së, KE-së etj. Ndër më kryesoret mund të përmendim: “Deklarata universale e të drejtave të njeriut”, 1948 (aderuar 1955); “Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial”, 1969 (aderuar 1994); “Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike”, 1966 (aderuar më 1991); “Pakti ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore”, 1976 (aderuar më 1991); “Akti final i konferencës së Helsinkit”, 1975; “Deklarata e Kopenhagenit”, 1990; “Karta e Parisit për një Evropë të re”, 1990; “Dokumenti i Konferencës së Moskës”, 1991; “Konventa – kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, 1995 etj.

Shteti shqiptar ka pranuar dhe nënshkruar dokumentet ndërkombëtare të respektimit të të drejtave të minoriteteve. Mund të themi se mimoritetet dhe pakicat e tjera në Shqipëri gëzojnë të gjitha të drejtat që gëzon dhe shumica sunduese e popullsisë. Shteti shqiptar jo vetëm që i mbron me ligj këto të drejta, por, në përputhje me kushtet reale të Shqipërisë, po përpiqet të krijojë mundësi për realizimin e tyre.

Vendi ynë gjithnjë është dalluar për një bashkëjetesë në harmoni dhe në paqe midis pakicave kombëtare dhe pakicave të tjera. Secila pakicë gjatë kësaj bashkëjetese ka demonstruar në vite origjinalitetin e vet, i cili është respektuar dhe, sipas mundësive, i janë krijuar kushte për ruajtjen dhe vazhdimësinë e tij në breza.

Duke u mbështetur në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e minoriteteve, qeveritë shqiptare kanë përpunuar politikat e tyre arsimore, të cilat kanë qenë gjithnjë politika të matura, që synonin integrimin jo të dhunshëm të pakicave në të gjitha aspektet e jetës së shoqërisë shqiptare. Kuadri ligjor për minoritetet në Republikën e Shqipërisë përfshin një numër të konsiderueshëm dispozitash ligjore të parashikuara në Kushtetutë, në Kodet Penale dhe të

Procedurës Penale, në aktet normative të Keshillit të Ministrave dhe Konventat e Ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

Në bashkësinë gjeografike dhe sociale të Gadishullit Ballkanik, në Shqipëri, Greqi, Bullgari dhe në vendet e ish-Jugosllavisë jeton në bashkëjetesë me popujt e këtyre vendeve edhe komuniteti vllah. Në Shqipëri vllehtë janë vendosur në Shqipërinë Qendrore dhe Jugore, kryesisht në jug të vijës Durrës-Ohër: në Durrës, Elbasan, Tiranë, Kavajë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Pogradec, Korçë, Gramsh, Ersekë, Përmet, Gjirokastër, Delvinë, Sarandë. Gjuha e këtij komuniteti është aromanishtja, një idiomë e latinishtes ballkanike.

Në morinë e të drejtave të minoriteteve të trajtuara në dokumente të shumta ndërkombëtare dhe kombëtare do të ndaleshim tek e drejta e pakicave për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës së tyre amtare. Ndër dokumentet më kryesore për këtë çështje janë “Karta evropiane për gjuhët rajonale ose të pakicave”, 1995 dhe “Deklarata universale e të drejtave gjuhësore”, 1996. Hartimi i këtyre dokumenteve u nxit nga qëllimi për të mbrojtur gjuhët rajonale ose të pakicave të Evropës, disa prej të cilave, për vetë kushtet ku ndodhen, rrezikojnë të zhduken.

Për sa i përket komunitetit vllah, ai është njohur si pakicë gjuhësore pas viteve 1990. Ky komunitet vazhdon të ruajë gjuhën dhe kulturën e vet, brenda gjirit të familjes. Në periudhën 1921-1939, në Shqipëri, krahas shkollave të pakicave të tjera, nën kujdesin e shtetit rumun, vazhduan të funksionojnë dhe të hapen shumë shkolla aromane ku mësimi zhvillohej në gjuhën rumune.⁴ Më vonë ligji i shtetëzimit të shkollave private në Shqipëri krijoi shumë probleme në marrëdhëniet shqiptare-rumune në lidhje me këto shkollat, të cilat u mbyllën dhe u rihapën disa herë. Pas vitit 1940 të gjitha shkollat aromane ishin mbyllur. Shkollat në gjuhën rumune në Shqipëri nuk mund të mbijetonin, sepse ato u ndien të huaja për vllehtë e Shqipërisë. Gjuha e tyre ishte aromanishtja dhe jo rumanishtja. Matilda Karaxhiu, akademike rumune, kur merret me statusin e arumunëve “autoktonë” që jetojnë në vendet ballkanike shpreh mendimin se këta janë pakicë në krahasim me popullsinë mazhoritare të shtetit në të cilin ndodhen

⁴ Shih K. Kyçyku, Arumunët e Shqipërisë në kontekst ballkanik, Bukuresht, 1999, f.198-218.

dhe kjo cilësi u jep të drejta, si ato që u janë akorduar të gjitha pakicave në çdo vend të botës, por vetë arumunët duhet t'i kërkojnë e t'i fitojnë të drejtat që u takojnë". Sipas saj, Rumania po ndërhynte për një arsimim në rumanishten letrare..., në një kohë që fëmijët e arumunëve po e humbnin gjuhën amtare dhe nuk dinin asgjë për historinë e tyre, për kulturën e tyre dhe personalitetet e tyre..⁵. Pas Luftës së Dytë Botërore pakica vllaha, e cila nuk njihej nga shteti shqiptar si minoritet i veçantë, u arsimua dhe vazhdon të arsimohet në shkollat publike shqiptare. Sot ata janë të integruar plotësisht në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike me shoqërinë shqiptare.

Komuniteti vllah në Shqipëri ka realizuar një bashkëjetesë shembullore gjatë gjithë historisë. Ajo e ka mbështetur kombin shqiptar në të gjitha ngjarjet historike. Shumë figura aromane kanë dhënë kontributin e tyre në ngjarjet e rëndësishme historike të popullit shqiptar, në politikë, në art, në kulturë, letërsi, shkencë, sport etj. Duke u nisur nga ky kontribut S. Frashëri në veprën e tij shprehet: “Nga kombet fqinj vetëm një kemi mik... Ky komb është kombi i vllahve që rrojnë në Shqipëri e afër Shqipërisë. Nga këta ca janë vllah-shqiptarë, që flasin vllahisht dhe shqip, ca janë vllah-grekë, që flasin vllahisht dhe greqisht”⁶

Në qoftë se në procesin e integritit të vllahve në shoqërinë shqiptare do të marrim parasysh faktorin kohë, dallojmë dy grupime vllahsh. Grupi i parë banon në qytetet dhe fshatrat që përfshijnë zonën midis Fierit, Tiranës, Beratit dhe Vlorës. Sot këta vllah janë dygjuhësh vetëm te brezi i tretë. Dygjuhësia e tyre është e njëanshme me mbizotërim të gjuhës shqipe për arsye se:

- Gjuha aromane është një gjuhë e toleruar nga shteti, por e papërkrahur.
- Ky komunitet ka qenë për një kohë shumë të gjatë në një mjedis të përbashkët me shqipfolësit.
- Gjuha shqipe është për ta gjuha e bukës dhe e punës, kurse aromanishtja është një gjuhë e izoluar, e cila në këtë grupim nuk shërben më si mjet komunikimi as në familje.

⁵ Shih M. Karaxhiu, Dictionar aromân (DIARO), București, 1997, f. 443-444.

⁶ S. Frashëri, Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet, Tiranë, 1980, fq.75.

- Mjetet e shtypit, gazetatat, radioja, televizioni dhe arsimiti i çdo niveli janë në gjuhën shqipe.

Ky grupim gjuhësisht ndihet i asimiluar, edhe pse ruan ende kulturën, traditën, zakonet vllahe.

Grupimi i dytë përbëhet nga vllehtë e Jugut të Shqipërisë, të cilët janë pjesë e pandarë e historisë së vllahëve në përgjithësi. Ky është grupimi i fundit i latinofolësve të Ballkanit, që ruajti deri vonë (1950) mënyrën e jetesës me karakter gjysmënomad e kolektiv (por jo tipik), me kontakte deri diku të kufizuara me jetën civile. Ky grupim ka trashëguar nga thellësia e shekujve, në mënyrë të “konservuar” mjaft aspekte gjuhësore e kulturore, të cilat na shfaqin sot një pamje të vjetër, me vlera të pakontestueshme për t’i hulumtuar.

Pas viteve 1950, familjet e këtij grupimi vendosen në formën e grup-fiseve në fshatra të tëra në krahinat e Lunxhërisë, Zagorisë, Pogonit, Odries, në Përmet, Kolonjë, Sarandë e Delvinë. Në shumicën e këtyre fshatrave popullsia përbëhej nga shqipfolës dhe vllahofolës ose nga greqishtfolës dhe vllahofolës. Vetëm fshati “A. Poçi” banohej dhe banohet dhe sot vetëm nga vllehtë. Kështu, këtij grupimi iu desh të fillonte një mënyrë të re jetese në simbiozë me popullatën shqipfolëse.

Cila ishte gjendja gjuhësore dhe sociale e këtij komuniteti dhe si evoluoi ajo deri në vitet 1990 e më pas?

Pjesëtarët e këtij grupimi deri në vitet 1950 karakterizoheshin nga dygjuhësia vllaho-greke me mbizotërim të gjuhës vllahe. Vetëm te kryefamiljarët gjuha shqipe duhet të ishte e pranishme si mjet komunikimi, por niveli i përvetësimit të saj nuk ka qenë i njëjtë me dy gjuhët e tjera, vllahishten dhe greqishten.

Më vonë, pas viteve 1950, si rezultat i marrëdhënieve të reja ekonomike, përfshirja e tyre në kooperativa bujqësore ose në ndërmarrje bujqësore, nevoja për komunikim në mjedisin rrethues shqipfolës, bëri që shqipja të përvetësohej nga vllehtë në një masë të gjerë. Vetëm gratë e brezit të tretë, të cilat nuk u përfshin asnjëherë në jetën kolektive, nuk mundën ta mësojnë gjuhën shqipe. Pas viteve 1970 vllehtë e fshatrave “A. Poçi”, “Humelicë”, “Shkallë”, “Xarë”, pavarësisht se ishin dygjuhësh, ende ruanin mirë arromanishten. Edhe sot në fshatin “A. Poçi” arromanishtja ruhet në të tri brezat. Ndryshe ndodhi në fshatrat ku vllehtë bashkëjetonin me shqipfolësit. Në këto fshatra gjuha shqipe u

përvetësua shumë shpejt dhe në një nivel më të lartë se në vendbanimet e mësipërme. Brezi i dytë dhe i tretë përdornin aromanishten në shtëpi dhe midis tyre, kurse në punë, me fqinjët, përdornin gjuhën shqipe. Fëmijët vllëh në këto fshatra, duke qenë në shoqëri të vazhdueshme me fëmijët shqipfolës, filluan ta përdorin gjuhën shqipe dhe në familje, midis tyre dhe me prindërit. Kështu në këto mjedise kishim dygjuhësi me mbizotërim të gjuhës shqipe. Edhe trysnia e regjimit të kohës bëri që ky komunitet të largohet nga elemente të traditës, kulturës dhe zakoneve të etnisë së tij, p.sh: në këtë periudhë vllëhtë filluan t'u vënë fëmijëve të tyre emra të fëmijëve shqiptarë të tillë si Bardhyl, Gëzim, Entela, Mimoza, Edlira, Albert, Dritan, Alfred, Elona, Erion, Arjan, Enkeleda, Agron, të cilët u zëvendësuan përsëri pas viteve 1990 me emra sipas traditës vllahe.

Pas viteve 1990, marrëdhëniet e reja ekonomike dhe shoqërore që u krijuan kanë bërë që aromanishtja, si një gjuhë e toleruar nga shteti, por e papërkrahur⁷, si një gjuhë që ka filluar të humbasë funksionin e saj komunikues edhe brenda familjes, të humbasë shumë përballë shqipes. (Para viteve 1990 martesat brendapërbrenda komunitetit ruheshin me fanatizëm. Vitet e fundit janë shtuar shumë martesat jashtë këtij komunitetit, duke prishur kështu bazën më të rëndësishme të konservimit të gjuhës). Gjithashtu, si pasojë e mospraktikimit nga mbartësit e saj, sidomos nga brezi i ri e i mesëm, i shumë profesioneve, si: profesionin e blegtorit, të përpunimit të leshit, të thurjes së veshmbathjeve, të endjes etj, aromanishtja humbet fondin leksikor përkatës. Për më tepër, aromanët përballë shqipfolësve ndihen të asimiluar gjuhësisht⁸, sepse gjuha shqipe për ta është gjuha e bukës, e shtypit, e arsimimit të brezit të ri. Si rrjedhojë, mund të flasim për huazime të shumta shqipe (edhe shqipja mund t'i ketë të huazuara nga gjuhë të tjera) në të folmen aromane të brezit të tretë dhe të dytë. Ata huazojnë, duke i përshtatur fonetikisht dhe morfologjisht, ato fjalë që nuk i gjejnë dhe që nuk kanë mundësi t'i krijojnë në aromanisht, për shkak të mundësive të pakta që u ofron kjo gjuhë, si një gjuhë që tashmë është futur në rrugën e asimilimit të pashmangshëm nga gjuha shqipe, p.sh: lavatriçe, frigorifer, dush, aspirator, petrogaz, celular, kalorifer, televizor, shkollë, libër, fletore, stilolaps, çantë, kompast, vizore,

⁷ V. Bici, Çështje të dygjuhësisë në shkollat e pakicave, Tiranë, 2001, f.16.

⁸ Sh. Demiraj, Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët, Tiranë, 2008, f.105-108.

shkumës, gazetë, provim, gjimnaz, universitet, gjyq, avokat, burg, ligj, dënoj, prokuror, tharëse, floktore, ushtar, oficer, komandat, pallat etj.

Për sa i përket gjuhës së brezit të ri aroman në Shqipëri, pavarësisht se ai është ende i vetëdijshëm se i përket një grupi etno-kulturor të ndryshëm nga shqiptarët, nuk mund të flasim më për numër huazimesh, por vërejmë se te ky brez aromanishtja po zëvendësohet me shpejtësi nga gjuha shqipe. Në përgjithësi, pas arsimit parashkollor, fëmijët vllah shkojnë në klasën e parë si dygjuhësh me mbizotërim të gjuhës shqipe ose si monoling, vetëm me gjuhën shqipe. Kjo vërehet dhe në rezultatet shkollore të tyre. Ata jo vetëm që s’ dallohen nga fëmijët e tjerë shqipfolës, por, në mjaft raste, niveli i tyre shkencor është më i lartë, gjë që ka sjellë, në rrjedhë të kohës, integrimin e këtij grupi në jetën shoqërore, politike, kulturore shqiptare në një shkallë të tillë, që është vështirë të dallosh elementin vllah nga ai shqiptar.

Kohët e fundit, nga disa shoqata, në qendra të ndryshme, po bëhen përpjekje për mësimin e gjuhës vllahe, përpjekje që, për shumë arsye, nuk rezultojnë të suksesshme. Në këto kushte, e ndodhur përpara rrezikut të asimilimit gjuhësor e kulturor, ky komunitet duhet të ndihmohet nga organizmat ndërkombëtarë dhe nga shteti me mjete dhe mënyra të ndryshme për të ruajtur gjuhën, kulturën, zakonet, traditën, të cilat paraqiten si fenomen historik, gjuhësor e kulturor i veçantë në përbërjen e mozaikut kulturor evropian.

Literatura

AQH, fondi 151, viti 1925, dosja nr. 139: Protection des minorités par la Société des Nations.

Universal Deklaration of the Human Rights, cituar nga R. Memushaj, Legjislacioni shqiptar për gjuhët e pakicave, Kërkime universitare, 2001, 5.

K. Kyçyku, Arumunët e Shqipërisë në kontekst ballkanik, Bukuresht, 1999.

M. Karaxhiu, Dictionar aromân (DIARO), București, 1997.

S. Frashëri, Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet, Tiranë, 1980.

V. Bici, Çështje të dygjuhësisë në shkollat e pakicave, Tiranë, 2001.

Sh. Demiraj, Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët, Tiranë, 2008.

PROF. AS. DR. LINDITA KHANARI (LATIFI)

**DEPARTAMENTI I GJUHËSISË
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI I TIRANËS**
lindalatifi@yahoo.com

PAKICAT SHQIPTARE NË TURQI- PROBLEMATIKAT E KALUARA DHE ZHVILLIMET E REJA NË FAVOR TË SAJ

Abstrakt

Punimi që po prezantojmë para jush është një pjesë shumë e vogël e një studimi të gjerë, që synon të kthehet në një projekt edhe më gjithëpërfshirës, për studimin e hollësishëm të gjendjes dhe të veçorive që paraqet diaspora shqiptare në Turqi, si nga pikëpamja historike, kulturore, gjuhësore, folklorike, etnografike etj.

Diaspora shqiptare në Turqi na rezulton të jetë diaspora më e madhe shqiptare në botë. Dhe jo vetëm kaq, është realisht edhe diaspora më e larmishme, më gjithëpërfshirëse për nga përbërja krahinore, e për rrjedhojë edhe gjuhësore.

Këtë e thekson edhe Robert Elsi kur cilëson se. “Ndonëse jo shumë i njohur jashtë dhe pavarësisht mungesës së statistikave të besueshme për popullsinë, komuniteti shqiptar në Turqi, në të vërtetë mund të jetë më i madhi në diasporë. Emigrimet e hershme të shqiptarëve në Turqi ishin rezultat i rekrutimeve me forcë për ushtrinë osmane dhe jeniçerë...Numri i shqiptarëve etnikë në Turqi mund të arrijë mbi një milion, ndonëse shumë prej tyre janë asimiluar.”

Mendohet se janë mbi 5 milion shqiptarë, pra një Shqipëri e madhe brenda shtetit turk. Statistika të sakta në lidhje me numrin e shqiptarëve që janë vendosur në Turqi, nuk ka.

Punimi ynë ndahet në tri pjesë kryesore: Pjesa e parë trajton arsyet e mungesës së statistikave të sakta mbi popullsinë shqiptare në Turqi. Pjesa e dytë shtjellon historikun e krijimit të pakicave shqiptare në Turqi, përhapjen, përbërjen, si dhe gjendjen aktuale të saj. Pjesa e tretë bën prezantimin e zhvillimeve të reja dhe kuadrin e ri ligjor që siguron mësimin e gjuhës shqipe në Turqi.

Fjalët kyçe: diaspora shqiptare, kuadër i ri ligjor, mësim, gjuhë shqipe

Punimi që po prezantojmë para jush është një pjesë shumë e vogël e një studimi të gjerë, që synon të kthehet në një projekt edhe më gjithëpërfshirës, për studimin e hollësishëm të gjendjes dhe të veçorive që paraqet diaspora shqiptare në Turqi, si nga pikëpamja historike, kulturore, gjuhësore, folklorike, etnografike etj.

Diaspora shqiptare në Turqi na rezulton të jetë diaspora më e madhe shqiptare në botë. Dhe jo vetëm kaq, është realisht edhe diaspora më e larmishme, më gjithëpërfshirëse për nga përbërja krahinore, e për rrjedhojë edhe gjuhësore.

Këtë e thekson edhe Robert Elsi kur cilëson se. “Ndonëse jo shumë i njohur jashtë dhe pavarësisht mungesës së statistikave të besueshme për popullsinë, komuniteti shqiptar në Turqi, në të vërtetë mund të jetë më i madhi në diasporë. Emigrimet e hershme të shqiptarëve në Turqi ishin rezultat i rekrutimeve me forcë për ushtrinë osmane dhe jeniçerë. Numri i shqiptarëve etnikë në Turqi mund të arrijë mbi një milion, ndonëse shumë prej tyre janë asimiluar.”

Mendohet se janë mbi 5 milion shqiptarë, pra një Shqipëri e madhe brenda shtetit turk. Statistika të sakta në lidhje me numrin e shqiptarëve që janë vendosur në Turqi nuk ka.

Punimi ynë trajton tri çështje kryesore:

1. Arsyet e mungesës së statistikave të sakta mbi popullsinë shqiptare në Turqi.
2. Historikun e krijimit të pakicave shqiptare në Turqi, përhapjen, përbërjen, si dhe gjendjen aktuale të saj.
3. Paraqitje e zhvillimeve të reja dhe kuadrit të ri ligjor në Turqi, që siguron mësimin e gjuhës shqipe atje.

Diaspora shqiptare në Turqi përmendet shumë pak, për të mos thënë fare, megjithëse nga vëzhgimet e bëra na rezulton të jetë diaspora më e madhe shqiptare në botë. Dhe jo vetëm kaq, është realisht edhe diaspora më e larmishme, më gjithëpërfshirëse për nga përbërja krahinore, e për rrjedhojë edhe gjuhësore. Këtë e thekson edhe Robert Elsi kur cilëson se. “Ndonëse jo shumë i njohur jashtë dhe pavarësisht mungesës së statistikave të besueshme për popullsinë, komuniteti shqiptar në Turqi, në të vërtetë mund të jetë më i madhi në diasporë. Emigrimet e hershme të shqiptarëve në Turqi ishin rezultat i rekrutimeve me forcë për ushtrinë osmane dhe jeniçerë...Numri i shqiptarëve etnikë në Turqi mund të arrijë mbi një milion, ndonëse shumë prej tyre janë asimiluar.”

Mendohet se janë mbi 5 milion shqiptarë, pra një Shqipëri e madhe brenda shtetit turk. Statistika të sakta në lidhje me numrin e shqiptarëve që janë vendosur në Turqi, nuk ka. Dy janë arsyet kryesore që kanë çuar në mungesën e tyre:

Së pari, për shkak se regjistrimi i popullsisë në shtetin turk nuk bëhet mbi baza etnike, pra në pasaportë cilësohet vetëm shtetësia, jo kombësia.

Së dyti, shpërnguljet e shqiptarëve drejt Turqisë kanë qenë të shumta në numër dhe janë kryer në periudha të ndryshme historike. Ato fillojnë që rreth viteve 1500 e kanë vazhduar deri tani vonë.

Këto shpërngulje përgjithësisht janë kryer për shkak të rrethanave historike siç është rasti i çamëve të Çamërisë, shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë etj., të cilët vuanin represionin sllav apo grek. Për nga koha kur u krye shpërngulja, Diasporën shqiptare të Turqisë mund ta klasifikojmë në tre shtresëzime:

Shtresa e parë i takon periudhës nga vitet 1500 deri më 1912. Lëvizja në këtë periudhë brenda për brenda perandorisë osmane ishte e lirë. Është fakt i njohur historik dhe mjafton të përmendim numrin relativisht të madh të vezirëve dhe sadrazamëve me origjinë shqiptare, që punuan si zyrtarë të lartë të perandorisë, apo grupe të tëra të zanatçinjve e ustallarëve që shkëlqyen me punën e tyre, siç bie fjala grupe të tëra të gurgdhendësve e skalitësve nga Kolonja e Erseka që u thirrën nga arkitekt Sinani si mjeshtrit që do të realizonin arkitekturën e disa nga kryeveprave të tij në Stamboll e Edirne, e që për këtë arsye u vendosën me familjet e tyre në zonën e Thrakës.

Shtresa e dytë i takon kryesisht periudhës së viteve 1913-1914, e sidomos periudhës ndërmjet dy luftërave botërore. Shpërnguljet në këtë periudhë kanë qenë kryesisht të çamëve për shkak të Marrëveshjes së Korfuzit, të shqiptarëve të Kosovës sidomos pas vdekjes së Azem Galicës por edhe për shkak të marrëveshjes famëkeqe të shtetit turk me mbretërinë serbo-kroate –slllovene, si edhe të shqiptarëve të Shqipërisë, kryesisht dibranë, gjirokastritë, matjanë, shkodranë etj.

Shtresa e tretë i takon periudhës pas Luftës së dytë botërore dhe në këtë periudhë për në Turqi janë shpërngulur kryesisht kosovarë sidomos pas masakrës së Tivarit, rreth viteve 1955-1956, si dhe çamë për t'i shpëtuar politikës shfarosëse që ndoqi shteti grek ndaj tyre pas Luftës së dytë botërore. Kjo shpërngulje ka zgjatur deri rreth viteve 1980.

Ku janë vendosur shqiptarët në Turqi?

Edhe kjo është një çështje interesante, pasi jo vetëm që janë përhapur pothuajse në çdo cep të Turqisë, por kanë arritur që në një pjesë të rasteve të

ruajnë bashkësinë e tyre, pra të grupohen sipas krahinave nga vijnë. Kështu është fakt se dibranët, shkodranët, matjanët dhe gjirokastritët janë vendosur kryesisht në Stamboll, në lagjet e pjesës evropiane si Besiktas, Arnavutkoy, Aksaray, Bayrampasa, Eyup etj, si dhe në Bursë, shqiptarët nga Kolonja, Erseka, Korça janë vendosur në Edirne, Ibriktepe, Tekirdag, Gelibolu, Kirklareli, çamët në Izmir, Çesme, Aydin, Manisa, Fethiye, Marmaris, kosovarët dhe tetovarët në Stamboll, Ayvalik, Sakarya, Kutahya etj. Një pjesë e përzier janë vendosur në Konja, Kajzeri, Nigde e deri në Elazig, Adana e Mersin. Ka me pas fshatra të vegjël të formuar vetëm me shqiptarë si në zonën rreth detit të zi, ashtu edhe deri në Hatay, në kufi me Sirinë etj.

A e kanë ruajtur shqiptarët e Turqisë gjuhën e tyre dhe ç'veçorish paraqet ajo?

Unë e di që një pjesë e mirë e shqiptarëve mendojnë se shqiptarët e Turqisë janë asimiluar plotësisht dhe ndoshta ky mendim i përgjithshëm, që nuk e di se nga e ka zanafillën, ka çuar në këtë heshtje totale ndaj kësaj diaspore dhe në mungesën e studimeve për to. Gjendja reale është krejtësisht në antonimi me mendimin e përgjithshëm. Shqiptarët e Turqisë e kanë ruajtur gjuhën e tyre dhe jo vetëm gjuhën, por edhe një pjesë të elementëve të kulturës, doket, zakonet, folklorin etj., por sigurisht që ky proces nuk ka qenë i njëjtë për të gjitha shtresëzimet dhe grupimet e shqiptarëve që përmendëm më parë. Një pjesë e shtresëzimeve më të hershme pothuajse e kanë humbur dhe kanë ruajtur vetëm elementë të caktuar të saj.

Mjafton t'ju përmend se unë vetë jam dëshmitare se si e kanë ruajtur shqiptarët e Thrakës, Edirnesë e Ibriktepesë, me prejardhje nga Erseka e Kolonja, toskërishten e tyre.

Por shqipja e shqiptarëve të Turqisë dallon nga ajo e diasporave të tjera shqiptare në botë, për shkak të larmisë së madhe që ngërthen në vetvete, larmi që vjen qoftë si rezultat i shpërnguljeve në periudha të ndryshme e të largëta kohore nga njëra-tjetra, qoftë edhe për shkak të origjinës krahinore, e për këtë arsye edhe dialektore apo të folmeve më të ngushta krahinore. Megjithëse kemi një mungesë totale të studimeve në lidhje me shqipen e përdorur dhe ruajtur nga shqiptarët e Turqisë, së fundmi kemi mundur të realizojmë një vëzhgim të përgjithshëm

lidhur me të. Këtë na e kanë mundësuar edhe dy fjalorët e mëdhenj shqip-turqisht e turqisht-shqip përgatitur nga filologu turko-shqiptar Nexhip Allpan.

Praktikisht, sa ç'është e larmishme përbërja e popullsisë shqiptare në Turqi, sa ç'është e larmishme shqipja e përdorur prej tyre, po aq është i larmishëm Fjalori i N. Alpan, i cili duke ngërthyer në vetvete shqipen e pothuajse të gjitha trevave në tokat shqiptare në Ballkan, del nga kufijtë e fjalorit të thjeshtë dygjuhësh dhe na ndihmon me një material gjuhësor dialektor, e cili pret të studiohet nga ne.

Fjalorët e Alpanit, me pasurinë dhe shumëllojshmërinë leksikore që bartin, na nxisin të synojmë studime më të thelluara të shqipes së shqiptarëve të Turqisë. Ne besojmë se për shkak të larmisë krahinore, larmisë së përdorimit të dialekteve, nëndialekteve dhe të folmeve krahinore, por edhe për shkak se shpërnguljet e shqiptarëve të Turqisë, janë kryer në periudha të largëta e të afërta kohore, ekziston mundësia e gjetjes së formave më të vjetra, të cilat do të ndihmonin në mënyrë të veçantë studimet në gjuhësinë historike të shqipes. Ka ardhur koha dhe besoj se po kthehet në domosdoshmëri organizimi i ekspeditave shkencore gjuhësore në terren, përfundimet e të cilave nuk kanë të krahasuar me asnjë lloj studimi tjetër.

Historia e mësimit të gjuhës shqipe në Turqi

Për të informuar në lidhje me këtë çështje na duhet të diferencojmë së pari marrëveshjet shtetërore mes institucioneve zyrtare, nga përpjekjet e shoqatave të diasporës shqiptare në Turqi, për hapjen e kurseve të mësimit të gjuhës shqipe.

Shoqatat e diasporës shqiptare në Turqi janë të shumta. Numërohen me dhjetëra, janë të përhapura në zona të ndryshme të Turqisë, pothuajse gjithkund ku ka ngujime shqiptarësh, por në mjaft raste nuk spikat ndonjë marrëdhënie e fortë mes tyre. Megjithatë vitet e fundit vihen re përpjekje serioze për t'u organizuar e në mënyrë të veçantë jo vetëm për të rritur vetëdijen kombëtare, por edhe për të mbajtur gjallë gjuhën shqipe, sidomos tek fëmijët e të rinjtë, përmes kurseve të saj.

Përpjekjet e tyre u finalizuan me hapjen e Qendrës së Kulturës Shqiptare "Sami Frashëri" në Ankara, në shkurt të vitit 2015. Projekti për hapjen e saj u ideua nga ambasada e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë në Ankara dhe administrohet prej tyre, duke synuar kthimin e saj në një vatër të kultivimit të gjuhës e

trashëgimisë kulturore shqiptare, për ta afirmuar atë, për ta mësuar atë, si dhe për të bashkuar rreth saj diasporën e atjeshme shqiptare.

Po të bëjmë pyetjen: kur ka filluar zyrtarisht mësimi i gjuhës shqipe në Turqi, përgjigja për të është “shumë vonë”. Cilët janë hapat e ndërmarrë?

Hapi i parë është marrëveshja e universitetit të Tiranës në vitin 2007 me universitetin e Trakyas në Edirne, fale përpjekjeve të rektorit të asaj kohe, Prof. dr. Sh. Rrokaj, ose klasat e hapura prej vitesh nga dhjetëra shoqata shqiptare në zona të ndryshme të Turqisë. Ajo që duam të theksojmë është se objektivi ynë për këtë diasporë, e të tjera të ngjashme me të, nuk duhet të përqendrohet vetëm në çështjen e mësimdhënies së shqipes. Ky duhet të jetë vetëm hapi i parë dhe kjo në fakt është pritshmëria që ka diaspora nga vendi amë.

Duhet të vlerësojmë e të shohim edhe anën tjetër të medaljes, pasi edhe ne vetë, pra shkencat tona kanë nevojë për këtë diasporë, kanë nevojë ta studiojnë atë, sepse kjo është një mënyrë mjaft efikase për të njohur veten e për të rritur dijen ndaj vetes. Pra ka ardhur koha të përcaktojmë objektiva më largpamëse dhe të bashkëpunojmë me diasporën shqiptare për realizimin e tyre.

Mendojmë se ka qenë dhe vijon të mbetet domosdoshmëri çështja e një studimi të hollësishëm mbi diasporën shqiptare në Turqi. Ky studim duhet të bëhet paralelisht në disa fusha duke përcaktuar historikun e krijimit të kësaj diaspore, gjeografinë e shpërnguljeve shqiptare drejt Turqisë, gjeografinë e përhapjes dhe vendosjet së saj atje, elementet gjuhësore, kulturore, etnografike e folklorike që janë ruajtur, si dhe perspektivat e ruajtjes dhe vijimit të tyre. Një studim i tillë do të na mundësojë realizimin e studimeve të karakterit sinkronik, për të diktuar gjendjen e dialekteve dhe të folmeve të hershme të shqipes në një periudhë të caktuar, si dhe realizimin e studimeve diakronike duke përqasur veçoritë e të folmeve të caktuara në shtresa të ndryshme kohore.

Lidhur me këtë çështje mendojmë se është domosdoshmëri krijimi i një grupi studiuesish të rinj, të cilët duhet të kenë një formim më të specializuar, për të përballuar nevojat e shumta që kanë arkivat dhe rrethet shkencore, në çështje të transkriptimit, interpretimit dhe vlerësimit të saktë shkencor të dokumentacionit që gjendet në arkivat brenda dhe jashtë vendit. Në Arkivat e shtetit turk, e sidomos në ato të Stambollit e Ankarasë, si dhe në arkivat e disa vendeve të tjera të Ballkanit, si në Sofje për shembull, gjenden mjaft dokumente të shkruara shqip

me alfabet arab. Bëhet fjalë për dokumentacione që kanë lidhje me Shqipërinë dhe tokat shqiptare. Për të realizuar këtë duhen zbuluar e shfrytëzuar burime njerëzore të përshtatshme e të përgatitura në këto çështje, nga kjo diasporë.

Gjithashtu ekziston një fond i veçantë dhe mjaft i madh, që mbulon një periudhë letrare prej afro 120 vjetësh e që përfshin një mori të madhe poetësh, përkthyesish dhe leksikografësh, të cilët e kanë shkruar shqipen me alfabet arab, ende i pastudiuar si duhet. Për domosdoshmërinë dhe rëndësinë e studimit gjuhësor të shqipes së shkruar me alfabet arab, si shkrime të vjetra të shqipes, janë shprehur që herët studiues të njohur si Osman Myderrizi, Mahir Domi, Shaban Demiraj etj.

Së fundi, për shkak të mosnjohjes së shqipes me alfabet arab, filologjia jonë nuk ka shqyrtuar ende një numër relativisht të madh të gazetave, revistave, fletoreve dhe periodikëve të ndryshëm që janë botuar në Stamboll nga shoqatat atdhetare shqiptare, të cilat përmbajnë të dhëna mjaft interesante për historiografinë, gazetarinë, gjuhën dhe kulturën tonë. Ekzistojnë mbi tridhjetë gazeta e periodikë të tillë, që me një numërim të shpejtë përbëjnë disa mijëra numra, e që na ftojnë t'i studiojmë sa më parë.

Kjo mosdije ka bërë që t'u qëndrojmë ende larg veprimtarive politike e kulturore jo vetëm të shoqatave, por edhe të personaliteteve shqiptare që kanë punuar, jetuar e që kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre në administratën shtetërore të perandorisë osmane. Mjaft punime të tyre, dorëshkrime e materiale të tjera qëndrojnë ende në arkivat turke të pabotuara.

Mjafton të përmendim dosjet dhe letërkëmbimet e panumërta të Sami Frashërit, Fjalorin shpjegues të shqipes që sipas disa të dhënave mendohet ta ketë hartuar rreth viteve 1883-1887, i cili nuk është gjetur e nuk është botuar ende, dosjet e letërkëmbimet e Hoxha Tahsinit, dosjet e mjaft shoqatave atdhetare e të tjera si këto. Veç tyre kemi mjaft abetare të gjuhës shqipe shkruar me alfabet arab, studimi i të cilave do të na lejonte të plotësonim dijen mbi metodikën, didaktikën e hartimit të tyre, e mbi të gjitha mbi rrugëtimin e alfabetit, abetares eshkollës në gjuhën shqipe. Në këto abetare që janë hartuar si tekste “gjithëditurore” gjejmë materiale mjaft interesante mbi fjalët e urta, frazeologjinë, përrallat, legjendat, nocione dhe koncepte mbi natyrën, jetën, shëndetin, edukatën etj.

Për të gjitha sa theksuam më sipër, hapja e qendrave shkencore albanologjike në Turqi dhe në disa vende të tjera, sidomos aty ku kemi diasporë të hershme, është domosdoshmëri. Kemi nevojë për krijimin e qendrave të mirëfillta studimore, që nuk do të merren vetëm me mësimdhënien e gjuhës shqipe, por që do të mundësojnë studimin në arkiva e biblioteka, për realizimin e studimeve me karakter gjithëpërfshirës. Kjo mund të realizohet fare mirë duke bashkëpunuar me intelektualë të diasporës sonë atje, si dhe me studentët aktualë shqiptarë në Turqi, natyrisht të kombinuara këto me një politikë të qartë e largpamëse.

Hapi i dytë: Në mars të vitit 2017 me vendim të posaçëm të shtetit turk mësimi i gjuhës shqipe futet si lëndë me zgjedhje në të gjitha shkollat turke të arsimit tetëvjeçar.

Aplikimi i këtij vendimi filloi në vitin akademik 2017-2018 dhe vetë ministrja e Arsimit të Shqipërisë merr pjesë në hapjen e njërit prej këtyre kurseve në një qytezë të Izmirit (Kemalpasha), në shkollën tetëvjeçare Aliya Izzetbegoviç. Gjuha shqipe në këtë shkollë u përzgjedh si lëndë nga 44 nxënës, të cilët u grupuan në dy klasa. Ata zhvillojnë dy orë mësimi në javë në gjuhën shqipe dhe për të zgjeruar njohuritë u janë krijuar kushte të ndjekin edhe orë shtesë në fundjavë. Grupe të tilla nxënësish që përzgjedhin gjuhën shqipe kanë filluar të krijohen edhe në shkolla të tjera të zonave të tjera të Turqisë.

Që në hapat e parë ndeshen probleme që e minojnë nga brenda këtë proces mjaft pozitiv dhe që do të ishte shumë rezultativ nëse do të trajtohej me seriozitetin e duhur.

Cilat janë problemet?

- Mungesa e mësuesve të kualifikuar
- Mungesa e teksteve të mirëhartuara në përputhje edhe me moshën e fëmijëve. Kjo mungesë u ezaurua me përgatitjen e teksteve nga ana e Ministrisë së Diasporës këto dy vitet e fundit.

Hapi i tretë pozitiv në çështje të shqipes ka të bëjë me vendimin e publikuar në fletoren zyrtare të kryeministrisë turke, më 7 shkurt 2018, që i hap rrugën mbrojtjes zyrtare të gjuhës shqipe në Turqi. Që në provimin e parë interesi që i madh jo vetëm nga shqiptarë të diasporës sonë atje, por edhe nga turq që punojnë në Shqipëri e Kosovë e që dinë shqip. **Dokument i lëshuar nga Qendra e Përzgjedhjes dhe Sistemimit të Nxënësve (OSYM) pas korigjimit të**

provimit mundëson gjithashtu edhe shpërblimin për nëpunësit shtetërorë që zotërojnë shqipen si gjuhë e huaj. Kështu që bashkë me shpërblimet e dhëna për gjuhët e tjera të huaja, një nëpunës në Turqi që zotëron gjuhën shqipe, do të marrë shpërblim nga shteti çdo muaj, duke e bashkangjitur atë me rrogën mujore. Dokumenti i lëshuar nga kjo qendër njihet jo vetëm në institucionet shtetërore por edhe nga sektori privat. **Gjithashtu shqipja në këtë mënyrë fiton statusin e gjuhëve që pranohen për t'u mbrojtur në rastin e specializimeve në sistemin master e doktoraturë.**

Sugjerime:

Duket që nga pikëpamja ligjore në Turqi gjuhës shqipe i është hapur dera dhe është e patolerueshme që ne të rrimë në pozicion pritjeje gjithmonë. Na është dhënë një mundësi e mirë dhe e mbrojtur nga ligjet e atjeshme për përhapjen e gjuhës shqipe e mbi të gjitha për grumbullimin e diasporës sonë rreth saj.

Ka ardhur koha të tregojmë seriozitetin dhe ndjeshmërinë e duhur ne lidhje me problemet që paraqet mësimdhënia e gjuhës shqipe në Turqi, qoftë në të mirë të diasporës sonë të atjeshme, qoftë edhe në shërbim të qëllimit për përhapjen e saj. Shteti turk na e dha më në fund këtë mundësi dhe do të ishte e pafalshme që mekanizmat e rregullit dhe sistemimit të gjendjes së re, t'i linim në dorën e tjetërkujt. Ka ardhur momenti të marrim përgjegjësitë që na takojnë.

DR. ERZEN KOPERAJ

DR. ZAMIRA SHKRELI

**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE
UNIVERSITETI “LUIGJ GURAKUQI”, SHKODËR
QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

GJUHA E FQINJIT – LIDHJE DHE NDASI

(RASTI I GJUHËS MALAZEZE NË ZONËN E SHKODRËS)

Abstrakt

Marrëdhëniet historiko-gjuhësore shqiptaro-malazeze shtrihen në një periudhë relativisht të gjatë kohore. Ata duhet të fillojnë që me ardhjen e popujve sllavë në Ballkan, në periudhën e Mesjetës së Hershme, për të mbërritur në periudhën e sotme me marrëdhënie kontakti, por ndonjëherë edhe simbioze (sidomos në territorin ndërkufitar) midis dy popujve, duke u paraqitur mjaft komplekse në rrafshin historiko-kulturor. Marrëdhëniet të tilla kanë lënë gjurmë dhe janë pasqyruar pa dyshim edhe në marrëdhëniet gjuhësore. Punimi merr përsipër të shqyrtojë rastin e përdorimit të gjuhës malazeze në Shkodër dhe zonat përreth saj, duke pasur parasysh tri target-grupe të cilat janë në kontakt me gjuhën malazeze. Së pari, gjuha malazeze si gjuhë e pakicave. Mendojmë se Shkodra paraqet një rast interesant studimi në këtë pikë, pasi këtu kemi një minoritet malazez që gjuhën malazeze e ka si gjuhë amtare. Përmes institucioneve dhe shoqatave, që veprojnë në bazë të kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë, mbi pakicat ata kanë të drejtën e mësimin të gjuhës së tyre, duke vijuar të jenë folës të gjuhës malazeze, ashtu siç flitet kjo gjuhë brenda territoreve të Malit të Zi. Një natyrë më të veçantë paraqesin një grup tjetër me origjinë nga Mali i Zi, që në zonën e Shkodrës njihen si “podgoriçanë”, të cilët janë vendosur në qytetin e Shkodrës në fundin e shek. XIX. Gjuha e tyre ka pësuar ndryshime të dukshme gjuhësore, aq sa mund të quhet një e folme arkaike dhe me ndikime të shqipes. Grupi i tretë që do të merret në shqyrtim është ai i studentëve të Universitetit të Shkodrës që e kanë gjuhën malazeze si lëndë mësimore, interesi që i ngjall gjuha e fqinjtit. Kjo përjasje synon të nxjerrë në pah një realitet ku kontaktet gjuhësore mund të shërbejnë si elemente bazë për pranimin, vlerësimin dhe ngritjen e urave reale të një bashkëzistence kulturore.

Fjalët kyçe: gjuha e fqinjtit; marrëdhënie; minoritet malazez; bashkëjetesë; urë

Marrëdhëniet historiko-gjuhësore shqiptaro-malazeze shtrihen në një periudhë relativisht të gjatë, ato paraqiten mjaft komplekse në rrafshin historiko

shoqëror dhe gjuhësor. Ata duhet të fillojnë që me ardhjen e poujve sllavë në Ballkan, në periudhën e Mesjetës së Hershme, për të ardhur në periudhën e sotme me marrëdhënie kontakti (adstrati) por edhe simbioze midis dy popujve. Këto marrëdhënie të ndërlikuara historiko-shoqërore janë pasqyruar pa dyshim edhe në marrëdhëniet gjuhësore. Zakonisht flitet për një ardhje të fillese sllave aty nga shekulli i katërt dhe një rritje të kësaj dyndjeje rreth shekullit VII. Kësaj periudhe duhet t'i takojë edhe kontaktet e para të shqipes me të folmet sllave në përgjithësi, ato bullgare dhe serbe, por mendojmë se në këtë pikë, kontaktet mes të fomeve shqiptare dhe atyre malazeze duhet të na rezultojnë para shekullit të X. Provinca e Diokleas, apo e Duklas në sllavisht, që përfshinte një territor që nga Cetina, gjiri i Kotorrit e deri në Bunë, banohej nga një popullsi shumë e përzier. Sipas K. Jirečekut¹, që citon kronikanin e njohur bizantin Konstantin Porfirogenetin, kjo provincë që i korespondon territorit të sotëm të Malit të Zi duhet të jetë banuar nga shqiptarë dhe sllavë. Porfirogeneti, nuk i përmend banorët sllavë si serbë, prandaj aty duhet të kenë qenë më të ndryshëm. Një mendim i tillë prej vitesh mbështetet nga studimet e Spiro Kulishiç² e Bozhidar Ferjançiç³, duke i përdorur pikërisht kontaktet me shqiptarët si përcaktues të dallimit mes serbëve dhe malazezëve, ndërsa të parët i kanë quajtur serbë, të dytët i kanë quajtur *shkja/shkje*⁴. Në vazhdim, më pas historia bëhet edhe më e dokumentuar dhe më e qartë kur kemi fillimin e krijimit të shtetit të Zetës, që emrin e mori pikërisht prej lumit të Zetës që përfshiu territoret e Shkodrës, Ulqinit, Kotorrit e Budvas. Kontaktet mes shqiptarëve e malazezëve më pas, sidomos në territoret pranë brigjeve veriore të liqenit të Shkodrës dhe në zonat bjeshkore të malësive të

¹ Constantin Jireček, “*Geschichte der Serben*” Vëll. I, që përfshin historinë e serbëve deri në vitin 1371, Gotha 1911, f. 25.

² Spiro Kulishiç, “*O etnogenezi Crnogoraca*”, “Pobjeda”, Titograd 1980. “*Porfirogenit nije raspolagao nikakvom tradicijom da je Duklja bila srpska oblast*” f.7

³ Bozhidar Ferjançiç, “*Dolazak Hrvata i Srba na Balkansko Poluostrvo, Osvrt na nova tumačenja*” në Recueil des travaux de l’Institute d’etudes byzanitesXXXV, Beograd 1996, f. 117.

⁴ Spiro Kulishiç, “*O etnogenezi Crnogoraca*”, “Pobjeda”, Titograd 1980, “*Crnogorce je takođe dosljedno iskazivao kao Srbe, a crnogorska plemena kao srpska. Međutim, u svom radu o Kučima zapao je u neposrednu kontradikciju kada je ustanovio da albanski Kuči zovu "Srbina", zapravo Crnogorca, Skja, Škja i "nikako drukče"* f.4.

MbiShkodrës (kryesisht Hot e Kastrat) kanë qenë gati në kushte simbioze⁵. Madje në pranimin e shtetit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, më 1921, në Konferencën e Paqes i njihen dy minoritete: pakica greke dhe pakica malazeze⁶. Një prej formave më të pranishme dhe më të qarta të shprehjes së identitetit është identiteti etnik kombëtar, që krahas faktorëve të tjerë shoqërorë, është i lidhur ngushtë me gjuhën. Kjo e fundit, në shumicën e rasteve bëhet përcaktuese për përkatësinë identitare etnike dhe kombëtare⁷. Në Ballkan, te popujt sllavë të jugut, identitetet gjuhësore kanë përjetuar luhate divergjente, kryesisht nën ndikimin e faktorëve fetarë politikë e kulturorë. Shkodra paraqet një rast interesant studimi në këtë pikë, pasi në këtë zonë kemi një minoritet që gjuhën malazeze e ka si gjuhë amtare. Përmes institucioneve dhe shoqatave, që veprojnë në bazë të kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë, mbi pakicat, ata kanë të drejtën e mësimin të gjuhës së tyre, duke vijuar të jenë folës të gjuhës malazeze, ashtu siç flitet kjo gjuhë brenda territoreve të Malit të Zi. Një natyrë më të veçantë paraqesin një grup tjetër me origjinë nga Mali i Zi, që në zonën e Shkodrës njihen si “podgoriçanë”, të cilët janë vendosur në qytetin e Shkodrës në fundin e shek. XIX. Gjuha e tyre ka pësuar ndryshime të dukshme gjuhësore, aq sa mund të quhet një e folme arkaike dhe me ndikime të shqipes. Grupi i tretë që do të merret në shqyrtim është ai i studentëve të Universitetit të Shkodrës që e kanë gjuhën malazeze si lëndë mësimore, interesi që i ngjall gjuha e fqinjtit. Kjo përfaqëson synon të nxjerrë në pah një realitet ku kontaktet gjuhësore mund të shërbejnë si elemente bazë për pranimin, vlerësimin dhe ngritjen e urave reale të një bashkëekzistence kulturore.

⁵ Mjafton të kujtojmë sesi fisi shqiptar i Kuçit asimilohet gradualisht në malazez rreth shekujve XVII-XVIII.

⁶ Dh. Berati, “*Marrëdhëniet e Shqipërisë me Lidhjen e Kombeve*”, Tiranë, Mbrothësija Kristo Luarasi, 1931, f.34.

⁷ Sh. Munishi, “*Luhatjet në identitetet gjuhësore dhe kombëtare në Ballkan*”, në Komunikimi ndëretnik në Ballkan, Tiranë 2013, f. 59.

Edhe sot në Qarkun e Shkodrës pakica kombëtare, e cila etiketohet shpesh si pakica serbo-malazeze⁸, sipas të dhënave zyrtare⁹ është e përqendruar kryesisht në disa fshatra në zonën e Vrakës (ku mund të përmenden fshatrat Grilë, Omaraj, Boriç i Vogël), në veri të qytetit të Shkodrës, pranë kufirit me Malin e Zi. Të dhëna statistikore mbi numrin e kësaj pakice janë kontradiktore. Në regjistrimin e popullsisë të bërë në vitin 1989, është e vështirë të përcaktohet qartë një numër, pasi të dhënat nuk janë të specifikuar, pasi në këtë regjistrim nuk merrej parasysh kombësia.

Ndërsa sipas statistikave zyrtare, të cilat janë nxjerrë nga “Regjistrimi i Përgjithshëm i Popullsisë dhe Banesave” bërë në vitin 2011, censusi ku për herë të parë deklarohet edhe kombësia, rezulton të regjistruar 366 malazezë dhe 142 serbëve¹⁰. Por edhe kjo shifër nuk mund të merret si e mirëqenë, pasi shoqatat joqeveritare të pakicave, duke përfshirë ato të pakicës serbo-malazeze në Shkodër, bojkotuan dhe i kërkuan anëtarësisë së tyre që të bojkotojnë regjistrimin e REPOBA-s¹¹. Në bazë të vlerësimit të organizatave të këtij minoriteti, pretendohet se në Shqipëri realisht jetojnë rreth 30 mijë persona me origjinë serbo-malazeze, por sipas të dhënave nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, kjo pakicë përbëhet nga rreth 2000 vete dhe “ka ruajtur kompaktësinë e vet si pakicë kombëtare, gjuhën, kulturën, fenë, traditat e shtetit amë etj”. Me fillimin e

⁸ Megjithëse që me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe shpalljen e Malit të Zi si vend i pavarur, një prej dy shoqatave të kësaj pakice, deklaronte se nuk mund të quhen si pakicë serbo-malazeze, por vetëm si pakicë malazeze, shih në <http://www.arkivalajmeve.com/Ne-Shqiperi-nuk-ka-pakica-serbe-vetem-malazeze/>.

⁹ Të dhënat bazohen në “Raporti i parë, paraqitur nga Republika e Shqipërisë, mbështetur në Nenin 25, paragrafi 1, të Konventes kuader të Keshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, f. 13. Dokumenti është i aksesueshëm edhe në <https://rm.coe.int/>.

¹⁰ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_Census2011/Census1113/table/tableViewLayout1/

¹¹ “për shkak të mosplotësimi i kërkesave të tyre për përjashtimin shprehimisht të deklaratës për çështjen e përkatësisë etnike dhe fetare si kundërvajtje administrative, për pjesëmarrjen e tyre në grupet e regjistrimit, për dhënien e kopjes së formularëve të deklaramit për seksionin e përkatësisë etnike për çdo person të interesuar” në “Raporti i parë, paraqitur nga Republika e Shqipërisë, mbështetur në Nenin 25, paragrafi 1, të Konventes kuader të Keshillit të Evropës për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare”, f. 13.

proceseve demokratike ne Shqipëri, në vitin 1990, një pjesë e madhe e kësaj pakice u larguan, pasi pakicës serbo-malazeze iu dha mundësia e lëvizjes së lirë në territorin e ish-Jugosllavisë. Vështirësitë ekonomike dhe tensionet e krijuara në ish Jugosllavi i shtynë një pjesë të të larguarve të rikthehen në shtëpitë e tyre në Shqipëri. Duke iu referuar raporteve zyrtare mund të thuhet se, “nga 2 mijë të larguar, janë rikthyer në shtëpitë e tyre rreth 600 prej tyre. Të tjerët, ose vazhdojnë të jetojnë në Mal të Zi (shumica), ose janë larguar në vende të tjera të Evropës Perëndimore, SHBA apo Kanada”¹².

Gjuha malazeze¹³ mbetet elementi kryesor që e bashkon këtë pakicë, pasi origjina dhe religjioni janë elemente që i dallojnë anëtarët e saj. Në zonën e Shkodrës, te ky minoritet dallohen dy grupe, ai i “podgoriçanëve” që përgjithësisht i takojnë besimit islam dhe ai i “vrakaçorëve”¹⁴ që i takojnë besimit të krishterë ortodoks. Në periudhën e para viteve ‘90, politika ateiste e shtetit, përmirësoi në një farë mënyre ndërveprimin e këtyre dy grupeve, për shkak se gjuha mbeti i vetmi element ndërlidhjeje midis tyre, pasi feja dhe tradita ishin lënë mënjanë, duke ndihmuar në krijimin e “një komuniteti të themeluar mbi gjuhën si mjet kryesor të përkatësisë kolektive”¹⁵.

Nëse komuniteti sllav përreth zonës së Vrakës mendohet të jetë vendosur aty që në mesin e shekullit XVII¹⁶, emigrantët podgoriçanë kanë ardhur drejt Shkodrës në periudha të ndryshme. Ato fillojnë që nga periudha e sundimit të Bushatlinjve me Pashallëkun e tyre; pas Kongresit të Berlinit, kur u krijua Mali i Zi dhe u bë copëtimi i tokave shqiptare; gjatë Luftës së Parë Botërore¹⁷. Vala më e madhe e emigracionit të kësaj popullate u bë në vitin 1880, kur Mali i Zi mori

¹² Po aty.

¹³ Më 22 tetor 2007, Republika e Malit të Zi, sanksionon në kushtetutën e saj gjuhën malazeze si gjuhë zyrtare. Zyrtarisht që nga kjo datë kemi gjuhë malazeze dhe jo serbisht.

¹⁴ Pasi fshati Vrakë është qendra kryesore e këtij komuniteti, çka është kthyer edhe në një element të identitetit kolektiv.

¹⁵ Inis Shkreli, “*Minoriteti serbo-malazez në Shkodër: Sfidat e identitetit*”, në “*Intelektualët dhe lufta: ndërmjetësit e të (pa)vërtetës kombëtare*”, Prishtinë 2018, f.308.

¹⁶ Gligorije Matanoviç, “*Vraka dhe Vrakaçorët*”, Shkodër 2013.

¹⁷ Hamdi Bushati, “*Shkodra dhe motet*”, vëll. II, Shkodër 1999, f. 309.

Podgoricën, Nikshiqin dhe Shpuzën, duke qenë të frikësuar nga persekutimet e ushtrisë malazeze ndaj myslimanëve edhe pse kishin një gjuhë të përbashkët dhe ishin të një kombësie. Ndërsa emigracioni i tretë i dukshëm ndodhi gjatë vitit 1918, pas ikjes së ushtrive austriake nga Podgorica, të cilën e kishin pushtuar më 1916. Përgjithësisht, kjo popullatë u vendos në qytetin e Shkodrës dhe në fshatrat përreth tij. Një prej dukurive të veçanta të këtij grupi ishte se ato nuk u bashkuan dhe nuk u vendosën pranë fshatrave ku jetonin malazezët ortodoksë (me qendër fshatin Vrakë).

Dallimi fetar mesa duket tejkalonte afrinë gjuhësore dhe etnike (këtë e dëshmojnë edhe disa dokumente osmane të viteve 1905-1906 që flasin për konflikte mes këtyre dy grupeve)¹⁸. Duke u vendosur në qytetin e Shkodrës, apo në fshatrat shqiptare ata, gradualisht filluan të “shqiptarizoheshin” gradualisht. Me kalimin e kohës ata u brumosën me traditat e zakonet shqiptare, duke krijuar edhe lidhje familjare me shkodranët dhe në zhvillimin e aktiviteteve tregtare dhe profesionale të përbashkëta. Brezat më të rinj duke u integruar në jetën e qytetit, aq më tepër duke ndjekur shkollat shqipe, bënë që gjuha e tyre kryesore e komunikimit edhe pse në ambjentet familjare ende përdorej gjuha “nashke”¹⁹. Gjuha ende ruhet përmes komunikimit brenda familjes dhe komunitetit, por në mungesë të shkollimit në gjuhën malazeze brezat e rinj po humbasin aftësinë për të komunikuar dhe për të njohur gjuhën amtare. Aktualisht nuk ka një shkollë ku mësimi zhvillohet në gjuhën malazeze²⁰. Shoqatat e kësaj pakice e kanë ngritur zërin duke kërkuar hapjen e një shkolle të tillë, madje duke kërkuar që në shkollat e Shkodrës të përfshihet si gjuhë e dytë²¹. Por, ndërsa sot e drejta e përdorimit të

¹⁸ Arkiv, Fondi BEO/2607/195512, dt.26 qershor 1905.

¹⁹ Nashke, në kuptimin “*gjuha e jonë*” është përdorur si etiketim i gjuhës së folur nga podgoriçanët, jo vetëm nga ata vetë, por edhe nga shkodranët për gjuhën malazeze.

²⁰ Historia e shkollave për këtë pakicë është me mjaft zigzage. Në fillim të viteve ’20 kishte 6 shkolla të cilat u hapën me mbështetjen e Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, por që me reformën e ndërmarrë më 1934 nga mbreti Zog, u mbyllën, për tu rihapur në periudhën e pasluftës më 1945, por për tu mbyllur sërish më 1948, pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë.

²¹ Sipas kryetarit të shoqatës “Rozafa-Moraça”, Pavllo Jakoja, “*Një ndër problemet është dhe implementimi i mësimin të gjuhës, vetëm maqedonasit dhe grekët e kanë zgjidhur mësimin e gjuhës për pakicat. Kanë qenë 6 shkolla në gjuhën serbe. Mendojmë në*

gjuhës është e sanksionuar me ligj, për hapjen e një shkolle në gjuhën e minoritetit duhet që kjo pakicë të përbëjë së paku 20% të banorëve të zonës²², çka, siç u shtjellua edhe më lart, nga regjistrimet zyrtare nuk plotësohet si kusht. Hapja e klasave të pakicës është e kushtëzuar me detyrimin e dëshmisë me dokumente të kombësisë së shtetasve, të cilët kërkojnë tu mësojnë fëmijëve të tyre gjuhën amtare të minoritetit të cilit ata i përkasin, gjë që sipas përfaqësuesve

mënyrë që ta implementojmë mësimin në mënyrë të detyruar që gjuhë e dytë të jetë ajo serbe në rajonin e Shkodrës” në <https://www.shkodraweb.com/video-te-hapen-shkollaserbe-ne-shkoder-pavlo-jako-kryetar-i-rozafa-moraca-7-janari-te-shpallet-feste-zyrtare/>²² (LIGJ Nr. 96/2017 Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), pikërisht në Neni 15 Përdorimi i gjuhës: 1. Personat, që u përkasin pakicave kombëtare, kanë të drejtë të përdorin, krahas gjuhës shqipe, në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin: 2.a) emrin dhe mbiemrin e tyre, në përputhje me legjislacionin përkatës; 3. b) shenja, mbishkrime dhe informacione të tjera të një natyre personale, të dukshme për publikun, në çdo aktivitet të jetës së tyre sociale, ekonomike dhe kulturore; 4. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat, që u përkasin pakicave kombëtare banojnë tradicionalisht ose përbëjnë mbi 20 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj njësie, bazuar në kërkesën e tyre, organet e vetëqeverisjes vendore krijojnë kushtet, për aq sa është e mundur, për përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave dhe këtyre organeve; 5. Me vendim të organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore, ku mbi 20 për qind e banorëve u përkasin pakicave kombëtare, kur ka një kërkesë të mjaftueshme prej tyre, emërtimet njësie administrative përkatëse, të rrugëve dhe të treguesve të tjerë topografikë, krahas gjuhës shqipe, shfaqen dhe në gjuhën e pakicës përkatëse, sipas parashikimeve ligjore për vetëqeverisjen vendore. 6. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku personat, që u përkasin pakicave kombëtare, përbëjnë mbi 20 për qind të numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj njësie, ata kanë të drejtë të marrin informacion, krahas gjuhës shqipe, edhe në gjuhën e pakicës, mbi zhvillimin e procesit zgjedhor. Dhënia e informacioneve në gjuhë pakicave për zhvillimin e procesit zgjedhor rregullohet me akte të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 7. Çdo person, që i përket një pakice kombëtare, ka të drejtë të informohet menjëherë në gjuhën që ai/ajo kupton për arsyet e arrestimit të tij/tësaj dhe për natyrën e shkakut e çdo akuze kundër tij/saj dhe për të mbrojtur veten e tij/esaj në këtë gjuhë, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

të këtij komuniteti është shumë e vështirë për tu bërë me anë të dokumenteve zyrtare të shtetit shqiptar²³.

Përveçse si element i identitetit etnik, gjuha e një pjese të pakicës malazeze në zonën e Shkodrës paraqet një interes të veçantë studimor. Nëse në fshatrat e Vrakës gjuha nuk ka pësuar ndryshime, tek të ashtuquajturit podgoriçanë, kemi edhe dallime gjuhësore. E folmja e tyre ka pësuar mjaft zhvillime fonetike gjë që ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve. Një pjesë e tyre mendojnë se këto ndryshime kanë ardhur nga kontakti i vazhdueshëm me shqipen. Ndër më kryesorët mund të përmendim V. P. Nikçeviq, M. Pizhurica, L. Vujoviç e A. Çirgiç²⁴. Këta autorë veçojnë si dukuri të kësaj të folmeje (që cilësohet si e folmja e myslimanëve podgoriçanë) monoftongimin e diftongjeve si një zhvillim i ardhur prej ndikimit të shqipes. M. Pizhurica nuk e quan të pamundur një ndikim të tillë duke argumentuar se në mënyrë të ngjajshme të ndeshet në Guci dhe Plavë por edhe në Podgoricë. V. Nikçeviq kalimin e zanores së shkurtër të patheksuar, në j që “është bazë e identifikimit Podgoriçan, nuk e ndeshim në ekavizmin boshnjak dhe kroat në Bosnjën përendimore, por përkundër kësaj flasin afërsitë, takimet, ngjeshjet dhe thurrjet ndër vete të të folurit e muslimanëve malazezë me gjuhën shqipe. Gërshetimi gjuhësor i shqipes me atë malazeze ka sjellë te kjo e folme edhe mostingëllimin e të gjitha konsonateve të zëshme në të folurit e muslimanëve podgoriçanë kur ata janë të zëshme (megjithëse duhet thënë se ruajtja e bashkëtingëlloreve të zëshme edhe në pozicion fundor mbahet si një karakteristikë e gegërishtes, përkundrajt dialektit të toskërishtes që i shurdhon). Këtu mund të përfshijmë edhe kalimin e o-së në a, duke reflektuar një tipar gjuhësor që vihet re edhe në të folmet e myslimanëve të Shkodrës, përkundrajt katolikëve që e kanë ruajtur o-në. Këto veçori janë regjistruar nga shumë

²³ Bledar Bashanoviç, “*Nacionalizmi, minoritetet dhe integrimi europian*”, në Identitet, gazeta e internetit e minoritetit serbo-malazez ne shqiperi. <https://www.identitet.al/nacionalizmi-minoritetet-dhe-integrimi-europian/>.

²⁴ Vojislav P. Nikcevic, “*Istorija crnogorskog jezika*”, “*Jezikoslovne studije*”; Luka Vujović, “*Je li postojao ekavski govor u jugoistočnoj Crnoj Gori i sjevernoj Albaniji*”, në Zbornik za jezik i književnost, knj. I, Titograd, 1972; Adnan Čirgić, “*Govor podgoričkih muslimana*”, Institut za crnogorski jezik i jezikoslovlje”, Cetinje 2007 (me literaturat përkatëse)

dialektologë, por kryesisht në disa të folura kufitare pasi siç e kanë theksuar mjaft prej studiuesve kjo e folur mbetet e pacekur dhe anashkalohet²⁵. Prandaj, edhe nga rëndësia studimore e folmja e kësaj pakice paraqet një vlerë të veçantë.

“Imazhi më i mirë i ballkanasve për njëri-tjetrin dhe për veten krijohet përmes njohjes, komunikimit të ndërsjellë, heqjes të terra incognita për tjetrin”²⁶. Prej tetë vitesh, në universitetin e Shkodrës, zhvillohet kursi i gjuhës malazeze, si gjuha e fqinjit dhe e minoritetit. Nga një anketim të bërë me studentë të degës gjuhë-letërsi, të cilët e kanë zhvilluar këtë kurs në vitet 2018, 2019, mund të kategorizojmë këto opinione të tyre në lidhje me mësimin e gjuhës malazeze. Shumica e studentëve të anketuar pranojnë se mësimi i gjuhës malazeze i ka dhënë një perceptim më pozitiv për vendin fqinj. Edhe pse, sipas mjaft prej tyre, nuk kanë arritur të përfitojnë shprehje në komunikim në këtë gjuhë, kanë pasur një shtim vëmendjeje ndaj kulturës e në veçanti letërsisë malazeze. Përmes kursit, mjaft student kanë arritur të kuptojnë shprehje dhe frazeologji të përdorura nga të moshuarit e zonave të tyre (pjesa më e madhe e studentëve janë nga zonat veriore). Po ashtu, nga ana mësimore, për studentët e dhënë pas studimeve ballkanistike, kursi shihet si domosdoshmëri.

Prandaj njohja e gjuhës së fqinjit sidomos për ne, ballkanasit duhet të ketë këtë orientim, siç e përcakton akademiku R. Ismajli: *“Ne ende nuk kemi një përfytyrim për imagologjinë e ballkanasve për njëri-tjetrin dhe eventualisht për ballkanasin, ashtu siç e kemi për gjuhët e Ballkanit që nga Sandfeldi e këtej. Është e nevojshme të orientojmë përpjekje dhe të ndërtojmë procedura të besueshme për vrojtme në këtë drejtim. Gjithë duke mos u neglizhuar, ndërkaq, në një rast të tillë nuk dotë duhej që pikënisjen ta kemi tek imazhet e prodhuara dhe të orientuara për qëllime të lëvizjeve dhe projekteve politike e të tjera të hapësirave të ndryshme. Kështu do të mund të kuptonim pse ndër këta popuj ekzistojnë dhe gjykime të tjera për njëri tjetrin, me tona positive, përtej stereotipeve të prodhuara kastile*

²⁵ Adnan Čirgić, “Govor podgoričkih muslimana”, Institut za crnogorski jezik i jezikoslovlje”, Cetinje 2007, f. 87.

²⁶ Po aty.

*për funksion të ideve të caktuara, dhe ky do të ishte thelbi i imazhit që do të na interesonte në radhë të parë*²⁷.

Në këtë pikë, një kurs i tillë, gjithashtu, mund të përmirësojë të kuptuarit e gjuhëve të pakicave, luftën e folësve të tyre kundër disavantazhet strukturore, dhe përfundimisht fuqizimin kulturor të grupeve minoritare dhe mbijetesën e gjuhës së tyre.

Bibliografia

- Bushati, H. “*Shkodra dhe motet*”, vëll. II, Shkodër 1999.
- Cenoz, J.; D. Gorter “*Linguistic Landscape and Minority Languages*”. International Journal of Multilingualism, nr. 3, 2006, f. 67–80.
- Čirgić, A. “*Govor podgoričkih muslimana*”, Institut za crnogorski jezik i jezikoslovlje”, Cetinje 2007
- Edéards, J. “*Minority Languages and Group Identity: Cases and Categories*”. Amsterdam: John Benjamins. 2010.
- Extra, G.; Gorter, D. “*Multilingual Europe: Facts and Policies*”, Neë York 2008.
- Ismajli, I. “*Imazhi i tjetrit në Ballkan*”, në Komunikimi ndëretnik në Ballkan, Tiranë 2013
- Tafili, E. “*Sfidat e nacionalizmit, Rasti i Ballkanit*”, Tiranë, 2008.
- May, S. “*Language Policy and Minority Rights*”, Oxford: Blackëell. 1997.
- Matanoviq, G. “*Vraka dhe Vrakaçorët*”, Shkodër 2013.
- Nikčević, N. “*Ogledi, studije, susreti. Apologetika crnogorskoga jezika*”, Institut za crnogorski jezik i jezikoslovlje, Osijek 2004.
- Omari, A. “*Lidhjet gjuhësore shqiptaro-serbe*”, Tiranë, 2012.
- Ostrakovski, V. “*Minority in the Balkan*”, Skopje, 1998.
- Riga L.; Kennedy, J. “*Tolerant Majorities, Loyal Minorities and ‘Ethnic Reversals’: Constructing Minority Rights at Versailles 1919*”, në Nations and Nationalism, vol.15, nr.3, 2009.
- Skutsch, C. “*Encyclopedia of the Eörd’s Minorities*”. NY: Routledge 2005.

²⁷ Rexhëp Ismajli, “Imazhi i tjetrit në Ballkan”, në Komunikimi ndëretnik në Ballkan, Tiranë 2013, f.18.

Vujović, L. "Je li postojao ekavski govor u jugoistočnoj Crnoj Gori i sjevernoj Albaniji", në Zbornik za jezik i književnost, knj. I, Titograd, 1972.

DR. ARDIAN DOKA

**DEPARTAMENTI I GJUHËSISË
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
ardian.doka@gmail.com**

RRETH DISA EMËRTIMEVE TË SHQIPES SË FOLUR PËR PAKICAT

Abstrakt

*Emërtimet e hasura në shqipen e folur lidhur me pakicat shfaqin njëherazi dy veçori, ato bartin që të gjitha negativitet e po ashtu mund të thuhet se në pjesën më të madhe janë fjalë që vijnë prej gjuhësh të huaja. Edhe kur përfaqësojnë ndonjë krijim të brendshëm të shqipes, si për shembull *arixhi* (fjalë e mbarë shqipes për një pjesëtar të komunitetit rom, meqë ata shpesh e nxirrnin bukën duke dhënë shfaqje me arinj të zbutur) ose *llacifac*, (fjalë e gegërishtes jugore, posaçërisht e të folmes së Tiranës, për të shënuar një pjesëtar të pakicës vllehe, meqë në gjuhën e tyre, sipas vendësve, ndeshen shpesh fjalëforma të tipit *llaci – faci*), ngarkesa negative është gjithmonë e pranishme. Lidhur me rastin e fundit është për t'u vënë re se i njëjti mekanizëm, ai i emërvënies nëpërmjet ndonjë tipari gjuhësor, është përdorur edhe nga italishtfolësit e Jugut për të emërtuar arbëreshët. Në të folmet e Kalabrisë dhe të Sicilisë arbëreshët njihen edhe si *ghegu – gjegj*, nga *gjegj* e shqipes me kuptimin 'dëgjo'. Në meset e tyre është mjaft popullore proverbi sicilian: *Si ncuontri un ghegu e un lupu, prima spara u ghegu e lassa u lupu!* (Po takove një arbëresh dhe një ujk, vrite arbëreshin dhe lëre ujkun!). Projektimi i tjetrit në gjuhë përmes kakofemizmave (termi përdoret këtu në kuptimin e gjerë), si manifestimi i ksenofobisë, nuk është një dukuri e re, prandaj as e panjohur.*

Fjalë kyçe: *shqipe e folur; emërvënie; kakofemizëm; ksenofobi, fjalëforma*

Emërtimet e hasura në shqipen e folur lidhur me pakicat shfaqin njëherazi dy veçori: ato bartin që të gjitha negativitet e, po ashtu, mund të thuhet se në pjesën më të madhe janë fjalë që vijnë prej gjuhësh të huaja. Edhe kur përfaqësojnë ndonjë krijim të brendshëm të shqipes, si për shembull *arixhi* (fjalë e mbarë shqipes për një pjesëtar të komunitetit rom, meqë ata shpesh e nxirrnin bukën duke dhënë shfaqje me arinj të zbutur) ose *llacifac*, (fjalë e gegërishtes jugore, posaçërisht e të folmes së Tiranës, për të shënuar një pjesëtar të pakicës vllehe, meqë në gjuhën e tyre, sipas vendësve, ndeshen shpesh fjalëforma të tipit *llaci – faci*), ngarkesa negative është gjithmonë e pranishme. Lidhur me rastin e fundit është për t'u vënë re se i njëjti mekanizëm, ai i emërvënies nëpërmjet

ndonjë tipari gjuhësor, të njëmendët ose të hamendësuar, është përdorur edhe nga italishtfolësit e Jugut për të emërtuar arbëreshët. Në të folmet e Kalabrisë dhe të Sicilisë arbëreshët njihen edhe si *ghegu* – *gegu*, nga *gjegj* e shqipes me kuptimin ‘dëgjo’. Në meset e tyre është mjaft popullor proverbi sicilian: *Si ncuontri un ghegu e un lupu, prima spara u ghegu e lassa u lupu!*¹ (Po takove një arbëresh dhe një ujk, vrite arbëreshin dhe lëre ujkun!).

Projektimi i tjetrit në gjuhë përmes kakofemizmave (termi përdoret këtu në kuptimin e gjerë), si shfaqje parake e ksenofobisë, nuk është një dukuri e re, prandaj as e panjohur. Grekët i quanin *barbarë* të gjithë ata që nuk ishin grekë. Fjala, që sot e njohim dhe e përdorim me të tjera kuptime, në krye të herës donte të thoshte ‘belban’, ngaqë të huajt, duke shtënë në punë gjuhë të pakuptueshme, për grekët, nuk flisnin, por belbëzonin.² Italianizmi i përdorur në shqipe për të lindurit nga martesat e përziera mes të bardhëve dhe të zinjve, *mulat*, ka si etimon fjalën *mulo* – ‘mushkë’.³ Për shkak të ngarkesës negative që mbart, edhe pa e lidhur me etimonin, në regjistrat e epërm të përdorimit të shqipes janë bërë përpjekje për ta zëvendësuar me *metis*.⁴ Kjo e fundit, ngaqë ka denduri të vogël përdorimi njihet pak dhe shërben si një lloj eufemizmi.

Ndonëse nuk mund të jemi të sigurt që kanë ardhur vërtet nga Egjipti, i kemi lidhur gjithnjë me këtë vend. *Jevg* e gegërishtes jugore, me gjasë një huazim nga turqishtja *yepk*⁵, *evgjit* e toskërishtes, shumë i singularizuar i së parës, dhe *magjyp* e gegërishtes veriore, huazim prej serbishtes *jéđupak*⁶, na thonë të gjitha të njëjtën gjë – i ardhur nga Egjipti. Prania e formës pa parashtesën *-ma*, *gjypsh*, e cila haset në disa të folme të gegërishtes veriore (edhe me kuptimin ‘kovaç’),

¹ Proverbi është regjistruar së pari nga Giuseppe Pitre në vitin 1889.

² Shih. *Enciclopedia Treccani*.

³ Shih edhe Kolec Topalli, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017.

⁴ Kolec Topalli në *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017, e jep si një huazim të ri nga frëngjishtja, me burim prej latinishtes *mixticus* – ‘i përzier’.

⁵ Kolec Topalli, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017.

⁶ Kolec Topalli, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017.

është një element që tregon se parashtesimi mund të ketë ndodhur në shqipe. Mandej fjala ka shtegtuar sërish për t'u kthyer në gjuhën dhënëse (serbisht) ku e gjejmë edhe si *mađupak*, me të njëjtin kuptim.⁷ Trajta me /u/ që ndeshet në gegërishten veriore, pra *magjup*, flet për një tjetër ndikim të serbishtes në shqipe. Krahas këtyre fjalëve në shqipen e folur përdoret edhe ndërtimi gjojaeufemistik *dorë e zezë* (khs. *dorë e bardhë*). Interes paraqet gjithashtu edhe përftesa e këtyre viteve të fundit, *egjiptian*, e cila po fiton terren si një etiketë e pangarkuar me negativitet, me vlerë eufemistike, veçanërisht pasi ka marrë statusin e emërtimit zyrtar për këtë komunitet dhe pjesëtarët e tij.

Arixhi që e përmenda më lart, *gabel*⁸ e gegërishtes, *kurbat* e toskërishtes juglindore, etimologjikisht e lidhur me *kurbet*, meqë fjala është për një popullsi nomade dhe *cigan*, huazim nga frëngjishtja *tsigane*⁹ janë fjalë që në shqipen e folur përdoren për të shënuar një pjesëtar të komunitetit rom. Ndër to më pak e ngjyrosur me negativitet ngjan të jetë *cigan*, si e ardhur nga shqipja e shkruar dhe e vetmja, me sa di unë, që deri më tani nuk ka prodhuar togje të ngulitura a gjysmë të ngulitura (khs. *thes arixhiu*, *varri i kurbatit*, *punë gabelësh*). Por kjo, me sa duket, nuk mjaftoi për t'i dhënë emërtesën zyrtare këtij komuniteti, prandaj thirrëm në ndihmë një tjetër fjalë, *rom*. Me *gabel* lidhet pa dyshim edhe *gabi* 'treg veshjesh të përdorura', meqë romët ishin të parët që u morën me këtë lloj tregtie te ne, pas viteve '90 të shekullit të shkuar. Njësitë të mësipërme u duhet shtuar edhe *xhipsi*, huazim nga anglishtja *gipsy* me kuptimin 'cigan'. Një pseudoeufemizëm i ligjërimeve rinore të shqipes, i cili nisi të qarkullojë nga mesi i viteve '80 të shekullit të shkuar, koha e shkëlqimit të një grupi muzikor të quajtur *Gipsy King*.

Pjesëtarët e pakicës greke që jetojnë në Shqipëri janë quajtur gjerësisht *grekofonë*, *grekofilë*, *dropullitë* (meqë ata janë të përqendruar në zonën e

⁷ Shih edhe Kolec Topalli, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017.

⁸ Për prof. Topallin një formim i brendshëm i shqipes nga *gabbare* e italishtes 'rrenë, mashtrim' me prapashtesën *-el*. Shih Kolec Topalli, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017.

⁹ Kolec Topalli, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017.

Dropullit), por edhe *minoritarë*. Përdorimi i fundit lidhet me faktin se deri në fillim të viteve '90 të shekullit të shkuar grekët përbënin të vetmin minoritet të njohur me ligj te ne.

Vllehët¹⁰ e Shqipërisë etiketohen si *çobanë*, fjalë e mbarë shqipes, huazim nga turqishtja, *çaponë* – kalim me metatezë i *çoban*, që haset në të folmen e Kavajës, meqë këta njihen si blegtorë, *llacifacë* (e përmendur më lart), e tash së voni edhe si *arumunë*. *Vllahinkë*, fjalë e përdorur për një grua vllehe, paraqet interes, ngaqë na ndihmon të kuptojmë shprehjen frazeologjike *është bo për t'u qa me llainga*, të gegërishtes jugore, ku emri shfaqet si derivat i fjalës *vllahinkë*. Të vërehet rënia e /v/-së në një grup bashkëtingëlloresh, bjerrja e /h/-së në trup të fjalës dhe zëshmimi i bashkëtingëllores së shurdhët në shoqërinë e një sonanteje dhe të një zanoreje. Gjithsesi duhet sqaruar se në këtë rast nuk është fjala për gratë vllehe në përgjithësi, por për vajtojcet vllehe. Është për t'u shënuar se fjala *vllahinkë* njihet edhe me kuptime të tjera: 'grua llafezane' në të folmen e Shkodrës¹¹ dhe 'lloj gune e përdorur nga vllehët'.¹²

Pakicat sllave të pranishme te ne në shqipen e folur njihen me emërtime të ndryshme që nuk burojnë prej etnonimeve gjegjëse. Ne i quajmë *vraçaçorë* malazetët e ngulur në fshatin Vrakë të Shkodrës, *goranë* serbët që jetojnë në Gorë të Kukësit, *gollobordas* ose *gollo* bullgarët e krahinës homonime, *muhaxhirë* boshnjakët e ngulur në rrethinat e Shijakut dhe *shule* maqedonasit e anëve të Juglindjes. Disa prej këtyre emërtimeve, veçmazi ato që lidhen me toponime, nuk mund t'i identifikojnë drejt pakicat. Në Gollobordë, fjala vjen, nuk ka vetëm bullgarë, atje jetojnë edhe shqiptarë që gjithashtu quhen gollobordas. Prandaj jo pak herë na ka ardhur në ndihmë gjuha (*flet bullgarçe, flet goraçe, flet nashke*).

¹⁰ Me sa duket bëhet fjalë për një eksonim me burim prej gjermanishtes së vjetër *Walh* që në krye të herës përdorej për të shënuar grupet etnogjuhësore të traditës gale e më pas të asaj latine të anëve të Danubit. (Shih edhe *Enciclopedia Treccani*). Më vonë fjala hyri edhe në gjuhë të tjera: në serbishte *viasi*, në italishte *valacchi*, në greqishte *κούτσο βλαχοί* (kucovllehë – 'vllahë të çalë').

¹¹ Kolec Topalli, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017.

¹² Kolec Topalli, *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2017.

Hebrenjtë që kanë jetuar në Shqipëri janë thirrur përgjithësisht *çifutë* me një huazim nga turqishtja. Në tre-katër dhjetëvjetëshat e fundit fjala është ngarkuar edhe me më shumë negativitet e kjo ka bërë të dëgjohet gjithnjë e më pak. Një gjë të tillë e dëshmon posë të tjerash edhe ndryshimi i titullit të një romani të njohur të Lion Fojhtvangerit, nga botimi i parë, i vitit 1962, prej shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, ku ai shfaqet si *Çifutja e Toledos*, në të dytin, atë të vitit 2002, prej shtëpisë botuese “Dituria”, ku i njëjti roman mban titullin *Çifutka e Toledos*. Siç del nga krahasimi i titujve, Robert Shvarci, përkthyesi i romanit nga gjermanishtja në të dyja botimet, e ka parë të udhës ta ëmbëlsojë sado pak emërtimin tashmë problematik me anën e prapashtesës zvogëluese-zbunuese *-kë*.

Rritja e vetëdijes lidhur me të drejtat e pakicave ka bërë që edhe në shqipen e folur të ndihet nevoja për emërtime kësodore të pangarkuara me negativitet. E vërteta është se deri më tani një nevojë e tillë është përmbushur me prurje nga gjuha e shkruar.

PROF. AS. DR. ELONA CECE (BIBA)

**DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE LETËRSISË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”**

elona_biba@yahoo.com

**FAKTORËT SOCIOLOGJIKË DHE KAHU I NDËRNDIKIMIT
FONETIK - ARGUMENTE QË SHËRBEJNË PËR TË PËRCAKTUAR
PERSPEKTIVËN E ZHVILLIMIT TË BILINGUIZMIT SHQIP-
VLLAHISHT NË ZONËN GJEOGRAFIKE TË RRETHIT TË KORÇËS**

Abstrakt

Duke pasur parasysh që vllahët u njohën zyrtarisht si minoritet etnokultural nga ekzekutivi shqiptar që nga viti 1999 dhe që në Shqipëri, ata janë vendosur në zonën qendrore dhe jugore, kryesisht në jug të vijës Durrës- Ohër, në këtë kumtesë, duke u përqëndruar në zonën gjeografike të qytetit të Korçës dhe disa rrethinave të saj ku jeton një pjesë e konsiderueshme e këtij komuniteti, do të interpretohen nga këndvështrimi sociolinguistik dy veçori të bilinguizmit shqip-vllahisht:

- 1. Kahu parësor i ndërndikimit gjuhësor, konkretisht në rafshin fonetik. Meqenëse ky ndërveprim gjuhësor ka një shtrirje kohore të gjatë, shtrohet pyetja: cili është kahu i ndikimeve fonetike, konkretisht cili është ndikimi fonetik i gjuhës vllahe mbi shqipen e këtyre individëve? Në trajtesë janë konstatuar dallimet fonologjike që lidhen me inventarin e fonemave; dallimet e sistemit të fonemave, që lidhen me vendin që zënë në sistem dhe me kundërvëniet që formojnë, si dhe dallimet e funksionit të fonemave, që lidhen me këmbimin e fonemave në kushte të caktuara fonetike;*
- 2. Faktorët sociolinguistikë *të cilët kushtëzojnë ruajtjen e bilinguizmit në rastet ideale, dhe në veçanti ndikimi i konformizmit tek anëtarët e kësaj bashkësie etnokulturore në gjirin e bashkësisë gjuhësore shqiptare.*

Përcaktimi i perspektivës së zhvillimit gjuhësor për komunitetin vllah të kësaj zone gjeografike përbën përfundimin e kësaj trajtese.

Fjalë kyçe: *bilinguizëm; dallime fonologjike; faktorë sociolinguistikë; minoritet etnokultural.*

I. Veçori të bilinguizmit shqip-vllahisht

Duke pasur parasysh që vllahët u njohën zyrtarisht si minoritet etnokultural nga ekzekutivi shqiptar që nga viti 1999 dhe që në Shqipëri, ata janë vendosur në zonën qendrore dhe jugore, kryesisht në jug të vijës Durrës- Ohër, në këtë

kumtesë, duke u përqëndruar në zonën gjeografike të qytetit të Korçës dhe disa rrethinave të saj ku jeton një pjesë e konsiderueshme e këtij komuniteti, do të interpretohen nga këndvështrimi sociolinguistik dy veçori të bilinguizmit shqip-vllahisht:

1. **ruajtja e bilinguizmit, e kushtë zuar nga faktorët sociolinguistikë *të cilët veprojnë aktualisht krahasuar me ata faktorë që veprojnë në rastet ideale, dhe në veçanti ndikimi i konformizmit tek anëtarët e kësaj bashkësie etnokulturore në gjirin e bashkësisë gjuhësore shqiptare.**
2. **kahu parësor i ndërndikimit gjuhësor, konkretisht në rafshin fonetik.** (Meqenëse ky ndërveprim gjuhësor ka një shtrirje kohore të gjatë, shtrohet pyetja: cili është kahu i ndërndikimeve fonetike, dhe cili është ndikimi fonetik i gjuhës vllahe mbi shqipen e këtyre individëve?)

II.1 Dukuri të zhvillimit gjuhësor në komunitetin vllah të zonë s gjeografike të rrethit të Korçës

Lidhur me veçorinë e parë, mund të themi se individët e kësaj minoriteti, që është pjesë përbërëse e bashkësisë shoqërore shqiptare, me ndjenjën e pranimit gjithnjë e më shumë nga grupi, që përbën shumicën, bëhen konformistë. “Modelet tona janë të rriturit e tjerë...Puna, lidhjet farafisnore dhe veprimtaritë e tjera shoqërore na bëjnë të biem në kontakt me të rriturit e tjerë që ofrojnë modele krahasimi, të cilat përpiqemi t’i shmangim ose t’i kopjojmë” (Bordieu dhe Boltanski 1975, e shqyrtuar edhe te (Chambers 1995) pra ligjërimi konsiderohet si një akt identiteti (Le Page Tabouret-Keller 1985) ¹ Pra në këtë rast, **anëtarët e bashkësisë gjuhësore vllahe identifikohen si anëtarë të një bashkësie gjuhësore tjetër dhe janë integruar në bashkësinë gjuhësore shqipe.** Në qoftë se do të analizojm faktin në fjalë do të vërejm këto dukuri:

Së pari, motivimi për ta nxënë gjuhën vllahe si një mundësi komunikimi, është shumë i kufizuar, vetëm për mjediset familjare dhe ato shoqërore në situata joformale.

Së dyti, vepron konformizmi i anëtarëve të kësaj bashkësie, sepse, duke u bërë anëtarë të bashkësisë gjuhësore shqipe, këta bilingvë strukturojnë në gjuhën

¹Gj. Shkurtaç, Sociolinguistika, Tiranë, 1999, f. 177

shqipe mendimet, sistemin e tyre të vlerave, përvojën e tyre dhe shprehitë për t’iu përshatur sistemit kulturor të grupit në të cilin janë integruar.

“Qëndrimi i bilingut për gjuhën e tij shpesh ndikohet nga qëndrimi i shumicës së bashkësisë shoqërore ndaj gjuhës së tij. Në situata të caktuara ai mënjanon përdorimin e gjuhës së origjinës, sepse gjuha e tij është e një bashkësie që mund të mos shihet mirë. Madje është i njohur fakti që disa persona të cilët flasin gjuhën e pakicës shkojnë deri aty sa të dëshmojnë urrejtje për gjuhën e tyre të parë dhe admirim për gjuhën e tyre të dytë.”²

Këto dy dukuri, për të cilat mund të themi që i përkasin si rrafshit sinkronik ashtu edhe atij diakronik, janë kushtëzuar nga një sërë faktorësh.

Konkretisht, për bilinguizmin (shqip-vllahisht) **zgjatja e kontakteve** të dy gjuhëve, shqipes dhe vllahishtes, lidhet me dendurinë e përdorimit e të tyre. (Duke qenë se ne po marrim në konsideratë vetëm ligjërimin e folur në gjuhën vllahe, denduria është matur me mesataren e orëve të kontaktit në javë apo në muaj.) Duhet të pranojmë se kjo denduri është relativisht e ulët në grupmshën e re dhe mesatare në grupmshën e mesme dhe të vjetër. Gjithashtu, në rastin e bilinguizmit (shqip-vllahisht) shfaqen faktorë të tjerë që kanë ushtruar trysinë e tyre, si: **faktori ekonomik**, (që nënkupton njohjen e gjuhës shqipe si një nevojë ekonomike) dhe **faktori demografik**, (që nënkupton presionin e gjuhës së folur nga shumica).

Faktorët e tjerë të njohur nga shkenca e sociolinguistikës që kushtëzojnë ruajtjen e bilinguizmit në rastet ideale, nuk veprojnë. Konkretisht: **faktori administrativ** (që lidhet me faktin që në disa krahina nëpunësit e administratës duhet të njohin mirë përveç gjuhës zyrtare edhe gjuhën e huaj, siç ndodh në rastin e minoritetit grek apo maqedonas në Shqipëri); **faktori historik**, [ngjarjet e kaluara, të cilat në rastin tonë janë shumë të hershme, që në kohë n e Perandorisë Romake, në shekullin I e.s, kur shteti romak në kuadër të zbatimit të një politike agrare vendosi në “ager publicus” (tokat e konfiskuara) qytetarët romakë, kolonët, veteranët e ushtrisë³]; **faktori kulturor** (kur për arsye kulturore mund të ndodhë që të jetë e domosdoshme për çdo person të kulturuar të flasë

² Gj. Shkurtaj, Sociolinguistika, Tiranë, 1999, f.156.

³ wikipedia

rrjedhshëm një a më shumë gjuhë të huaj, përfshirë edhe gjuhën e huaj të bilinguizmit); **faktori politik** (që nënkupton përdorimin e gjuhëve të mbështetur nga rrrthanat politike) si dhe **faktori fetar**, (kur mësimi i gjuhës bëhet për motive fetare).⁴

Në situatën e bilinguizmit (shqip-vllahisht) kur ndodh këmbimi midis këtyre dy gjuhëve shfaqen: **funksionet e secilës prej gjuhëve në sjelljen e përgjithshme**, si dhe **shkalla e zotërimit të të dy gjuhëve** që kanë arritur bilingët. Nga konstatimet tona përqindja dhe përpjestimi i këmbimit ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme të njëjti individ në funksion të subjektit për të cilin flet, të vetës së cilës i drejtohet dhe të situatës në të cilën gjendet.* Interpretimi statistikor për kë- të rast është objekt i një punimi tjetër, icili e plotëson dhe e argumenton përfundimisht faktin që po analizohet.

Si përfundim, për këtë çështje, do të theksonim se anëtarët e këtij minoriteti realizojnë **përdorim të brendshëm** të gjuhës: biseda me tematikë të kufizuar, kryesisht familjare. Në këtë kuadër, nga anketimet, spikatin: numërimi, sharjet (në disa raste në grupmoshën e vjetër), ëndrrat.

Ky pë rdorim pë rcahton **edhe kahun parësor të ndërdikimit fonetik, i cili përgjithësisht orientohet nga vllahishtja mbi gjuhën shqipe të këtyre individëve ve, duke “konservuar” kë shtu tipare fonetike konstante, të cilat më parë se sa gjuha vllahe, i identifikojnë këta individëve si vllahë.**

II.2 Ndikime fonetike të vllahishtes mbi shqipen në ligjërimin e folur

Në shfaqjen e ndikimeve fonetike mbi shqipen i jemi referuar dy rrafshëve: atij të të folurit (*personal*) dhe rrafshit të gjuhës (*sistematik*) kolektiv, por për përfundimet e mëposhtme natyrisht ky i fundit përbën pikën e referimit. Do të theksonim se personat e përzgjedhur kanë një kompetencë gjuhësore mesatare, që do të thotë se zotërojnë variantin gjeografik (toskërishten) dhe variantin standard të shqipes.

Kërkimi në këtë rast ka si objekt dallimet fonologjike që lidhen me **inventarin e fonemave**; me **dallime të sistemit të fonemave**, që lidhen me vendin që zënë në sistem dhe me kundërvëniet që formojnë, si dhe me **dallimet e funksionit të**

⁴ Shih: Vesel Nuhiu, Studime sociolinguistike, Prishtinë.

fonemave; dallimet që lidhen me këmbimin e fonemave në kushte të caktuara fonetike. Duke qenë se këndvështrimi është sociolinguistik, natyrisht këto dallime fonologjike i kemi parë të lidhura me ndryshoren sociolinguistike “moshë”, pra janë anketuar folës që u përkasin tri grupmoshave: asaj të re, të mesme dhe të vjetër.

Për të arritur në përfundimet e mëposhtme janë shfrytëzuar të dhënat e përshkrimit nyjetimor dhe akustik të zanoreve dhe bashkëtingëlloreve për gjuhën shqipe, si dhe botimi “Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre”, i autores S. Poçi.

Për dukuri fonetike, që nuk i ka gjuha standarde, janë shfrytëzuar veçoritë e dialektit të toskërishtes veriore. drejtuar dialekteve. Për gjuhën vllahe janë shfrytëzuar jo vetëm të dhënat teorike nga literatura ekzistuese në gjuhën shqipe, por edhe duke i vështruar nga lidhjet që ato realizojnë në rrjedhën e ligjëritimit. Për këto krahasime janë përzgjedhur grupe folësish kompetenca gjuhësore e të cilëve është e nivelit të mesëm, pra që zotërojnë mirë përveç variantit dialektor edhe variantin standard të gjuhës shqipe.

a. Inventari i fonemave zanore

Në këndvështrimin dialektor, seria e zanoreve të theksuara për variantin dialektor paraqitet:

Vllehët e Jugut të Shqipërisë (Mallakastër, Vlorë, Berat, Skrapar, Pogradec, Gorë, Korçë, Devoll, Kolonjë, Përmet, Myzeqe Lushnjë) kanë një inventar prej shtatë fonemash zanore gojore të shkurtra: ĩ, y, ě, ě, ǒ, ǎ, ũ.

Të njëjtin inventar kemi edhe për serinë e zanoreve të gjata.⁵ Jugu nuk ka zanore hundore.

Në shqipen standarde nuk ekziston kundërvënja zanore të gjata- zanore të shkurtra.

Për të përpiluar inventarin iu kemi referuar studimeve në fushën e fonetikës së gjuhës shqipe: Klasifikimi i zanoreve, që mbështetet në sistemin e tipareve dalluese nyjetimore të Trubeckoit, ka një traditë gjysmëshekullore në studimet fonetike shqiptare. Tiparet e këtij sistemi janë kryesisht pozitive, d.m.th. tipare nyjetimore, i vetmi tipar negative është tipari e pabuzorëzuar.

⁵ Shih: Gj. Shkurtaj, J. Gjinari, Dialektologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2008.

Zanoret	E perparme	E përzier	E prapme	E hapur	Gjysme e mbyllur	E mbyllur	E buzërozu	E pabuzërozu
i	+					+		+
y	+					+	+	
u			+			+	+	
o			+		+		+	
e	+				+			+
ë		+			+			+
a			+	+				+

Një klasifikim më i thjeshtë është ai që mbështetet në sistemin e tipareve binare të N.Çomskit dhe M. Halles. Edhe ky sistem bazohet në tipare nyjetimore, ashtu si sistemi i Trubeckoit, por dallon prej këtij sin ë numrin e tipareve, edhe në konceptimin e tipareve si madhësi me dy vlera: një positive (+) dhe një negative (-), që do të thotë që prania e një tipari shënohet me (+) dhe mungesa e tij me (-). Përparësia e këtij sistemi për shqipen është se për karakterizimin e fonemave zanore të gjuhës standard shqipe mjaftojnë vetëm pesë tipare binare: [±e lartë], [±e ulët], [±e prapme], [±e përparme] dhe [±buzore], pra tri tipare më pak se në sistemin e Trubeckoit.⁶

Zanoret	u	o	y	i	e	ë	a
[±e lartë]	+	-	+	+	-	-	-
[±e ulët]	-	-	-	-	-	-	+
[±e prapme]	+	+	-	-	-	-	+
[±e përparme]	-	-	+	+	+	-	-
[±buzore]	+	+	+	-	-	-	-

b. Dallimet në funksionet e fonemave zanore

⁶ Shih: Rami Memushaj, Fonetika e shqipes standarde, Tiranë 2009.

1. **Fonema |a|** në vllahisht është një zanore gojore e ngritjes së ulët, e radhës së mesme. Ajo del e theksuar në të tri pozicionet e mundshme: nistor, p.sh. árnu, (pjsë mishi), mesor grási (I dhjamur); fundor imná(ecte), si dhe e patheksuar, në pozicion nistor arúku; në pazicion mesor paštámalu (peshqiri); fundor kápra (dhia).

Në shqipen standarde fonema |a| është një zanore e hapur, jobuzore e radhës së prapme. Kjo fonemë e theksuar del në të tri pozicionet e mundshme:

P.sh.: nistor, Ár, álpe, árrë, árë, ájër etj. Në fjalë njërrokëshë: áh, cáp, cáj, çám etj.

Në pozicion mesor: Matánë, argát, por edhe në fjalë të përbëra a të përngjitura ku |a| është e theksuar (si theks i dytë i fjalës) p.sh.: nënëmádhe, njëfárë, etj.

Në pozicion fundor në rrokje të mbyllur: p.sh.: përkráh, qelquriná-t, si dhe në fjalët qerratá, belá, xhaxhá, bakllavá (të cilat janë të huazuara nga turqishtja, dhe kanë ruajtur theksin fundor). Në të njëjtat pozicione del edhe kur është e patheksuar: Amtar, aparat, arsim, brendazi, gusha, thembra.

Në gjuhën vllahe para bashkëtingëlloreve hundore, fonema |a| merr timbër hundor, p.sh.: án, (vite); cilimán, (fëmijë) etj.

Kjo dukuri reflektohet edhe në gjuhën shqipe të këtyre bilingëve dhe njëlloj si në vllahisht, por jo vetëm në rrokje të mbyllur. *i mángët, ranishtë. (Diçka e tillë në gjuhën shqipe ndodh në dialektin e veriut(gegërisht), ku zanoret e theksuara para bashkëtingëlloreve hundore m, n, nj. kanë timbër hundor.)*

Duke qenë se në gjuhën shqipe fonema |a| është e ngritjes së ulët, bilingët shpesh, nyjëtimin e saj, në pozicion të theksuar e realizojnë si më të përparme, konkretisht midis e-së dhe a-së së shkurtër. P.sh.: sándzi (gjak), mána (dorë) bákër, i çálë, çadër etj.

Fonema |e| në gjuhën vllahe paraqitet e ngritjes së mesme, e radhës së përparme gojore. Del e theksuar në pozicion nistor ési (del); mesor nvésti (nuset). Në aromanisht vërehet që kjo fonemë kur është e theksuar në pozicion fundor nuk realizohet.

Edhe në gjuhën shqipe kjo fonemë karakterizohet nga të njëjtët tregues, por del në të tri pozicionet e mundshme si e theksuar ashtu edhe e patheksuar p.sh.: écje, bréndazi, étje.

Në gjuhën shqipe këta bilingë e realizojnë këtë fonemë edhe në këto kushte. P.sh. në fjalë njërrrokëshe si: pè, drè, fè, por edhe në fjalë të huazuara nga turqishtja, si: xhadè, bahçè, (të cilat mund të dalin edhe me theks në rrokjen e parë sipas skemës theksore të shqipes). Ashtu si folësit e shqipes standarde edhe bilingët vllahë në rrokje të hapur të theksuar e shqiptojnë si të hapur këtë fonemë p.sh.: pé [pɛ], dhé [dɛ], fre [frɛ].

Në dialektin e toskërishtes zanorja e e patheksuar pranë bashkëtingëlloreve hundore m, n, nj, zëvendësohet me ë psh: pë, drë, zëmër, thëmbër, vënd, shënjë etj., përjashtohen këtu të folmet e Korçës, Pogradecit, Devollit.

Në rastin tonë, kjo dukuri del si fakultative në grupmoshën e mesme dhe të re të bilingëve, ndërkohë që grupmosha e vjetër përgjithsisht nuk e ka një prirje të tillë.

Në gjuhën vllahë nuk ekziston fonema |ɛ|. Kurse në gjuhën shqipe ajo realizohet si një zanore e ngritjes së mesme, e pabuzorëzuar dhe per nga rradha shfaqet e përzier. Në këtë rast, bilingët e këtyre zonave nuk e realizojnë fonemën |ɛ| si gjysmë të mbyllur, siç është tipari karakterizues i saj në gjuhën shqipe, por e realizojnë si më të përparme sidomos para paragjuhoreve alveodhëmbore /t/ fëmijët, mëtoj, /d/ mëdyshje, medalje. Edhe afrikantet alveolare /c/, pesëcepësh /x/, xixë, xëc e bëjnë më të përparme këtë zanore. Këto dukuri ndodhin edhe në gjuhën standarde të shqipfolësve.

Kjo zanore del si më e prapme pas anësore /l/ gëlltit. Pra kjo zanore nuk është shumë e mprehtë dhe e kthjellët në të dëgjuar. Në fakt variantin dialektor zanorja ë, në pozicion fundor dhe në rrokje të hapur dëgjohe vetëm në pak të folme të anës juglindore ndërkohë që mosrregjimi i zanores ë është një tipar dallues në të folmen e bilingëve vllahë.

Fonema |i| në gjuhë n vllahë paraqitet si zanore e ngritjes së lartë, e rradhës së përparme, gojore. Ajo realizohet përkatësisht si në pozicion të theksuar ashtu edhe të patheksuar në të tri pozicionet e mundshme në fjalë (nistor, mesor, fundor) p.sh.:

-íntra (hyr); ímur (i butë); amínu (hidhe); aísta (kjo); susí (fejoi); fudzí (iku).
-tendí (tenda), vínis (erdhe); isa (doli)

Edhe për shqipen kjo fonemë në pozicion të theksuar ka të njëjtat tipare dhe del në tri pozicionet e mundshme p.sh.

íkër, hí, hírrë, ínat, íntësí, besëíldhje, aníje, deti, beqarí, bashkí, avllí, pjerrësí etj. Edhe e patheksuar, kjo zanore del në të tri këto pozicione, p.sh.: nistor *ínát*; mesor *incizím*; fundor *kunatí*.

Në gjuhën shqipe fonema |i| del si element i patheksuar në diftongjet ngjithëse ose zbritëse, si në fjalët ia dha, ndier babai. Në këto diftongje /i/ realizohet si [j], përkatësisht [ja] [ndjerë], [babaj], duke u përzier me variantin themelor të fonemës bashkëtingëllore /j/. Mund të themi se këta bilingë orientohen më shumë ndaj |i| dhe jo ndaj fonemës bashkëtingëllore |j|, siç ndodh me folësit e gjuhës shqipe.

Fonema |y| në vllahisht mungon.

Në gjuhën shqipe kjo fonemë realizohet si një zanore e ngritjes së lartë, buzore, e rradhës së përparme.

Në variantin standard të kjo bashkësi nuk vërehet dukshëm dallimi në gjatësi, në varësi të faktit se ndodhet në rrokje të hapur apo të mbyllur p.sh.: *dý*, *i dýtë*, *sý*, *sýtë*. Mendojme se këtu ndikon edhe fakti se ashtu si shqipfolësit, këta bilingë nuk e rrëgjojnë zanoren ë të patheksuar, si dhe faktit se zanorja |y| nuk del asnjëherë e patheksuar në pozicion fundor.

Gjithashtu, do të theksonim se edhe te këta bilingë, ashtu si edhe te folësit e shipes në disa fjalë vërehet këmbimi i pakushtëzuar i kësaj foneme me fonemën |u|, p.sh.: *virtut* (*virtyt*); *trusni* (*trysni*), *musliman* (*mysliman*).

Fonema |o| në gjuhën vllahe realizohet si një zanore e rradhës së prapme, e ngritjes së mesme, buzore.

Fonema |o| e theksuar mund të dalë në të tri pozicionet e mundshme: nistor, mesor dhe fundor, p.sh: *óptu* (*tetë*); *dómnu* (*zotëria*); *akó* (*atje*).

Fonema |o| e patheksuar nuk del në asnjë pozicion.

Në shqipe ajo realizohet si e theksuar dhe si e patheksuar p.sh:

-orë, pilót, përsós, çlodh, kashtór, fól, pickó, punó, hórr, lót, lóz,

- kálllo, karrocíer, kokorósh, korrózi, monédhë etj. **Do të theksonim se në grupmohën e vjetër të këtyre bilingëve shpesh kjo fonemë na shfaqet me nuancë hundore sidomos në rastet kur është e theksuar, në të tri pozicionet, p.sh.órë, langónj, punó.**

Në gjuhën vllahe togjet e zanoreve (në krahasim me diftongjet) dalin shumë rrallë.

Dallojmë këto togje zanoresh: aq, au, ai, ea, ia, p.sh.: aqtsi, (këtu), aúšu (plaku), aísti (këto), aíč (këta), béañ (bejlerë), atsía (aty).

Në gjuhën shqipe, denduri përdorimi kanë togjet e zanoreve: ua, ue, ye, ie. Megjithëse, sic e shohim nuk ka ndonjë ngjashmëri, kemi konstatuar se të gjitha grupmoshat nuk kanë vështirësi në realizimin e këtyre diftongjeve, të cilat në dialektin e jugut paraqisin këto tendenca:

-theksohet zanorja e parë, por dalin si zanore të shkurtra si pasojë e ë-së së patheksuar fundore që shpesh i shtohet trajtave të fjalëve, p.sh. në shumësin e emrave që s'marrin prapashitesë trajtëformuese (mësuesë [disa mësues], punuarë [punuar], lyerë [lyer]).

Do të theksonim se togu zanor *ie* në këta folës paraqet rezistencë ndaj dukurisë së kalimit të këtij togu në *je*: *miell* [mjell], *diell*, [djellë] ose të monoftongimit në *e* p.sh. në rastin e fjalës *qiell*, [qelli].

c. Inventari i fonemave bashkëtingëllore

Shqipja standarde ka një sistem që përbëhet nga 29 fonema bashkëtingëlloresh:

p t c c q k
 b d x xh gj g
 h
 m n nj
 f th s sh
 v dh z zh
 l ll r rr

Në variantin dialektor të jugut, në toskërisht në sistemin e bashkëtingëlloreve dallimet dialektore janë më të pakta se në sistemin e zanoreve. Prej të folmeve të toskërishtes do të veçonim atë të Beratit me rrethinat, e Korçës e të Devollit, të cilat kanë dy fonema më pak krahasuar me të folmet e pjesës tjetër të arealit jugor. Pikërisht në këto të folme kanë dalë nga sistemi bashkëtingëllorja *h* dhe bashkëtingëllorja dridhëse e fortë *rr*.⁷

d. Dallimet në funksionin e fonemave bashkëtingëllore dhe të grupeve të bashkëtingëlloreve

⁷ Shih: Shkurtaç, Gj, Gjinari, J, Dialektologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2008.

Për të përcaktuar dallimet në funksionin e fonemave bashkëtingëllore kemi përzgjedhur nga inventari i fonemave të aromanishtes ato raste që lidhen me përdorimin e gjegjëseve të tyre në pozicion nistor: s, z, š, č, si dhe grupet e bashkëtingëlloreve mb, nd.

Në vllahisht fonema |s| është një bashkëtingëllore e shurdhët shtegore, alveolare.

Del në pozicion nistor, mesor dhe fundor p.sh: sari, mesor (mes dy zanoresh ose e paraprirë a ndjekur nga një bashkëtingëllore) përkatësisht: másini (ullinj); nviásta (nusja); fundor ars (i djegur).

Fonema |z| është një bashkëtingëllore e zëshme, shtegore alveolare.

Del në pozicion nistor dhe mesor. Në pozicion fundor nuk del.p.sh: zálă (zall), ază (sot)

Në gjuhën shqipe, këto fonema bashkëtingëllore, përkatësisht |s| dhe |z| kanë të njëjtat tipare me fonemat e vllahishtes. Në shqip në pozicion nistor |s| përdoret në fjalë para bashkëtingëlloreve të shurdhëta, ndërsa |z| përdoret para bashkëtingëlloreve të zëshme. Të dyja këto bashkëtingëllore s/z i kundërvihen njëra-tjetrës për nga tipari i zëshmërisë. Shembujt janë çifte fjalësh që dëshmojnë këtë ligjësi në gjuhën shqipe: (sfilit/zvarit; spërkat/zbavit; sqepar/zgjedh).

Në gjuhën vllahe fonema |č| është një bashkëtingëllore e shurdhët, mbylltore qiellzorealveolare. Del në të tri pozicionet e mundshme p.sh.: čoku (çekan); fičór (djalë); ič (fare).

Në gjuhën shqipe kjo fonemë bashkëtingëllore |c| në pozicion nistor, me disa përjashtime përdoret para bashkëtingëlloreve të tingullta dhe para zanoreve p.sh: çmalle, çlodhem, çngatërroj, çorganizoj. Për të gjitha këto raste është konstatuar se folësit bilingë përgjithësisht i përdorin drejt këto bashkëtingëllore në pozicion nistor. Në disa raste në mënyrë fakultative vërehet përdorimi i fonemes |x| në vend të |z| p.sh. xbres (zbres); xbath (zbath), si dhe realizimi i fonemës |s| me një tendencë alveo-qiellzore.

Në gjuhën shqipe përveç këtyre fonemave që shfaqin tipare të përbashkëta kemi edhe fonemën bashkëtingëllore |zh| e cila realizohet si shtegore, qiellzorealveolare e zëshme. Ky fakt pasqyrohet në variantin dialektor në të folmen e grupmohës së vjetër, të cilët ndonëse në mënyrë fakultative bëjnë herë-herë një përzgjedhje të gabuar duke përdorur fonemën |sh| me një shteg pak më

të gjerë se në rastin tipik në vend të kësaj foneme. Madje do të theksonim se kjo dukuri vërehet më tepër te femrat.

Fonema **[h]** në gjuhën vllahe realizohet si një bashkëtingëllore shtegore, velare e shurdhët, p.sh.: hári (lezet); ahtári (e tillë) dhe rrallë në pozicion fundor zādúh (zagushi)

Kjo fonemë, në të folmen e bilingëve vllahë, për faktin që në dialektin e jugut (toskërisht) nuk është pjesë e sistemit të bashkëtingëlloreve, ndodh që të mos realizohet fare në të tri pozicionet e mundshme. Por edhe kur realizohet, kryesisht në grupmoshën e vjetër, dhe në mënyrë fakultative në dy grupmoshat e tjera, realizohet si shtegore, e zëshme, glotale në të tri pozicionet e mundshme në fjalë p.sh.: hije, hedh, krahët, lahem, gjah, krah etj.

Së fundi, do të ndaleshim te shqiptimi në gjuhën shqipe i fonemës **[r]** (dridhëse, e tingullt) dhe fonemës **[rr]**, (dridhëse e fortë, e tingullt). Fonema **[r]**, në aromanisht paraqitet si dridhëse, e tingullt, prapagjuhore dhe del në të tri pozicionet e mundshme: róshi (të kuqe); aríu (kullotë verore) sínur (kufi).

Në shqip ajo realizohet si mesgjuhore. Kjo mospërputhje bën që shqiptimi i kësaj bashkëtingëlloreje në gjuhën shqipe të jetë një tipar dallues i këtij minoriteti. Konkretisht, në të tri pozicionet e mundshme, bashkëtingëlloreje **r** shqiptohet më shumë si prapagjuhore, si në fjalët: raki, regj, lemeri, kukurec, i kaltër; i mësuar etj. Në gjuhën shqipe fonema **[rr]** pothuajse nuk realizohet nga bilingët e të gjitha grupmoshave. Rastet e shqiptimit janë të rralla dhe fakultative.

Grupet e bashkëtingëlloreve, në gjuhën shqipe, janë: *mb, nd, ng, ngj*. Në qoftë se do të bënim një përqasje të grupeve të bashkëtingëlloreve, përkatësisht, në vllahisht dhe shqip do të theksonim se edhe në gjuhën vllahë:

Nd shfaqet në të tri pozicionet e mundshme në fjalë, p. sh.: ndárdzia (rregullonte); téndi (tenda); känd (kur);

Mb shfaqet në pozicion nistor dhe mesor, p.sh.: mbărám (kalonin varg).

Në gjuhën shqipe këto grupe bashkëtingëlloresh bilingët i realizojnë pa vështirësi në të tri pozicionet: mbaj, kumbull, thumb, nder, mendje, end.

Në mbyllje të kësaj çështjeje, mund të themi se në lidhje me veçoritë e sistemit fonologjik të shqipes së këtyre bilingëve, për të dy varietetet, atëdialektor dhe atë standard, përcaktojnë shkallën e dygjuhësisë vllahisht-shqip, shkallë kjo që dëshmon për nivel të mirë të zotërimit të shqipes, si dhe funksionet

në të cilat këta bilingë përdorin këto dy gjuhë si dhe masën e ndërrimit të gjuhës, kryesisht në dy sfera të sjelljes shoqërore: në familje, në miqësi, ku dhe realizohet ndërveprimi transaksional..⁸

III. Përfundime

Për të konkluduar për perspektivën e zhvillimit të bilinguizmit shqip-vllahisht, në zonën gjeografike të rrethit të Korçës, në kushtet kur ajo paraqitet e kushtëzuar nga faktorët sociolinguistikë të kufizuar në numër krahasuar me faktorët që veprojnë në rastet ideale, kur kahu i ndërndikimive të konsiderueshme fonetike, **dëshmon jo vetëm për faktin se gjuha e këtij minoriteti nuk mund tëshërbejë për komunikimin gjuhësor në tërësinë e sferës shoqërore, por vetëm për komunikim familjar, a brenda grupit, në situata joformale, por edhe për faktin që shqipja dominon repertorin e tyre gjuhësor; si dhe kur numri i individëve të kësaj bashkësie shoqërore paraqitet i reduktuar, (Sipas të dhënave të publikuara, rreth 60 % e vllahëve të Shqipërisë, jetojnë në Greqi).⁹ mund të themi se në vijimësi ajo mund të mos realizojë standardin e një gjuhe funksionale, e si e tillë të mos funksionojë më në kuadër të bilinguizmit të mirëfilltë.**

Natyrisht, perspektiva e zhvillimit gjuhësor, nuk duhet të shkojë në kah të bjerrjes së gjuhës, e për këtë **politika gjuhësore duhet të stimulojë më shumë ruajtjen e gjuhës së minoritetit vllah, duke e konsideruar atë si vlerë të shtuar në një bashkësie shoqërore heterogjene,** (koncept bashkëkohor ky në studimet sociolinguistike).

BIBLIOGRAFI

- Beci, B., Vëzhgime për dendurinë e përdorimit të fonemave zanore dhe bashkëtingëllore në gjuhën e sotme letrare shqipe, SF, 1986, f.61-76.
- Bevington, G., Albanian Phonology, Otto Harrassoëitz, Eiesbaden, 1974.
- Brezeanu, S. *Latiniteti lindor në mijëvjecarin e migrimeve të mëdha*, Historia e Rumanisë, Tiranë, 1976.

⁸ Shih: Gjovalin Shkurtaj, "Sociolinguistika" Tiranë, 1999.

⁹ Wikipedia

- Çabej E., Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Fonetika historike, Studime gjuhësore, III, Prishtinë, 1976.
- Demiraj, Sh., Theksi në gjuhën shqipe, SF 1984, nr.2.
- Gjinari, J, Dialektologjia shqiptare, Tiranë, 1998.
- Jashari, A., Biba, E., Praktikum për drejtshkrimin dhe shenjat e pikësimit, Korçë, 2005.
- Memushaj, R., Fonetika e shqipes standarde, Tiranë, 2009.
- Nuhiu, V., Studime sociolinguistike, Prishtinë.
- Poçi, S. Vllehtë, historia dhe gjuha e tyre, Tiranë, 2009.
- Shkurtaj, Gj, Gjinari, J, Dialektologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2008.
- Shkurtaj, Gj, Sociolinguistika, Tiranë, 1999.
- Topalli K, Fonetika historike e gjuhës shqipe, tiranë, 2007.
- Trubeckoj, N.S., Osnovy fonologii, Moskva, 1960.

DR. HYSNIE HAXHILLARI (HYSKA)

**DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”**

hhyska@unkorce.edu.al

NDËRTIME SINTAKSORE TË GJUHËVE NË KONTAKT: SHQIP- MAQEDONISHT-ARUMANISHT

Abstrakt

Shqipja, maqedonishtja dhe arumanishtja janë tre gjuhë të cilat historikisht kanë qenë në kontakt mes tyre. Duke pasur folësit e tyre në territore të përafërta ose fqinje, përgjithësisht në zonat përreth liqenit të Ohrit e të Prespës, por edhe në gjithë Shqipërinë Juglindore, këto tre gjuhë kanë bashkëjetuar për një kohë të gjatë mes tyre duke formuar edhe të ashtuquajturën “Lidhje gjuhësore” siç njihet në gjuhësinë ballkanike. Ashtu siç e kanë nënvizuar edhe përfaqësues të gjuhësisë ballkanike si Kopitari, Sandfeldi etj., këto gjuhë kanë material të ngjashëm leksikor, me veshje fonetike të ndryshme. Por, përveç leksikut, tre gjuhët në kontakt kanë formuar edhe struktura të ngjashme sintaksore si pasojë e ndërveprimit gjuhësor për nevoja të komunikimit të folësve të tyre. Ndërtimet sintaksore të përfuara si rezultat i ndërveprimit gjuhësor mes shqipes, maqedonishtes dhe arumanishtes do të përbëjnë edhe objektin e kësaj kumtese, duke u përqendruar kryesisht në përbërjen e sintagmës emërore, të sintagmës mbiemërore dhe të sintagmës parafjalore. Metoda e këtij punimi do të jetë kryesisht ajo krahasuese dhe analizuese. Duke qenë se dialektet apo të folmet janë burimi më i frytshëm për të nxjerrë në pah dallime dhe ngjashmëri sintaksore mes gjuhëve në kontakt, edhe materiali gjuhësor mbi të cilin do të punohet do t'i përkasë këtyre varianteve gjuhësore.

Fjalë kyçe: ngjashmëri; strukturë; sintagmë emërore; sintagmë mbiemërore; sintagmë parafjalor

1. Hyrje

Ballkani ka qenë për një kohë të gjatë vendi i kontakteve gjuhësore, që nga lashtësia deri në kohët e sotme. Pikënisja e krahasimit të ndërmarrë në këtë kumtesë për gjuhën shqipe, arumune dhe maqedone është pikërisht produkti gjuhësor i krijuar nga marrëdhënie të gjata gjuhësore mes folësve të këtyre gjuhëve të ndryshme në Ballkan, që vetvetiu të çon tek ideja e Sprachbund-it ballkanik, dëshmi e gjeografisë gjuhësore dhe kontaktit gjuhësor. Kontaktet gjuhësore në Ballkan kanë qenë të vlerësuara edhe nga vetë folësit përkatës të

këtyre gjuhëve të cilët kanë krijuar edhe proverbin ballkanik “Sa më shumë gjuhë të flasësh, aq më shumë vlera ke si njeri” (the more languages you speak, the more people you are worth), i gjendur në shqipe, arumanishte, meglendorumanishte, bullgarishte, romishte dhe maqedonishte¹.

Dukuria e shumëgjuhësisë në një territor jo aq të madh si gadishulli i Ballkanit ka sjellë edhe kontakte gjuhësore mes gjuhëve të tipologjive të ndryshme si ato mes shqipes, greqishtes, gjuhëve latine dhe gjuhëve sllave. Siç dëshmon edhe ballkanologu i njohur V. Friedman “shumëgjuhësia në Ballkan zhvillohet në nivel vendor në të gjitha shtetet-kombe ballkanike.² Megjithatë, dihet tashmë se epiqendra e lidhjes gjuhësore ballkanike (Sprachbund-i Ballkanik) përcaktohet shteti i Maqedonisë së Veriut, këtë e pohon edhe V. Friedman-i kur shkruan se “me rëndësi të veçantë është kompleksiteti i shumëgjuhësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku gjedhe të risive ballkanike vijnë të veprojnë edhe sot e kësaj dite. Kjo dukuri, nga ana e saj, jep prova të zhvillimit të mekanizmit të kontaktit të gjuhëve”. Duke u nisur nga fakti se kushtet që prodhuan lidhjen gjuhësore ballkanike vijnë të ekzistojnë në nivel të rajoneve dhe komuniteteve, Friedman-i arrin në përfundimin se jo vetëm historia e lidhjes gjuhësore ballkanike meriton hulumtime të mëtejshme, por edhe e tashmja e saj³.

Në literaturën gjuhësore si ballkanizma përgjithësisht mbahen tipare strukturore, elemente të gramatikës, veçanërisht të natyrës morfo-sintaksore, por gjuhët ballkanike tregojnë edhe konvergjenca në tipare fonologjike gjithashtu. Kontaktet e shpeshta gjuhësore mes folësve të gjuhëve të ndryshme në Ballkan kanë sjellë formimin e konvergjencave strukturore ku marrin pjesë elemente jo vetëm të klasave të hapura të fjalëve, por edhe elemente të klasave të mbyllura. Këtë dukuri e sjellin në vëmendje dy studiues, Friedman dhe Joseph, të cilët në një artikull trajtojnë konvergjenca leksikore të Sprachbund-it, ku dallojnë një grup special të huazimeve bisedore që lindin në kushtet e Sprachbund-it, më

¹ V. Friedman, art. *Languages are wealth*, Proceedings of the Annual Meeting of the Berkeley Linguistics Society, 2012, f. 163

²V. Friedman, *The Balkan Sprachbund in the Republic of Macedonia today*, Colloquia Humanistica, 2015, f. 115

³V. Friedman, po aty, f. 115

saktësisht në ato kushte që u japin jetë konvergencave strukturore. Në këtë grup fjalësh të huazimeve bisedore në disa raste përfshihen edhe njësi të klasave të mbyllura të fjalëve dhe forma gramatikore të menduara si të pamundura për t'u huazuar, dhe megjithatë ato janë huazuar në Ballkan, duke dëshmuar kontakte gjuhësore të shpeshta (intense) dhe të qëndrueshme në gadishull, që kanë çuar edhe në krijimin e lidhjes gjuhësore ballkanike (Sprachbund).⁴

Duke pasur parasysh këtë kuadër të përgjithshëm të shumëgjuhësisë, të lidhjes gjuhësore ballkanike, të kontakteve të shpeshta gjuhësore mes gjuhëve të ndryshme në gadishullin e Ballkanit, na u duk me interes të trajtohen kontaktet gjuhësore mes shqipes, arumanishtes dhe maqedonishtes, si kontakte të shpeshta dhe mjaft të zgjatura në kohë. Si të tilla, kontaktet mes tre gjuhëve na ofrojnë një material të pasur gjuhësor, i cili dëshmon edhe gjurmët e shkëmbimeve gjuhësore përkatëse.

Marrëdhënie më të ngushta mes shqipes dhe arumanishtes janë zhvilluar nga kontaktet e shqiptarëve me arumunët e quajtur “Frashëriot” të vendosur në Shqipërinë Qendrore, rreth shek. X të erës sonë. Këtë kohë e përcaktojmë nisur nga dëshmia që ka lënë studiuesi danez K. Sandfeld në veprën e vet “Linguistique Balkanique” (1930) ku shkruan se “Prania e arumunëve në Maqedoni dhe Tesali dëshmohet prej shek. X. Mund të shpjegojmë atëherë pse një pjesë e përkimeve mes shqipes dhe rumanishtes nuk gjenden në arumanishte.”⁵ Gjithashtu, një dëshmi tjetër, më e vonë, është ajo e studiuesit B. D. Joseph, i cili shënon se “kontaktet gjuhësore ndërmjet greqishtes dhe arvanitikishtes (varietet i dialektit tosk të shqipes) dhe greqishtes dhe arumanishtes (Vlach- varietet i rumanishtes) janë zhvilluar për më se 600 vjet.”⁶

Koha e gjatë dhe lidhjet e ngushta ndërgjuhësore sollën si pasojë një ndikim të madh të shqipes si gjuhë vendëse mbi gjuhën e “ardhësve”, gjë që e pohon edhe

⁴ V. Freidman, B. D., Joseph, *Eastern and Western Romance in the Balkans – the Contrasting but Revealing Position of the Danubian Romance Languages and Judezmo*, në “Journal of Language Contact, 14, 2021, 127-146.), f. 130

⁵ K. Sandfeld, *Linguistique Balkanique*, Paris, 1930, f. 145

⁶ B. D., Joseph, *Is Balkan Comparative Syntax possible?* në *Comparative Syntax of Balkan Languages*, Oxford University Press, 2001,

K. Sandfeldi kur shkruan se “arumunët që jetojnë në Shqipëri pasqyrojnë në gjuhën e tyre pa dyshim numrin më të madh të veçorive të shqipes.”⁷

Ndërsa marrëdhëniet gjuhësore mes shqipes dhe maqedonishtes janë zhvilluar dhe zhvillohen në kushte të ndryshme historike, gjeografike dhe politike. Zhvillimi i kontakteve gjuhësore mes tyre është kryer në dy areale të ndryshme: së pari, në zonat përreth liqenit të Prespës dhe të Ohrit, ndërmjet folësve maqedonë, të cilët mund të quhen folës dygjuhësh në këtë rast dhe, folësve shqiptarë, të cilët në rrethana të caktuara shoqërore janë ndikuar nga gjuha e tyre. Së dyti, kontakti mes shqipes dhe maqedonishtes merr përmasa edhe më të mëdha në territoret e shtetit maqedonas. Për këto marrëdhënie Friedman-i shkruan se secila nga gjuhët ndikon mbi tjetrën në varësi të rrethanave të ndryshme sociolinguistike. Duke sjellë një shembull konkret të këtij ndikimi, shkruan se në lagjen Çair të Shkupit, që në harkun kohor të dyzet vjetëve të fundit ka kaluar nga një lagje e përzier gjuhësisht në një lagje me predominancë të shqipes, folësit e rinj amtarë të maqedonishtes synojnë ta theksojnë fjalën në rrokjen e fundit të temës, sesa në rrokjen e parafundit, që është theksi kryesor i shqipes: *cove 'k-om* (personi). Friedman-i përmend edhe një tjetër ndikim të shqipes në maqedonishten e shqiptarëve dhe të folësve të tjerë (si prirje për t'u përhapur) siç është përdorimi i formave të së pakryerës kur në maqedonishte pritej përdorimi i formave të së kryerës.

Nga ana tjetër, edhe maqedonishtja ka ndikuar në gjuhën shqipe, veçanërisht në përdorime të karakterit zyrtar/fomal. Sipas Friedman-it përdorues të shqipes në Maqedoni kanë prirjen të përdorin ndërtimet mbiemërore ku maqedonishtja përdor një mbiemër dhe shqipja normalisht përdor gjinoren:

shqip: *fakulteti i filologjisë*

shqipja e Maqedonisë: *fakulteti filologjik*

maqedonisht: *filllolloshki fakultet* (филолошки факултет)⁸

Gjuha shqipe në këto areale ka qenë në marrëdhënie të ngushta me maqedonishten. Në arealin gjuhësor përreth liqenit të Ohrit dhe të Prespës gjuha

⁷ K. Sandfeld, *Linguistique Balkanique*, vep. e cit., f. 118

⁸ V. Friedman, *The Balkan Sprachbund in the Republic of Macedonia today*, *Colloquia Humanistica*, 2015, f. 118-119.

shqipe është në nivel dygjuhësie, ndërsa në arealin brenda shtetit të Maqedonisë së Veriut, në varësi të politikave të ndjekura, gjuha shqipe nuk ka qenë një gjuhë me të drejta të barabarta me maqedonishten, vetëm kohët e fundit është njohur si gjuhë e dytë zyrtare.

2. Ndërtime sintaksore të gjuhëve në kontakt: shqip-arumanisht-maqedonisht

Një nga qëllimet e Gramatikës Universale është përcaktimi i ngjashmërive dhe dallimeve mes gjuhëve, që në literaturën gjenerative quhen parime dhe parametra. Kjo teori nuk parashikon që gjuhët e analizuara të jenë gjuhë me lidhje prejardhjeje apo gjuhë në kontakt, megjithatë, analizat sintaksore të sjella në vëmendje këtu janë konceptuar mbi bazën e ndarjes parim – i përbashkët, parametër – i veçantë, siç do të vihet re në strukturat e sintagmave të mëposhtme.

Ngjashmëritë sintaksore që burojnë nga Sprachbundi dhe nga situatat e kontaktit nga natyra priren të jenë sipërfaqësore dhe kanë lidhje me një konvergencë të strukturës sipërfaqësore më tepër sesa të strukturës së thellë. Në lidhje me këtë dukuri, studiuesi B. Joseph shkruan se “Gjuhët në situatat e kontaktit mund të shfaqin ngjashmëri “më të thella” ose ndryshime në mënyrat se si këto forma sipërfaqësore gjenerohen sinkronikisht (ose më përgjithësisht, janë integruar në gramatikat e gjuhëve individuale), por vetë format sipërfaqësore, autputi i rregullave gjenerative të sintaksës, duken të jenë niveli kritik ku mund të gjykohen ngjashmëritë që do të dëshmojnë ekzistencën e një Sprachbund-i. Mund të pohojmë se “veprimi” në gjuhët në kontakt ndodh në sipërfaqe, jo në nivelin e strukturës së thellë, megjithëkëtë kontakti është thelbësor në zhvillimin e Sprachbund-it⁹.

Duke pasur parasysh parimin e mësipërm, krahasimi i strukturave të sintagmave emërore, mbiemërore dhe parafjalore, që do të paraqitet më poshtë, i përmbahet strukturës sipërfaqësore të tyre, pa u thelluar në rolin e brendshëm sintaksore të elementeve brenda sintagmave përkatëse. Studimi i kryer për këto ndërtime sintaksore ka pasur si qëllim që të nxjerrë në pah struktura të ngjashme

⁹B. D. Joseph, *Is Balkan Comparative Syntax possible?* në “Comparative Syntax of Balkan Languages”, Oxford University Press, 2001, f. 22

të ndërtimit të sintagmave, përmes analizimit të elementeve përbërës në bazë të përndarjes së tyre në kufijtë e sintagmës.

Sintagma emërore

Në gjuhën shqipe, ashtu si edhe në gjuhën arumune dhe maqedonase sintagma emërore përbëhet nga një caktuesor dhe një emër i pashquar. Caktuesori i kësaj sintagme mund të jetë një nyjë e pashquar apo një përemër dëftor i cili eptohet dhe merr tiparet gramatikore në gjini, numër dhe rasë, siç ilustruhet në shembujt e mëposhtëm:

Shqip: **një** libër i mirë rrëfen gjithcka

arum.: **unë** carti bunë spuni multt.

maqed. **Edna** dobra **kniga** kazhuva sè

shqip: **ky** libër / **kjo** shtëpi

arum. **aist** carti/ **aiste** case

maqed. **ovoj student** / **ovaa** kniga (kniga, gjinia fem.)

Në sintagmat emërore të shqipes dhe arumanishtes caktuesori qëndron në periferinë e majtë të emrit dhe luan rolin e kokës funksionale të kësaj sintagme, ndërsa në sintagmën emërore të maqedonishtes, caktuesori në ndërtimin “*edno dobra kniga*” shfaqet në periferinë më të majtë të emrit të paraprirë nga një mbiemër, çka do të thotë se ai luan rolin e një specifikuesi, duke u ndodhur më lart në strukturën e sintagmës emërore.

Sintagma emërore në përbërje të të cilave shfaqen përemra të pacaktuar dhe numërorë quhen sintagma sasiore, duke u nisur nga emërtimi “sasiore” që u bëhet këtyre elementeve.

shqip: **çdo** libër

arum. **cafi** carti

maqed. **sekoja** kniga

shqip. **shumë** libra

arum. **multt** cërts

shqip: **pesë** libra

arum. **cinci** cërts

maqed. **pet** knigi

Në sintagmat e mësipërme, në të tre gjuhët vihet re se sasioret qëndrojnë në periferinë e majtë të kësaj sintagme dhe nuk shfaqin tipare gramatikore. Këtu

mund të veçojmë sasioren *tre* i cili merr tipar gramatikor për gjininë femërore në shqipe dhe arumanishte. Këtë ndikim e ka përmendur M. Weigand-i i cili dëshmon për formën femërore në arumanishte *treiã* nga *trei*, e krijuar në analogji me shqipen që ka një formë femërore *tri*, krahas mashkullores *tre*.¹⁰

Sintagma emërore me emër të shquar shfaq praninë e caktuesorit shques të pasvendosur, një element i përbashkët për të tria gjuhët. Caktuesori shques i pasvendosur emrit është parë si një nga tiparet ballkanike të gjuhëve të Ballkanit, pranohet gjerësisht nga studiuesit se është shfaqur më herët në shqipe dhe rumanishte, si një veti tipologjike e këtyre gjuhëve për të pasvendosur përcaktorët e pavetmjaftueshëm të emrit. Në këtë kontekst, mund të diskutojmë praninë e nyjës shquese të pasvendosur në maqedonishte dhe arumanishte. Nyja shquese e pasvendosur në këto gjuhë është shfaqur si pasojë e kontaktit me gjuhën shqipe, duke qenë se gjuhët prej nga rrjedhin ato, si gjuhët sllave, ashtu dhe gjuhët latine nuk e kanë nyjën shquese të pasvendosur ndaj emrit, por e shfaqin në pozicionin paraemëror. Në arumanishte, nën ndikimin e latinishtes, nyja shquese shfaqet edhe para emrit, në rastin e emrave të përveçëm dhe të disa emrave të përgjithshëm të ndikuar nga ata: *alu Miha*, *alu preftu*, *ale feate/a* (gjin, dhan.)¹¹. Caktuesori shques shfaq veti gramatikore të gjinisë mashkullore, femërore në shqipe, maqedonishte, ndërsa në arumanishte shfaq edhe tiparin gramatikor të gjinisë asnjëse:

shqip: djal-**i**, vajz-**a** (mashk., fem.)

maqed. grad-**ot**, zena-**ta** (qyteti, gruaja)

arum. ficor-**lu**, cas-**a**, scamnu-**lu** (fëmijë, shtëpia, shkalla- asnj.)

Në sintagmat emërore të shqipes dhe maqedonishtes vihet re një strukturë e përbashkët sintaksore siç është struktura dëftor + emër i shquar. Në këto ndërtime, caktuesori dëftor ka rolin e specifikuesit të sintagmës emërore, ndërsa nyja shquese vijon të ketë funksionin e kokës së sintagmës:

shqip: *Ish një mbret, ai mbreti kish një pelë; pa një shtëpi, ajo shtëpia ish e kaplanit*

¹⁰ K. Sandfeld, *Linguistique Balkanique*, vep. e cit., f. 118

¹¹ A. G., Lazarou, *L'Aroumain et ses rapports avec le Grec*, Institute for Balkan Studies, Thessaloniki, 1986, f. 169

maqed. *Edno vreme imalo nekoj tãrgovec. Toj, tãrgovec-o, imal edno dete i edna žena (Ishte një herë një tregtar. Ky tregtari kishte një djalë dhe një grua).*

Shembujt janë dëshmuar nga studiuesi K. Sandfeld që pohon se këtu kemi të bëjmë me një nga ato raste ku është vështirë të përcaktosh pikën e nisjes së tiparit gjuhësor të përbashkët në gjuhët që merren në studim këtu.¹² Në sintagmat mbiemërore të maqedonishtes caktuesori shques i pasvendoset edhe mbiemrit dhe elementeve të tjera që shfaqen në periferinë më të majtë të kësaj sintagme, ndërsa në shqipe dhe arumanishte caktuesori shques shfaqet në pozicionin pasemëror, shumë më poshtë në strukturë se ai i maqedonishtes:

maqed. *dobrata kniga*

shqip: *libri i mirë*

arum. *cartea bunë*

Siç vihet re nga shembujt e mësipërm, sintagmat mbiemërore të tre gjuhëve kanë struktura të ndryshme: në shqipe dhe arumanishte mbiemri ka pozicion pasemëror, ndërsa në maqedonishte paraemëror. Dallimi tjetër është se në gjuhën shqipe mbiemri shfaqet me një caktuesor nyjor, i quajtur ndryshe “lidhës” (linker Manzini, Savoia), prejardhja e të cilit mendohet se vjen nga një strukturë predikative: *libri është i mirë*. Prania e “lidhësit” në gjuhën shqipe paralelizohet me strukturën e sintagmës mbiemërore të greqishtes: *to kalo vivlio*.¹³

Sintagmat parafjalore

Ndërtimet parafjalore janë përzgjedhur si objekt studimi i kësaj kumtese duke qenë se këto ndërtime janë shumë të pranishme në gjuhën bisedore, regjistri me të cilin realizohet edhe kontakti gjuhësor. Nga shembujt e qëmtuar nga ballkanologët K. Sandfeld dhe V. Friedman, gjuha shqipe, maqedone dhe ajo arumune, duke qene gjuhë në kontakt kanë ndikuar tek njëra-tjetra edhe në rrafshin sintaksor, nëpërmjet huazimit të strukturave parafjalore apo nëpërmjet kalkimit të tyre.

Në ndërtimin e sintagmave parafjalore vihen re ndërtime të ngjashme messhqipes dhe arumanishtes nga njëra anë dhe, shqipes, maqedonishtes dhe

¹² Sandfeld, *Linguistique Balkanique*, vep. e cit., f. 122

¹³ A., Androutsoupoulou, *Adjectival determiners in Albanian and Greek*, Oxford University Press, 2001, f. 165

arumanishtes nga ana tjetër. Këtë kriter ka ndjekur edhe K. Sandfeld-i në veprën e tij “Linguistique Balkanique” (1930) ku dëshmohe disa struktura të ngjashme parafjalore ndërmjet këtyre tre gjuhëve.

Sintagmat parafjalore në shqipe dhe arumanishte

Parafjala *te/tek* në shqipe, *la* në arumanishte + përemër vetor

arum.: *vas-yinã la io (do të vijë tek unë)*

shqip: *do të vinje tek unë, tek prifti*

Përemri vetor në rasën emërore drejtohet nga parafjala *la* në arumanishte, ndërsa në shqipe parafjala *te/tek*: Sandfeld-i na sqaron se përdorimi i emërores në shqipe shpjegohet me atë që “tek” ka si **origjinë një fjalë të afërt nga kuptimi me shprehjen “aty ku”**.¹⁴

Sintagma parafjalore nga, di + numëror/emër

Ky ndërtim gjendet në greqishte, në arumanishte dhe shqipe:

gr, *na pari o hathenas apo ena* (që çdokush mund të ketë nga një)

shqip: *të thoshtë kush nga një përrallë; bënj nga dhjetë ditë sëmurë*

arum.: *lã deade di featã cãte nã palate* (ai i dha secilës prej (nga) vajzave një pallat)¹⁵

Sintagmat parafjalore në shqipe-arumanishte-maqedonishte

Sintagma me parafjalën **me gjithë** + emër

maqedo-bullgarisht: *pojde do se ofçarot* (ai erdhi me bariun)

otide pri zmijata so se baltija (ai shkoi drejt dragoit me sëpatë)

shqip: *nisen këta me gjithë priftin; me gjithë të shoqen*

arum. *le båg ã n casã eu lût çãpitanlu* (ai i vendosi në shtëpi bashkë me kreun e komitëve).

Sandfeldi shpjegon se parafjala *so* (me) në maqedo-bullgarishte shpesh përforcohet nga **se** (gjithë) dhe se në këtë rast kemi një kalkim të ndërtimit “me gjithë” nga maqedonishtja në shqipe.¹⁶

¹⁴ K. Sandfeld, *Linguistique Balkanique*, vep. e cit., f. 118

¹⁵ po aty, f. 111

¹⁶ K. Sandfeld, *Linguistique Balkanique*, vep. e cit., f. 120

Një tjetër studiuës i gjuhëve ballkanike V. Friedman na dëshmon edhe ndërtime sintagmash me parafjalë të dyfishta në maqedonishte dhe arumanishte, të cilat kanë gjegjësen e tyre edhe në shqipe, si në shembujt:

maqed. **od na** padoma/radoma

arum. **di a** lukur

shqip: **për në** punë

Sipas Friedman-it në maqedonishte këto ndërtime janë ndikime nga arumanishtja (nga kontakti gjuhësor arumanisht-maqedonisht), së pari kanë hyrë në maqedonishten e Ohrit dhe më pas janë përhapur edhe në maqedonishten e Shkupit.¹⁷

Përveç ngjashmërive të strukturave parafjalore të mësipërme, sintagmat parafjalore të këtyre gjuhëve shfaqin edhe disa dallime, të para këto tek disa folës të sotëm të arumanishtes dhe maqedonishtes.

Parafjala lokucionore e rasës gjinore në shqipe “me anë të” nuk gjen të njëjtën formë edhe në dy gjuhët e tjera. Në maqedonishte përdoret një parafjalë e vetme në vend të shprehjes lokucionore ndërsa në arumanishte nuk kemi praninë e një parafjale, por kuptimi rasor shprehet me anë të mbaresës rasore të rasës gjinore: shqip: Problemi zgjidhet **me anë të** diskutimeve.

arum.: Problemu si dizleagë diskutantului.

maqed.: Problemot se reshava **preku/so** diskutii (preku = me anë të, so= me)

Parafjala tjetër e rasës gjinore në shqipen “në vend të” gjen gjegjësen e saj në gjuhën arumune, por jo në maqedonishte, në të cilën përdoret pjesëza krahasuese në vend të parafjalës:

shqip: Atë e kam **në vend të** motrës

arum.: Aca u am **tu lloku ali** sori.

maqed.: Taa mi e **kako** sestra. (kako = si)

Parafjala *mbi* e rasës kallëzore gjen gjegjësen e vet edhe në arumanishte, ndërsa në maqedonishte në vend të saj përdoret parafjala *në*:

shqip: Libri ndodhej **mbi** tavolinë

arum.: Cartea ira **pi** masë.

maqed.: Knigata e **na** masa. (na = në)

¹⁷ V. Friedman, *The Balkan Sprachbund...*, vep. e cit., f. 117

E njëjta dukuri vihet re edhe në lidhje me parafjalën *prej* të rasës rrjedhore, ajo përdoret në arumanishte, ndërsa në maqedonishte gjen përdorim parafjala “so”:

shqip.: Ai vinte në shtëpinë tonë **prej** vitesh

arum. Atsel vinia a casa nostë **di** anj tërkuc.

maqed. Toj doagjashe vo nashata kuqa **so** godini. (so = me)

Po e njëjta parafjalë *prej*, në shqipe përdoret në rasën rrjedhore për të treguar lëndën prej së cilës është bërë një send, gjen përdorim edhe në arumanishte me formën *di*, ndërsa në maqedonishte i përgjigjet parafjala *od*, e cila nuk gjen përdorim. Në vend të saj përdoret mbiemri prejëmëror *sfilen* – i mëndashtë:

Kishte veshur një fustan **prej** mëndafshi

Avea n-vëskutë une fustani **di** sirmë.

Oblekla **sfilen** fustan. (Obleka fustan **od** sfila)

Gjuha shqipe dallon prej arumanishteve dhe maqedonishtes në përdorimin e parafjalëve në rasën dhanore: shqipja nuk ka parafjalë në rasën dhanore, ndërsa në gjuhën maqedone dhe arumune përdoren përkatësisht parafjalët *na* dhe *ali*:

shqip: Librit të mirë ia grisa fletët / Lules së bukur ia ndërrova vazon

maqed.: **Na** dobrata kniga i gi iskinav listovite/ stranicite

Na ubovato cveqe mu ja smeniv saksijata

arum.: Iu arupsi frëndzili **ali** carti bunë.

Iu allëksi vazea **ali** lilici aca mushata.

3. Përfundime

Gjuhët në kontakt në gadishullin e Ballkanit kanë qënë dhe janë burimi i lidhjes gjuhësore ballkanike ose siç njihet ndryshe Sprachbund-it Ballkanik. Në veçanti, gjuha shqipe, gjuha arumune dhe ajo maqedone, duke pasur marrëdhënie të gjata gjuhësore të cilat janë zhvilluar në një areal të përbashkët gjuhësor, krijojnë modelin më të mirë të kësaj lidhjeje gjuhësore.

Shumëgjuhësia në Ballkan zhvillohet në nivel vendor në të gjitha shtetet-kombe ballkanike, megjithëse epiqendra e saj është Maqedonia e Veriut, ku gjedhe të risive ballkanike vijnë të veprojnë edhe sot e kësaj dite. Duke u nisur nga fakti se kushtet që prodhuan lidhjen gjuhësore ballkanike vijnë të ekzistojnë në nivel të rajoneve dhe komuniteteve, arrijmë në përfundimin se jo vetëm historia e lidhjes gjuhësore ballkanike meriton hulumtime të mëtejshme, por edhe e tashmja e saj.

Në literaturën gjuhësore si ballkanizma përgjithësisht mbahen tipare strukturore, elemente të gramatikës, veçanërisht të natyrës morfo-sintaksore, por gjuhët ballkanike tregojnë edhe konvergjenca në tipare fonologjike gjithashtu. Kontaktet e shpeshta gjuhësore mes folësve të gjuhëve të ndryshme në Ballkan kanë sjellë formimin e konvergencave strukturore ku marrin pjesë elemente jo vetëm të klasave të hapura të fjalëve, por edhe elemente të klasave të mbyllura. Kontaktet e ngushta gjuhësore mes shqipes, arumanishtes dhe maqedonishtes na ofrojnë një material të pasur gjuhësor, i cili dëshmon edhe gjurmët e shkëmbimeve gjuhësore përkatëse.

Ngjashmëritë sintaksore që burojnë nga Sprachbundi dhe nga situatat e kontaktit nga natyra priren të jenë sipërfaqësore dhe kanë lidhje me një koncergjencë të strukturës sipërfaqësore më tepër sesa të strukturës së thellë.

Sintagmat emërore me një caktuesor dhe emër të pashquar tregojnë se janë ndërtuar me të njëjtën strukturë në shqipe, arumanishte dhe maqedonishte, si caktuesor në këto sintagma mund të jetë nyja e pashquar dhe përemri dëftor.

Sintagma emërore me caktuesor shqes gjithashtu ka ndërtim të njëjtë në të tre gjuhët, pasi caktuesori shqes shfaqet në të njëjtin pozicion pasemëror: **djal-i**, **vajz-a**; maqed.: grad-**ot**, zena-**ta** (qyteti, gruaja); arum. fîcor-**lu**, cas-**a**, scamnu-**lu** (gj.asnjanëse).

Në sintagmat emërore të shqipes dhe maqedonishtes vihet re një strukturë e përbashkët sintaksore siç është struktura dëftor + emër i shquar: ... **ai** mbreti; **toj**, *târgovec-o* (ky tregtari). Në këto ndërtime, caktuesori dëftor ka rolin e specifikuesit të sintagmës emërore, ndërsa nyja shquese vijon të ketë funksionin e kokës së sintagmës.

Sintagmat mbiemërore shfaqin ndryshime më të mëdha: në strukturë, shqipja dhe arumanishtja e kanë mbiemrin pasemëror, ndërsa maqedonishtja paraemëror; në shqipe mes emrit dhe mbiemrit shfaqet nyja e quajtur “linker-lidhëse”, ndërsa dy gjuhët e tjera mbiemri është i panyjshëm.

Sintagmat parafjalore ndahen në dy grupe: me elemente të ngjashme, si sintagmat me parafjalë të emërores *te.tek/la*; nga/din ë shqipe dhe arumanishte’; sintagma me parafjalën “me gjithë” në shqipe, arumanishte dhe maqedonishte; sintagma me parafjalë të dyfishta etj. Sintagma parafjalore me elemente të ndryshme: lokucionet parafjalore që shqipja ka në rasën gjinore si “me anë të, në

vend të” nuk i kanë dy gjuhët e tjera; parafjala e rasës rrjedhore *prej* nuk e gjen gjegjësen në gjuhën maqedone, në vend të saj përdoren forma mbiemërore për të shprehur lëndën prej nga bëhet një send; parafjalët e vendosura para një emri kundrinor i zhdrejtë në maqedonishte dhe arumanishtje, përkatësisht *na/ ali* nuk kanë gjegjëse në gjuhën shqipe, pasi shqipja nuk ka parafjalë në rasën dhanore.

Bibliografi

- Abney, S. P., *The English Noun Phrase in its Sentential Aspect*, Ph.D. dissertation, Cambridge, MA: MIT Press, 1987.
- Abrashi, T., *Nyja e prapavendosur në gjuhët e Ballkanit, ngjashmëri dhe dallime morfosintaksore*, në “Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit, ASHAK, ASHS, Prishtinë, 2012, ff. 235–266.
- Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe, I*, Tiranë, 2002.
- Akademia e Shkencave, *Gramatika e gjuhës shqipe, II*, Tiranë, 2002.
- Alexiadou, A., Haegeman, L., Stavrou, M., *Noun phrase in the generative perspective*, Mouton de Gruyter, Berlin, 2007.
- Andriotis, N. & Kormoulis, G., *Questions de la linguistique balkanique et l’apport de la langue grecque*, në “Actes du premier congrès international des études balkaniques et sudest européennes”, vol. 6: Linguistique, Izdatelstvo na Bălgarskata akademija na naukite, Sofia, 1966, ff. 21–30.
- Androusoypoulou, A., *Adjectival determiners in Albanian and Greek*, Oxford University Press, 2001.
- Bokshi, B., *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*, ASH, Prishtinë, 2008.
- Campos, H., *Some Notes on Adjectival Articles in Albanian*, *Lingua* 119, 2008, 1009–1034.
- Catasso, N., *Genitive-Dative Syncretism in the Balkan Sprachbund: An Invitation to Discussion*, *Journal of Theoretical Linguistics*, 8, ff. 70–93.
- Chomsky, N. & H. Lasnik, *The principles and parameters theory*, në J. Jacobs, A. von Stechow, W. Sternefeld, & T. Vennemann (Eds.), *Syntax: ein internationales Handbuch zeitgenössischer Forschung*, 506–569, Walter de Gruyter, Berlin, 1992.
- Chomsky, N., *Aspects of the Theory of Syntax*, MIT Press, Cambridge, Massachusetts, 1965.

- Demiraj, Sh., *Gjuhësi ballkanike*, ASH, 2004.
- Demiraj, Sh., *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, 1985.
- Dimitrova-Vulchanova, M., Tomič, O. M., *The Structure of the Bulgarian and Macedonian Nominal Expression: Introduction*, në M. Dimitrova-Vulchanova & O.M. Tomič (eds.) “Investigation in the Bulgarian and Macedonian Nominal Expression”, Tapir Academic Press, Trondheim, 2009, ff. 1–24.
- Freidman, V., Joseph, B., D., *Eastern and Western Romance in the Balkans – the Contrasting but Revealing Position of the Danubian Romance Languages and Judezmo*, në “Journal of Language Contact, 14, 2021, 127-146.),
- Friedman, V., art. *Languages are wealth*, në Proceedings of the Annual Meeting of the Berkeley Linguistics Society, 2012
- Friedman, V., *Macedonian*, SEELRC, 2001.
- Friedman, V., *The Balkan Sprachbund in the Republic of Macedonia today*, Colloquia Humanistica, 2015
- Friedman, V., *The Balkan Languages and Balkan Linguistics*, Annual Review of Anthropology, vol. 40, 2011, 275–291.
- Friedman, V., *The typology of Balkan evidentiality and areal linguistics*, në “Balkan Syntax and Semantics”, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam/Philadelphia, 2004, ff. 101–134.
- Giusti, G., DimitrovaVulchanova, Mila, *Fragments of Balkan Nominal Structure*, Working Papers in Linguistics, vol.8, n.1, 1998; ff. 141–172.
- Giusti, G., *The Categorical Status of Determiners*, në “The New Comparative Syntax”, Longman, 1997, ff. 95–123.
- Giusti, G., *The Functional Structure of Noun Phrases*, në G. Cinque (ed.), “Functional Structure in DP and IP: the Cartography of Syntactic Structures”, Vol. 1, Oxford University Press, 2002, ff. 54–90.
- Giusti, G., *Nominal Syntax at the Interfaces*, University Ca’ Foscari, Venice, Cambridge Scholars Publishing, 2015.
- Haegeman, L., *Introduction to Government and Binding Theory*, Cambridge, Massachus-sets, 1995.

- Haegeman, L., *Introduction: On the Interaction of Theory and Description in Syntax*, në L. Haegeman (ed.) “The New Comparative Syntax”, Longman, London and New York, 1997, ff. 1–32.
- Ismajli, R., *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, ASHAK, Prishtinë, 2015.
- Joseph, B. D., *Is Balkan comparative syntax possible?*, në “Comparative Syntax of Balkan Languages”, Oxford University Press, 2001.
- Lazarou, A. G., *L’Aroumain et ses rapports avec le Grec*, Institute for Balkan Studies, Thessaloniki, 1986
- Longobardi, G., *The Structure of DPs: Some Principles, Parameters and Problems*, in M. Baltin & C. Collins (eds) “The Handbook of Contemporary Syntactic Theory”, Oxford, Blackwell, 2001, ff. 562–603.
- Lunt, H. G., *Grammar of the Macedonian literary language*, Скопје, 1952.
- Manzini, M. R., Savoia, L. M., *Linkers in Aromanian in comparison to Albanian and Romanian*, Università degli studi di Firenze, RGG, 2014, 36, ff. 83–104.
- Memushaj, R., *Gjuhësia gjenerative*, shblu, Tiranë, 2008.
- Mita, J., *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Shpresa, Prishtinë, 2005.
- Sandfeld, K., *Linguistique Balkanique, Problème et résultats*, La Société de Linguistique de Paris, Paris, 1930.
- Sobolev, A. N., *On the areal distribution of syntactic properties in the languages of the Balkans*, në “Balkan Syntax and Semantics”, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam/Philadelphia, 2004, ff. 59–100.
- Tomčić, O. M., *Balkan Sprachbund Morpho-syntactic Features*, Springer, Dordrecht, 2006.
- Tomčić, O.M., *The Balkan Sprachbund properties*, në “Balkan Syntax and Semantics”, John Benjamins Publishing Company, Amsterdam/Philadelphia, 2004
- Turano, G., Rrokaj, Sh., *A proposito del sintagma nominale in Albanese*, Lingua e stile, 2000

DR. URTIS HARRI

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

UNIVERSITETI I TIRANËS

urtis2000@yahoo.com

ÇËSHTJE DHE PROBLEMATIKA TË PAKICAVE TURKE NË BALLKAN

Abstrakt

Për shkak të ngjarjeve historike që janë të njohura nga të gjithë, rezulton se pakicat turke janë ndër pakicat më të përhapura në Ballkan. Ato gjenden kryesisht në rajonet e Greqisë, të Bullgarisë, të Bosnjës, të Maqedonisë dhe të Kosovës. Mbështetur edhe nga shteti turk për gjatë shumë viteve këto pakica që janë në një numër relativisht të madh në këto vende, kanë bërë përpjekje të vazhdueshme të fitojnë të drejta ligjore, të marrin pjesë në vendimmarrje duke hyrë në parlamentet e këtyre shteteve përmes partive të tyre politike, të marrin pjesë në pushtetin vendor, si dhe të sigurojnë mësimin e gjuhës turke në nivele të ndryshme të arsimimit.

Gjendja e pakicave turke në vende të ndryshme të Ballkanit paraqitet e ndryshme. Kjo ka lidhje edhe me politikat që kanë ndjekur këto vende, në përgjithësi, me pakicat kombëtare që gjenden në to.

Minoritetet turke kanë hasur, gjithashtu, edhe plot problematika në vendet e Ballkanit ku ato jetojnë, sidomos në shtetin grek, por në periudha të caktuara edhe në shtetin bullgar e atë maqedonas. Vitet e fundit vihen re zhvillime të reja në politikat e shteteve të Ballkanit ndaj pakicave në përgjithësi e atyre turke në veçanti.

Punimi ynë do bëjë një prezantim të gjerë të përhapjes gjeografike të pakicave turke në Ballkan, të problemeve me të cilat janë përballur këto pakica ndër vite, si dhe do të përpiqet të japë një tablo të qartë të të drejtave të fituara e atyre të munguara të këtyre pakicave në Greqi, në Bullgari, në Bosnjë, në Maqedoni e në Kosovë.

Fjalët kyçe: pakica; pakicat turke; Ballkan; politika; të drejta ligjore; përhapje gjeografike

Hyrje

Për shkak të ngjarjeve historike që janë të njohura nga të gjithë, rezulton se pakicat turke janë ndër pakicat më të përhapura në Ballkan. Ato gjenden kryesisht në rajonet e Greqisë, Bullgarisë, Bosnjës, Maqedonisë, Rumanisë dhe Kosovës. Mbështetur edhe nga shteti turk për gjatë shumë viteve këto pakica që janë në një numër relativisht të madh në këto vende, kanë bërë përpjekje të vazhdueshme të fitojnë të drejta ligjore, të marrin pjesë në vendimmarrje duke hyrë në parlamentet

e këtyre shteteve përmes partive të tyre politike, të marrin pjesë në pushtetin vendor, si dhe të sigurojnë mësimin e gjuhës turke në nivele të ndryshme të arsimimit.

Gjendja e pakicave turke në vende të ndryshme të Ballkanit paraqitet e ndryshme. Kjo ka lidhje edhe me politikat që kanë ndjekur këto vende në përgjithësi me pakicat kombëtare që gjenden në to.

Minoritet turke kanë hasur gjithashtu edhe plot problematika në vendet e Ballkanit ku ato jetojnë, sidomos në shtetin grek, por në periudha të caktuara edhe në shtetin bullgar e atë maqedonas.

Nga ajo që thamë më sipër na rezulton se gjeografia e përhapjes së pakicave turke në vendet e Ballkanit është relativisht e gjerë. Kjo për faktin se ajo nuk gjendet vetëm në shtetin kufitar me Turqinë, pra në Greqi, por pothuajse në të gjitha vendet ballkanike. Kjo e vështirëson prezantimin me detaje në këtë trajtesë, pasi për këtë do të duhej një studim i posaçëm dhe më gjithëpërfshirës. Tri janë të drejtat parësore që kërkon një pakicë:

1. Njohjen zyrtare të saj.
2. Pjesëmarrjen me të drejta të plota në përfaqësimin si në pushtetin vendor, ashtu edhe në atë qendror.
3. Njohjen e të drejtës për t'u shkolluar në gjuhën amë e për ta përdorur atë.

Nga vëzhgimi që kemi bërë na rezulton se gjendja e pakicave turke në shtete të ndryshme të Ballkanit, në lidhje me të drejtat themelore që duhet të ketë një pakicë në një vend tjetër, është një tablo shumëngjyrëshe.

Janë fakt i njohur nga të gjithë përpjekjet e pandërprera të shtetit turk për të kontribuar sa më shumë në lidhje me këtë çështje. Marrëveshjet e shumta, si dhe prioriteti që i jep shteti turk pakicave turke në Ballkan e të drejtave që ato duhet të zotërojnë, në një pjesë të rasteve kanë dhënë rezultate mjaft pozitive. Mund të përmendim këtu në mënyrë të veçantë marrëveshjet e rëndësishme me Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut, marrëveshje këto që kanë bërë të mundur si shkollimin në gjuhën turke, ashtu edhe përfaqësimin me parti politike, që u ka hapur rrugën përfaqësimit në pushtetin vendor-lokal dhe në parlament. Ka pasur raste kur parti politike të pakicës turke në ndonjë vend ballkanik ka hyrë edhe në koalicionë qeverisëse.

Ndikimi turk në Ballkan që prej vitesh po bëhet përmes investimeve në universitete, xhami dhe infrastrukturë. Ankaraja gjithashtu ka ushtruar “pushtet të butë” përmes qendrave kulturore, Agjencisë Turke të Ndihmave dhe mediat e mbështetura nga shteti turk, që transmetojnë programe në gjuhët e rajonit.

Më poshtë po bëjmë një prezantim të shkurtër të gjendjes së pakicave turke, sipas shteteve ballkanike, ku ato gjenden:

1. Pakica turke në Kosovë

Republika e Turqisë ka njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës, më 18 shkurt 2008, duke u renditur ndër vendet e para që ka njohur pavarësinë e Kosovës. Po ashtu, Republika e Turqisë ka ofruar përkrahje për Republikën e Kosovës në platforma ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe. Marrëdhëniet politike në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë kanë hyrë në një epokë të re dhe kanë përjetuar një avancim të dukshëm.

Republika e Kosovës ka inkurajuar vazhdimisht investitorët turq për të investuar në Kosovë. Një theks i veçantë është vënë në kalimin nga faza e tregtisë në atë të investimeve të drejtpërdrejta, sidomos në fushën e prodhimit.

Komuniteti turk në Kosovë është i përqendruar kryesisht në komunate **Prizrenit, Mitrovicës, Gjilanit, Prishtinës e Istogut**, ndërsa sipas llogaritjes së fundit të popullsisë në Kosovë, minoriteti turk në Kosovë përbën 1% të popullsisë.

Gjuha turke, ashtu si edhe gjuha boshnjake e rome në Kosovë, gëzojnë përdorim zyrtar në nivel komunal; përveç komunitetit turk, gjuha turke flitet si gjuhë e parë dhe si gjuhë e dytë edhe nga një numër shqiptarësh.

Turqit e Kosovës kanë partinë e tyre: Kosova Demokratik Türk Partisi, e cila merr pjesë rregullisht në zgjedhjet qendrore dhe lokale. Ata përfaqësohen si në Parlamentin e Kosovës, ashtu edhe në nivel lokal në Bashki e Komuna të ndryshme.

Mësimi i gjuhës turke dhe përdorimi i saj nga anëtarët e komunitetit turk në Kosovë është fakt real dhe i pamohueshëm. Kjo pasi shteti i Kosovës përmes Kushtetutës garanton të drejtat e të gjitha komuniteteve, si pasuri etnike për vendin.

2. Pakica turke në Maqedoninë e Veriut

Maqedonia e Veriut dhe Turqia gëzojnë marrëdhënie të mira miqësore, për arsye të lidhjeve historike dhe kulturore që ato kanë me njëra tjetrën. Republika e Maqedonisë së Veriut që nga pavarësia e saj gjithmonë ka pasur mbështetje të vazhdueshme nga Republika e Turqisë në të gjitha sektorët.

Marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë dhe Turqisë janë në nivel të lartë, se ato janë dy vende miqësore dhe vëllazërore, që nuk kanë konteste politike, kanë nënshkruar partneritet strategjik dhe sërë marrëveshjesh bilaterale, realizojnë bashkëpunim dhe takime të suksesshme në të gjitha nivelet. Janë hapur dhjetë konsullata nderi të Republikës së Maqedonisë së Veriut në mbarë Turqinë dhe dy konsullata turke në Manastir dhe Ohër.

Rëndësi të madhe për turqit ka dhe komuniteti turk në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili ka ruajtur tiparet e saj dhe ka marrë në vazhdimësi përkrahje të madhe si nga Maqedonia e Veriut ashtu edhe nga Turqia.

Pakica turke në Maqedoninë e Veriut zë 3.85% të popullsisë së vendit.

Mund të thuhet se në këtë shtet pakicat turke gëzojnë të drejta të plota. Kështu pakica turke në Maqedoninë e Veriut ka përfaqësimin e vet politik në parlament dhe në nivel lokal, shpesh merr pjese në bashkëqeverisje përmes koalicioneve politike, si dhe gëzon të drejtën e shkollimit në gjuhën amtare turke.

Nga ana tjetër pakica turke në Maqedoninë e Veriut ka arritur të ketë edhe festën zyrtare të gjuhës turke, 21 dhjetorin, që njihet dhe festohet si dita e gjuhës turke.

Në Maqedoninë e Veriut janë ngritur mjaft fondacione dhe institucione zyrtare turke, që synojnë gjithmonë të ndihmojnë pakicën turke atje. Tri janë partitë e pakicës turke në këtë shtet:

- Partia Demokratike Turke
- Partia e Lëvizjes së Turqve
- Lëvizja e Unitetit Kombëtar Turk

3. Pakica turke në Bullgari

Një statistikë e disa viteve me parë, në vitin 2011, tregon se në Bullgari jetojnë rreth 588.318 turq, përafërsisht 8.8% e popullsisë. Shumica e tyre ndodhen në zonën e Karzhdali të Bullgarisë.

Kohë më parë diktatori komunist bullgar Todor Zhivkov udhëhoqi fushatat e asimilimit të detyrueshëm dhe spastrimit etnik ndaj pakicave jobullgare,

veçanërisht të turqve dhe myslimanëve të tjerë. Në verën e vitit 1989, midis 22 dhe 30 gushtit, Bullgaria komuniste, e udhëhequr nga diktatori i tre dekadave e gjysmë, Todor Zhivkov, dëboi në mënyrë të njëanshme 360 000 shtetas në Turqinë fqinje. Të dëbuarit i përkisnin pakicës turke të këtij vendi që llogaritej më shumë se një milion, e të cilët zyrtarisht u deklaruan joekzistent në vitin 1985.

Bullgaria u paraqit si një shtet komb tërësisht homogjen, pa asnjë minoritet jobullgar. Etnologjia “turq” u ndalua nga shtypi ose ndonjë përdorim zyrtar.

Tani marrëdhëniet Bullgari-Turqi, nuk janë si vitet e lëna pas. Turqia dhe Bullgaria janë dy vende mike dhe aleate. Me Bullgarinë duke përqafuar demokracinë dhe marrëdhëniet me ekonominë e tregut të lirë janë zhvilluar vizitat e nivelit të lartë midis dy vendeve, të cilat gjithashtu janë rritur. Turqia ka mbështetur integrimin e Bullgarisë në strukturat euroatlantike.

Për këtë arsye edhe gjendja e pjesës së mbetur të pakicës turke atje nuk paraqitet më si më parë. Sipas regjistrimit të popullsisë së atjeshme 8,8% e popullsisë është pakicë turke. Në zonat në kufi me Turqinë, atje ku gjendet pakica turke lejohet mësimi në gjuhën turke, megjithëse nuk rezulton të jetë gjuhë e parë. Përfaqësimi politik i pakicës turke atje është mjaft i dobët e gati inekzistent.

4. Pakica turke në Greqi

Pakicat turke që jetojnë në Greqi, në dallim nga ato të vendeve të sipërpërmendura hasin plot problematika sidomos në shtetin Grek.

Këta turq vuajnë një shumëllojshmëri shkeljesh të të drejtave të njeriut në këtë shtet. Shteti grek, për shkak të marrëdhënieve historike në vijimësi, marrëdhënie që vazhdojnë të jenë mjaft të tensionuara me Turqinë, nuk ka qenë në gjendje të pranojë faktin se këta mund të jenë qytetarë besnik të Greqisë. Ata shihen nga shteti grek gjithmonë me dyshim, forca e të cilit pasqyron edhe marrëdhënien greko-turke. Greqia pranon vetëm ekzistencën e një pakice “myslimane” në Thrakë dhe ndjek në mënyrë agresive organizatat dhe individët që kërkojnë ta quajnë veten “turq”. Shkeljet e të drejtave të njeriut e të pakicave në tërësi, në fushën e arsimit kanë prekur numrin më të madh të këtij minoriteti turk. Qeveria Greke ka bërë më së shumti një nxitje për moszhvillimin relativ të pakicës turke atje. Shkollat janë të mbipopulluar dhe të financuara dobët, në krahasim me ato që ndiqen nga Greqet etnikë. Zyrtarët greke tërhiqen nga Traktati i Lozanes, i cili i detyron ata të sigurojnë arsimin fillor në gjuhën turke

për pakicën turke atje, duke injoruar faktin se ligji grek urdhëron një arsim minimalisht nëntë-vjecar.

Kjo është një ndër problematikat e shumta, që prek minoritetin turk që jeton në Greqi, duke marrë parasysh se e drejta e arsimimit është një ndër të drejtat themelore dhe e domosdoshme për këdo, pa dallim race apo feje.

Greqia dhe qeveria greke kanë shkelur Traktatin e Lozanës të vitit 1923 dhe shumë marrëveshje të tjera shumëpalëshe. Greqia shkel me këmbëngulje të drejtat e minoritetit turk në Trakinë Perëndimore.

Kështu ajo vazhdon të mbyllë shkollat e pakicave në Trakinë Perëndimore. Ulja e numrit të shkollave të pakicave në Trakinë Perëndimore nga 231 në 115, gjatë 25 viteve të fundit, përbën shembullin më konkret të ndryshimit midis qëndrimeve të të dy vendeve ndaj pakicave.

Greqia është i vetmi vend ballkanas që shkel haptazi të drejtat themelore të minoritetit turk në Ballkan. Ai mohon dhe shkel të drejtat themelore të njeriut, duke mbyllur shkolla e duke ndaluar arsimimin e këtij minoriteti në gjuhën e vet amtare.

Përgjatë viteve të fundit është vënë re një tendence në rritje e shtetasve turq të cilët “po pushtojnë” sërish Ballkanin. Një statistikë e viteve të fundit tregon se, veç pakicave turke të së kaluarës, sot numërohen edhe rreth 750.000 deri në 1 milion turq, që jetojnë në Ballkan.

Ata po shpërngulen nga vendi i tyre drejt Ballkanit me synimin për të gjetur një jetë akoma më të mirë. Sigurisht që edhe ekzistenca e pakicave turke gati në çdo vend të Ballkanit e stimulon një lëvizje të tillë, sidomos në vendet ku ata kanë fituar një pjesë të mirë të të drejtave që u takojnë. Kjo tendence është vënë re akoma më shumë pas vitit 2016.

SEANCA III

**VARIETETET GJUHËSORE, GJUHA NË PËRDORIM DHE
PROBLEME TË EDUKIMIT**

PROF. AS. DR. ROZANA RUSHITI

**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI I TIRANËS**

rozana.rushiti@unitir.edu.al

DR. ILIRJANA NANO

**FAKULTETI I DREJTËSISË
UNIVERSITETI I TIRANËS**

ilirjananano@yahoo.com

E DREJTA E PËRDORIMIT TË GJUHËS DHE POLITIKAT ARSIMORE MBI PAKICAT NË SHQIPËRI

Abstrakt

Përdorimi i gjuhës nga pakicat dhe njohja e së drejtës për arsim janë ndër çështjet më të debatueshme gjatë diskutimeve që zhvillohen në kuadër të integrimit në BE. Të drejtat e personave që u përkasin pakicave janë pjesë integrale e të drejtave themelore të njeriut, pjesë e rëndësishme e vlerave të Bashkimit Evropian, ndaj dhe përbëjnë një element thelbësor në procesin e zgjerimit të BE-së. Në vitet e fundit Shqipëria ka bërë progres për afirmimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave. Nëpërmjet ligjit për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe akteve nënligjore, të hartuara në zbatim të tij, janë adresuar disa problematika të rëndësishme, megjithatë situata mbi përdorimin e gjuhëve nga pakicat dhe njohja e të drejtave të tyre për arsim mbeten jo në nivelin e duhur. Ky punim synon të paraqesë situatën aktuale, problematikat e shfaqura, si dhe politikat që duhen ndërmarrë për të siguruar zbatimin e të drejtave të pakicave realisht dhe jo vetëm parashikimin e tyre në ligj.

Fjalët kyçe: pakicë; gjuhë; e drejta e përdorimit të gjuhës; arsim; politika; shkollë; ligj

1. Kuadri kushtetues shqiptar lidhur me të drejtat e pakicave kombëtare

Çështja e njohjes së pakicave kombëtare dhe garantimi i të drejtave të tyre është një problematikë sa historike aq edhe aktuale. Pothuajse në të gjitha kushtetutat e shtetit shqiptar pas luftës së dytë botërore është parashikuar parimi i mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare që jetojnë në Shqipëri. Në kushtetutat (statutet) e mëhershme ky parim nuk ishte i parashikuar.

Në Statutin e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946, në artikullin (nenin) 35 parashikohet: *Pakicat nacionale kanë në Republikën Popullore të Shqipërisë të gjitha të drejtat, mprojtjen e zhvillimit kultural të tyre dhe përdorjen e lirë të gjuhës së tyre.*¹

Në Kushtetutën e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1950, në nenin 39 të saj kemi të njëjtin parashikim si më sipër.²

Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1976 duket që i kushton një vëmendje më të madhe njohjes dhe garantimit të të drejtave të pakicave. Së pari, shihet një zgjerim i kuptimit për të drejtat e pakicave. Nga ana tjetër, shihet që neni përkatës për të drejtat e pakicave kombëtare nuk është më deklarativ, por parashikon edhe sanksion në rast shkeljeje të tij. Konkretisht, në nenin 42 të saj parashikohet, si më poshtë: *Pakicave kombëtare u sigurohet mbrojtja e zhvillimi i kulturës dhe i traditave popullore, përdorimi i gjuhës amtare dhe mësimi i saj në shkollë, zhvillimi i barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Çdo privilegj a pabarazi kombëtare dhe çdo veprim që shkel të drejtat e pakicave kombëtare është antikushtetues dhe dënohet sipas ligjit.*³

Periudha postkomuniste, përveç zhvillimeve të vrullshme politike dhe ekonomike, shoqërohet edhe me zhvillime në fushën e të drejtave të njeriut në përgjithësi, por edhe të personave që u përkasin pakicave kombëtare në veçanti. Pa u ndalur gjatë në këtë pjesë hyrëse të punimit, po paraqesim, shkurtimisht, parashikimet kushtetuese të kësaj periudhe.

Në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” riafirmohet në dispozitat kryesore njohja dhe garantimi i të drejtave të pakicave kombëtare. Ndryshim thelbësor tashmë është njohja dhe garantimi i tyre në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Në nenin 4 të dispozitave kryesore kushtetuese parashikohet: *Republika e Shqipërisë njuh dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të pakicave kombëtare, të pranuar në dokumentet ndërkombëtare.*⁴

¹ Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë i vitit 1946.

² Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë e vitit 1950.

³ Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1976.

⁴ Ligji nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë të vitit 1998, kushtetuta që është sot në fuqi e ngre në një nivel më të lartë, të papranuar më herët çështjen e pakicave kombëtare. *Bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat që shteti ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë, renditen bashkë me pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësinë shoqërore, rendin kushtetues, pluralizmin, identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kombëtare e bashkëjetesën fetare si baza të shtetit shqiptar* (neni 3 i Kushtetutës).⁵

Gjithashtu të drejtat e pakicave renditen në kreun e të drejtave dhe të lirive kryesore, duke zgjeruar tashmë jo vetëm të drejtat, por edhe garancitë për mbrojtjen e tyre.

Në nenin 20 të Kushtetutës parashikohet: *Personat që u përkasin pakicave kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë para ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. Ata kanë të drejtë të shprehin lirisht, pa u ndaluar as detyruar, përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ata kanë të drejtë t'i ruajnë e zhvillojnë ato, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe të identitetit të tyre.*⁶

Një kapitull i ri në fushën e njohjes, të garantimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare është ai i nënshkrimit dhe ratifikimit të akteve ndërkombëtare në këtë fushë, ku më i rëndësishmi është Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve që është nënshkruar nga Republika e Shqipërisë më 29.06.1995, ratifikuar me ligjin nr. 8496, datë 3.6.1999 “Për ratifikimin e “Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve””. Pavarësisht se me ratifikimin e saj, Konventa Kuadër është pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar, ajo hyn në kategorinë e atyre instrumenteve ndërkombëtare, për zbatimin e të cilave nevojitet hartimi dhe miratimi i një ligji vendas, ndaj në këtë kuadër, hapi më i rëndësishëm legjislativ ishte miratimi i ligjit nr. 96, datë 2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", miratuar nga Kuvendi në muajin tetor 2017, hyrë në fuqi në muajin nëntor 2017.

⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998.

⁶ Po aty.

Ky ligj, i hartuar për herë të parë në Shqipëri, është bazuar në Konventën Kuadër, angazhimet në kuadrin e procesit të integritimit evropian të vendit, ekspertizën e organizatave ndërkombëtare, praktikat e mira evropiane, nevojat dhe veçoritë e vendit, si dhe zhvillimin e një procesi gjithëpërfshirës të konsultimit me shoqatat e pakicave kombëtare.⁷

2. Kuadri ligjor në vendet e Ballkanit Perëndimor për pakicat kombëtare

Vështrim i përgjithshëm

Kornizat ligjore për mbrojtjen e pakicave janë të pranishme në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Megjithëse Shqipëria renditet ndër vendet e para të Ballkanit Perëndimor, bashkë me Maqedoninë e Veriut si shtet anëtar i Konventës kuadër (1999), por ndër më të vonuarat për sa i përket miratimit të ligjit për pakicat kombëtare në vitin 2017, i ndjekur nga Kosova në 2011 (Ligji “Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre”); nga Maqedonia e Veriut në vitin 2008 (ligji “Për promovimin dhe mbrojtjen e anëtarëve të komuniteteve më pak se 20%”); nga Mali i Zi në vitin 2006 (ligji “Për të drejtat dhe liritë e minoriteteve”); nga Bosnja Hercegovina ku ligji “Për të drejtat e pakicave kombëtare” u miratua në 2003 dhe nga Serbia në vitin 2002 me ligjin “Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të pakicave kombëtare”. Kosova ka legjisllacionin më miqësor në lidhje me përdorimin zyrtar të gjuhëve të pakicave, ndërsa disa shtete janë më të ngurta lidhur me të drejtat arsimore dhe gjuhësore, si Bosnja Hercegovina dhe Mali i Zi. Shqipëria, nga ana tjetër, nuk ka nënshkruar ende Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare. Siç shihet nga dokumentet⁸, në vitin 2019, përfaqësues të Shqipërisë dhe të Këshillit të Evropës janë në bashkëbisedime për të identifikuar dispozitat që Shqipëria mund ta nënshkruajë dhe ta ratifikojë këtë kartë. Raport-progreset e fundit të BE-së tregojnë se vendet e Ballkanit Perëndimor i kanë krijuar kornizat ligjore për mbrojtje të pakicave kombëtare/minoritete, por nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre në zbatim e praktikë, prandaj ende nuk mund pranohet ekzistenca e një sistemi mbrojtës i

⁷ <https://rm.coe.int/5th-sr-albania-al/1680a2614d>, f. 6.

⁸ www.eupolicyhub.eu, f.9.

institucionalizuar për pakicat kombëtare në rajon apo zbatim standardesh në mënyrë efektive.

Kuadri ligjor për pakicat kombëtare në Shqipëri parashikon përkufizimin e pakicës kombëtare duke eliminuar diferencimin e dy kategorive të pakicave (pakicave kombëtare dhe pakica etnike-gjuhësore) dhe njohjen formale të nëntë pakicave: greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare; bën të mundur marrjen e masave konkrete për të mbrojtur të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare, si: e drejta për të shprehur lirisht përkatësinë e tyre, për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre, elemente të veçanta që karakterizojnë jetën e komunitetit të tyre, mësimin e gjuhës amtare, veprimtarinë kulturore, ushtrimin e kultit fetar etj.

3. E drejta e përdorimit të gjuhës nga personat që u përkasin pakicave kombëtare sipas legjislacionit shqiptar

Ndër të drejtat e pakicave që garantohen nga ligji nr. 97/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” është edhe *e drejta e përdorimit të gjuhës* (neni 15 i ligjit). Kjo e drejtë trajtohet në disa aspekte dhe përfshin përdorimin e gjuhës së pakicës së cilës i përket personi krahas gjuhës shqipe në disa veprimtari individuale dhe kolektive në kuadër të komunitetit. Me sa vihet re nga situata në praktikë, ky nen i ligjit që lidhet me përdorimin e gjuhës nga ana e pakicave dhe të personave që u përkasin atyre, zbatohet pjesërisht. Detyrimi që parashikon ligji për hartimin e akteve nënligjore, përkatësisht në zbatim të pikës 2 dhe 3 të këtij neni, nuk është përmbushur deri tani.

Cilat janë këto aspekte të përdorimit të gjuhës në kuptim të këtij neni?

Së pari, kemi të drejtën që ligji u njeh personave që u përkasin pakicave të përdorin gjuhën e tyre në marrëdhënie me organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore, aty ku banojnë tradicionalisht pakica në masën mbi 20% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së asaj njësie.

Së dyti, kemi detyrimin e njësisë të vetëqeverisjes vendore, ku të paktën 20% e popullsisë i përket një pakice, që, me kërkesë të mjaftueshme të tyre, të vendosen edhe emërtimet e njësisë administrative, të rrugëve dhe të treguesve të tjerë topografikë, krahas gjuhës shqipe, edhe në gjuhën e pakicës.

Lidhur me realizimin praktik të këtyre të drejtave të përmendura më sipër, është në proces hartimi dhe konsultimi i një projekvendimi të Këshillit të

Ministrave. (VKM-ja “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”). Referuar Raportit të Pestë të qeverisë shqiptare,⁹ projektvendimi do të garantojë të drejtën e tyre ligjore për të përdorur gjuhën e pakicës që i përkasin dhe krijimin e mundësive për ruajtjen e gjuhës, duke marrë parasysh situatën vendore; të përdorin zyrtarisht gjuhën e tyre në aspekte të ndryshme në ato njësi të vetëqeverisjes vendore, në të cilat personat që i përkasin një pakice kombëtare banojnë tradicionalisht ose përbëjnë mbi 20 % të numrit të përgjithshëm të popullsisë së tyre, në bazë të një kërkesë dhe kur ajo i përgjigjet një nevoje reale dhe objektive.

Projektvendimi do të parashikojë konkretisht mënyrën sesi do të realizohet përdorimi i gjuhës së pakicës kombëtare (komunikimi në gjuhën e pakicave kombëtare), konkretisht: gjatë procesit të informimit mbi të drejtat e tyre, duke hartuar për këtë qëllim rregullore apo nëpërmjet fletëve informuese, të cilat mund të publikohen apo të afishohen në ambiente të dukshme të organeve të vetëqeverisjes vendore. Për të siguruar përdorimin në gjuhën e pakicës kombëtare, në rastet e specifikuara të parashikuara në të, organet përgjegjëse të njësisë të vetëqeverisjes vendore do të krijojnë kushtet për përdorimin e gjuhës së pakicës në marrëdhëniet ndërmjet tyre; do të parashikojnë në buxhetin vjetor të tyre, për aq sa është e mundur, zë të veçantë për punësimin e personave që njohin gjuhën e pakicës kombëtare.

Duket se një e drejtë e personave që u përkasin pakicave, që lidhet me *marrjen e informacionit për procesin zgjedhor edhe në gjuhën e pakicës, krahas gjuhës shqipe* është tashmë një e drejtë e mbrojtur, e garantuar dhe e realizuar në praktikë.

Le të marrim në analizë zgjedhjet e fundit parlamentare, ato të 25 prillit 2021. Në procesin që i parapriu zgjedhjeve, KQZ-ja miratoi dhe zbatoi një program të detajuar për informimin, edukimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve.

Në zbatim të detyrimeve që burojnë nga ligji “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të gjitha materialet informuese janë

⁹ Raporti V, paraqitur nga Republika e Shqipërisë, mbështetur në nenin 25, paragrafi 2, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare.

përkthyer edhe në gjuhën e pakicave kombëtare, përkatësisht në 8 gjuhë nga 9 pakica kombëtare, të njohura në Shqipëri. (pakica rome dhe egjiptiane përdorin një gjuhë). Materialet informuese, edukuese dhe sensibilizuese që u përdorën për zgjedhësit, në funksion të rritjes së pjesëmarrjes në zgjedhje ishin: billboard, city lights, postera, bus station etj. Të gjitha këto materiale u përkthyen dhe u përdorën në zona në të cilat jetojnë persona që u përkasin pakicave kombëtare, përkatësisht në gjuhën/gjuhët sipas përkatësisë së pakicave. Spotet e prodhuara për televizione u realizuan me titra në gjuhët e pakicave.

ΕΚΛΟΓΙΚΑ ΑΔΙΚΗΜΑΤΑ

Η Ελληνική Εκλογική Επιτροπή και τα όργανα επιβολής του νόμου θα παρακολουθούν βίαια τον χώρο κάθε εκλογικού χώρου διασφαλίζοντας τις εκλογές.

ΠΡΟΣΟΧΗ, ΑΠΟΤΕΛΕΙ ΠΟΙΝΙΚΟ ΑΔΙΚΗΜΑ!

- Η ψήφηση και η εγγραφή της ψήφου τιμωρείται με φυλάκιση από 1 έως 5 έτη.
- Η φωτογράφιση της ψήφου και η προβολή της σε άλλους τιμωρείται με φυλάκιση από 3 μήνες έως 3 έτη.
- Η πολλαπλή ψήφος, ή ψήφος και επανάληψη τιμωρείται με φυλάκιση από 1 έως 3 έτη.
- Κάθε ενέργεια που παραβιάζει τις εκλογές, όπως ψήφοφορία χωρίς ηλεκτρονική ενσημάτωση, απεικόνιση, παραποίηση ή καταστρέφει του εκλογικού χώρου, τιμωρείται με φυλάκιση από 3 μήνες έως 7 έτη.

Εάν παρατηρήσετε παραβίαση του νόμου, αναφέρετε τη **ΑΜΕΣΩΣ** στα όργανα επιβολής του νόμου.

ΕΝΗΜΕΡΩΣΤΕΙΤΕ μέσω:

ΚΩΖ, App Store, Google play, Facebook, Instagram, Twitter, YouTube, LinkedIn, Messenger, WhatsApp, Telegram, Email, SMS.

Στις 25 Απριλίου 2021
Σε γλώσσες βουλγαρικής εκλογής στην Αλβανία.

ΕΞΕΛΞΕ, ΨΗΦΙΣΕ, ΑΠΟΦΑΣΙΣΤΕ!

ИЗБОРЕН КРИМИНАЛ

Централната изборна комисија и телата за спроведување на законот ќе го казват со сила на законот сèкој делател што ги загрозува изборите.

ВНИМАНИЕ, ПРЕТСТАВУВА КРИВИЧНО ДЕЛО!

- Продажбата и купувањето на гласови се казнува со затвор од 1 до 5 години.
- Спирањето на гласот и покажувањето на други се казнува со затвор од 3 месеци до 3 години.
- Семејното гласање, или гласањето повеќе од еднаш се казнува со затвор од 1 до 3 години.
- Секое дејствие што ги нарушува изборите, како што се: гласањето без електронска идентификација, закана, фалсификување или оштетување на изборниот материјал, се казнува со затвор од 3 месеци до 7 години.

Дополу забележете прекршување на законот, **ВЕДНАШ** пријавете при телата за спроведување на законот.

ИНФОРМИРАЈТЕ СЕ преку:

ΚΩΖ, App Store, Google play, Facebook, Instagram, Twitter, YouTube, LinkedIn, Messenger, WhatsApp, Telegram, Email, SMS.

На 25 април 2021 година
се гласа за пратеници на Собранието на Албанија.

ИЗБЕРИ, ГЛАСАЈ, ОДЛУЧИ!

ΠΡΟΒΕΡΙ
СПΙΣΥΚΑ НА ГЛАСУΒΑЩИТЕ.

Ако вашето име не е в списыка на избирателите или ако вашите данни не са точни, обрнете се към **ОФИСА ЗА ГРАЖДАНСКО СЪСТОЯНИЕ** на административната единица, в която живеете.

ΠΡΟΒΕΡΙ
ΔΟΚΥΜΕΝΤΑ ЗА САΜΟΛΙΧΝΟΣΤ.

Κανδιδатаσταιте **ΒΕΔΝΑΓΑ**, за подновяване на документа за самоличност, ако не е валиден.

Ако не сте в избирателен списык и ако нямате един валиден документ за самоличност, не можете да гласувате.

ИНФОРМИРАЙТЕ чрез:

ΚΩΖ, App Store, Google play, www.kqz.gov.al

На 25 април 2021 г.
се гласува за депутати в албански парламент.

ИЗБЕРИ, ГЛАСУВАЙ, РЕШИ!

BĂGATS OARĂ
LISTA A ALEGĂTORLOR.

Аноч нума а та ну а афишу ту lista а алегăторлор. I аноч дăтил а воасту ну сăнту сăли, нăдретăсă вѐ **UFITSIU ALI STĂTURII TSIUVILĂ** аи уни административа ту бăнедз.

DIALITHINĂ (VERIFICĂ)
DOCUMENTU TI IDENTITATI.

Аplică **CUNOARĂ** ti sananoveza (finovnera) а documentu ti identificari аноч афу ну еасті валѐбу.

Аноч ну ешти ту lista а алегăторлор ши аноч ну аи уни document валѐбу ti identificari, тини ну готѐ та а вѐтешт.

ИНФОРМАТИ чрез:

ΚΩΖ, App Store, Google play, www.kqz.gov.al

Pl 25 di Aprilu 2021
аи цотешти ту deputati ту Parlamentu аи Arbănishi.

ALEAGĂ, VOTĂ, APOFĂSIĂ!

<p>DIKH I LISTA ALOSARIPENGE.</p> <p>Se tro anav na arakadhio! andi lista alosaripenge, ja se tumare detajja andi lista nanaj lukar, 3an andi VIRAMU TO STATUSI CIVILO andi administrata kaj 3yven.</p>	<p>PROVIJERI NA LISTU GLASAÇA</p> <p>Ako tvoj ime nije na listu glasača ili vaše podatke u listu nisu tačne idi u URED CIVILNOG STANA kantona gdje vi živite.</p>	<p>PROVERITE BIRAČKI SPISAK.</p> <p>Aka se Vaše ime ne nalazi na birračkom spisku ili ako su Vaši podaci na spisku metačni, kontaktirajte KANCELARIJU MATIČNE SLUŽBE administrativne jedinice u kojoj živite.</p>
<p>KER VERIFIKIMI DOKUMENTI IDENTIFIKIMI.</p> <p>Ker aplikimi JEKHFORASTE, vaš rinovimi to dokumenti identifikimi nesave ov nanaj moluk.</p>	<p>PROVIJERI SREDSTVU IDENTIFIKACIJE.</p> <p>Prijavite ODMAH, za renoviranje vašeg sredstva identifikacije ako nije više vrijedan.</p>	<p>PROVERITE IDENTIFIKACIONI DOKUMENT.</p> <p>ODMAH se prijavite za obnavljanje identifikacionog dokumenta ako on nije važeći.</p>
<p>Nesave na ishan andi lista alosaripenge thaj nanaj tut jekh dokument moluk, tu nasti te votone.</p>	<p>NAKO nisi na listu glasača i ako nemas vrijednog sredstva identifikacije, ne možeš glasati.</p>	<p>Ako niste na birračkom spisku i ako nemate važeću ličnu kartu, ne možete da glasate.</p>
<p>LE INFORMIRAJ SE preko</p>  <p>www.kqz.gov.al</p>	<p>INFORMIRAJ SE kroz</p>  <p>www.kqz.gov.al</p>	<p>INFORMIŠTE SE preko</p>  <p>www.kqz.gov.al</p>
<p>Ando 25 Gastronaj 2021 ovël votimi vaš deputenge ando Aaانبli Albanisko.</p> <p>ALOSAR, VOTONE, DE DECIZIA!</p>	<p>25. Aprila 2021. god. se održavaju izbori za članove Parlamenta Albanije.</p> <p>BIRAJ, GLASAJ, ODLUČI!</p>	<p>25. aprila 2021. Glasace se za poslanike Parlamenta Albanije.</p> <p>IZABERITE, GLASAJTE, ODLUČITE!</p>

<p>Aidzeritë të Parlamentit të Arbinshijë 2021 CUM S'VOTESHT ?</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Prezantësi tu këntro ti votari cu pasaportë i tu cartea di identiteti. 2. Spuri cartea di identiteti epimet di Comisiona ai Këntro ti Votari. 3. Identifikativë entru di identifikimë electronicë cu documentu di identitëti shi ana hëni, kumëncimë, albënkëu sëmna i dëzëdritë. 4. Ua frëndza di votari shi sigurisemë cana la s'frëndzë vëlutëti cu s'frëndzë vëlutëti. 5. Ua frëndza di votari shi durti singlar tu camera accountë. 6. Sëmëncimë cu sëmna tu spuri limpëdu albëzëra a tzu gëatë ti unu di sulagëti atëptati shi gëatë ti unu di candidantëti a tzu. 7. Dhëpëruvëna frëndza di votari tu camera accountë cana albëzëra. Unu di vëpëti shi ti ma përtëna, unu di vullëti s'frëndzë vëlutëti. 8. Anuacë frëndza di votari tu çuarta di votari shi dëpërtëti di Këntro ti Votari. <p>www.kqz.gov.al</p>	<p>Избори за Парламента на Албанија 2021 КАК ДА ГЛАСУВАШ?</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Представи се и изборителната секција с паспорт или лична карта. 2. Покажете вашата лична карта или паспорт пред комисијата и изборната секција. 3. Идентифицирајте се преку електронски услуги или со идентификацион с документ за совладеност и след тоа се подпишете, оставивши претовот отпечаток. 4. Вземете бюлетената и се уверете, че тие е поддржаната с 2 ленаца. 5. Вземете бюлетената и отидете сами в тайната стая. 6. Маркирајте със знак, којшто јавно покажува изборот ви само за едни от изборителните субјекти и само за едни от неговите кандидати. 7. Ставнете бюлетената в тайната стая, така че изборите да не се видијат и помне едни от печатите да се видија. 8. Пуснете бюлетената в урната и напуштете изборителната секција. <p>www.kqz.gov.al</p>
---	---

Një e drejtë tjetër, e afirmuar në ligj, është edhe e drejta për t’u informuar në gjuhën që kupton për arsyet e arrestimit, për natyrën dhe shkakun e çdo akuze kundër tij si dhe për t’u mbrojtur në këtë gjuhë, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

Nëse i referohemi formulimit të kësaj pike në raport me pikat e mësipërme, vërejmë një ndryshim. Më sipër, parashikohej, shprehimisht, përdorimi i gjuhës së pakicës dhe në disa raste përdorimi i saj krahas gjuhës shqipe. Në këtë

dispozitë, parashikohet e drejta e informimit dhe e drejta për t'u mbrojtur në gjuhën që kupton.

Pse ky ndryshim?

Le të shkojmë të Kodi i Procedurës Penale, sipas referimit të ligjit tëpacticave. Në nenin 8 të KPP-së përcaktohet përdorimi i gjuhës shqipe në të gjithafazat e procedimit penal. Në një kuptim fazat e procedimit penal janë hetimi, gjykimi dhe ekzekutimi i vendimeve. Nga ana tjetër, procedimi është tërësi veprimesh të cilat duhet të dokumentohen në mënyrë shkresore, të shkruar. Pra, parimi i përdorimit të gjuhës shqipe në këtë rast ka të bëjë me gjuhën e shkruar, pasi nëpërmjet shkrimit dokumentohet çdo veprim në kuadër të një procedimi penal.

Por, KPP-ja përcakton edhe disa përjashtime, për shkak se personat që marrin pjesë në një procedim penal, në cilëndo cilësi, mund të mos e kuptojnë gjuhën shqipe. Në vlerësimin tonë këtu bëjnë pjesë si shtetasit shqiptarë, pjesëtarë të një pakice kombëtare, ashtu edhe shtetasit e huaj. Kodi ka një parashikim përgjithësues, pa bërë ndarjen në kategori si më sipër. Ai parashikon: *Personat që nuk dinë shqip, përdorin gjuhën e tyre dhe, me anën e përkthyesit, kanë të drejtë të flasin e të marrin dijeni për provat e aktet, si dhe për zhvillimin e procedimit.*

¹⁰ Madje KPP-ja parashikon edhe të drejtën e personave që nuk dëgjojnë dhe nuk flasin të përdorin gjuhën e shenjave.

Rregulli i përgjithshëm është ai i përmbushjes së veprimeve përgjatë të gjithë procedimit në gjuhën shqipe të folur e të shkruar, rregull i cili pranon shmangie kur është fjala për personat që nuk dinë shqip, të cilët mund të jenë në procedimin penal si subjekte, palë apo figura procedurale. Këta persona lejohen të përdorin gjuhën e tyre dhe me anë të përkthyesit, sipas rastit dhe cilësisë përkatëse që kanë në procedim, mund të marrin dijeni për provat, veprimet dhe zhvillimin e procedimit.¹¹

Veç sa më sipër, ajo që ka rëndësi të theksohet është fakti se shpenzimet për përkthyesin përballohen nga shteti dhe ky detyrim përcaktohet edhe në vendimin përfundimtar të gjykatës.

¹⁰ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

¹¹ Lara.D., *Koment mbi procedurën penale*. Botimet Morava, Tiranë 2019, faqe 115.

4. E drejta për arsim e personave që u përkasin pakicave kombëtare

Përdorimi i gjuhës nga pakicat kombëtare dhe njohja e së drejtës për arsim janë ndër çështjet më të debatueshme gjatë diskutimeve që zhvillohen në kuadër të integritimit në BE.

Legjislacioni shqiptar njeh të drejtën e pakicave kombëtare për të mësuar gjuhën e tyre përmes funksionimit të shkollave dhe të klasave ku mësohet gjuha amtare, historia dhe kultura e vendit të origjinës. Ligji nr 97/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, neni 13 “E drejta e arsimit në gjuhën e pakicës kombëtare”, konkretisht, pikat 1 dhe 2 parashikojnë: *1. Personat, që i përkasin një pakice kombëtare, gëzojnë të drejtën të mësojnë gjuhën e pakicës. 2. Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ato banojnë tradicionalisht ose në numër thelbësor, nëse ka kërkesë të mjaftueshme, u sigurohen mundësi për të mësuar ose për të marrë mësim në gjuhën e pakicës kombëtare, në përputhje me legjislacionin përkatës në fushën e arsimit.*¹²

Para miratimit të ligjit për mbrojtjen e minoriteteve, funksionimi i shkollave dhe i klasave me mësimdhënie në gjuhët e pakicave lejohej vetëm në ish-zonat minoritare. Kjo praktikë me daljen e ligjit ndryshoi dhe krijimi i shkollave me mësimdhënie në gjuhët e pakicave u lejua në “njësitë e vetëqeverisjes lokale ku pakicat jetojnë tradicionalisht ose në një numër të konsiderueshëm”.

Siç është evidentuar, për garantimin e kësaj të drejte, në vitet 2018-2020 janë miratuar 4 akte nënligjore¹³ për hapjen dhe funksionimin e klasave për mësimin

¹² Ligji nr 97/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”

¹³ VKM nr. 561, datë 29.9.2018 “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”;

VKM nr. 562, datë 29.9.2018, “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”

VKM nr. 227, datë 17.4.2019 “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve publike parauniversitare ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”

VKM nr.1155, datë 24.12.2020 “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të numrit thelbësor dhe të kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”.

e tyre, për përgatitjen, shtypjen, botimin, shpërndarjen falas dhe pajisjen me tekste shkollore të arsimit bazë; për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, të historisë, të gjuhës dhe të besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë.

Nismën për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare e ndërmerr njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, njësia arsimore vendore përkatëse dhe komuniteti i zonës ku pritet të hapen klasa të pakicave kombëtare, të propozuara me 15 nxënësish, numër ky i dallueshëm në raport me numrin që lejohet për krijimin e klasave të tjera të sistemit arsimor parauniversitar. Nga ana e prindërve apo e kujdestarëve kërkohet shprehja e vullnetit për arsimimin e fëmijëve të tyre në gjuhën e pakicës kombëtare, vullnet që bazohet në të drejtën e vetidentifikimit të tyre dhe reflektohet përmes kërkesës me shkrim që depozitohet në bashki apo në njësinë administrative.

Institucionet arsimore ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare mbështeten në planin mësimor për arsimin bazë për pakicat kombëtare, bazuar në kurrikulën e re me kompetenca, të miratuar nga Ministria e Arsimit¹⁴, përdorin programet mësimore lëndore, të hartuara nga ASCAP-i, në të cilat përfshihen edhe 22 programet specifike për gjuhën, historinë dhe gjeografinë amtare greke dhe maqedonase, si: *Gjuha amtare greke*, *Gjuha amtare maqedonase*, *Historia e Greqisë*, *Gjeografia e Greqisë*, *Historia e Maqedonisë së Veriut dhe Gjeografia e Maqedonisë së Veriut*, të hartuara nga grupe pune me pjesëmarrjen e personelit akademik të Universitetit të Gjirokastrës dhe të Tiranës, si dhe nga mësues të gjuhës greke dhe të gjuhës maqedonase. Nxënësit e pakicave kombëtare në arsimin bazë zhvillojnë në gjuhën e tyre amtare të gjitha lëndët, si: Gjuhë amtare; Histori amtare; Gjeografi amtare; Dituri natyre; Matematikë 1-5, Biologji; Art pamor; Muzikë, Qytetari etj., me tekste mësimore në gjuhën greke dhe në maqedonase, përkthime të teksteve fituese të katalogut të MASR-së, ndërsa tekstet e gjuhës amtare, të historisë dhe të gjeografisë¹⁵ janë hartuar nga

¹⁴ Urdhri nr.186, datë 15.05.2015 i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e planit mësimor për pakicat kombëtare”.

¹⁵ Tekstet mësimore “Gjuhë amtare greke”, “Histori amtare greke”, “Gjeografi amtare greke”.

pedagogët e Departamentit të Gjuhës Greke dhe të Qytetërimit Grek në Gjirokastrë, si dhe të Departamentit të Gjuhëve Sllavo-Ballkanike në Tiranë.

Në kuadër të riorganizimit të njësive arsimore vendore që u bë në vitin 2019, aktualisht shkolla publike me mësimdhënie në gjuhën greke dhe maqedonase ekzistojnë në bashkitë Gjirokastrë, Dropull, Sarandë, Delvinë, Finiq, Pustec. Ky riorganizim solli funksionimin e klasave me mësimdhënie në gjuhët e pakicave në zonat ku ato janë më të përqëndruara dhe mungesën apo vështirësinë e hapjes në zonat me numër të vogël pakicash. Sipas shifrave të raportuara, pakicat greke dhe maqedonase, në krahasim me pakicat e tjera të njohura zyrtarisht, shihen më të privilegjuarat, megjithëse nga ana e tyre kërkohet shtim i shkollave dhe hapja e shkollave të reja edhe në qytete të tjera. Kërkesat e tyre së bashku me kërkesat e pakicave serbe dhe arumune nuk janë pranuar nga qeveria shqiptare për shkak të mosrespektimit të kriterëve të vendosura në ligj¹⁶. Si rezultat, përveç mësimdhënies në gjuhët greke dhe maqedonase dhe në një masë të kufizuar në gjuhën rome, aktualisht nuk ekzistojnë shkolla me mësimdhënie në gjuhët e pakicave të tjera në Shqipëri.

Numri i nxënësve të pakicave kombëtare greke dhe maqedonase që kanë ndjekur shkollën, sipas viteve shkollore përkatëse në arsimin publik janë:

- Viti shkollor 2016-2017 - Gjithsej 763 nxënës dhe 101 mësues
- Viti shkollor 2017-2018 - Gjithsej 685 nxënës dhe 94 mësues
- Viti shkollor 2018-2019 - Gjithsej 611 nxënës dhe 96 mësues
- Viti shkollor 2019-2020 - Gjithsej 565 nxënës dhe 87 mësues

Para tri vitesh Ministria e Arsimit miratoi, në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, hapjen e programit për zhvillimin e mësimit të gjuhës rome, shkalla III-IV¹⁷, në arsimin e mesëm të ulët si lëndë me zgjedhje. Mësimi i gjuhës rome dhe zhvillimi i mësimit në gjuhën rome do të bëhet në përputhje me aktet nënligjore për mësimin në gjuhën e pakicave në Republikën e Shqipërisë. Aktualisht, gjuha rome mësohet në një shkollë 9-vjeçare në Elbasan, në kuadrin e shkollës qendër komunitare.

¹⁶ Opinioni i Katërt i Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s, f.30.

¹⁷ Urdhri nr. 754, datë 9.11.2018, i Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e programit të gjuhës rome, shkalla III-IV, klasat VI-IX”.

Afërsisht 30 nxënësve çdo vit u ofrohet kjo mundësi, por vihet re mungesë e mësuesve, të diplomuar për gjuhën rome. Kjo situatë mendojmë se do të përmirësohej me mësuesit e rinj, pas përfundimit të studimeve të tyre në programin “Bachelor në gjuhë shqipe dhe rome” në Universitetin e Elbasanit, një program studimi që konsiderohej edhe si përmbushje e standardit në mbështetje të studentëve të këtij komuniteti, por edhe të pakicës rome në përgjithësi. Por, për fat të keq, ky program studimi u realizua vetëm në 4 vite akademike. Duke iu referuar të dhënave të marra nga një studim i prof. Toskës¹⁸, në vitet akademike 2015-2017, u regjistruan vetë 17 studentë, dy prej tyre ishin romë, një nga këta përfaqësues i pakicës rome në këshillin bashkiak të qytetit të Elbasanit, mësues i gjuhës rome në këtë qytet, aktiv në organizata për mbrojtjen dhe integrimin e kësaj pakice, si dhe një student ishte gjysmërome. Siç kuptohet, programi synonte edhe njohjen, studimin dhe evidentimin e pakicës rome në këto aspekte: origjina, prejardhja historike, përhapja, zhvillimi etnokulturor në faza të ndryshme të zhvillimit të kësaj etnie në botë, dhe me fokus të veçantë në Shqipëri. Në fund të këtij programi studimi, studentët do të mund të pajiseshin me njohuri që do t’i mundësonin aftësimin dhe formimin e kompetencave profesionale për realizimin e programeve shkollore të cikleve 9-vjeçare dhe atyre 3-vjeçare. Vështirësia themelore në zbatimin e këtij programi fillimisht ishte gjetja e specialistëve të gjuhës dhe të kulturës rome, veçanërisht ata që i përkisnin kësaj pakice. Shumë pak prej tyre kuptuan rëndësinë e studimit të gjuhës rome në nivel universitar, një mundësi shumë e mirë për ruajtjen dhe promovimin e kulturës rome, njësimin shpirtëror dhe kulturor të pakicës, nxitjen e integritit të kësaj pakice dhe zbatimin e projekteve të nisura nga institucionet shqiptare për ruajtjen e kësaj gjuhe dhe mësimin e saj në shkolla të ndryshme 9-vjeçare, veçanërisht ato pranë kësaj pakice. Një vështirësi tjetër në realizimin e këtij programi, që çoi edhe në mbylljen e tij, ishte se vetë të rinjtë e pakicës rome që, siç dihet shumë pak prej tyre arrijnë të ndjekin studimet universitare, nuk u përfshinë në këtë program.

Nga sa parashtroam, duhet pranuar se ende nuk ofrohet mësimdhënie për të nëntë pakicat e njohura zyrtarisht¹⁹, sidomos për ato numerikisht më të vogla për

¹⁸ Toska, T., *Gjuha rome në Universitetin e Elbasanit “A. Xhuvani”*.

¹⁹ Opinioni i Katërt i Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s, f. 30.

arsye të mungesës së stafit mësimor për të gjitha llojet e pakicave kombëtare, si dhe të teksteve shkollore në këto gjuhë. Megjithatë, ekzistenca e një ligji për pakicat dhe bashkëpunimet dypalëshe vetëm nuk mjaftojnë për zgjidhjen e të gjitha problemeve ekzistuese në fushën e arsimit të pakicave.

Vetëm një qasje e vendosur dhe e qëndrueshme, me vullnet politik do të krijonte kushtet e zhvillimit të marrëdhënieve të besueshme midis pakicave dhe qeverisë, një parametër i domosdoshëm për zbatimin e reformave dhe të masave që do të sigurojnë zbatimin e të drejtave të pakicave realisht dhe jo vetëm parashikimin e tyre në ligj.

Nisur nga problematikat e trajtuara më sipër, në funksion të jetëzimit të drejtave të pakicave kombëtare të njohura tashmë në RSH, vlerësohen hapat e mëposhtëm, si rekomandime në të ardhmen. Konkretisht, përfundimi i procesit të hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 97/2017; mbështetja dhe rritja e kapaciteteve të Komitetit për Pakicat Kombëtare, si dhe krijimi i marrëdhënieve të besueshme mes qeverisë dhe pakicave, veç të tjerash edhe nëpërmjet aderimit të Shqipërisë në Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare.

Literatura:

I Legjislacion

1. Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë i vitit 1946
2. Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë e vitit 1950
3. Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë e vitit 1976
4. Ligji nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”
5. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998
6. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë
7. Ligji nr 97/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”
8. VKM nr. 561, datë 29.9.2018 “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe krijimin e funksionimit të klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”
9. VKM nr. 562, datë 29.9.2018, “Për masat e përshtatshme për nxitjen e njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave

- kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”
10. VKM nr. 227, datë 17.4.2019 “Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve publike parauniversitare ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare”
 11. VKM nr.1155, datë 24.12.2020 “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të numrit thelbësor dhe të kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare për t’u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare”.
 12. Urdhri nr.186, datë 15.05.2015 i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për përcaktimin e planit mësimor për pakicat kombëtare”.
 13. Urdhri nr. 754, datë 9.11.2018, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e programit të gjuhës rome, shkalla III-IV, klasat VI-IX”.

II Tekste dhe studime

1. Lara, D., *Koment mbi procedurën penale*. Botimet Morava, Tiranë 2019
2. Rrokaj, Sh. *Çështje të gjuhës shqipe 4*, Botime Pegi, Tiranë, 2018.
3. Toska, T., *Gjuha rome në Universitetin e Elbasanit “A. Xhuvani”*.

III Raporte të ndryshme

1. <https://rm.coe.int/5th-sr-albania-al/1680a2614d>
2. www.eupolicyhub.eu
3. Raporti V paraqitur nga Republika e Shqipërisë mbështetur në nenin 25, paragrafi 2, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare.
4. Opinioni i Katërt i Komitetit Këshillëdhënës të FCNM-s.

PROF. ASOC. NAIM BERISHA

INSTITUTI ALBANOLOGJIK PRISHTINË

naimberisha40@hotmail.com

SHQIPJA NË RRJEDHAT GLOBALIZUESE

(NATYRA E HUAZIMEVE GJUHËSORE NË KOSOVË)

Abstrakt

Ndryshimet shoqërore përgjatë historisë manifestohen në mënyra të ndryshme në jetët e njerëzve. Fundi i shekullit të kaluar ishte fillimi i një epoke të re të ballafaqimit dhe të bashkekzistencës së shqipes me gjuhët e huaja, sidomos me anglishten. Përditshmëria jonë karakterizohet me kontakte të shumta, me njerëz profilesh të ndryshme dhe të vendeve të ndryshme, kontakte të cilat na krijojnë situata të shumta ligjërimore në të cilat shpërfaqet diversiteti kulturor e gjuhësor i bashkëbiseduesve. Rrethanat e reja të krijuara dhe mënyra e të jetuarit sot, në një mjedis ku shumëçka mund të quhet “ndërkombëtare”, ndikimi i anglishtes si gjuhë mbizotëruese dhe prijëse e proceseve globalizuese është mjaft aktiv.

Në këtë vështrim temë trajtimi do të jenë disa aspekte gjuhësore të cilat lidhen me ndikimin e anglishtes në ligjërimin e përditshëm, si: përmes muzikës, sportit, modës etj., por edhe prania e gjermanizimeve në shqipen e folur dhe të shkruar në Kosovë. Te këto të fundit, kemi konstatuar se një pjesë e tyre fillimisht kanë hyrë nëpërmjet serbokroatishtes, si gjuhë ndërmjetësuese, gjatë periudhës kur Kosova ka qenë pjesë e ish-Jugosllavisë.

Fjalët kyçe: *fjalë e huaj; ndërndikim gjuhësor; anglicizma; gjermanizma; gjuhë ndërmjetëse; gjuhë e folur; huazime leksikore*

Për arsye të ndryshme, historike, gjeografike, ekonomike, kulturore, politike etj., shqipja ka pasur kontakte me gjuhë të ndryshme, të cilat kanë ndikuar që në leksik të kemi numër të konsiderueshëm huazimesh. Nëse dikur është diskutuar për huazimet nga gjuhët me të cilat shqipja ka pasur kontakte, qofshin ato të drejtpërdrejta ose jo, sot diskutohet për ndërndikime gjuhësore e huazime edhe ndërmjet gjuhëve të largëta. Në rrethanat aktuale, shkalla e shtrirjes së tyre i kalon kufijtë kombëtarë apo regjionalë për t’u shtrirë nëpër kultura të popujve të ndryshëm.

Në pjesën e dytë të shekullin XX, avancimi i dijeve në përgjithësi e përparimet teknologjike në veçanti e futën botën në një periudhë të re, në periudhën e globalizimit. Kjo dukuri në kuptimin e përgjithshëm kap shumë

fusha njëherësh dhe është interpretuar në mënyra të ndryshme. Në harmoni me këto zhvillime, njëri ndër faktorët kryesorë është fuqia ekonomike e SHBA-ve, që ka krijuar terren të përshtatshëm për përhapjen e ndikimit të anglishtes. Në këtë linjë, kur kemi parasysh që korporatat ndërkombëtare, mediet kryesore dhe interneti janë të dominuara në masë të madhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, atëherë mund të thuhet lirisht që anglishtja është gjuha dominuese në botë¹. Pra, edhe në komunikimin gjuhësor, mund të vlerësohet se globalizimi është një proces i rritjes marramendëse të ndikimit të anglishtes në botë.

Kontaktet e drejtpërdrejta të shqipes me gjuhët e Evropës filluan pothuajse para një shekulli. Ato vazhduan pa ndërprerje dhe në mënyrë të shkallëshkallshme u intensifikuan vazhdimisht duke arritur kulmin në fund të shek. XX. Në fillim të viteve të 90-ta, së pari në Shqipëri e pastaj në Kosovë pas vitit 1999, u krijua një realitet i ri politik e shoqëror, rrethana të cilat ndikuan në formimin e një realiteti të ri gjuhësor duke e ballafaquar shqipen me anglishten si prijëse e proceseve globalizuese, por edhe me gjuhë të tjera. Zhvillimet e gjithmbarshme kanë ndikuar që shqipja të futet në një proces përshtatjeje me këto rrethana. Ashtu siç dihet, që nga periudha e administrimit të UNMIK-ut, anglishtja ishte gjuha e tretë zyrtare në Kosovë. Kur e kemi parasysh këtë dhe një sërë faktorësh tjerë politikë, socialë e kulturorë, vetvetiu nënkuptohet se vënia përballë e shqipes me anglishten, e krijoi një situatë të re gjuhësore e komunikuese në Kosovë. Tashmë është pranuar se kjo situatë gjuhësore ka prodhuar edhe pasoja për shqipen, si: futja e fjalëve të huaja e të panevojshme, mosdallimi i tyre nga ndërkombëtarizmat, mospërshtatja e disa huazimeve me natyrën e shqipes etj. Në këtë relacion, bie në sy mospërputhja e fondit leksikor të dy gjuhëve, (anglishtja mbi 500.000 fjalë), dhe pashmangshëm pritet që ky ndikim të shoqërohet me huazime gjuhësore.

Natyra e huazimeve gjuhësore në Kosovë lidhet edhe me rrethana të tjera, nëse mund të themi të natyrës praktike. Prania e shumë organizatave ndërkombëtare nga shumë vende të botës, mundësoi që të punësohen shumë njerëz, që në njëfarë forme e përshejtoi depërtimin e anglicizmave në shqipen e

¹ Shkumbin Munishi, *Globalizimi, komunikimi gjuhësor dhe gjuha shqipe*, Langue and Society (artikull i marrë nga interneti), 2008.

Kosovës. Prej kësaj kohe ndryshoi mënyra e të huazuarit – nga mënyra e të huazuarit të tërthortë, kaloi në mënyrën e të huazuarit të drejtpërdrejtë². Në këtë drejtim, mendoj se nga fondi i përgjithshëm i elementeve të huaja leksikore, duhet të dallohen ndërkomtarizmat, termat shkencorë, teknikë, teknologjikë etj., pastaj fjalët që kanë hyrë bashkë me objektin, si dhe fjalët që sjellin nocione të reja në gjuhën tonë, të cilat domosdo lejohen që të përdoren, sepse shqipes i mungojnë fjalët përgjegjëse³.

Procesin e huazimeve në gjuhën shqipe e kanë përshpejtuar edhe risitë teknologjike dhe rritja e komunikimit ndërkombëtar, të cilat ia dhanë shtysën kryesore shumë ndryshimeve, por edhe dukurisë së globalizmit në përgjithësi. Në kuadër të kësaj, duhet veçuar rrjetet e ndryshme sociale (networks).

Duke e pasur parasysh rrugën e depërtimit të huazimeve, krahas zhvillimit të madh teknologjik, mediet kanë luajtur dhe po luajnë rol të madh në këtë proces. Ballafaqimi me anglishten fillon shumë herët, madje qysh në moshën e fëmijërisë. Për këtë, rol ndikues kanë rrjetet kablore, të cilat transmetojnë programe 24 orëshe me filma të vizatuar për fëmijë si Baby Tv, Carton Network, Çufo, Bang Bang, Digji Sofie, etj., pjesa më e madhe e përmbajtjeve të tyre janë në anglisht, në disa raste me titra shqip.

Përveç tyre, rrugë tjetër e depërtimit të anglicizmave është edhe muzika. Rrymat moderne muzikore, si: rep, rok, R'n'B, pop etj., ndikojnë drejtpërsëdrejti në fjalorin e përditshëm, veçanërisht në fjalorin e të rinjve, duke u përhapur më vonë edhe në mjedise më të gjera. Ky ndikim është më i theksuar te të rinjtë e mjedisëve urbane. Tekstet e këngëve karakterizohen me një përzierje kodesh, duke përdorur pak fjalë në gjuhën shqipe, pak fjalë nga anglishtja dhe anasjelltas. Në këto raste, kemi të bëjmë me tekstshkrues biling, për të cilët mund të thuhet se kanë kompetencë të dyfishtë gjuhësore dhe i ekuilibrojnë të dy gjuhët. Në tekstet e këngëve të këtyre rrymave muzikore, kjo bëhet për efekt stilistik, pra për përshatjen e rimave dhe ritmit, por edhe për të treguar “modernitet”. Këto

² Vesel Nuhiu, *Gjuha shqipe sot shikuar nga këndvështrimi i huazimeve (Angleze)*, në: “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, Prishtinë, 2008, f. 499-500.

³ Ragip Mulaku, *Huazimet dhe purizmi në mediet e Prishtinës*, Java e Albanologjisë, Prishtinë 2010.

rrethana gjuhësore kanë krijuar edhe hibridizime gjuhësore,...disa nga këto anglicizma kanë krijuar fushat e tyre leksikore, duke krijuar njësi të reja leksikore në gjuhën shqipe, p.sh.: mbi bazën e fjalës *rep* janë krijuar një varg fjalësh të tjera të prejardhura, si: *reper*, *repoj*, *repovat*, *repturë*⁴. Këto hibridizime, duke pasur përdorim aktiv në të folur kanë krijuar njësi leksikore me rrënjë me prejardhje angleze dhe formate fjalëformuese të shqipes. Kështu, meqë elementi rrënjor është me prejardhje nga anglishtja e formanti fjalëformues është i shqipes, fjala *reper*, si dhe fjalët *rep-ist*, *rep-oj*, *rep-oveat*, *rep-turë* janë hibride gjuhësore⁵.

Më tutje, anglishtja sot është gjuhë kryesore e marketingut dhe e reklamave, të cilat i kanë vërshuar jo vetëm hapësirat fizike nëpër vendbanime anekënd botës, por edhe hapësirat digjitale e virtuale. Anglishtja është bërë gjuhë e misioneve ndërkombëtare e paqeruajtëse nëpër botë (mision language) dhe, në të shumtën e rasteve, është edhe gjuha kryesore e samiteve politike, e simpoziumeve dhe seminareve ndërkombëtare, të cilat organizohen gjithandej nëpër botë⁶.

Sa u përket gjermanizmave, konstatohet se një pjesë e tyre fillimisht kanë hyrë nëpërmjet serbokroatishtes, si gjuhë ndërmjetësuese, gjatë periudhës kur Kosova ka qenë pjesë e ish-Jugosllavisë.

Kur flasim për fillimet e depërtimit të gjermanizmave, një nga rrugët e depërtimit të tyre ka qenë nëpërmjet serbokroatishtes, si gjuhë ndërmjetësuese, gjatë periudhës kur Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë. Si rrugë e dytë e depërtimit të tyre ishte punësimi i kosovarëve në Gjermani gjatë viteve '60-'70 si punëtorë sezonalë (*gastarbajterë*), kryesisht në ndërtimtari, po dhe në sektorë të tjerë. Është një mendim i përgjithshëm se gjermanizmat që kanë depërtuar në gjuhën shqipe në Kosovë janë sjellë kryesisht përmes gjuhës së folur dhe shumica prej tyre u takojnë fushave të ndryshme profesionale.

Përdorimi i gjermanizmave lidhet me fusha profesionale, automobilizmi, veglat dhe punët e mekanikut e të elektrikut etj., si: *anllaser*, *auspuh*, *bormashinë*,

⁴ Shpëtim Elezi, *Ndikimi i anglishtes në shqipen nëpërmjet muzikës Rep*, në: "Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare". Prishtinë, 2010.

⁵ Po aty.

⁶ Shkumbin Munishi, *Globalizimi, komunikimi gjuhësor dhe gjuha shqipe*, Langue and Society (artikull i marrë nga interneti), 2008.

dihtung, feder, gepek, gurtne, haubë, kuplung, ler, lluster, rikvers, sajllë, shajbe, shraf, shrafçiger, shteker etj.; me mjetet dhe punët në ndërtimtari: *bager, ibercug, glet, llager, moler, pllac, shleper, treger, vagon, vinkëll* etj.; me ushqimin e hotelerinë: *buter, krigëll, krofne, kugëll, shank, shllag, shnicëll, shpajz, shpricer, shtrudëll, vekne, virshël* etj., apo me veshmbathjen e kujdesin personal, si: *bademantil, blluzë, fen, lloknë, mantil, shtikëll, shminkë, shtof* etj.

Procesi i huazimit të fjalëve të huaja në mjaft raste shoqërohet me lëvizje kuptimore, si në shembujt e përdorimit të këtyre gjermanizmave: **gepek**, në gjermanishte (*das Gepäck*) ka kuptimin e *valixheve që kemi me vete në udhëtim*, ndërsa në gjuhën shqipe, në Kosovë, *gepek –pjesa e veturës ku fusim valixhet, gepeku i veturës; gilipter*, në Kosovë përdoret me ngjyrim negativ, *i pasjellshëm, i pagdhendur, i pafytyrë, i papjekur*, kurse në gjermanisht (*der Geliebter*) përdoret në kontekst pozitiv: *person i dashur, dashnor; ibercug* (*der Überzug*), gjermanisht d.m.th. *mbështjellëse apo edhe këllëf shtrati*, ndërsa në shqip është fjalë që lidhet me fushën e ndërtimtarisë - *shtresë e dyshemesë për nivelizim dhe për izolim* etj.

Sipas mendimit tonë, duke pasur parasysh se shqipja në vazhdimësi po i nënshtrohet trysnisë së gjuhëve të huaja të cilat janë në një shkallë më të lartë të zhvillimit, kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet pengimit të depërtimit të fjalëve të panevojshme për të cilat ekziston fjala shqipe. Gjithsesi, ne duhet të veprojmë me maturi ndaj huazimeve, nuk duhet ta lejojmë me çdo kusht nxjerrjen e fjalëve të huaja nga përdorimi kur ato janë të nevojshme.

PROF. AS. DR. ANILA CEPANI

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

anila.cepani@unitir.edu.al

PROF. AS. DR. ADELINA CERPJA

INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

adicerpja@gmail.com

RRETH NJË PROJEKTI TË DIVERSITETIT GJUHËSOR DIGJITAL PËR PAKICAT NË BALLKAN

Abstrakt

Ruajtja e diversitetit kulturor dhe gjuhësor në kushtet të globalizimit të jetës shoqërore bashkëkohore është një domosdoshmëri e kohës, por njëkohësisht edhe sfidë e çështje shumë komplekse dhe delikate. Sot jemi në një kohë kur politikat gjuhësore multikulturale i mëshojnë detyrimit të respektimit të kërkesave të veçanta të identitetit; kur OSBE-ja, KE-ja dhe BE-ja i kanë bashkërenduar përpjekjet për të zhvilluar një sistem koherent e të qëndrueshëm për mbrojtjen e pakicave kombëtare; kur shtetet kanë detyrim jo vetëm të respektojnë identitetin etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar, por edhe të krijojnë kushtet e nevojshme për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar këtë identitet. Por, me gjithë këto orientime dhe përpjekje, vihet re që mosmarrëveshjet për të drejtat që duhet t'u njihen minoriteteve janë të mprehta dhe shpesh kanë penguar punën për mbrojtjen e tyre. Dhe një ndër pikat kyçe të drejtave të minoriteteve është gjuha e tyre e origjinës. Nëse ndalemi në çështjen e ruajtjes së gjuhës së pakicave, a do të mjaftonte vetëm zbatimi me përpikëri i këtyre politikave? A duhet që procesi të jetë më i hapur, duke i dhënë vëmendjen e duhur secilit aspekt: ruajtjes, mësimi dhe përcjelljes së këtyre gjuhëve të minoriteteve? Si do të ndihmonte teknologjia për ruajtjen e diversitetit gjuhësor?

Duke pasur në mendje pyetjet e mësipërme dhe duke rënë në kontakt me një projekt në kuadër të Programit Erasmus+ “The Digital Language Diversity Project - DLDP”, 2015-2018, ndërmarrë nga Instituti i Gjuhësisë Kompjuterike “A. Zampolli” (ILC, Itali), pjesë e Departamentit të Shkencave Humane dhe Sociale, Trashëgimisë Kulturore (DSU) të Këshillit Kombëtar të Kërkimit (CNR), na lindi ideja për të parë më në thellësi mënyrën se si mund të shfrytëzohet zhvillimi i teknologjisë për ruajtjen e veçantive gjuhësore duke realizuar softuerë specifikë sipas nevojave përkatëse. Të gjitha këto

mund të realizohen në kuadër të një projekti të ngjashëm me DLDP, por duke u kufizuar në gjuhët e pakicave në Ballkan.

Në këtë kumtesë synohet të vihen në dukje mundësitë e shumta që ofron teknologjia për ruajtjen e gjuhëve, si dhe të parashtrihen disa ide konkrete për realizimin e softuerëve të ndryshëm gjuhësorë në funksion të diversitetit gjuhësor për pakicat.

Fjalë kyç: *pakicë, gjuhë, diversitet, teknologji, softuer, përmbajtje digjitale*

Që në ngjizjen e tij, Bashkimi European e bazoi filozofinë, politikat dhe deri diku praktikën e tij të brendshme në parimin e shumëgjuhësisë. Një varg programesh dhe raportesh të rregullta janë realizuar për të vënë theksin terëndësia e madhe që ka ndërlidhja mes shumëgjuhësisë, ekonomisë, shoqërisë së informacionit dhe qytetarisë. Disa nga shtetet përbërëse të Ballkanit (Greqia, Bullgaria, Kroacia, Rumania¹) janë tashmë pjesë e BE-së, ndërsa pjesa tjetër (Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Serbia, Mali i Zi, Bosnja e Hercegovina) janë në rrugën për t'u anëtarësuar, ndërkohë që Turqia (me pjesën e saj europiane) ka bërë zgjidhjen e vet politike.

Në dekadat e fundit, kanë ndodhur ndryshime të mëdha ligjore në vendet e BE-së: disa gjuhë pakicash janë kthyer në gjuhë zyrtare ose gjysmë zyrtare në territoret brenda shteteve përkatëse, duke u dhënë hapësirë në administratën publike, në arsimim, në media dhe në tregti. Politika të tilla janë në proces edhe në vendet ballkanike jo anëtare të BE-së. Shqetësimi për gjuhët e pakicave është ngritur prej kohësh, duke u përforcuar prej parashikimeve jo shumë optimiste se problemet që vihen re sot në gjuhët e pakicave herët a vonë do të reflekohen në të ardhmen edhe tek gjuhët 'e vogla'. Prandaj është shumë e rëndësishme të mirënjihet rëndësia e gjuhëve, të mëdha e të vogla, të shumicave dhe të pakicave, e rolit që kanë këto gjuhë dhe në transmetimin e kulturës dhe të vlerave të vendeve përkatëse.

Sipas Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave, "Gjuhët rajonale ose të pakicave" janë gjuhë që përdoren tradicionalisht brenda një territori të caktuar të një shteti nga shtetas të tij, të cilët formojnë një grup

¹ Lidhur me përfshirjen ose jo të Rumanisë në shtetet e Gadishullit Ballkanik hasen qëndrime të ndryshme. Shih: <https://www.treccani.it/enciclopedia/penisola-balconica>; <https://www.britannica.com/place/Balkans>

Në kumtesën tonë do ta trajtojmë Rumaninë si shtet përbërës të Gadishullit Ballkanik.

numerikisht më të vogël se pjesa tjetër e popullsisë; ato janë të ndryshme nga gjuha (gjuhët) zyrtare dhe nuk përfshijnë as dialektet e gjuhëve zyrtare të shtetit dhe as gjuhët e emigrantëve.

Ballkani, për vetë kushtet gjeografike, historike e politike, është një mozaik i pasur gjuhësh të cilat mund të jenë gjuhë kombëtare ose zyrtare, gjuhë rajonale ose të pakicës. Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis ‘gjuhëve ballkanike’, të cilat janë autoktone në Ballkan, dhe ‘gjuhëve të Ballkanit’, të cilat janë gjuhët që fliten në Ballkan².

Nga shfrytëzimi i burimeve³ të ndryshme rreth minoriteteve dhe gjuhëve të pakicave në vendet e Ballkanit të cilat jo gjithmonë kanë informata identike, ndikuar nga faktorë të tjerë jashtëgjuhësorë, na rezultojnë këto të dhëna, megjithëse duhet të vëmë në dukje ka mendime të ndryshme mes studiuesve: Shqipëri (*greqisht, romisht, arumanisht, maqedonisht, bullgarisht, serbisht, gjuha malazeze*); Greqi (*maqedonisht, turqisht, gjuha vllahe, gjuha arvanite, romisht, shqip*); Kosovë (*serbisht, turqisht, gjuha rome, boshnjakisht*); Kroaci (*serbisht, italisht, hungarisht, shqip*); Mali i Zi (*boshnjakisht, kroatisht, serbisht, shqip*); Maqedonia e Veriut (*shqip, romisht, turqisht, serbisht*); Serbi (*boshnjakisht, kroatisht, romisht, hungarisht, shqip*); Bosnjë dhe Hercegovinë (*serbisht, kroatisht, romisht*); Sloveni (*serbisht, kroatisht, boshnjakisht, shqip, romisht, maqedonisht, hungarisht, italisht, gjermanisht*); Rumani (*hungarisht, gjermanisht, romisht, gjuha ukrainase-rutene, gjuha ruse-lipovane*).

² Për më shumë, Shih Friedman A., Victor, *Languages of the Balkans*, publikuar ‘online në 29.03.2017, <https://doi.org/10.1093/acrefore/9780199384655.013.348>

³ Sipas Grupit Ndërkombëtar për të Drejtat e Minoriteteve (<https://minorityrights.org/>); “Minority-language related broadcasting and legislation in the OSCE”, Institute for Information Law (IVI), Universiteit van Amsterdam Study commissioned by the OSCE High Commissioner on National Minorities, April 2003. <https://www.osce.org/files/f/documents/3/1/78058.pdf>; Ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” (<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>); Ligji nr. 03/I-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2531>).

Nëse i përmbledhim të gjitha, rezulton se në Gadishullin e Ballkanit fliten këto gjuhë pakicash: *arumanisht, boshnjakisht, bullgarisht, greqisht, gjermanisht, gjuha arvanite, gjuha malazeze, gjuha rome, gjuha ruse-lipovane, gjuha ukrainase-rutene, gjuha vllahe, hungarisht, italisht, kroatisht, maqedonisht, romisht, serbisht, serbisht, shqip, turqisht.*

Gjuha është një nga faktorët kryesorë të identitetit dhe identifikimit për personat që u përkasin pakicave kombëtare. Gjuhët minoritare ose të pakicave janë gjuhë që fliten nga një pakicë e popullsisë së një territori ose shteti, dhe ato përcaktohen me legjislacion ose dokumente kushtetuese. Në vitin 1992, Këshilli i Evropës miratoi Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare me qëllim mbrojtjen dhe promovimin e gjuhëve historike rajonale dhe minoritare në Evropë. Ruajtja e diversitetit gjuhësor është me rëndësi të madhe për të ruajtur trashëgiminë e pasur kulturore, pasi gjuha është një komponent thelbësor i identitetit individual dhe kolektiv. Mbijetesa e gjuhëve, veçanërisht e gjuhëve të pakicave dhe atyre të rrezikuara, përveç të tjerave, varet nga aftësia e tyre për t'u përshtatur me mjedisin modern. Sa prej gjuhëve të përmendura më sipër kanë aktivitet të pasur digjital me të cilin kuptojmë përdorimin e tyre në rrjete sociale, në lokalizimin e softuerëve të rëndësishëm dhe me përdorim masiv, në titrat e filmave të ndryshëm, në fjalorë elektronikë etj.?

Duke pasur në mendje pyetjet e mësipërme dhe duke rënë në kontakt me një projekt në kuadër të Programit Erasmus + “The Digital Language Diversity Project - DLDP”, 2015-2018, ndërmarrë nga Instituti i Gjuhësisë Kompjuterike “Antonio Zampolli” (ILC, Itali), pjesë e Departamentit të Shkencave Humane dhe Sociale, Trashëgimisë Kulturore (DSU) të Këshillit Kombëtar të Kërkimit (CNR), na lindi ideja për të parë më në thellësi mënyrën se si mund të shfrytëzohet zhvillimi i teknologjisë për ruajtjen e veçantive gjuhësore duke realizuar softuerë specifikë sipas nevojave përkatëse. Të gjitha këto mund të arrihen në kuadër të një projekti të ngjashëm me DLDP, por duke u kufizuar në gjuhët e pakicave në Ballkan, sigurisht duke mos i konsideruar këto përpjekje thjesht si shpenzime shtesë, por duke u ndalur në aspektet pozitive që sjellin gjuhët e pakicave në shoqërinë e gjerë në të cilën jetojnë.

Në këtë kumtesë synohet të vihen në dukje mundësitë e shumta që ofron teknologjia për ruajtjen e gjuhëve, veçanërisht të atyre që kanë një traditë shkrimi,

si dhe të parashtrihen disa ide konkrete për realizimin e softuerëve të ndryshëm gjuhësorë në funksion të diversitetit gjuhësor për pakicat. Këto ide do të jenë të gërshetuara me objektivat për sjelljen në vëmendje të problematikave që ekzistojnë për gjuhët e pakicës në Ballkan; marrjen në konsideratë të masave që mund të merren për të lehtësuar përdorimin dhe shfrytëzimin e këtyre gjuhëve në komunikim dhe në internet; vënien në dukje të rolit të madh që ka teknologjia e informacionit në ruajtjen dhe përdorimin e gjuhëve të pakicave që duhet të konsiderohen si pasuri për shoqërinë, veçanërisht në ditët e sotme kur ka njohur një zhvillim marramendës.

Gjuha është mjete kryesor i komunikimit të informacionit dhe të njohurive dhe gjuha amtare është çelësi i identitetit dhe i shprehjes kulturore. Evolucioni teknologjik i dekadave të fundit ka bërë të mundur komunikimin e gjerë në të gjithë botën në kohë reale. Është e vërtetë që infrastruktura teknologjike që mbizotëron në jetën tonë është kryesisht në anglishte dhe si pasojë gjuhët e pakicave janë nën kërcënim më shumë se kurrë. Por nga ana tjetër, nëse punohet si duhet, është e mundur që teknologjia të ndihmojë në forcimin e diversitetit gjuhësor në vend që ta dëmtojë atë. Është gjithashtu e mundur që teknologjitë gjuhësore të veprojnë si një lloj bashkimi shoqëror midis folësve të shpërndarë të një gjuhe të caktuar. Nëse në të kaluarën një folës i një gjuhe të pakicës langohej nga komuniteti, mundësitë e ruajtjes së bashkëbisedimit në gjuhën e tij ishin shumë të pakta, por në ditët e sotme, falë teknologjisë ata mund të qëndrojnë në kontakt në të gjitha llojet e mënyrave. Kur ka mbështetje për gjuhët në internet dhe në përfaqësimin digjital, qofshin ato gjuhë autoktone, të rrezikuara ose zyrtare, ajo vepron si një stimul për folësit e tyre, ndaj qëndrueshmëria dhe ruajtja e gjuhëve rajonale dhe të pakicave është e lidhur ngushtë me perceptimin nga folësit e tyre si gjuhë të plota që mund të përdoren në çdo kontekst, përfshirë edhe në atë digjital.

Kufizimi i këtyre gjuhëve rrjedh kryesisht nga përdorimi i gjuhëve kombëtare dhe globale për të cilat përmbajtja dhe shërbimet digjitale janë lehtësisht të mundshme, duke bërë që folësit e gjuhëve rajonale dhe të pakicave t'i përdorin sa më pak gjuhët e tyre në mënyrë digjitale. Për të shmangur këtë gjë dhe për t'i bërë këto gjuhë tërheqëse dhe të përdorshme ashtu si gjuhët e tjera kryesore, duhet një planifikim i kujdesshëm, duke identifikuar së pari se sa, si

dhe ku përdoren këto gjuhë në mënyrë digjitale. Sipas D. Crystal “Një gjuhë e rrezikuar do të përparojë nëse folësit e saj mund të përdorin teknologjinë elektronike.”⁴ Pëngesat dhe kufizimet e përfaqësimit të tyre masiv digjital janë të lidhura me disa faktorë teknologjikë, gjuhësorë e psikologjikë, si:

1. mungesa e kompetencës në gjuhën e shkruar, që i pengon njerëzit të përdorin gjuhën e tyre në formë të shkruar. Kjo lidhet ngushtësisht me mungesën e burimeve të ndryshme gjuhësore, mungesën e një standardi gjuhësor të shkruar.
2. profili i ulët që gëzojnë shumë rajone dhe minoritete, të cilat shpesh nuk njihen dhe nuk mbështeten zyrtarisht.
3. prestigji i ulët dhe një profil i dobët socio-politik bëjnë që folësit t’u drejtohen gjuhëve të tjera në botën digjitale, duke minimizuar kështu përdorimin e gjuhës së komunitetit të tyre. Nisur nga kjo, ka më pak interes ekonomik nga kompanitë e zhvillimit të aplikacioneve digjitale për këto gjuhë, ndaj dhe numri i aplikacioneve të teknologjisë më të fundit për gjuhët e pakicave, të cilat do të mundësonin dhe do të nxisnin përdorimin e tyre në mediat dhe pajisjet digjitale, është shumë i kufizuar.
4. mungesa e një tastiere specifike që mund të lehtësojë shkrimin në këto gjuhë.

Sipas një studimi të Parlamentit Europian⁵, gjuhët në të ardhmen do të ndihën më të kërcënuara për shkak të zhvillimit të pabarabartë të teknologjisë gjuhësore, prandaj theksojmë rëndësinë e digjitalizimit, i cili ofron platforma të reja komunikimi për gjuhët e pakicave, të cilat mund të ndihmojnë ruajtjen e tyre afatgjatë dhe mbrojtjen e diversitetit gjuhësor.

Disponueshmëria e përmbajtjes digjitale dhe mbështetja teknike për ta përdorur atë janë kushtet thelbësore për zhvillimin e aplikacioneve digjitale të bazuara në gjuhë, të cilat nga ana tjetër mund të nxisin përdorimin digjital të këtyre gjuhëve.

⁴ D. Crystal, *Language death*. Cambridge: Cambridge University Press. 2000, f. 130–141.

⁵ [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/etudes/join/2000/289662/DG-4-JOIN_ET\(2000\)289662_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/etudes/join/2000/289662/DG-4-JOIN_ET(2000)289662_EN.pdf), f. 6.

Përmbajtjet digjitale mund të sigurohen së pari duke digjitalizuar të gjitha burimet gjuhësore të një gjuhe të caktuar, qofshin këto vepra artistike, studimore, fjalorë, revista, gazeta etj. Mund të krijohet gjithashtu një arkiv i publikimeve dhe i përmbajtjeve në ueb, duke përzgjedhur ato që janë në gjuhën e synuar. Këto materiale të digjitalizuara bëhen pjesë e bibliotekave digjitale të cilat kanë një rol kyç në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e kulturave ndërkombëtare në gjuhët mbizotëruese dhe të pakicave në veçanti. Bibliotekat digjitale përfaqësojnë një zgjidhje për këtë problem dhe janë mjete praktike për ruajtjen dhe rigjallërimin e gjuhëve të pakicës. Ndërsa prodhimi i dokumenteve digjitale rritet, njerëzit shpesh duan t'i ruajnë dhe t'i shpërndajë dokumentet e tyre në një audiencë më të gjerë. Përveç krijimit të arkivave digjitale të teksteve të shkruara, është e rëndësishme të krijohen arkiva të regjistrimeve të gjuhës së folur. Shumë nga gjuhët e pakicave fliten vetëm nga anëtarët më të vjetër të komuniteteve përkatëse dhe gjuha e folur do të vdesë bashkë me ta.

Një tjetër mënyrë për krijimin e përmbajtjeve digjitale është dhe duke regjistruar lexime nga njohës të mirë të gjuhës të përmbajtjeve në gjuhët e pakicave. Këto histori digjitale mund të ndërthuren me imazhe apo muzikë, duke i dhënë kështu një përmasë tjetër këtyre materialeve, gjithmonë në funksion të rigjallërimit të gjuhës.

Përparimet teknologjike tani lejojnë regjistrimin dhe ruajtjen lehtësisht e pa kufizime të teksteve origjinale, të filmave apo regjistrimeve të përdorimit të gjuhës së një komuniteti. Të gjitha këto materiale arkivore në formë elektronike shërbejnë si për ruajtjen e gjuhës, ashtu dhe për studimin e mëtejshëm të saj. Ato shërbejnë gjithashtu si një bazë e mirë për krijimin e korpusit të gjuhës së shkruar dhe të folur.

Ku mund të përqendrohet puna për zhvillimin e teknologjisë në funksion të ruajtjes së veçantive të gjuhëve të pakicave në Ballkan?

Ndërtimi i korpusit

Një korpus është në thelb një koleksion tekstesh i ndërtuar me qëllimin për të qenë përfaqësues i përdorimit të gjuhës, qoftë në përgjithësi, qoftë edhe me specifika të veçanta, si në rastin e korpuseve të specializuara. Të gjitha burimet

gjuhësore që përshkruam më sipër, të shkruara ose të folura të konvertuara në format elektronik, shërbejnë për të ndërtuar korpusin e asaj gjuhe. Fillimisht, në nivelin bazë mund të ndërtohet një korpus që përmban tekst të papërpunuar, ku fjalët e tij janë të paetiketuara me veçori të ndryshme morfologjike, sintaksore e leksikore. Më pas mund të shtohen meta të dhëna ose shënime gjuhësore për të pasuruar korpusin dhe për të rritur dobinë e tij. Korpusi ndërtohet me kritere të përcaktuara qartë dhe përmban një sasi të madhe informacioni që mund të përdoret ose të konsultohet për qëllime të ndryshme. Përdoruesit e gjuhës nëpërmjet korpusit mund të mësojnë shumë gjëra për gjuhën e tyre, si, fjalët e reja që nuk i kanë ditur dhe që falë kontekstit ku dalin bëhen të qarta për ta, cilat fjalë ose variante fjalësh përdoren më tepër, mund të nxjerrin të dhëna statistikore për bashkëvajtjen e fjalëve me njëra-tjetrën duke e rritur kështu mundësinë e tyre për t'u shprehur me forma të larmishme. Gjithashtu informacioni në korpus është shumë i dobishëm për të hartuar dhe redaktuar fjalorë, mund të shërbejë si burim për zhvillimin e aplikacioneve të ndryshme gjuhësore për të cilat do të ndalemi më poshtë, si kontrollues drejtshkrimor e sintaksor etj.

Në faza të mëvonshme mund të ndërmerren hapa për përgatitjen e korpuseve dy ose më shumëgjuhëshe, duke shfrytëzuar sidomos të gjitha tekstet e përkthyer prej specialistëve nga gjuha kryesore zyrtare në një nga gjuhët minoritare.

Duhet pasur parasysh se ndërtimi i një korpusi të tillë është një detyrë e rëndësishme që kërkon bashkëpunim midis disa grupeve të interesit dhe kërkon një investim në kohë, si dhe fonde që mund të jenë përtej mundësive të disa komuniteteve.

Një nga problemet kryesore është se si të përftohet një sasi të konsiderueshme tekstesh në format elektronik dhe po ashtu zgjidhja e së drejtës së autorit me botuesit dhe autorët. Një mundësi për të kapërcyer këtë pengesë është shfrytëzimi i materialeve të publikuara në ueb, por duhet pasur kujdes në përzgjedhjen e tyre me qëllim që të identifikohen vetëm tekste shkruara në gjuhën e synuar për korpusin. Për të identifikuar se cilat faqe interneti kanë përmbajtje në gjuhën përkatëse është e dobishme të kërkohet nga komuniteti gjuhësor që të ofrojë adresat e faqeve të njohura ekzistuese dhe atyre të krijuara rishtas. Gjithashtu gjatë krijimit të algoritmit mund të specifikohet një grup fjalësh

përfaqësuese të gjuhës të cilat shërbejnë për motorët e kërkimit për t'i kombinuar me fjalë të tjera e për të kryer disa kërkime me qëllim mbledhjen e dokumenteve në gjuhën e synuar.

Korpusi mund të përpunohet më tej duke etiketuar fjalët dhe fjalëformat e ndryshme sipas pjesës së ligjëratës që i përkasin, si dhe me veçori të tjera morfologjike, sintaksore e leksikore.

Tastiera e modifikuar për një gjuhë specifike

Shumica e përdoruesve të gjuhëve të ndryshme nuk janë në gjendje të shkruajnë në kompjuter siç duhet në gjuhën e tyre për shkak të mungesës së një tastiere specifike për atë gjuhë, e cila përfshin shenjat diakritike ose simbolet që mungojnë, të cilët nuk mbështeten në mënyrë universale nga tastierat ekzistuese.

P.sh. në alfabetin e gjuhës shqipe gjenden dy shkronja të veçanta “ë” dhe “ç” të cilat nuk ndodhen në tastierat e zakonshme dhe kjo bën që shpesh përdoruesit t'i zëvendësojnë këto karaktere me “e” dhe “c” duke deformuar kështu alfabetin dhe fjalët e gjuhës shqipe. Po ashtu në sistemet e shkrimit të gjuhëve të tjera ka shumë më tepër shkronja të tilla të pajisura me shenja të posaçme, por përdorimi i këtyre shkronjave të veçanta mund të zgjidhet me mënyra të ndryshme.

Një mënyrë është prodhimi i tastierave të veçanta për gjuhën përkatëse dhe kjo do t'ua lehtësonte punën përdoruesve të gjuhës. Por ndoshta një zgjidhje më ekonomike do të ishte realizimi dhe përdorimi i aplikacioneve falas për instalimin e tastierës së gjuhës përkatëse. Në përdorim janë disa të tilla, p.sh.: SwiftKey, që vë në dispozicion tastiera virtuale për më shumë se 190 gjuhë dhe funksionon në të dyja platformat, iOS dhe Android.

Një program tjetër për tastierën është *Keyboard layout manager*, i cili e lehtëson edhe më tepër problemin. Mjafton një instalim i këtij programi në kompjuter e më pas zëvendësimi i përhershëm i tasteve që përdoren shumë rrallë me simbolet karakteristike të gjuhës. Ky zëvendësim gjen përdorim në të gjitha programet kompjuterike, përfshirë këtu dhe shkrimin në ueb.

Ngjashëm me këtë program funksionon *Microsoft Keyboard Layout Creator*, i cili mundëson krijimin nga e para ose modifikimin e paraqitjes së tastierës për një gjuhë që Microsoft Windows nuk e mbështet, madje mund të përcaktohet dhe

struktura e tastierës, në mënyrë që të mund të futen simbolet e parapëlqyera me një shtypje të thjeshtë të tastierës. Microsoft Keyboard Layout Creator është një zgjidhje softuerike që mund të përdoret në mënyrë të sigurt si nga fillestarët, ashtu edhe nga përdoruesit më me përvojë dhe falë veçorive të tij të fuqishme, ai i shërben qëllimit të tij shpejt e lehtë dhe punon pa ndikuar fare në performancën e pajisjes.

Burimet gjuhësore, fjalorët elektronikë

Për zhvillimin e aplikacioneve kompjuterike të përparuara të bazuara në një gjuhë të caktuar, duhet plotësuar kushti thelbësor i disponueshmërisë së burimeve gjuhësore, që përfshijnë fjalorë, koleksione tekstesh ose korpusesh, gramatika, baza të dhënave leksikore dhe terminologjike.

Gjatë dekadave të fundit, metodat digjitale filluan të ndryshojnë procesin e punës për hartimin e fjalorëve. Sipas metodave tradicionale kërkohet shumë kohë e punë për vjeljen e fjalëve dhe formulimin e kuptimeve të tyre. Leksikografëve dhe forcave ndihmëse u duhej të lexonin libra të ndryshëm dhe të përgatitsnin skeda të posaçme për një fjalë dhe kontekstin ku dilte ajo. Përveç kësaj, një punë tejet e lodhshme ishte grupimi i skedave sipas konteksteve ku fjala dilte me një kuptim të caktuar dhe përgatitja e shpjegimit të kuptimit të ilustruar me shembuj konkretë. Në ditët e sotme kur teknologjia kompjuterike është zhvilluar ndryshëm, dhe po ashtu softuerët e veçantë për përpunimin e fjalës, kjo punë paraprake e vjeljes së fjalëve kryhet lehtësisht dhe në kohë rekord. Tani është e mundur të përpilohen korpuse të mëdha tekstesh që mbulojnë të gjitha llojet e një gjuhe, të dalin të gjitha shfaqjet e një fjale në kontekste të ndryshme dhe e kombinuar me fjalë të tjera; të renditen sipas kriterëve të ndryshme duke i shtuar sa më shumë kontekst që nevojitet etj. Një kompjuter mund të përpunojë lehtësisht korpuse prej disa qindra milionë fjalësh dhe burime të reja mund të shtohen me shpejtësi. Kjo lejon një mbulim shumë më të gjerë dhe shumë më përfaqësues të një leksiku se asnjëherë më parë.

Për të hartuar një fjalor me anë të kompjuterit, shfrytëzohet korpusi i një gjuhe duke nxjerrë fjalët dhe ilustrimet e kuptimeve të tyre që do të përfshihen në fjalor. Nëpërmjet programit të konkordancave leksikore që është pjesë

integrale e korpusit, renditen alfabetikisht format e fjalëve si dhe kontekstet ku ato dalin. Kjo e lehtëson shumë punën e hartuesit të fjalorit i cili analizon të gjitha përdorimet e një fjale dhe formulon kuptimet e saj të dallueshme nga konteksti. Po ashtu, materiali ilustrues për secilin kuptim është një shembull real nga tekste të ndryshme letrare dhe joletrare dhe nuk janë shembuj të stisur.

Në një fazë paraprake fjalorët ekzistues të shtypur mund të transferohen në kompjuter dhe të përshtaten për qëllimet e përdoruesit të zakonshëm. Versionet elektronike të fjalorëve ofrojnë disa përparësi: kërkimi është më i shpejtë dhe më shterues; informacioni është më i lehtë për t'u rishikuar dhe përditësuar; është e mundur të shtohen informacione audio për tingujt e folur në vend të transkriptimeve fonetike; mund të shkarkohen lehtësisht si aplikacione dhe të kenë shfrytëzim masiv nga çdo përdorues, ose mund të shfaqen në ueb.

Këta fjalorë ekzistues, por tashmë në formë elektronike mund të shërbejnë si bazë e platformës për hartimin e fjalorëve. Këto platforma krijojnë mundësinë e përfshirjes së fjalorëve ekzistues dhe gjithashtu të futjes së fjalëve të reja. Në platformë mund të integrohen disa module, si ai i shembujve, i shprehjeve frazeologjike, i fjalëve të urta të cilat shërbejnë si burim për modulën kryesor të hartimit të fjalorit. Platforma krijon lehtësira për ndërfaqjen e kuptimeve të fjalëve të tjera të ngjashme, për ndërfaqjen e shembujve, fjalëve të urta, shprehjeve frazeologjike në fjalën zë që je duke e hartuar. Mjafton të shkruhen gërmat e para të fjalës në secilën nga rubrikat dhe menjëherë listohen të gjitha sipas kërkesës së kryer. Bashkë me këto module në platformë është i integruar korpusi i gjuhës përkatëse i cili të ofron mundësinë e kërkimit të fjalës në të gjithakontekstet ku ajo del.

Softueri për Morfologjinë

Softueri për morfologjinë mund të përgatitet si një aplikacion i strukturuar i fjalëve të një gjuhe sipas veçorive gramatikore dhe mund të shfrytëzohet për studime të mirëfillta dhe për përvetësimin e asaj gjuhe. Ai do t'u vijë në ndihmë jo vetëm nxënësve e studentëve, përdoruesve të interesuar për gjuhën e tyre minoritare, të huajve që mësojnë gjuhën, por dhe specialistëve që dëshirojnë të bëjnë studime më të thella në fusha të ndryshme gjuhësore. Programi përmban

fjalësin e gjuhës të zbërthyer në të gjitha trajtat dhe format me të cilat dalin këto fjalë. Aty përfshihen të gjitha pjesët e ligjëratës (pjesët e ndryshueshme dhe pjesët e pandryshueshme) me trajtat përkatëse duke krijuar tabela të veçanta për secilën. Ky program shërben gjithashtu si një mjet i sigurt referimi për çdo përdorues që nuk është i sigurt për trajtën e fjalës që zgjedh të përdorë në shkrimin e tij, pasi është i vetmi softuer që përmban të gjitha fjalëformat e gjuhës përkatëse.

Për ndërtimin e një softueri të tillë duhet njohur mirë struktura morfologjike e gjuhës përkatëse dhe falë këtyre njohurive mund të krijohen formula të gjenerimit automatik të fjalëformave duke u bazuar në modele të lakimit apo të zgjedhimit. Kjo bën të mundur plotësimin automatik të të gjitha fjalëformave të pjesëve të ligjëratës, duke lënë mënjanë format e parregullta për të cilat duhet ndërhyrje manuale. Gjenerimet automatike nëpërmjet formulave krijon mundësinë që softueri të përditësohet me fjalë të reja duke u futur në mënyrë automatike për një kohë shumë të shpejtë.

Ky softuer është i realizueshëm dhe shumë i lehtë për t'u përdorur. Ai mund të përgatitet në versione të ndryshme të përshtatshme për ueb, desktop, android, Iphone, në mënyrë që të ketë qasje masive nga të gjithë përdoruesit.

Kontrolluesi drejtshkrimor

Kontrolluesi drejtshkrimor është një mjet thelbësor dhe shumë i rëndësishëm. Ai mund të jetë i integruar në programet e përpunimit të fjalës ose në faqet e uebit, në Cloud dhe në aplikacionet për telefonat inteligjentë.

Përdorimi i këtij softueri është i lehtë dhe kalimi nga kontrolluesi i një gjuhe në atë të një gjuhe tjetër është mjaft i thjeshtë dhe nuk merr kohë (mjafton të jenë të instaluar në pajisje).

Softueri i korrektorit drejtshkrimor është i lidhur ngushtësisht me softuerin e morfologjisë. Nëse përgatitet softueri i morfologjisë që ka në përbërje të tij të gjitha fjalëformat e një gjuhe, ai mund të shërbejë si bazë të dhënash për korrektorin drejtshkrimor. Korrektori drejtshkrimor përdor listën e fjalëformave e cila shërben si referencë për verifikimin e mënyrës së të shkruarit nga përdoruesit. Ai shënon me një ngjyrë të parazgjedhur fjalët e shkruara gabim të cilat nuk përputhen me asnjë nga fjalët e listës së fjalëformave dhe u propozon

përdoruesve disa fjalë opsionale të sakta si zëvendësues të fjalës së pasaktë. Nëse fjala nuk gjendet në fjalor, ajo nuk është e shkruar mirë dhe algoritmet funksionojnë për të gjetur fjalën që, sipas gjasave, përdoruesi donte të shkruante. Ndryshimi midis dy vargjeve jepet me numrin minimal të operacioneve që nevojiten për të transformuar një varg në një tjetër, atje ku operacioni është një futje, heqje ose zëvendësim. Kjo distancë është e nevojshme për të përcaktuar ngjashmërinë midis dy vargjeve.

Softueri i drejtshkrimit, jo vetëm nënvizon me ngjyrë të parazgjedhur fjalët e shkruara gabim dhe bën korrigjimin automatik për shumë fjalë e trajta fjalësh, por ofron dhe mundësinë që përdoruesi të krijojë në kompjuterin e tij një fjalor të përshtatur me fjalët që nuk janë në program, por që ai i përdor shpesh (të cilat mund të jenë terma të fushave të veçanta, emra njerëzish ose vendesh, si dhe shkurtime të ndryshme).

Softueri përmirësohet dhe përditësohet hera herës si nga ana teknike, edhe nga ana gjuhësore, me të cilën kuptohet: 1) shtimi i fjalëve të reja që mungojnë; 2) çaktivizimi i fjalëve të vjetra, të cilat pothuajse nuk përdoren; 3) shtimi i një numri termash bazë nga fusha të ndryshme të dijës etj. Ai pasurohet herë pas here me fjalë të reja që hyjnë në përdorim. Gjithashtu programi përmirësohet edhe në aspektin programues: punohet rregullisht për t'i ofruar përdoruesit korrigjimin automatik të gabimeve të ndeshura më shpesh, për t'i ofruar sugjerimet përkatëse varianteve të shkruara gabim etj.

Lokalizimi i softuerëve më të përdorshëm

Projekti i lokalizimit të softuerëve kompjuterikë në gjuhën vendase është i një rëndësie të veçantë. Të kesh mundësinë për të përdorur softuerët në gjuhën tënde është një shenjë prestigji që tregon se mund të përdorësh gjuhën tënde në mënyrë digjitale, por ka gjithashtu vlerë të madhe, pasi mund të inkurajojë përdoruesit të zgjedhin gjuhën e tyre të komunitetit si gjuhë për komunikim dhe punë. Nëse asnjë softuer nuk është i lokalizuar, mund të fillojë puna për lokalizimin e sistemeve operative më të përdorshme, të shfletuesve të uebit dhe të softuerëve të tjerë që kanë përdorim më masiv. Për disa nga këto punë duhet bashkëpunim më i gjerë, ndërsa për disa të tjera mund të punohet në mënyrë

vullnetare duke kontribuar në lokalizimin dhe në përkthimin e teksteve në gjuhën e minoritetit. P.sh. Google Translate të ofron mundësinë që të përkthesh ose të redaktosh dhe të përmirësosh përkthimet e kryera nga një gjuhë në një gjuhë tjetër.

Strategji të tjera alternative mund të jenë të përshtatshme duke u fokusuar fillimisht në aplikacionet më të vogla dhe më të afërta të përdoruesve për të krijuar një komunitet të ri lokalizimi. Mund të fillohet një përpjekje e komunitetit për të lokalizuar softuerët me përdorim të lirë, me qëllim që të shfrytëzohen më së shumti në komunitetin gjuhësor.

Për të arritur efikasitetin më të madh dhe për të përqendruar përpjekjet në lokalizimin e softuerit më të përdorur, është e rëndësishme të njihen nevojat dhe kërkesat e përdoruesve të gjuhëve minoritare, si dhe të mësohet nga rruga e ndjekur për lokalizimet ekzistuese të gjuhëve të tjera. Këtu duhen pasur parasysh dhe përvojat e gjuhëve të pakicave nga vende jashtë Ballkanit, si dhe kostoja e madhe financiare që kanë këto lokalizime. Ndoshta prioritet mund t'u jepet pakicave të një gjuhe që është zyrtare në një vend tjetër ose gjuhëve që kanë një traditë shkrimi.

Cilësia e përkthimit dhe fakti nëse është i përfunduar dhe i përputhshëm me versionet më të reja të aplikacioneve ose sistemeve operative janë faktorë që ndikojnë në vendimin e përdoruesve për të zgjedhur versionin e softuerit në gjuhën e tyre.

Lokalizimi nuk është thjesht përkthim fjalë për fjalë, por përshtatje si e përmbajtjes (tekstit e stilit), ashtu edhe e komponentëve teknikë e grafikë të një produkti ekzistues në përputhje me karakteristikat gjuhësore dhe kulturore të rajonit të cilit i drejtohet. Ky proces është i gjatë e i vështirë dhe kërkon bashkëpunim midis ekspertëve teknikë dhe atyre gjuhësorë.

Lokalizimi është një proces kompleks dhe arritja e cilësisë së dëshiruar realizohet falë përmbylljes me sukses të disa fazave, ndër të cilat më të rëndësishmet janë:

- Udhëzuesi i stilit (Style Guide)
- Polycheck
- Glossary (Fjalor)

Duhet vënë në dukje që përveç këtyre etapave paraprake, një rol të rëndësishëm në rritjen e cilësisë së lokalizimit luan dhe përdorimi i programeve të posaçme për lokalizim, si *LocStudio*, *Trados* etj., të cilët bëjnë të mundur që të përftohet një lokalizim i njësuar jo vetëm për terma të caktuar, por edhe për paragrafë të gjatë që përsëriten herë pas here, duke ruajtur kështu të njëjtin stil gjatë gjithë lokalizimit.

Një mundësi shumë e mirë është dhe nisma për titrimin e filmave dhe videove në gjuhën vendase duke shfrytëzuar punën e vullnetarëve për përkthimin e titrave. Falë kësaj pune kolektive u krijohet mundësia përdoruesve të gjuhës të shikojnë filmat në versionin e tyre origjinal me titra në gjuhën e tyre. Po ashtu, mund të punohet për titrimin në gjuhë me përhapje të madhe të veprave origjinale të prodhuara në gjuhën e pakicave.

Si përfundim, mund të themi se Gadishulli i Ballkanit karakterizohet nga një larmi dhe pasuri gjuhësore. Në vendet e tij përdoren rreth 20 gjuhë pakicash, disa prej të cilave konsiderohen si të tilla në disa shtete. Këto gjuhë pakicash në vende specifike kanë statuse të ndryshme njohjesh, përdorimesh dhe mbështetjesh digjitale. Pavarësisht nga nivelet e ndryshme të digjitalizimit të tyre, propozimet e përmendura më sipër, si dhe ide të tjera që mund të merren si model prej gjuhëve kryesore, por edhe gjuhëve minoritare në vende jashtë Ballkanit, janë shumë të rëndësishme për shfrytëzimin e teknologjisë në dobi të ruajtjes, të përdorimit dhe të përcjelljes së gjuhës së pakicave në Ballkan, duke shërbyer në këtë mënyrë dhe në forcimin e diversitetit gjuhësor.

Bibliografi

Baldwin, C., *Minority Rights in Kosovo under International Rule*, A4, 40pp, ISBN 1 904584 46 2.

Çepani, A., “Lokalizimi i versioneve të MS Windows-it e MS Office-it dhe “Fjalori i termave të informatikës”, *Gjuha shqipe*, 1, Prishtinë, 2014.

Çepani, A.; Çerpja, A., “Globale Entwicklungen der Computerterminologie. Das Albanische im Vergleich”. in- *The Potentiality of Pluricentrism. Albanian Case Studies and Beyond*. Albanische Forschungen, Band 41. Edited by Lumnije Jusufi. Harrassowitz Verlag. Wiesbaden. ISSN 0568-8957. ISBN 978-3-447-11160-7, 2018, f. 185-198.

- Çepani, A.; Çerpja, A., *Hyrje në gjuhësinë kompjuterike* (tekst universitar), Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i gjuhës shqipe, Botime “Albas”, Tiranë, ISBN 978-9928-02-833-4, 2017, 232 f.
- Çerpja, A., “Drejt një korigjuesi sintaksor në gjuhën shqipe”, *Seminari XXVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 2008, f. 383-398.
- Çerpja, A., “Drejtshkrimori i shqipes – përmirësimi dhe plotësimi i tij”. *Akademia jubilarë me rastin e 40-vjetorit të Kongresit të drejtshkrimit*, Universiteti “Fan S. Noli”, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë, Korçë, 2015, f. 129-134.
- Çerpja, A.; Çepani, A., “Computer Terminology in Albanian versus Other Languages and the Benefits of Its Codifications”, *Journal of Education and Practice*, International Institute for Science, Technology & Education. Vol. 5. No. 11. 2014. ISSN (Paper) 2222-1735 ISSN (Online) 2222-288X.
- D. Crystal, *Language death*. Cambridge: Cambridge University Press. 2000, f. 130–141.
- Friedman A., Victor, *Languages of the Balkans*, publikuar ‘online në 29.03.2017, <https://doi.org/10.1093/acrefore/9780199384655.013.348>
<https://minorityrights.org/directory/>
[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/etudes/join/2000/289662/DG-4-JOIN_ET\(2000\)289662_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/etudes/join/2000/289662/DG-4-JOIN_ET(2000)289662_EN.pdf), f. 6
https://www.minoritetet.gov.al/?page_id=9
- Ligji nr. 03/l-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2531>)
- Ligji nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” (<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2018/05/1524738824-Ligji-Per-Mbrojtjen-e-Pakicave-Kombetare-ne-R.Sh-2017.pdf>)
- Minority-language related broadcasting and legislation in the Osce*, Institute for Information Law (IViR), Universiteit van Amsterdam Study

commissioned by the OSCE High Commissioner on National Minorities
April 2003 (<https://www.osce.org/files/f/documents/3/1/78058.pdf>)

The Digital Language Diversity Project, Erasmus+ Programme | Grant
Agreement No. 2015-1-IT02-KA204-015090.

PROF. AS. DR. KLEDI SHEGANI

FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

kshegani@yahoo.com

**POLITIKAT NË ARSIM QË LEHTËSOJNË MËSIMIN E GJUHËS
AMTARE TE FËMIJËT E EMIGRANTËVE TË KTHYER NË ATDHE**

Abstrakt

Sistemi arsimor, ashtu si çdo sistem tjetër organizohet dhe funksionon nëpërmjet ligjeve, akteve nënligjore, vendimeve, udhëzimeve e nëpërmjet dispozitave normative, që janë mekanizma që vënë në lëvizje çdo ndryshore të këtij sistemi. Kontekste të caktuara shoqërore, të tilla, si: lëvizjet demografike, rikthimi i emigrantëve në vend, martesat me të huaj e plot të tjera si këto na përballin me kontekste gjuhësore që kërkojnë hapësira të reja ligjore për hartimin e politikave në arsim që lehtësojnë mësimin e gjuhës amtare nga fëmijët bilingë.

Duke pasur parasysh që ligji mbron dhe zhvillon vlerat kombëtare, respekton e mbron të drejtat dhe liritë e individit, mbështet pakicat kombëtare, në përputhje me të gjitha konventat evropiane për pakicat kombëtare, duhen vënë në funksion mekanizmat që lehtësojnë mësimin e gjuhës amtare te fëmijët bilingë, fëmijët e emigrantëve shqiptarë të kthyer në atdhe, pas vitesh në emigracion.

Programi i integruar i mësimi shqip në diasporën shqiptare synon që nxënësit të mbajnë gjallë gjuhën shqipe dhe vetëdijen e përkatësisë etnike dhe të origjinës shqiptare në vend të huaj. Pikërisht në këtë linjë duhet të orientohen dhe politikat për fëmijët e emigrantëve që kthehen në atdhe që ta kenë të lehtë kthimin në atdheun e origjinës dhe integrimin në shoqërinë e sotme shqiptare.

Fjalët kyçe: politika; gjuhë amtare; fëmijë bilingë; mekanizma; diasporë shqiptare

Sistemi arsimor, ashtu si çdo sistem tjetër organizohet dhe funksionon nëpërmjet ligjeve, akteve nënligjore, vendimeve, udhëzimeve, dispozitave normative që janë mekanizma që vënë në lëvizje çdo ndryshore të këtij sistemi.

Kontekste të caktuara shoqërore, të tilla si lëvizjet demografike, rikthimi i emigrantëve në vend, martesat me të huaj e plot të tjera si këto na përballin me kontekste gjuhësore që kërkojnë hapësira të reja ligjore për hartimin e politikave në arsim që lehtësojnë mësimin e gjuhës amtare nga fëmijët bilingë.

Duke pasur parasysh që ligji mbron dhe zhvillon vlerat kombëtare, respekton e mbron të drejtat dhe liritë e individit, mbështet pakicat kombëtare, në përputhje

me të gjitha konventat evropiane për pakicat kombëtare, duhen vënë në funksion mekanizmat që lehtësojnë mësimin e gjuhës amtare te fëmijët bilingë, fëmijët e emigrantëve shqiptarë të kthyer në atdhe, pas vitesh në emigracion.

Programi i integruar i mëimit shqip në diasporën shqiptare synon që nxënësit të mbajnë gjallë gjuhën shqipe dhe vetëdijen e përkatësisë etnike dhe të origjinës shqiptare në vend të huaj. Pikërisht në këtë linjë duhet të orientohen dhe politikat për fëmijët e emigrantëve që kthehen në atdhe që ta kenë të lehtë kthimin në atdheun e origjinës dhe integrimin në shoqërinë e sotme shqiptare.

Është fakt që çdo komb përfaqësohet me identitetin e vet kombëtar, i cili në thelb është një identitet kulturor dhe qytetar, që përbëhet nga gjuha, trashëgimia historike, kultura popullore, tradita e jetesës.

Në kushtet e sotme kur plurilinguizmi duket se është një realitet shumë i prekshëm në mjediset tona është me interes të studiohen disa elemente gjuhësore, të cilat bëjnë të mundur analizën e vetëdijes gjuhësore të folësit në bashkësinë gjuhësore. Kjo analizë në fakt duhet të realizohet në kontekste të caktuara që mund t'i përmbledhim për lehtësi studimi në: kontekste familjare, shkollore dhe shoqërore, kjo edhe për analogji me hipotezën e Fishmanit lidhur me dygjuhësinë e hershme, sipas së cilës tri janë fushat në të cilat duhet të studiohet kjo dukuri: familja, bashkëmoshatarët (peer group) dhe shkolla.¹

Sistemi arsimor, ashtu si çdo sistem tjetër organizohet dhe funksionon nëpërmjet ligjeve, akteve nënligjore, vendimeve, udhëzimeve, dispozitave normative që janë mekanizma që vënë në lëvizje çdo ndryshore të këtij sistemi.

Kontekste të caktuara shoqërore, të tilla si lëvizjet demografike, rikthimi i emigrantëve në vend, martesat me të huaj e plot të tjera si këto na përballin me kontekste gjuhësore që kërkojnë hapësira të reja ligjore për hartimin e politikave në arsim që lehtësojnë mësimin e gjuhës amtare nga fëmijët shqiptarë të kthyer në atdhe nga jashtë vendit.

Duke pasur parasysh që ligji mbron dhe zhvillon vlerat kombëtare, respekton e mbron të drejtat dhe liritë e individit, mbështet pakicat kombëtare, në përputhje me të gjitha konventat evropiane për pakicat kombëtare, duhen vënë në funksion mekanizmat që lehtësojnë mësimin e gjuhës amtare nga këta fëmijë, të kthyer në

¹ Fishman J., (1965) Who speaks, what language, to whom and when, "La linguistique"²

atdhe, pas vitesh në emigracion, një dukuri kjo jo aq e panjohur në këto vitet e fundit për shtetin shqiptar.

Nga njëra anë, është punuar fort dhe është përcaktuar mirë ligjërisht programi i mësimit të shqipes në diasporë, nëpërmjet të cilit synohet që nxënësit të mbajnë gjallë gjuhën shqipe dhe vetëdijen e përkatësisë etnike dhe të origjinës shqiptare në vend të huaj. “Kultura shqiptare, qoftë e diasporës më të hershme të Greqisë e të Italisë, qoftë e asaj më të re tashmë kudo nëpër Europë, Amerikë, Kanada është një element përbërës i bashkësive të sotme plurikulturore dhe nuk mund të mos i shfaqë edhe gjurmët e veta, duke dalë kështu, si ndihmesë e diasporës shqiptare në pasurimin kulturor e shpirtëror të vendeve e popujve në gji të të cilëve janë integruar”².

Binomi: “*Gjuha e bukës*“ dhe “*gjuha e zemrës*” duket se ka shoqëruar jetën e shqiptarëve kudo që jetojnë dhe ka krijuar një klimë të përshtatshme për bashkëjetesë të shkëlqyer në të gjitha fushat. Në mbështetje të kësaj ideje është punuar dhe janë ravijëzuar qartë piketat për mbarëvajtjen e mësimit të shqipes në diasporë. Pikërisht, në këtë linjë duhet të orientohen edhe politikat për fëmijët e emigrantëve që kthehen në atdhe, që jo vetëm ta kenë më të lehtë kthimin në atdheun e origjinës, por edhe integrimin në shoqërinë shqiptare dhe marrjen pa vështirësinë e gjuhës të roleve të ndryshme individuale, organizative apo edhe drejtuese.

Organet kompetente si Ministria e Arsimit apo edhe ente të tjera përgjegjëse, në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë dhe institucione të tjera shtetërore, mbështesin zbatimin e programeve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët e diasporës, në përputhje me legjislacionin shqiptar³.

Ky program⁴ synon që nxënësit:

² K.Shegani, M. Koçi, Mësimi i shqipes në Suedi përmes kompetencës gjuhësore dhe ndërkulturore.

³ A.Tahiri, K.Shegani, Politikat në arsim dhe fuqia e gjuhës, OMSCA, Tirane, 2018, f.35.

⁴ Ligji nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”...dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, i azhurnuar me: Ligjin Nr. 56, datë 28.05.2015.

- të mbajnë gjallë gjuhën shqipe dhe vetëdijen e përkatësisë etnike dhe të origjinës shqiptare në vend të huaj;
- ta ndiejnë veten krenarë për identitetin kombëtar shqiptar dhe ta ushqejnë e ta ruajnë edhe më tej atë, nëpërmjet mësimit të gjuhës amtare, si dhe me anë të njohjes së trashëgimisë kulturore, natyrore e historike të shqiptarëve, si pjesë përbërëse e qytetërimit evropian e botëror;
- të ushtrojnë e të pasurojnë shprehitë ligjërimore në gjuhën shqipe (me shkrim e me gojë) në të gjitha mjediset dhe rrethanat e mundshme të komunikimit;
- të ndërgjegjësohen se gjuha shqipe dhe kultura shqiptare jo vetëm nuk i pengon, por edhe ua lehtëson integrimin në shoqërinë ku jetojnë, sepse sot Evropa dhe mbarë bota po orientohen nga bashkëjetesa, shumë gjuhësia dhe shumë kulturësia;
- të mbajnë gjallë dituritë dhe njohjen e shqipes e të kulturës shqiptare, mundësisht edhe t'i shtojnë ato, me qëllim që, nëse u krijohen kushtet dhe mundësitë e nevojshme, eventualisht ta kenë të lehtë kthimin në atdheun e origjinës dhe integrimin në shoqërinë e sotme shqiptare.

Arsimimi për fëmijët shqiptarë jashtë vendit mbështetet në baza ligjore *neni 11 i ligjit 69/2012 dhe Kushtetuta* e RSH-së. Linjat integruese janë: identiteti shqiptar; shqiptarët në hapësirë dhe në kohë; kultura dhe shoqëria. Zhvillohet 60% gjuhë dhe letërsi; 40% histori, gjeografi, kulturë dhe identitet.

Për të formuluar një përkufizim të përdorshëm të identitetit shqiptar, thotë studiuesi A.Vehbiu⁵ në fillim duhet bërë dallimi midis identitetit sinkronik ose horizontal, ose vetëdijes së pandërmjetme, intuitive, që kemi të gjithë se jemi “shqiptarë”; dhe identitetit diakronik ose vertikal, i cili përcillet brez pas brezi, në histori. Identiteti horizontal **komunikohet**, identiteti vertikal **transmetohet**.

Besojmë se me këto linja integruese është gati edhe modeli për të vendosur në korniza ligjore mësimin e shqipes për fëmijët e emigrantëve të kthyer në atdhe. Në fakt, kjo lidhet me shansin, që i duhet dhënë çdo fëmije për të drejtën e arsimimit, ndihmën për të kaluar barrierat psikologjike dhe ato gjuhësore në mënyrë që të krijohet një klimë sa më miqësore dhe në këtë pikë është shkolla

⁵A.Vehbiu, Identiteti shqiptar, Peizazhe të fjalës, Tiranë, 2009.

ajo që ka misionin kryesor dhe të pazëvendësueshëm, natyrisht e mirëmbështetur nga korniza ligjore në përballjen me sfidat që deri më tash ata kanë kaluar.

Shkolla në fakt ka ndikim të fuqishëm mbi formacionin gjuhësor të fëmijëve, sepse krijon një kontekst të ri, në të cilin zhvillohen përdorime të reja të gjuhës. “Çdo nxënës është në fakt, bashkautor i procesit të tij formues dhe shkolla luan rolin e katalizatorit të ndikimeve gjuhësore mbi kompetencën komunikative edhe të dygjuhësisë së hershme, duke u kushtëzuar natyrisht edhe nga ndryshore socio-kulturore, të cilat, padyshim, me vlerën e tyre ndikojnë në formatimin e aftësisë së fëmijës”⁶.

Në varësi të qëllimit të këtij punimi mendojmë se dy janë problemet më kryesore, me të cilat përballen sot fëmijët e emigrantëve që kthehen në atdhe: vështirësia në komunikimin në gjuhën shqipe, si dhe përshtatja e tyre me mjedisin në shkollat shqiptare.

Sipas shumë materialeve të shfrytëzuara për këtë vështrim tonin na ka rezultuar që është shumë e dobishme që fëmijët e riatdhesuar të regjistrohen menjëherë në shkollë dhe ta ndjekin atë rregullisht, ku vëmendje e posaçme u duhet kushtuar fëmijëve nga komunitetet e pakicave. Fëmijëve u duhet ofruar një vend në shkollë, mangësitë në dokumentet e tyre zyrtare, nuk duhet të bëhen pengesë. Disa fëmijë vijnë nga vende, ku sistemi arsimor është i ndryshëm nga ai i vendit tonë, si nga pikëpamja e organizimit, metodave të mësimdhënies, programeve dhe kurrikulave mësimore që nxënësi i ka mësuar në vendin e migrimit mund të ketë qenë ndryshe nga ajo në shkollën ku do ndjekë mësimin në Shqipëri. Me pak fjalë, formimi gjuhësor i këtyre fëmijëve mund të jetë i

ndryshëm, në varësi nga vendi ku kanë jetuar dhe janë shkolluar deri në momentin që janë rikthyer në atdhe. Disa kanë pasur pak ose aspak kontakt me gjuhën shqipe. Disa mund të kenë marrë pak ose aspak arsim të mëparshëm dhe mund të mos dinë të lexojnë as në gjuhën e tyre. Që të dyja këto probleme, realisht vazhdojnë të mos kenë një zgjidhje të plotë, të mbështetur nga pikëpamja ligjore.

Disa praktika janë konsideruar si të efektshme për të ndihmuar fëmijën të mësojë nga bisedat me mësues në shkolla të ndryshme të vendit.

⁶ Satka, K. *Gjuha e fëmijëve përballë informacionit global*, Seminari XXVII Nderkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, f. 305.

Edukimi ndërkulturor i shtrirë në gjithë kurrikulën duhet të jetë elementi kryesor i punës së mësuesve si për procesin mësimor, ashtu edhe për aktivitete shkollore me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi rreth diversitetit kulturor. Përveç kësaj, kurrikulës bazë mund t'i shtohen projekte të vogla dhe në këtë pikë, orët e arteve, historisë dhe gjuhës ofrojnë shumë mundësi për të zhvilluar kompetencat e tyre qytetare dhe aftësitë e të folurit dhe dëgjimit nëpërmjet dramatizimeve dhe debateve mbi temat përkatëse, nëpërmjet prezantimit të informacionit dhe negocimit.

Spektori i arsimit, pavarësisht hapave që ka ndërmarrë për lehtësimin e procesit të riintegrit të fëmijëve të kthyer, përballet me disa vështirësi, të cilat kanë nevojë për t'u adresuar urgjentisht, si: mungesa e udhëzimeve apo e trajnimeve për të aplikuar në mënyrë efikase planet mësimore individuale, mungesa e stafit të shtuar për të bërë të mundur zbatimin e këtyre planeve, shërbimi i pamjaftueshëm psiko-social.

Bashkëpunimi i shkollës me komunitetin e prindërve, klasën ku nxënësi vazhdon, qeverinë e nxënësve duhet bërë i mundur me synim bashkëpunimin e të gjithëve duke krijuar para së gjithash një klimë pozitive emocionale, të cilën ta përdorin në funksion të riintegrit të kësaj kategorie. Edhe realizimi i orëve shtesë në fundjavë apo gjatë pushimeve me plane të veçanta sipas nevojave të fëmijëve të kthyer, mund të rezultojë më efikase se dhënia e detyrave shtesë në lehtësimin e procesit të riintegrit të këtyre fëmijëve.

Aplikimi i planit individual mësimor për të ndihmuar nxënësit e kthyer të mbushin boshllëqet e lindura për shkak të shkëputjes nga shkolla për një periudhë kohe.

Spektori i arsimit, pavarësisht hapave konkrete që ka marrë për lehtësimin e procesit të riintegrit të fëmijëve të kthyer, përballet me disa vështirësi, të cilat kanë nevojë për t'u adresuar dhe zgjidhur sa më parë për ta kornizuar ligjërisht si: mungesa e udhëzimeve apo trajnimeve për të aplikuar në mënyrë efikase planet mësimore individuale, mungesa e stafit të shtuar për të bërë të mundur zbatimin e këtyre planeve, shërbimi i pamjaftueshëm psiko-social. Klima pozitive emocionale, realizimi i orëve shtesë në fundjavë apo gjatë pushimeve me plane të veçanta, sipas nevojave të fëmijëve të kthyer, mund të rezultojë më efikase

Si përfundim, për hartimin e politikave frutdhënëse në arsimimin e fëmijëve të emigrantëve shqiptarë sugjerojmë se duhen që organet kompetente:

- të kornizojnë ligjërisht të gjitha përpjekjet e mësuesve dhe kontributin e tyre për mbarëvajtjen e mësimit të shqipes për fëmijët e emigrantëve të kthyer në atdhe
- të identifikojnë tipologjitë e modeleve mësimore që duhen ofruar
- jo vetëm të eksplorojnë situatën e krijuar, por edhe të paraqesin kurrikulën konkrete që garanton integrimin dhe përshtatjen pa problem të fëmijëve bilingë që janë kthyer në vendin e tyre.
- duke vlerësuar impaktin e mekanizmit të riintegrimin në jetën e emigrantëve të kthyer, duke marrë në analizë përvojat e tyre dhe duke e vënë theksin te nevoja për përmirësim të mëtejshëm të këtij mekanizmi të përmirësohet dhe të plotësohet më së miri kurrikula për arsimimin e tyre, e cila duhet të jetë në sinkron me atë të mësimit të shqipes në diasporë.
- të përmirësojnë punën për hartimin e politikave arsimore, e cila mund të vazhdohet me hapjen e shkollave verore për mësimin e gjuhës shqipe për fëmijët e emigrantëve, që kthehen në Shqipëri.

Është mësuesi, i cili me profesionalizëm të lartë e me përkushtim në punë, i jep jetë legjisllacionit në arsim nëpërmjet kreativitetit dhe përkushtimit të tij.

Le të bëjmë maksimumin për t'i ndihmuar mësuesit në misionin e tyre fisnik. Është momenti i duhur për shqipen dhe misionarët e saj anekënd globit.

PROF. AS. DR. MIMOZA ZEKAJ

**FAKULTETI I EDUKIMIT DHE I SHKENCAVE SHOQËRORE
UNIVERSITETI “EQEREM ÇABEJ” GJIROKASTËR**

mimoza_zekaj@yahoo.com

**VËSHTRIM MBI FORMIMIN DYGJUHËSOR TË NXËNËSVE
MINORITARË NË QARKUN E GJIROKASTRËS DHE ROLI I
SHKOLLËS**

Qeveritë shqiptare, për arsimimin e minoritetit grek, në etapa të caktuara historike, kanë përpunuar politikat e tyre arsimore, të cilat nuk kanë qenë konstante. Shqipja dhe greqishtja janë trajtuar si gjuhë kontakti, njëlloj të përdorura, të lejuara, të njohura dhe të përkrahura.

Gjithmonë janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të garantuar më mirë të drejtat arsimore, kulturore e shpirtërore të kësaj popullsie, duke synuar zhvillimin e identitetit dhe forcimin e mundësive integruese të minoritarëve në jetën politike-shoqërore të shoqërisë shqiptare. Kjo duket qartë në disa aspekte të cilat i kemi bërë objekt të punimit tonë.

Politika arsimore shtetërore ka mbajtur parasysh parimet dhe standardet e parashikuara në “Kartën evropiane mbi gjuhët rajonale dhe të pakicave” (1988), miratuar nga Këshilli i Evropës, si dhe dokumente të tjera ndërkombëtare të OKB-së, të BE-së në këtë fushë. Këto parime kanë udhëhequr hartimin e dokumentacionit ligjor mbi të cilin mbështetet politika zyrtare e arsimimit të fëmijëve minoritarë

Në këtë proces shkolla është një nga faktorët themelorë që e ndihmon nxënësin të bëjë pronë të tij eksperiencën mësimore, të zhvillohet si person me potencial të plotë. Shkolla e ndihmon nxënësin minoritar të kapërcejë shumë dukuri komplekse.

Programet dhe tekstet mësimore vitet e fundit janë përfshirë nga ndryshime të shumta, duke u afruar me standardet e përparuara të vendeve perëndimore. Raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor përcaktohen me akte të veçanta nga Ministria.

Në ecurinë e mirë të këtij procesi i kushtohet një vëmendje e veçantë përgatitjes dhe rolit të mësuesit, si potencial ndikues në mbarëvajtjen e formimit dygjuhësor të nxënësve në këto shkolla.

Politikat gjuhësore të shtetit shqiptar janë në funksion të forcimit të bashkëjetesës qytetare të të dy nacionaliteteve.

Fjalët kyçe: minoritet, dygjuhësor, bashkëjetesë, shkollë, mësues, formim.

Shteti shqiptar, pavarësisht nga uljet dhe ngritjet e politikës, ka treguar qëndrim korrekt e parimor për çështjen e mësimit të gjuhës amtare nga pakica

greke. Qeveritë shqiptare, për arsimimin e minoritetit grek, në etapa të caktuara historike, sipas kushteve politike, kanë përpunuar politikat e tyre arsimore, të cilat nuk kanë qenë konstante, kanë ndryshuar¹. Nga qeveritë shqiptare të të gjitha kohërave shqipja dhe greqishtja janë trajtuar si gjuhë kontakti, njëlloj të përdorura, të lejuara, të njohura dhe të përkrahura.

Janë garantuar gjithnjë e më mirë të drejtat arsimore, kulturore e shpirtërore të kësaj popullsie, duke synuar zhvillimin e identitetit dhe forcimin e mundësive integruese të minoritarëve në jetën politike-shoqërore të shoqërisë shqiptare. Kjo duket qartë në disa aspekte të cilat i kemi bërë objekt të kumtimit tonë.

1. Politika arsimore shtetërore ka mbajtur parasysh parimet dhe standardet e parashikuara në “Kartën evropiane mbi gjuhët rajonale dhe të pakicave” (1988), miratuar nga Këshilli i Evropës, si dhe dokumente të tjera ndërkombëtare të OKB-së, të BE-së në këtë fushë etj². Këto parime kanë udhëhequr hartimin e dokumentacionit ligjor mbi të cilin mbështetet politika zyrtare e arsimimit të fëmijëve minoritarë, si: ligji “Mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, miratuar në prill 1993, sipas të cilit: “...personat që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të shprehin, ruajnë dhe zhvillojnë lirisht identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar, gjuhësor, të mësojnë e të mësohen në gjuhën e tyre...”. Ka gjetur shprehje të plotë në ligjin “Për sistemin Arsimor Parauniversitar”, si dhe në një sërë udhëzimesh të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve³”.

2. Në këtë proces shkolla mbetet një nga faktorët themelorë që e ndihmon nxënësin të bëjë pronë të tij eksperiencën mësimore, të zhvillohet si person me potencial të plotë. Shkolla është një vatër e rëndësishme që e ndihmon nxënësin minoritar të kapërcejë shumë dukuri komplekse. Një dukuri e tillë është ndërrimi i kodeve me degëzimet sociologjike e psikologjike, e cila ka të bëjë me zgjedhjen prej folësve të gjuhës që di më mirë. Duke parë nga afër procesin e mësimdhënies në shkollat e minoritetit, ku shqipja mësohet krahas gjuhës amtare, vëmë re se shkolla e realizon këtë proces, pra mësimin e shqipes, duke e rritur shkallën e

¹ V. Terpo, *Arsimimi dygjuhësor në shkollat e pakicave greke*, në “Kërkime universitare”, nr. 5, 2001, f. 8.

² R. Memushaj, *Vështrim mbi dygjuhësishtë në Shqipëri*, në SA., nr. 2, 1997, f. 102.

³ V. Bici, *vepër e cituar*, f. 18.

vështirësive sipas viteve të shkollimit. Të mësuarit e shqipes si gjuhë e huaj, pastaj si gjuhë e dytë e më tej si gjuhë zyrtare, vjen gradualisht nga klasa në klasë deri në arritjen e njëjtësimi potencial, duke u bashkëshoqëruar nga dukuri tipike që lidhen me një mësimdhënie specifike e të menduar mirë⁴. Shkolla me programet, tekstet, me përkushtimin e mësuesve, me politikat gjuhësore frytdhënëse, deri diku, i ndërgjegjëson dhe i motivon për domosdoshmërinë edhe të mësimit të gjuhës shqipe. Megjithatë, shqipja e këtyre nxënësve ka një lloj strukture, rendi, ritmi e theksi me ndikim nga greqishtja.

3. Programet dhe tekstet mësimore vitet e fundit janë përfshirë nga ndryshime të shumta, duke u afruar me standardet e përparuara të vendeve perëndimore. Raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor përcaktohen me akte të veçanta nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve. Sipas drejtuesve të arsimit, të specialistëve, të mësuesve që merren drejtpërdrejt me këtë proces, si dhe nga vëzhgimet e bëra në këto shkolla, vëmë re se ky raport plotëson dhe garanton formimin dygjuhësor të fëmijëve minoritarë për arsimimin e mëtejshëm të tyre. Në zhvillimin e lëndëve ka një shpërndarje të tillë: në ciklin fillor të gjitha lëndët zhvillohen në gjuhën amtare dhe vetëm lënda “Gjuhë shqipe” zhvillohet në gjuhën shqipe. Në ciklin e mesëm të ulët një pjesë e konsiderueshme e lëndëve, si: Gjuha shqipe, Matematika, Fizika, Kimia, Biologjia, Informatika, Historia dhe Gjeografia e Shqipërisë zhvillohen në gjuhën shqipe. Lëndët si: Historia, Gjeografia, Edukata, Vizatimi, Edukata muzikore zhvillohen në gjuhën amtare. Në klasën e tetë zhvillohet edhe lënda “Gjeografia e Greqisë” dhe në klasën e nëntë zhvillohet lënda “Historia e Greqisë”. Nga klasa I – IX në arsimin bazë të pakicave kombëtare punohet me programe mësimore të sistemit të ri arsimor 9-vjeçar, por me një përndarje të tillë:

Në klasën e parë⁵ një pjesë e fëmijëve shkon me ato njohuri që ka në gjuhën amtare dhe njohuritë për gjuhën shqipe, thuhetse mungojnë, pra, shkon në klasën e parë monoling. Një pjesë e vogël e fëmijëve shkon me pak njohuri në gjuhën

⁴ Po aty, f. 131.

⁵ Të gjitha materialet e paraqitura mbi hartimin e programeve dhe strukturimin e tyre për ciklin fillor dhe atë 9-vjeçar, i kemi marrë nga programet e detajuara të mësuesve të “Gjuhës shqipe”, në shkollën fillore dhe 9-vjeçare, që ka në profilin e saj mësimin e nxënësve minoritarë, në qytetin e Gjirokastrës, shtator, 2021.

shqipe që mund t'i ketë përfituar nga raste të veçanta të takimit me gjuhën shqipe. Një pjesë e nxënësve kontaktin me shqipen e fillon në javën e parë të shkollës, fillimisht, nëpërmjet ushtrimit gojor, duke u përdorur fjalë të përdorimit të përditshëm, fjalë përshëndetëse dhe më vonë aftësimin të mëtejshëm me shkrimin. Bëhet gradualisht përkthimi i fjalëve të librit të Abetares, nga gjuha shqipe në gjuhën greke. Për ta trealizuar sa më mirë këtë proces, përdoren tekstet “Abetare” dhe “Abetare pune”⁶. Me anë e tyre vendosen lidhjet dhe vazhdimësia e fëmijëve minoritarë me gjuhën shqipe. Nxënësit marrin disa njohuri fillestare për tingujt e shqipes, për shqiptimin e fjalëve, për shqiptimin e disa shprehjeve e strukturave të thjeshta të përdorimit të përditshëm. Ushtrohen të japin përgjigje, të bëjnë pyetje, të bashkëbisedojnë me njëri-tjetrin rreth gjërave të njohura të veprimtarisë së përditshme. I kushtohet vëmendje e veçantë përparimit në të dyja linjat kryesore të gjuhës: në gjuhën e folur dhe në gjuhën e shkruar. Te nxënësit vihen re disa vështirësi në shqiptimin e disa tingujve zanorë, si; /e/, /y/, të bashkëtingëlloreve /ll/, /sh/, si dhe të disa fjalëve që kanë në përbërje disa grupe bashkëtingëlloresh. Vëmendje i kushtohet dhe drejtshkrimit të shkronjave, rrokjeve, fjalëve, duke arritur deri në shkrimin e fjalive.

Në klasën e dytë mësimi i gjuhës shqipe zhvillohet me tekstin “Gjuha shqipe 2”⁷ (si në shkollat shqipe). Edhe në këtë klasë vazhdohet me të njëjtat orë dhe rubrika, si në klasën e parë (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit, përdorimi drejt i gjuhës). Gjatë kësaj klase i kushtohet rëndësi e madhe ushtrimit të nxënësve në përvetësimin e elementeve kryesore të të folurit e të shkrimit. Punohen dikttime të ndryshme dhe fillohet leximi i librave të vegjël me përralla. Nga praktika shkollore, në shumicën e rasteve kalimi në këtë klasë bëhet jo pa vështirësi nga nxënësit.

Në klasën e tretë vazhdohet të punohet me “Gjuha shqipe 3”⁸. Për aftësimin sa më mirë të nxënësve të kësaj klase, mësuesi i kushton vëmendje të veçantë: të folurit; të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit, duke rritur orët për përdorimin drejt të gjuhës (50 orë mësimore). Megjithëse nxënësit e kanë pasuruar fjalorin e tyre,

⁶ Grup autorësh, “Abetare”, “Abetare pune”. Shtëpia botuese “Pegi”, 2021. Botime të tjera: *Paraabetare, Fletore e modeluar*. Shtëpia botuese “Pegi”, 2013.

⁷ Grup autorësh, *Gjuha shqipe 2*. Shtëpia botuese “Albas”, 2021.

⁸ I njëjti grup autorësh dhe shtëpi botuese si në klasën e dytë.

kanë arritur të bëjnë analiza të thjeshta, krahasime, të nxjerrin ngjashmëritë apo ndryshimet midis dukurive të ndryshme gjuhësore, përsëri vihen re disa vështirësi në krijimin e fjalive dhe përdorimin si duhet të disa kategorive gramatikore, sidomos për emrat dhe foljet. Në këtë klasë shtohet sasia e librave jashtëshkollorë dhe nxënësit fillojnë me krijimin e disa eseve të vogla në gjuhën shqipe.

Edhe në klasën e katërt vazhdojnë me tekstin “Gjuha shqipe 4” (me të njëjtët autorë dhe shtëpi botuese). Në këtë klasë vihet re aftësimi i mëtejshëm i këtyre nxënësve në përvetësimin sa më korrekt të shqipes. Krahas eseve, disa punëve me shkrim, nxënësit realizojnë punimet e leximeve jashtë klase, si dhe projekte të ndryshme po në gjuhën shqipe.

Në klasën e pestë vihet re aftësimi i nxënësve në komunikimin me gojë, në përgjigjet dhe informacionet që përcjellin, lexim i rrjedhshëm, janë më të vëmendshëm duke respektuar përmbajtjen e pjesës dhe shenjat e pikësimit, në përdorimin e formave të leximit shprehës. Bie në sy përmirësimi i komunikimit me shkrim, duke pasur parasysh që këta nxënës shprehen më mirë me shkrim sesa me gojë. Marrja e disa njohurive gramatikore nga morfologjia, sintaksa, leksikologjia, si dhe njohuri nga drejtshkrimi kanë ndihmuar në përforcimin e njohurive gramatikore, të cilat i kanë njohur nëpërmjet gjuhës amtare, si dhe në përdorimin drejt të atyre dukurive gramatikore të gjuhës shqipe me të cilat ndeshet për herë të parë. Gjatë kësaj klase bie në sy një interesim dhe përkushtim më i madh për mësimin e shqipes. Kjo, ndoshta, për shkak të provimit që zhvillohet në fund të kësaj klase.

Në klasat gjashtë, shtatë, tetë, nëntë punohet me tekste dhe programe të njëjta si në shkollat kombëtare shqipe. Megjithëse edhe një pjesë të orëve të lira mësuesit ia kanë kushtuar përforcimit të këtyre rubrikave, ndikuar edhe nga faktorë të tjerë jashtëshkollorë, nuk është bërë e mundur kapërcimi lehtësisht i tyre. Në ciklin e mesëm të ulët, duke qenë se raportet në përndarjen e lëndëve ndryshojnë, ku gjysma e lëndëve zhvillohen në shqipe dhe gjysma në greqishte, ndikojnë në të mirë të shqipes, por rriten vështirësitë e nxënësve në përvetësimin dhe përdorimin e saj në mënyrë të lirshme.

Pra, në fund të këtij cikli, kur përfundon klasën e 9-të, nxënësi minoritar ka arritur ta përvetësojë gjuhën shqipe në atë nivel e cilësi që të mundësojë të mësuarit e saj në vazhdimësi.

Mbështetja, përgjegjësia dhe përkushtimi në realizimin sa më drejt të këtij procesi duket edhe në një përkujdesje të vazhdueshme për përmirësimin e teksteve të shkollave minoritare krahas atyre të shkollës kombëtare, sepse roli i teksteve mësimore është parësor dhe materializon përmasat e një përmbajtjeje unike, e aftë për një integrim të plotë gjuhësor të fëmijëve të pakicave⁹. Këto masa kanë qenë në vazhdimësi të gjera, gjithëpërfshirëse, duke mbetur si pikat më të forta të politikës arsimore.

Tekstet e gjuhës amtare janë ndërtuar tërësisht sipas konceptimeve të reja, duke u gërshetuar analiza funksionale me atë formale gramatikore. Gjithë materiali mësimor i këtyre teksteve synon përvetësimin drejt të normës gjuhësore, aftësinë për të lexuar bukur, zotërimin e njohurive themelore të leksikut, fjalëformimit, fonetikës, morfologjisë, sintaksës, përshtatja e tyre me situatat konkrete komunikative me gojë dhe me shkrim. Është risi e këtyre tri viteve të fundit, që me përgatitjen e teksteve shkollore në shkollat e minoritetit po merren pedagogët e Departamentit të greqishtes, pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Këto tekste, sipas mënyrës së përgatitjes së tyre, janë të grupuara në tri kategori:

- a. Në kategorinë e parë përfshihen tekste krijime, ku përfshihen tekstet e gjuhës amtare nga klasa e parë deri në të nëntën, si dhe tekstet e Gjeografisë dhe Historisë greke.
- b. Në kategorinë e dytë përfshihen tekstet e lëndëve shkencore, të cilat përkthehen dhe përshtaten si tekstet përkatëse që përdoren në shkollat shqipe.
- c. Në kategorinë e tretë përfshihen tekstet me natyrë shoqërore, si: Edukata shoqërore apo Edukimi muzikor që përshtaten me natyrën e nxënësve të minoritetit.

Në hartimin e teksteve të Gjuhës shqipe vihet re një përkujdesje dhe përkushtim i strukturave shtetërore. Në kuadër të vështirësive që fëmijët minoritarë ndeshin gjatë përvetësimit të shqipes, metodistët, hartues tekstesh,

⁹ V. Bici, *Vështrim kritik mbi tekstet që realizojnë arsimimin dygjuhësor të fëmijëve të pakicave*, në “Kërkime universitare”, nr. 5. Gjirokastër, 2001, f. 56.

prindërit janë të mendimit që tekstet e Gjuhës shqipe për klasën e parë deri në të pestën të jenë në kuadrin e disa metodikave për mësimin e gjuhës shqipe.

4. Në ecurinë e mirë të këtij procesi i kushtohet një vëmendje e veçantë përgatitjes dhe rolit të mësuesit, si potencial ndikues në mbarëvajtjen e formimit dygjuhësor të nxënësve në këto shkolla. Roli i mësuesit është shumëplanësh, sepse ai është hallka kryesore e veprimtarisë në shkollë. Madje, në kushtet e sotme, faktor vendimtar për t'i mësuar shqipen nxënësit minoritar mbetet mësuesi dhe puna e tij¹⁰. Suksesin dhe përshtatjen e tyre në këto shkolla mësuesit e kanë realizuar më së miri duke gërshetuar formimin e tyre shkencor, gjuhësor me disa faktorë psikologjikë, socialë, pedagogjikë. Më konkretisht:

- a. Pjesa më e madhe e mësuesve njohin dhe zotërojnë mirë gjuhën dhe kulturën e të dy etnive, të shtetit amë dhe të shtetit zyrtar, pavarësisht nga profili i tyre. Pjesa tjetër, falë përgatitjes shkencore, përkushtimit, përgjegjësisë profesionale dhe morale ndihet mirë e integruar dhe e aftë për ta realizuar si duhet misionin e saj.
- b. Mësuesit kanë përgatitjen e duhur psiko-pedagogjike, metodike, didaktike dhe aftësinë e përshtatjes në një mjedis dygjuhësor.
- c. Njohin vështirësitë gjuhësore të nxënësit dhe kontribuojnë në kapërcimin sa më lehtë të tyre, duke ndihmuar denjësisht në këtë proces.

Mësuesit e këtyre shkollave tregojnë kujdes të vazhdueshëm për përsosjen e metodave dhe strategjive që rritin shkallën e komunikimit dhe aktivizimin e nxënësve. Puna këmbëngulëse dhe përkushtimi i tyre kanë mënjanuar në mënyrë të vazhdueshme qëndrimet përçarëse. Kjo gjë është arritur mjaft mirë duke shërbyer edhe si model për vendet e tjera evropiane.

5. Një kontribut dhe vlerë të veçantë ka përkushtimi i Departamentit të greqishtes, pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Ky Departament i ka kushtuar një vëmendje të veçantë kualifikimit të mësuesve në dy drejtime:

¹⁰ Th. Dhima, *Vështirësi të kalimit të nxënësve minoritarë nga cikli i ulët në atë të lartë dhe probleme të të mësuarit të shqipes*, në ‘Kërkime universitare’, nr. 5, Gjirokastër, 2001, f. 68.

- a. Përsosjes së vazhdueshme në formimin të tyre shkencor, në përgjithësi, si dhe në atë gjuhësor, në veçanti.
- b. Përsosjen dhe perfeksionimin e tyre të vazhdueshëm nga pikënamja metodike.

Vitet e fundit Departamenti i greqishtes ka menaxhuar drejtpërdrejt kualifikimin e mësuesve të kësaj dege, unifikimin e programeve, bashkëpunimin midis shkollave dhe bashkëpunimin me MAS-in.

Për kualifikimin sa më të mirë të mësuesve, ky Departament ka hapur edhe programe të reja studimi për përgatitjen dhe kualifikimin e mëtejshëm të mësuesve të ciklit të ulët në gjuhën amtare, sepse një pjesë e konsiderueshme e këtyre mësuesve nuk përshtaten me vendin e punës. Në ndihmë të këtij kualifikimi, ky Departament i ka kushtuar vëmendje edhe bashkëpunimit me Universitetet e ndryshme të Greqisë dhe kohët e fundit, edhe me të Qipros.

Në përfundim, mund të themi se përsosja dhe modernizimi i arsimit dhe i shkollës së minoritetit mbeten parësore dhe përcaktuese jo vetëm në formimin dhe zhvillimin e përgjithshëm intelektual të nxënësve, por edhe në funksion të forcimit të kësaj bashkëjetese të gjatë e qytetare.

BIBLIOGRAFI

- Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2009.
- M. Gjokutaj, grup autorësh, *Abetare, Abetare pune*, “Pegi”, 2021.
- R. Memushaj, *Vështrim mbi dygjuhësinë në Shqipëri*, Studime Albanologjike, 2, Tiranë, 1997.
- R. Petro, grup autorësh, *Gjuha shqipe 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9*, “Albas”, 2021.
- R. Zisi, *Edukimi dygjuhësor në një rajon shumëkulturor*, Ederne, 2009.
- Th. Dhima, *Vështirësi të kalimit të nxënësve minoritarë nga cikli i ulët në atë të lartë dhe probleme të të mësuarit të gjuhës shqipe*, në “Kërkime universitare”, 5, Gjirokastrë, 2001.
- V. Bici, *Çështje të dygjuhësisë në shkollat e pakicave*, Tiranë, 2001.
- V. Bici, *Vështrim lingistik e pedagogjik në arsimin dygjuhësor*, në “Revistën pedagogjike”, nr.2, Tiranë, 1997.
- V. Nuhiu, *Ndikimet ndërgjuhësore*, Prishtinë, 1990.

V. Terpo, *Arsimimi dygjuhësor në shkollat e pakicave greke*, në “Kërkime universitare”, 5, Gjirokastër, 2001.

Xh. Lloshi, “Shqipja standarde në rrethanat e dygjuhësisë”, SF, 3-4, Tiranë, 2001.

PROF. AS. DR. ALBANA DEDA

**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
albana.deda@fhf.edu.al**

PROBLEMATIKAT QË SHFAQ APLIKIMI I KRITERIT FONETIK TE PËRDORUESI

Abstrakt

Ky punim do të përqendrohet në shqyrtimin e të dhënave që lidhen me fazën e fundit të aplikimit të standardit dhe që ka të bëjë me mirëmbajtjen e tij. Fillimisht do të paraqiten trajtimet teorike botërore, të cilat pasqyrojnë fazat e aplikimit të standardeve në kodet më të studiuara. Në vijim do të jepet një pasqyrë e historikut të hartimit të standardit tonë dhe problemeve që vazhdojnë të pasojnë këtë mënyrë hartimi akoma dhe sot. Në vijim do të shfaqim të dhënat e një pyetsori që u bëhet nxënësve të nivelit parauniversitar të kl. XII, në të cilin do të shihet aplikimi dhe përvetësimi veçanërisht i rregullave që lidhen me kriterin fonetik, si kriteri bazë mbi të cilin hartuesit e tij shprehet se mbështetet ai. Punimi ynë, veçanërisht ai që lidhet me trajtimin teorik në lidhje me standardin e shqipes do të pasqyrojë jo vetëm trajtimin zyrtar, po dhe qasjet alternative që, pavarësisht se kanë vite që janë artikeluar, nuk i janë nënshtruar një debati objektiv e mbi të gjitha të bazuar në të dhëna konkrete të marra nga përdoruesi.

Fjalët kyçe: *kriteri fonetik; standard; të dhëna konkrete; përdoruesi*

Po e nisim këtë trajtim me pohimin se tematika e kësaj konference që lidhet në thelb me legjislacionin gjuhësor, veçanërisht me atë që ka të bëjë me minoritetet, nuk është pjesë e ekspertizës sonë, por meqenëse autorët kishin menduar edhe anekse tematike, ku mund të përfshiheshin edhe probleme të planifikimit gjuhësor (e jo vetëm), të cilat mendojmë se në lidhje me shqipen mbeten akoma një terren i hapur për diskutime konstruktive, gjithpërfshirëse dhe objektive nga pikëpamja shkencore, menduam të trajtojmë pikërisht një tematikë të tillë.

Duhet të themi që nuk është hera e parë që ne merremi me këtë tematikë. Kujtojmë këtu se:

-2012 kemi botuar në një të përditshme të njohur (Panorama) artikullin “Le të kujtojmë edhe një herë porosinë e Çabejt¹”;

¹ <http://www.panorama.com.al/le-te-kujtojme-porosine-e-cabejt-per-standardin/>

-2014 kemi qenë pjesë e Konferencës shkencore “Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe dhe diskutimet e sotme mbi të”, të organizuar Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gjuhësisë, në të cilin kemi referuar artikullin “Mendime mbi materialin e grupit të punës së sintaksës”;

- 8 tetor 2021 kemi qenë pjesë e Konferencës së organizuar nga Universiteti i Shkodrës, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Departamenti i Gjuhësisë mbi kontributin e prof. Bahri Becit, në të cilën kemi kumtuar punimin “Bahri Beci dhe koncepti i tij mbi procesin e planifikimit gjuhësor të gjuhës shqipe”.

-Në proces botimi, përkatësisht pritet të dalë në dhjetor në revistën Këna, është dhe artikulli “Pse vazhdon me u t’huajt Arshi Pipa?”.

Një punë e tillë ka kërkuar dhe njohjen e mirë në lidhje me literaturën e nevojshme, duke përvijuar dhe llojin e analizës, po dhe kahet e debatit e debatuesve në të.

Ashtu siç kemi theksuar dhe së fundmi në Konferencën e Shkodrës, debatet që i referohen këtij problemi kanë ravijëzuar tashmë dy kahe të kundërta. Njëra palë përfaqëson qëndrimin zyrtar me përfaqësues kryesor Androkli Kostallarin, kurse pala tjetër qëndrimet e Pipës dhe të Becit² (Beci, 1999:149), Janet Bajronit³ (Të ngjashme me shumicën prej tyre janë edhe tonat.). Duhet thënë se Xhenet Bajron-i përmendet në trajtimet zyrtare vetëm nga Kostallari (1984⁴), natyrisht me nota mjaft kritike, siç shprehet Beci (1999:40), po pas 90-ës nuk ka trajtime direkte në lidhje me të. Gjithsesi, Pipa thotë se në qëndrimet e tij rimerr tezat e Bajronit, kështu që ajo është pranishme në palën e dytë, pavarësisht se nuk emërtohet direkt nga kahu zyrtar.

Natyrisht që auditori i kësaj konference është i familjarizuar më së shumti me kahun zyrtar që ka qenë dhe vazhdon të mbetet po i tillë. Në lidhje me palën

² B. Beci. Probleme të politikës dhe planifikimit gjuhësor, Dukagjini, 2000; B. Beci. Historia e shqipes standarde, ShBLSH e Re, 2010; B.Beci. “Homo ideologicus” në shkencën shqiptare, princi, 2015;

B. Beci. “Përjetimet”, UET Press, 2021

³ J. Bajron, Selection among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian, De Gruiter, 1976.

⁴ Studime filologjike, nr 4. 1985.

tjetër, duhet thënë se reagimi ndaj saj ka qenë shumë i ashpër dhe në raste të caktuara me një diskurs, që del jashtë atij të mbështetur në argumente shkencore (Kujtojmë këtu mjaft etiketime në media e konferenca të ndryshme që i janë bërë jo vetëm Pipës, po dhe Becit. Shembull i gjallë i këtij pohimi janë dhe dëshmitë, që gjejmë te “Homo ideologicus” (2015) i Becit, e jo vetëm).

Tezat kryesore që gjenden në Manualin e drejtshkrimit (1973 dhe natyrisht në artikujt e Kostallarit e të tjerë mbështetësve të tij) përcaktojnë se në fakt puna për hartimin e standardit kishte nisur përpara Kongresit. Citojmë “Pas përpjekjeve të para që u bënë menjëherë pas Çlirimit dhe punës së vijueshme për të ecur në rrugën e afrimit drejtshkrimor të varianteve letrare, e cila u kurorëzua me Ortografinë e gjuhës shqipe (1956), zhvillimi i vrullshëm i gjuhësisë sonë në njohjen e thelluar të strukturës së shqipes së sotme krijuan kushtet, që në fushën e drejtshkrimit të bëhej një hap cilësor përpara -të bëhej një drejtshkrim i vetëm për një gjuhë të vetme letrare. Ky hap ishin rregullat e drejtshkrimit të shqipes që u botuan si projekt në 1967.” (Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, 1973, f. 5.).

Kahu tjetër e pohon faktin se puna për hartimin e standardit kishte nisur më përpara, po jo si studim i thelluar që pasqyronte ndërveprimin dialektor, po si një proces i mirëorientuar politikisht. Citojmë këtu Ismajlin⁵ dhe Becin (e natyrisht Pipa e nënvizon këtë fakt), të cilët rendisin edhe ndërhyrjet ekzekutive në këtë kontekst:

Rexhep Ismajli (2005:7) rendit vepra të tjera pararendëse të manualit të Drejtshkrimit (1972), mjaft domethënëse se ky proces veprat e para i kishte të fazës së normativizimit:

Ortografia e gjuhës shqipe, Tiranë, 1948.

Ortografia e gjuhës shqipe, Tiranë, 1951.

Ortografia e gjuhës shqipe, Tiranë, 1956.

Beci shton edhe të dhëna të tjera. Citojmë: “Mendoj se duhet pranuar që në zgjidhjen e problemit të gjuhës letrare shqipe ka pasur që në fillimet e pasluftës ndërhyrje nga partia-shtet dhe zgjidhja e këtij problemi nga përfaqesuesit e

⁵ Sqarojmë se Rexhep Ismajli nuk renditet në kahun e dytë, pavarësisht se herë pas here bën vërejtje objektive që në fakt i pohon ky kah. I referohemi veprës së tij “Drejtshkrimet e gjuhës shqipe”, 2005.

shkencës zyrtare është politizuar. Si e argumentojmë këtë pikëpamje. Më 1945 gegërishtja letrare filloi të hiqej nga shtypi, kurse më 1946 edhe nga librat shkollorë. Më 1951 Ministria e Arsimit mori vendimin që në klasat e para të shkollës fillore në veri mësimi të bëhej në toskërisht. Po kjo vërtetohet edhe përmes pohimeve të bëra në Konferencën e vitit 1952 ku, ndër të tjera, thuhej se me ndërhyrje nga lart u vendos që fjalorët, përkthimet marksiste-leniniste, tekstet, gjuha e administratës e shtypit e radios etj. të beheshin në dialektin jugor.” (Beci, 2010:174-175).

Pra, i bie që tashmë kishte përfunduar procesi i studimit, testimi dhe kishte kaluar te kodifikimi, sipas një logjike socioinguistike, të sugjeruar nga sociolinguistët.

Gjithsesi përveç ndërhyrjes politike dy janë argumentet më të debatueshme të këtij procesi.

I pari ka të bëjë me tezën e Kostallarit që standardi i sotën përbën një koine, në të cilën ndërthuren elemente të dy dialekteve të niveleve të ndryshme gjuhësore dhe, i dyti ka të bëjë me parimet kryesore të shpallura nga kahu zyrtar dhe përkatësisht parimin fonetik, që është dhe parimi bazë i tij (Drejtskrimi i gjuhës shqipe, 1973, f. 7).

Në këtë punim nuk do të diskutojmë gjithë panoramën e debateve, pasi e kemi bërë në shkrimet pararendëse tonat. Këtu do të dalemi te parimi kryesor i ndërtimit të këtij standardi, siç pretendohet në manualin e drejtskrimit dhe natyrisht në shkrimet e përfaqësuesve zyrtarë, pra te parimi fonetik. Kjo do të prihet nga një paraqitje e shkurtër teorike mbi procesin e standardizimit që parashikojnë sociolinguistët dhe studiuesit e planifikimit gjuhësor.

Në parantezë duhet thënë se folja *standardizoj*, sipas Fergusonit (1959:189), përfaqëson në kontekstin linguistik: “procesin se si një varietet i gjuhës bëhet më i pranuar gjerësisht nga komuniteti ligjërimitor si një normë mbidialektore, formën më të mirë të gjuhës, të rankuar mbi dialektet rajonale dhe sociale, megjithëse këto mund të ndihem më të përshtatshme në disa domene”.

“Si rrjedhim produkti i standardizimit, pra standardi, është varieteti që propagandohet të përdoret në arsim, kodifikohet në libra dhe është i parapëlqyeri i folësve jo rajonalë (i kryeqyteteve, i metropoleve me ndikim ekonomik e politik) të një shoqërie” do të sqarojë më tej Hickei (Hickey, 2012: 2).

Vetë koncepti *standard* si term i përket regjistrit formal, përkatësisht të specializuar. Sipas Peter Auer-it⁶, në një ligjërim më të lirshëm, këtij koncepti i referohen dhe terma të tillë si *Hochsprache* ose *Bon usage* apo dhe *Literaturnyj Jazik* (Vini re dhe referencën e termit rus, aq familjar në shqipe edhe sot e kësaj dite “gjuhë letrare” dhe që për vite me radhë i është induktuar përdoruesit në çdo nivel, duke krijuar homonimi strukturore të panevojshme për gjuhën e letërsisë (e jo vetëm), që nuk e ka të detyrueshme këtë variant.).

Në lidhje me procesin e standardizimit gjuhëtari, të cilit i referohen gjerësisht është Einar Haugen [Kujtojmë se pikërisht veprës së Haugenit i referohet edhe Pipa (2010: 18). Kemi parasysh se në parathënien e manualit “Drejtskrimi gjuhës shqipe”, 1973, nuk ka asnjë referencë teorike sociolinguistike, apo që i përket planifikimit gjuhësor, të cilat ekzistonin edhe në atë kohë.]. Haugen-i përcakton katër faza në lidhje me këtë proces:⁷

1. selektimi i normës (perzgjedhja)
2. kodifikimi i formës (codification, gramatika, fjalorë etj.)
3. elaborimi- përhapja (përhapja në shkollë, administratë, media)
4. pranimi nga komuniteti⁸ (që parashikon testime për të parë se sa pranues apo refuzues është përdoruesi ndaj invariantit të servitur si standard)

Është e qartë se procesi i standardizimit nuk i ka zbatuar e mësipërme. Madje edhe në 1972, 1973 ka pasur vërejtje dhe sugjerime, ose më mirë reflektime (pasi nuk guxonte kush të bënte vërejtje në atë kohë.).

Kështu risjellim në vëmendje A. Dodin⁹, i cili që në 1972 vinte re reduktimin e ë -së në ligjërimin e folur, dukë dhënë shembuj fjalësh jo të parme me këtë problematikë(f.111).

⁶P. Auer. (2011). *Dialect& standard: a typology of scenarios in Europe*, ([http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/\(2011\)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf](http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/(2011)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf))

⁷<file:///C:/Users/user/Desktop/Doenloads/LanguageStandardizationinSociolinguisticsandInternationalBusiness-TheoryandPracticeacrosstheTable..pdf>

⁸ Milroy & Milroy (*Authority in Language*, 1985: 22) u shton katër elementeve të skemës së Haugenit edhe tre elemente të tjera. Ata parashikojnë përzgjedhjen, pranimin, përhapjen (diffusion), mirëmbajtjen (maintance), elaborimin, kodifikimin (codification) dhe normativizimin (prescription).].

⁹ A. Dodi. Rreth problemeve të drejtshkrimit...Studime filologjike. nr 4. 1972.

Po kështu edhe M. Totoni¹⁰ në 1973 jep disa propozime për shmangien e ë-së në fjalë të prejardhura nga një temë me *ë* me anë prapashtesash që nisin me bashkëtingëllore dhe në fjalët e përbëra që kanë si pjesë të parë një temë më *ë* të ndjekur nga një temë, që nis me bashkëtingëllore (antar, bulzon, këngtar, marrdhënie etj., 1973:45). Në 1991 foneticienia e njohur Lumnie Boriçi argumentonte se w-ja nuk para dilte “edhe nëse krijohen grupe prej tre ose katër bashkëtingëlloresh njëra pas tjetrës (ujëshkarkues, dorërendë etj).”

Pra, problematika të mosreflektimit real në të folur të parimit fonetik janë vënë re edhe para.

Në këtë kontekst pohimi më i fortë vjen nga një prej firmëtarëve të Kongresit, prof. Xhevat Lloshit (1992:13) shprehet “Nuk ka asnjë mundësi që drejtshkrimi i shqipes të mbështetet vetëm në parimin fonetik. Ky parim do të thotë të shkruhet siç shqiptohet. Këtë mund ta arrijë me përafërsi alfabeti fonetik ndërkombëtar. Por edhe sikur ta marrim parasysh atë, cili shqiptim do të marrim për bazë? Të kujt konkretisht, të cilit fshat, qytet, lagje, krahinë, shtresë të popullsisë?”

Nga ana tjetër, A. Pipa thekson se “Komisia Letrare me lëshimet e bëra në fakt shkatërroi parimin fonetik, që është baza e drejtshkrimit aktual (Pipa, 2010:3).

B. Beci, duke përshkruar gjatësinë e zanoreve të shqipes standarde të matura në laborator, thekson ndër të tjera në lidhje me ë-në fundore “Të dhënat eksperimentale provojnë që ë-ja fundore e patheksuar ka prirje të bjerë. Pritej në këtë rast që ë-ja fundore të sillte zgjatimin kompensator të zanores së theksuar para saj, siç ka ndodhur në të folmet e gegërishtes. Në të vërtetë dallimet që vihen re në gjatësinë e zanoreve [a] në fjalë si [plak] plaku-u-[plak(ë)] plaka janë të paqendrueshme dhe aq të vogla sa nuk mund të lozin rol në kundërvënien e tyre funksionale, raporti i gjatësisë është 10.6/11.5 qs.” (Beci. 2010: 200).

Dy janë deduksionet e këtij pohimi: Së pari, me matje laboratorike provohet rënia e ë-së fundore të standardit.

Së dyti, pavarësisht se bie ë-ja, ky proces nuk shoqërohet me zgjatje të zanores së theksuar si në gegërisht. Sipas nesh, kjo do të thotë se edhe

¹⁰ M. Totoni. Shkrimi i ë-së paratheksore. Kongresi i Drejtshkrimit...II. Tiranë. 1973.

mikrosistemi fonematik i shqipes standarde e pranon këtë proces dhe nuk është diçka, që po e prish systemin e saj.

E themi këtë, nëse kemi parasysh verejtjen tjetër të Becit, i cili, pasi sqaron se “...bazën e strukturës fonetike dhe morfologjike të saj (standardit) e përbën toskërishtja letrare. (Beci, 2010: 179), shton se “Vlerësime të tilla...(ato të Kostallarit që fliste për karakter mbidialektor të standardit në nivelin fonetik “baza fonetike e shqipes standarde ka karakter mbidialektor, pasi ka zgjedhur elemente të sistemit fonetik të dy varianteve”, Kostallari, 1970: f. 3-5), nuk marrin parasysh teorinë e sistemit. Është e vërtetë se mikro dhe makrosistemet dialektore të gjuhës shqipe kanë tipare të përbashkëta dhe dalluese, po secili prej tyre hyn në mikrosistemin dhe makrosistemin që bën pjesë në marrëdhënie të caktuara që përcaktohen nga lidhjet brenda sistemit, të cilit i përket.

Në këto rrethana sistemi fonematik i gjuhës letrare standarde ose i shqipes standarde nuk mund të jetë rezultat i zgjidhjes së elementit të përbashkët, po i zgjedhjes së një mikrosistemi a makrosistemi që në rastin tonë përputhet me sistemin e toskërishtes veriore, që në të vërtetë është sistemi më i thjeshtë dhe për pasojë ka në përbërjen e tij fonemat bazë karakteristike edhe për mikro dhe makrosistemet e tjera dialektore të shqipes (Beci 2010:183).

Në këtë mënyrë Beci vërteton se dhe rënia është pjesë normale e zhvillimit brenda mikrosistemit fonematik të standardit.

Një e dhënë tjetër në këtë kontekst na vjen edhe nga database i maturës shtetërore të vitit 2017, i cili është analizuar në disertacionin e doktoratës së dr. Natasha Poroçanit dhe është mbrojtur në Departamentin tonë.

Në të gjejmë edhe një tabelë kampion publikuar nga QSHA, në të cilën jepen rezultatet e esesë për 12 nxënës, nga të cilët 2 kanë notën mesatare 5, dy 6, 2 shtatë, dy 8, dy 9 e dy 10. Në këtë tabelë përveç kriterëve që kanë të bëjnë me shtjellimin e idesë, strukturën dhe organizimin e esesë, stilin dhe origjinalitetin e saj është edhe saktësia gjuhësore. Këtë të fundit dihet që mësuesit përgjithësisht e lidhin me kompetencën drejtshkrimore të nxënësit, në të cilin futet edhe norma fonetike.

Rezultatet janë të tilla: Nga 12 vetë 3 prej tyre kanë 0 pikë te kriteri *saktësi gjuhësore* (nga dy të mundshmet) pra i bie 25% nuk e kanë këtë kompetencë, 5 kanë 1 pikë (nga dy pikë të mundshme), pra gjysmën e kompetencës së kërkuar

që i bie 41.7%, dhe vetëm 4 vetë kanë 2 pikë (nga dy të kërkuara) që i bie se kanë kompetencë të plotë drejtshkrimore dhe që përbëjnë 33.3%.

Nëse analizojmë më tej do të thoshim se 67.7% shfaqen me probleme në aspektin e kompetencës që ka të bëjë me saktësinë gjuhësore, drejtshkrimore.

Në lidhje me këto problematika ne kishim programuar të bënim një testim të përdoruesi i nivelit parauniversitar në lidhje me përdorimin e ë-së në pozicione pastheksore dhe atë fundore. Pyetjet që kishim programuar kishin të bënin, jo vetëm në përdorimin në të shkruar, po dhe në të folur. Kemi hartuar 10 pyetje, cilat jepen në strukturë sintaksore, jo si fjalë të shkëputura të tilla: Si shkruhet fjala *punëtor* në fjalinë “Djali është punëtor i mirë? Si shqiptohet ose dëgjohet fjala punëtor në fjalinë “Djali është punëtor i mirë.¹¹”.

Testimi u planifikua të kryhej nëpërmjet google forms, po në klasë në praninë e mësueses në një grup fëmijësh prej 100 vetësh, që u përkasin klasave V-XII. Për arsye të situatës pandemike, ku klasat kishin një kapacitet të përgjysmuar, u detyruam që ta zhvillonim pyetësorin vetëm për kl XII. E bëmë këtë gjë edhe pasi në këtë nivel mendohet se nxënësi ka marrë kompetencën e nevojshme preskriptive.

Rezultatet paraprake me të cilat u përballëm ishin këto: Rreth 63.4 % e nxënësve të klasës 12 i shkruajnë drejt variantet e kërkuara, kurse, kur vjen puna për ta shqiptuar kurba e grafikut është shumë e larmishme, pasi mbi 78.8 % e tyre rrethojnë variantin pa -ë, veçanërisht, kur u jepet rasti i përemrit unë në shqiptim.

¹¹ 9 pyetjet e tjera:

Gjeni gabimin drejtshkrimor në fjalinë: Un shkoj në shkollë çdo ditë.

Si e shqiptoni përemrin unë në fjalinë “Un shkoj në shkollë çdo ditë.” me ë apo pa ë.

Gjeni gabimin drejtshkrimor në fjalinë: Ai është antar i kryesisë./

Si shqiptohet dhe si dëgjohet “anëtar” në fjalie “Ai është antar i kryesisë.” me ë apo pa ë.

Gjeni gabimet drejtshkrimore në fjalinë: Nxënësit vizituan shtëpin e Kadares.

Si shqiptohen dhe si dëgjoohen fjalët që nuk janë shkruar saktë në fjalinë “Nxënësit vizituan shtëpin e Kadares.” me ë apo ë.

Gjeni gabimet drejtshkrimore në fjalinë: “Shkolla mjeksore është afër një kopështi.”

Si shqiptohen dhe si dëgjoohen fjalët që nuk janë shkruar saktë në fjalinë “Shkolla mjeksore është afër një kopështi.” me ë apo pa ë.

Është e dukshme se pranimi i formave të standardit në klasat e larta edhe si rezultat i përsëritjes së njohurive dhe induktimit të teksteve, me të cilat mësojnë është më i madh. Ndërsa te klasat më të ulëta pranimi paraqitet më i brishtë, të paktën nga ata nxënës që e plotësuan pyetësin nga këto klasa.).

Natyrisht që këto të dhëna duhen interpretuar dhe në kontekstin ku janë bërë, pra në shkollë dhe kjo nga pikëpamja sociolinguistike indukon dhe një lloj përgjigje më pak spontane në të shkruar dhe në të folur.

Ajo që duam të themi dhe realisht ka baza reale për t'u diskutuar ka të bëjë pikërisht me problematikat e dukshme në pranim të parimit fonetik nga përdoruesi.

Kjo nuk është vetëm përshtypja jonë. Mjaft të kujtojmë se një pjesë e propozimeve të Këshillit Ndërkademi kishin të bënin pikërisht me ë-në në pozicione të ndryshme. Pavarësisht se këto propozime patën vërejtjet përkatëse, ndër të cilat edhe fakti se nuk kishte bazë të dhënash testimi të bashkangjitur materialit (Buxheli, Jorgaqi: 2014¹²), prapë se prapë duhet të kujtojmë se ato u propozuan nga gjuhëtarë me kontribute të njohura në fushën tonë e mbi të gjitha, që presupozohet që kanë një intuitë informale, dhe jo vetëm, mjaft të zhvilluar për të vërejtur, pranuar dhe propozuar ndryshime të tilla.

Në përfundim të këtij punimi gjykojmë se çështjet në lidhje me problematikat që shfaq parimi fonetik janë të konsiderueshme e tashmë shumë të dallueshme, jo vetëm në të folur, po dhe në të shkruar.

Ajo që sugjerojmë në këtë kontekst është testimi në një numër të konsiderueshëm të përdoruesit si faza e fundit e standardizimit dhe që duhet bërë herë pas herë, para se të bëhen ndërhyrje në standard dhe reflektimi i këtyre të dhënave, pasi t'i nënshtrohet debatit të hapur dhe objektiv shkencor, në manualët preskriptive përkatëse.

Praktika botërore tashmë ka shembuj të shumtë të zgjidhjes së situatave të tilla. Metodologjitë dhe infrastruktura sot janë sofistikuar në atë masë, sa që nuk lenë vend për diskutime.

¹² Studime albanologjike, nr.1, 2014: L. Buxheli. Përmirësimi i rregullave drejtshkrimore në përputhje me realitetin gjuhësor dhe bazën e drejtshkrimit ekzistues; K. Jorgaqi. Reforma drejtshkrimore dhe planifikimi gjuhësor;

Tendenca e mbylljes dhe e paprekshmërisë së asaj që është bërë (në fakt ishte bërë, apo të themi vulosur në 1972) dhe mungesa e hapjes së një debati pa paragjykime nuk mendojmë se i shërben objektivitetit shkencor. Pavarësisht se si merremi, apo nuk merremi vesh ne, përdoruesi është aq i zgjuar sa të përzgjedhë variantet që i interesojnë dhe që i shërbejnë për të arritur ilokucionet individuale.

BIBLIOGRAFI

- Bajron, B. (1976). Selection among Alternates in Language Standardization: The Case of Albanian, De Gruiter.
- Beci, B. (2010). Historia e standardizimit të shqipes, Politikat e planifikimit gjuhësor në Shqipëri. Shblsh e Re.
- Beci, B. (2015). Homo ideologicus në shkencën shqiptare. Princi.
- Deda (Ndoja), A. (2012). Le të kujtojmë edhe një herë porosinë e Çabejt. Panorama.
- Deda (Ndoja), A. (2014). Konferenca Shkencore “Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe dhe diskutimet e sotme mbi të. Mendime mbi materialin e grupit të punës së sintaksës. Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gjuhësisë. Studime albanologjike. nr. 1.
- Deda (Ndoja), A. (2021). Universiteti i Shkodrës, Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Departamenti i Gjuhësisë mbi kontributin e prof. Bahri Becit. Bahri Beci dhe koncepti i tij mbi procesin e planifikimit gjuhësor të gjuhës shqipe.
- Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe. (1973). Tiranë.
- Ferguson, C. A. (1968). Language development. In J. A. Fishman, C. A. Ferguson, J. das Gupta (Eds.), Language problems of developing nations (pp. 27–35). New York: John Wiley & Sons.
- Haugen, E. (1959). Planning for a standard language in modern Norway. Anthropological Linguistics, 1(3). Stanford University Pres.
- Haugen, E. (1966). Linguistics and language planning. In W. Bright (Ed.), Sociolinguistics. The Hague: Mouton.
- Ismajli, R. (2005). Drejtshtkrimet e gjuhës shqipe.

Milroy, J. & Milroy, L. (1985). Authority in language: Investigating language prescription and standardisation. London: Routledge & Kegan Paul.

Ortografia e gjuhës shqipe. (1948). Tiranë.

Ortografia e gjuhës shipe. (1951). Tiranë.

Ortografia e gjuhës shqipe. (1956). Tiranë.

Pipa, A. (1989). The Politics of Language in Socialist Albania. East European Monographs.

Studime albanologjike, nr.1, 2014.

Studime filologjike, nr 4. 1985.

[http://www.panorama.com.al/le-te-kujtojme-porosine-e-cabejt-per-standardin/](http://www.panorama.com.al/le-te-kujtojme-porosine-e-cabejt-per-standardin/(http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/(2011)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf)
([http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/\(2011\)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf](http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/(2011)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf))

<file:///C:/Users/user/Desktop/Doënloads/LanguageStandardizationinSociolinguisticsandInternationalBusiness-TheoryandPracticeacrosstheTable..pdf>

[http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/\(2011\)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf](http://paul.igl.unifreiburg.de/auer/userfiles/downloads/(2011)%20Dialect%20vs.%20standard%20a%20typology%20of%20scenarios%20in%20Europe.pdf)

PROF. AS. DR. NEVILA KOCOLLARI FURXHIU

DR. ERIS DHAMO

**FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE
DEPARTAMENTI PUNË DHE POLITIKË SOCIALE
UNIVERSITETI I TIRANËS**

nkocollari@gmail.com

eris_dhamo@yahoo.com

IDENTITETI NË FOKUSIN E KOMUNIKIMIT POLITIK PËR NDRYSHIM SOCIAL

Abstrakt

Komunikimi politik vjen i kulmuar sidomos gjatë periudhave elektorale, ku qëllimi shigjeton pikërisht influencimin e sjelljeve dhe qëndrimeve të individëve, kundrejtpartive politike dhe qeverisë që pritet të vijë në pushtet. Nevoja për argumente, prova, analiza, ndikime, parashikime, gjatë periudhave elektorale, e ul këmbëkryq komunikimin politik në tryezat e njerëzve, përmes kohës mediatike të përcaktuar ligjërisht, por jo vetëm, përmes prezencës së diskutimit, mendimit dhe marketingut politik në të gjitha mediet dhe mjetet e ndarjes së informacionit.

Qëllimi i studimit lidhet me nevojën e identifikimit të analizave dhe argumenteve shkencore mbi identitetin në fokusin e komunikimit politik për ndryshim social. Për realizimin e studimit u aplikua rishikimi sistematik i literaturës dhe analizës së tekstit, për të treguar hapësirat e komunikimit politik që prekin elemente të identitetit dhe modele të zhvillimit e ndryshimit social në Shqipëri. Kërkimi u krye në biblioteka online dhe në artikuj të lirë të gjurmuar online, sipas termave kyçe. Kërkimi online u drejtua mbështetur në bashkëshoqërimin e termave të tilla si: identitet kulturor, sjellje gjuhësore; identitet kulturor, komunikim dhe drejtim politik; identitet kulturor, komunikim mediatik; identitet kulturor, politika zhvillimi.

Çështjet problemore që përshkojnë punimin fokusojnë lidhjen midis politikë-bërjes, identitetit dhe ndryshimit social, që nga proceset elektorale e deri në ndërtimin e organeve qeverisëse dhe planet konkrete të zhvillimit. Disa nga përfundimet tregojnë se në politikën shqiptare nuk ka gjithnjë një dualizëm partish, por një dualizëm tendencash: zgjidhjet janë ose më njërën, ose me tjetrën. Komunikimi tabu, i papërpunuar në rrjedhën e ndryshimeve sociale, modifikon, manipulon dhe ndryshon komunikimin gjithëpërfshirës. Nxitja për ndryshim social, ndesh në tendenca të identitetit kulturor që pengojnë zhvillimin e politikave. Sjelljet gjuhësore ndërtojnë sa kufij (deputetë, ministra), aq edhe ura midis grupeve sociale (populli, grupet në nevojë). Instrumentet dixhitale të komunikimit politik përmes medieeve, përballin mes tyre individin dhe grupet.

Fjalët kyçe: *drejtim politik, identitet kulturor, komunikim dixhital, politika zhvillimi, sjellje gjuhësore.*

Hyrje

Komunikimi ka qenë gjithnjë në qendër të proceseve politike. Praktikrat e komunikimit politik, përfshijnë shumë aktorë, qeverinë, politikanët partiakë, në një territor dhe jashtë tij, liderët e biznesit, sindikatat, aktorët anësorë politikë, grupet e presionit, organizatat, përfshi edhe ato terroriste. Në kuadrin e tendencave identitare, nuk mund të zhvendosim jashtë kontureve të analizave të komunikimit politik, elemente që nisin që nga komunikimi verbal, deklaratat politike, mjetet vizuale domethënëse, siç janë veshja, make-up-i, modeli i flokëve, hartimi i logos, d.m.th. gjithë elementet e komunikimit, të cilat thuhet se krijojnë një “imazh”, ose një identitet politik.¹

Mënyrat e ndërtimit dhe menaxhimit të fjalës brenda komunikimit, kanë siguruar rrjedhshmërinë e dështimeve, apo sukseseve, në procese të ndryshme politike. Qasjet e ndryshme në komunikim, kanë krijuar imazhe dhe vizione, të cilat absolutisht si në rastet e pakënaqësive publike, ashtu edhe në praktikrat më të mira të raportimit politik me frymë demokratike, vijnë si refleksione të forcës dhe shfaqjes së identitetit kulturor, traditës së organizimit dhe intelektit të bashkëjetesës.

Komunikimi është simbolikë e variacionit identitar, identitetit kulturor, po aq sa është edhe mjet i ndërtimit të një identiteti të ri. Në planet social- psikologjike e kulturore, identiteti nënkupton statusin social të individit, sikurse përcakton edhe marrëdhëniet dhe përkatësinë e individit brenda grupit, pra mund të konsiderohet institucion social². Në kontekstin e zhvillimeve globale, rrugëtimi i identitetit në labirintet e hartimit dhe zhvillimit të politikave, vjen si nevojë reflektimi kundrejt standardeve. “Bashkësitë e vogla rrezikohen me hapjen e tyre dhe për të mirë të tyre është që të jenë të izoluara, se vetëm ashtu mund ta ruajnë identitetin e tyre. Mirëpo, hapësira sot nuk prezanton barrierë, por ajo

¹ McNair, B. “An introduction to political communication. 4th edition. Routledge, Taylor & Francis Group. Botuar në shqip UET-Press 2009, f.18

² Berishaj, M (2010) Identiteti dhe shtetësia. Kolegji universitar “Victory” Prishtinë. f. 109.

konceptohet si kapërcyell për lidhje dhe komunikim me të tjerët. Prandaj, nisur nga ky fakt, hapësira e trojeve fiton dimensionin e ri politik, ekonomik dhe kulturor në integrimin europian, si formë e akseptimit dhe sjelljes hapësinore e që unë do ta quejsha dimension të hapësirës së rrjedhave. Komunikimi i çelur nënkupton proces të ndërsjelltë, akseptim të rrjedhave të informacioneve, përgatitje për lidhshmëri të ardhshme” (Berishaj, 2004:83). “Shteti në vetvete nuk është asgjë tjetër, përpos bartës i fuqisë politike. Çështjet që e mishërojnë legjitimitetin e tij janë religjioni, ideologjitë politike dhe grupacionet etnike që paraqiten si bartës të tij dhe njëkohësisht prezantojnë kultura dhe vlera specifike” (Berishaj, 2004:85). “Tradita dhe vetëdija e identitetit të ulët mund të formohet në bazë të ndërlidhjeve komunikuese, që është kusht themelor për formimin e çfarëdo bashkësie njerëzore.³Pra, mund të flasim për komunikimet vertikale dhe horizontale. Komunikimet vertikale lidhin gjeneratat e tashme me ato të hershme dhe me gjeneratat fëmimore, dhe në atë mënyrë formojnë ndjenjën e identitetit të përbashkët.

Komunikimet parashikojnë gjuhën e përbashkët”.⁴ “... Nga ana tjetër, gjuha i shërben çdo individ për të njohur dhe realizuar funksionet e veta. Ajo vendoset në mjedise të caktuara, për të projektuar një kuptim të caktuar. Thënë kështu, jo gjithnjë gjuha përcakton identitetin dhe anasjelltas, pra ajo përfshihet nga relativiteti dhe nevoja për të patur interpretime të ndryshme të fjalës, tekstit dhe kontekstit, duke na treguar nivele të caktuara të narracionit dhe psikologjisë së individit, apo grupit/eve që e përdorin atë. Gjuha dhe elementë të caktuar të identitetit (lakuar, sipas kontekstit, nevojës, etj), janë shtylla të padiskutuara të komunikimit politik, i cili në fakt parashtron gjithnjë vështirësi në përkufizimin dhe kuptimin e tij. Nuk ka diskutim që komunikimi politik përfshin simbolikën e lidhur me përdorimin e “gjuhës politike”, që nga gjuha e trupit, aktet politike, bojkotet, protestat (Graber, 1981)⁵. Por, faktori kyç që e bën komunikimin

³ Berishaj, M. Nga hapësira e trojeve në hapësirë të rrjedhave(2004)Qendra për studime shqiptare “Albanica” Ljubljana f.86

⁴ Po aty, f. 86.

⁵ Graber, D.A., (1981) Political language in Nimmo and Sanders, eds, Handbook of Political Communication, Beverly Hills, Sage. Cituar nga: McNair, B. “An introduction

“politik”, nuk bazohet vetëm në burimin e një mesazhi, por tek përmbajtja dhe qëllimi i tij, për të influencuar mjedisin politik.⁶ Po aq i vërtetë është edhe përcaktimi i hasur, sipas të cilit komunikimi që tremb opinionin publik, lartëson figura, shpërndan ankth e pasiguri, siguron suksesin apo zbukuron përjetimet nga arritjet e aktorëve politikë, është ena bazë e qetësisë, apo tërbimit të njerëzve e popujve, pa të cilën nuk do të mundej asnjë ekzaminim global, për të kuptuar të mirën e të keqen e popujve dhe politikës⁷. Elementet bazike që kornizojnë komunikimin politik janë organizatat politike (partitë, organizatat publike, grupet e interes dhe presionit, organizatat terroriste, qeveritë); media (artikuj, komente, editorial, analiza) dhe qytetarët që thirren në komunikim përmes gazetarisë qytetare, sondazheve të opinionit, medieve sociale, etj. Partitë dhe mediet lidhen mes tyre përmes programeve të ndryshme, reklamave, thirrjeve, marrëdhënieve publike. Të gjithë këtë hapësirë të komunikimit e kuptojmë aktive, nëse marrëdhëniet me publikun janë proaktive, për të bindur audiencat përkatëse. Pavarësisht proceseve demokratike, komunikimi politik, kërkon që individët të reagojnë kolektivisht për të vendosur se kush do t'i qeverisë ata⁸. Si rregull i përgjithshëm, efektet e komunikimeve politike të çfarëdolloji nuk përcaktohen vetëm nga përmbajtja e mesazhit, por nga konteksti historik në të cilin ato shfaqen dhe sidomos nga mjedisi politik që mbizotëson në çdo kohë.⁹ Komunikimi politik vjen i kulmuar sidomos gjatë periudhave elektorale, ku qëllimi shigjeton pikërisht influencimin e sjelljeve dhe qëndrimeve të individëve, kundrejt partive politike dhe qeverisë që pritet të vijë në pushtet. Bazuar në

to political communication. 4th edition. Routledge, Taylor & Francis Group. Botuar në shqip UET-Press 2009.

⁶ Denton, R.E., Woodward, G.C. (1990). Political communication in America, New York, Praeger. Cituar nga: McNair, B. “An introduction to political communication. 4th edition. Routledge, Taylor & Francis Group. Botuar në shqip UET-Press 2009.

⁷ Denton, R.E., Woodward, G.C. (1990). Political communication in America, New York, Praeger. Cituar nga: McNair, B. “An introduction to political communication. 4th edition. Routledge, Taylor & Francis Group. Botuar në shqip UET-Press 2009.

⁸ McNair, B. “An introduction to political communication. 4th edition. Routledge, Taylor & Francis Group. Botuar në shqip UET-Press 2009.

⁹ McNair, B. “An introduction to political communication. 4th edition. Routledge, Taylor & Francis Group. Botuar në shqip UET-Press 2009. f.44.

rishikimin sistematik të literaturës dhe analizën e tekstit, punimi paraqet një përpjekje përshkruese, për të prezantuar elemente të komunikimit politik që prekin tendenca identitare, në hapësirën e zhvillimeve politike shqiptare. Ky studim ka në fokus kryesor të tij nevojën e identifikimit të analizave apo argumenteve shkencore, që bashkojnë elementët e identitetit në fokusin e komunikimit politik për ndryshim social. Nevoja për argumente, prova, analiza, ndikime, parashikime, gjatë periudhave elektorale, e ul këmbëkryq komunikimin politik në tryezat e njerëzve, përmes kohës mediatike të përcaktuar ligjërisht, por jo vetëm, përmes prezencës së diskutimit, mendimit dhe marketingut politik në të gjitha mediet dhe mjetet e ndarjes së informacionit. Qëllimi i studimit i përgjigjet si elementëve komunikativ nacional edhe mungesës së studimeve në terren për më shumë analizë së evidencave.

Metodologjia

Objektivat kryesorë studimorë, i referohen identifikimit të analizave dhe evidentimit të argumenteve shkencore, të komunikimit politik, mbi rëndësinë që ky komunikim ka kryesisht në proceset e reformimeve dhe ndryshimeve sociale. Ky është një kërkim i bazuar në metodologjinë kërkimore cilësore dhe mjeti i vetëm metodologjik për mbjedhjen dhe analizimin e të dhënave, është rishikimi i literaturës. Për të garantuar minimizimin e *bias-it* që shoqëron kërkimin cilësor, është përgatitur paraprakisht harta kërkimore me hapat e saj. Metodologjia përfshin kërkimin sistematik të literaturës, bazuar në teknikat e përzgjedhjes dhe analizës së kërkimit shkencor, e përbërë nga një strategji kërkimi në përputhje me objektivin e studimit. Strategjia e rishikimit sistematik online për këtë studim, përfshin këto hapa: hapi 1: artikulimi i pyetjeve dhe termave të kërkimit, si një pikë referimi për përzgjedhjen e të dhënave; hapi 2: kërkimi i literaturës dhe artikujve; hapi 3: rishikimi i nivelit 1: zgjedhja e artikujve bazuar në rëndësinë e tyre në pyetjen e rishikimit; hapi 4: rishikimi i nivelit 2: nxjerrja e të dhënave nga artikujt përkatës; hapi 5: përmbledhje e rezultateve të gjetura. Kërkimi online u drejtua mbështetur në bashkëshoqërimin e termave të tilla si: identitet kulturor, sjellje gjuhësore; identitet kulturor, komunikim politik; identitet kulturor, komunikim përmes medias; identitet kulturor, politika zhvillimi dhe ndryshim social.

Kërkimi u krye në biblioteka online dhe në artikuj të lirë të gjurmuar online, sipas termave kyçe.

Konkretisht, rezultati: Artikuj që përmbanin dy nga fjalët kyçe 348 000; SocINDEX artikuj të plotë me dy nga termat kyçe 57,712; Google Scholar 112; World Politics Review 5 artikuj të plotë, me dy nga termat. Kërkimi u realizua gjatë periudhës korrik- tetor 2021. Artikujt që kënaqën më mirë kërkesat bazë të kërkimit rezultuan 6. Studime tipike për mjedisin shqiptar për temen në fjalë, ku të fokusoheshin të tre kulmet e problematikës së studimit, nuk rezultuan.

Pyetjet problemore të përdorura që orientojnë rishikimin e literaturës janë:

1. Si prezantohen mundësitë që tregojnë se tendencat identitare të caktuara, mbërrijnë përmes komunikimit politik proceset qeverisëse?
2. Si përcillet përmes studimeve dhe literaturës vendi që zënë elemente të caktuara të identitetit në djepin e komunikimit politik, kundrejt politikave të zhvillimit?

Boshtet kryesore të rishikimit të literaturës, duke u përqëndruar tek karakteristika të komunikimit me bazë identitare, që mund të ndikojnë politikën konsiderohen: a) identiteti, i cili bëhet subjekt përfaqësimi për çdo individ, përmes statusit social në komunikimin politik, nivelit të përkatësisë dhe marrëdhënieve në grup përkundrejt komunikimit politik; b) komunikimi politik: i cili vjen si simbolikë e variacionit kulturor, por edhe si mjet për ndërtimin e identitetit të ri; c) Politikëbërja: që reciprokisht varësohet dhe varëson ndryshimet sociale, të përcaktuara në kontekstin shqiptar me periudhën para viteve 1990-të dhe periudhën post komuniste.

Gjetje:

Karakteristikat e diskursit publik formojnë kulturën politike të një populli, ndërgjegjen e tij politike dhe mënyrën se si elektorati i kupton çështjet politike, strategjitë qeverisëse dhe pritshmëritë që elitat në pushtet krijojnë mbi të sunduarit. Politikanët, ashtu si secili prej nesh, komunikojnë me përdorimin e retorikës. Ata përdorin gjuhën për të ushtruar pushtetin: për të përcjellë një ideologji të caktuar, për të ndikuar dhe bindur votuesit të marrin vendime të caktuara politike. Me fjalë të tjera, gjuha në politikë nuk është më pak se arti i

qeverisjes ¹⁰ (Paul Chilton, 2003:45). Artikujt konfirmojnë se programet elektorale të të dyja partive kryesore politike në Shqipëri, janë të përgjithshme dhe shumë të ngjashme. Duke ditur aspiratat dhe dëshirat e votuesve, programet shpesh përfshijnë retorikë tërheqëse si integrimi euroatlantik, lufta kundër korrupsionit dhe varfërisë, norma më të larta punësimi, etj. (Paul Chilton, 2003:37). Sot ka kërkesa të tjera të reja në lidhje me komunikimin dhe lidhshërinë publike. Kjo nuk i referohet vetëm disa aspekteve të njohura si “menaxhimi mediatik”, por gjithashtu edhe aktivitetet e ndryshme, të tilla, si garancia e “aftësisë së medieve” në vendimmarrjet e mëdha, prezantimi strategjik i informacioneve në media ose përshtatja e strukturave të partisë ndaj presionit të intensifikuar kohor përmes medieve të komercializuara. Ndryshimi i pritshmërive të shoqërive demokratike, të cilat janë të lidhura me legjitimitetin, janë po aq të rëndësishme: legjitimiteti i pushtetit politik sot është shumë më i lidhur me aftësitë e komunikimit, sesa disa dekada më parë. Retorika e lidhshërisë, në këtë kontekst, ka një rëndësi të veçantë. Ndryshimi i modeleve të komunikimit të elitës politike, brenda saj dhe me qytetarët, kërkon aftësi mediatike, si kërkesë themelore e komunikimit politik në demokracinë mediatike. Në kushte të tilla, udhëheqje politike do të thotë, “krijim i vazhdueshëm i shumicës nga grupe të ndryshme të interesit. Racionaliteti objektiv i masave të planifikuara ecën përpara bashkë me komunikimin politik dhe aplikimin e racionalitetit të zbatimit. Prandaj shpesh lidhshëria politike është më shumë paraqitje pragmatike se sa menaxhim hierarkik” ¹¹. Lidhshëria nën rrethanat e komunikimit mediatik ka “prodhuar modelin e ri të politikanit - star”. Ai e diferencon vetveten nga të tjerët duke qenë

¹⁰ Chilton, Paul. *Analysing Political Discourse: Theory and Practice*. Taylor & Francis, 2003. Cituar në: Gjonçaj, M. (2012). *Living on a prayer: Representations of the nation and EU in the Albanian political discourse*. EUHR18 Master thesis in European Studies. Faculty of Humanities Centre for Literature and Languages, LUND University. Burimi: <https://lup.lub.lu.se/luur/download?func=doenloadFile&recordOID=3046930&fileOID=3046931>

¹¹ Hofmeister, W., and Grabow, K., (2011). *Partitë politike: funksionet dhe organizimi në shoqëritë demokratike*. Kapitulli mbi Shqipërinë, nga Afrim Krasniqi Konrad Adenauer Stiftung, Singapor. Përkthyer dhe botuar (2017). Konrad Adenauer Stiftung, West Print, Tiranë. F.85 <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2018/02/LIBRI-MBI-PARTITE-POLITIKE.pdf>

“zbavitës” dhe “krijues”, “mendjemprehtë” dhe “gazmor”, një “tip fituesi” dhe “pro-TV-së”, dikush “që mund të zhvillojë spektakël në media”. Në këtë rast, kemi të bëjmë me kërkesat për të fituar prestigj dhe pushtet përmes televizionit. Megjithatë, sa i përket kapaciteteve të menaxhimit efektiv të tyre, këto karakteristika përbëjnë vetëm kualifikimet periferike”. Në shumicën e rasteve këto kualifikime i mundësojnë politikanit-star që të tërheqë vëmendjen e publikut në situata të caktuara. Megjithatë, ata përfaqësojnë vetëm një pjesë minimale të këtyre karakteristikave që janë të nevojshme për të komunikuar dhe zbatuar reformat.¹²

Sipas Krasniqi (2013), “...e dukshme është qeverisja e vendit ende nga pjesa rurale e popullsisë, në të cilat pjesëmarrja në zgjedhje është më e lartë sesa në pjesën urbane, hapësira për informim është më e kufizuar, statusi arsimor dhe ekonomik janë në nivele më të ulta, por ku çdo qeveri ka kërkuar dhe gjetur mbështetje të dukshme, në raport me qytetet e mëdha urbane, ku ka një lidhje më të fortë midis ndjesisë së votës dhe ndërgjegjes qytetare. Pjesa rurale pasqyron një mentalitet pragmatist, pamundësi organizimi dhe vetëmbrojtje nga ofertat kompromentuese të politikës, konkurrin gati formal midis individëve dhe sidomos partive politike, si dhe një elektorat në lëvizje, vështirë të identifikueshëm për shkak të nivelit të lartë të migrimit dhe emigrimit. Analiza jep një pasyrim të detajuar të votës sipas shtresimeve të popullësisë dhe raporteve të partive me këto grupe presioni. Kalimi i proceseve zgjedhore nga zgjedhje bardh e zi, në një balancë të dukshme midis palëve politike, është shoqëruar me dobësimin gjithnjë e më shumë të rolit inspirues të partive politike në shoqëri”¹³.

Në vitet e fundit kemi një përafrim më të madh midis grupeve tradicionale ideologjike dhe sociale me të majtën ose të djathtë, sipas traditave të njohura bashkëkohore, sic edhe kemi një rënie të dukshme të retorikës ideologjike për shkak të rritjes së numrit të zgjedhësve të rinj (Krasniqi 2013). “Fushatat elektorale në Shqipëri u kanë mohuar të drejtën qytetarëve të përzgjedhin

¹² Po aty.

¹³ Krasniqi, A. (2013). Sjellja zgjedhore dhe identifikimi i votës në Shqipëri. Revista “ILLYRIUS - academia.edu. Burimi online <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2018/02/LIBRI-MBI-PARTITE-POLITIKE.pdf>

alternativat më të mira, ato kanë imponuar zgjedhjet KUNDER dhe njëherësh përshatjen e elektoratit me vetë nevojat elektorale të partive politike. Tradita e llogaridhënies dhe transparencës ende është e brishtë, dhe sistemi elektorale është larguar nga modelet e votës direkte, gjë që dobëson ndjeshëm marrëdhëniet afatgjatë midis votuesve dhe të zgjedhurave, dhe kështu, edhe shprehjen direkte të sovranitetit të popullit. Shqipëria nuk ka ende një traditë të votës popullore, referendumeve apo formave të tjera të demokracisë direkte që mundësojnë një peshë më të madhe qytetare në vendimmarrje. Partitë janë gjithnjë e më pak ideologjike, por njëherësh gjithnjë e më pak demokratike nga brenda, gjë që shoqërohet me rritje të zhgënjimit qytetar tek politika dhe për pasojë, shanse më të mëdha të militantëve besnikë për të vendosur fatet e zgjedhjeve”¹⁴.

Megjithatë, debati mbi identitetin ka pasur më pak ndikim nga sa mund të pritej në studimet sasiore të sjelljes politike në përgjithësi dhe në psikologjinë politike në veçanti (Huddy, 2020)¹⁵. Të marra së bashku, kërkimet për identitetet etnike e kombëtare tregojnë se, së paku formimi i identitetit nuk mund të shpjegohet thjesht dhe vetëm me rëndësinë e të qenit pjesë e një grupi. Këto kërkime tregojnë për një element kyç të formimit të identitetit, pra kuptimet subjektive të identitetit, të cilat janë të nevojshme për teorinë e identitetit social, para se ajo të aplikohet për fenomenet politike¹⁶. Këto kërkime tregojnë për një element kyç të formimit të identitetit, pra kuptimet subjektive të identitetit, të cilat janë të nevojshme për teorinë e identitetit social para se ajo të aplikohet për fenomenet politike. Kështu, p. sh., kërkimet për patriotizmin tregojnë se identiteti amerikan ka kuptime të ndryshme për amerikanët, pra ata nuk kuptojnë të gjithë të njëjtën gjë me togfjalëshin “identitet amerikan”. Në fakt, pasojat politike të identitetit përcaktohen nga kuptimet e identitetit dhe jo nga ekzistenca e tij.¹⁷

¹⁴ Krasniqi, A. (2013). Sjellja zgjedhore dhe identifikimi i votës në Shqipëri. Revista “ILLYRIUS - academia.edu. Burimi online <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2018/02/LIBRI-MBI-PARTITE-POLITIKE.pdf>

¹⁵ Huddy, L., (2020). Nga identiteti social tek ai politik: Një studim kritik i teorisë së identitetit social. Revista Akademia. Burimi: <https://telegrafi.com/nga-identiteti-social-tek-ai-politik-nje-studim-kritik-teorise-se-identitetit-social/>

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.

“Një shembull për këtë qasje, është edhe kërkimi im për identitetin feminist. Unë e kam zbatuar teorinë e identitetit social në analizën për zhvillimin e identitetit feminist dhe kam shqyrtuar mënyrat e ndryshimit të këtij identiteti në varësi të karakteristikave sociale dhe politike të feministeve dhe kundërshtarëve të tyre (Huddy, 1997). Kërkimet e mia mbështesin shtrirjen e teorisë së identitetit social në identitetet politike dhe në të njëjtën kohë sfidojnë konceptin e identiteteve si fluid. Në mbështetje të qasjes së identitetit social, unë mendoj se identiteti feminist varet nga ndjenja e të qenit e ngjashme me gratë e tjera feministe, pavarësisht besimeve individuale... Identifikimi i bazuar në tipare social demografike si mosha, raca apo etnia mund të përkufizohet si një vetëdije e individit për anëtarësinë e tij objektive në një grup të caktuar dhe, njëkohësisht, si një ndjenjë e të qenit pjesë e atij grupi, një ndjenjë bashkëngjitjeje. Mirëpo ky përkufizim për identifikimin me një grup të caktuar nuk mund të përdoret për kategoritë politike, pasi anëtarësia në to është ambigue, e paqartë.”¹⁸.

Sipas Krasniqit (2014)¹⁹, në dallim nga grupet e interesit, një parti pritet të mbajë qëndrim në të gjitha çështjet e rëndësishme për qeverinë. Një pritshmëri është që partitë të propozojnë pikëpamjet e tyre në politikat e jashtme, ekonomike, politika sociale, në politikat e rinisë dhe politikat civile etj. Në mënyrë që t’i përmbushë këto kërkesa, secila parti duhet të ketë një program, në të cilin shprehet pozicioni i saj themelor në fusha të ndryshme. Për më tepër, pritet që një parti të ketë një organizim të qëndrueshëm. Mjedisi mediatik në ditët e sotme është prekur gjerësisht nga globalizimi dhe mediet lokale e kanë të vështirë të “mbijetojnë” në kushtet e “etjes” për t’u informuar më tepër me lajme sensacionale nga bota sesa nga vendi ku ato gjallojnë. Kjo gjendje pasqyrohet, qoftë edhe tërthorazi, në zhvillimin e mëtejshëm të kulturave kombëtare, të cilat po fitojnë gjithnjë e më tepër tipare të huazuara nga kultura të “jashtme”, shpesh

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Krasniqi, A. (2013). Sjellja zgjedhore dhe identifikimi i votës në Shqipëri. Revista “ILLYRIUS - academia.edu. Burimi online <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2018/02/LIBRI-MBI-PARTITE-POLITIKE.pdf>

shumë të largëta; elementet e tyre “shkrihen” natyrshëm me elementet kulturore vendase derisa nuk është çudi që t’i asimilojnë ata (Dhima,2013:21).²⁰

Në bazë të analizës së gjendjes aktuale dhe sfidave të globalizimit kulturor në rrafsh kombëtar²¹, unë mund të pohoj se shoqëria shqiptare është ende larg perceptimit bashkëkohor të “globales” në komunikim, me gjithë zbatimet e lavdërueshme teknologjike dhe kushtet e reja të krijuara nga pluralizmi i “mallit mediatik”. Kjo gjendje i detyrohet, në radhë të parë, aksesit të diferencuar dhe shpesh herë të mangët të aktorëve të jetës shoqërore në përcjelljen shumëgjyreshë të mesazhit, *me gjasmë* për ruajtjen e identitetit etno-kulturor dhe së dyti, prirjeve politike të ditës, që denatyrojnë dëshirën për krijimin e një klime dashamirëse ndaj kumtit mediatik, që vjen “nga jashtë” (Dhima, 2013:25).²²Një aspekt i rëndësishëm i prezantimit dhe njëkohësisht i krijimit të identiteteve është komunikimi (Lami, 2013: 30).²³ Në vijim, Lami duke risjellë konceptin ëeberian lidhur me analizën e grupeve shoqërore thekson se subjektiviteti kolektiv i jep identitet çdo grupi shoqëror dhe, njëkohësisht, natyra e një grupi shoqëror i jep specifikat e veta të veçanta, mendësisë së individëve të veçantë. I njëjti grup shoqëror, por i shfaqur në kohë dhe në vende të ndryshme të hapësirës shoqërore, përmes historisë dhe eksperiencave të veçanta, e formon identitetin e vet shoqëror në mënyra të ndryshme dhe duke iu përmbajtur disa parimeve specifike. Shoqëria postkomuniste shqiptare është përballur me një dallgë migracioni, në dukje kaotike dhe spontane, por që reflekton deri diku kundërveprimin e natyrshëm dhe praktik të shqiptarëve drejt gjeografisë së re të

²⁰ Dhima, A.,(2013) Globalizimi kulturor dhe komunikimi global. Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale.Polis NR 12/2013. Burimi: <https://uet.edu.al/polis/images/polis%2012.pdf>

²¹ Dhima, A.,(2013) Globalizimi kulturor dhe komunikimi global. Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale.Polis NR 12/2013. Burimi: <https://uet.edu.al/polis/images/polis%2012.pdf>

²² Dhima, A.,(2013) Globalizimi kulturor dhe komunikimi global. Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale. Polis NR 12/2013. Burimi: <https://uet.edu.al/polis/images/polis%2012.pdf>

²³ Lami, R. (2013). Vështirësitë në procesin e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale.Polis NR 12/2013. Burimi: <https://uet.edu.al/polis/images/polis%2012.pdf>

mundësive. Lëvizjet e brendshme migratore ndryshuan brenda një periudhe të shkurtër raportin midis popullsisë rurale dhe asaj urbane....Ky realitet i pasur nga pikëpamja multikulturore prodhon disa probleme të natyrës psikosociale ku komunikimi bëhet mbartës dhe pengesë njëkohësisht.²⁴

Lëvizjet sociale (qytetare) janë një pasuri e pazëvendësueshme e një shoqërie, me një objektiv të gjerë, rol dhe ndikim domethënës për të mirën e përparimit të vendit.²⁵ “Lëvizjet sociale apo qytetare, janë një rast tipik i ndryshimeve nga poshtë-lart brenda shoqërive dhe sistemeve të ndryshme politike. Studiuesit e shkencave politike e të sociologjisë kanë përcaktuar përkufizime të ndryshme në lidhje me këto lëvizje, të cilat varen nga faktorë të ndryshëm. Në vende të ndryshme, të paktën që prej gjysmës së dytë të shek. XIX, janë formuluar një sërë teorish të ndryshme që përpiqen të shpjegojnë shkaqet, faktorët, peshën dhe rolin që ato luajnë për të nxitur ndryshime të caktuara në nivel social apo politik brenda shoqërive ku ato lindin. Përgjatë dy dekadave të shek. XXI, roli e pesha e tyre është fuqizuar për shkak të ndikimit të teknologjive të informacionit dhe mjeteve të komunikimit, mediave sociale si interneti, Facebook –u, etj. Shqipëria nuk ka një traditë të gjerë të lëvizjeve sociale (qytetare). Kjo traditë i ka fillimet në fillim të viteve 1990-të, me një reagim të fortë civil ndaj sistemit totalitar.... Përveç Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit, e cila ka pasur një pasqyrim më të gjerë në media, për shkak të përqendrimit të veprimtarisë në Tiranë, si rrjedhojë e vendndodhjes së teatrit dhe pasqyrimin në media për shembjen e ndërtesës së Teatrit Kombëtar më 17 maj 2020, lëvizje të tjera sociale si Nisma Thurja, EcoAlbania, Alternativa duket të kenë një nivel më të ulët njohjeje nga publiku. Historia e lëvizjeve në të shkuarën tregon se kur ato janë shndërruar në subjekte zgjedhore, e humbasin relevancën dhe nuk kanë qenë në gjendje të mobilizojnë mbështetje të mjaftueshme për të patur të zgjedhur në parlament (shembuj si Lëvizja Mjaft - G99, partia Sfida, Partia LIBRA, Aleanca Kuq e Zi, etj.). Këto lëvizje kanë kapacitetin për mobilizim rreth çështjeve

²⁴ Po aty, f.31.

²⁵ Center for Economic and Social Studies (CESS) (2020). Lëvizjet sociale (qytetare) në Shqipëri mes perceptimit qytetar dhe kapacitetit të tyre për të nxitur ndryshime. Autorët prodhuan këtë raport për Fondacionin Westminster për Demokraci, f.55. Burimi: <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2021/01/Raporti-Shqip-FINAL.pdf>

specifike në një kontekst të caktuar, por nuk kanë struktura dhe kapacitete për mobilizim si aktorë politikë rreth zgjedhjeve. Pjesa më e madhe e lëvizjeve nuk kanë anëtarësi të qartë dhe të identifikuar. Megjithatë fusha ku shqiptarët shprehin në mënyrë të dukshme angazhimin e tyre social ka mbetur procesi elektoral që siç duket konsiderohet si kulmi i përfshirjes së tyre në përpjekjet për ndryshim apo për të mbrojtur interesat tyre.”²⁶

Sipas Lamit (2014), ”... të komunikosh nuk do të thotë vetëm të prodhosh informacion dhe ta shpërndash atë, por nënkupton gjithashtu të jesh i vëmendshëm ndaj kushteve në të cilat mesazhmarrësi e merr, e pranon e kundërshton, e rimodelon në funksion të horizontit të vet kulturor, politik, filozofik mesazhin dhe njëkohësisht, i përgjigjet nga ana e tij. Jo në pak raste, urat e komunikimit konsolidohen brenda anëtarëve që ndajnë të njëjtat kode komunikimi dhe përjashtohen të tjerët e ndryshëm nga ata. Në përgjithësi, anëtarët e grupi “saldojnë” unitetin e tyre duke krijuar një entitet në të cilin çdo anëtar njihet dhe me të cilin identifikohet, në të njëjtën kohë dobëson ndjeshëm lidhjet me anëtarët e tjerë të ndryshëm nga ata. Janë pikërisht konvencionet e përbashkëta që lejojnë bashkimet dhe ndarjet ndërmjet individëve apo grupeve të ndryshme shoqërore.²⁷ ... Tashmë, urat e komunikimit midis elektoratit të gjerë dhe përfaqësuesve të partive të ndryshme politike, realizohen me anë të mesazheve televizive, që jepen nga politikanët dhe konsumohen nga audiencia televizive, sidomos gjatë periudhës së fushatës elektorale”²⁸ . “Për shumë specialistë të komunikimit mbrohet teza se sot nuk është media që i nënshtrohet politikës, por e kundërta.” (cit:Louw, 2005: 57)²⁹. Sipas Lamit (2014) ...”Po t’i referohemi kontekstit shqiptar do të vërejmë shuma marramendëse në adresë të sigurimit të aksesit në televizion. Sipas OPEN Data Albania “zgjedhjet e

²⁶ Po aty.

²⁷ LAMI, R., (2014). Efektet e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme, në Komunikimi dhe marrëdhënia shoqërore. Kolana “MONOGRAFI, ESSE, STUDIME”. UET Press” f 45.

Burimi:

file:///C:/Users/User/Downloads/Komunikimi_dhe_Marredhenia_Shoqerore.pdf

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty. F. 85.

përgjithshme të vitit 2009 janë administruar nëpërmjet një fondi prej 600 milionë lekësh dhe po kaq janë parashikuar për zgjedhjet lokale të vitit 2011. Këto shifra janë 25 herë më të larta sesa në vitin 2005... Ndërsa në Fushatën Zgjedhore të vitit 2013, janë harxhuar 15 940 966 lekë më shumë për shpenzime, sesa në Fushatën Zgjedhore të vitit 2011 dhe 13 859 417 lekë më shumë sesa në Fushatën Zgjedhore të 2009-ës³⁰. Në Zgjedhjet për Kuvend, të mbajtura në 23 qershor 2013, subjektet kanë deklaruar më shumë shpenzime dhe një pjesë e tyre edhe në formën e debive apo tejkalimeve që janë shpenzime të palikuiduara brenda afateve zyrtare. Nga monitorimi rezulton që pjesa më e madhe e shpenzimeve ka shkuar në media... Standardet estetike të konsoliduar nga televizioni përgjatë një kohe relativisht të gjatë, kthehen në modele për t'u imituar nga politikanët. Larmia e simbolikës së komunikimit joverbal si shikimi, qëndrimi, gjestikulacioni, shprehjet në fytyrë, përdorimi i hapësirës si dhe intonacioni i zërit, i nënshtrohen simbolikës "tip" të fabrikuar nga televizioni. Ky i fundit e fabrikon dhe e shpërndan atë për konsum tek audiencia. Të keqen në këtë rast e pëson teleshikuesi, i cili e ka të vështirë të dallojë ngjyresat politike dhe personalitetet njerëzore të ndryshme, përballë një numri të kufizuar simbolesh virtuale të standardizuara që i serviren për deshifrim. Të njëjtin fat pëson edhe simbolika verbale³¹"Në këtë logjikë, "idetë e përgjithshme", që luajnë një rol të madh në komunikimin e përditshëm, tentohet të përfshihen në pjesë dominante të ligjërimit, me justifikimin që gjithkush të mund t'i receptojë dhe në mënyrë të atypëratyshme. Kjo kërkesë stimulohet nga televizioni, i cili dikton "tipologjinë" e komunikimit mediatik". Ndërsa sot, stili i ligjërimit merr më shumë rëndësi sesa përmbajtja, retorika bëhet më e preferuar sesa logjika, teknikat e bindjes mbivendosen mbi arsyen. Mirëpo, duke qenë se të gjithë e synojnë këtë gjë, në finale, ligjërimi i tyre pavarësisht diferencave profesionale, akademike, ideologjike që ata përfaqësojnë, reduktohet në një numër të kufizuar

³⁰ Raport i KQZ-së. Burimi: <http://www.cec.org.al>

³¹ LAMI, R., (2014). Efektet e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme, në Komunikimi dhe marrëdhënia shoqërore. Kolana "MONOGRAFI, ESSE, STUDIME". UET Press", f. 88.

kodesh. Mund të themi se kodet gjeneralizuese i mbivendosen kodeve specifike që ata kanë trashëguar nga e kaluara.³²

Në terma të përgjithshëm, në zgjedhjet e 2017-s (Gërguri, 2021)³³, çdo i treti kandidat për deputet kishte faqe në Facebook dhe, ky është një indikator për shkallën e lartë të përdorimit të Facebook-ut në spektrin politik kosovar. “Mesatarja e adaptimit të politikanëve kosovarë me mediet sociale është më e lartë se në disa shtete shumë më të zhvilluara europiane, si Franca, Suedia, Norvegjia, gjë që konfirmon se gjendja ekonomike e një vendi nuk është faktor përcaktues për përshtatjen e elitës politike të atij vendi me teknologjitë e reja. Deputetët kosovarë të moshës 31 deri 40 vjeç, janë më aktivët në Facebook, por, është interesant edhe numri i madh i deputetëve më të moshuar, mbi 50 vjeç, që orvaten të përdorin çdo mundësi për të qenë sa më aktiv në sferën publike, nëpërmjet medieve sociale”³⁴. Vijon Gërguri, “Padyshim, media luan rol shumë të rëndësishëm gjatë fushatës zgjedhore, sepse është burimi kryesor i informacionit për qytetarët. Krahas televizionit, në zgjedhjet e vitit 2017 në Kosovë, rol të madh ka luajtur edhe Facebook-u, si një kanal komunikimi që u mundëson partive politike ta përçojnë mesazhin që dëshirojnë dhe, njëherësh, qytetarët e shfrytëzojnë Facebookun si burim informacioni rreth partive politike dhe rreth fushatës së tyre. Kjo ka bërë që mediet sociale dhe në veçanti Facebook-u, në rastin e Kosovës, të fitojnë rëndësi në komunikim politik.” Po aty,...”Procesi i komunikimit politik nuk ka qenë imun ndaj ndryshimeve në fushën e medieve, si rrjedhojë e zhvillimeve teknologjike (Gërguri, 2021:68). Media sociale ka ndikuar në ndryshimin e rrjedhës së komunikimit politik në mes të tre aktorëve, politikës, medias dhe audiencës. Sot, çdo ditë e më shumë, politikanët preferojnë mediet sociale, Facebook-un apo Twitter-in, për të komunikuar me publikun, duke anashkaluar medien tradicionale, si urë lidhëse ndërmjet politikës dhe publikut. Kjo ka bërë që të ndryshojë rrjedha e informacionit. Rrjedha tradicionale e informacionit është pothuajse njëdrejtimëshe, ndërkaq, me përfshirjen e medieve sociale, rrjedha është shumë

³² Po aty. F 90-91.

³³ Gërguri, Dren. (2021) Komunikimi politik në epokën e medieve sociale. Prishtinë: Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës. f.215.

³⁴ Po aty.

më dinamike dhe pothuajse interaktive.” Konteksti shqiptar³⁵(Çela, 2017:135), ofron gjithashtu shumë shembuj që tregojnë se përdoruesit e mediave sociale, falë mundësive për të ndërtuar komunitete virtuale, mundet që mes komunikimit interaktiv të organizohen për të diskutuar, debatuar dhe kundërshtuar një aksion të caktuar politik apo një vendimmarrje të gabuar. Lajmi i përhapur se demontimi i armëve kimike të Sirisë do të bëhej në Shqipëri shkaktoi një reagim të fortë nga ana e publikut. Të gjendur përballë faktit ku televizionet apo gazetatat kryesore, me apo pa qëllim, nuk po e bënin pjesë të agjendës së tyre informuese, nxiti reagimin e një pjese të qytetarëve për këtë çështje, një komunitet në “Facebook” organizoi një fushatë, e cila bëri bashkë shumë njerëz. Në pak orë faqja në “Facebook” e Lëvizjes kundër demontimit të armëve kimike në Shqipëri arriti një numër shumë të madh ndjekësish. Ky profil shërbeu për të organizuar grupet kundërshtuese për protestat e zhvilluara atë kohë.

Sërish, Lami (2014) shprehet se pothuaj, të gjitha studimet dhe artikujt e konsideruar, përputhur qëllimit të punimit tonë, theksojnë diferencën midis komunikimit politik të hapur masiv dhe atij përmes televizionit. Komunikimi politik i hapur dhe ballë për ballë me audiencën, kërkon specifikimin dhe peshimin e mirë të logjikës së argumentit, përkundër rastit tjetër, kur mjaftojnë mesazhe të përgjithme, pa bosht, për shkak të anonimitetit të audiencës. Për pasojë, imazhi në sytë e publikut standardizohet, bëhet njësh pavarësisht diferencave profesionale, kulturore, ekonomike apo ideologjike që mbartin kandidatët. Televizioni krijon stereotipe të reja, pasi përfaqësuesit e politikës duhet t'i përgjigjen dhe vijnë përshtat modeleve dhe standardeve që televizioni krijon. Kështu, “manipulimet e televizionit” prezantojnë mesazhe politike publike të boshatisura nga përmbajtja, që lehtësisht kapen dhe shkëmbehen sepse janë gati banale, kundrejt mesazheve që prezantojnë argumente, analiza dhe llogjikë që stimulon debatin. Siç citon edhe Lami (2014:94) “sot, shumë politikanë kanë bindjen se të jesh politikan, do të thotë të shfaqesh në televizion, pra më konkretisht, të jesh i dukshëm për gazetarët, të shihesh me sy të mirë prej tyre, gjë që nënkupton bërjen e kompromiseve dhe komprometim reciprok në

³⁵ Cela, E. (2017). Personalizimi i komunikimit politik, roli i mediave sociale. Burimi: <file:///C:/Users/User/OneDrive/Desktop/Artikulli%20Korce,%20materiale>

shkëmbim të kohës televizive.³⁶ (Louw, 2005: 123). “...Publiku vihet përballë dëgjimit të të njëjtin zhargon politik, të bazuar në fjalët nëse do t’i referohemi kontekstin shqiptar “ korrupsion”, “integrim”, “drejtësi”, “ krizë ekonomike”, “demokraci”, europianizim, etj.”³⁷

Krasniqi (2017)³⁸ ”në dallim nga grupet e interesit, një parti pritet të mbajë qëndrim në të gjitha çështjet e rëndësishme për qeverinë. Një pritshmëri është që partitë të propozojnë pikëpamjet e tyre në politikat e jashtme, ekonomike, politika sociale, në politikat e rinisë dhe politikat civile etj. Në mënyrë që t’i përmbushë këto kërkesa, secila parti duhet të ketë një program, në të cilin shprehet pozicioni i saj themelor në fusha të ndryshme. Për më tepër, pritet që një parti të ketë një organizim të qëndrueshëm.

Partitë politike janë një institucion thelbësor dhe i pazëvendësueshëm për jetësimin e demokracisë, baza mbi të cilat ngrihet dhe funksionon pluralizmi politik³⁹. Gjatë viteve 1991-1995 partitë politike bënë përpjekje të mëdha për të jetuar pluralizmin politik, - morën pjesë rregullisht në zgjedhje, zhvilluan aktivitete permanent politik, dominuan jetën politike, zhvilluan zgjedhje të brendshme, ndryshuan programe dhe struktura, krijuan partneritete të reja

³⁶ Louw, E. (2005) *The Media and Political Process*, London: SAGE Publication Cit. LAMI, R., (2014). *Efektet e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme, në Komunikimi dhe marrëdhënia shoqërore*. Kolana “MONOGRAFI, ESSE, STUDIME”. UET Press” f 94.

Burimi:

file:///C:/Users/User/Downloads/Komunikimi_dhe_Marredhenia_Shoqerore.pdf

³⁷ LAMI, R., (2014). *Efektet e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme, në Komunikimi dhe marrëdhënia shoqërore*. Kolana “MONOGRAFI, ESSE, STUDIME”. UET Press, f 97.

Burimi:

file:///C:/Users/User/Downloads/Komunikimi_dhe_Marredhenia_Shoqerore.pdf

³⁸ Hofmeister, Grabow, W., Krasniqi A., (2011) *Partitë politike: funksionet dhe organizimi në shoqëritë demokratike Singapor*: Konrad Adenauer Stiftung, 2011. Botimi për Shqipërinë 2017.

³⁹ Hofmeister, W and Grabow, K., (2011). *Partitë politike: funksionet dhe organizimi në shoqëritë demokratike*. Kapitulli mbi Shqipërinë, nga Afrim Krasniqi Konrad Adenauer Stiftung, Singapor. Përkthyer dhe botuar (2017). Konrad Adenauer Stiftung. West Print, Tiranë. f.85 <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2018/02/LIBRI-MBI-PARTITE-POLITIKE.pdf>

ndërkombëtare, si dhe u orientuan nga koncepti i reformave në sistemin qeverisës, në shtet dhe në vetë partitë politike. Gjatë viteve pasuese (1996-2005) partitë politike u karakterizuan nga procese intensive brenda tyre, pati konkurrencë dhe fraksione të ndryshme, brenda tyre u kryen ndryshime strukturore dhe organizative, vendimmarrja politike dhe pritshmëria publike kaluan nga selitë politike tek parlamenti, partitë krijuan profile ideologjike dhe identitete konkurruese. Gjatë periudhës pasuese (nga 2005) dhe sidomos vitet e fundit partitë politike kryesore kanë pësuar ndryshime thelbësore në identitetin, aktivitetin dhe raportet e tyre me shoqërinë, - ato kanë marrë gjithnjë e më shumë tipare presidenciale, me vendimmarrje vertikale, janë të prirura të funksionojnë si parti elektorale dhe kanë ngushtuar në maksimum diferencat midis tyre në identitetin, ideologjinë dhe programin politik⁴⁰.

Për më shumë se katër dekada kjo marrëdhënie ishte vertikale dhe nominale: PPSH dhe udhëheqësi i saj u identifikuan me shtetin, kombin, popullin, Kushtetutën, ligjin dhe shoqërinë. Sfida për të krijuar një marrëdhënie të re horizontale dhe të besimit tëndërsjellë, është e mbetet sfida kryesore e demokracisë së re në Shqipëri. Në këtë mënyrë partitë mund të kuptohen si bashkime permanente të qytetarëve që bazohen në anëtarësim të lirë dhe një program, të cilat mundohen, që nëpërmjet zgjedhjeve me ekipin e tyre të udhëheqësve, të zënë pozicione kryesore politike në qeverisjen e vendit, në mënyrë që të materializojnë premtimet e tyre për zgjidhjen e problemeve thelbësore. Koncepti i zgjedhjeve nënkupton garën e së paku dy partive.⁴¹ Në dallim nga grupet e interesit, një parti pritet të mbajë qëndrim në të gjitha çështjet e rëndësishme për qeverinë. Një pritshmëri është që partitë të propozojnë pikëpamjet e tyre në politikat e jashtme, ekonomike, politika sociale, në politikat e rinisë dhe politikat civile etj. Në mënyrë që t'i përmbushë këto kërkesa, secila

⁴⁰ Po aty, f.87.

⁴¹ Hofmeister, W., and Grabow, K., (2011). Partitë politike: funksionet dhe organizimi në shoqëritë demokratike. Kapitulli mbi Shqipërinë, nga Afrim Krasniqi Konrad Adenauer Stiftung, Singapor. Përkthyer dhe botuar (2017). Konrad Adenauer Stiftung, West Print, Tiranë.

Burimi: <http://isp.com.al/wp-content/uploads/2018/02/LIBRI-MBI-PARTITE-POLITIKE.pdf>

parti duhet të ketë një program, në të cilin shprehet pozicioni i saj themelor në fusha të ndryshme. Për më tepër, pritet që një parti të ketë një organizim të qëndrueshëm. Komunikimi mbi qëllimet politike dhe synimi për marrjen e pëlqimit publik gjithmonë ka qenë pjesë e kritereve kryesore për leadership-in politik në demokraci. Që prej fillimeve të demokracisë moderne partiake, kushtet dhe realizimi i komunikimit kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme⁴².

Partitë politike janë përdorueset dhe përfitueset kryesore të sistemit politik dhe atij zgjedhor. Sistematika e analizave të dukurive partiake, tregon se ndërmjet partive dhe shoqërisë globale, ka konflikte që lidhen me kurthet e gjuhës dhe terminologjisë, lidhur me partitë unike/mobilizuese dhe autonominë në politikë. Debati mbi raportin parti-shoqëri, shënjon një një çështje thelbësore: statusi i politikës përballë sociale. Modeli më i afërt në Shqipëri, përkon me organizime ad-hoc të ngjarjeve si aktiviteti i partisë, konferenca ose fushata elektorale. Në modelin shqiptar, ekzistojnë praktika rregullatore për mbledhjet, për numrin e tyre minimal, për ndarjen e përgjegjësive të drejtuesve të lartë në hierarkinë organizative të partisë, etj, por me dallime thelbësore në mënyrën e shprehjes dhe të përmbajtjes. Natyra e dokumenteve statutorë të partive shqiptare është kryesisht deklarative, pa parashikuar struktura me përgjegjësi të qarta dhe të matshme, modalitete funksionimi dhe pa detyra konkrete, situatë që prodhon shpesh edhe hapësira gri dhe skenarë të kontestueshëm. Referuar vrojtimit, një në tetë të intervistuar shprehen se vendimet me rëndësi politike i merr kryetari i partisë. Një e treta e të pyeturve deklarojnë që kryetarët nuk konsultohen me bazën e partisë për vendimmarrjet politike, një në gjashtë të intervistuar mendojnë se nuk konsultohet as me këshilltarët e tij të afërt, dhe po kaq mendojnë se kryetarët pavarësisht nga vendimet që marrin kanë “gjithmonë në drejtë”! Dallimi i përgjigjeve midis vetë partive politike është minimal, çfarë dëshmon për një model klasik “kryetari” të krijuar në partitë politike shqiptare, bazuar në elementë përbërës transversale të shoqërisë shqiptare (Lami, 2013:93).

Lami (2013:98), konkludon se “...thelbi i procesit politik është riformatuar, si rezultat i bashkëveprimit të kodit mediatik dhe atij politik. Politikanët u flasin televizioneve, ndërsa këta të fundit u flasin votuesve. Në këtë realitet

⁴² Po aty.

komunikativ, asnjë politikan nuk mund të komunikojë pa kaluar më parë në filtrin e saj. Në këtë kontekst, politika dorëzohet pa kushte në kriteret që dikton televizioni duke pësuar transformime rrënjësore qoftë në përmbajtje, qoftë dhe në formë. Diversitetet doktrinare, profesionale, kulturore dhe ekonomike, si pasojë e televizionit dhe e kompanive marketuese, homogjenizohen pasi i nënshtrohen teknikave standarde të komunikimit verbal dhe joverbal të sugjeruar nga televizioni dhe nga kompanitë marketuese me qëllim perfeksionimin e estetikës dhe të masivizimit të deshifrimit të mesazhit. Mirëpo, në finale publiku e ka të vështirë të bëjë diferencën”.

Tendenca identitare shqiptare përkrah që politika zë një vend të privilegjuar në gjirin e shoqërisë. Partitë politike ndërkohë mund të gjejnë justifikime për veten, vetëm në realitetin social. Jean Blondel (1978) e sheh në origjinën e çdo partie, një konflikt social të thellë ⁴³. Më tej Selier, paraqet citimet e Moise Ostrogorsky ⁴⁴, që shënojnë se partitë janë pengesë për zhvillimin e demokracisë. Sipas Michels, funksionimi i partive nuk është demokratik, por oligarkik dhe i personalizuar. Në kontekstin shqiptar, konfirmohet teza e David Hume se ...”njerëzit i duan gjithnjë personat në partinë e të cilëve bëjnë pjesë dhe urrejnë ata që janë në partinë e kundërt. Dhe pasionet transmetohen tek pasardhësit”. Teza e Michels (1971)⁴⁵, mund të ketë pasqyrime vërtetësie, në mënyrën e zgjedhejs së rotacionit të lidërshit në partitë politike në Shqipëri, sikurse edhe në organizimin dhe jetëgjatësinë e vetë lidërshit.

Rritja dhe fuqizimi i medias sociale ka ngritur shumë pyetje në mes të akademikëve për të kuptuar efektin e medias së re në politikë dhe në audiencë⁴⁶. Në artikullin në fjalë prezantohet kjo tablo lidhur me komunikimin politik përmes

⁴³ Blondel, Jean, (1978) *Political Parties: A genuine case for discontent*, London, Wildhouse. Cituar në: Seiler, Daniel-Louis “*Les Partits Politiques*” Armand Colin. Botuar në shqip UET-Press 2009. f.13.

⁴⁴ Ostrogorsky, Moise (1993). *La democratic et les parties politiques*. Paris. Fayard.

⁴⁵ Michels, Robert, (1971). *Le partis politiques*. Flammarion, Paris. Cituar në: Seiler, Daniel-Louis “*Les Partits Politiques*” Armand Colin. Botuar në shqip UET-Press 2009. f.13.

⁴⁶ Kapri, E., (2013). *Media sociale, audienca dhe politika*. Çfarë audience synojnë politikanët nëpërmjet internetit. Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale. Polis NR 12/2013. Burimi: <https://uet.edu.al/polis/images/polis%2012.pdf>

medieve ...” Në qershor do të mbahen zgjedhjet e përgjithshme dhe të dy liderët kryesorë e kanë zhvendosur fushatën e tyre në median sociale. Katër vite më parë, fushata ishte e gjitha ndryshe. Të dy liderët kënduan me këngëtarë pop të famshëm vetëm për të pasur pak më shumë vota. Tashmë ata nuk e bëjnë më një gjë të tillë, por debatojnë nëpërmjet medias sociale. Lideri i opozitës përdor më shumë Tëitter-in, ndërsa ai i maxhorancës përdor Facebook-un. Në mesin e fushatës elektorale dhe vetëm dy javë larg ditës së votimeve u bë një sondazh në lidhje me pëlqimin e materialit të hedhur nga liderët e dy partive kryesore, PD dhe PS, respektivisht Sali Berisha dhe Edi Rama në rrjetet sociale. Në gazetën Mapo të datës 10 qershor 2012 u publikuan të dhënat e qendrës Abacus Research. Këto të dhëna nxjerrin materialet që kanë më shumë pëlqime, komente apo shpërndarje nga anëtarët e faqeve. Të dhënat tregonin diçka krejtësisht ndryshe. Nëse kryeministri Sali Berisha, p.sh., në 5 materialet me më shumë aktivitet, kishte më shumë aktivitet nga pëlqyesit e tij, kreu i opozitës kishte materialin më me shumë aktivitet. Nëse Berisha kishte më shumë pëlqime për takimin me këngëtarën Elhaida Dani, kreu i opozitës kishte një koment për golin e kombëtares së futbollit. Sipas “Mapo-s”, për disa orë me radhë postimi i kryeministrit për takimin me Elhaida Danin mbante vendin e parë me (8119 pëlqime /166 komente /211 ndarje) dhe ky vend në renditjen e postimeve më të pëlqyera u fitua vetëm vonë në mbrëmje nga fotoja e shpërndarë e Ramës me diçiturën “çasti i golit” që mblodhi rreth orës 23.00 (8986 pëlqime /371 komente / 267 ndarje). Një e dhënë tjetër interesante sipas matjes së këtij projekti, tregon se aktiviteti i fushatës, duke pasur në qendër premtimet ndryshe, kishin më pak aktivitet nga pëlqyesit. Nëse shikojmë faqen zyrtare ne Facebook të kryeministrit në ikje, Sali Berisha, ai ka arritur një numër rekord prej 540 mijë pëlqyesish (deri në qershor 2012). Nga të dhënat e publikuara në Facebook, vetëm në një javë janë rreth 2.4 milionë shqiptarë që lexojnë aktivitetin e Berishës në Facebook. Nga ana tjetër, faqja zyrtare e kreut të opozitës ka një numer te me te vogel pëlqyesish, 340 mijë, edhe pse ajo është hapur dy vite më parë për zgjedhjet lokale të 8 majit në vitin 2011, e për më tepër, më pak se 10 për qind e pëlqyesve janë aktivë në faqen e tij. Kryeministri Berisha ka më shumë pëlqyes dhe aktivitet në tërësi në rrjetet sociale, por Rama arriti një rekord për materialin më të pëlqyer gjatë fushatës edhe pse me numër më të vogël pëlqyesish. Në këtë pikë,

mund të arrihen dy konkluzione: së pari, materiali i hedhur nga kreu i opozitës ishte më i mirë, ose anëtarët e faqes së tij, edhe pse më të pakët në numër, ishin aktivë më të shumtë në faqe se të kryeministrit Berisha. Po ta hedhim shikimin prapa, në fushatën për zgjedhjet lokale të 2011 për Bashkinë e Tiranës, mund të thuhet padyshim se fitoi kandidati i cili zhvilloi një fushatë më të mirë online. Analistët politikë e cilësuan si “fushata e Facebook-ut” dhe të dy partitë e mëdha shpenzuan mjaft kohë për të shpërndarë mesazhin e tyre përmes Facebook-ut. Në fund, fitoi kandidati i cili pati më shumë mbështetje në Facebook.”⁴⁷ Në të njëjtën kohë, është e vërtetë se njerëzit e angazhuar politikisht mund të anëtarësojnë në faqet online të kandidatëve në median sociale si në Facebook apo Tëitter. Pavarësisht se më pak të angazhuarit nuk e bëjnë një gjë të tillë, ata sërish shikojnë dhe ndjekin mesazhet politike kur miqtë e tyre i ripostojnë, pëlqejnë apo komentojnë ato. Ky koncept ka ngjashmëri me modelin e komunikimit me dy modele dhe që i referohet impaktit që liderët e opinionin kanë mbi njerëz të tjerë.⁴⁸ Roli më i rëndësishëm dhe shënjes që media sociale ka ne lidhje me politiken është përqendrimi i mesazhit. Të përdorësh median sociale është më fleksible dhe më e thjeshtë të menaxhosh përmbajtjen, që do të thotë se grupi që punon për mirëmbajtjen e faqes mundet që më lehtësi dhe në kohë reale të hedhë lajm të çdo lloj natyre, edhe nga telefonat mobile ose nga pajisje të tjera.... Kjo është një lloj ndryshe marrëdhënie nga ajo që kemi pasur me median tradicionale me konferencat e përhershme të shtypit dhe ku llogaridhënia mund të bëhet drejtpërdrejtë me gazetarët përballë... Procesi i komunikimit ka ndryshuar nëse e krahasojmë me vitet e hershme të studimeve në komunikim. Përdorimi i medias ishte një faktor i rëndësishëm nga diktaturat në Europë dhe përtej saj, por në ditët e sotme censura është më e përshtatshme.. Shumë akademikë nuk kanë një mendim të detajuar se sa larg ne po shkojmë me mediet sociale dhe me internetin në përgjithësi...⁴⁹ Kjo formë e re komunikimi përbën një proces transformues që lidhet me mekanizma lehtësues të marrjes së informacionit në shkallë botërore. Popujt, edhe në të kaluarën, e kanë pasur prirjen për një komunikim që do t'i

⁴⁷ Po aty.

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Po aty.

kalonte hapësirat e rrokura normalisht prej tyre; por, për shkak të izolimit të natyrave të ndryshme (kulturore, etnike, sociale etj.), të distancës gjeografike dhe barrierave gjuhësore, ata nuk mund ta realizonin lehtë këtë ëndërr të kahershme⁵⁰. “Me evolucionin e teknologjisë, ky lloj komunikimi filloi të marrë jetë gradualisht, duke u bërë më i lehtë, më i shpejtë, më i qartë dhe, sidomos, më efektiv. Interneti, qysh nga koha e shpikjes së tij, po ndërhyu fuqishëm në krijimin e modeleve të reja të ndërveprimit social, duke konvergjuar me produktet e tjera dhe duke sjellë ndryshime thelbësore në karakterin e shoqërisë së sotme. Në vitet '60-'70-të të shek. XX, televizioni filloi të zëvendësojë gazetatat, sidomos për lajmet; në vitet '90-të, televizioni kabllor u bë përfundimisht më popullor sesa televizioni analog; në fillimet e shek. XXI, interneti u shndërrua në një burim madhor komunikimi, për shkak të përditësimit dhe shumëllojshmërisë së informacionit të ofruar. Në dekadën e fundit, kompanitë e fuqishme, që veprojnë në fushën e kompjuterëve, duke përfshirë telekomunikacionet, filmin, botimet elektronike dhe TV digjital, kanë fituar një status global. Nga ana tjetër, vendet e ndryshme po synojnë gjithnjë e më tepër të ruajnë identitetet etno-kulturore të tyre nëpërmjet kufizimit të efekteve të globalizimit në sferën ekonomike. Mediet, si pasqyrë e këtyre identiteteve, kanë për detyrë të bëjnë diferencimin/ fragmentarizmin e lajmit, për t’ia përshtatur atë kontekstit social dhe semiotik ku lëvrohen.”⁵¹

Termi “familje politike” na paralelizon grindjet familjare, pajtimet, divorcet, “shtëpinë e vjetër”, etj., sepse në kontekstin sociologjik, partitë lindin nga konfliktet e vazhdueshme. Kështu që në këtë kontekst, literature na tregon se klasifikimet politike, burojnë nga mendimi dhe dija e përbashkët dhe i binden rendit ideologjik, ose konsideratave strategjike. Kjo luftë klasifikimesh, nuk është gjë tjetër, veçse përpjekje për të siguruar mbisundimin e një grupi dhe stigmatizim për kundërshtarin. Kjo analizë na ndihmon të kuptojmë rrugëtimin identitar të ndarjeve dhe familjeve politike në funksion të rrënjëve sociale dhe historike, për të interpretuar multipartitizmin dhe trajektoret e sistemeve partiake

⁵⁰ Dhima, A., (2013) Globalizimi kulturor dhe komunikimi global. Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale.Polis NR 12/2013, f. 19-21.

Burimi: <https://uet.edu.al/polis/images/polis%2012.pdf>

⁵¹ Po aty.

në Shqipëri, pa harruar edhe konjunkturat që aktivizojnë ndarjet e shuara, pra materialistët dhe postmaterialistët.

Në kontekstin e kohezionit në politikë, vjen i dukshëm atribuimi social kundrejt rezidencës. Kjo shfaqet me tendencën për të rekrutuar, apo përfshirë në strukturat qeverisëse e më gjerë, individët nga një përfaqësim gjeografik i caktuar duke ndërtuar komunikime specifike mbi ta (jugorë/jo jugorë/ veriorë, etj). Gjithçka përfshihet në këto analiza, reflektohet edhe në debatet politike, që janë pjesë e sfidave konkrete, që nga premtimet elektorale dhe deri tek programet konkrete qeveritare.

Projektet se demokracia mund të funksionojë edhe pa nevojën e partive, mbetet në stadin e utopisë, eksperiencë e provuar jo pozitivisht në vendet e Europës Lindore. Sot nuk ka asnjë demokraci që të funksionojë pa partitë politike. Kjo marrëdhënie pozitive me pushtetin, përputhet mbrapsht me metodologjinë e qeverisjes, duke u rikthyer në mentalitetin e praktikave të vjetra të para viteve '90, duke shtrembëruar demokracinë, që nga proceset e rekrutimit të kandidatëve e deri në produktin përfundimtar politik shumëdimensional. Në kontrollin dhe koordinimin e organeve qeverisëse, partitë janë sa ruajtëse aq edhe kapërcyese të kufijve e statusit dhe identitetit të tyre, herë duke qenë lubrifikuese në transmetimin e pushtetit, e herë agresive dhe denigruese në nivelet e përfaqësimit të tyre.

Përfundime

Secila nga forcat politike, shpreh interesat e veta, pa asnjë fjalë për interesin e përgjithshëm, pra ndërtojnë vetëm piramida letrash dhe lëmshe procedurash, por pak produkte.

Nëse në literaturë përmendet pedagogjia e partive dhe qeverisjes, në terrenin shqiptar (vëzhgimet mediatike, tekste) asnjëherë nuk përmendet ky term. Ndërkohë, flitet për term “edukim politik”, pra për procese të nxëni në funksion të politikës, pa organizim, pa rindërtuar zonat shoqërizuese të proceseve të angazhimit dhe rritjes politike. Kështu që rezultati, përmenden pak, ose aspak, individë të përgatitur në brazdën e politikës, sipas ciklit normal që nis me moshën e re dhe vijon me politikanin e karrierës. Të paktën në rajonin tonë, kjo vjen në plane të tjera, më të konsoliduara dhe strukturuara. Arsyet mund të lidhen me

faktin se, një pjesë e mirë e logjikës, vendoset në planin e ndryshimeve aktive të periudhës post komuniste, ku ende ndryshimi social, i nisur nga politika, ka ende rrugë për të bërë drejt barazisë, me elemente e tjera të filozofisë liberale dhe neo liberale.

Një tjetër tendencë që lidhet me identitetin shqiptar të marrëdhënieve në kontekste social-politike, është dhe raporti me shoqërinë civile. Nëse ne pranojmë që organizatat e shoqërisë civile, ndihmojnë qeverinë kundrejt interesave të individit dhe komunitetit, shohim se praktikrat më të shpeshta janë ato të pritshmërive të buxhetimit të këtyre organizatave nga qeveria, apo pushteti lokal. Organizatat pranojnë presionin e pushtetit, i cili zbret kështu disa shkallë nga funksionet instrumentale dhe përfaqësuese.

Ndryshimi i sistemit nënkuptoi, siç dihet, një krizë dramatike të vetë jetesës së përbashkët, duke nxjerrë në pah veç mungesës shqetësuese të kohezionit të brendshëm social, edhe një krizë të rëndë të ndjenjës së shtetit. Për qytetarin shqiptar, ishte e vështirë të kuptonte se sistemi i ri nuk nënkuptonte vetëm të drejta, por edhe detyrime të shtetasve në një shoqëri demokratike. Por, do të ishte gabim përojekja për të shpjeguar kundërthëniet e shumta, që vazhdojnë të karakterizojnë në shumë raste qëndrimet e qytetarit, thjesht me trashëgiminë e komunizmit. Ato lidhen, padyshim, edhe me një sërë mendësish e shprehish, që përbëjnë një problematikë me të cilën shteti shqiptar u ndesh që me krijimin e tij para një shekulli. Është fjala këtu, para së gjithash, për kulturën e trashëguar të mosbesimit ndaj shtetit, sidomos në pjesën rurale të vendit.⁵²

Ka ende grupe të shoqërisë civile të papërfaqësuar si organizime politike. Kjo është tendencë identitare e zvarritur nga blloku i mentalitetit të para `90-ës, ku kategori të caktuara sociale ishin totalisht të pa identifikuar dhe të stigmatizuara. Prania e gjinisë, etnisë në komunikimin politik, mbetet jo komode dhe e papërshtatshme në shumë raste, pavarësisht diskutimit teorik rreth këtyre çështjeve. Flitet dhe ka përpjekje, për rritjen e përfaqësimit me bazë gjinore në drejtimin politik, por ende praktikrat e buxhetimit gjinor janë në mjergull.

⁵² Misha, P.,(2015).Shqiptarët dhe modeli social evropian. Mangesitë, pengesat, sfidat, vizionet Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung Office Tirana, ALBANIA. F.30. Burimi: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12303.pdf>

Përmenden pak në politikën shqiptare grupet me përfaqësim të ulët (ose aspak) politikisht.

Nga studimet vijnë përfundime lidhur me terminologjinë “e majtë”, “e djathtë”, që lundron në politikën shqiptare e varur ende nga boshti ideologjik i së shkuarës, ku dominonte pushteti i klasës punëtore si diktaturë e proletariatit⁵³. Kjo përlligj temperamentin e politikës shqiptare, duke kaluar nga individi tek format e organizimit që ai ndërton: partitë politike. Në fakt, këto terma mbartin në vetvete paqartësi konceptuale, por shtuar kësaj edhe fantazinë sociale dhe pavetëdijen kolektive shqiptare, pështjellimi në përcaktimin e situatave të ndryshimit dhe zhvillimit social, prek shumë kategori e grupe sociale. Gjeometria e ndryshme në perceptimet mbi termat e sipërcituar, na prezanton çdo ditë simbolikën e ndarjes së kufirit midis absolutizmit dhe parlamentarizmit, pa patur mundësinë që as e majta as e djathta, të ketë identitet të qartë në opinionin mbarëkombëtar.

Nga vlerësimi i gjetjeve të përsëritura dhe të përbashkëta nga artikujt dhe studimet e konsultuara, por jo vetëm, mbërrijmë lehtësisht në përfundimin se njerëzit nuk kuptojnë qartazi, politikën dhe zhvillimin e territorit, sepse nuk u serviren analiza të produkteve publike, të realizuara mbi bazën e nevojave të matura.

Komunikimi tabu, i papërpunuar në rrjedhën e ndryshimeve sociale, modifikon, manipulon dhe ndryshon komunikimin gjithëpërfshirës.

Nxitja për ndryshim social, ndesh në tendenca të identitetit kulturor që pengojnë zhvillimin e politikave.

Sjelljet gjuhësore ndërtojnë sa kufij (deputetë, ministra), aq edhe ura midis grupeve sociale (populli, grupet në nevojë).

Instrumentet dixhitale të komunikimit politik dhe publik aktualisht, janë mjetet që përballin mes tyre individin dhe grupet.

⁵³ Duhet marrë me rezervat e nevojshme, një analizë e tillë nga autorët, sepse nuk i përgjigjet koherencës në kohën kur është kryer studimi. Trajtime të elementeve të komunikimit gjatë pesë viteve të fundit, japin kontribute minimale kundrejt boshteve të studimit tonë.

Bibliografi

- Berishaj, M (2010) Identiteti dhe shtetësia. Kolegji universitar “Victory” Prishtinë, f. 109.
- Berishaj, M. Nga hapësira e trojeve në hapësirë të rrjedhave (2004) Qendra për studime shqiptare “Albanica” Ljublanë f.86.
- Blondel, Jean, (1978) Political Parties: A genuine case for discontent, London, Wildhouse. Cituar në: Seiler, Daniel-Louis “Les Partits Politiques” Armand Colin. Botuar në shqip UET-Press 2009. f.13.
- Çela, E. (2017). Personalizimi i komunikimit politik, roli i mediave sociale. Burimi:
<file:///C:/Users/User/OneDrive/Desktop/Artikulli%20Korce,%20materiale>
- Center for Economic and Social Studies (CESS) (2020). Lëvizjet sociale (qytetare) në Shqipëri mes perceptimit qytetar dhe kapacitetit të tyre për të nxitur ndryshime. Autorët prodhuan këtë raport për Fondacionin Westminster për Demokraci. f.55. Burimi: <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2021/01/Raporti-Shqip-FINAL.pdf>
- Denton, R.E., Woodward, G.C. (1990). Political communication in America, New York, Praeger. Cituar nga McNair, B. “An introduction to political communication. 4th edition.Routledge, Taylor & Francis Group. Botuar në shqip UET-Press 2009.
- Dhima, A., (2013) Globalizimi kulturor dhe komunikimi global. Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale.Polis NR 12/2013. F. 19-21. Burimi:
<https://uet.edu.al/polis/images/polis%2012.pdf>
- Gërguri, Dren.(2021) Komunikimi politik në epokën e medieve sociale. Prishtinë: Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës. f. 215
- Graber, D.A., (1981) Political language in Nimmo and Sanders, eds, Handbook of Political Communication, Beverly Hills, Sage. Cituar nga: McNair, B. “An introduction to political communication. 4th edition.Routledge, Taylor & Francis Group. Botuar në shqip UET-Press 2009.

- Hofmeister, Graboe W., Krasniqi A., (2011) Partitë politike: funksionet dhe organizimi në shoqëritë demokratike Singapor: Konrad Adenauer Stiftung, 2011. Botimi për Shqipërinë 2017. Hofmeister, Grabow, W., Krasniqi A., (2011) Partitë politike: funksionet dhe organizimi në shoqëritë demokratike Singapor: Konrad Adenauer Stiftung, 2011. Botimi për Shqipërinë 2017.
- Huddy, L., (2020). Nga identiteti social tek ai politik: Një studim kritik i teorisë së identitetit social. Revista Akademia. Burimi: <https://telegrafi.com/nga-identiteti-social-tek-ai-politik-nje-studim-kritik-teorise-se-identitetit-social/>
- Kapri, E., (2013). Media sociale, audienca dhe politika. Çfarë audience synojnë politikanët nëpërmjet internetit. Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale.Polis NR 12/2013. Burimi: <https://uet.edu.al/polis/images/polis%2012.pdf>
- Lami, R. (2013). Vështirësitë në procesin e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme Revistë Shkencore e Fakultetit të Shkencave Sociale.Polis NR 12/2013. Burimi: <https://uet.edu.al/polis/images/polis%2012.pdf>
- Lami, R., (2014). Efektet e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme, në Komunikimi dhe marrëdhënia shoqërore. Kolana “MONOGRAFI, ESSE, STUDIME”. UET Press”, f. 88.
- Burimi: <file:///C:/Users/User/Downloads/Komunikimi dhe Marredhenia Shoqerore.pdf>
- Louw, E. (2005) The Media and Political Process, London: SAGE Publication
- Cit. LAMI, R., (2014). Efektet e komunikimit mes anëtarëve që i përkasin nënkulturave të ndryshme, në Komunikimi dhe marrëdhënia shoqërore. Kolana “MONOGRAFI, ESSE, STUDIME”. UET Press”, f 94. Burimi: <file:///C:/Users/User/Downloads/Komunikimi dhe Marredhenia Shoqerore.pdf>
- McNair, B. “An introduction to political communication. 4th edition.Routledge, Taylor & Francis Group. Botuar në shqip UET-Press 2009, f.18.

Michels, Robert, (1971). Le partis politiques. Flammarion, Paris. Cituar në: Seiler, Daniel-Louis "Les Partits Politiques" Armand Colin. Botuar në shqip UET-Press 2009. f.13.

Misha, P., (2015). Shqiptarët dhe modeli social evropian. Mangesitë, pengesat, sfidat, vizionet Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung Office Tirana, ALBANIA, f.30. Burimi: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12303.pdf>

Ostrogorsky, Moise (1993). La democratic et les parties politiques. Paris. Fayard.

PROF. DR. IRENA NIKAJ

**DEPARTAMENTI I EDUKIMIT
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”
inikaj@unkorce.edu.al**

KOMENTE RRETH MENDIMIT ANTIK, ZHVILLIMIT TË SHKENCËS DHE STUDIMEVE GJUHËSORE

Abstrakt

Në këtë punim duam të ofrojmë mendime në lidhje me lashtësinë greko-romake, e cila ushqeu krijimin e një perandorie kulturore dhe politike, duke filluar nga shekulli III p.e.r, e që jetoi rreth 7 shekuj, për të vazhduar e ndarë pas shekullit IV e.s. Në fakt, ndodhi që romakët u bënë me krenari nxënës të mësuesve grekë.

Tradita evropiane e gjuhësisë ka përshkruar shkallë të ndryshme zhvillimi, duke ndryshuar shumë herë prirjet e zhvillimit në ndikimin e kushteve të brendshme dhe kushtëzimeve të jashtme. Përpos kësaj, e gjithë jeta intelektuale e Evropës, mendimi i saj filozofik, moral, politik dhe estetik e ka zanafillën në veprën e mendimtarëve grekë. Edhe sot ndihet afëria e qartë shpirtërore me grekët e lashtë, që nuk ndodh me asnjë nga qytetërimet e tjera, me gjithë vlerat e padyshimta që edhe ato qytetërimet kanë krijuar. Mbase nuk do të dimë qartë se cilat rrethana mjedisore, kulturore dhe biologjike u bënë bazë e lulëzimit të pashembullt të intelektit njerëzor në Greqinë antike, por jemipadyshim të mahnitur dhe të kënaqur që kjo ndodhi. Ndërmjet grekëve antikë u shfaqën shumë syresh që këmbëngulën për të hulumtuar gjëra, çështje, probleme, të cilat të tjerëve u kishin shpëtuar, ose nuk u kishin tërhequr vëmendjen. Grekët antikë mrekulloheshin me gjëra, të cilat për të tjerët ishin krejt të natyrshme.

Në fushën e gjuhësisë përparimi shfaqet si spekulim gjuhësor i vetëdijshëm, fryt i veprimtarisë intelektuale të njerëzve që arsyetonin për natyrën dhe gjuhën. Veçmas stoikët dhanë një ndihmesë të çmuar, sepse falë tyre gjuhësia u bë pjesë e filozofisë dhe çështjet gjuhësore filluan të trajtoheshin rregullisht në vepra të veçanta në fusha të ndryshme të gjuhës. Grekët antikë shkëlqyen në teorinë dhe përshkrimin gramatikor. Në tërësi, ngadhënjimi i grekëve antikë në qytetërimin e intelektit qëndron në prodhimtarinë e tyre të bollshme në shumë fusha: në logjikë, në etikë, në shkencën politike, në retorikë, në matematikë, si degë të veçanta të dijes.

Fjalët kyçe: qytetërim, kultura greke, filozofia, gjuhësia

Hyrje

Interesin e grekëve të lashtë për gjuhën dhe problemet që lidhen me të e nxiti vetëdija se ekzistonin bashkësi të tjera, që flisnin gjuhë, të cilat dallonin nga ajo që flisnin grekët, bile kishte edhe dialekte në gjirin e bashkësisë së

greqishtfolësve. Ndërveprimet midis botës greke dhe barbarëve (bashkësitë që nuk iu përkisnin qytetërimeve greke, romake dhe judeo-kristiane) kanë qënë të natyrës tregëtare, diplomatike, por edhe me bashkësitë greke në trevat bregdetare barbare në Azinë e vogël, në Itali etj. Gjuha greke ka qënë me shumë dialekte, për shkak të ndarjeve në njësi të vogla vetëqeverisëse si ishin qytet-shtetet, por edhe për shkak të dyndjeve të vazhdueshme të fiseve dorike etj.

Grekët e lashtë nuk qëndruan indiferentë ndaj qytetërimeve të tjera, ata i bënë të vetat arritjet e qytetërimeve rreth e rrotull tyre, deri ato në skajin lindor të Mesdheut apo të mbledhura rreth “Gjysmëhënës” në Azinë e vogël. Merita e grekëve të lashtë ka qënë dëshira sistematike për të diskutuar për botën dhe njerëzit. Figurat e shquara të mendimit të lashtë grek treguan një gjallëri të pazakontë intelekti dhe hulumtuan çështje, fenomene dhe dukuri, të cilat gjithë njerëzve të qytetërimeve të tjera më parë, apo bashkëkohës, rrotull tyre apo më larg, nuk iu kishin tërhequr vëmendjen, ose më saktë u kishin shpëtuar nga hetimi, kishin aftësinë të mrekulloheshin me dukuri dhe fenomene, të cilat për të tjerët ishin të natyrshme.

Momenti më i rëndësishëm i kthesës, i transformimit e i ndryshimit të thellë i natyrës filozofike dhe kulturore i lashtësisë mendojmë se është shpikja e alfabetit. Tradita e shkrimit ka filluar vonë, por alfabeti u soll në Mesdhe nga fenikasit, të vendosur më parë në Azinë e Vogël, e më pas rrotull Kartagjenës, dhe brenda pak dhjetëvjeçarësh me pak korrigjime dhe ndryshime ky alfabet u bë *alfa dhe omega* (shkronja e parë dhe e fundit e alfabetit grek), që çoi drejt një transformimi të paparë, *së pari*, të traditës gojore në formën e legjendave, miteve, historive të perëndive dhe heronjve, lufrave të lavdishme, rrëfimeve në lidhje me to që u shkruan dhe u bënë dëshmi të vyera të udhës së ndryshimit të kulturave dhe shoqërive.

Sistemi më i lashtë i shkrimit që njohim, fillimisht piktografik, ka qënë sistemi sumer, 3000 vjet më parë në Mesopotami. Mendohet se nga ky sistem mund të jetë krijuar shkrimi i egjiptianëve dhe kinezëve të lashtë, pavarësisht ndryshimeve që kanë të dy shkrimet. Shkrimi sumer është përdorur për raste të veçanta dhe për qëllime administrative, më pas edhe për komunikim të përditshëm dhe në letra. Lundrimi dhe tregëtia janë veprimtaritë, të cilat bënë të mundur që alfabetet e lashta të përhapeshin dhe të ndihmonin në krijimin e

alfabetit nga grekët, dhe deti Egje është epiqendra në Mesdhe që udhëheq këtë transformim, sidomos qytetet-porte në brigjet egjeane.

Të dhënat e para për zhvillimin e gjuhësisë si shkencë shfaqen nga shekulli VI-V p.e.r, kur grekët e lashtë ishin vendosur prej shumë kohësh dhe brezash në brigjet perëndimore të Azisë së Vogël, në ishujt e Egjeut, në brigjet e Sicilisë, në pjesë të Italisë së Jugut dhe në territore të tjera rreth Mesdheut lindor. Grekët antikë u vendosën në Greqinë e sotme përgjatë dyndjeve të grupeve apo fiseve greqishtfolëse, që vinin nga veriu dhe u vendosën në Greqi dhe Egje. Gjatë mijëvjeçarit të dytë p.e.r. grekët e vendosur rreth Mikenës, në Peloponez, arritën një shkallë të lartë qytetërimi, i cili u rrënuar më pas, dhe mendohet se shkaku kryesor i rrënimt kanë qënë dyndjet e fiseve të dorëve, por pranohet se mund të ketë edhe shkaqe të tjera, midis të cilave mund të merret në konsideratë edhe përhapja e popullsisë greqishtfolëse në mënyrë të shkallëshkallëshme në kontinent dhe në ishujt përreth.

Grekët kanë meritën e krijimit të alfabetit modern, në të cilin ata dalluan zanoret dhe bashkëtingëlloret, më pas ishin stoikët, midis gjithë shkollave dhe emrave të mëdhenj të mendimit antik grek, që i dhanë vend të posaçëm gjuhësisë në kuadër të filozofisë. Shkolla stoike u themelua gjatë periudhës së helenizmit pasaleksandrin dhe nga pikëpamja gjuhësore kjo periudhë pati si karakteristike kontaktet midis bashkësive greqishtfolëse dhe bashkësive që flisnin gjuhë të tjera. Mendohet se vëmendja që stoikët i kushtuan çështjeve gjuhësore dhe mprehtësia që treguan në analizën semantike të kohëve të foljes në greqishten e vjetër lidhet ndoshta me faktin që Zenoni, themeluesi i shkollës stoike, ishte dygjuhësh, gjuhë të parë kishte një gjuhë semite dhe greqishten e mësoi më vonë. Shkolla stoike e pa gjuhësinë si pjesë të sistemit të vet filozofik, sidomos si pjesë e studimeve në fushën e logjikës, por e dalluar qartë si pjesë e veçantë tek e tëra.

Pushtimi romak solli si rrjedhojë që kultura greke dhe romake duke bashkëjetuar krijuan një perandori kulturore, krahas asaj politike, e cila jetoi deri në shekullin IV e.s., kur Perandoria u nda në dy pjesë, në Perandorinë Romake të Lindjes dhe Perandorinë Romake të Perëndimit. Për hir të së vërtetës, gjuhëtarët grekë dhe latinë qetësisht jetuan rreth Mesdheut, njihnin mirë si pararendësit dhe bashkëkohësit si dhe veprat e tyre, por ndikimi i botës greke ndaj asaj romake ishte kaq ndriçues, sa që romakët, në terma kulturorë, u bënë me krenari nxënës

të magistrave-mjeshtrave (mësuesve) grekë. Arritjet në shkencën gjuhësore gjatë antikitetit krijuar murin mbrojtës që trashëgimia kulturore e Antikitetit t'u përcillej gjeneratave të së ardhmes, sidomos gjatë goditjeve rrënuese në Mesjetë, por edhe më vonë, përgjatë historisë së shoqërisë njerëzore.

Më tej po sjellim paraqitje të përmbledhura për tre mendimtarë tepër të veçantë, në mënyrën si zgjodhën të mbështeten tek trashëgimia e papërsëritshme e Antikitetit dhe entuziazmi kërkimor i përfaqësuesve më të shquar të tij.

1. Ludwig Wittgenstein: gjuha e mirëpërcaktuar

Në vitin 1914, vit kur po ndodhte Lufta e Parë Botërore, në një ditë vjeshte buzë lumit Vistula (Wichsel), qëndronte një inxhinier avionësh, shumë pak i interesuar për luftën, që lexonte në një revistë përshkrimin dhe sqarimin sesi kishte ndodhur një aksident, të dhënë nga një gjykatë pariziane, e cila e kishte rindërtuar aksidentin në formën e modeleve në miniaturë. Këto modele shtëpish, makinash, njerëzish dhe një karrocë për fëmijë mund të lëvizeshin lirisht. Inxhinieri Ludwig Josef Johann Wittgenstein (1889-1951) ishte magjepsur nga mundësia për ta projektuar saktësisht realitetin.

Si bëhet e mundur?

Fillimisht, figurat duhet të përfaqësojnë sa më saktësisht objektet reale. *Së dyti*, marrëdhëniet midis figurave të përputhen me marrëdhëniet faktike të objekteve reale. Përpyekja synonte projektimin e realitetit nëpërmjet figurave, para së gjithash, të figurave të mendimit, të fjalëve, pikërisht “në një fjali të krijohet vetë bota në formën e një prove”.

Në mënyrë radikale Wittgenstein vendosi logjikën e gjuhës në qendër të të menduarit. Matematikani Friedrich Ludwig Gottlob Frege(1848-1925) e pikasi talentin e Wittgenstein dhe e orientoi tek figurat më të shquara filozofike të kohës: Alfred North Whitehead(1861-1947), Bertrand Russell(1872-1970) dhe tek studimet në Trinity College në Cambridge. Rusell fillimisht e quajti humbje kohe të merrej me Wittgenstein-in, por për pak javë ndërroi mendim, saqë i dha lejë të bënte kritikën dhe plotësime për Principet e matematikës(*Principia Mathematica*), vepra e vetë Rusell-it, në bashkëautorësi me Whitehead.

Në vitin 1921 Wittgenstein botoi gjermanisht dhe anglisht Traktatin Logjik-Filozofik (*Tractatus Logico-Philosophicus*), me pretendimin që nga bazat e logjikës të shkonte tek thelbi i botës. Vepra është rreth 75 faqe, me fjali dhe

paragrafë të numëruar, e ngjashme me Biblën. I nisur nga modeli në miniaturë i aksidentit automobilistik, abstraksioni transformues i Wittgenstein ishte ta vinte gjuhën në qendër të filozofisë. E gjithë filozofia është kritikë gjuhësore sipas tij, sepse në një fjali fjalët dhe ndërtimi i fjalisë projektojnë realitetin, emrat iu gjegjen gjërave të botës dhe kuptimin e marrin përmes pozicionimit në fjali. Nëse emrat dhe ndërtimi i fjalisë përputhen plotësisht me gjëra dhe rregullin e tyre në realitet, në këtë rast fjalia është e vërtetë. Përsa i përket gjuhës kjo do të thotë se ajo ka nevojë të përmirësohet vazhdimisht gjatë përdorimit të saj të përditshëm dhe në këtë mënyrë mënjanohehen fjalitë e pakuptimta dhe të paparsyeshme. Fjali të pakuptimta janë ato fjali që gjatë testimit nëse janë të vërteta apo të rreme nuk kanë nevojë për të patur marrëdhënie me realitetin, fjala vjen “e kuqja është e kuqe”, ndërsa fjali të papsyeshme janë ato fjali që nuk mund të provohet nëse janë të vërteta apo të rreme, sepse nuk kanë gjegjës në realitet; edhe morali, sipas Wittgenstein, nuk kishte nevojë për gjuhë, sepse e mira apo e keqja nuk projektojnë objekte që ekzistojnë në realitet. Morali mund të pajisej me një gjuhë shenjash, mund të shfaqej me gjeste apo vështrime.

Projekti i Wittgenstein ishte një gjuhë shumë saktë që ka fuqinë të bëjë të mundur të kuptuarit dhe përshkrimin objektiv të realitetit në të gjitha fushat. Në vitin 1922 u krijua Rrethi i Vjenës, i cili funksionoi rreth 14 vjet për të realizuar programin e Wittgenstein: në kohë reale rezultoi të ishte e pamundur të krijohej një gjuhë sa totalitare, aq edhe autoritare nën përkufizimin *gjuhë e saktë*. Arsyet dhe shkaqet mund të jenë shumë, por para së gjithash një gjuhë e saktë është jonjerëzore, josociale, sepse shtysa që ka vënë në lëvizje fenomenin gjuhë, nuk është thjesht kërkimi i së vërtetës, por nevoja sociale për të kuptuar tjetrin, të njohësh vetveten për të kuptuar tjetrin. Gjuha ka kapacitetet e duhura për realizimin e procesit njohës, pra ka kapacitetin e përdorimit si logjikë, por bota jashtë nesh e njohur vetëm përmes ligjeve të logjikës ngjan të jetë sa qesharake aq edhe joracionale.

Ku e ka mungesën e madhe kjo pikëpamje atëherë?

Te mosmarrja parasysh se kuptimet, përdorimet gjuhësore janë të lidhura me nevojat sociale, kulturore e më gjerë të përdorimit të fjalëve. Pas shumë peripecish akademike dhe joakademike, Wittgenstein-i shkroi Kërkimet filozofike (*Philosophical Investigations*), që dëftonte se autori i ishte larguar përpjekjeve

për të krijuar një gjuhë absolutisht të saktë, të mirëpërcaktuar nga një strukturë logjike. Një pjesë nga kjo vepër mund ta shohim si paralajmërimin e ndryshimit të madh: Gjuhën tonë mund ta përfytyrojmë si një qytet të vjetër: një tërësi rrugicash dhe sheshesh, shtëpish të vjetra dhe të reja, me shtesa nga të gjitha anët, e gjitha kjo e rrethuar nga një numër zonash periferike, me rrugë të rregullta dhe me shtëpi me forma të njëjta (2001: Pra, Traktati dhe përfytyrimet atomistike rezultuan një rrugë pa krye, ndryshe nga Kërkimet, të botuara në 1953, një holizëm praktik, që shërbyen si një frymëzues i madh për filozofinë, ashtu edhe për gjuhësinë, mbështetur nga pikëpamja e shprehur nga Wittgeinstein që problemet filozofike duhet të kuptohen dhe analizohen edhe si probleme të konteksteve, përmbajtjeve gjuhësore.

2. Ferdinand de Saussure: Larmia e gjuhëve

Ferdinand de Saussure (1857-1913) studioi një numër të kufizuar gjuhësh, të cilat në pjesën më të madhe ishin të njohura në Evropë, ndërsa ndikimi i tij mbi shkencën e gjuhësisë të shekullit XX, që fillon me të, është i pakrahuesueshëm me autorë të mëparshëm. Botimi i “Kursi i gjuhësisë së përgjithshme” (*Cours de Linguistique Générale*) është vlerësuar si “revolucioni kopernikan” në gjuhësi. Sosyri, i mbështetur te një traditë mendimi që fillon nga antikiteti e vazhdon me periudhën klasike të mendimit filozofik evropian, ka shkruar se gjuhësia në kuptimin e vërtetë të fjalës, lindi nga studimi i gjuhëve romane dhe gjermanike. Sosyri e përcaktoi shkencën e gjuhës si shkencë të ligjërimit njerëzor dhe gjithë përbërësit e ligjërimit apo çfarëdo formë të shprehuri, për më tepër e sheh gjuhën si produkt shoqëror që ndryshon në varësi të grupeve gjuhësore.

Saussure flet dhe për ndërlikimet e larmisë gjeografike, duke dhënë shembuj nga lashtësia dhe koha e tij: Afrika e Jugut, Meksika, Evropa dhe Perandoria Romake: Sikur të kishim një hartë gjuhësore të Perandorisë Romake, ajo do të na dëftonte fakte krejt të ngjashme me ato të epokës së sotme. Kështu, nga fundi i Republikës, në Kampania flitëshin: oskishtja, sikurse dëshmojnë mbishkrimet e Pompeit; greqishtja, gjuhë e kolonëve themelues të Napolit, etj, latinishtja, ndoshta dhe etruskishtja, që mbretëronte në këtë rajon, para mbërritjes së romakëve. Në Kartagenë gjuha punike apo fenikase kishte mbijetuar përkrah latinishtes (ajo ekzistonte edhe në kohën e pushtimit arab), pa llogaritur se në trojet e Kartagenës

flitej me siguri edhe gjuha numide. Gati mund të pohojmë, se në Antikitët, përreth gjirit të Mesdheut, viset njëgjuhëshe përbënin një përjashtim (2002: 222).

Ndryshueshmëria gjeografike lidhet, sipas Sosyrit, me kohën, variabelët e tjerë mund të ndikojnë si një e dhënë konstante në çdo hapësirë, mjedis apo gjerësi gjeografike. Saussure i kushtoi vëmendje marrëdhënieve të fenomenit gjuhësor me hapësirën, duke nënvizuar se dialektet dhe gjuhët nuk kanë kufij natyrorë. Sipas mendimit të tij, dy forca veprojnë papushim mbi njerëzimin, njëkohësisht e me kahe të kundërta: nga njëra anë, fryma e veçantisë, “fryma lokale”; nga ana tjetër, forca e “interkursit”-e ndërveprimit shoqëror, e cila krijon komunikimet ndërmjet njerëzve.

Ndihmesa e çmuar e Sosyrit mund të shihet në tri përmasa: *së pari*, i dha formë të qartë dhe të saktë përmasës sinkronike gjuhësore: gjuhët në një epokë të caktuar shihen si sisteme komunikimi të mbyllura, dhe përmasës diakronike: ndryshimet që gjuhët kanë në rrjedhën e kohës shqyrtohen në dimensionin historik. *Së dyti*, Saussure bëri dallimin midis gjuhës dhe ligjërit, dhe termat

që ai përdori tashmë janë terma ndërkombëtarë që përdoren ashtu si ai i konceptoi. *Së treti*, Saussure vërtetoi se çdo gjuhë ka nevojë të studiohet në mënyrë sinkronike si sistem i përbërësve leksikorë, gramatikorë dhe fonologjikë në ndërveprim të ndërsjellë. Për më tepër, termat gjuhësorë duhen përkufizuar në lidhje me njëri tjetrin në mënyrë dinamike. Sipas tij, gjuha është formë, dhe këtë gjendje të gjuhës e sjell me shembujt e gurëve të shahut dhe të trenave, të cilët njihen dhe dallohen në sajë të vendit që gëzojnë në sistemin e përgjithshëm të lojës apo të rrjetit hekurudhor, dhe jo për shkak të lëndës, nga e cila janë ndërtuar.

Ndriçimi që solli Saussure në fushën e studimeve për gjuhësinë, përgjithësisht mund të kuptohet edhe më mirë kur ai shkruan: Thuhet se mjafton arsyeja e shëndoshë për t’i davaritur gjithë fantazmat... Por ne nuk jemi të kësaj bindjeje. Përkundrazi, jemi të bindur thellësisht se, kushdo qoftë që vë këmbën mbi truallin e gjuhës, që atë çast braktiset nga të ngjashmit në qiell e mbi dhé (2002: 287).

3. Sfidat e gramatikës gjenerative

Gjuhësia gjenerative u shfaq në mesin e viteve 1950 në ShBA. Themeluesi i saj ka qenë Zellig Sabbetai Harris (1909-1992), i cili mendonte se gjuhësia është mjaft e lidhur me matematikën dhe logjikën, në një përcaktim të ri si *gjuhësia*

generative. Studenti i tij dhe kërkuesi i zellshëm Avram Noam Chomsky (1928) në vitin 1957 botoi “Strukturat sintaksore” (Syntactic Structures) e kështu u shfaq para komunitetit shkencor teoria dhe praktika e gramatikës gjenerative-transformuese, e cila më përmbledhtas njihet si teoria e gramatikës gjenerative.

Noam Chomsky në shumë raste dhe veçanërisht në veprat e tij ka tërhequr vëmendjen mbi qëndrimet filozofike që kanë qenë dhe janë në bazë të mënyrës së tij të menduarit, mbi ndikimin që ka pasur vepra e tij nga tradita evropiane klasike dhe bashkëkohore e mësimdhënies së gjuhëve, më shumë sesa strukturalizmi empirik amerikan.

Si edhe studiues të tjerë para tij, Chomsky u përpoq dhe vazhdon ende të llogaritet se si folësit e një gjuhe mund të përdorin në mënyrë të pafundme burimet e fundme të çdo gjuhe. Këndvështrimi i brendshëm i Chomsky-t, e lejon ta shohë gjuhën si çelës për të kuptuar, qoftë edhe në mënyrë të pjesshme, mendjen njerëzore, pikëpamje kjo që e kanë pasur edhe përfaqësuesit e shkollës stoike. Në vazhdim, në kuadër të teorisë së gramatikës gjenerative, përvetësimi i gjuhës amëtare përfaqëson një proces shumë të veçantë, gati të pavetëdijshëm dhe të ndryshëm nga shumica e formave të tjera të të mësuarit të një gjuhe të dytë, që realizohet si një proces të mësuari formal dhe i vetëdijshëm. Dallimi që shfaq teoria e gramatikës gjenerative për kompetencën nga kuptimi që ka pasur Saussure, ka të bëjë me natyrën krijuese të njohjes së gjuhës nga folësi amëtar, ndryshe nga natyra statike që ka gjuha për Saussure. Tashmë është pranuar se gramatika universale, si koncept bazë në gramatikën gjenerative dhe ndryshimet e dukshme që i bëjnë gjuhët të pakuptueshme kanë të bëjnë me strukturat më sipërfaqësore dhe leksikore të gjuhës.



Foto e sotme e Tempullit të Apolonit në Delfi

Ndër aftësitë dhe shprehjet e njeriut, gjuha përfaqëson veçorinë, cilësinë, aftësinë më njerëzore, më sociale. Në përpjekjet njerëzore të djeshme dhe të sotme për të arritur kuptimin dhe njohjen e fenomenit gjuhë, njeriu, shoqëria është përpjekur në fakt të njohë vetveten sa më thellë, duke ndjekur një porosi të lashtë sa vetë qytetërimi, në të cilin bëjmë pjesë, e cila ndodhej, midis tre postulateve, në tempullin e Apolonit në Delfi, në qendrën e qytetërimit grek: ΓΝΩΘΙ ΣΕΑΥΤΟΝ (KNOW THYSELF)-Njih vetëveten!, që ishte edhe deviza e njohur e Sokratit.

Bibliografi

- Byron, J. 2012. Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës. Rasti i shqipes dhe shkrime të tjera. Tiranë: DITURIA.
- Chomsky, N. 2007. Gjuha dhe problemet e saj. Tiranë: TOENA.
- Chomsky, N. 2011. Strukturat sintaksore. Prishtinë.
- Fuga, A. 2012. Rënia e qytetit. Tiranë: PAPIRUS.
- Gadamer, H-G. 2008. Historia e filozofisë. Tiranë, Plejad.
- Kullashi, M. 2016. Dy gjenealogji të modernitetit. Prishtinë: ASHAK.
- Luhmann, N & Giorgi, D.R. 2016. Teoria e shoqërisë. Tiranë: Pika pa sipërfaqe.
- Murtezai, E. 2015. Hyrje konceptuale në filozofi. Prishtinë: ASHAK.
- Nikaj, I. 2010. Metatheory in Sociology and Social Reality, UET: Sociological Analysis, Volume 4, Number 1, Spring.

Robins, R.H. 2007. Historia e gjuhësisë. Tiranë: Dituria.

Russo, A. 2008. La sociologia di Freud. Milano: FrancoAngeli.

Saussure, F de. 2002. Kurs i gjuhësisë së përgjithshme. Tiranë: KB & ShLK.

Uçi, A. 2001. Paradigma të ndërgjegjes shoqërore. Tiranë: Mësonjëtorja e Parë.

Wittgenstein, L. 2001. Philosophical Investigations. New Jersey: Blackwell Publishing.

Wittgenstein, L. 2011. Traktat logjiko-filozofik. Tiranë: Fan Noli.

DR. ELVIS BRAMO

FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

UNIVERSITETI I TIRANËS

elvisbramo@yahoo.com

KOMPETENCA GJUHËSORE E FËMIJËVE MINORITARË GREKË NË PROCESIN E MARRJES SË SHQIPES SI GJUHË E DYTË

Abstrakt

Në këtë shkrim po sjellim disa dukuri që vërehen në procesin e marrjes gjuhësore të fëmijëve nga komuniteti etnik grek, në Shqipërinë e Jugut. Janë përfshirë hulumtime rreth këtij akti gjuhësor, kryesisht për moshat e reja nga parashkollorët deri tek studentët universitarë. Kemi parasysh që këta fëmijë, që në hapat e parë të leksikut e të holofrazave, fitojnë një kompetencë gjuhësore në gjuhën amtare, që është greqishtja ose gjuha e nënës. Ndërsa ballafaqimi me shqipen, si gjuhë e dytë, ngjet në moshën e fëmijërisë së hershme, kur nisin shkollimin në grupe homogjene, si nga vitet, ashtu edhe nga mjedisi që i rrethon. Vërejmë se vështirësitë e para dalin në përvetësimin e leksikut, sidomos për leksemat dy e trirrokëshe, apo te shqiptimi i fjalëve me grupe bashkëtingëlloresh, në mënyrë të veçantë, për ato që mungojnë në gjuhën greke.

Veç kësaj, gjatë hulumtimeve tona, kemi shënuar se kur nisin formimet me sintagma të përbëra, si E + Mb, dalin probleme të rendit sintaksor, kur mbiemri në gjuhën shqipe del pas emrit; ashtu siç është vërejtur se kur rendi vjen e përputhet në të dyja gjuhët, bie fjala, topika e kundrinës në raport me foljen-predikat, gjenerimi i fjalive ndodh me shpejtësi.

Fjalët kyçe: *kompetencë gjuhësore, fëmijë, gjuhë amtare, gjuhë e dytë, rendi sintaksor*

Probleme të tilla të marrjes gjuhësore, duhet të lidhen patjetër me shkollën e gjenerativizmit, përndryshe, me mendimin chomskian, pranuar prej më se gjysmë shekulli nga teoritë e ndryshme të linguistikës dhe të universalitetit të gjuhëve, sintetizuar në atë që, folësit e lindur të një gjuhe, e mbyllin formimin dhe marrjen ligjërimore, deri në moshën 14 – 15 vjeçare. Për rastin tonë nuk bëhet fjalë për fazat e mirëpërcaktuara të përvetësimit të leksikut, etapës së holofrazave e në vijim të krijimit të kompetencës dhe performancës së gjuhës amtare (L₁), por për subjekte, të cilët që nga mosha e foshnjërisë e fëmijërisë së hershme, duke qenë në vend të huaj, janë të detyruar që hapat e parë të ligjërimit t'i bëjnë jo në gjuhën amtare, por në një gjuhë tjetër që është idioma e vendit ku jetojnë, shkollohen dhe formohen nga ana linguistike. Ndodh ajo që L₁ e prindërve të tyre, të

shndërrohet në L₂, për shkak se gjuha e mësimit, e shoqërizimit nga arsimi parashkollor dhe shkollor të jetë një gjuhë e huaj. Në argumentin që trajtojmë, fëmijët migrantë me prindër shqiptarë, në fshatra e qytete greke, kanë si amtare gjuhën greke.

Gjatë qëndrimit dhe studimeve në Universitetin Aristotelis të Selanikut, na ka takuar të shohim dhe të vërejmë për së afërmi vështirësitë në hapat e parë të marrjes gjuhësore të grupeve të vogla të vegjëlsh të cilët ndodhen në një pozitë jo aq të favorshme përpara greqishtes sepse, sado pak, të ndikuar nga gjuha e nënës, kanë përvetësuar një numër fjalësh: më tepër të veçuara, por edhe të lidhura në bashkime sintagmash, si bukë, ujë, lodra, biçikletë, kukull, orë, natë, ditë; apo togje të bashkuara: *unë bukë, Beni ujë, Jani top, dua luaj, eja ti, babi këtu, ne ikim* etj. Me vajtjen në kopësht, mjedisi gjuhësor ndërron në një përqindje të madhe me fëmijë grekë; kështu që ky leksik fillestar vjen e përzihet edhe me fjalë të një gjuhe tjetër, e cila aq shpejt do të kthehet si gjuhë amtare. Marrja ose përthithja e një leksiku fillestar në kontakt me bashkëmoshatarët e tyre sillet rreth fjalëve, shoqëruar me veprimtarinë e mjedisit rrethues: *καρέκλα, τραπέζι, μπάλα, μολύβι, παίζουμε, έλα, το άλογο, η αλεπού, ο σκύλος κα.*

Vërejmë se, midis këtij leksiku, marrja arrihet lehtë në këto moshë, si për shqiptimin e zanoreve, grupeve të tyre dhe të diftongjeve, b.f., *αέρας, αορτή, αεροπλάνο* etj. Këto faza zhvillimi që po përmendim janë në pajtim të plotë me teorinë e GU¹ dhe mendimin e gjuhëtarit amerikan Noam Chomsky ² i cili vuri bazat e shkollës së gjenerativizmit, ku përvetësimi gjuhësor zë vendin e parë. Me këta fëmijë, kemi parë se si shkallë-shkallë kjo marrje e gjuhës së folur, kalon pa shumë vështirësi tek ajo fazë përvetësimi lingustike që quhet *holofrastike*. Veçoria kryesore e marrjes dhe e aftësisë për të krijuar fjali, këtu del në dukje që në këto struktura, përgjithësisht mungojnë foljet.

Kjo ngjet sepse të folurit e fëmijëve në këtë etapë egocentrike, çka nga ana formale, të vegjëlit e shprehin veprimin në vetën e tretë p.sh.: ο Γιώργος το κουνελάκι, η Μαρία τραγουδάει, ο Στεφάνος μπάλα etj. Si hap i dytë në

¹ (gramatikës universale)

² Ferretti, F., 2018, *Alle origini del linguaggio umano – Il punto di vista evolucionistico*, Editore Laterza, p.22.

përvetësimin e leksikut kemi vërejtur që kalohet nga emërtimet nominative të botës së lojrave, te veprimet me to. *Η Ελένη χτυπά, ο Αλέξανδρος διαβάζει, Ο Φίλιππος έπεσε, η Δανάη μιλά etj.* Është interesante të vëmë në dukje që gjenerimi i holofrazave lidhet me objektet e njohura që të vegjëlit i kanë prekur ose i kanë nëpër duar, prandaj dhe shqiptimi i tyre, çdo herë e më tepër vjen natyrshëm e pa u menduar gjatë.

Kërkimet e para mbi përftimin e ligjërit kanë treguar që gjatë muajve të parë të jetës, të porsalindurit janë të aftë të dallojnë midis tingujve të ngjashëm p.sh. midis tingullit /b/ dhe /p/ qoftë në gjuhën e tyre të lindjes apo edhe në gjuhë të huaj. Me kalimin e kohës fëmijët sintonizohen në gjuhën e tyre amtare e bëhen mendërisht të aftë të dallojnë tingujt edhe në gjuhë të huaj³.

Psikolinguisti amerikan Fodor këmbëngul se ***është forma logjike e shprehjes në gjendje të luaj një funksion interfaqës, pasi në trurin e njeriut ndodhet një modul specifik i aftë të udhëheqë proceset e përmbajtjes duke shndërruar tingujt në domethënie; e mund ta bëjë këtë për relacionin e ngushtë që ka forma logjike, nga njëra anë, me sistemin e tingujve dhe, nga ana tjetër me strukturën sintaksore të mendimit.***⁴

Në këto institucione parashkollore, u konstatua që një vit pas hyrjes në grupe mësimore, etapa e kalimit prej holofrazave arrihet duke u bazuar në tregime të shkurtra me figura. Fjala vjen nëpërmjet katër figurave të vizatuara, edukatorja nxit hap pas hapi mendimin e fantazinë e të vegjëleve për të krijuar një kallëzim të shkurtër të përralla e njohur “*Iriqi dhe molla*”.

³ King A. Kendall, Mackey Alison, 2008, *L’acquisizione linguistica, il Mulino, Child language Acquisition e Second Language Acquisition, in R.W.* p.27.

⁴ Ferretti, F., 2018, *Alle origini del linguaggio umano – Il punto di vista evolucionistico*, Editori Laterza, p.37.



Duke i nxitur të mendojnë, midis të vegjëlve arrijmë në gjenerimin e tre fjalive:

- Iriqi pa një mollë. (Ο σκαντζόχοιρος είδε ένα μήλο).
- Mendoi ta merrte në shtëpi. (Σκέφτηκε να το πάρει στο σπίτι).
- Nuk mundej ta kapte dot. (Δεν μπορούσε να το πιάσει).
- Atëherë u shtri mbi mollën. (Τότε ξάπλωσε πάνω στο μήλο).
- E ngarkoi dhe shkoi në shtëpi. (Το φορτώθηκε και το πήγε σπίτι).

Çdo shqipfolës e vëren lehtësisht se nga katër fjalitë, vetëm e para e ka kryefjalën e shprehur: *Iriqi*, kështu ngjet edhe në greqisht që kryefjala e fjalisë së parë, në këtë kontekst, shërben si kryefjalë edhe për tri fjalitë e tjera.

Në klasa më të larta, kryesisht në klasën e tretë objektivi është te kalimi në të menduarit abstrakt, pa u bazuar në kontretësinë e sendëve të njohura.

Ndryshe paraqitet problemi në shkollat e minoritetit etnik grek në Shqipëri, ku nga aspekti ligjor i arsimit nuk kanë asnjë pengesë; perkundrazi është krijuar një traditë disa vjeçare edhe për përfitim të gjuhës së dytë. Të vegjëlit e këtyre familjeve shkojnë në shkollë me gjuhë amtare të përvetësuar, që është gjuha e nënës, sepse quhen folës të lindur të greqishtes. Ky status lingvistik ka të gjitha atributet dhe përkatësitë që kanë moshatarët e tyre përtej kufirit. Vajtja në shkollë brenda territorit shqiptar i përball ata me tekste në gjuhën e njohur, ndërsa shqipja për ta është L₂.

Pozicioni i tyre pedagogjik është: mësimi i shqipes krahas me greqishten, me mësues jominoritarë dhe tekste të aprovuar për të dyja gjuhët nga Ministria e Arsimit. Kemi parë se marrja e L₂ (shqipes në këtë rast) bëhet me hapa mjaft të shpejtë, falë edhe lëndëve mësimore pas klasës së gjashtë, pasi deri në klasën e gjashtë programi është hartuar me raportin: gjithçka në gjuhën greke dhe vetëm katër orë gjuhë shqipe në javë, ndërsa pas klasës së gjashtë, raporti përmbysset dhe bëjnë vetëm katër orë gjuhë greke në javë me synim që nxënësit të përgatiten për vijueshmërinë e tyre në shkollat shqiptare.

Nëse shohim planin mësimor të sintaksës, duke u ndalur te treguesit e kësaj lënde në nivel fraze, njësi kumtuese e kësaj disipline në aktin e komunikimit me gojë e me shkrim, themi se përbërësit e saj: *fjalitë*, vijnë e nuk krijojnë probleme për këto mosha, sidomos në çështjet e rendit sintaksor të vendosjes së atyre që quhen fjali të cilat bashkohen me hipotaksë dhe atyre që lidhen me parataksë. Ndërtimi i parë përfiton frazat me strukturë të drejtë, si struktura në vijim:

«Σίγουρα θα κιντουνέει,/ αλλιώς, δεν μπορώ να εξηγήσω την απότομη ανάγκη/ ποσ με κυρίεψε/ ν'ανασυντάζω ό,τι δικό του,/ να θυμηθώ,/

ό,τι μου είπε/ κι όσα έκαμε,/ και να τ'ακινητήσω στο χαρτί,/ να μη φύγουν/»⁵.

«Me siguri, do të rrezikonte,/ përndryshe, nuk mund të shpjegoj nevojën e menjëhershme/ që më pushtoi/ të riformuloj çdo gjë të tij,/ të kujtoj,/ se çfarë më tha/ dhe sa bëri,/ dhe t'i imobilizoj në letër/ që të mos ikin/».

Me një përkthim të lirë, përqëndruar te studentët më të mirë të kursit të dytë, do të arrinim në ndërtimin shqip që vihet re pas paragrafit në greqisht.

Tani zbatojmë ecurinë:

A. Ndajmë frazat në përbërës fjali: 9 njësi predikative njëra e 9 njësi tjetra.

B. Qendra e Organizimit Sintaksor (QOS) është në fillim të të dyja frazave.

C. Mjetet e Lidhjes Sintaksore (MLS) janë si vijon:

Për shqipen –

që-përemër lidhor,

të-pjesës e lidhore,

të-pjesëz e lidhore,

se-lidhës fthilluese,

dhe-lidhës parataktike shtuese,

dhe- lidhëz parataktike shtuese,

që- lidhës hipotaktike qëllimore.

Për greqishten:

που- αναφορική αντωνυμία

να- μόριο της υποτακτικής

να- μόριο της υποτακτικής

ό,τι- αναφορική αντωνυμία

κι- σύνδεσμος παρατακτικός

και- σύνδεσμος παρατακτικός

να- μόριο της υποτακτικής

⁵ Καζαντζάκης Ν. 1968, *Βίος και πολιτεία του Αλέξη Ζορμπά*, εκδόσεις Ελ. Καζαντζάκη, Αθήνα, σελ12.

Me një transformë të thjeshtë, u japim nxënësve detyrën të kalojnë nga ndërtimi i drejtë i frazës në të zhdrejtë, çka do të thotë që struktura të nisë jo me QOS në fillim, por me një njësi kallëzuese të varur.

Se çfarë më tha/ dhe sa bëri,/ «Ό,τι μου είπε/ κι όσα έκαμε,/
dhe t'i imobilizoj në letër/ και να τ'ακινητήσω στο χαρτί,/
që të mos ikin/me siguri, να μη φύγουν/σίγουρα
do të rrezikonte,/ θα κιντυνέει,/
përndryshe, nuk mund të shpjegoj αλλιώς, δεν μπορώ να εξηγήσω
nevojën e menjëhershme/ që më pushtoi/ την απότομη ανάγκη/ που με
κυρίεψε/
të riformuloj çdo gjë të tij,/e të kujtoj,/». ν'ανασυντάζω ό,τι δικό του,/ και
να θυμηθώ/».

Operacione të tilla mësimore me nxënësit, sipas situatave të ndryshme, jo vetëm që janë tërheqëse në procesin didaktik, por shërbejnë edhe për përvetësimin e njohurive teorike në shkallë të lartë.

Përfundime

Për dy tablotë që sollëm në këtë ndërhyrje pedagogjike themi se:

Marrja gjuhësore për të vegjëlit që janë folës të lindur të greqishtes, ingranohen mjaft mirë e në kohën e duhur, brenda programeve të institucionalizuara shkollore për të kaluar nga njëra gjuhë në tjetrën, në rastin tonë tek shqipja.

Vështirësitë që dalin kalojnë falë përkushtimit pedagogjik të mësuesëve dhe metodave të përparuara bashkëkohore.

Mënyra e vetme, e përdorur përgjatë arsimimit të tyre është krahasimi shkallë-shkallë në të gjitha nivelet e studimit gjuhësor, nga fonetika deri te sintaksa.

Vëmendje të veçantë i duhet kushtuar kësaj disipline (sintaksës) për faktin se në këtë rrafsh dijesh linguistike mësohen rregullat e komunikimit shoqëror.

Vërejmë me bindje se në shumë tregues të ndërtimeve sintaksore: nga sintagma, fjalia dhe fraza, ka mjaft ngjashmëri midis dy gjuhëve, në mënyrë të veçantë tek struktura e njërive predikative të cilat quhen fjali njëshe, ku lejohen ndërtime me elipsë të kryefjalës, çështje që zgjidhet midis folësve duke u mbështetur në mbaresat foljore vetore.

Literaturë

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, *Gramatika I, II*, ASHSH, 1995.

Deutscher Guy, *La lingua colora il mondo, come le parole deformano la realta*, Bollati Boringheri, 2010.

Ferretti, F., *Alle origini del linguaggio umano – Il punto di vista evolucionistico*, Editori Laterza, 2018

Grimm Jacob, Schellinge Friedrich, *Sull'origine del linguaggio*, Edizioni Christian Marinotti, 2004.

Καζαντζάκης Ν., *Βίος και πολιτεία του Αλέξη Ζορμπά*, εκδόσεις ΕΛ. Καζαντζάκη, Αθήνα 1968.

King A. Kendall, Mackey Alison, *L'acquisizione linguistica, il Mulino, Child language Acquisition e Second Language Acquisition, in R.W. 2008.*

Shamku-Shkreli Ledi, *Shtatë vjet prolog*, botimet Çabej 2005.

Tullio de Mauro, *Dukuri të shqipes bashkëkohore*, botimet Çabej 2006.

Tullio de Mauro, *Che cos'è una lingua?*, editore Luca Sossella, 2008.

MSC. LONORA HYSOLLI

**UNIVERSITETI “FAN. S. NOLI” KORÇË
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GJUHËS DHE I LETËRSISË
lhysolli@unkorce.edu.al**

GJUHA DHE DISKRIMINIMI GJUHËSOR

Abstrakt

Gjuha është mjeti themelor e më i rëndësishëm i komunikimit ndërmjet njerëzve. Është sistem i krijuar e i zhvilluar historikisht, që shërben si një nga tiparet më themelore të një kombësie. Shkalla më e lartë e zhvillimit të një gjuhe është gjuha letrare (standarde), pra, gjuha e shkruar dhe e folur në tërësi në të gjitha sferat e veprimtarisë njerëzore dhe që është pranuar si e tillë nga shumica e përdoruesve të saj (anëtarët e një bashkësie gjuhësore). Ajo është institucionalizuar përmes organizmave që përcaktojnë, përhapin dhe detyrojnë rregullat shoqërore të komunikimit gjuhësor, si: shkolla, radioja, televizioni, shtypi, botimet, apo institucionet akademike dhe qendrat e specializuara për mbrojtjen e gjuhës, shoqatat, klubet e shërbimit gjuhësor etj. Njerëzit e kulturës dhe të shkencës përpiqen ta zotërojnë sa më mirë gjuhën standarde e të ndikojnë mbi të në mënyrë të vetëdijshme. Kjo quhet politikë gjuhësore (ose planifikim gjuhësor) dhe është e natyrshme për vetë rëndësinë jetësore që ka gjuha letrare (standarde) edhe për kombin shqiptar. Gjuha letrare ngrihet mbi dialektet për të formuar një sistem të vetin, me normë të njësuar për mbarë kombin. Pasi lind e formohet gjuha letrare kombëtare, dialektet futen në marrëdhënie me këtë variant të ri të gjuhës së përbashkët.

Gjatë procesit të të mësuarit të gjuhës shqipe në shkollë, ngrihen plot pyetje që duan përgjigje. A realizohet sa dhe si duhet ky proces marrëdhënior përmes kurrikulave shkollore për mësimin e gjuhës shqipe, që zhvillohen në tri nivelet e arsimit parauniversitar: AF, AMU, AML? Mos vallë ndodh një lloj diskriminimi gjuhësor-dialektor në planifikimin dhe realizimin e marrëdhënies mes dialekteve, si gurët e themelit të gjuhës standarde shqipe? A realizohet misioni dhe qëllimi i kurrikulës shkollore në AP lidhur me këtë marrëdhënie? Çfarë ndikon pozitivisht? Cilat janë problematikat që dalin e duhen zgjidhur?

Në këtë punim, përmes një analize të detajuar të mbështetur në hulumtim tekstesh shkollore të gjuhës shqipe që përdoren gjerësisht në shkollat tona, vëzhgime orësh mësimore e biseda me nxënës, prindër, mësues të gjuhës shqipe e drejtues shkollash apo specialistë të fushës, do përpiqemi të japim përgjigjet e këtyre pyetjeve.

Fjalë kyçe: AF, AMU, AML, gjuha letrare, ndikim pozitiv, kurrikula shkollore, politikë gjuhësore, problematika

Duket se nuk janë të rastësishëm nëntorët e Shqipërisë për historinë e saj e sidomos për identitetin kombëtar të përfaqësuar përmes gjuhës letrare kombëtare. Edhe kjo konferencë shkencore gjuhësore ndërkombëtare në kuadër të 50-vjetorit të themelimit të universitetit të Korçës, e mirëmbledhur për t'u zhvilluar pikërisht në nëntor, kur pak ditë na ndajnë nga 49-vjetori i mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, ngjarjes më kulmore në historinë e gjuhës shqipe duket se përkohë më së miri. Tematika e konferencës “Politika gjuhësore mbi pakicat në Ballkan, arritje dhe perspektiva”, nënkupton që pjesëmarrësit kanë zgjedhur të trajtojnë në kumtesat e tyre, çështje të rëndësishme gjuhësore, porë në këtë këndvështrim, që vjen si rezultat i zhvillimeve më të fundit të marrëdhënive të etnive dhe popujve në Ballkan, por jo vetëm.

Në përputhje me tematikën e sesionit, kumtuesit trajtojnë çështje rreth varieteteve gjuhësore, gjuhës në përdorim dhe probleme të edukimit. Punimi ynë lidhet me gjuhën dhe diskriminimin gjuhësor.

Në pamje të parë, kur themi gjuhë, nuk vjen ndonjë ngacmim negativ, pasi ndihet si diçka natyrale dhe e përligjur për t'u trajtuar. Ndërsa, te sintagma *diskriminim gjuhësor*, duket se vjen së brendshmi një reagim paksa ndryshe, sidomos me termin diskriminim (veçim, mënjanim, shmangie, shpërfillje).

Në këtë kumtesë, për ta sjellë sa më butë dhe real këtë reagim, do të përpiqemi të sjellim një dinamikë jo të panjohur të zhvillimit dhe të trajtimit të problemit që ngrihet: një lloj diskriminimi gjuhësor- dialektor në planifikimin dhe realizimin e marrëdhënies mes dialekteve, por të parë e studiuar mbi atë që ndodh realisht në mësimdhënien e gjuhës shqipe standarde dhe problematikat e dala në trajtimin dhe rolin që kanë dialektet në këtë proces.

Jemi përqendruar tek ky problem, pasi në përditshmëri, në arsimin parauniversitar, por pse jo dhe në arsimin e lartë, ndeshemi edhe me termin përkthim apo gjuhë veriore, për tekste të shkruara kryesisht në dialektin geg, gjatë studimit dhe analizës së teksteve letrare dhe jo vetëm, në lëndën e gjuhës shqipe. Duket si dalje nga fokusi i konferencës, por në këndvështrimin tonë, ky problem merr rëndësi. Në kushtet kur bashkësitë e ndryshme shoqërore përpiqemi t'i afrojmë sidomos në marrëdhëniet gjuhësore, kur priremi të kemi prurje veprash të ndryshme nga çdo fushë e jetës, të përkthyer në shqip, ku përkthyesit cilësorë padyshim njohin mirë gjuhën e shtetit të huaj nga po përkthejnë, na del si detyrë

njohja e mirë e gjuhës sonë jo vetëm atë letrare, standard, por edhe varietetet e saj, dialektet apo të folmet e saj.

Pa njohur mirë gjuhën amtare, nuk mund ta ndriçojmë e përparojmë atë përmes gjuhëve të tjera. Duhet lexuar, njohur, studiuar e analizuar mirë veprat dhe kryeveprat e dijetarëve të kombit krahas dijetarëve botërorë të çdo fushe, sepse vetëm kështu drita e diturisë përpara do na shpjerë...

Dihet që çdo gjuhë i përket një bashkësie gjuhësore të caktuar. Kështu edhe gjuha shqipe është gjuha e shqiptarëve, jo vetëm brenda kufijve administrativë të Shqipërisë, por kudo që ndodhen e jetojnë. Gjuha standarde shqipe është themeluar e ngritur me shumë mundim e sfida të shoqërisë brenda e jashtë trojeve shqiptare. Krijimi i saj ka bazën e vet historike e shoqërore. Ajo erdhi si rezultat i nevojës që ndjeu shoqëria shqiptare për të patur një mjet komunikimi shtetëror, zyrtar, të vetin, që do të ishte trajta e shkruar e njëjtë për të gjithë.

Sot, gjuha standarde shqipe flitet, përdoret dhe ka strukturë të arsyeshme, normë të thjeshtë dhe lehtësisht të mundshme për t'u përvetësuar jo vetëm nga shqiptarët, por edhe të huajt, të cilët për arsye të ndryshme bien në kontakt me të.

Kuptohet që kur flasim për shqipen e shekullit XXI, kemi parasysh një gjuhë, një komb dhe një kulturë shqiptare gjithëpërfshirëse. Udha e zhvillimit të shqipes së shkruar, edhe pse e nisur vonë, ka qenë e mbushur plot vështirësi e sfida që i kanë përballuar me aq dinjitet figurat më të shquara kombëtare.

Si periudha parakombëtare edhe ajo kombëtare meritojnë mirënjohjen më të madhe për arritjen dhe përmbledhjen e mesazhit: "Një gjuhë dhe një komb shqiptar". E kjo arritje duhet mbajtur fort, pa sjellë kthim pas, por vetëm duke e përparuar e duke e bërë dinjitoze përballë gjuhëve të tjera të kombeve të përparuara në qytetërim.

Këtë detyrë e kryejnë më së miri gjuhëtarët. Por gjuha, nuk është vetëm e tyre dhe vetëm për ta. Ajo është e gjithë bashkësisë shoqërore. I takon asaj të kujdeset për mirëmbajtjen e gjuhës së vet, ndërsa gjuhëtarëve, si pjesë e bashkësisë, të qëmtojnë problematikat, t'i diskutojnë ato mes tyre dhe me bashkësinë e të gjejnë zgjidhjet më të mira për to.

Studimi i gjithanshëm i gjuhës letrare të njësuar vazhdon të jetë një nga detyrat themelore të gjuhësisë shqiptare, e cila e vlerëson gjuhën si një element shumë të rëndësishëm të kulturës kombëtare. Për t'i ardhur në ndihmë praktikës

së përditshme gjuhësore, në radhë të parë shkollës, shtypit, shtëpive botuese, shkrimtarëve, gazetarëve, administratës dhe gjithë atyre që interesohen drejtpërdrejt për gjuhën, shteti dhe gjuhëtarët kujdesen të trajtojnë çështje të përgjithshme dhe të veçanta, për të zgjidhur probleme e për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të panumërta që dalin e shtrohen vazhdimisht. Mbështetja e gjuhës në përgjithësi dhe e gjuhës standarde në veçanti, në formën e saj më të hapur bëhet nëpërmjet dispozitave kushtetuese, përmes ligjeve, vendimeve dhe urdhëresave të caktuara shtetërore. Duke qenë qëndrim i hapur institucional shtetëror që mbahet ndaj gjuhës, pikërisht ky qëndrim është quajtur politikë gjuhësore. Ndërsa, ndërhyrja dhe mbështetja nga shteti dhe institucionet publike apo private për gjuhën zyrtare është quajtur planifikim gjuhësor.

Në çdo etapë të historisë njerëzore ka një lidhje të ngushtë midis gjuhës së shkruar dhe politikës gjuhësore të shoqërisë, sepse duke qenë tipari themelor i çdo bashkësie etnike dhe pasqyrimi më besnik i jetës së saj, është edhe trashëgimia më e rëndësishme e traditës shoqërore që lidh brezat e një epoke me zinxhirin e pandërprerë të tyre. Janë njerëzit e dijes, të shkencës, kulturës e të artit që me punën dhe shembullin e tyre, së bashku me masat e gjera të popullit, përpiqen ta zotërojnë sa më mirë këtë mjet, të ndikojnë mbi të, për ta bërë sa më të zhdërvjellët, të fuqishme e vepruese.

E përpunuar në mënyrë të vetdijshme, e normëzuar në shkallën më të lartë, e njëjtë dhe e detyrueshme për të gjithë pjesëtarët e kombit, me funksione shoqërore të gjithanshme dhe me një sistem të zhvilluar stilesht funksionale, është pra, gjuha standarde apo gjuha letrare kombëtare. E tillë është edhe shqipja, gjuha e shqiptarëve.

Ajo ngrihet dhe formohet mbi bazën e dialekteve, sepse lëndën gjuhësore e merr prej tyre, duke formuar një sistem mbidialektor me normë të njëjtë për të gjithë. Në bazë të saj qëndron një dialekt, por që nuk përputhet krejtësisht me të, të cilin zakonisht e përcaktojnë faktorët politikë e shoqërorë që veprojnë në kohën kur formohet gjuha letrare kombëtare, edhe pse gjuhësisht çdo dialekt ka mundësi dhe është i aftë për t'u ngritur në nivelin e saj. Shqipja ka në bazë tiparet fonetike e morfologjike me qenësore të dialektit tosk, por në sistemin leksikor, morfologjik e fonetik ka edhe plot tipare të dialektit geg. Pra, shqipja ka një

shtresë të madhe elementesh të përbashkëta të të dyja dialekteve që i përkasin çdo sferë të gjuhës dhe janë të shumta në numër.

Në këtë shtresë bëjnë pjesë jo vetëm tiparet që janë të njëjta nga forma dhe përmbajtja, por edhe tiparet të cilat nga forma dalin me dallime në dialekte, kurse nga përmbajtja janë të njëjta kudo. Këto janë të shumta në gjuhën shqipe.

Për të mos i hyrë një analize më të detajuar, të bërë ndër kohëra nga studiuesit e gjuhës, marrëdhëniet e gjuhës letrare kombëtare me dialektet e saj, janë të dyanshme, të kristalizuara, të qëndrueshme, por edhe në dinamizëm sipas zhvillimit të bashkësisë.

Kanë kaluar pothuaj 50 vite që shoqëria shqiptare ka krijuar një ekuilibër të qëndrueshëm të mësimit dhe përdorimit të gjuhës letrare kombëtare. Kjo është sërish një arritje e çmuar e shoqërisë, që duhet vlerësuar edhe për shkak të vazhdimësisë dhe përmirësimit të politikave gjuhësore.

Debatet e ndezura të dhjetëvjeçarit të fundit për rishikimin e gjuhës standarde, pasurimit apo përmirësimit të saj, mbase do të sjellin ndryshime në politikën gjuhësore të së ardhmes, por sa kohë kjo gjuhë u ka bërë ballë sfidave të ndryshimeve që ka pësuar shoqëria gjatë këtyre 50 viteve, tregojnë një maturi të saj dhe një zhvillim shumë të drejtë, të qëndrueshëm e të logjikshëm.

Po atëherë, pse gjithë kjo parantezë e gjatë? Çfarë nuk shkon?

Mësimi i gjuhës shqipe (sikundër i çdo gjuhe tjetër) fillon në marrëdhëniet me nënën, babain, familjarët, vazhdon në shoqëri, jashtë dyerve të shtëpisë dhe ajo njihet vetëm ecje para... Por mësimi i gjuhës standarde fillon i planifikuar, i studiuar, i strukturuar, sipas politikës gjuhësore kombëtare në klasën e parë të arsimit fillor e vazhdon pandërprerë klasë pas klase në tri nivelet e arsimit parauniversitar shqiptar: arsim fillor (AF, kl. 1-5), arsim i mesëm i ulët (AMU, kl. 6-9), arsimi i mesëm i lartë (AML, kl. 10-12), për të vazhduar gjatë gjithë jetës...

Përdoruesit e gjuhës standarde shqipe, padyshim që nuk mund të shmangen kurrsesi nga përdorimi i dialektit, apo të folmeve ku bëjnë pjesë. Standardi dhe dialektet vijnë paralelisht të përdoren, duke ndikuar tek njëri-tjetri, në mënyrë të pandërprerë.

Kjo duket edhe te testet mësimore, si burimi kryesor material i prekshëm nga përdoruesit e të gjitha moshave shkollore, por edhe nga të interesuar të tjerë.

Nga hulumtimi i përmbajtjes së teksteve shkollore të lëndës së gjuhës shqipe, në tri nivelet e shkollimit të arsimit parauniversitar kemi një panoramë të tillë:

□ Në arsimin fillor (AF, shkalla 1 dhe 2 e kompetencave)

Shkalla e përdorimit të gjuhës standarde është e lartë, pasi këtu hidhen themelet e shëndosha të shqipes zyrtare. Tek të gjitha kompetencat, në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar; mbizotëron gjuha standarde. Si tek tekstet letrare, tek ato joletrare dhe tek njohuritë gjuhësore, klasë pas klase vihet re se shumë pak jepen informacione rreth dialekteve të shqipes, edhe pse në përditshmëri nxënësit janë përdoruesit e tyre. Tekstet e ndryshme për nga lloji, gjinia, forma, volumi, etj, duket se janë përzgjedhur prej hartuesve kryesisht në gjuhën letrare ose nga baza - toskërisht. Zënë më pak vend krijimet e shkrimtarëve veriorë të Shqipërisë. Madje vërehet se reforma e alartekstit në arsim ka sjellë më shumë prurje të reja nga letërsia e huaj bashkëkohore për fëmijë.

Në linjat “Të lexojmë”, “Të dëgjojmë”, “Të flasim”, autorët më të përzgjedhur shqiptarë janë N. Frashëri, Gj. Fishta, N. Mjeda, K. Kristoforidhi, S. Frashëri, B. Dedja, O. Grillo, S. Goliku, N. Prifti, V. Kikaj, A. Gajtani, L. Gurakuqi, A. Mamaqi, Asdreni, I. Kadare, F. Konica, Migjeni etj.

Në linjat gjuhësore, informacioni kulturor gjuhësor rreth dialekteve është i paktë. Me rreth 1-2 orë në klasën e katërt e diku rreth 3-4 orë në klasën e pestë, ku te linja “Njohuri për gjuhën”, jepet informacion rreth dialekteve dhe gjuhës standarde si dhe punohen disa ushtrime të thjeshta që i aftësojnë nxënësit të bëjnë dallimet në rrafshin fonetikor, gramatikor e leksikor.

Kur punohen tekstet letrare, informacionet dialektore plotësohen nga rubrika “Fjalor” dhe nga vetë mësuesit.

Ku qëndron problemi dhe vështirësia në një panoramë të tillë?

Nga vëzhgimet e bëra në orët e mësimit, nga informacioni i marrë prej pyetësorëve me nxënësit dhe mësuesit, si dhe nga bisedat e lira me nxënës, mësues e prindër në shkolla të ndryshme në jug apo në veri të vendit bie në sy se: Tekstet mësimore të arsimit fillor, japin shumë pak informacione rreth dialekteve të shqipes (edhe orët e planifikuara janë të limituara). Në përzgjedhjen e teksteve letrare, mbizotërojnë tekste të autorëve toskë, e ka më pak tekste të autorëve gegë... (ky mund të shihet si një diskriminim i autorëve gegë)

Mësuesit gegë e kanë më lehtë shpjegimin e teksteve si të autorëve toskë, sepse janë më pranë gjuhës standarde, edhe të autorëve gegë, pasi ata dhe nxënësit janë banorë të arealit geg. Mësuesit toskë e kanë shumë lehtë shpjegimin e teksteve të autorëve toskë, pasi vetë ata dhe nxënësit janë banorë të arealit tosk, si dhe gjenden më pranë gjuhës standarde, por tek tekstet letrare apo joletrare të autorëve gegë ndeshin vështirësi në rrafshin fonetik, po edhe gramatik e leksikor.

Shpesh, poezitë apo tekste të tjera në gegërisht vetëm lexohen (nga mësuesi ose edhe nxënës të ndryshëm), apo dëgjohen si interpretime të incizuara. Ndodh që tekste të tilla edhe të anashkalohe ose të lihen në dorën e nxënësve e kujdesit të prindërve të tyre. Këtu duket se kemi një “diskriminim” të nxënësve toskë, e të teksteve geqe...

Problemi: Ekziston një lloj diskriminimi dialektor e rrjedhimisht edhe gjuhësor, që duhet të shmanget në të ardhmen. Në një vështrim të parë duket se diskriminohet gegërishtja. Kjo lidhet me sasinë e teksteve geqe që trajtohen. Në vështrim më të thellë, janë nxënësit dhe mësuesit toskë që duket se diskriminohen po për të njëjtën gjë. Këtu ata privohen nga njohja dhe analiza e veprave të autorëve gegë.

Vështirësia: Prirjet individuale të mësuesve për ta zgjidhur problemin apo për ta thelluar atë, si dhe planifikimi i pabarabartë i teksteve letrare apo joletrare të autorëve gegë si dhe rubrikave më specifike për këtë qëllim.

□ Në arsimin e mesëm të ulët (AMU, kl 6-9, shkalla 3 dhe 4)

Nga hulumtimi i bërë në tekstet e gjuhës shqipe në përdorim më të gjerë, (kryesisht nga shtëpitë botuese “Albas” dhe “Pegi”) vihet re se tanimë ka një prirje për të shtuar informacionin rreth gjuhës standarde dhe dialekteve, duke planifikuar pak më tepër orë të linjave të ndryshme (lexojmë dhe flasim, dëgjojmë, njohuri për gjuhën). Këtu planifikohen më tepër ushtrime të larmishme për nxënësit. Vihet re një integrim më cilësor i njohurive gjuhësore me ato letrare, sa i takon marrëdhëniet standard-dialektor. (P.sh. fragmenti i komedisë, “Karnavalet e Korçës” te Gjuha Shqipe 8, “Pegi”, fq 96-98, apo fragmenti “Trashëgimia” i dramës “Kondili argjandit” nga M. Camaj po aty.

Më të plotë e më të qartë, përdorimin e gjuhës standarde, rëndësinë e saj, lidhjen me dialektet e japin tekstet e gjuhës shqipe kl. 9, “Albas” e sidomos “Pegi”, Tiranë, 2021.

Autorët më të spikatur janë: Konica, Fishta, Kuteli, Kristoforidhi, Mit'hat Frashëri, N. Frashëri, F. Arapi, I. Kadare, M. Camaj, At Zef Pllumi, pra, sërish, autorët toskë janë më të trajtuar.

Ajo që bie në sy në lidhje me qëllimin e punimit është një prirje për të analizuar më cilësisht dialektet në tekste të figurave më të spikatura historike e kulturore gege e toske, si një krahasim e ballafaqim i përzgjedhur qëllimisht. (Fjalimi i Ismail Qemalit, fq 177, “Pegi”,2021; “Ca këshilla mbi artin e shkrimit” nga F. Konica, “Pegi”, 2021, fq 164-165, apo “Gjuha Shqype” e Gj. Fishtës, ushtrimi 5 faqe 227 etj.)

Po çfarë thonë nxënësit dhe mësuesit?

Duke qenë se tanimë nxënësit janë më të rritur, edhe përgjegjshmëria e tyre për arritje më cilësore duket se vjen më e ndërjegjshme. Ata nuk mjaftohen vetëm me leximin e tyre të pavarur në tekst, por në epokën digjitale, ata shfrytëzojnë si burim informacioni edhe internetin. Madje, tanimë mund të punojnë më mirë edhe me fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, apo duke frekuentuar edhe bibliotekat (familjare, shkollore apo të qytetit). Më tepër të interesuar për gegërishten janë nxënësit toskë.

Sa u takon mësuesve, sërish është formimi shkencor, por dhe prirja individuale e mësuesit për cilësinë e mësimdhënies. Duket se puna e mësuesve toskë është paksa më e vështirë se e mësuesve gegë.

Mësuesit e gjuhës shqipe në AMU dhe AML, cilësohen si specialistë, ndaj dhe kanë përgjegjësi më të madhe në këtë drejtim. Mësuesit e arsimit fillor e kanë më të ngarkuar misionin e tyre për të hedhur themelet e shëndosha në çdo fushë të dijes dhe edukimit.

□ Në arsimin e mesëm të lartë (AML, kl. 10-12), shkalla V

Reformat në arsim zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme, bazuar edhe në nevojat që dalin herë pas here për ndryshime. Një ndryshim i tillë ka ndodhur në periudhën 2013-2021, ku, përveç futjes së kurrikulës me kompetenca, kemi edhe ndarjen e gjuhës shqipe nga letërsia në AML, duke u programuar nga 2 orë në javë për secilën. Kjo erdhi si pasojë e kërkesës nga nxënësit, mësuesit dhe prindërit që njohuritë të zhvilloheshin pa u përzier.

Megjithatë, duke u fokusuar te çështjet dhe problematikat e kumtesës, vihet re se në lëndën e gjuhës shqipe, vetëm në klasën 10 planifikohen disa orë mbi dialektet

e shqipes dhe gjuhën standarde, tek kompetenca lëndore *Njohuri mbi komunikimin*, si dhe tek *njohuritë mbi leksikun*, ku trajtohen shumë pak (1-2 orë) fjalët dialektore, krahinore, etj. Në klasën e 11 e 12 nuk jepet asnjë informacion. Në kl. 12 te rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës kemi: -Evidentojnë dallimet gjuhësore mes dialekteve; -Vlerësojnë pasurinën që vjen prej dialekteve. Këto rezultate duken se lidhen me tekstet ilustruese sipas tematikave dhe ushtrimeve të planifikuara, ku spikatin autorë si: Camaj, Frashëri, Noli, Poradeci, Spasse, Kadare, Migjeni, J. Xoxa, Dh. Xhuvani, Fishta, R. Qosja, Xh. Spahiu, P. Marko, Konica, Agolli, M. Zeqo, K. Trebeshina, B. Xhaferi, Çabej, Koliqi, si dhe autorë të huaj me tekste të përkthyer në shqip të përshtatura me gjuhën standarde. Pra, edhe në tekstet e përzgjedhura për t'u përdorur si material analize në përmbajtje të kompetencave të lëndës dhe fushës, autorët veriorë, me tekstet e tyre në gegërisht, janë më të pakët në numër.

Në lëndën e letërsisë, në përputhje me tematikat e ndryshme që trajton lënda klasë pas klase 10,11,12, bazuar në kronologjinë e zhvillimit të tyre, vihet re se autorët shqiptarë më të trajtuar përmes teksteve të tyre në gjini e lloje të ndryshme letrare sipas drejttimeve letrare të zhvilluara në kohëra janë: Kadare, Mjeda, Poradeci, Camaj, Migjeni, E. Haxhiademi, S. Frashëri, Z. Serembe, G. Dara, F. Shiroka, De Rada, N. Frashëri, Fishta, D. Agolli, A. Shkreli. Pra sërish mbizotërojnë autorët toskë...Përsa i takon teksteve letrare të autorëve të huaj, ato vijnë të përkthyer kryesisht në standard ose sipas dialektit të përkthyesit shqiptar, por të pajisur me komente e fjalor shpjegues.

Është e natyrshme të pranojmë që këto janë figurat më të spikatura të letrave shqipe dhe ne me ta krenohemi brenda e jashtë kufijve, në kohëra, duke përfshirë edhe humanistët shqiptarë që janë themeluesit e shqipes së shkruar, të shqipes së pasur, të larmishme, që u ka rezistuar shekujve.

Nxënësit punojnë kryesisht të pavarur me tekstet e autorëve shqiptarë, toskë apo gegë, por ata përdorin termin “përkthim”, kur bie fjala për kthimin e një teksti gegërisht në gjuhën standarde (bëhet fjalë për në shkollat në jug). Nga vështirësitë që hasin, priren përgjithësisht ta anashkalojnë këtë punë. Madje, edhe kur e kryejnë nuk kanë dëshirë, ose e përdorin si justifikim. Ndodh që edhe mësues të bëhen palë, ose të mjaftohen thjesht me leximin apo me punën e pavarur

të nxënësve. Vetëm të apasionuarit pas letërsisë u kushtojnë kohën dhe vëmendjen e duhur.

Përfundime

Konferenca shkencore ndërkombëtare “Politika gjuhësore mbi pakicat në ballkan arritje dhe prespektiva”, mbajtur në mjediset e universitetit “Fan S. Noli”, Korçë më 12.11.2021, vë në fokus të saj Ballkanin dhe shtetet e tij me politikat përkatëse gjuhësore për integrim e marrëdhënie të shumicës me pakicën. Në këtë kuadër edhe ky punim synoi të trajtojë në mënyrë joshteruese padyshim, integrimin dhe marrëdhëniet mes gjuhës standarde shqipe dhe dialekteve të saj, si e tëra me pjesët, parë me këndvështrimin diskriminues (veçues, përjashtues, “bullizues”) në planifikim dhe përmbajtje të teksteve shkollore të lëndës “Gjuha shqipe” kl 1-12, në arsimin parauniversitar.

Gjuha dhe diskriminimi gjuhësor janë dy koncepte tepër gjithëpërfshirëse në rrafshet e tematika. Por në kohën kur priremi të bëhemi ballkanas, europianë apo globalistë të mirë, harrojmë dashur apo padashur çështje të rëndësishme identitare. Ne duam të njohim gjuhën, historinë, kulturën, traditat, fenë, zakonet e gjithçka tjetër të fqinjëve apo të popujve të qytetëruar. Priremi të mësojmë gjuhë të huaja për të qenë qytetarë të botës. Në gjuhë të tyre, në origjinal, duam ta marrim emocionin e shkrimtarëve më të mirë të botës.

Bëjmë shumë mirë. Është prirja që i rri për shtat zhvillimeve të brendshme e të jashtme shqiptare, por ne ende nuk e njohim sa dhe si duhet gjuhën tonë. Bëhet fjalë si për gjuhën zyrtare, standarde, edhe për dialektet e saj. Shkrimtarët tanë, më të vyerit në kohëra, kanë shkruar në gjuhën e nënës, në gjuhën e vendlindjes. Edhe bota njësoj duhet të na njohë ne, në gjuhën tonë e me ngjyrat e saj. Shqiptarët, me gjuhën e tyre, vlerësohen të jenë rreth 13 milionë folës, ku pjesa më e rëndësishme ndodhet në Ballkan: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, por edhe në Serbi, Mal të Zi, Kroaci, Bosnjë, Hercegovinë, Slloveni, Rumani, Bullgari etj. Areali shqipfolës shtrihet në kontinentin europian, por edhe jashtë tij, në kontinente të tjera.

Ne prezantohemi si shqiptarë, me gjuhën shqipe, por padyshim me ngjyrimin dialektor apo krahinor që e bartim ngado.

Pikërisht kjo marrëdhënie gjuhë standarde -dialekt, një simbiozë e përjetshme është hulumtuar në përmbajtjen e teksteve shkollore të gjuhës shqipe, të cilat në

një të ardhme ndoshta mund të unifikohen sikundër abetarja mbarëkombëtare e realizuar së fundmi. Në këtë prirje duhet ruajtur një marrëdhënie e balancuar informacionesh në standard e dialekte, ku parësore mbetet padiskutim gjuha standarde.

Mbetet sfidë për hartuesit e teksteve një arritje e plotë e këtij balancimi, e cila do të bazohet natyrisht tek politika gjuhësore kombëtare në përmirësim.

Është mirë që tekstet letrare apo joletrare ardhur në origjinal nga gegërishtja, të shoqërohen me sa më tepër komente apo shpjegime në standard, pse jo dhe krahasuar me toskërishten (sikundër ndodh edhe me tekste në gjuhë të huaj, ku krahas origjinalit, vjen përkthimi, me fjalor shpjegues e komente)

Sfida u takon padyshim universiteteve e pedagogëve që përgatitin mësues për gjuhën shqipe dhe letërsinë, për një formim sa më cilësor edhe në kuadrin e njohjes sa më të plotë të dialekteve të shqipes, të grupeve të të folmeve apo varieteteve të tjera të gjuhës.

Janë mësuesit ata që duhet të marrin përsipër realizimin e këtij misioni nga veriu në jug, nga lindja në perëndim të vendit tonë, por dhe kudo ku mësohet e flitet gjuha shqipe. Mësuesit tanë nuk duhet të jenë robër interpretues tekstesh, imitues të librave të mësuesit. Ata janë fuqia dhe zëri i shqipes së bukur, të pastër, të pasur, që vjen e larmishme dhe e plotë përmes dialekteve të saj. Duke përdorur një gjuhë sa më të thjeshtë e të kuptueshme, duhet të arrijnë që nxënësit mos shprehin: “ne themi kështu, ata thonë ndryshe”, duke nënkuptuar dy gjuhë të ndryshme e jo dy varietete të së njëjtës gjuhë. Përmes ekipeve lëndore në shkolla, me pjesëmarrje të gjerë, mund të realizohen tema të tilla që të shërbejnë si kualifikime të brendshme.

E padyshim, i takon shtetit që në kushtet e një zhvillimi të tillë të shoqërisë shqiptare drejt Ballkanit të hapur, drejt integritit në BE apo më tej, të ndërmarrë reforma përmirësuese sa i takon politikës gjuhësore, por edhe në drejtim të problematikës që trajtuam në këtë kumtesë. Politikat zbatohen vertikalisht nga lart-poshtë, por problematikën, sfidat dhe propozimet shtrohen vertikalisht nga poshtë-lart. Ndoshta zëri i bashkësisë folëse, në veri apo jug do të dëgjohet për përmirësimin e kurrikulës shkollore, sidomos në lidhje me riorganizimin e planeve dhe programeve lëndore, ku mund të rishihet shpërndarja e orëve, tek linjat gjuhësore e letrare që sjellin prurje rreth dialekteve të shqipes.

Burimet dhe bibliografia:

- Gjokutaj, M., Rrokaj, Sh., Abetare, ABC-“ Shkronjë pas shkronje”, Tiranë 2018. (f. 98, f 104)
- Petro, R., Shehri, Dh., Pepivani, N., Gjuha shqipe 2, Albas, Tiranë, 2016. (f. 80, 82, 83, 84, 96, 258)
- Petro, R., Shehri, Dh., Pepivani, N., Gjuha shqipe 3, Albas, Tiranë, 2017. (f. 241, 254)
- Gjokutaj, M., Shuteriqi, L., Rrokaj, Sh., Babasuli, J., Gjuha shqipe 4, Pegi, Tiranë, 2018. (fq. 191)
- Petro, R., Pepivani, N., Shehri, Dh., Gjuha shqipe 5, Albas, Tiranë, 2019, (f. 61, 62, 70, 71)
- Gjokutaj, M., Rrokaj, Sh., Shuteriqi, L., Basho, J., Gjuha shqipe 5, Pegi, Tiranë, 2020.
- Petro, R., Pepivani, N., Jubani, A., Sula, L., Çerpja, A., Metani, I., Gjuha Shqipe 6, Albas, Tiranë, 2019.
- Petro, R., Jubani, A., Sula, L., Çerpja, A., Metani, I., Çepani, A., Gjuha Shqipe 7, Albas, Tiranë, 2016.
- Gjokutaj, M., Rrokaj, Sh., Koleci, F., Lami, A., Pema, E., Gjuha shqipe 8, Pegi, Tiranë, 2021.
- Petro, R., Jubani, A., Çerpja, A., Sula, L., Metani, I., Çepani, A., Gjuha shqipe 9, Albas, Tiranë, 2019.
- Hamiti, S., Marashi, A., Shehri, Dh., Letërsia 10, Albas, Tiranë, 2020.
- Kalo, V., Kapllani, M., Neni, M., Balliçi, M., Gjuha shqipe 10, Filara, Tiranë, 2016.
- Marashi, A., Hamiti, S., Shehri, Dh., Letërsia 11, Albas, Tiranë, 2021.
- Mëniku, L., Petro, R., Jubani, A., Gjuha shqipe 11, Albas, Tiranë, 2021.
- Akademia e Shkencave e Republikës të Shqipërisë, Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës I, Tiranë, 1973.
- Kryeziu, B., Shqipja e sotme, këndvështrim teoriko-praktik, SHBLU, Prishtinë, 2011.
- Shkurtaç, Gj., Kultura e gjuhës, SHBLU, Tiranë, 2006
- Shkurtaç, Gj., Peshë e fjalës shqipe, UFO Press, Tiranë, tetor 2009

Thomai, J., Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme, Botimi i Akademisë së Shkencave, Tiranë, 2001.

Shoqata e Gjuhës Shqipe e Kosovës., Kulturë e gjuhës 2, Prishtinë, 2013.

Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, Fakulteti i Filologjisë., Shqipja e sotme dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët e tjera, “Meshari”, Prizren, 2019.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Universiteti "Fan S. Noli"

Politika gjuhësore mbi pakicat në ballkan : arritje dhe perspektiva :
akte të konferencës shkencore ndërkombëtare / Universiteti "Fan S.
Noli", UT. Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë. – Korçë : Universiteti
"Fan S. Noli", 2022

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-4731-1-0

1.Sociolinguistika 2.Gjuhët e Ballkanit 3.Gjuha shqipe
4.Politika gjuhësore 5.Konferenca

811.135/.18(497) '272 (062)

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

**POLITIKA GJUHËSORE MBI
PAKICAT NË BALLKAN:
ARRITJE DHE PERSPEKTIVA**

